Deficiti i llogarisë korrente shënoi vlerën 338 milion Euro gjatë gjysmës së parë të vitit 2018. Ai u ngushtua me 18.2% në terma vjetorë dhe qëndron në nivelin 5.4% ndaj PBB-së nominale.

Ndikimet kryesore në ngushtimin e deficitit korrent kanë buruar nga të ardhurat dytësore dhe shërbimet. Në rastin e të ardhurave dytësore, rritja vjetore e prurjeve të remitançave shënoi

10.6%. Në të njëjtin drejtim, kanë ndikuar edhe prurjet e transfertave zyrtare të cilat shkuan për asistencë teknike. Gjithashtu, eksporti i shërbimeve u zgjerua me rreth 7.5% në terma vjetorë ndikuar nga “shërbimet e inputeve fizike” dhe “shërbimet e udhëtimit”. Eksporti i mallrave shënoi gjithashtu rritje të konsiderueshme ndikuar nga zgjerimi i shpejtë i prodhimit të energjisë elektrike. Nga ana tjetër edhe importi i mallrave shënoi rritje të shpejtë, duke ndikuar në zgjerimin e deficitit tregtar në mallra. Në tërësi, deficit i përgjithshëm tregtar në mallra dhe shërbime u ngushtua me 2.4% në terma vjetorë gjatë gjysmës së parë të vitit 2018.

Hyrjet neto në llogarinë kapitale shënuan 39.6 milion Euro gjatë gjysmës së parë të vitit 2018. Këto u pakësuan nga vlera prej 49.0 milion Euro, të regjistruar në gjysmën e parë të vitit të kaluar. Pozicioni neto i llogarisë financiare dëshmon për rënie të flukseve hyrëse neto me rreth 2.6% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2017. Kjo erdhi kryesisht si rezultat i zgjerimit të mjeteve vendase jashtë vendit, pavarësisht rritjes së shpejtë të investimeve direkte neto. Deficiti korrent u financua kryesisht nga flukset jo-borxh-krijuese.

Rezervat ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm

Borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë shënoi 8,111 milion Euro në fund të gjashtëmujorit të parë 2018. Niveli i borxhit qëndron në raportin 66.8% ndaj PBB-së nominale dhe u zgjerua me rreth 3.2% në terma vjetorë. Sipas disagregimit sektorial, qeveria e përgjithshme zotëron 43.4% të borxhit total; korporatat depozitë-marrëse mbajnë 17.5% të totalit; sektorët e tjerë 17.3% të totalit, IHD përfaqësojnë rreth 21.1% dhe autoriteti monetar 0.7% të totalit. Sipas instrumenteve, zëri “investimet e tjera” në formën e “huave” dhe “monedhave dhe depozitave” përbën pjesën më të madhe të borxhit ndjekur nga IHD (huatë ndërkompani). Sipas maturitetit, borxhi afatgjatë përbën 80.0% të totalit dhe është zgjeruar me rreth 3.8% në terma vjetorë.

Në fund të tremujorit të tretë 2018, rezerva ndërkombëtare shënonte 3,108 milion Euro, duke u zgjeruar me rreth 10.0% në terma vjetorë. Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervës qëndrojnë në nivele optimale. Raporti i rezervës ndaj borxhit të jashtëm afatshkurtër qëndron në nivelin 164.2%, dukshëm më i lartë se niveli kritik prej 100%. Rezervat janë të mjaftueshme për të mbuluar 6.7 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Politika monetare

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë synon arritjen e objektivit për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve nën regjimin e politikës monetare të cilësuar si “shënjestrimi i inflacionit”. Procesi i vendimmarrjes mbështetet tek devijimi i inflacionit nga objektivi prej 3% në periudhën afatmesme.

Dobësia ciklike e ekonomisë dhe presionet e ulëta inflacioniste kanë kërkuar ndjekjen e një politike monetare akomoduese gjatë viteve të fundit. Kjo politikë synon të mbështesë rritjen ekonomike dhe kthimin e inflacionit brenda objektivit përgjatë horizontit efektiv të politikës monetare. Norma e interesit qëndron në një nivel rekord të ulët prej 1.00% që nga qershori 2018. Stimuli monetar ka kontribuar në zvogëlimin e kostove të financimit dhe mbështetjen e konsumit dhe investimeve të agjentëve ekonomikë, ndërkohë që komunikimi i hapur përmes orientimit të publikut për mbajtjen e normave të ulëta të interesit (forward guidance) ka kontribuar në zvogëlimin e primit të rrezikut.

Banka e Shqipërisë pret që aktiviteti ekonomik të zgjerohet, duke ushqyer rritjen e presioneve të brendshme inflacioniste. Inflacioni pritet të kthehet në objektivin 3.0% në vitin 2020. Në përputhje me këto pritshmëri, politika monetare pritet të nisë normalizimin gradual gjatë afatit të mesëm.

Banka e Shqipërisë ndjek një regjim të kursit të luhatshëm të këmbimit, ku kursi i këmbimit përcaktohet nga kërkesa dhe oferta për monedhat e huaja. Banka e Shqipërisë është prezente në tregun e brendshëm valutor me qëllim ndryshimin e nivelit të rezervave ndërkombëtare, sipas një kalendari vjetor të publikuar paraprakisht.

Kuadri i politikës monetare dhe regjimi i kursit të këmbimit nuk pritet të pësojnë ndryshime të rëndësishme në periudhën afat-mesme. Banka e Shqipërisë synon të përmirësojë dhe të përshtatë përdorimin e instrumenteve të politikës monetare në përputhje me rrethanat dhe kufizimet ligjore. Përdorimi i orientimit të publikut mbi kahun e pritur të politikës monetare (forward guidance) do të vijojë të jetë në paketën e instrumenteve të politikës monetare.

Prioritetet e Bankës së Shqipërisë në fushën e Kriterit Ekonomik janë:

- Forcimi i mekanizmit të transmissimit të politikës monetare nëpërmjet vijimit të zbatimit të masave për uljen e nivelit të kredive me probleme; për rritjen e përdorimit të monedhës vendase në tregun financiar; dhe për mbështetjen e zhvillimit të tregut sekondar të letrave me vlerë.
- Përmirësimi i koordinimit të politikës monetare me politikën makroprudenciale dhe me atë fiskale.
- Përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe analitike të nevojshme për vendimmarrjen e politikës monetare.

Inflacioni

Inflacioni gjatë vitit 2018 ka shënuar vlera më të larta dhe më pak të luhatshme krahasuar me vitin 2017. Në terma mesatarë, inflacioni për dhjetëmujorin e parë të vitit 2018 është 2.1%, nga 2% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Presionet e brendshme inflacioniste janë rritur gradualisht ndërkohë që ekonomia po afrohet drejt potencialit të saj, tregjet e punës po

përmirësohen dhe bizneset po përdorin më mirë kapacitetet e tyre prodhuese. Presionet e jashtme inflacioniste vijnë të jenë ulëta, në reflektim të mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut kundrejt euros. Ndikimi i këtij faktori është balancuar disi nga rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare nga muaji qershor.

Inflacioni bazë ka shfaqur një prirje të lehtë rritëse, por ai mbetet nën mesataren e vet historike duke dëshmuar për një ekonomi që operon ende poshtë potencialit. Ai është rritur në rreth 1% gjatë vitit 2018, në krahasim me rritjen 0.9% gjatë vitit 2017 (10-mujori i parë i vitit).

Projeksionet tona tregojnë se zgjerimi i vazhduar i kërkesës agregate do të rrisë shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë, duke shtuar presionet e brendshme inflacioniste. Inflacioni parashikohet të rritet gradualisht, duke konvergjuar në objektivin tonë prej 3% brenda vitit 2020.

Politika fiskale

Politika fiskale në periudhën afatmesme 2019-2021 do të jetë e orientuar drejt konsolidimit fiskal, në përputhje me rregullat fiskale të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit. Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik janë thelbësorë për reduktimin e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike.

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej -1.9% të PBB-së për 2019, nga 2% i programuar për vitin 2018; nivel prej -1.6% të PBB në 2020; dhe -1.2% në vitin 2021. Njëkohësisht targeton në vijimësi një balancë primare pozitive dhe në rritje për vitet 2019-2021, respektivisht 0.5% në 2019 nga 0.3% i targetuar në buxhetin 2018; 0.9% në 2020; dhe 1.5% në vitin 2021. Po ashtu edhe balanca korrente, pra diferenca midis investimeve publike dhe deficitit (huamarrjes) vjetore, targetohet në nivele të larta dhe në rritje graduale përgjatë horizontit afatmesëm. Respektivisht balanca korrente në vitin 2019 targetohet në nivelin 3.1% të PBB, ndërsa për vitin 2018 ajo programohet të jetë 3.3%; më tej targetohet në nivelin 3.3% në vitin 2020 dhe 3.6% në vitin 2021.

Ky konsolidim fiskal synon që niveli i borxhit publik si raport ndaj PBB-së të vijojë trajektoren e sigurtë rënëse të nisur që në vitin 2016. Borxhi publik pritet që të bjerë rreth nivelit 65.5% të PBB në 2019, 63.7% në 2020 dhe më tej në 59.9% në vitin 2021. Në të njëjtën kohë, ky kuadër fiskal akomodon politika buxhetore për të mbështetur rritjen ekonomike dhe për të kompensuar efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Investimet publike në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme parashikohen të mbahen rreth 5% të PBB-së, nivel i cili vlerësohet si optimal për të ushqyer kërkesën agregate në afat të shkurtër dhe për ta zhvendosur rritjen potenciale ekonomike në një nivel më të lartë në afat të mesëm dhe të gjatë.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimulimin e sektorin privat. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen dhe për këtë arsye efekti shtrëngues i konsolidimit fiskal pritet të kompensohet.

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomik, reformave fiskale të ndërmarra, efekteve të pritshme të përmirësimit administrativ, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vitet në vijim (2019 -2021) parashikohen të rriten mesatarisht me rreth 6.6% në çdo vit, ndërsa shpenzimet totale të buxhetit parashikohen të rriten me rreth 5.6%. Në periudhën afatmesme, të ardhurat totale të buxhetit llogariten të jenë mesatarisht rreth 28% e PBB-së, ndërsa shpenzimet totale të jenë rreth 29% e PBB-së.

Mbështetja e rritjes gjithë-përfshirëse ekonomike kërkon një angazhim për të trajtuar sfidat strukturore që lidhen me mjedisin e biznesit, sigurinë energjetike dhe kapitalin njerëzor.

Borxhi publik

Borxhi Publik gjatë vitit 2018 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me buxhetin e planifikuar për vitin 2018 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB).

Në përputhje me buxhetin e vitit 2018, huamarrja do të mundësojë rifinancimin e borxhit ekzistues dhe mbulimin e nevojave të qeverisë për likuiditet.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2018 do të menaxhohet reduktimi i mëtejshëm i ekspozimit ndaj risqeve të borxhit të brendshëm, si edhe mbajtja nën kontroll e kostove. Në drejtim të reduktimit të risqeve në portofolin e borxhit të brendshëm do të kushtohet rëndësi zgjatjes së jetëgjatësisë së borxhit, si edhe reduktimit të peshës së titujve me norma interesi të ndryshueshme.

Kontribut të rëndësishëm në realizimin e objektivave strategjike të vitit 2018 edhe atyre afatmesme ka pasur edhe emetimi i Eurobond-it, shoqëruar me procesin e blerjes mbrapsht (buyback) të një pjese të Eurobondit ekzistues që maturohet në vitin 2020. Transaksioni i Eurobond-it do të shërbejë: a) për të menaxhuar nevojat për likuiditet të vitit aktual si edhe të viteve pasardhëse; b) për të reduktuar riskun e rifinancimit; c) për të mbajtur nën kontroll kostot që mund të materializohen në periudhën afatmesme si rezultat i rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare përtej pritshmërive; si edhe d) për të ulur presionin për hua në tregun e brendshëm.

Kostot e borxhit për vitin 2018 pritet të rezultojnë me një tendencë të moderuar rritëse, kryesisht të ndikuar nga rritja e normave të interesit të bonove të thesarit përgjatë vitit 2017. Megjithatë, pavarësisht rritjes së kostove në vlerë absolute, kostot për njësi të borxhit rezultojnë të jenë në minimumet historike.

Për sa i përket zhvillimeve në tregun primar, kërkesa për tituj shtetërorë, megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e bazuar kryesisht tek sektori bankar, gjatë vitit 2018 ka qenë e kënaqshme dhe është shoqëruar me rritje në drejtim të individëve.

Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë, si edhe hedhjen e hapave për zhvillimin e tregut sekondar, përgjatë vitit 2018 janë realizuar objektiva të tilla si:

- Reduktimi i numrit të ankandëve dhe konsolidimi i shumave të shpallura me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në treg;
- Komunikimi i vazhdueshëm me aktorët kryesorë të tregut të titujve shtetërorë;
- Zbatimi i Projektit Pilot për Obligacionin 5 vjeçar Referencë⁸.

Gjatë vitit 2019 edhe në vijim, përveç reduktimit të konsiderueshëm të ekspozimit ndaj risqeve, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet aktiviteteve të cilat do të kenë në fokus zhvillimin e mëtejshëm të tregut të titujve shtetërorë.

Në periudhën afatmesme, mesatarisht mbi 80% e nevojave të përgjithshme për financim do të realizohen nëpërmjet burimeve të brendshme. Niveli i financimit të brendshëm në terma neto do të synohet të mbahet i qëndrueshëm duke mos tejkaluar kapacitetet optimale të tregut (rreth 20-22 miliard Lek në vit).

Duke qenë se normat e interesit prirën të qëndrojnë ende në nivele të ulëta, financimi i brendshëm do të orientohet kryesisht në drejtim të titujve afatgjatë me norma interesi fikse, me qëllim reduktimin e risqeve me kosto sa më të ulët. Titujt afatshkurtër kryesisht do të shërbejnë për të rifinancuar maturimin e titujve ekzistues, si dhe menaxhimin aktiv të nevojave për likuiditet.

Financimi i huaj do të shërbejë si një plotësues i mirë i burimeve të brendshme dhe përveç të tjerash edhe si optimizues i kostove të borxhit. Ky financim do të mbështetet: i) në huatë me terma pjesërisht të buta, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga Qeveria për zhvillimin e vendit; ii) në huatë me terma të buta të akorduara nga institucionet ndërkombëtare financiare për të mbështetur politikat zhvillimore të vendit; dhe iii) në instrumentet financiare të tregjeve të kapitalit mbi baza oportuniste dhe

⁸https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Titujt_shteterore/Titujt_reference/http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2096/UDHEZIM%20nr.%2021,%20date%2022.6.2018.pdf

kryesisht për të mundësuar një menaxhim aktiv të detyrimeve të borxhit dhe optimizuar risqet e portofolit.

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut primar vendas dhe hedhja e hapave për zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë është një tjetër objektiv afatmesëm, realizimi i të cilit do të shoqërohet me aktivitete të cilat do të kenë në fokus:

- Zhvillimin e kurbës së yield-it në drejtim të titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë nëpërmjet krijimit të madhësive benchmark dhe reduktimit të fragmentimit të kërkesës;
- Përshtatjen e politikave të huamarrjes (përfshirë shitjen, parablerjen dhe shkëmbimin e titujve shtetërorë) me kushtet e tregut dhe kërkesën për tituj të caktuar;
- Rritjen e transparencës nëpërmjet konsultimit të vazhdueshëm me aktorët kryesorë të tregut dhe raportimit e publikimit periodik në kohë të të dhënave të borxhit;
- Përmirësimin dhe standardizimin e kuadrit rregullator për emetimin e titujve shtetërorë;
- Analizimin e rezultateve të projektit pilot për emetimin e obligacioneve 5 vjeçare referencë dhe shqyrtimin e mundësisë në bashkëpunim me aktorët kryesorë të tregut për shtrirjen e këtij projekti edhe tek titujt e tjerë afatgjatë.
- Diversifikimin dhe zgjerimin e bazës së investitorëve.

Politikat makroekonomike miks

Miksimi i politikave aktuale makroekonomike është i përshtatshëm për krijimin e premisave të nevojshme për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë. Banka e Shqipërisë vijon të ndjekë një politikë monetare lehtësuese. Krahu lehtësues i politikës monetare pritet të ruhet në afatin e mesëm. Politika fiskale vijon të jetë konsoliduese me qëllim uljen e nivelit të borxhit publik në nivele të qëndrueshme.

Politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë synon të ruajë stabilitetin e çmimeve në afatin e mesëm, duke krijuar një ambient të përshtatshëm ekonomik. Politika monetare lehtësuese ka vepruar në kahun kundërciklik si mbështetje për ekonominë, duke krijuar kushte të përshtatshme financimi dhe nxitje për rritjen e konsumit dhe të investimeve private. Rritja e aktivitetit ekonomik pritet të vijojë e qëndrueshme edhe në vitin e ardhshëm, duke e sjellë ekonominë më pranë nivelit potencial. Inflacioni pritet të rritet gradualisht dhe ti afrohet objektivit 3.0% të Bankës së Shqipërisë në vitin 2020. Politika fiskale pritet të jetë konsoliduese, kushtëzuar nga niveli i lartë i borxhit publik. Qeveria shqiptare ka vijuar të marrë hua në tregjet ndërkombëtare nëpërmjet emetimit të një Eurobond-i të ri, duke ulur presionet tek normat e interesit në tregun e brendshëm dhe duke rritur hapësirat për kreditimin e sektorit privat.

Në përputhje me mandatin ligjor dhe pa cenuar objektivin kryesor, Banka e Shqipërisë ka marrë disa masa në funksion të stabilitetit financiar dhe funksionimit të tregjeve. Në bashkëpunim me qeverinë është hartuar plani kombëtar për uljen e kredive me probleme, i cili përfshin një sërë ndryshimesh ligjore. Këto masa kishin për qëllim të reduktonin nivelin e kredive me probleme

nëpërmjet krijimit të nxitjeve për fshirjen e huave të humbura dhe ristrukturimin e kredive me probleme. Raporti i kredive me problem ndaj totalit është në një prirje rënëse, duke zbritur në 12.9% në shtator 2018 nga mbi 20% në vitin 2016. Gjithashtu, në bashkëpunim me autoritete të tjera publike, Banka e Shqipërisë ka hartuar një strategji për rritjen e përdorimit të monedhës vendase në sistemin financiar dhe në ekonomi. Në vijim të zbatimit të strategjisë, janë miratuar ndryshime rregullative të cilat synojnë të dekurajojnë huadhënien në valutë dhe të nxisin përdorimin e monedhës vendase në transaksionet financiare.

Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, rritja vjetore ekonomike ka shënuar një rritje relativisht të lartë në tremujorin e dytë të vitit 2018, në nivelin 4.32%, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Politikat makroekonomike janë nxitur nga nevoja për të ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe fiskal në periudhën afatmesme.

Funksionimi i tregjeve të produkteve

Mjedisi i biznesit

- Këshilli Ekonomik Kombëtar, një platformë që institucionalizon diskutimet dhe bashkëveprimet midis institucioneve qeveritare dhe komunitetit të biznesit, është tërësisht funksional. Në vitin 2017 ka realizuar 2 takime, ku çështjet kryesore të diskutuara ishin: ndihma shtetërore dhe paketa fiskale;
- Këshilli i Investimeve i krijuar në bazë të VKM-së Nr. 294, datë 08.04.2015 “Për themelimin e Këshillit Kombëtar të Investimeve”. Këshilli është një platformë e krijuar nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e BERZH-it për të intensifikuar dialogun midis qeverisë dhe sektorit privat, për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të promovuar qeverisjen e mirë. Deri më tani ka realizuar 14 takime (2015 – 2018) duke u përqendruar në: reformën derregullatore, informalitetin, formalizimin e bujqësisë, aksesin në financim, e-permission, apelin administrativ, inspektimin tatimor për rimbursimin e TVSH-së, incentivat për investime në Shqipëri/Ballkan, procedurat doganore, cilësinë e aftësive për punë, formalizimin në Turizëm, kuadrin ligjor të investimeve, etj (www.investment.com.al).
- AIDA ka ngritur shërbimin (Help Desk) në kuadër të paketës incentivuese të krijuar nga Qeveria, e cila i dedikohet përmbushjes së nevojave të SME-ve, duke përfshirë ndërmarrjet “Fason”. Nëpërmjet këtyre shërbimeve informohen, këshillohen dhe ndihmohen një numër i madh i SME-ve, të lidhura me kërkimet e tregut, planet e biznesit, partnerët e biznesit, panairët ndërkombëtare, takimet B2B, etj.

Qeveria ka marrë masa për reformimin dhe modernizimin e sistemit tatimor, me qëllim rritjen e performancës në mbledhjen e të ardhurave buxhetore. Krijimi i kadastrës fiskale dhe kalimi në

sistemin e vlerës për pasuritë e paluajtshme janë hapa të rëndësishëm për modernizimin e sistemit.

Procedurat e administratës tatimore janë thjeshtuar për të zvogëluar barrën administrative dhe për të rritur pajtueshmërinë. Është miratuar një Kod i ri Doganor, si dhe një sërë ndryshimesh të tjera që synojnë nxitjen e industrisë dhe sektorëve jetikë të vendit. Në të njëjtën kohë, është ndërmarrë një fushatë e gjerë kundër informalitetit në ekonomi, punës së zezë dhe evazionit fiskal, ku janë arritur rezultate inkurajuese në reduktimin e aktiviteteve ekonomike të paligjshme, si dhe në rritjen e ndjeshme të të punësuarve të ligjshëm që paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kontributin e tatimit mbi të ardhurat personale nga paga. Reformat e ndërmarra në fushën e legjislacionit dhe administratës tatimore, të kombinuara me reformat strukturore në përgjithësi, kanë rritur performancën në mbledhjen e të ardhurave fiskale të shtetit. Të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitet 2016 dhe 2017 janë realizuar pa pasur nevojën e rritjes së nivelit të taksave dhe tarifave. Në 2017-en, të ardhurat e buxhetit të shtetit arritën në 27.8% të PBB-së, ndërsa në vitin 2013 ato ishin sa 24.2% e PBB-së. Në të njëjtën kohë, reformat e planifikuara dhe masat fiskale të ndërmarra synojnë përmirësimin e klimës së investimeve në vend. Pritet që të ardhurat të rriten për shkak të rritjes së niveleve të pajtueshmërisë dhe përpjekjeve për të përmirësuar performancën e administratës tatimore dhe doganore në mbledhjen e taksave. Synohet që të ardhurat buxhetore të rriten mbi 28% të PBB-së.

Privatizimi

Procesi i privatizimit mbetet një prioritet, veçanërisht në sektorët strategjikë, duke synuar tërheqjen e kapitalit të huaj dhe vendas që do të kishte një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik.

Ofertat për privatizimin e 100% të aksioneve në INSIG S.A. u hapën më 10 mars 2016. U paraqitën katër ofertues. Oferta më e lartë prej 16.1 milion euro u prezantua nga EUROSIG S.A. Oferta ishte pak më e lartë se vlerësimi i aksioneve të INSIG-it të bëra nga konsulenti BDO Albania sh.pk. Komisioni i Vlerësimit të Ofertës bëri vlerësimin e ofertave sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 18.06.2015 “Për përcaktimin e formës dhe formulës për privatizimin e aksioneve të INSIG S.A.”. Pas vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 23.03.2016 “Për miratimin e procedurës së tenderimit për shitjen e paketës së aksioneve (100%) në pronësi të shtetit në INSIG SA Tiranë dhe deklarimin e EUROSIG SA si fitues i ofertave”. Kontrata për shitjen e aksioneve të shoqërisë aksionare INSIG S.A., është nënshkruar me datë 1.06.2016, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe EUROSIG S.A.

Në gjysmën e parë të vitit 2016, shitja e 8 aseteve shtetërore solli gjithsej 93,686,844 lekë (rreth 680,000 euro). Shitja e aseteve kryhet përmes një procedure ankandi publik dhe pronarët e mëparshëm të tokës kanë përparësi për blerjen e aseteve. Katër nga këto asete janë blerë nga

pronarët e tokës që ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes. Janë përgatitur dosjet e privatizimit të 20 aseteve të tjera shtetërore të përfshira në paketën e tretë të privatizimit. Paketa e tretë e privatizimit është pjesë e Planit të Veprimit për Privatizimin e Aseteve për periudhën 2016-2020, nënshkruar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, më 29.04.2016.

Në 2016 u privatizuan 14 asete që sollën në total 110,115,128 Lekë. Disa nga këto asete u blenë nga pronarët e tokës që ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes.

Në 2017 u privatizuan 31 asete dhe kuota shtetërore në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), në një total prej 145,039,455 Lekë. Shitja e aseteve është kryer përmes procedurave të ankandit publik dhe ish-pronarët e tokës kanë pasur prioritet në blerjen e aseteve. Disa nga këto asete janë blerë nga pronarët e tokës që ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes.

Gjithashtu gjatë këtij viti, Plani i veprimit për privatizimin/likuidimin e shoqërisë shtetërore në sektorët jo strategjikë 2017 – 2020 u miratua nga ish Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në trajtën e dokumentit Nr. 2564, datë 29.03.2017.

Lidhur me planet për Albpetrol sh.a., Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", përcakton ndarjen e aktivitetit prodhues nga aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror. Për këtë qëllim, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 848, datë 12.07.2016 "Për ngritjen e shoqërisë "Albgaz" sha dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar i aksioneve të shoqërive "Albpetrol" sha dhe "Albgaz sha".

Sipas këtij vendimi, kompania Albgaz sha u krijua si një operator i kombinuar i cili ushtron veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Gazit Natyror. Kapitali fillestar i Albgaz sha u vendos në vlerën 359,068,000 Lekë. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë) është autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar i 100% të aksioneve në kompaninë e re, Albgaz sha, ndërsa Ministria e Energjisë dhe Industrisë (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) përfaqëson shtetin si aksionar i kompanisë Albpetrol sha. Marrëdhënia ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Albgaz sha do të rregullohet sipas Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror".

Albgaz sha. u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numrin unik të identifikimit (NIUS) L71306034U.

Gjatë periudhës Janar-Shtator të vitit 2018, janë privatizuar 10 asete shtetërore duke realizuar 59,300,000 lekë dhe 81,700,000 Bono Privatizimi (në lekë), pra në total 141,000,000 lekë. Shitja e aseteve bëhet nëpërmjet procedurës së ankandit publik ku ish-pronarët e tokës kanë të drejtën e parablerjes. Katër nga këto asete janë blerë nga pronarët e tokës që ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Referuar ndryshimeve të fundit ligjore dhe strukturore, me Urdhrin Nr. 88 datë

21.03.2018 është bërë ndryshimi i “Planit të Veprimit për privatizimin e aseteve shtetërore, për periudhën 2016 – 2020”, për vitet 2018-2020.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë me Urdhrin Nr. 64, datë 22.02.2018 ka miratuar “Paketën e pestë me 60 (gjashtëdhjetë) objekte shtetërore për t’u privatizuar gjatë vitit 2018”, pjesë e Planit të Veprimit për Privatizimin e Aseteve Shtetërore për periudhën 2016 – 2020 (lartpërmendur).

Gjithashtu, gjatë periudhës Janar-Shtator 2018, është përgatitur dokumentacioni i vlerësimit për 30 asete shtetërore, pjesë e paketës së pestë (urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, i lartpërmendur), të cilat do t’i nënshtrohen procedurave të shitjes.

Procesi i privatizimit për periudhën në vijim, 2019-2020, do të bëhet sipas parashikimeve në planet e veprimeve, të raportuara.

Funksionimi i tregut financiar

Stabiliteti financiar

Sistemi financiar

Zhvillime në sektorin jobankar

Gjatë periudhës⁹ Institucionet Financiare Jobanka (IFJB) shënuan zgjerim të totalit të aktiveve dhe tregues të mirë të performancës financiare. Deri në fund të muajit qershor të vitit 2018, në sistemin financiar kanë operuar 30 IFJB të angazhuara kryesisht në fushën e mikrokredisë, kreditimit, leasing-ut, faktoring-ut, parasë elektronike etj. Peshën kryesore e zënë IFJB-të që kryejnë aktivitet kreditues, ndjekur nga ato që kryejnë pagesa dhe transferta. Aktivitetet e IFJB shënuan 47 miliardë lekë. Ky nivel ka shënuar rritje si në terma gjashtëmujori (+5.8%) ashtu dhe vjetorë (+9.8%). Rezultati financiar i IFJB-ve rezultoi pozitiv në +1.2 miliardë lekë dhe në rritje krahasuar me një vit më parë (+0.7 miliardë lekë), dhe kapitalizimi i veprimtarisë ishte në nivele të përshtatshme.

Ecuria e aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit ka qenë pozitive dhe në zgjerim si në terma gjashtëmujorë, ashtu edhe vjetorë. Rritja e investimeve në sektorin bankar në formën e llogarive rrjedhëse, depozitave dhe kredia neto përcaktuan sjelljen e aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit për periudhën. Rezultati financiar i SHKK-ve rezultoi pozitiv, por më i ulët se një vit më parë, në nivelin 44 milionë lekë. Kreditë neto për anëtarët dhe investimet në banka përfaqësojnë

⁹ Qershor 2018

zërat kryesorë të aktiveve të këtyre institucioneve. Në qershor 2018 tregu numëronte 13 shoqëri aktive të kursim-kreditit.

Aktiviteti i shoqërive të sigurimit ka shënuar rritje. Deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2018 numërohen 11 shoqëri sigurimi të licencuara që kryejnë aktivitet të jetës dhe jo-jetës dhe 1 shoqëri risigurimi. Aktivitetet e këtyre institucioneve shënuan rritje vjetore me 4.1%, në 30.5 miliardë lekë. Investimet në banka zënë peshën kryesore në bilancin e shoqërive të sigurimit, rreth 30% për periudhën. Primet e shkruara bruto¹⁰, me kontributin kryesor nga primet e jo-jetës (92%), që përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit të shoqërive të sigurimit, u zgjeruan me 3.9% në terma vjetorë.

Aktiviteti i fondeve të investimit¹¹ u tkurr krahasuar me fundin e vitit 2017 si rezultat i rënies së nivelit të investimeve në letrat me vlerë të qeverisë. Vlera neto e aktiveve ra në nivelin 66.5 miliardë lekë nga 72 miliardë lekë. Në sistemin financiar shqiptar bëjnë pjesë 4 fonde investimi aktive. Aktivitetet e fondeve të investimit investohen kryesisht në bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në Lek, dhe të tjera në Euro.

Fondet e Pensioneve Private Suplementare¹² kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre gjatë periudhës. Në Shqipëri veprojnë 3 fonde pensionesh private vullnetare. Aktivitetet e këtyre fondeve shënuan vlerën 2 miliardë lekë ose 16% më shumë se niveli i aktiveve në fund të vitit 2017. Aktiviteti i fondeve të pensionit dominohet nga investime në titujt e borxhit të qeverisë.

Zhvillime në sektorin bankar

Sektori bankar shqiptar ka ndryshuar strukturën e tij gjatë vitit 2018.¹³ Në përgjithësi, ecuria e treguesve makroekonomikë dhe zhvillimet në mjedisin ekonomik në përgjithësi siguruan mbështetje të mirë për veprimtarinë e sistemit financiar. Në terma të treguesve të qëndrueshmërisë financiare, sektori bankar u karakterizua nga rritja e niveleve të kapitalizimit, kryesisht të nxitura nga rënia e vlerës së ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, për shkak të ndryshimeve rregullatore. Raporti i përfitueshmërisë dhe likuiditetit vlerësohet në nivele të larta. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar ndaj sektorit jo-bankar vlerësohet të jetë i ulët, ndërsa ecuria e sektorit bankar mbetet kritike për veprimtarinë dhe qëndrueshmërinë e sektorit jo-bankar.

¹⁰ AMF, Buletini Statistikor “Tregu i Sigurimeve: Janar-Qershor 2018”, publikuar më 25 korrik 2018.

¹¹ AMF, “Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, 30 Qershor 2018, publikuar 27 gusht 2018.

¹² AMF, Raporti Statistikor “Tregu i Pensioneve Private Vullnetare”, 30 Qershor 2018, publikuar më 16 gusht 2018.

¹³ Të dhënat më të fundit i përkasin Shtator 2018. Sektori bankar shqiptar përbëhet nga 14 banka: 3 banka janë me kapital shqiptar dhe 11 banka me kapital të huaj. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e 6 Shtator 2018, aprovoi bashkimin me përthithje ndërmjet bankës Intesa SanPaolo sh.a dhe Bankës Veneto sh.a dhe gjithashtu bashkimin ndërmjet Bankës Amerikane të Investimeve (ABI) dhe Bankës Kombëtare të Greqisë (BKG). Asnjë nga bankat e huaja nuk operon si degë në vendin tonë.

Cilësia e kredisë vazhdoi të përmirësohej, edhe pse me një ritëm të ngadaltë për shkak të shlyerjes; ristrukturimit të kredive (zhvendosje në klasa me cilësi më të lartë); dhe fshirja e kredive të humbura. Reduktimi i kredive me probleme u shoqërua me uljen më të shpejtë të provigjionimit të kredive me probleme, duke ndikuar në rënien e raportit të mbulimit të provigjoneve. Mbulimi me kolateral i kredive u përmirësua për shkak të zgjerimit të kredive të kolateralizuara me pasuri të tjera.

Raporti i aktiveve të sistemit financiar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) vlerësohet në 107.8% duke qenë rreth 2.7 pikë përqindje më i ulët se në fund të vitit 2017. Kontributin kryesor në këtë rënie, e ka dhënë rënia e peshës së sektorit bankar me 2.3 pikë përqindje, në nivelin 97.1% të PBB-së. Gjatë periudhës, aktivet e sektorit bankar rezultuan 1,427 miliardë lekë, duke u tkurrur me 1.3%. Kontributin kryesor në rënien e tepricës së bilancit e dhanë veprimet me thesarin e ato ndër-bankare, kredia dhe depozitat, mbi të cilat ndikimi pakësues i mbiçmimit të kursit të këmbimit ka qenë më i rëndësishëm. Në marrëdhënien me subjektet jo-rezidente, sektori bankar ka ruajtur nivelet e larta të pozicionit kreditor neto.

Aktivitetet e sektorit bankar shqiptar janë rritur në terma vjetorë me 3.04% në shtator 2018 në krahasim me 4.3% të një viti më parë. Ngadalësimi i normës së rritjes së aktiveve është pasojë e tkurrjes së aktiviteteve kryesore, por kryesisht të veprimeve me klientë (ose aktivitetit kreditues). Investimet e sektorit bankar në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë përbënin rreth 23% të totalit të aktiveve të sektorit bankar.

Portofoli i kredisë në shtator 2018 arriti vlerën 586 miliardë lekë. Ai ra me 3.5% (21 miliardë lekë) krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndikuar kryesisht nga përmirësimi i cilësisë së aktiveve. Gjatë vitit, fshirjet e kredive të humbura llogariten në 10.2 miliardë lekë dhe për shkak të këtij zhvillimi, kreditë e klasifikuara si “të humbura” ranë me 33% në terma vjetorë. Duke përjashtuar ndikimin e fshirjeve, totali i kredive do të ishte ulur me 1.9% (në vend të 3.5%). Kredia në valutë (56% e totalit të kredive) ra me shpejtësi, me 4.6% në terma vjetorë dhe në monedhën vendase me 2.1%. Kredia për korporatat jo-financiare ishte 6.1% më e ulët se një vit më parë, në një kohë kur kreditë për individët u rritën me 4.4%. Përsa i përket strukturës së maturitetit, efekti në rënien vjetore të tepricës së kredisë i atribuohet kryesisht kredisë afatshkurtër, e cila ra me 10%, ndërsa kreditë afatmesme u ulën me 3.8% dhe kreditë afatgjata u rritën pak me 0.6% (vjetore).

Aktiviteti bankar vijoi të financohej krejtësisht nga depozitat, të cilat përbënin rreth 80% të totalit të aktiveve. Raporti kredi-depozitë është rreth 50%. Vëllimi i depozitave në monedhë vendase u rrit me 1.4% (në terma vjetorë) në shtator 2018 për shkak të rritjes së lehtë të normave mesatare të interesave të depozitave në monedhë vendase. Depozitat në valutë të huaj kanë pasur një kontribut pozitiv, por me ritme të ngadalta krahasuar me monedhën vendase (0.9% në shtator 2018, ndryshimi vjetor nominal). Varësia e sektorit bankar në burimet e jashtme të financimit është i kufizuar. Pozicioni neto i sektorit bankar ndaj jo-rezidentëve mbeti në mënyrë të konsiderueshme në anën e kreditimit dhe u zvogëlua pak gjatë periudhës rreth 0.5% në vit. Huamarrja nga grupet e bankave mëmë u zvogëlua. Pjesa më e madhe e detyrimeve përbëhet nga

detyrimet ndaj grupeve bankare mëmë, kryesisht në formën e linjave të kreditit. Pjesa e përdorur e linjave të kredisë ka rënë në nivelin prej 0.6 miliardë lekësh nga 0.9 miliardë lekë në shtator 2017.

Kapitalizimi i sektorit bankar në shtator 2018 u vlerësua i kënaqshëm. Shfuqizimi i masës kundërciklike mbi rritjen e kapitalit për investime ndaj jo-rezidentëve në valutë dhe tkurrja e kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë çoi në rënien e aktiveve të ponderuara me rrezikun në tremujorin e tretë të vitit 2018. Kapitali rregullator u rrit për shkak të injektimit të kapitalit dhe rezultatit financiar pozitiv. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit u ngjit në 18.2% kundrejt 16.4% një vit më parë, i nxitur nga rënia më e shpejtë e aktiveve të ponderuara me rrezik (-8.1%), ndërsa kapitali rregullator u rrit (+2.2%) në terma vjetorë si rezultat i përmirësimit të rezultatit financiar. Niveli i aktiveve të ponderuara me rrezik arriti në 798 miliardë lekë. Aktivët e ponderuara më rrezik për rrezikun e kredisë janë ulur me -2.6% kryesisht si rezultat i zvogëlimit të ekspozimeve ndaj institucioneve të mbikëqyrura dhe ekspozimeve me rrezik të lartë. Kërkesat për kapital për rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional u rritën me rreth 1.8% dhe 1.1% në terma vjetorë.

Rezultati neto financiar, pavarësisht vlerave pozitive, u zvogëlua në terma vjetorë për shkak të humbjeve më të mëdha nga instrumentet financiare dhe shpenzimet operative, por shpenzimet e provigjioneve ishin më të ulëta në krahasim me vitin e kaluar. Në shtator të vitit 2018, treguesi i kthimit nga aktivet (RoA) dhe kthimit nga kapitali (ROE) - treguesit e përfitueshmërisë - ishin respektivisht në nivelin 1.3% dhe 12.9%, nga 1.6% dhe 16.3% të një viti më parë. Cilësia e portofolit të kredisë u përmirësua lehtësisht gjatë vitit 2018, kryesisht nga fshirjet, shlyerjet dhe ristrukturimet. Raporti i RKP-së ndaj totalit të kredive bruto ra në 12.9% në shtator 2018 nga 14.8% vitin e kaluar. Raporti i kredive me probleme neto ndaj kapitalit rregullator rezultoi në nivelin 18% në shtator 2018 nga 17% vitin e kaluar.

Sektori bankar shfaqet i mbrojtur nga rreziku i drejtpërdrejtë i luhatjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit dhe normave të interesit. Pozicioni neto i hapur i këmbimit valutë në bilanc ndaj kapitalit rregullator (në nivelin 5.6%) dhe pozicioni i tyre “në blerje” sugjeroi ekspozim të kufizuar ndaj zhvlerësimit të kursit të këmbimit. Megjithatë, ekspozimi ndaj rrezikut indirekt të tregut nga huamarrja e pambuluar në valutë mbetet relativisht e lartë. Kreditë e tilla të pambrojtura në valutë të huaj përbëjnë rreth 28.4% të totalit të kredive (për T3 2018).

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar mbetet i fortë. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit shfaqet i ulët. Në fund të shtatorit 2018, aktivët likuide përbënin 33.5% të totalit të aktiveve të sektorit bankar nga 29% vitin e kaluar.

Sektori bankar në Shqipëri ka kapital prudent dhe rezerva likuiditeti që mund të akomodojnë tronditje të forta të shkaktuara nga zhvillimet e pafavorshme makroekonomike të brendshme dhe të jashtme. Rezultatet e testeve të stresit tregojnë se sektori bankar mbetet i mirëkapitalizuar dhe me performancë të mirë në skenarë që përmbajnë supozime me probabilitet më të lartë të

ndodhjes. Në skenarët më ekstremë, bankat individuale dhe sektori bankar do të duhet të rrisin kapitalin.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të veprimtarisë

Në lidhje me rreziqet e veprimtarisë me të cilat përballet sektori bankar, Banka e Shqipërisë vlerëson si më poshtë:

- Përmirësimi në cilësinë e kredisë vijoi, ndonëse me ritme më të ulëta. Pakësimi i kredive me probleme është shoqëruar me uljen më të shpejtë të rezervave për rrezikun e kredisë (provigjioneve), duke sjellë uljen e raportit të mbulimit të tyre me provigjione. Mbulimi me kolateral është përmirësuar për shkak të zgjerimit të kredive të kolateralizuara me kolateral të ndryshëm nga pasuria e paluajtshme. Procesi i uljes së kredive me probleme lehtësohet nga rritja më e qëndrueshme ekonomike dhe përvoja e fituar e bankave lidhur me mbledhjen dhe ristrukturimin e tyre, por rënia e vlerave të fshirjeve mund të sugjerojë një rënie të ndikimit të këtij faktori në ecurinë e procesit të përmirësimit të kredisë dhe të theksojë nevojën për të rritur përpjekjet në drejtim të formave të tjera të zgjidhjes së kredive me probleme. Gjithashtu, bankat duhet të vlerësojnë me kujdes dhe të provigjionojnë në mënyrë proaktive ekspozimet e kreditit që mund të kenë në juridiksione të huaja, të cilat përballen, apo mund të përballen, me luhatshmëri të treguesve ekonomikë e financiarë. Këta faktorë mund ta bëjnë më sfidues procesin e uljes së kredive me probleme në afat të shkurtër.
- Rreziku i likuiditetit në veprimtarinë bankare mbetet i ulët. Raportet e aktiveve likuide, në lekë dhe valutë, ndaj detyrimeve afatshkurtra, janë ndjeshëm mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullator. Burimi kryesor i financimit të veprimtarisë së bankave mbeten depozitat, që zënë gati 80% të detyrimeve dhe që mbulojnë gati dy herë vëllimin e kredive të sektorit. Në strukturën e burimeve të financimit të sektorit bankar, vijon rritja e depozitave pa afat dhe e llogarive rrjedhëse, kundrejt rënies së depozitave me afat dhe kontributi i bizneseve në rritjen e depozitave është rritur në krahasim me atë të individëve. Ritheksojmë se struktura aktuale e burimeve të financimit, kufizon aftësinë e sektorit bankar për të financuar projektet më afatgjata, të cilat lidhen kryesisht me investimet e familjeve dhe ndërmarrjeve, duke ulur eficiencën e veprimtarisë së tij. Kjo dukuri është e lidhur edhe me faktorë strukturorë të tregut financiar, të cilët vështirësojnë gjetjen e burimeve më afatgjata të financimit. Sidoqoftë, përpjekjet për të ofruar instrumente financiare që tërheqin burime më të qëndrueshme të financimit, duhet të jenë të vazhdueshme.
- Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut, ndonëse ka ardhur në rënie gjatë periudhës, mbetet i rëndësishëm. Ekspozimet ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të kursit të këmbimit, nuk treguan ndryshime të rëndësishme gjatë periudhës. Portofoli i kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit zbriti në 24.2% të totalit të tepricës së kredisë, ku bizneset vijnë të mbajnë rreth 2/3 e vlerës. Në lidhje me ndikimin e lëvizjeve në normën e interesit, sektori bankar mbetet i ekspozuar ndaj luhatjeve të normës së interesit. Të dhënat tregojnë që ndikimi i drejtpërdrejtë është i moderuar, në kushtet kur pozicionet e hapura në bilanc midis aktiveve dhe pasiveve të

ndjeshme ndaj normës së interesit, në raport me kapitalin rregullator të sektorit, janë të kufizuara. Ndikimi i tërthortë i rrezikut të normës së interesit mbetet i rëndësishëm, pasi në kushtet kur në portofolin e kredisë mbizotërojnë ato me normë interesi të ndryshueshme dhe kur vlerat e spread-ve të normave të interesit janë në nivele të ulëta historike, rritet madhësia e ndikimit të një korrektimi të mundshëm të normave të interesit në aftësinë paguese të huamarrësve, në periudhën afatmesme. Në mjedisin aktual me norma të ulëta të interesit, të dhënat për ecurinë e aktiveve me rrezik dhe për afatet mesatare të maturimit të aktiveve, tregojnë se përgjithësisht sektori bankar nuk ka shfaqur rritje të preferencës për investime me tipare më të larta të rrezikut në dy vitet e fundit.

- Harta e stabilitetit financiar, indekset e materializimit dhe të akumulimit të rrezikut sistematik dhe indeksi i stresit financiar, përgjithësisht tregojnë rreziqe të kontrolluara për stabilitetin financiar. Kontribut pozitiv në këtë drejtim, kanë dhënë rritja ekonomike, ulja e normës së papunësisë, ecuria e kursit të këmbimit, kontrolli i niveleve të borxhit publik dhe përmirësimi i disa treguesve të sektorit bankar që lidhen kryesisht me kapitalizimin dhe likuiditetin e tij. Nga ana tjetër, kontribut negativ kanë dhënë ngadalësimi i rritjes së depozitave, tkurrja e kredisë dhe ulja e marzhit neto të interesave në sektorin bankar. Përgjigjet e bankave në vrojtimin përkatës, tregojnë se ato nuk patën ndryshime të rëndësishme në perceptimin e rreziqeve sistematike gjatë periudhës dhe pritshmëritë mbeten përgjithësisht pozitive.

Politika makroprudenciale

Në përputhje me dokumentin e Strategjisë së Politikës Makroprudenciale, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar metodologjitë dhe ka përmirësuar bazën e nevojshme të të dhënave, të cilat mundësojnë vlerësimin e treguesve sinjalizues për ecurinë e rreziqeve sistematike dhe mbështesin procesin e vendimmarrjes për zbatimin e instrumenteve të caktuara makroprudenciale. Për këto të fundit, ka nisur procesi i konsultimit me industrinë bankare dhe palët e tjera të interesuara, për kuadrin rregullativ që lejon përdorimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit. Përgatitja e këtij kuadri i përshtatet fazës aktuale të ciklit financiar, ndihmon në vendosjen e një mekanizmi që zbut luhatshmërinë e ciklit financiar përgjatë zhvillimeve të ardhshme ekonomike dhe përfaqëson një përafrim të rëndësishëm me standardet ndërkombëtare të fushës.

Sektori bankar vijoi të shfaqë një trend të qëndrueshëm në drejtim të shpërndarjes dhe përdorimit të burimeve financiare. Kjo u pasqyrua edhe në Indeksin Herfindahl, i cili mat nivelin e përqendrimit në sektorin bankar. Treguesit e përqendrimit, të matur nga Indeksi Herfindahl, për totalin e aktiveve, depozitave dhe huave, kanë dëshmuar për një përqendrim relativisht të lartë në sektorin bankar në terma të aktiveve, depozitave dhe më pak për kreditë. Megjithatë, ka një shpërndarje pak më të mirë të peshave në treg gjatë viteve të fundit që rrjedhimisht tregon rritjen e konkurrueshmërisë.

Tabela 8. Indeksi i përqendrimit Herfindahl i aktiveve, kredive dhe depozitave.

Treguesi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
----------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------

HI_aktive	0.15	0.14	0.14	0.15	0.15	0.14	0.14	0.15	0.15	0.15	0.15
HI_depozita	0.17	0.15	0.16	0.16	0.15	0.14	0.14	0.14	0.14	0.15	0.15
HI_kredi	0.11	0.11	0.11	0.12	0.12	0.12	0.12	0.12	0.13	0.13	0.13

Tabela. Hua me probleme, në përqindje.

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Raporti i huave me probleme	6.64	10.48	13.96	18.77	22.49	23.49	22.8	18.22	18.27	13.2	12.9

Tabela. Diferenca e normave të interesit.

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Spread i normave të interesit (mesatarja e normave të kredisë dhe depozitave)	5.69	6.81	5.96	5.6	5.4	6.1	5.89	5.67	4.76	5.13	5.02

Tabela: Treguesit kryesorë të përfitueshmërisë, në përqindje (kumulative).

Ratios	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Të ardhura nga interesi/aktiveve mesatare që sjellin të ardhura (1)	8.1	8.11	7.78	7.73	7.31	6.28	5.72	5.2	4.71	4.47
Shpenzime interesi/pasive mesatare që shkaktajnë shpenzime (2)	4.06	3.78	3.57	3.72	3.42	2.14	1.29	0.94	0.69	0.65
Marzhi neto i interesave (NIM) {(1)-(2)}	4.04	4.32	4.2	4.01	3.88	4.15	4.42	4.23	3.92	3.73

Funksionimi i tregut të punës

Tregu i punës po përmirësohet vazhdimisht duke reflektuar një aktivitet më të mirë ekonomik.

Në tremujorin e dytë 2018, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 12,4 %. Krahësuar me tremujorin e dytë të vitit 2017, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me

1.5 pikë përqindje. Krahastuar me tremujorin e parë 2018, shkalla zyrtare e papunësisë pësoi një rënie prej 0.1 pikë përqindje.

Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë është 22.6%. Krahastuar me tremujorin e dytë të vitit 2017, shkalla e papunësisë për të rinjtë në tremujorin e dytë të vitit 2018 është 3.8 pikë përqindje më e ulët. Krahastuar me tremujorin e parë 2018, shkalla e papunësisë për të rinjtë ka pësuar një rënie prej 1.9 pikë përqindje.

Në tremujorin e dytë 2018, shkalla e punësimit për popullsinë 15 – 64 vjeç është 59.2%. Gjatë këtij tremujori, numri i të punësuarve u rrit me 3.3%, krahasuar me një vit më parë. Në terma tremujorë, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2018, punësimi pësoi një rritje prej 0.1%. Punësimi pësoi rritje në sektorin e shërbimeve me 0.3% dhe në sektorin e industrisë me 0.1%, ndërsa sektori bujqësor mbetet në të njëjtin nivel.

Në tremujorin e dytë të vitit 2018, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15 – 64 vjeç është 68.0%. Krahastuar me tremujorin e dytë të vitit 2017, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 1.2 pikë përqindje më e lartë. Krahastuar me tremujorin e mëparshëm ky tregues ka mbetur në të njëjtin nivel.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15 – 29 vjeç është 49.0%. Për popullsinë 30 – 64 vjeç, në tremujorin e dytë 2018, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 78.3%.

Tabela e të dhënave të tregut të punës (15 vjeç e lart)

(Në %)		Shkalla Zyrtare e Papunësisë	Shkalla e Punësimit	Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore
2012	Q1	12.9	51.1	58.7
	Q2	13.3	50.2	57.9
	Q3	13.6	48.6	56.2
	Q4	13.6	48.7	56.4
2013	Q1	14.3	47	54.9
	Q2	16	44.1	52.5
	Q3	16.8	42.9	51.5
	Q4	16.8	42.4	50.9
2014	Q1	18.2	41.5	50.8
	Q2	17.2	44.4	53.6
	Q3	17	45.8	55.2
	Q4	17.6	45.6	55.3
2015	Q1	16.9	45.6	54.8
	Q2	17	45.8	55.2

	Q3	17.2	46.3	55.9
	Q4	17.3	47	56.8
2016	Q1	16.6	47.5	56.9
	Q2	15.5	48.4	57.2
	Q3	14.7	49.9	58.6
	Q4	14.2	49.1	57.2
2017	Q1	14.2	49.2	57.3
	Q2	13.9	50	58.1
	Q3	13.6	50.7	58.7
	Q4	13.4	51.2	59.1
2018	Q1	12.5	51.9	59.3
	Q2	12.4	52	59.3

Në lidhje me politikat e punësimit, zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë (SKPA) 2014-2020 ka vijuar që nga fundi i vitit 2014, sipas aktiviteteve të parashikuara në planin përkatës të veprimit. Raporti i tretë i progresit të SKPA-së u përgatit nga Ministria e Financave me objektivin që: (i) të rishikojë zbatimin e aktiviteteve të NESS të planifikuara për vitin 2017, (ii) të vlerësojë nivelin e arritjeve sipas rezultateve të pritura dhe objektivave të SKPA, veçanërisht rezultatet dhe objektivat e lidhura me Kontratën e Reformës Sektoriale për Punësim dhe Aftësi (2016-2018).

SKPA 2014 – 2020 përfshin 52 masa që do të zbatohen në një periudhë 7-vjeçare. Progresi vjetor në Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA), që mbulon vitin 2017 është miratuar në gjysmën e parë të vitit 2018 dhe ka rezultatet e mëposhtme:

- 49 masa kanë filluar të zbatohen nga 52 të planifikuara (94% e masave të planifikuara janë iniciuar dhe janë në progres ose kompletuar);
- Masat që nuk tregojnë përparim janë ato që kanë të bëjnë me zgjerimin shërbimeve të punësimit në zonat rurale.
- Për masat që kanë filluar të zbatohen progresi vlerësohet mesatarisht në masën 74%;
- Gjatë vitit 2017, progresi i përgjithshëm në zbatimin e strategjisë është në masën 9%.

Aktualisht po punohet për rishikimin afatmesëm të Strategjisë, ku do të rishikohen të gjitha masat dhe gjithashtu mund të vendosen masa të reja në planin e veprimit të Strategjisë. Një ndër shtyllat, ku strategjia ka pasur probleme në zbatimin e saj është prioriteti C “Nxitja e përfshirjes sociale dhe e kohezionit territorial”, kryesisht për masat që kanë lidhje me shtrirjen e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional në zonat rurale. Ky rishikim ka filluar në Korrik 2018 dhe rezultatet do të dalin në gjysmën e parë të Dhjetorit 2018.

Informacioni i mëposhtëm është sipas shtyllave kryesore të prioritetëve strategjike. Disa nga arritjet janë si më poshtë:

21 zyra punësimi janë rinovuar dhe janë të aksesueshme për publikun me modelin e ri të shërbimeve të punësimit. Gjatë vitit 2017 u rikonstruktua 1 zyrë më shumë e punësimit sipas modelit evropian të shërbimeve të punësimit. Deri në fund të vitit 2018 do të kemi 15 zyra të tjera të punësimit. Sistemi Informativ i Shërbimeve Kombëtare të Punësimit (SHKP) ka parë përmirësime të konsiderueshme dhe paraqet një hap cilësor në modernizimin e institucionit. Aktualisht sistemi është bërë më interaktiv duke lejuar shkëmbimin e informacionit me Sistemin e Informacionit të Gjendjes Civile, Sistemin Tatimor, Sistemin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dhe Sistemin e Ndhmës Ekonomike.

Sistemi i gjurmimit për të diplomuar/certifikuar në sistemin VET është funksional pranë SHKP në bashkëpunim me projektin GIZ.

Ligji i ri për punëkërkesit e papunë (Ligji nr. 145/2015) i miratuar nga parlamenti në dhjetor 2015 dhe që është në zbatim që nga viti 2016 ka çuar në një reduktim të ndjeshëm të numrit të punëkërkesve të regjistruar të papunë nga 145,147 në vitin 2015 në 63,597 në Tetor 2018. Zbatimi i ligjit ka mundësuar zyrat e punësimit që të identifikojnë më mirë ata punëkërkes me nevoja reale të punësimit.

Të dhënat administrative nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) për të papunët e regjistruar në zyrat e punësimit, në të gjithë vendin, për periudhën janar – tetor 2018, janë si më poshtë:

- 63,597 persona janë regjistruar si punëkërkes të papunë në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, prej të cilëve:
 - o 52.6% janë gra;
 - o 30% përfitojnë ndihmë ekonomike, krahasuar me 47% në fund të vitit 2017.
 - o 52.6% janë të papunë afatgjatë, 54.8% prej të cilëve janë gra;
 - o 19% janë punëkërkes të papunë të moshës 15-30 vjeç;
 - o 8% janë të papunë punëkërkes romë dhe egjiptianë.

Që nga viti 2014 fondet për programet e nxitjes së punësimit kanë qenë në një trend të vazhdueshëm rritës nga 90 milionë lekë në vitin 2013, në 270 milionë lekë në vitin 2014, 450 milionë lekë në 2015 dhe 490 milionë lekë në vitin 2016. Shpërndarja buxhetore për zbatimin e një portofoli për 7 programet e nxitjes së punësimit (të listuara më poshtë) mbeti e pandryshuar për vitin 2017, duke mbështetur punësimin e 5 264 punëkërkesve të papunë (d.m.th. 5.8% të totalit). Gjithashtu dhe për vitin 2018 është miratuar nga Këshilli i Ministrave një program i ri i cili zbatohet për herë të parë në vitin 2018 dhe është programi “Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional” dedikuar personave të papunë të dalë nga skema e ndihmës ekonomike. Për vitin 2018 fondet e vëna në dispozicion të programit të nxitjes së punësimit janë 490 milion lekë. Në fazën e parë të zbatimit të këtyre programeve për vitin 2018 janë përfshirë 4844 punëkërkes të papunë. Për vitin 2018 zbatohen 8 programe të nxitjes së punësimit si më poshtë:

- trajnimi në vendin e punës;
- punësimi i grave beqare kryefamiljare;

- punësimi i personave me aftësi të kufizuara;
- punësimi i grupeve vulnerabël;
- punësimi i të rinjve në posedim të gradave të larta universitare;
- praktika për të diplomuarit rishtas;
- promovimi i punësimit për jetimët;
- formim profesional me pagesë.

Gjithashtu nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit deri në muajin Tetor 2018 janë punësuar rreth 29 mijë punëkërkues të papunë.

Qeveria zbatoi me sukses reformën në skemën e ndihmës ekonomike dhe në të njëjtën kohë Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka trajtuar me përparësi ri-integrimin e ish përfituesve të tyre në tregun e punës. Qeveria shqiptare ka miratuar një program të ri i cili adreson kategoritë e përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike, apo dhe të atyre që kanë dhe do të dalin nga reformimi i kësaj skemë, program i cili mundëson përfshirjen në kurse formimi profesional falas të tyre në qendrat e formimit profesional dhe gjithashtu gjatë pjesëmarrjes në kurs të marrin një pagesë mujore prej 6 000 lekësh.

Disa nga rezultatet e arritura gjatë vitit 2018 të zbatimit të reformës së ndihmës ekonomike:

- Janë trajtuar me shërbime rreth 14,000 ish përfitues të skemës së ndihmës ekonomike.
- Janë punësuar 982 punëkërkues të papunë, ish përfitues të skemës së ndihmës ekonomike.
- Janë dërguar në formim profesional 427 persona, ish përfitues të skemës së ndihmës ekonomike, të cilët janë duke ndjekur një kurs formimi në profesionet Instalues dhe riparues rrjeti elektrik, hidraulik, Kuzhinier, Pastiçer, parukeri - estetike, panele diellore, Rrobaqepësi, etj.

Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian

Edukimi dhe inovacioni

Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe tregu funksional i punës janë faktorët kyç që kontribuojnë në rritjen ekonomike, konkurrencën dhe pozicionin e sistemit ekonomik shqiptar si pjesëmarrës në tregun evropian dhe global. Problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Shqipëria dhe pengimi i realizimit të plotë të kapitalit njerëzor janë: ndryshimet në sistemin e ekonomisë, "ikja e trurit" (brain drain) gjatë viteve të fundit, informaliteti dhe mungesa e sistemit të arsimit dhe formimit profesional. Si rezultat, bizneset shpesh përballen me mungesë aftësish që kufizojnë rritjen e tyre. Në fund të tremujorit të katërt 2017, shkalla e papunësisë ishte 13.4%, siç raportohet nga INSTAT.

Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës

Interkonektiviteti energjetik.

Në kuadër të Procesit të Berlinit, vendeve të Ballkanit Perëndimor ju është rekomanduar zhvillimi i mëtejshëm i linjave të interkonjeksionit të energjisë. Shqipëria tashmë ka linja interkonjeksioni të energjisë elektrike me Greqinë, Malin e Zi dhe Kosovën, të cilat janë renditur më poshtë:

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Zëmlaku (Shqipëri) - Kardia (Greqi);
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) - Podgoricë (Mali i Zi);
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) - Prishtinë (Kosovë);
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Fierza (Shqipëri) - Prizreni (Kosovë);
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Koplik (Shqipëri) - Podgoricë (Mali i Zi)
- Linja e interkonjeksionit 150 kV Bistricë (Shqipëri) - Myrtos (Greqi).

Linja e interkonjeksionit 400 kV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës përfundoi më 28.06.2016 dhe kjo linjë është teknikisht funksionale. Prandaj, OST S.A. dhe KOST S.A. kanë kërkuar zyrtarisht asistencën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Komisionit Evropian për të filluar funksionimin e linjës së interkonjeksionit. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë e ka ngritur këtë çështje me autoritetet e duhura serbe, por deri tani asnjë zhvillim i ri.

Në lidhje me ndërtimin e linjave të reja të interkonjeksionit që do të lidhin Shqipërinë me vendet e rajonit, parashikohet ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Linja e Interkonjeksionit 400 kV Elbasani (Shqipëri) - Manastir (Maqedonia e Veriut), si pjesë e korridorit Lindje - Perëndim, mundëson lidhjen e drejtpërdrejtë të sistemeve energjetike të Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë dhe përmirëson lidhjen e sistemit energjetik shqiptar me rajonin. Ndërtimi i kësaj linje interkonjeksioni 400 kV Shqipëri – Maqedonia e Veriut është parashikuar të kushtojë gjithsej 70 milionë euro.

Me qëllim ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Maqedonia e Veriut, më 09.11.2017 është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë ligji Nr. 101/2017 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe KFW Frankfurt Am Main, në lidhje me Marrëveshjen ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST Sh.a) dhe KFW Frankfurt Am Main, në Projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri – Maqedoni (Fier – Elbasan – Qafëthanë)”.

Më 9 janar 2018, Operatori i Sistemit të Transmetimit nënshkroi një kontratë me konsulentin gjerman “Fichtner GmbH dhe Co.KG” për shërbimin e konsulencës në linjën e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Maqedoni, linja Elbasan – Fier dhe zgjerimi i nënstacionit Elbasani 2,

Nënstacioni i Fierit. Konsulenca do të mbulojë fazën 12 mujore të përgatitjes së projektit dhe tenderimit, si dhe zbatimin e fazës 24 mujore dhe përfundimin e tij.

Në janar 2018, u nënshkrua kontrata ndërmjet OST S.A dhe konsulentit të përzgjedhur.

Më 16 prill 2018 është bërë efektive kontrata e nënshkruar me Konsulentin.

Pas nënshkrimit të kontratës, nga ana e konsulentëve është përgatitur dokumentacioni si më poshtë:

- Raporti fillestar;
- Raporti i Planifikimit të Projektit:

Pas pranimit të “No object” nga banka KfW për raportin “Raporti i Planifikimit të Projektit”, do të vijohet me hartimin e dokumenteve të tenderit për të dy Projekt-lotet.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

AIDA është pjesë e Rrjetit të Ndërmarrjeve Evropiane (EEN) që nga viti 2012 si Koordinator i Konsorciumit Shqiptar. Në vitin 2015 AIDA përfitoi mbështetje financiare nga BE për të qenë pjesë e këtij rrjeti. Pjesëmarrja në rrjetin më të madh, Rrjeti i Ndërmarrjeve Evropiane (EEN) synon të ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të shfrytëzojnë më mirë mundësitë e biznesit në tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian, si dhe në vendet e tjera që janë partnerë/anëtarë. AIDA aktualisht vazhdon zbatimin e këtij projekti që përfundon në dhjetor 2018. Gjithashtu, AIDA ka aplikuar në qershor 2018 për thirrjen e re të projektit dhe është shpallur fituese për implementimin e projektit edhe për vitin 2019.

Fondi i Konkureshmërisë menaxhohet nga AIDA. Në vitin 2016, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin e ri nr. 24, datë 01.20.2016 “Fondi i Konkurrencës” për periudhën 2016 – 2018, me një buxhet të përgjithshëm prej 84 milion Lek. Për vitin 2016 janë alokuar 22 milionë lekë për këtë fond. Aktualisht, 26 kompani kanë përfituar dhe fondi është disbursuar 100%. Ky fond mbulon deri në 70% të kostove të projektit. Çdo kompani merr deri në 1,400,000 lekë.

Për vitin 2017 janë alokuar 22 milionë lekë për këtë fond. Aktualisht, 6 kompani kanë përfituar dhe fondi është disbursuar 28%.

Për vitin 2018, janë shpallur fitues 15 kompani aplikuese dhe janë mbështetur në vlerën 16, 000, 000 Lekë deri në muajin tetor.

Fondi për Inovacion u miratua me Vendimin Nr. 406 datë 13.05.2015 “Për krijimin e fondit të inovacionit”. Ky fond ka një vlerë prej 40,000,000 lekësh për një periudhë sfiduese 3-vjeçare, vlera e fondit në vitin 2015 ishte 10,000,000 lekë dhe për vitet 2016-2017 15,000,000 lekë çdo

vit. Qëllimi i Fondit nuk është zëvendësimi i asaj që kompania do të financojë me burimet e veta, por për të rritur buxhetin e ndërmarrjes, duke shërbyer si nxitje për SME-të për të kontrolluar nevojat e tyre për inovacion dhe teknologji, për të identifikuar furnizuesin e teknologjisë dhe partnerë në vende të tjera, për të ndihmuar dhe lehtësuar promovimin dhe licencimin ose patentimin e inovacionit të SME-ve duke u mundësuar përfituesve të SME-ve që të arrijnë më shumë se ç'mund të kishin arritur vetëm me mjetet e tyre.

- Një ndërmarrje mund të përfitojë plotësisht 400,000 lekë për një projekt.
- Skema mbulon 50% të kostove të marra brenda kufirit të mësipërm.

Për vitin 2017 janë dhënë 10 milionë lekë për këtë fond. Aktualisht, një kompani ka përfituar dhe fondi është disbursuar 4%. Është në proces një VKM e re.

Në vitin 2018 u miratua VKM e re e Fondit të Inovacionit, VKM Nr. 211 Dt. 20.04.2018, për periudhën 3 vjeçare me vlerë totale 45, 000, 000 Lekë (15, 000, 000 Lekë për çdo vit deri në 2020).

Për vitin 2018, deri në tetor, janë shpallur fitues 3 kompani dhe janë mbështetur në vlerën 1, 800, 000 Lekë.

Fondi i Ekonomisë Kreative

Fondi i Ekonomisë Kreative miratohet me Vendimin Nr. 954, datë 05.09.2012 “Për themelimin e Fondit të Ekonomisë Kreative (Artizanatit)” dhe është përmirësuar kohët e fundit me Vendimin nr. 25, datë 01.10.2016. Janë ndarë gjithsej 40 milionë lekë, 10 milionë në vit për periudhën 2013-2016. Ky fond ofron mbështetje për (i) zhvillimin e produkteve, (ii) marketingun, (iii) trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e artizanatit, dhe (iv) blerjen e pajisjeve për promovimin e prodhimit artizanal.

VKM e re e Fondit të Ekonomisë Kreative është miratuar me Nr. 15 Dt. 11.01.2017. Kjo VKM është për periudhën tre – vjeçare deri në vitin 2019, me një fond total prej 30,000,000 Lekë (10,000,000 Lekë për çdo vit).

Për vitin 2018, janë shpallur 13 kompani fituese dhe janë mbështetur financiarisht në vlerën 5, 000, 000 Lekë deri në muajin tetor.

Fondi për Start-Up-et

Fondi për Start-Up-et u krijua me VKM Nr. 593, datë 10.09.2014 “Për Mbështetjen e Ndërmarrjeve Start- Up”.

Fondi synon të mbështesë bizneset e sapoformuara “Start-Up” në Shqipëri, nëpërmjet subvencioneve të drejtpërdrejta financiare duke përmirësuar klimën dhe kushtet e tyre të punës, me qëllim krijimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik dhe mundësive për punësim. Shuma totale e fondit është 25 milionë lekë për një periudhë 4 vjeçare. Skema mbulon 70% të shpenzimeve të miratuara. Një kompani mund të përfitojë një shumë totale 300,000 lekë për projektin. Buxheti i përgjithshëm për vitin 2016 është 10 milionë lekë. Aktualisht 21 kompani kanë përfituar dhe shuma totale e alokuar është 6,300,000 Lekë. Fondi është disbursuar në 63%, aplikimet vazhdojnë deri në fund të vitit. Pritet të disbursohet në masën 100% të fondit.

Sektorët e mbuluar nga ky fond janë:

- Prodhimi dhe Sektori i Shërbimeve;
- Sektori i Industrisë së Lehtë;
- Sektori i Turizmit;
- Hulumtimi dhe Zhvillimi;
- Agropërpunimi;
- Dizenjimi, modelimi, artizanati

Për vitin 2017 janë dhënë 10 milionë lekë për këtë fond. Aktualisht kanë përfituar 18 kompani dhe fondi është disbursuar 54%. Ky fond mbulon deri në 70%. Është në proces një VKM e re.

Për vitin 2018, janë shpallur fitues 14 kompani dhe janë mbështetur financiarisht në vlerën 7, 000, 000 Lekë deri në muajin tetor.

Integrimi ekonomik me BE-në dhe konkurrenca e çmimeve

Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë janë të përqendruara me vendet e BE-28. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018, eksportet e mallrave drejt vendeve të BE-28 arritën në 176.7 miliardë Lekë ose rreth 74.6% të eksportit total. Ato shënuan një rritje vjetore prej 14.7%. Gjatë së njëjtës periudhë, importet nga vendet e BE-28 arritën në vlerën 287.7 miliardë lekë ose rreth 61.6% të importeve totale. Ato shënuan një rritje vjetore prej 2.6%.

Italia mbetet destinacioni kryesor i eksporteve shqiptare (me rreth 48.1% të totalit). Për sa i përket vendeve të BE-28, eksporti ka shënuar rritje vjetore në rastin e Italisë (3.9%), Greqisë (13.1%), Spanjës (63.1%). Në të njëjtën kohë, origjina e importeve ka qenë kryesisht nga Italia (27.7%), Greqia (8.4%) dhe Gjermania (7.7%).

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018, eksportet drejt vendeve të CEFTA arritën nivelin 37.9 miliardë Lekë duke u zgjeruar me 25.5% në terma vjetorë. Këto eksporte përbëjnë rreth 16.4% të totalit. Nga ana tjetër, importet e mallrave me vendet e CEFTA arritën në nivelin ALL 49.4

miliardë ose rreth 7.9% të importeve totale. Importet e mallrave me vendet e CEFTA u rritën me 29.7% në krahasim me një vit më parë.

Eksportet e mallrave mbeten të përqendruar në kategorinë “tekstile dhe veshje këmbësh”, e cila përfaqëson mbi 40% të totalit të eksporteve të nëntë muajve të parë të vitit 2018. Eksportet e mallrave u rritën me rreth 6.1% në krahasim me një vit më parë. Përpjesët e “mineraleve, lëndës djegëse dhe energjisë elektrike” (19.0% të totalit të eksporteve) janë zgjeruar shpejt për shkak të eksporteve në rritje të energjisë elektrike. E njëjtë gjë vlen edhe për kategorinë “materiale ndërtimi dhe metale”, e cila ka përfituar nga rritjet e kohëve të fundit në çmimet e eksporteve.

Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e *acquis* e BE-së

Parimi i përgjithshëm i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton se produktet duhet të tregtohen lirisht nga një vend i Bashkimit Evropian në një tjetër. Lëvizja e lirë e mallrave është faktor kyç në rritjen dhe zhvillimin e tregut të brendshëm. Ky parim është përcaktuar në nenet 34, 35 dhe 36 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), duke parandaluar Shtetet Anëtare të miratojnë ose të ruajnë kufizime të pajustificuara në tregtinë brenda BE-së.

Dispozitat e TFEU-së nuk përjashtojnë ndalimet e justifikuara për shkak të moralit publik, politikës publike ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose mbrojtjes së pronës industriale dhe tregtare, si dhe kërkesave të tjera të detyrueshme të njohura nga Gjykata e Drejtësisë (p.sh. mbrojtjen e mjedisit). Megjithatë, ndalesa të tilla duhet të mbeten proporcionale dhe nuk duhet të përbëjnë diskriminim arbitrar ose një kufizim të fshehtë në lidhje me tregtinë midis Shteteve Anëtare.

Masat që kanë efekt të njëjtë me kufizimet sasiore janë të ndaluara me përjashtim të një grupi të vogël masash kufizuese. Kjo konkretisht nënkupton eliminimin e pengesave teknike dhe përmbushjen e parimit të njohjes reciproke. Dispozitat administrative relevante duhet të miratohen për të zbatuar procedurat e shkëmbimit të informacionit të përcaktuara në Rregulloren (EC) Nr. 764/2008 dhe në Rregulloren “Strawberry” (KE) Nr. 2679/98.

Në një numër sektorësh parimi i përgjithshëm plotësohet nga një kornizë rregulluese e harmonizuar. Masat horizontale përcaktojnë infrastrukturën e cilësisë që Shtetet Anëtare duhet të vendosin në fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

Legjislacioni i harmonizuar në lidhje me produktet evropiane, i cili duhet të transpozohet nga çdo shtet anëtar, përfaqëson pjesën më të madhe të *acquis* së këtij kapitulli. Ajo bazohet në “përjasjen e vjetër” që imponon specifikimet specifike të produktit) dhe “përjasjen e re dhe globale” (imponon kërkesat e përgjithshme të produktit).

Legjislacioni në kuadër të përjasjes së re përfshin pajisjet e tensionit të ulët (LVD), përputhshmërinë elektromagnetike (EMC), lodrat, makineritë, ashensorët, emetimet e zhurmave në ambient, shkarkimet ndotëse nga pajisjet motorike të lëvizshme në rrugë, pajisjet personale mbrojtëse (PPE) sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera shpërthyes (ATEX), pajisje mjekësore, aparate të gazit, enë nën presion, teleferikët, prodhime ndërtimore,

anijet rekreative, kërkesat e projektimit ekologjik për produktet e lidhura me energjinë (ERP). Legjislacioni i përjasjes së vjetër mbulon fushat e automjeteve dhe kimikateve.

Zbatimi në mënyrën e duhur i një sërë masash procedurale kërkojnë gjithashtu kapacitete të mjaftueshme administrative. Këto përfshijnë procedurën e njohjes në fushën e standardeve teknike dhe rregulloreve të përcaktuara në Direktivën 98/34/KE të ndryshuar, legjislacionin mbi tregtinë e armëve, produktet e mbrojtjes, xhamin e kristaltë, këpucët, etiketimin e tekstilit, çmimet e produkteve mjekësore dhe Direktivën 2014/60/BE për mallrat kulturore.

I 1.2. Kërkesat e MSA-së

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian në Kapitullin 1 buron nga nenet 70 dhe 75 i MSA-së.

Këto dispozita detyrojnë Shqipërinë jo vetëm të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë që ai të hyjë në fuqi dhe të zbatohet. Në këtë fazë të procesit të para-anëtarësimit, organet e ndryshme shtetërore duhet të jenë të përfshira në ushtrimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të *acquis* që është në fuqi.

Për më tepër, kur legjislacioni i BE-së është subjekt konstant zhvillimi, përafrimi i legjislacionit shqiptar nuk do të jetë i plotë me atë të legjislacionit evropian aktualisht në fuqi. Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve të BE-së është i nevojshëm për përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësimin në të ardhmen në BE.

I.2. Situata Aktuale

Shqipëria ka bërë një farë progresi në fushën e lëvizjes së mallrave. Legjislacioni mbi masat horizontale në lidhje me standardizimin, akreditimin, metrologjinë, marketingun e produkteve, mbikëqyrjen e tregut dhe vlerësimin e konformitetit është në fuqi.

Për sa i përket parimeve të përgjithshme, nga fundi i vitit 2011 u miratua paketa ligjore për i) sigurinë e përgjithshme të produkteve, si dhe ii) për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore.

Kjo paketë transponon dispozitat përkatëse të GPSD dhe Kuadrin e ri legjislativ (Vendimi 768/2008/KE dhe Rregullorja 765/2008/KEE). Ligji mbi tregtimin e produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut krijon bazat e nevojshme ligjore për transpozimin e Direktivave të Përjasjes së Re dhe të Vjetër përmes legjislacionit sekondar.

Në këtë kontekst, të gjitha rregulloret teknike në lidhje me Ligjin Nr. 10489/2011 janë rishikuar. 18 rregullore teknike u miratuan nga Këshilli i Ministrave, të cilat transpozojnë legjislacionin përkatës të produkteve të tekstilit, të tensionit të ulët (LVD), të makinerive, të ashensorëve, të etiketimit të furrave dhe aspiratoreve thithës, të pajisjeve të gazit nën presion, të pajisjeve mbrojtëse personale, të pajtueshmërisë elektromagnetike (EMC) shkarkimet nga pajisjet në natyrë, të pajisjeve dhe sistemit mbrojtës për përdorim në mjedise potencialisht shpërthyes, të kërkesave të efikasitetit për kaldaja të reja për ujin e nxehtë, instrumentet matëse etj.

Gjatë vitit 2018 ka vazhduar përafrimi i legjislacionit me *acquis* e re të BE-së, u miratuan dy rregulla teknike:

- Vendimi Nr. 191, datë 4.4.2018 “Për miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e energjisë për furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës” i cili është në përputhje të plotë me rregulloren e deleguar të komisionit Nr. 65/2014, datë 1 tetor 2013, “Për etiketimin e energjisë për furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës”;
- Vendimi Nr. 192 datë 4.4.2018 “Për miratimin e rregullit teknik “Për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, i cili përafro plotësisht Direktivën 2014/33/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë.”

Megjithatë, nuk është përafruar legjislacion në fushat për teleferikët, pajisjet e radios dhe telekomunikacionit, pajisjet për mjediset shpërthyes, produktet e ndërtimit, motoskafët privatë, artikujt piroteknikë, eksplozivët civilë, ekologjikë dhe instrumentet e peshimit jo-automatikë. Procesi i përafrimit për disa prej tyre ka filluar tashmë.

Legjislacioni kombëtar mbi çmimet e produkteve mjekësore është pjesërisht në përputhje me *acquis*.

Për sa i përket nënfushës së pa harmonizuar, është përfunduar metodologjia në lidhje me *screening* e rregullave kombëtare teknike për të vlerësuar pajtueshmërinë me nenet 34-36 të TFBE-së. Është zhvilluar trajnimi i parë i GNP-së në lidhje me këtë çështje. Plan i përkatës i veprimit është në përgatitje. Në nëntor të vitit 2018 MFE në bashkëpunim me GIZ zhvilloi një trajnim në kuadër të përgatitjeve për takimin shpjegues dhe për procesin e pre-screening i cili u zhvillua në Janar 2019 në Bruksel.

Është bërë pak përparim në heqjen e pengesave të pajustificuara tregtare nëpërmjet ndryshimeve në ligjet për inspektimin e detyrueshëm për lubrifikantët e importuar të mbushur dhe pajisjet nën presion të transportueshme.

Strategjia “Për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut” është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 753/2015 duke u shoqëruar edhe me një plan veprimi të detajuar. Kjo strategji ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2015 dhe do të zbatohet deri në vitin 2020.

Institucionet e infrastrukturës së cilësisë si dhe harmonizimi afatshkurtër dhe afatgjatë i objektivave të *acquis* janë pjesë përbërëse e kësaj strategjie.

Kjo strategji vazhdon zbatimin e aktiviteteve nga institucionet që janë pjesë e kësaj saj, në përputhje me aktivitetet e parashikuara në planin përkatës të veprimit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur nga Projekti GIZ, po koordinon dhe monitoron procesin e zbatimit të strategjisë. Për arritjen e objektivave, të gjitha institucionet e përfshira në strategji kanë përgatitur tashmë pasaportën e treguesve dhe raportet narrative.

Ky proces është finalizuar me publikimin e raportit përfundimtar në faqen e internetit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, ndërkohë që pritet të publikohet dhe në faqen e Këshillit të Ministrave.

Është krijuar një koncept i strategjisë për lëvizjen e lirë të mallrave, por duhet të zhvillohet dhe të miratohet më tej. Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut, si organi kryesor për zbatimin e sigurisë së produkteve është funksional nga Janari 2016, me kapacitete në rritje dhe njohuri profesionale për inspektorët e tregut, përmes trajnimeve. Për më tepër, është përcaktuar metodologjia për klasifikimin e rreziqeve dhe vlerësimin serioz të rrezikut, si dhe procedurat standarde të operimit.

Legjislacioni në fushën e standardizimit siguron qartë rregulla dhe procedura në përputhje me ato të përdorura nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, si CEN, CENELEC, ETSI, ISO dhe IEC.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 382/2018 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit” ka transpozuar plotësisht Rregulloren e BE-së Nr. 1025/2012 “Për standardizimin evropian”. Përveç legjislacionit në fuqi, të gjitha proceset e standardizimit bazohen në rregulloret e brendshme të DPS që janë në përputhje me rregulloret evropiane dhe ndërkombëtare.

Ligji Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” me qëllim që legjislacioni shqiptar të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores (KE) Nr. 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 korrik 2008 kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut, u miratua. Të gjitha aktet dytësore në fushën e akreditimit janë miratuar në korrik 2015. DPA nënshkroi EA-MLA dhe ILAC-MRA për laboratorë testimi, e cila është një arritje shumë e rëndësishme drejt heqjes së barrierave teknike të pajustificuara në tregti.

Strukturat kryesore administrative përgjegjëse për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë janë të ngritura dhe funksionale. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është anëtare e plotë e Institutit Evropian të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI) dhe anëtar i asociuar i Komitetit Evropian për Standardizimin (CEN) dhe Komitetit Evropian për Standardizimin Elektroteknik (CENELEC), anëtar korrespondent në Organizatën Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO) dhe anëtare në Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC). Në

Maj 2017 DPS nënshkroi Marrëveshjen e Re me CEN&CENELEC për vazhdimin e detyrimeve të ndërsjella në fushën e standardizimit. Databaza e DPS është përmirësuar në lidhje me regjistrimin / arkivimin e standardeve, terminologjinë e standardeve për përkthimin e tyre, ndërlidhjen me databazat e standardeve të organizmave evropiane e ndërkombëtare të standardizimit, porosinë online për blerjen e standardeve, si dhe azhurnimin e standardeve të publikuara dhe lidhjen / referencën e tyre me Direktivat e Përqasjes së Re.

Që nga maji i vitit 2015, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) është anëtare e plotë e Bashkëpunimit Evropian për Akreditim (EA). DPA nënshkroi EA-MLA dhe ILAC-MRA për laboratorët testues. Numri i përgjithshëm i organizmave të akredituar të vlerësimit të konformitetit është 73, prej të cilave:

- 45 laboratorë: 38 laboratorë testimi, 5 laboratorë mjekësore, 2 laboratorë kalibrues,
- 19 organe inspektuese;
- 9 organe certifikimi (katër për sistemet e menaxhimit, pesë për certifikimin e personelit).

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është anëtar i EURAMET si dhe anëtar i asociuar i WELMEC. Kapacitetet e kalibrimit dhe të matjes në DPM-së u regjistruan në bazën të krahasimit të Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave.

DPM ka filluar rishikimin e procedurave për implementimin e standardit të ri ISO 17025:2017 , në të gjithë laboratorët kalibrues, me qëllim prezantimin e sistemit të cilësisë në Komitetin Teknik të Cilësisë të EURAMET, në vitin 2019.

Në vitin 2018, DPM ka filluar një projekt 3 vjeçar “Financim dhe Konsultim Rajonal i Infrastrukturës së Cilësisë”, në bashkëpunim me Institutin Gjerman të Metrologjisë (PTB), i fokusuar për laboratorët e temperaturës, elektrik dhe gjatësisë”.

Për sa i përket legjisllacionit të produkteve të “përqasjes së vjetër”, Ligji për menaxhimin e kimikateve është pjesërisht në përputhje me dispozitat e Rregullores mbi Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH) dhe aktet e tjera relevante të *acquis*. Legjisllacioni kombëtar mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin kimik ende nuk është në linjë me Sistemin e Harmonizuar të Kombeve të Bashkuara për Klasifikimin dhe Etiketimin e Kimikateve.

Për prekursorët e ilaçeve, lista e substancave të kontrolluara është në përputhje me listat në *acquis* relevante të BE-së.

Në lidhje me masat procedurale ka një përafrim të pjesshëm, veçanërisht në lidhje me: armët e zjarrit; etiketimin dhe përzierjet e tekstilit; çmimet e produkteve mjekësore. Legjisllacioni për produktet e mbrojtjes dhe prokurimin dhe kthimi i objekteve kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme nga territori i një Shteti Anëtar nuk është në përputhje me *acquis*.

I.3. Prioritetet

- Harmonizimi i legjislacionit me *acquis* horizontale, sidomos për metrologjinë, standardizimin, akreditimin;
- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit në fushën e përjasjes së re dhe globale;
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve zbatuese në lidhje me të Inspektoratin e Mbikëqyrjes së Tregut;
- Progres i mëtejshëm në planin e veprimit në lidhje me *screening* në funksion të Neneve 34-36 TFEU;
- Të përparohet në lidhje me strategjinë e lëvizjes së lirë të mallrave

II.1. Çështje horizontale

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia “Për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut” është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 753/2015 duke përfshirë një plan veprimi të detajuar. Infrastruktura e cilësisë afatshkurtër dhe afatgjatë si dhe harmonizimi e objektivave të *acquis* janë pjesë përbërëse e kësaj strategjie.

Për arritjen e objektivave, të gjitha institucionet e përfshira në strategji kanë përgatitur tashme pasaportën e treguesve dhe raportet narrative. Ky proces është finalizuar me publikimin e raportit përfundimtar në faqen e internetit Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, ndërkohë që pritet të publikohet dhe në faqen e Këshillit të Ministrave.

Ligji Nr. 10480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore”, i ndryshuar, është pjesërisht i përafruar me Direktivën Nr. 2001/95/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe rregulloren Nr. 765/2008/KE “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut në lidhje me tregtimin e produkteve”.

Ligji Nr. 10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe sigurinë e tregut të produkteve jo ushqimore”, të ndryshuar, ka transpozuar Rregulloren nr. 765/2008/KE dhe Vendimin 768/2008/KE “Për një kornizë të përbashkët për marketingun e produkteve”.

Në lidhje me standardizimin, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 382/2018 “Për miratimin e rregulloreve për veprimtarinë e standardizimit”, i cili ka transpozuar plotësisht Rregulloren 1025/2012/BE.

Në lidhje me metrologjinë, është miratuar Ligji Nr. 100/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, me synim harmonizimin e

mëtejshëm me *acquis*. Po ashtu është miratuar Ligji Nr. 9/2018 “Për një ndryshim në Ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për Metrologjinë”, i ndryshuar.

Përveç kësaj, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 770/2016 “Për instrumentet e matjes dhe listën referuese të standardeve përkatëse të harmonizuar” ka përafruar plotësisht Direktivën 2014/32/BE të njohur si Direktiva e Instrumenteve Matëse.

Lidhur me akreditimin, ligji Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” është përafruar pjesërisht me Rregulloren nr. 765/2008/KE. Ky ligj rregullon funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të bordit të saj të akreditimit, të komisioneve teknike dhe të çështjeve të tjera procedurale. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është anëtare e plotë e Bashkëpunimit Evropian për Akreditim (EA), anëtar i Forumit Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF) dhe i Marrëveshjes Shumëpalëshe për Laboratorët e Testimit të Bashkëpunimit Evropian për Akreditim dhe një anëtar i asociuar i Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Akreditimit të Laboratorëve (ILAC).

Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut (ISHMT) është ngritur në vitin 2016. Sektori i inspektimit të strukturave të metrologjisë, të drejtës së autorit dhe akomodimit është pjesë e këtij institucioni. ISHMT aktualisht ka 50 punonjës dhe po rekruton më shumë. Në maj të vitit 2017, nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (që nga shtatori 2017 Ministria e Ekonomisë dhe Financave) u miratua rregullorja e brendshme për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të ISHMT.

Në lidhje me eksplozivët civilë, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 675, datë 28.09.2016 “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe të identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil”. Ky vendim hyri në fuqi në tetor 2017 dhe përafroi plotësisht Direktivën 2008/43/KE “Për ngritjen e një sistemi të identifikimit dhe gjurmimit të lëndëve plasëse për përdorim civil”.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

II.1.3. Masat e planifikuara 2019 – 2021

II.1.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk është parashikuar miratimi i dokumenteve të politikave gjatë periudhës 2019 – 2021.

II.1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

- Projektligji “Për Metrologjinë” i cili do të përafrojë pjesërisht Direktivën 2009/34/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 23 prill 2009 në lidhje me dispozitat e përbashkëta për instrumentet matëse dhe metodat e kontrollit metrologjik. Planifikohet të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2019.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për etalonët kombëtare të matjes”, i cili do të përafrojë pjesërisht Guidën Nr. 1 versioni 2 (01/2015) Euramet dhe operimi i NMI (Institutit Kombëtar të Metrologjisë). Planifikohet të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2019.
- Projektvendim “Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI”, i cili do të përafrojë plotësisht Direktivën 2009/3/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, 11 mars 2009 Amendimi Direktivës të Këshillit 80/181/KEE “Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me njësitë matëse”. Planifikohet të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2019.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara”, i cili do të përafrojë plotësisht Direktivën 2014/32/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënien në dispozicion të tregut të instrumenteve matës. Planifikohet të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2020.
- Udhëzimi i Ministrit “Miratimin e rregullores ‘Për kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti”, i cili do të përafrojë pjesërisht OIML G21 Edicion 2017 (E) Guidë për përcaktimin e kërkesave për sistemin e certifikimit të parapaketimeve. Planifikohet të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2020.

II.1.3.3. Masa të tjera të planifikuara

Nuk është parashikuar marrja e masave të tjera në këtë nënkapitull.

II.2. Direktivat e përqasjes së vjetër

II.2.1 Kuadri Politik dhe Ligjor

Sa i përket kimikateve, Plani Kombëtar i Veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimi i ndotësve organikë të qëndrueshëm është përditësuar në vitin 2016. Plani Kombëtar i Veprimit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimi i Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm” është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 505, datë 29.08.2018. Miratimi i këtij dokumenti ka përmbushur një nga detyrimet ndaj Konventës së Stokholmit për Ndotësit Organik të Qëndrueshëm (NOQ). Për më tepër, paketa ligjore që përafron pjesërisht Rregulloret REACH dhe plotësisht CLP është në fuqi prej datës 28 Mars 2018, si më poshtë:

- Ligji Nr. 27 datë 17.3.2016 “Mbi menaxhimin e kimikateve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 488, datë 29.06.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve” i cili përafron plotësisht rregulloren (KE) nr. 1272/2008, të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 16 dhjetor 2008, “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e substancave dhe përzierjeve”, që ndryshon dhe shfuqizon Direktivat 67/548/KEE dhe 1999/45/KE dhe ndryshon Rregulloren (KE) 1907/2006;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 489, datë 29.6.2016 “Për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) e të kriterëve për përfshirjen e substancave në listën SVHC dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC-ve” i cili përafron plotësisht shtojcat XIII, XIV dhe XVI të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 18 dhjetor 2006, në lidhje me regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH), krijimin e Agjencisë Evropiane të Kimikateve, ECHA, që ndryshon direktivën 1999/45/KE dhe shfuqizon rregulloren e Këshillit (KEE) Nr. 793/93, si dhe direktivën e Këshillit 76/769/KEE dhe direktivat e Komisionit 91/155/KEE, 93/67/KEE, 93/105/KE dhe 2000/21/KE;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 665, datë 21.09.2016 “Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme” i cili përafron plotësisht Rregulloren (KE) Nr. 649/2012 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 4 korrik 2012, në lidhje me eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme.

Sa i përket kozmetikës, Ligji 26/2017 u miratua në mars të vitit 2017 dhe hyri në fuqi në mars të vitit 2018. Ligji transpozoi pjesërisht Rregulloren Nr. 1223/2009/KE mbi produktet kozmetike. Aktet nënligjore ende nuk janë miratuar dhe planifikuar.

Në fushën e produkteve farmaceutike, Ligji 105/2014, datë 31.7.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” është në fuqi, i përafruar pjesërisht me Direktivën 2001/83/KE; Direktivën 2001/20/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

Për sa i përket detergjenteve, Rregullorja 648/2004/KE është përafruar plotësisht përmes Ligjit Nr. 10216, datë 21.02.2010 “Për detergjentet”, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 669, datë 28.09.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat përbërëse” si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 220, datë 28.3.2012 “Për përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe

kufijtë e lejuar për biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente”; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 222, datë 28.3.2012 “Për etiketimin e materialeve të përdorura në komponentët kryesorë të këpucëve për shitje konsumi” i cili përaftron Direktivën 94/11/KE.

Ligji Nr. 10390/2011 “Për përdorimin e plehrave për bimët”, është miratuar, duke përafuar pjesërisht Rregulloren 2003/2003 / KE.

II.2.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Mjedisit dhe Turizmit
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

II.2.3. Veprimet e planifikuara 2019 – 2021

II.2.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk është parashikuar miratimi i politikave.

II.2.3.2 Kuadri politik dhe ligjor

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka planifikuar për 2019, si vijon:

Transpozimi në legjislacionin kombëtar i dispozitave specifike teknike të Rregullores REACH Nr. 1907/2006, ka përparuar më tej nëpërmjet dy projektakteve nënligjore të ndërmarra në këtë fushë dhe që lidhen me:

- (i) kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar, të rrezikshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisit;
- (ii) rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit dhe kërkesat specifike, përmbajtjen dhe formatin e dokumentit me të dhënat e sigurisë.

Projektvendim “Për rregullat e ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit metalik dhe kriteret specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje, i cili është planifikuar të miratohet gjatë katër muorit të parë të vitit 2019.” Ky projektvendim synon të transpozojë pjesërisht

Rregulloren EU 2017/852 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 Maj 2017 “Për merkurin” dhe që shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 1102/2008.

Projektvendimi “Për rregullat e nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti”, i cili është planifikuar të miratohet gjatë katër mujorit të tretë të vitit 2019.” Ky projektvendim synon të transpozojë pjesërisht Direktivën 87/217/KEE, datë 19 Mars 1987 “Për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti.

II.2.3.3 Masat e tjera të planifikuara

Nuk është parashikuar marrja e masave

II.3. Direktivat përqasjes së re

II.3.1 Kuadri politik dhe ligjor

Legjislacioni shqiptar parashikon të njëjtat parime të legjislacionit të harmonizuar evropian lidhur me kërkesat minimale / kërkesat esenciale, referencën ndaj standardeve të harmonizuara për prezumimin e konformitetit etj. Këto pasqyrohen në ligjin 10489/2011 dhe në të gjitha rregulloret teknike të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të “Përqasjes së Re”. 14 Rregulloret teknike miratohen nga Këshilli i Ministrave në bazë të këtij ligji në vitin 2015 - 2016 për: pajisjet e gazit, lodrat, etiketimin e energjisë, instrumentet matëse, pajisjet medicinale, ashensorët etj.

II.3.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Mjedisit dhe Turizmit;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Brendshme;
- Autoriteti i Komunikimit Elektronik dhe Postar;
- Qendra Kombëtare për Kontrollin e Drogave;
- Inspektorati Qendror Teknik.

II.3.3. Masat e planifikuara

II.3.3.1. Kuadri i Masave të Planifikuara 2019 - 2021

Nuk është parashikuar miratimi i politikave.

II.3.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

- Projektvendim “Për ngritjen e sistemit të gjurmimit të artikujve piroteknikë” i cili do të përafrojë pjesërisht Direktivën e Implementimit të Komisionit 2014/58/BE të datës 16 prill 2014, në përputhje me Direktivën 2007/23/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për krijimin e një sistemi për gjurmimin e artikujve piroteknikë”; Planifikohet të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2020.
- Projektligji “Për hedhjen në treg të produkteve piroteknikë”, i cili do të përafrojë pjesërisht Direktivën 2013/29/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 12 qershor 2013 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënien në dispozicion të tregut të produkteve piroteknike”. Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2019.
- Projektligji “Për hedhjen në treg të lëndëve plasëse për përdorim civil”, i cili do të përafrojë pjesërisht Direktivën 2014/28/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me vënien në dispozicion të tregut dhe mbikëqyrjen e eksplozivëve për përdorim civil. Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2019.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik për tension të ulët dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” që synon përafrimin e plotë me Direktivën 2014/35/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e ligjet e Shteteve Anëtare lidhur me vënien në dispozicion të tregut të pajisjeve elektrike të dizajnuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit (LVD)”. Planifikohet të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2019.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik për instrumentet e peshimit joautomatik dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” që synon përafrimin e plotë me Direktivën 2014/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e ligjet e Shteteve Anëtare lidhur me vendosjen në dispozicion në treg të instrumenteve jo-automatik. (NAWI)”. Planifikohet të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2019.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” që synon përafrimin e plotë me Direktivën 2014/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e ligjet e Shteteve Anëtare në lidhje me përputhshmërinë elektromagnetike (EMC)”. Planifikohet të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2019.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores Teknike për Pajisjet e Transportueshme me Presion” i cili do të përafrojë plotësisht Direktivën 2010/35/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 16 qershor 2010 mbi pajisjet

nën presion të transportueshme dhe shfuqizon Direktivat e Këshillit 76/767/KEE, 84/525/KEE, 84/526/KEE, 84/527/KEE dhe 1999/36/KE”. Planifikohet të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2019.

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimi i listës së standardeve të harmonizuara” për transpozimin e pjesshëm të Direktivës 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 16 prill 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënien në dispozicion të tregut të pajisjeve radiofonike dhe duke shfuqizuar Direktivën 1999/5/KE e cila ka qenë transpozuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 546, datë 13.6.2013. Planifikohet të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2019.
- Projektligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” që synon të transpozojë pjesërisht Direktivat 93/42 “Për pajisjet mjekësore”, Direktivën 90/385/KEE “Për kërkesat thelbësore, vlerësimin e konformitetit dhe markimin CE të pajisjeve të implantueshme aktive” si dhe Direktivën 98/79/KEE “Mbi kërkesat thelbësore, vlerësimin e konformitetit dhe markimin CE të pajisjeve të pajisjeve in vitro”. Planifikohet të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2019.

II.3.3.3. Masa të tjera të planifikuara

Nuk është parashikuar marrja e masave ligjore.

II.4 Masat procedurale

II.4.1 Kuadri politik dhe ligjor

Ka përafrim të pjesshëm në fushën e masave procedurale, veçanërisht në: armët e zjarrit; etiketimin dhe përzierjet e tekstit; dhe çmimet e produkteve medicinale.

U miratua Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” që shfuqizoi Ligjin Nr. 9048, datë 7.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” dhe Ligjin Nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, që përafroi pjesërisht Direktivën 2014/60/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 15 maj 2014 mbi kthimin e objekteve kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme nga territori i një Shteti Anëtar, si dhe Rregulloren e Këshillit Nr. 116/2009, datë 18 dhjetor 2008 mbi eksportin e mallrave kulturore.

Gjithashtu, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 278 datë 16.05.2018 “Për krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore, Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, Baza e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKIPK)”, administrohet pranë Ministrisë së

Kulturës, Qendra Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, për të gjitha kategoritë e poseduesve përmes Sistemit Informatik Kombëtar të Regjistrimit dhe Administrimit të Pasurive Kulturore e cila synon identifikimin, regjistrimin, ruajtjen dhe lidhjen në kohë reale *online* të këtij shërbimi me:

- Institucionet Shtetërore, Subjektet Private (Fizike/Juridike) që posedojnë dhe administrojnë Fonde të Pasurive Kulturore për regjistrimin dhe pajisjen me pasaportë për objektet pasuri kulturore në pronësi publike dhe private.
- Shërbimin doganor të Republikës së Shqipërisë për monitorimin e lëvizjeve dhe të pronësisë së objekteve të pasurive kulturore në pronësi publike dhe private brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Policinë e Shtetit për shkëmbim informacioni në sistem lidhur me rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore në vend dhe denoncimet nga Institucionet Ndërkombëtare që operojnë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë .
- Qytetarët për informim mbi procedurat e regjistrimit të pasurive kulturore kombëtare në pronësi private dhe publike, procedurat e lëvizjes brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për objektet trashëgimi kulturore
- Ndërveprimin në Gov-net për ofrim dhe marrje shërbimi *online* me institucionet dhe qytetarët për regjistrimin e pasurive kulturore kombëtare.

II.4.2. Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse janë palë të treta.

II.4.3. Masat e planifikuara 2019 – 2021

II.4.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk është parashikuar miratimi i politikave

II.4.3.2 Masat ligjore të planifikuara

Nuk është parashikuar marrja e masave ligjore.

II.4.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Nuk është parashikuar marrja e masave të tjera në këtë nënkapitull.

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total i institucionit koordinues për këtë kapitull	200.000	0	0
Buxheti total i institucioneve të tjera	150.000	0	0
Buxheti total i kapitullit	350.000	0	0

Kapitulli 2: Lëvizja e lirë e punëtorëve

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e *acquis* së BE-së

Legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve parashikon që qytetarët e një Shteti Anëtar kanë të drejtë të punojnë në një Shtet tjetër Anëtar, duke u mundësuar atyre të njëjtat kushte pune dhe sociale si punëtorët vendas. Lëvizja e lirë e personave bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Këto parime përfshijnë heqjen e pengesave për lëvizjen e lirë të punëtorëve, qasjen e barabartë në tregun e punës dhe ndalimin e diskriminimi. *Acquis* në këtë kapitull parashikon që shtetasit e BE-së kanë të drejtë të lëvizin dhe të punojnë në vende të tjera anëtare të BE-së, të qëndrojnë aty për këtë qëllim së bashku me familjet e tyre dhe të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët kombëtarë në kushtet e punës, si dhe në çështjet sociale dhe tatimore. Për më tepër, *acquis* përfshin instrumentet e BE-së për koordinimin e sistemeve të ndryshme kombëtare të sigurisë sociale.

Kapitulli është strukturuar si më poshtë:

- Aksesit në tregun e punës;
- Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

I.1.2. Kërkesat sipas MSA-së

Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit përmban detyrime të shumta, që burojnë nga dispozitat e neneve 48 dhe 49 të MSA, në fushën e qasjes në tregun e punës për shtetasit e BE-së në Republikën e Shqipërisë, lëvizjen e punëtorëve, kushtet e punësimit dhe trajnimit profesional. Një aspekt tjetër i lëvizjes së lirë të punëtorëve është të promovojë shkëmbimet rinore dhe përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe për punësimin dhe formimin profesional ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit parashikon që, në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme, Shqipëria dhe Shtetet Anëtare të BE-së të sigurojnë që shtetasit e vendit partner të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e tyre nuk janë objekt diskriminimi, për sa i përket kombësisë, kushteve të punës, shpërblimit apo pushimit nga puna.

Detyrimi i Shqipërisë për koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore buron nga nenet 48 e 99 të MSA-së. Nenet 46, 47, 49, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 70 SAA përcaktojnë shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e aksesit në tregun e punës për qytetarët e BE-së.

Trajtimi i punëtorëve që janë shtetas shqiptarë dhe të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar rregullohet sipas Neneve 46 dhe 47 të MSA.

I.2. Situata aktuale/Përmbledhje

Sa i përket aksesit në tregun e punës, qytetarët e BE kanë të drejtë të punojnë në Shqipëri pa leje pune. Kjo është në përputhje me dispozitat e Ligjit për të Huajt dhe ndryshimet e mëvonshme dhe aktet nënligjore të tij, të cilat parashikojnë që të huajt nuk do të kenë nevojë për leje pune ose certifikatë për regjistrimin e biznesit nëse janë shtetas të një Shteti Anëtar të BE-së ose shteti Schengen dhe banon ligjërisht në Shqipëri.

Ligji për të Huajt Nr 108/2013 dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij u miratuan në përputhje me rekomandimet e BE-së. Ligji synon përafrimin e rendit juridik shqiptar me *acquis* të BE-së. Më konkretisht, neni 72, shkronja a) e Ligjit 108/2013 “Për të huajt”, përcakton se: “Nuk pajisen me leje pune ose certifikatë regjistrimi të punës: a) shtetasit e një prej shteteve anëtare të Bashkimit Evropian të zonës Shengen që banojnë legalisht në territorin e Republikës së Shqipërisë që gëzojnë të drejtën e punësimit, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur punësimi është veçanërisht i lidhur me shtetësinë shqiptare, sipas legjislacionit shqiptar. Deklarimi i punësimit të tyre bëhet në zyrën përkatëse të punësimit nga punëdhënësi ose i vetëpunësuar, ose nga vetë investitori i huaj në zyrën e punësimit në vendin ku kryhet veprimtaria. Me qëllim që të lehtësohet zbatimi i këtij neni, është miratuar Urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr 70 datë 23 shkurt 2018.

Shtetasit e një prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të zonës Shengen, nuk janë subjekt i kuotave vjetore që ligji përcakton të miratohen çdo vit për hyrjen e punëtorëve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë. Germa a) e nenit 72 të ligjit Nr 108/2013, i ndryshuar si dhe Urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr 70/2018 për deklarimin për punësim, nuk përcaktojnë detyrimin për trajtimin brenda kuotave të shtetasve të vendeve anëtare të BE. Përkundrazi, pika 2 e nenit 84 të ligjit Nr 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, i jep të njëjtën përparësi si edhe shtetasve shqiptarë punëkërkues të papunë, shtetasve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen për të plotësuar një vend vakant pune të publikuar pranë zyrave të punës, para miratimit të kërkesës dhe lëshimit të lejes së punës shtetasit të huaj që aplikon për atë vend vakant pune.

Pavarësisht se, ligji për të huaj, nuk ka një përcaktim të veçantë referuar hyrjes në tregun e punës së anëtarëve të familjes së punëtorit migrant shtetas i një prej vendeve të BE, anëtarët e familjes së tij që janë shtetas të një prej vendeve anëtare të BE, gëzojnë të njëjtat të drejta si dhe punëtori migrant për t’u punësuar ose vetëpunësuar në territorin e RSH. Gjithashtu, ky ligj përcakton se, i jepet e njëjta përparësi si edhe shtetasve shqiptarë punëkërkues të papunë, anëtarëve të familjes të shtetasit të huaj me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë pavarësisht

shtetësisë, për të plotësuar një vend vakant pune të publikuar pranë zyrave të punës, para miratimit të kërkesës dhe lëshimit të lejes së punës një shtetasi të huaj që aplikon për atë vend vakant pune. (Ligji Nr 108/2013 “Për të huajt”, ndryshuar me ligjin Nr 74/2016 germa c) dhe ç), pika 2, neni 84).

Lidhur me aksesin në tregun shqiptar të punës, gjatë vitit 2018, (periudha janar – shtator 2018), kanë hyrë në tregun shqiptar të punës 584 shtetas me shtetësinë e vendeve anëtare të BE, nga të cilët 526 janë shtetas italianë dhe 58 janë shtetas rumunë.

Shtetasit italianë janë të përfshirë në tregun shqiptar të punës, kryesisht në shërbime dhe industrinë përpunuese. Konkretisht, 51% e tyre punojnë në aktivitete shërbimesh të tjera dhe 19% në industrinë përpunuese, ku pjesa më e madhe në industrinë e tekstileve dhe të veshjeve e ndjekur nga ajo e përpunimit të lëkurës dhe këpucëve. Gjithashtu, ata punojnë në aktivitetin e ndërtimit me 5%, aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike 5% dhe aktivitete të shëndetësisë dhe punës sociale 4,5%. Përsa i përket statusit të punësimit, shtetasit italianë punojnë, 74,5% si punëmarrës, 23% si të vetëpunësuar dhe 3% si investitorë. Ata e kanë të përqendruar aktivitetin e tyre kryesisht në rajonet Tirane, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Fier.

Ndërsa, shtetasit rumunë janë të përfshirë në tregun shqiptar të punës, kryesisht në aktivitete të ndërtimit dhe të shërbimeve të tjera. Konkretisht, 31% punojnë në aktivitete ndërtimi dhe 22.4% në aktivitete shërbimesh të tjera. Gjithashtu, ata punojnë në aktivitete të informacionit dhe komunikacionit 19%, aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike 15.5% dhe industrinë nxjerrëse 10.3%. Përsa i përket statusit të punësimit, shtetasit rumunë punojnë, 95% si punëmarrës dhe 5.1% si të vetëpunësuar. Ata e kanë të përqendruar aktivitetin e tyre kryesisht në rajonet Tiranë dhe Durrës.

Përshtatshmëria e skemave të sigurimeve shoqërore dhe të pensioneve profesionale rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe.

Një përpjekje për të përafruar më tej ligjin shqiptar me *acquis* të BE-së për lëvizjen e lirë të personave është parashikuar për fazat e mëvonshme. Rregullorja 883/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore dhe Rregulloren (EC) Nr. 987/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 16 shtatorit 2009 që përcakton procedurën për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 883/2004 mbi koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore do të bëhet direkt i zbatueshëm në lidhje me Shqipërinë në datën e aderimit. Në përgjithësi, Shqipëria është në një fazë të hershme në fushën e lirisë së lëvizjes të punëtorëve.¹⁴

¹⁴ Raporti i Komisionit të BE për Shqipërinë, 2018

I.3. Prioritetet

Fokusi kryesor i Qeverisë në fushën e punësimit të të huajve në Shqipëri për një periudhë afatgjatë është arritja e përputhshmërisë me aktet e BE-së lidhur me lëvizjen e lirë të punëtorëve. Kjo do të thotë se qytetarët e BE-së do të kenë akses për punësim në Shqipëri dhe do të trajtohen në mënyrë të barabartë me shtetasit shqiptarë në aspektin e punësimit, kushtet e punësimit, shpërblimit, studimit dhe formimit profesional.

Gjithashtu, në fushën e sigurimeve shoqërore një prioritet afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë është përmirësimi i skemës aktuale duke reformuar shtyllën e pensioneve publike. Reformimi sistematik do të synojë të rrisë qëndrueshmërinë financiare të skemës, duke forcuar lidhjen midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, duke krijuar një llogari personale për secilin kontribuues dhe përfitues për të arritur transparencën maksimale, si dhe përgatitjen dhe integrimin e skemës sonë në sistemin e Bashkimit Evropian.

Në adresim të rekomandimeve të Komisionit Evropian, Qeveria shqiptare ka përqendruar përpjekjet e saj në koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore për qytetarët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, si dhe punëtorët e Shteteve Anëtare të BE-së të punësuar në Shqipëri. Kjo përfshin nënshkrimin e marrëveshjeve të mbrojtjes sociale me shumë vende. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punëve të Jashtme po punon për të forcuar koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore me vendet ku ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve shqiptarë, veçanërisht në Itali dhe Greqi. Për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore ekzistojnë marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore me: Belgjikën, Republikën Çeke, Gjermaninë, Luksemburgun, Hungarinë, Austrinë, Rumaninë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Turqinë.

Negociatat po vazhdojnë me Zvicrën, Kosovën dhe Kanadanë. Ka pasur shkëmbime fillestare për koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore me vende si Bullgaria, Spanja, Franca dhe Kroacia. Kjo përfshin vazhdimin e negociatave dhe zbatimit të marrëveshjeve bilaterale të reja mbi sigurimet shoqërore, veçanërisht me vendet anëtare të BE-së, duke pasur parasysh se nuk është bërë progres gjatë periudhës raportuese lidhur me nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe për qytetarët e Shqipërisë.

Gjithashtu, në lidhje me përgatitjet për t'u anëtarësuar në EURES (Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Punësimit), Shqipëria ka krijuar një bazë të dhënash të integruar për Sistemin e Shërbimeve të Punësimit. Kjo do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet departamenteve të TI-së për gjendjen civile, sistemin e taksave, sistemin e kujdesit të detyrueshëm shëndetësor dhe sistemin e ndihmës ekonomike. Ky shënon një hap para në përgatitjen e një baze kombëtare të punësimit. Autoritetet shqiptare janë të angazhuar për të vijuar me përgatitjet për pjesëmarrje në programin EURES(deri në aderim) të punësimit dhe iniciativat për marrjen e hapave për krijimin e databasave të shërbimeve kombëtare të punësimit. Në këtë kuadër është miratuar VKM Nr 191 datë 9.3.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e shërbimeve të punësimit”. Ky vendim është në zbatim të Ligjit nr. 10325 “Për bazën e të dhënave shtetërore”

dhe synon të realizojë krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Shërbimeve të Punësimit. Objektivi i tij është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore, duke siguruar dhe ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, si dhe lidhjen me portalin e punësimit të Bashkimit Evropian EURES.

II.1 Aksesi në tregun e punës

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri i politikave në fushën e aksesit në tregun e punës përfaqësohet nga Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014-2020. Ky dokument strategjik synon të integrojë politikat ekonomike, arsimore, trajnimin dhe sipërmarrjen, duke prodhuar një plan veprimi që synon të nxjerrë shoqërinë shqiptare nga papunësia. Një mekanizëm për monitorimin e tij është gjithashtu në fuqi. Është publikuar raporti i parë vjetor për zbatimin e SKPA, sipas të cilit përparimi më i madh është arritur në fushën e politikave dhe shërbimeve të punësimit, ndërsa progresi ishte i kufizuar në fushën e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial, si dhe në lidhje me sistemin e qeverisjen së tregut të punës.

SKPA është në përputhje me vizionin dhe direktivat e Bashkimit Evropian, Strategjinë Evropiane të Punësimit 2020 dhe kërkesat për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Akti kryesor ligjor që rregullon regjimin e hyrjes, qëndrimit, punësimit dhe daljes së të huajve për në dhe nga Republika e Shqipërisë është Ligji nr. 108/201, datë 28.03.2013 “Për të huajt”, i ndryshuar. Ky ligj është në përputhje me disa akte të BE-së që kanë të bëjnë me emigracionin. Janë miratuar gjithsej 18 VKM bazuar në Ligjin për të Huajt, të cilat specifikojnë rregulla për lëshimin, refuzimin dhe anulimin e lejeve të punës.

Në përgjithësi kuadri ligjor ende nuk është plotësisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional që trajton lirinë e lëvizjes për punëtorët përbëhet nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Këshilli i Ministrave;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (ISKSH);
- Ministria e Brendshme;
- Ministria për Evropën dhe e Punët të Jashtme;
- Avokati i Popullit;

- INSTAT.

II.1.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.1.3.1. Kuadri i politikave të parashikuara

Strategjia Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planit të Veprimit, 2019 – 2022 është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2019.

II.1.3.2. Masat ligjore të parashikuara

Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin Nr 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar. Ndryshimet kanë si qëllim të arrijnë përafrim më të plotë me nenet 23 dhe 24 të Direktivës 2004/38/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 29 Prillit 2004 mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të Shteteve Anëtare duke ndryshuar Rregulloren (KEE) Nr 1612 / 68/360/EEC, 75/34/EEC, 75/35/EEC, 90/364/EEC, 90/365/EEC, dhe 93/96/EEC. Ky projektligj është parashikuar të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2021.

II.1.3.3 Masa të tjera të parashikuara

N/A

II.2. Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Koordinimi i skemave të sigurimeve shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera, në pajtim me Nenin 48 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, MFE ka ndërmarrë angazhimin për të koordinuar skemat e sigurimeve shoqërore, për të siguruar lirinë e lëvizjes së shtetasve shqiptarë dhe gjithashtu të drejtën e punëtorëve për të mbrojtur dhe garantuar me elementet e sigurimeve shoqërore. Procesi i koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore me vendet e tjera është një nga angazhimet thelbësore për t'u bërë pjesë e familjes evropiane.

Marrëveshjet e mëposhtme dypalëshe mbi sigurimet shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve përkatëse janë ratifikuar dhe kanë hyrë në fuqi me:

- Republikën e Maqedonisë, në fuqi nga 01.06.2016, e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr 123 datë 12.11.2015;
- Dukatin e Madh të Luksemburgut, në fuqi nga 01.07.2016, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr 42 datë 16.04.2015;
- Hungarinë, në fuqi nga 01.07.2016, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr 151 datë 21.12.2015;
- Republikën Çeke, në fuqi nga 01.02.2017, e ratifikuar me Ligjin Nr 34 datë 24.03.2016;
- Republikën Federale të Gjermanisë, në fuqi nga 01.12.2017, e ratifikuar me Ligjin Nr 23 datë 10.03.2016;
- Republikën e Austrisë, do të hyjë në fuqi nga 01.12.2018, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr 14 datë 29.12.2018.

Priten të hyjnë në fuqi marrëveshjet dypalëshe me:

- Rumaninë, e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr 42 datë 14.04.2016;
- Republikën e Kosovës, “Për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës për pension“ ratifikuar nga Parlamenti me Ligjin Nr 20 datë 12.04.2018.

Lidhur me marrëveshjet me:

- Kanadanë, e cila është e miratuar në parim me VKM-në Nr 336 datë 22.04.2015, në pritje të nënshkrimit;
- Konfederatën Zvicerane, kanë filluar procedurat teknike për nënshkrimin.

Lidhur me shtetet e mëposhtme:

- Malin e Zi, është shprehur një interesim i palës Malazeze për hapjen e bisedimeve për dakordësimin e një marrëveshjeje dypalëshe;
- Italia, është realizuar një takim në nivel ekspertësh ku janë prezantuar sistemet e sigurimeve shoqërore dhe mundësitë e bashkëpunimit, por akoma nuk ka ende një përgjigje pozitive për fillim negociatash;
- Bullgaria, është rënë dakord që të fillojnë negociatat, për hartimin e një marrëveshjeje të re që do të zëvendësonte marrëveshjen e vjetër me Bullgarinë, e hyrë në fuqi me dekretin nr. 1578, datë 20.11.1952, por ende nuk janë dakordësuar datat.

Në përgjithësi kuadri ligjor nuk është ende plotësisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së.

II.2.2 Institucionet Përgjegjëse

Kuadri institucional që trajton lirinë e lëvizjes për punëtorët përbëhet nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Këshilli i Ministrave;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- Ministria e Brendshme;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Avokati i Popullit;
- INSTAT.

II.2.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.2.3.1 Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.2.3.2 Masat ligjore të parashikuara

Projektligji “Për Ratifikimin e Marrëveshjes për Sigurimet Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë” synon transpozim të pjesshëm të Rregullores (EC) Nr. 883/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore. Është planifikuar për miratim brenda tremujorit të dytë të vitit 2019 dhe është nën përgjegjësinë e MFE.

Projektvendim “Për miratimin në parim të Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane”. Është planifikuar për miratim brenda tremujorit të dytë të vitit 2019.

Projektligj “Për ratifikimin e Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane”. Është planifikuar për miratim brenda tremujorit të katërt të vitit 2019.

Projektvendim “Për miratimin në parim të Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi”. Është planifikuar për miratim brenda tremujorit të parë të vitit 2020.

Projektligj “Për ratifikimin e Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi”. Është planifikuar për miratim brenda tremujorit të katërt të vitit 2020.

II.2.3.3 Masa të tjera të parashikuara

II. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

000 Lek

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit përgjegjës	1,240.000	1,240,000	0
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera	0	0	
Buxheti total i kapitullit	1.240.000	1,240,000	0

Shënim: Kostoja e zbatimit të marrëveshjeve për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve si (Austria, Kanadaja, Zvicra, Kosova) nuk është përfshirë këtu pasi nga zbatimi i këtyre marrëveshjeve nuk do të ketë efekte financiare të menjëhershme. Kjo sepse e drejta për përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, iu lind shtetasve shqiptarë në një periudhë të dytë, kur ata të kenë mbushur moshën për pension (grupmosha që ka emigruar në këto shtete pretendohet të jetë kryesisht në moshë të re dhe nuk është afër moshës së pensionit). Në këtë kontekst, nga zbatimi i marrëveshjeve me shtetet e lartpërmendura nuk rrjedhin efekte të menjëhershme financiare. Për momentin nuk të llogaritet numri i shtetasve shqiptarë që kanë emigruar në këto shtete dhe që janë afër moshës së pensionit. Për periudhën e zbatimit të PKIE, mund të llogaritet kostoja e zbatimit të marrëveshjeve të parashikuara.

Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e *acquis* e BE-së

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se e drejta e vendosjes e shtetasve dhe personave juridikë të BE-së në çdo Shtet Anëtar dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare, si në nenin 49 dhe 56 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFEU) nuk pengohet nga legjislacioni kombëtar, duke iu nënshtruar përjashtimeve të përcaktuara në Traktat. Pjesa thelbësore e *acquis* në këtë fushë është Direktiva 2006/123 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për shërbimet në tregun e brendshëm (Direktiva e Shërbimeve). Praktika ligjore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në lidhje me nenet 49 dhe 56 është gjithashtu pjesë e *acquis*.

Acquis në këtë kapitull është e natyrës horizontale dhe mund të ndahet në tre fusha të përgjithshme: i) e drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve (nenet 49 dhe 56 të TFEU dhe Direktiva e Shërbimeve); ii) njohja reciproke e kualifikimeve profesionale (së pari Direktiva 2005/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi njohjen e kualifikimeve profesionale e ndryshuar kohët e fundit nga Direktiva 2013/55/KE, ndryshimet e fundit 1 dhjetor 2017); dhe iii) shërbimet postare, të cilat përbëhen nga një kornizë rregullatore specifike sektoriale që siguron ofrimin e shërbimeve postare universale dhe krijimin e një tregu të brendshëm postar.

Në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime, Direktiva e Shërbimeve përmban dispozita që synojnë të lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për ofruesit e shërbimit, si dhe të ofrojnë shërbime të përkohshme ndërkufitare në një Shtet tjetër Anëtar. Direktiva është një instrument horizontal që mbulon një gamë të gjerë shërbimesh të ndryshme dhe që ka gjasa të ndikojë në një numër të konsiderueshëm të ligjeve dhe rregulloreve kombëtare. Zbatimi i saj kërkon që Shtetet Anëtare të ndërmarrin një kombinim të masave legjislative dhe jo-legjislative (masa organizative ose praktike). Për këtë arsye, dhe sa i përket legjislacionit zbatues, kërkohet një përzierje e masave legjislative specifike dhe horizontale, që ka të ngjarë të përfshijë ndryshimin e ligjeve ekzistuese, si dhe miratimin e legjislacionit të ri specifik dhe të një ligji kuadër horizontal. Dispozitat e Direktivës së Shërbimeve në masë të madhe bazohen në jurisprudencën relevante të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, të cilat mbeten plotësisht të zbatueshme. Direktiva kërkon caktimin e një Pike Kontakti të Vetëm (PKV), ku ofruesit e shërbimeve mund të marrin informacion elektronikisht dhe të plotë mbi procedurat administrative të kërkuara për akses dhe ushtrimin e aktiviteteve të shërbimit. Për më tepër, autoritetet e shteteve anëtare duhet të marrin pjesë në një sistem informacioni elektronik midis autoriteteve administrative (Sistemi i brendshëm i informacionit të tregut ose IMI) që lejon bashkëpunimin në mbikëqyrjen e aktiviteteve të shërbimeve dhe shkëmbimin efektiv të informacionit midis shteteve anëtare.

Përsa i përket njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale, Direktiva 2005/36, e ndryshuar, përcakton rregullat në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale ndërmjet shteteve anëtare për të lehtësuar aksesin në profesione të rregulluara për shtetasit evropianë që dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e tyre në një Shtet Anëtar tjetër sesa në atë ku ata fitojnë kualifikimet e tyre. Direktiva lehtëson gjithashtu ofrimin e shërbimeve të përkohshme dhe të rastësishme nga profesionistët (që mbulohen nga Titulli II i Direktivës). Për disa profesione të rregulluara, duhet të ndiqet një program i përbashkët trajnimi minimal, me qëllim që kualifikimi të njihet automatikisht në një Shtet Anëtar të BE (mbuluar nga Kapitulli III i Titullit III të Direktivës). Në rastin e profesioneve të sektorit të shëndetësisë, kërkesat minimale të trajnimit janë të detyrueshme në çdo Shtet Anëtar si kushte për aksesin në profesion edhe në nivel kombëtar. Përveç Direktivës së lartpërmendur, njohja e kualifikimeve profesionale për disa profesione udhëhiqet nga legjislacioni specifik. Brenda Kapitullit 3 ekzistojnë 5 direktiva të tilla.

Dy direktiva kanë të bëjnë me profesionet që merren me produkte toksike: Direktiva 74/557/KEE dhe Direktiva 74/556/KEE, sepse disa Shtete Anëtare kërkojnë kualifikime specifike për profesionet që merren me produkte toksike. Sidoqoftë, profesionistët që vijnë nga një shtet anëtar i BE-së që nuk kërkojnë kualifikime të tilla ende mund t'i kryejnë këto aktivitete nëse ata ofrojnë dëshmi për përvojën profesionale. Direktivat mbulojnë profesionistët që merren me substancat toksike në vijim: pesticide, substanca helmuese, produkte medicinale (fitofarmaceutike dhe produkte të destinuara për përdorim si ruajtës të ushqimit), herbicide, produkte të dëmshme për përdorim në industri, gazra toksike, produkte mjekësore kirurgjikale, bactericide, germicide dhe desinfektantë) dhe produktet kozmetike dhe ngjyruarit që përmbajnë substanca helmuese.

Dy direktiva të tjera mbulojnë profesionin e avokatëve, Direktiva 77/249/KEE dhe Direktiva 98/5/KE, e para merret me ofrimin e shërbimeve dhe e dyta me të drejtën e vendosjes.

Direktiva e fundit rregullon profesionin e agentëve tregtarë, ndërmjetësve të vetëpunësuar të autorizuar për të negociuar shitjen dhe blerjen e mallrave për dhe në emër të një personi tjetër (Direktiva 86/653/KEE). Direktiva harmonizon rregullat për: të drejtat dhe detyrimet e agentëve tregtarë dhe drejtorëve të tyre; shpërblimi i agentëve tregtarë; dhe lidhjen dhe përfundimin e kontratave të agjencisë, çdo dëmshpërblim ose kompensim për agentët komercialë kur përfundon një kontratë.

Acquis e Legjislacionit të Bashkimit Evropian për shërbimet postare synon hapjen e sektorit të shërbimeve postare ndaj konkurrencës në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, brenda një kuadri rregullator i cili garanton ofrimin e shërbimeve postare universale. Pjesa kryesore e legjislacionit përfshin tre direktivat postare në vijim: i) direktiva e parë (kornizë) është ajo 97/67/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e ndryshuar nga ii) Direktiva e dytë postare 2002/39/KE e Parlamentit dhe Këshillit, dhe iii) Direktiva e tretë postare 2008/6/KE. *Acquis* parashikon krijimin e një tregu të brendshëm për shërbimet postare dhe promovon një shërbim postar të cilësisë së lartë për përdoruesit përfundimtarë. Përsa i përket kapacitetit administrativ, krijimi i

një Autoriteti Kombëtar Rregullator (NRA) të pavarur në këtë fushë, është vendimtar për zbatimin e duhur të legjislacionit relevant të BE-së.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Nenet e MSA-së që kanë rëndësi për këtë kapitull janë: 50, 57, 58, 70 dhe 100.

Neni 50 kërkon që Shqipëria të lehtësojë krijimin e veprimtarisë në territorin e saj nga kompanitë dhe shtetasit e Komunitetit (duke përfshirë filialet dhe degët), duke u dhënë atyre trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u akordohet kompanive të tij ose ndonjë kompanie të vendit të tretë, cilado që është më e mirë. Neni 57 kërkon që të dy palët të ndërmarrin hapa të domosdoshëm për të lejuar në mënyrë progresive furnizimin e shërbimeve nga kompanitë përkatëse ose shtetasit të cilët janë themeluar në një palë tjetër nga ajo e personit për të cilin shërbimet janë të destinuara. Në hap me këtë proces liberalizimi, palëve u kërkohet të lejojnë lëvizjen e përkohshme të personave fizikë që ofrojnë shërbimin ose që janë të punësuar nga ofruesi i shërbimit si personel kyç. Neni 58 kërkon që Shqipëria të mos vendosë ndonjë masë apo veprimi të ri që i bëjnë kushtet më të rrepta për furnizimin e shërbimeve nga shtetasit e BE-së në krahasim me situatën ekzistuese përpara se të hyjë në fuqi të MSA-së.

Sipas nenit 70 të MSA-së, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* të BE-së, si dhe të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe të zbatohet siç duhet.

I.2. Situata aktuale / Përmbledhja

Sipas Raportit të Komisionit 2018, Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime.

Në lidhje me të drejtën e vendosjes, Shqipëria ka disa ligje horizontale që kontribuojnë në sigurimin e lirisë së vendosjes, si dhe në legjislacionin sektorial që rregullon vertikalisht lirinë e vendosjes të sektorit. Ligji Nr. 66/2016, i miratuar më 9.06.2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë” dhe që ka hyrë në fuqi më 24 shtator 2016, është pjesa kryesore e legjislacionit në këtë fushë, pjesërisht i përafruar me Direktivën 2006/123/KE për shërbimet në fushën e brendshme të tregut. Ligji parashikon një periudhë kalimtare për përfundimin e shqyrtimit të legjislacionit ekzistues të sektorit dhe krijimin e një pike kontakti të plotë funksionale.

Përsa i përket kualifikimeve profesionale, Ligji Nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” është ndryshuar me Ligjin Nr. 90/2014, datë 17.07.2014 dhe Ligjin Nr. 10357, datë 16.12.2010, duke shtuar në listën aktuale të dhjetë profesioneve të

rregulluara dy profesione të tjera, punonjës social dhe psikolog (së bashku me 1. Mjekësi e përgjithshme, 2. Stomatologji/dentistri, 3. Farmacist, 4. Infermiere, 5. Mami, 6. Fizioterapist, 7. Veteriner, 8. Arkitekt, 9. Inxhinier, 10. Mësues. Aplikantët për ushtrimin e këtyre profesioneve i nënshtrohen provimeve shtetërore të organizuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Është nxjerrë Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 115 datë 13.03.2018 “Për ngritjen e Grupit të Punës për ndryshimin e Ligjit Nr. 10171 datë 22.10.2009 ‘Për profesionet e rregulluara’”.

Gjithashtu, Shqipëria është pjesë e planit shumëvjeçar të veprimit në Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA). Një nga shtyllat e këtij plani është njohja reciproke e kualifikimeve profesionale mes 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Planit Shumëvjeçar i Veprimit në Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA) është nënshkruar nga kryeministrat e gjashte vendeve të rajonit në Trieste.

Për këtë qëllim u miratua Urdhri i Kryeministrit Nr. 99, datë 16.07.2018, “Për ngritjen e grupit negociator në negocimin e projekt marrëveshjes rajonale ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale për doktorët, dentistët, arkitektët dhe inxhinierët e ndërtimit”.

Në kuadër të përafrimit të kualifikimeve profesionale në fushën e drejtësisë janë miratuar dy ligje gjatë vitit 2018.

Përsa i përket shërbimeve postare, Ligji Nr. 46/2015, datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” është plotësisht në përputhje me Direktivën 97/67/KE, i ndryshuar. Ai përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve postare në një treg të hapur, sigurimin e një shërbimi universal postar dhe financimin e shërbimeve universale. Ligji përcakton parimet tarifore dhe transparencën e llogarive për ofrimin e shërbimeve universale, përcaktimin e standardeve të cilësisë për ofrimin e shërbimeve universale, si dhe garanton funksionimin e autoritetit të pavarur kombëtar rregullator.

Në fushën e shërbimeve postare, legjislacioni është i përafruar plotësisht me Direktivën 97/67/KE të amenduar me Direktivën 2002/39/KE dhe Direktivën 2008/6/KE.

Autoriteti i Komunikimit Elektronik dhe Postar është institucioni rregullator përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në këtë fushë.

I.3. Prioritetet

Prioriteti kryesor në fushën e së drejtës së vendosjes është përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me Direktivën e Shërbimeve. Ligji horizontal Nr. 66/2016 dhe aktet nënligjore zbatuese të tij, që të zbatohet siç duhet brenda afatit të caktuar duhet të shoqërohet me zbatimin e procesit të

shqyrtimit të legjislacionit. Ky do të jetë një proces gjithëpërfshirës që do të kërkojë angazhimin e pothuajse të gjitha ministrive në shqyrtimin e legjislacionit që mbulon të gjithë sektorët e ekonomisë. Screening është vetëm një pjesë e procesit të përafrimit. Për t'u konsideruar i përfunduar, legjislacioni duhet të shoqërohet me plane veprimi për rishikimin dhe shfuqizimin e legjislacionit ekzistues jo në përputhje me Ligjin Nr. 66/2016. Sipas këtij Ligji, procesi i shqyrtimit duhet të përfundojë brenda shtatorit 2019.

Në fushën e kualifikimeve profesionale, prioritet kryesor është harmonizimi i legjislacionit me Direktivën e Kualifikimeve Profesionale. Ai kërkon një qasje strategjike për të adresuar këtë prioritet, sipas nevojës, shqyrtimit të parë të legjislacionit / sistemit kombëtar në lidhje me Direktivën e Kualifikimeve për 7 profesione nën sistemin e njohjes automatike, dhe së dyti hartimin e një plani për përafrimin e mëtejshëm me Direktivën e Kualifikimeve, si dhe me 5 direktivat e tjera për avokatët, profesionistët e produkteve toksike dhe agjentët tregtarë.

Përafrimi dhe zbatimi i Kualifikimeve Kombëtare Kuadër në Shqipëri duhet të jetë në përputhje me Kualifikimet Evropiane Kuadër dhe direktivat e BE-së si dhe përgatitjen e kuadrit sektorial që do të ndihmojë në procesin e njohjes së kualifikimeve në vendet e tjera evropiane.

Ndërkohë, forcimi i kapaciteteve institucionale në të dy fushat, e drejta e vendosjes dhe njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale, është me rëndësi të madhe.

Sa i përket shërbimeve postare, pasi që politika dhe kuadri ligjor tashmë janë në fuqi, prioritet mbetet zbatimi i atij kuadri ligjor. Rishikimi i planit të veprimit për dokumentin e politikave do të jetë në fokus në vitet e ardhshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë së performancës së shërbimeve postare, veçanërisht në lidhje me tregtinë elektronike (e-commerce).

II.1. E drejta e vendosjes dhe liria për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare

II.1.1. Politikat dhe kuadri ligjor

Ligji Nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë” është miratuar më 9.06.2016 dhe ka hyrë në fuqi më 24 shtator 2016. Ky ligj paraqet parimet themelore dhe kërkesat për të siguruar të drejtën e vendosjes dhe të drejtën e ndjekjes së veprimtarisë për ofruesit e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar kështu cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre.

Legjislacioni tjetër i rëndësishëm horizontal përfshin:

- Ligji nr. 9723, datë 3.05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, që rregullon regjistrimin e biznesit;

- Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, që rregullon licencimin e biznesit;
- Ligji nr. 131 / 2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, që rregullon funksionimin e NBC-së si një ofrues shërbimi me një ndalesë;
- Ligji nr. 44 / 2016 “Kodi i Procedurave Administrative”, i harmonizuar me *acquis* të BE-së që rregullon procedurat administrative të administratës publike në të gjitha nivelet, qendrore dhe lokale;
- Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, që rregullon njohjen dhe përdorimin e nënshkrimit elektronik.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) (bashkimi në një institucion i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit) është në funksion që nga prilli i vitit 2016. Ky institucion funksionon si një ndalesë për regjistrimin e bizneseve dhe lirin e licencave, autorizimet dhe avancimet, heqjen e mëtejshme të pengesave administrative për bizneset. Përveç kësaj, disa nga shërbimet e QKB-së, në lidhje me regjistrimin dhe licencimin, mund të bëhen elektronikisht pa pagesë.

Sa i përket Ligjit Nr. 66/2016 për shërbimet, ai parashikon kërkesa të detyrueshme për:

- njoftimin e legjislacionit të ri të ardhshëm, para miratimit të tij formal, në ministrinë që mbulon ekonominë, në mënyrë shmangiet dhe mospërputhjeve në legjislacionin e ardhshëm;
- monitorimin dhe të harmonizimin në përputhje me rrethanat, legjislacionin ekzistues sektorial, brenda një periudhe kalimtare prej tre vjetësh pas hyrjes në fuqi të Ligjit.

Janë miratuar dy vendime të Këshillit të Ministrave për të siguruar zbatimin e mirë të ligjit në lidhje me të dy proceset e lartpërmendura.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 300 datë 5.04.2017 “Për procedurën e njoftimit dhe formularin për vlerësimin e përputhshmërisë së akteve të reja ligjore të sektorit me dispozitat e Ligjit Nr. 66/2016 ‘Për shërbimet’”. Ky vendim përcakton rregullat, procedurat dhe formatet standarde për të gjitha ministrinë dhe autoritetet e tjera rregullatore, me qëllim zbatimin e procedurës së njoftimit për legjislacionin e ardhshëm para miratimit. Formatet standarde të vlerësimit përmbajnë të gjitha elementet që sigurojnë përputhshmërinë me ligjin 66/2016;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 299, datë 5.04.2017 “Për përcaktimin e autoriteteve përgjegjëse për shqyrtimin e legjislacionit dhe miratimin e metodologjisë për shqyrtimin e kriterëve ekzistues dhe metodologjinë e shqyrtimit të përputhshmërisë së kriterëve ekzistues që garantojnë të drejtën e themelimit me Ligjin Nr. 66/2016 “Për shërbimet”.

Një draft i parë i Planit të Veprimit të Integruar është përgatitur për të zbatuar VKM-në Nr. 299/2017, dhe për të siguruar një mënyrë të strukturuar të kryerjes së procesit të shqyrtimit të legjislacionit. Ai përcakton: a) të gjithë sektorët dhe aktivitetet e shërbimeve të tyre që do të shqyrtohen (përfshihen dhe përjashtohen nga sfera e Direktivave të Shërbimeve); b) institucionet përgjegjëse dhe c) afatin kohor. Ndërkohë, shqyrtimi i këtyre dispozitave ligjore për

përputhshmërinë me Direktivën e Shërbimeve është finalizuar për këta sektorë: Minierat, Veterinarinë, Tatimet, Shërbimet Sociale dhe Profesionet Ligjore (Avokatët, Noterët, Përmbauesit dhe Ndërmjetësit).

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor përgjegjës për fushën e politikave është ministria përgjegjëse për tregtinë, në momentin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Ajo gjithashtu është përgjegjëse për koordinimin e procesit të përgjithshëm të screening. Meqenëse kjo fushë është shumë horizontale nga natyra e saj, në parim, të gjitha ministritë dhe institucionet përgjegjëse për politikën për çdo sektor të shërbimeve specifike, janë përgjegjëse për të siguruar përputhjen me Direktivën e Shërbimeve. Në nivelin e ministrive, lista relevante përcaktohet me Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 299/2017 dhe përbëhet nga këto ministri (të rishikuara sipas strukturës së re të ministrive deri në shtator 2017):

- Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF)
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)
- Ministria e Drejtësisë (MD)
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE)
- Ministria e Kulturës (MK)
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

Këto ministri dhe institucionet e tyre vartëse janë të ngarkuara për zbatimin dhe shqyrtimin e Planit të Veprimit të Integruar, siç përcaktohet me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 299/2017.

II.1.3. Masat e parashikuara 2019 – 2021

II.1.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk është planifikuar miratimi i dokumenteve të reja të politikave në këtë nënkapitull.

II.1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk është planifikuar miratimi i akteve të reja në këtë nënkapitull.

II.1.3.2. Masa të tjera të planifikuara

Shqyrtimi i legjislacionit ekzistues sektorial për të gjitha shërbimet, siç përcaktohet me Ligjin Nr. 66/2016 dhe me VKM Nr. 299/2017, dhe siç parashihet në Planin e Veprimit të Integruar.

II.2. Njohja e kualifikimeve profesionale

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Më 17.7.2014 u miratua Ligji Nr. 90/2014 "Për një shtesë në Ligjin Nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" duke shtuar në listën aktuale të dhjetë profesioneve të rregulluara dy profesione të tjera, punonjës social dhe psikologun. Nga lista e profesioneve të rregulluara, provimet shtetërore zhvillohen vetëm për profesionet e mëposhtme:

- mjek i mjekësisë,
- dentist,
- farmacist,
- infermiere,
- mami,
- fizioterapist,
- logoped,
- teknik i imazhit,
- teknik i laboratorit,
- mësues.

Ekzistojnë disa Urdhra Profesional në fushën mjekësore në Shqipëri të tillë:

- Urdhri i mjekut të përgjithshëm,
- Urdhri i stomatologut,
- Urdhri i farmacistit;
- Urdhri i infermierit (i cili mbulon profesionet e mëposhtme: e infermierit, fizioterapistit, logopedit, teknikut laborant dhe teknikut imazherist);
- Urdhri i psikologut;
- Urdhri i punonjës social.

Në kuadër të përafrimit të direktivës së kualifikimeve profesionale në fushën e drejtësisë janë miratuar Ligji Nr. 55/2018 "Për Profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligji Nr. 26/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 'Për ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" Nr. 10385 datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) është përgjegjëse për profesionet e rregulluara në lidhje me kualifikimet e arsimit të lartë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) është përgjegjëse për profesionet e rregulluara në lidhje me kualifikimet profesionale.

II.2.3. Masat e planifikuara 2019 – 2021

II. 2.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk është parashikuar miratimi i dokumenteve të reja të politikave.

II.2.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Përafrimi i plotë i Direktivës 36/2005/KE, e ndryshuar, për sa ka të bëjë me profesionet e rregulluara në lidhje me kualifikimet e arsimit të lartë, do të realizohet brenda tremujorit të katërt të vitit 2020.

II. 2.3.3. Masa të tjera të planifikuara

Nuk është planifikuar miratimi i masave të reja ligjore.

II.3 Shërbimet postare

II.3.1 Kuadri politik dhe ligjor

Politika e zhvillimit të shërbimit postar në Republikën e Shqipërisë është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 625, datë 24.07.2013. Ajo përcakton liberalizimin e mëtejshëm të tregut të shërbimeve postare nëpërmjet reduktimit të menjëhershëm të zonë së rezervuar nga 100 gram në 50 gram dhe heqjen e zonës së plotë të rezervuar në vitin 2016.

Shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë rregullohen me Ligjin Nr. 46/2015, datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”. Ky Ligj është plotësisht i përafruar me Direktivën 97/67/KE, të ndryshuar nga Direktiva 2002/39/KE dhe Direktiva 2008/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 20 shkurt 2008. Ligji përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve postare në një treg të hapur, të një shërbimi universal postar dhe të financimit të shërbimeve universale. Ligji përcakton parimet tarifore dhe transparencën e llogarive për ofrimin e shërbimeve universale, përcaktimin e standardeve të cilësisë për ofrimin e shërbimeve universale, si dhe garanton funksionimin e autoritetit të pavarur kombëtar rregullator.

Bazuar në këtë ligj janë miratuar disa akte nënligjore, si më poshtë:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 360, datë 11.05.2016 “Për miratimin e rregullave për themelimin e fondit universal të shërbimit postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit në rast të bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimeve postare universale”. Vendimi siguron rregulla për fondin e shërbimit universal për kompensimin e kostos neto të shërbimeve postare universale në përputhje me dispozitat e *acquis* të BE-së;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 239, datë 02.05.2018 “Për miratimin e rregullave për caktimin e ofruesit të Shërbimit Universal Postar”. Vendimi siguron rregullat për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar me konkurrencë publikë si dhe caktimin e zonës minimale për ofrimin e shërbimit universal postar;
- Rregullorja Nr. 41, datë 03.03.2016 “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos së shërbimit postar universal”, miratuar me vendimin e Bordit Drejtues të AKEP Nr. 2670, datë 3.03.2016;
- Rregullorja Nr. 42, datë 03.03.2016 “Për llogaritjen e kostove neto të shërbimit postar universal”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP-it nr. 2671, datë 3.03.2016;
- Rregullorja Nr. 45, datë 27.10.2016 “Metodologjia e Inspektimit të Ofruesve të Shërbimeve Postare” miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr. 2694, datë 27.10.2016;
- Rregullore Nr. 40, Datë 17.12.2015 për “Të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”;
- Rregullore Nr. 39 datë 17.12.2015 për “Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”;
- Rregullore Nr. 20, datë 28.12.2015 për “Procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare;
- Rregullore Nr. 38, datë 19.11.2015 “Për autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare;
- Rregullore Nr. 3, datë 29.10.2015 për “Ofrimin e Shërbimit Universal”.

Pas miratimit të Ligjit të ri, skema e re për licencimin e operatorëve është në përputhje me nenin 9 të Direktivës Postare dhe zona e rezervuar nuk është më në vend që nga 1 janari 2017.

II.3.2. Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse përfshijnë si në vijim:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE)
- Autoriteti i Komunikimit Elektronik dhe Postar (AKEP)

II.3.3. Veprimet e planifikuara

II.3.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 - 2021

Dokumenti i politikës postare është parashikuar të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2019.

II.3.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 - 2021

Nuk është planifikuar miratimi i masave të reja ligjore.

II.3.3.2. Masa të tjera të planifikuara

Nuk është planifikuar miratimi i masave të reja ligjore.

III. Alokimet financiare

III. 1. Buxheti:

000 Lek

Viti	2018	2019	2020
Buxheti total i institucionit koordinues për këtë kapitull	0	0	0
Buxheti total i institucioneve të tjera.	0	0	0
Buxheti total i kapitullit	0	0	0

Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e *acquis* së BE-së

Përsa i përket lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave, Shtetet Anëtare duhet të heqin, me disa përjashtime, të gjitha kufizimet për lëvizjen e kapitalit si brenda BE-së, ashtu edhe midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. Dispozitat përkatëse të Traktatit që rregullojnë lirinë e lëvizjes së kapitalit janë të sanksionuara në nenet 63 deri 66 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Përkufizimi i llojeve të ndryshme të lëvizjes së kapitalit mbështetet në Aneksin I të Direktivës 88/361/KEE. Praktika relevante e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Komunikimeve të Komisionit 97/C220/06 dhe 2005/C293/02 japin interpretim shtesë të neneve të mësipërme.

Liberalizimi i pagesave është gjithashtu një kërkesë thelbësore për lëvizjen e lirë të kapitalit. Rregullorja EC (Nr) 924/2009 për pagesat ndërkufitare rregullon tarifën e vendosura nga një institucion për transaksionet e pagesave elektronike në euro dhe valuta të tjera të njoftuara të Shtetit Anëtar (p.sh. transfertat e kredive, debitime të drejtpërdrejta, pagesa me karta, tërheqje nga ATM-të). Direktiva 2015/2366/BE për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm ka për qëllim lehtësimin e transaksioneve të pagesave brenda BE-së, duke krijuar një kornizë ligjore për tregun e vetëm “të brendshëm” të pagesave. Direktiva e-money 2009/110/EC që ndryshon Direktivat 2005/60/EC dhe 2006/48/EC dhe ndryshon Direktivën 2000/46/EC parashikon kornizën legjislative për marrjen e hapave të mëtejshme, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të parave elektronike si dhe krijon një treg të vetëm në shërbimet e parasë elektronike.

Pjesa kryesore e legjislacionit në fushën kundër pastrimit të parave është Direktiva (EU) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, e cila ndryshon Rregulloren (EU) 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizon Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/EC. Direktiva kërkon që subjektet që i nënshtrohen asaj të zbatojnë kujdesin e duhur ndaj klientit dhe të raportojnë transaksione të dyshimta, si dhe të marrin masa të rëndësishme mbështetëse, të tilla si ruajtja e të dhënave, trajnimi dhe vendosja e procedurave të brendshme. Për më tepër, Rregullorja (EC) 1889/2005 e cila rregullon paratë *cash* që hyjnë ose dalin nga BE, dhe Rregullorja (EC) 1781/2006 (që do të zëvendësohet nga Rregullorja (EU) 2015/847) parashikojnë që transferimet e fondeve duhet të shoqërohen me informacione kuptimplota mbi pagesin për të siguruar gjurmueshmërinë e plotë të fondeve.

Për të luftuar me sukses krimin financiar, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të ketë një kapacitet efektiv administrativ dhe zbatues, duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, me atë të Bashkimit Evropian rrjedh nga nenet 60-62 dhe 70 të MSA-së. Pastrimi i parave është parashikuar në nenet 4 dhe 82 të MSA-së.

Neni 62 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit parasheh që gjatë tre viteve të para pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të marrin masa që lejojnë krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e mëtejshëm gradual të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe që deri në fund të vitit të tretë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit përcakton modalitetet për zbatimin e plotë të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e kapitalit.

I.2 Situata Aktuale/Përmbledhje

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit.

Në përgjithësi, Shqipëria ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA në këtë fushë. Blerja e pasurive të paluajtshme nga të huajt mbetet subjekt i kufizimeve: atyre nuk u lejohej të blejnë tokë bujqësore, pyje, livadhe dhe kullota. Shqipëria është e vonuar në përmbushjen e angazhimeve të marra përsipër në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) të vitit 2006, për të ndryshuar regjimin për blerjen e pronës nga qytetarët/entitetet e BE deri në vitin 2016.

Ndryshimet në Ligjin për Investimet e Huaja kanë zgjatur mbrojtjen e veçantë që gëzojnë investorët/investimet e huaja sipas legjislacionit shqiptar, deri më 31 dhjetor 2018, mbrojtje nga e cila do të përfitojnë gjithashtu investimet strategjike sipas Ligjit për Investimet Strategjike.

Sa i përket sistemeve të pagesave, bankat e huaja kanë të drejtë të hapin degë dhe agjenci në Shqipëri dhe të ofrojnë pagesa ndërkufitare. Kuadri ligjor kombëtar është pjesërisht i harmonizuar me *acquis*. Ndryshimet e bëra në dhjetor 2016, në rregulloret mbi licencimin e aktiviteteve të institucioneve financiare jo-bankare dhe mbi instrumentet e pagesave elektronike, pjesërisht në përputhje me Direktivën Evropiane “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm” dhe me Direktivën “Për institucionet e parasë elektronike” kanë parashikuar procedura përjashtuese lidhur me kërkesat e licencimit për subjektet ose personat që ofrojnë

shërbime të pagesave nëpërmjet telefonit celular ose mjeteve të tjera elektronike, si dhe gjithashtu për një rritje të kapitalit fillestar minimal të kërkuar për institucionet e parasë elektronike.

Kuadri ekzistues ligjor në luftën kundër pastrimit të parave është pjesërisht në përputhje me *acquis* e BE-së. Disa përparime u bënë me një ndryshim në rregulloren e Bankës së Shqipërisë mbi të njëjtën tematikë.

Kapacitetet administrative të Njesisë Shqiptare të Inteligjencës Financiare (FIU), si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe Prokurorinë janë forcuar. Gjate vitit 2018 është përmbyllur edhe rekrutimi i stafit shtesë të FIU dhe njësia aktualisht ka një organikë prej 39 personash. Numri i raporteve të aktivitetit të dyshimtë (RAD) është rritur gradualisht, kështu në 2016 janë raportuar 1292 RAD, në 2017 janë raportuar 1384 RAD, ndërsa për vitin 2018 ruhet i njëjti trend si për vitin 2017.

Në 2016, strukturat e zbatimit të ligjit sekuestruan rreth 47.6 milionë euro në llogaritë bankare dhe pronat e lidhura me veprat penale të pastrimit të parave dhe një shtesë prej 38.8 milionë euro u konfiskua në vitin 2017. Për vitin 2018, përveç pasurive të paluajtshme të sekuestruara, rezultojnë edhe rreth 9 milion Euro fonde në banka që janë produkt i sistemit parandalues në vend dhe FIU.

Megjithatë, një rritje e lehtë është vërejtur në numrin e dënimeve të gjykatave të apelit për akuzat të veprave penale të pastrimit të parave (4 në 2017 nga vetëm 2 në vitin 2016).

I.3. Prioritetet

Prioritetet janë si më poshtë:

- Të vijohet me harmonizimin e legjislacionit me rekomandimet e FATF si dhe indirekt dhe gradualisht me *acquis* e BE-së në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Zbatimi i planit të veprimit për blerjen e tokës nga të huajt.

II.1 Lëvizjet e kapitalit dhe pagesat

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia ndërsektoriale për reformën mbi të drejtat e pronësisë 2012-2020 dhe plani i saj i Veprimit është dokumenti kryesor i politikave për të drejtat e pronësisë. Përveç kësaj, plani i

veprimet për blerjen e tokës nga të huajt është dokumenti i politikave që planifikon hapat për liberalizimin gradual në këtë fushë.

Strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për vitet 2018-2020 gjithashtu përfshin çështje që lidhen me lëvizjet e kapitalit dhe pagesat.

Akte ligjore dhe rregullative me rendësi në fushën e lëvizjes së kapitalit dhe pagesave që janë përafruar me legjislacionin e Bashkimit Evropian :

- Ligji Nr. 7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, i ndryshuar është pjesërisht i përafruar me nenin 63 të TFBE-së;
- Rregullorja e Bankës së Shqipërisë nr. 70, datë 14.10.2009 “Për veprimtarinë valutore”, i ndryshuar, përafruar pjesërisht me nenin 63 të TFBE-së dhe Direktivën 88/361/EEC;
- Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përafruar pjesërisht me Direktivën 2013/36/EU dhe Rregulloren 575/2013/EU;
- Vendimi nr. 12, datë 23.02.2011 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren ‘Për funksionimin e Sistemit të Pagesave Ndërbankare Shqiptare - AIPS’ dhe në Rregulloren ‘Për funksionimin e Sistemit të Kleringut të Sistemit Automatik AECH’, Rregullorja nr. 70, datë 14.10.2009 “Për veprimtarinë valutore”, e ndryshuar, të Bankës së Shqipërisë, janë pjesërisht në përputhje me Direktivën 88/361/KEE të datës 24 qershor 1988 mbi zbatimin e nenit 67 të Traktatit.
- Ligji Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe Ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” janë përafruar pjesërisht me Direktivën 2015/2366/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 nëntor 2015 mbi shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm.

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për të drejtat pronësore.

Banka e Shqipërisë monitoron pagesat ndërkombëtare që rezultojnë nga tregtia e jashtme, transaksionet jo-tregtare dhe angazhimet e bankave të tjera shqiptare, sipas kontratave me Shtetet e huaja, banka dhe kompani.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Ujore është përgjegjëse për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore.

II.1.3 Masat e parashikuara 2019 – 2021

II.1.3.1 Kuadri politik i planifikuar

Nuk është parashikuar miratimi i dokumenteve të reja të politikave.

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara

Nuk është parashikuar miratimi i akteve ligjore që synojnë përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

II.1.3.3 Të tjera masa të planifikuara

Zbatimi i:

- Strategjisë ndërsektoriale për Reformën e të Drejtave Pronësore 2012-2020 dhe Planit të saj të Veprimit;
- Strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2018-2020.

II.2 Sistemet e pagesave

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri i politikave miratohet përmes Strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2018-2020.

Kuadri kryesor ligjor është themeluar me Ligjin nr. 133, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave”, i cili përafrohet pjesërisht me Direktivën 98/26/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 maj 1998 mbi përfundimin e shlyerjes në sistemet e pagesave dhe shlyerjes së letrave me vlerë; Direktiva 2002/47/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 qershorit 2002 mbi marrëveshjet e kolateralit financiar; Parimet Themelore të BIS për Sistemet e Pagesave me Rëndësi Sistemike; Protokolli (Nr. 4) mbi Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane. Pjesërisht të përafuara me Direktivën 2002/47/EC janë gjithashtu Ligji nr. 9974, datë 28.07.2008, “Për kontratën e riblerjes së letrave me vlerë”, Ligji nr. 8537, datë 18. 10. 1999 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar dhe Ligji nr. 110/2016, datë 27.10.2016 “Për falimentimin” dhe Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Rregullorja nr. 11, datë 06.02.2008 “Për instrumentet e pagesave elektronike” të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregullorja nr. 14, datë 11.03.2009 “Për licencimin dhe zhvillimin e veprimtarisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Rregullorja nr. 2, datë 17.01.2013 “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e institucioneve financiare jo-bankare” të Bankës së Shqipërisë, janë pjesërisht në përputhje me Direktivën 2009/110/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 16 shtator 2009 mbi marrjen e masave, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e biznesit të institucioneve të parasë elektronike.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Banka e Shqipërisë
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

II.2.3 Masat e parashikuara 2018-2020

II.2.3.1 Kuadri politik i planifikuar

Strategjia e zhvillimit afat-mesëm të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2018 – 2020.

II.2.3.2 Masat ligjore të planifikuara

Projektligji që përaftron Direktivën 2015/2366/BE “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm” është planifikuar të miratohet në vitin 2019.

II.1.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Strategjia e zhvillimit afat-mesëm të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2018-2020

II.3 Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

II.3.1 Kuadri politik dhe ligjor

- Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar dhe rregulloret e zbatimit të tij, janë të përafuar pjesërisht me Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi parandalimin e

përdorimit të sistemit financiar me qëllim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

II.3.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Brendshme
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (GDML)

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (GDML) është Njësia e Inteligjencës Financiare në Shqipëri, nën Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e fuqizuar nga legjislacioni AML/CFT (Anti Money Laundering and Countering the Financing of Terrorism) për të mbledhur, menaxhuar dhe analizuar raportet e paraqitura nga personat që kanë detyrimin për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. DPPP iu shpërndan informacion autoriteteve shqiptare të zbatimit të ligjit nëse ekzistojnë baza për të dyshuar se pastrimi i parave ose financimi i veprave terroriste janë kryer ose po kryhen aktualisht. Gjithashtu bashkëpunon ngushtë me Njësitë e tjera të Inteligjencës Financiare në mbarë botën. DPPP gjithashtu ka rol mbikëqyrës, me të cilin kontrollon përputhshmërinë e personave që kanë detyrimin për të raportuar, me kërkesat e Ligjit AML/CFT dhe në këtë drejtim bashkëpunon me të gjitha autoritetet mbikëqyrëse dhe në veçanti me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Gjithashtu, DPPP-ja në mënyrë proaktive bashkëpunon me organet vendore të zbatimit të ligjit dhe rregullatorët dhe homologët ndërkombëtarë për të ndihmuar në mënyrë efektive në zbulimin, vlerësimin dhe zhdukjen e kërcënimeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në ekonominë kombëtare.

II.3.3 Masat e parashikuara 2018-2020

II.3.3.1 Kuadri politik i planifikuar

N/A

II.3.3.2 Masat ligjore të planifikuara

N/A

II.3.3.3 Masa të tjera të planifikuara

N/A

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

N/A

Aktivitetet në lidhje me Bankën e Shqipërisë do të financohen nga buxheti i Bankës së Shqipërisë, jo nga buxheti i shtetit.

Kapitulli 5: Prokurimi publik

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e *acquis* së Bashkimit Evropian

Acquis e prokurimit publik bazohet në parimet e përgjithshme siç janë transparenca, trajtimi i barabartë, konkurrenca e lirë dhe mosdiskriminimi që rrjedhin nga Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), Pjesa e tretë, Titulli IV dhe Titulli VII, dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED). Këto parime zbatohen për të gjitha procedurat e prokurimit duke përfshirë edhe ato që janë jashtë fushëveprimit të direktivave të prokurimit të BE-së për shembull, duke pasur parasysh vlerën e tyre (prokurimi nën kufijtë e BE-së) ose objektin e prokurimit.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit përfshihen në Nenin 74 “Kontratat Publike”, i cili përcakton se Shqipëria dhe BE do të konsiderojnë hapjen e dhënies së kontratave publike në bazë të mosdiskriminimit dhe reciprocitetit, veçanërisht në kontekstin e OBT-së, si një objektiv të dëshirueshëm.

Neni 70 i MSA-së, në anën tjetër, përcakton detyrimin e përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë për të përafruar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së.

I.2. Situata aktuale

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje në prokurimin publik. Legjislacioni i prokurimit publik është rishikuar në vitet e fundit në mënyrë që të përafrohet më tej me parimet e përgjithshme të BE-së dhe *acquis* përkatëse për dhënien e kontratave publike. Në këtë kuadër, ndryshimet e fundit në Ligjin për prokurimin publik u miratuan në prill të vitit 2017 me ligjin 47/2017 duke përmirësuar sistemin e shqyrtimit të ankesave që lidhen me procedurat e prokurimit dhe garantuar pavarësinë e Komisionit të Prokurimit Publik si organi më i lartë administrativ përgjegjës për këtë qëllim.

Gjithashtu, nga fundi i vitit 2017 dhe gjatë vitit 2018 janë marrë një sërë masash dhe janë miratuar një sërë aktesh nënligjore të cilat synojnë rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit dhe të efencës në përdorimin e fondeve publike.

Nga ana tjetër, është duke u punuar intensivisht për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar të prokurimit me direktivat përkatëse të BE-së si më poshtë:

1. Sa i përket prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, me Urdhrin nr. 128, datë 29.08.2018 të Kryeministrit, është ngritur dhe ka funksionuar Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e projektligjit “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, i drejtuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe me përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Grupi i punës ka finalizuar projektligjin, i cili synon një përafrim të pjesshëm të Direktivës 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009 “Për koordinimin e procedurave për dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe që ndryshon Direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE”. Parashikohet që projekt ligji të dërgohet për miratim në Këshill të Ministrave brenda vitit 2018 dhe në vijim të kalojë në Kuvend.

2. Në kuadër të përmirësimit të legjislacionit shqiptar të prokurimit publik dhe të përafrimit të tij me direktivat e BE në këtë fushë, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 129, datë 29.08.2018, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës, i drejtuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, me përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me qëllim rishikimin e ligjit për prokurimin publik.

Gjithashtu, ky grup pune synon të përafrojë legjislacionin shqiptar të prokurimit publik me direktivat 2014/24 dhe 2014/25.

3. Pavarësisht se nuk ka qenë e planifikuar, gjatë vitit 2018 është punuar gjithashtu edhe për ndryshimin e ligjit të koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat sidomos sa i takon adresimit të problematikave të vëna në dukje në mënyrë të vazhdueshme nga Komisioni Evropian.

Konkretisht, ATRAKO ka përgatitur një projektligj të ri i cili shfuqizon propozimet e pakërkuara dhe bonusin prej 10% në rastin e tyre si edhe heqjen nga lista e përjashtimeve nga fusha e zbatimit të ligjit të projekteve të rrugëve me rëndësi kombëtare.

I.3. Prioritetet

Siç vlerësohet nga Raporti i KE-së i vitit 2018 për Shqipërinë, legjislacioni aktual shqiptar i prokurimit publik është pjesërisht i përafëruar me *acquis* e BE-së. Kjo është vërejtur edhe në Raportin e Bankës Botërore për Sistemin e Prokurimit Publik në Shqipëri si dhe në Raportin e Monitorimit të SIGMA mbi Parimet e Administratës Publike që u publikua më 9 mars 2018.

Në këtë kuadër duke marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet e shprehura në dokumentet e mësipërm, prioritetet kryesore për kapitullin 5 paraqiten si më poshtë:

- Hartimi i një Strategjie Kombëtare për Prokurimin Publik me qëllim identifikimin dhe adresimin e të gjitha problematikave;
- Përafrimi i mëtejshëm i ligjit të prokurimit publik me Direktivat 2014/24 dhe 2014/25 si edhe me direktivat për shqyrtimin e ankesave;
- Miratimi dhe implementimi i një ligji të ri për prokurimet e mbrojtjes dhe sigurisë i cili transponon Direktivën 2009/81;
- Përafrimi i mëtejshëm i ligjit për koncesionet me Direktivën 2014/23.

II.1.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ishte fillimisht i përafruar pjesërisht me direktivat e mëposhtme të BE-së që janë shfuqizuar:

- Direktiva 2004/18/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 31 mars 2004 mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave për punë publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimeve publike;
- Direktiva 2004/17/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 31 Mars 2004 që koordinon procedurat e prokurimit të subjekteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare.

Ligji është i përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2014 mbi prokurimin publik dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/EC;
- Direktivën e Këshillit 89/665/EEC e datës 21 dhjetor 1989 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave publike të furnizimit dhe të punëve publike (ndryshuar me Direktivën 2007/66/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2007 për ndryshimin e Direktivave të Këshillit 89/665/EEC dhe 92/13/EEC në lidhje me përmirësimin e efektivitetit të procedurave të rishikimit në lidhje me dhënien e kontratave publike).

Sa i përket koncesioneve, Ligji Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” është i përafruar pjesërisht me Direktivën 2014/23/BE për dhënien e kontratave të koncesionit.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Agjencia e Prokurimit Publik;

- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (ATRAKO);
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Brendshme (Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit).

II.1.3. Aktivitetet e planifikuara

II.1.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik është parashikuar të hartohet nga APP në bashkëpunim me një sërë institucionesh të përfshira në sistemin e prokurimit si edhe në konsultim të vazhdueshëm me SIGMA/OECD dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë.

Ky dokument mendohet të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave në tremujorin e tretë të vitit 2019 në përputhje me Direktivën e Këshillit 92/13/KEE e 25 shkurtit 1992 për bashkërendimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit mbi procedurat e prokurimit të subjekteve që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit, Direktivën e Këshillit e datës 21 dhjetor 1989 për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave për furnizim publik dhe punëve publike (89/665/KEE), Direktivën 2007/66/KE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Dhjetor 2007 që amendon Direktivat e Këshillit 89/665/KEE dhe 92/13/KEE në lidhje me përmirësimin e efektivitetit të procedurave të rishikimit në lidhje me dhënien e kontratave publike.

II.1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Masat ligjore dhe periudhat e miratimit janë të planifikuara për kapitullin 5 si më poshtë:

- Projektligji ri i Prokurimit Publik, në përfaqësim të Direktivës 2014/24/BE planifikuar për tremujorin e katërt 2019;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përfaqësim të Direktivës 2014/24/BE dhe 2015/25/BE planifikuar për tremujorin e parë 2020;
- Ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve/PPP”, në përfaqësim të Direktivës 2014/24/BE planifikuar për tremujorin e dytë 2020;
- Projektligji për disa ndryshime në Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe PPP”, në përfaqësim të Direktivës 2014/23 planifikuar për tremujorin e dytë 2019;

- Projektligji “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, në përafrim të Direktivës 2009/81 planifikuar për tremujorin e dytë 2019;
- Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, në përafrim të Direktivës 2014/23 planifikuar për tremujorin e katërt 2019.

II.1.3.3. Aktivitete të tjera të planifikuara

Nuk ka masa të tjera të planifikuara në këtë kapitull.

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull e institucionit lider	5,330	5,330	n/a
Buxheti total për këtë kapitull e institucioneve të tjera	718	n/a	n/a
Buxheti në TOT për këtë kapitull	6,048	5,330	n/a

Kapitulli 6: E drejta e ndërmarrjeve

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e *acquis* e BE-së

Ky kapitull përfshin rregulla të harmonizuara në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, duke përfshirë kërkesat për raportim financiar, që synojnë lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së themelimit.

Në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, Direktiva për bashkërendimin e masave mbrojtëse që kërkohet nga shoqëritë tregtare për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të palëve të treta (2009/101/KE -Direktiva e mëparshme për Shoqëritë tregtare) përfshin masat mbrojtëse që parashikojnë kërkesat e detyrueshme dhënien e informacioneve shpjeguese, duke kufizuar arsyet për pavlefshmërinë e detyrimeve të lidhura nga shoqëritë tregtare, si dhe duke kufizuar arsyet për pavlefshmërinë e shoqërive publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar. Direktiva (89/666/KEE) parashikon gjithashtu kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me degët e hapura në një Shtet Anëtar të qeverisur nga ligji i një shteti tjetër. Direktiva 2012/30 / BE (e ndryshuar nga Direktiva 77/91/KEE) përmban rregulla për formimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre. Direktiva 2009/102/KE kërkon nga shtetet anëtare të sigurojnë që ligji i tyre i brendshëm të njohë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar me një dege.

Direktivat 2011/35/BE dhe Direktiva 82/891/KEE harmonizojnë rregullat kombëtare për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve në kontekstin e bashkimit të brendshëm dhe ndarjeve të shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar. Direktiva 2009/109/KE paraqet kërkesa të thjeshtuara për raportim dhe dokumentim në rastin e bashkimeve dhe ndarjeve. Direktiva 2005/56/KE për bashkimet ndërkufitare parashikon rregullat dhe procedurat për të lehtësuar bashkimet ndërkufitare të shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuara. Direktiva 2004/25/KE për ofertat e marrjes në detyrë përcakton rregullat e harmonizuara për të lehtësuar blerjet ndërkufitare brenda BE-së, si dhe përmirësimin e transparencës dhe mbrojtjen e aksionarëve të pakicave në kontekstin e marrjeve të tilla. Direktiva 2012/17/BE për ndërlidhjen e regjistrave qendrorë, tregtarë dhe të shoqërive përcakton krijimin e sistemit të interkonjeksionit të regjistrave të biznesit, që përfshin një platformë qendrore evropiane përmes së cilës regjistrat kombëtarë të biznesit do t'i bëjnë të disponueshme informacionet e tyre në lidhje me mekanizmat e zbulimit ndërkufitar, duke përfshirë edhe portalin e-Drejtnesisë.

Acquis e BE-së gjithashtu parashikon forma të caktuara evropiane ligjore: p.sh. Grupimi Evropian i Interesit Ekonomik (GEIE - Rregullorja 2137/85) dhe Shoqëria Evropiane (Societas Europaea ose SE - Rregullorja 2157/2001), duke lënë disa aspekte të strukturës së tyre të

brendshme dhe të funksionimit të rregullohen përmes legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare.

Direktiva 2007/36/KE e të drejtave të aksionarëve paraqet standardet minimale për ushtrimin e të drejtave të caktuara të aksionarëve në shoqëritë e listuara. Rekomandimet e Komisionit (2004/913/KE, 2005/162/KE dhe 2009/385/KE, dhe 2009/384/KE) adresojnë parimet e një qeverisjeje korporatash për institucionet financiare në lidhje me shpërblimin e drejtorëve, pavarësinë e drejtorëve joekzekutivë dhe komisionet e bordit. Rekomandimi i Komisionit 2014/208/BE mbi cilësinë e raportimit të qeverisjes së korporatave ('pajtohet ose shpjegon') jep udhëzime se si shoqëritë e listuara duhet të shpjegojnë ndryshimet nga rekomandimet e kodeve përkatëse të qeverisjes së korporatave.

Direktiva 2004/109/KE kërkon harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me shoqëritë e listuara.

Në fushën e kontabilitetit, *acquis* përfshin njohjen, vlerësimin dhe shënime shpjeguese për pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara (Direktiva 2013/34/BE) të shoqërive publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar. Kjo direktivë gjithashtu përcakton se kush ka nevojë për një auditim, si dhe detyrimet e publikimit. Përveç kësaj, Rregullorja (KE) Nr. 1606/2002 mbi aplikimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, kërkon që shoqëritë tregtare të BE-së të listuara në një treg të rregulluar të hartojnë pasqyrat financiare të tyre të konsoliduara në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të cilat janë miratuar nga Bashkimi Evropian. Sipas kësaj rregulloreje, Shtetet Anëtare gjithashtu mund të vendosin të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për pasqyrat financiare individuale dhe / ose të konsoliduara të shoqërive tregtare.

Direktiva 2006/43/KE për auditimet ligjore harmonizon rregullat duke përfshirë, ndër të tjera, miratimin dhe regjistrimin e auditëve ligjorë, sigurimin e jashtëm të cilësisë, mbikëqyrjen publike, pavarësinë e audituesit dhe zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Amendimi i Direktivës 2014/56/BE përcakton kërkesat shtesë për të përmirësuar cilësinë e auditimit, me fokus në pavarësinë e audituesit, raportet e auditimit dhe mbikëqyrjen e auditimit publik. Rregullorja e re 537/2014/BE paraqet kërkesa specifike lidhur me auditimin ligjor të Njësive Ekonomike me Interes Publik (PIE). PIE-të janë institucione të kreditit, shoqëri të listuara, ndërmarrje të sigurimeve, dhe subjektet të tjera të përcaktuara si të tilla nga Shtetet Anëtare. Rregullorja gjithashtu parashton kërkesa specifike për organizimin e sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe kontrollon firmat e auditimit të cilat auditojnë PIE-të.

I 1.2. Kërkesat e MSA-së

Në përputhje me detyrimet e parashikuara në nenet 70 (3), 49, 50 (1), 51 (1), 55 (1) dhe 56 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria është e angazhuar të përafrojë legjislacionin e shoqërive tregtare me *acquis* të BE-së.

Neni 49 kërkon që legjislacioni shqiptar të ketë koncepte të përcaktuara qartë për shoqëritë tregtare, filialet, degët dhe ndërmarrjet.

Përveç kësaj, neni 50 parashikon lehtësimin e fillimit të aktiviteteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga shoqëritë dhe qytetarët e BE-së, duke garantuar trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i akorduar shoqërive të saj ose shoqërive në një vend të tretë, si dhe bashkëpunëtorët dhe degët e tyre.

Neni 51 i MSA-së parashikon që çdo Palë mund të rregullojë vendosjen dhe funksionimin e shoqërive dhe shtetasve në territorin e saj, për sa kohë që këto rregullore nuk krijojnë diskriminim ndaj shoqërive dhe shtetasve të Palës tjetër në krahasim me shtetasit dhe shoqëritë e saj. Krijimi dhe zbatimi i një kuadri ligjor tregtar në përputhje me standardet e BE-së, krijimi i shoqërive tregtare, zvogëlimi i barrierave të hapjes së biznesit, thjeshtësimi dhe standardizimi i praktikave të biznesit në përputhje me praktikat ndërkombëtare.

I.2. Gjendja aktuale / Përmbledhja

Në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, legjislacioni shqiptar është përgjithësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare” rregullon formimin, organizimin dhe zhvillimin e organizatave të biznesit në Shqipëri. Ligji përputhet kryesisht me legjislacionin përkatës të BE-së, me amendamentet e bëra me kalimin e kohës. Progres i mëtejshëm është bërë me miratimin e Ligjit Nr. 110/2012 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare” që përafrojnë legjislacionin shqiptar me kërkesat e direktivës 2005/56/KE të BE-së, datë 26 tetor 2005 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar” e ndryshuar.

Është përfunduar infrastruktura teknike për aplikimin e nënshkrimit elektronik (e-signature). Janë akredituar dy ofrues të Shërbimit të Certifikimit (CSHC) një publik, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), dhe një CSHC private, Aleat Ltd.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) funksionon si një qendër e vetme me një ndalesë për regjistrimin dhe licencimin/lejimi. QKB mban regjistrin tregtar, i cili është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit dhe ai mbahet në format elektronik. Të gjitha shërbimet e QKB-së, me përjashtim të çregjistrimit të biznesit dhe revokimin vullnetar të licencës/lejes, ofrohen elektronikisht në portalin qeveritar e-albania.

Subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë në regjistrin tregtar edhe pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Dorëzimi i tyre bëhet në formë elektronike nëpërmjet portalit e-albania.

Me asistencën financiare të Bankës Botërore, QKB ka qenë pjesë e projektit “Përmirësimi i cilësisë së Raportimit Financiar”, i përfunduar më nëntor të vitit 2018, i cili ndër të tjera:

- Mundëson një mënyrë të re të depozitimit të pasqyrave financiare gjithmonë nëpërmjet sistemin online ku informacioni financiar do të jetë i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit.
- Mundëson implementimin e formatit të ri (sistem) për dorëzimin e pasqyrave financiare në QKB, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albanian, duke përdorur një format komunikimi elektronik (XML).

Përsa i përket ofertave të marrjes në detyrë, Shqipëria ka transpozuar plotësisht Direktivën 2004/25/KE “Për ofertat e marrjes në detyrë” sipas Ligjit Nr. 10236 datë 18.2.2010 “Për marrjen nën kontroll të shoqërive me ofertë publike”.

Në fushën e kontabilitetit të korporatave, prej vitit 2008 janë shpallur të detyrueshme për zbatim Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (përfshirë përditësimet e vazhdueshme të tyre) dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Ligji për kontabilitetin parashikon kriteret që duhet të plotësojnë njësitë ekonomike për përcaktimin e standardeve të raportimit financiar. Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar përkthehen në gjuhën shqipe nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit janë miratuar nga viti 2008 dhe ndryshimet e tyre janë miratuar që nga korriku 2014 me datë efektive 1 janar 2015. Përmirësimi dhe rishikimi i standardeve kombëtare kontabël është një proces i vazhdueshëm, i cili realizohet nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Kërkesat e standardeve kombëtare të përmirësuara janë në përputhje me Standardi Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) për Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla (SME-të), ndërsa paraqitja e pasqyrave financiare është plotësisht e përafuar me kërkesat e Direktivës së BE-së 2013/34 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e amenduar (Direktiva e Kontabilitetit). Gjatë vitit 2018, është miratuar ligji i ri i kontabilitetit, ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i cili ka një përafrim të pjesshëm me Direktivën nr. 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Mbi pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të ndërmarrjeve”, që ndryshon Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe shfuqizon Direktivat e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE”, e ndryshuar me Direktivën 2014/95/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 22 tetor 2014 dhe Direktivën e Këshillit 2014/102/BE, datë 7 nëntor 2014. Ligji i ri siguron harmonizimin me Direktivën e kontabilitetit në lidhje me klasifikimin e njësive ekonomike, grupeve të njësive ekonomike si dhe me kërkesat e raporteve të ndryshme të menaxhimit. Konkretisht, ligji synon të arrijë këto objektiva:

- Përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së dhe konkretisht me Direktivën nr. 2013/34/BE të Parlamentit Evropian;
- Klasifikimin e njësive dhe grupeve ekonomike, për efekt të standardeve kombëtarë apo ndërkombëtarë të kontabilitetit; hartimin e raporteve financiare dhe jo financiare, të cilët japin një pamje të plotë të zhvillimit dhe politikave të ndërmarrjes; paraqitjen e raportit të pagesave që u bëhen autoriteteve shtetërore nga ana e industrisë nxjerrëse ose shfrytëzimit për lëndë drusore të pyjeve, për qëllime të raportimit financiar;
- Të lehtësojë barrën e raportimit financiar për personat fizikë, mikronjësitë dhe njësitë e vogla ekonomike, duke rritur transparencën e raportimit financiar për të gjitha njësitë ekonomike;
- Qartësimin e terminologjive përkatëse ku janë hasur problematika, me synim unifikimin dhe përmirësimin e zbatueshmërisë;
- Përmirësimi dhe rregullimi ligjor i standardeve të raportimit të pasqyrave financiare të njësive ekonomike ka rëndësi të veçantë për faktin se, nëpërmjet këtij procesi, sigurojmë pasqyra financiare të besueshme dhe transparente, të cilat janë të domosdoshme për të gjitha palët e interesuara si: administrata shtetërore, sistemi bankar dhe financiar, si dhe vetë bizneset.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me *acquis* për pasqyrat financiare vjetore dhe të konsoliduara.

Kapaciteti i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, i cili përkthen pa ndryshime nga origjinali SNRF-të, harton dhe mirëmban standardet e kontabilitetit si dhe monitoron zbatimin e të dyja seteve të raportimit financiar duhet të përforcohet dhe më shumë. Gjithsesi, theksojmë se në ndryshimet ligjore të reja, në ligjin e ri të kontabilitetit, është parashikuar detyrë specifike për KKK, në nenin 24, pika f) e cila përcakton “të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar”, e cila nuk ka qenë e përfshirë në ligjin e mëparshëm.

Lidhur me auditimin ligjor, Ligji Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” është amenduar dhe ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2016. Amendamentet synuan krijimin e bordit të mbikëqyrjes publike si një strukturë e përhershme nga burimet e veta financiare. Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i themeluar si autoritet i pavarur rregullator me burimet e tij financiare shërben për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të jenë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë e auditimeve të kryera. Qëllimi i sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese është të rrisë sigurinë, që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik. Audituesit ligjorë dhe firmat e auditimit zbatojnë standardet ndërkombëtare të auditimit - të përkthyer dhe botuara në gjuhën shqipe - dhe i nënshtrohen trajnimit të vazhdueshëm profesional. Ligji për Auditimin Ligjor përcakton dispozitat për etikën profesionale. Bordi i Mbikëqyrjes Publike mund të delegojë sigurimin e cilësisë së auditimeve ligjore të jo-PIE, te organizata profesionale e audituesve ligjorë. Përpjekjet e mëtejshme janë të nevojshme për t'u përafruar me *acquis* më të fundit për auditimin ligjor.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka miratuar disa akte nënligjore lidhur me funksionimin dhe organizimin e saj, si më poshtë vijon:

- Statutin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”;
- Rregulloren nr. 1, datë 26.07.2017 “Për mbledhjen e të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, i ndryshuar;
- Rregulloren nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e komisionit të provimeve të aftësive profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”;
- Rregulloren nr. 4, datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”;
- Rregulloren nr. 6, datë 31.05.2018 “Për procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale”;
- Kodi i Etikës së Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i cili përcakton standardet etike, parimet e punës dhe vlerat themelore, në të cilat Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Sekretariati dhe Komisionet e tij Teknike duhet të punojnë.
- Vendimet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike mbi vërtetimet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, mbi regjistrimin për provimet e sezonit 2018 si dhe mbi procedurat e rishikimit.

Aktualisht, Bordi i Mbikëqyrjes Publike është duke punuar në hartimin e një manuali për sigurimin e cilësisë së auditimit ligjor. Ky manual është përgatitur si një referencë për t'i mundësuar BMP-së të zhvillojë dhe zbatojë një sistem të kontrollit të sigurimit të cilësisë të shërbimeve të monitorimit dhe auditimit në Shqipëri për subjektet me interes publik dhe jo-publik, duke përfshirë monitorimin dhe inspektimin e sistemeve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të zbatuara nga audituesit ligjorë / firmat e auditimit, si dhe inspektimet e angazhimeve individuale të auditimit.

I.3. Prioritetet

Prioritetet janë:

- Të rrisë përpjekjet në përafrimin e legjislacionit e saj me *acquis* në fushën e kontabilitetit dhe auditimit dhe të përforcojë më tej kapacitetet zbatuese të këtij legjislacioni;
- Të garantojë transparencë të plotë të pasqyrave financiare të shoqërive tregtare në regjistrin e biznesit.

II.1.1 Legjislacioni Tregtar

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Pjesa më e rëndësishme e legjislacionit në fushën e të drejtës së shoqërive është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare”, e cila rregullon formimin, organizimin dhe drejtimin e organizatave të biznesit në Shqipëri. Ligji është amenduar në vitin 2011 me Ligjin Nr. 10475, datë 27.10.2011 “Për një ndryshim në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për të përshtatur nivelin e kapitalit minimal për shoqëritë aksionare me kërkesat e kapitalit të Direktivës së Dytë të Ligjit për Shoqëritë, Direktiva e Dytë e Këshillit 77/91/KEE. Ndryshimet u bënë në vitin 2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me qëllim harmonizimin me direktivat e reja të BE-së:

- Direktiva 2009/109/KE në lidhje me kërkesat e raportimit dhe informacionet në rast të bashkimeve dhe ndarjeve, si dhe;
- Direktiva 2009/101 e masave për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të palëve të treta.

Ndryshimet parashikojnë rregullat për zbulimin e informacionit, mbrojtjen e palëve të treta që ndërveprojnë me shoqëritë, duke ofruar një listë të plotë të shkaqeve të pavlefshmërisë, shkrirjeve ndërkufitare dhe kërkesave për raportim dhe dokumentim për bashkimet dhe ndarjet. Për të lehtësuar zbatimin e ligjit në praktikë, komenti i ligjit është finalizuar dhe publikuar në të dy gjuhët në janar të vitit 2017. Ai përfshin në një dokument të vetëm paketën e plotë dhe të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e një shoqërie në Shqipëri dhe u shërben praktikuesve ligjor, zyrtarëve të politikave, si dhe komunitetit të biznesit.

Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, është amenduar në shkurt të viti 2015 me Ligjin Nr. 8/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007”, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, duke u përshtatur më tej me Direktivën 2009/101/KE me qëllim dorëzimin në formë elektronike të balanceve vjetore dhe raporteve të auditimit nga shoqëritë tregtare. Kodi i Qeverisjes së Korporatave u miratua nga Këshilli Konsultativ i Biznesit në dhjetor 2011. Kodi siguron që shoqëritë shqiptare të jenë të qeverisura mirë dhe të qëndrueshme për një afat të gjatë dhe, si rrjedhim, të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Ligji Nr. 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare” ka përafruar Direktivën 2005/56/KE “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar” të amenduar. Ligji rregullon procedurat, autoritetet përgjegjëse të përfshira në rastet e shkrirjes së jashtme dhe të brendshme ndërmjet një shoqërie shqiptare dhe një shoqërie të themeluar në një shtet anëtar të BE-së, duke lehtësuar bashkimin pa kaluar në likuidim. Për të lehtësuar zbatimin e ligjit në praktikë, i) një koment i ligjit dhe një ToT për noterët është bërë, pasi ata janë caktuar nga ligji me detyrën e shqyrtimit të ligjshmërisë së bashkimit; ii) 15 forma të regjistrimit ndërkufitar janë në dispozicion në QKB.

Ligji Nr. 10236, datë 18.2.2010 “Për marrjen në dorëzim të shoqërive me ofertë publike”, ka transpozuar plotësisht Direktivën 2004/25/KE “Për ofertat e marrjes në detyrë”. Ligji zbatohet për ofertat publike për blerjen e letrave me vlerë të lëshuara nga një shoqëri aksionare e themeluar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizuar në tregun e letrave me vlerë të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Qendra Kombëtare e Biznesit

I.1.3. Veprimet e planifikuara

II. 1.3.1. Korniza e Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka zhvillim të ri

II. 1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka zhvillim të ri

II. 1.3.2. Veprime të tjera të planifikuara

Nuk ka zhvillim të ri

II.1. Kontabiliteti dhe auditimi

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Auditimi

Ligji Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Direktivën përkatëse të BE në fushën e auditimit ligjor . U miratua Ligji Nr. 47/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 091, datë 05.03.2009, ‘Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar’”.

Ligji, duke përfshirë amendamentet, është pjesërisht në përputhje me direktivën 2014/56/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 16 prill 2014 që ndryshon Direktivën 2006/43/KE për auditimet ligjore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara dhe Rregulloren BE Nr. 537/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 16 prill 2014 mbi kërkesat specifike lidhur me auditimin ligjor të subjekteve me interes publik dhe shfuqizimin e Vendimit 2005/909/KE të Komisionit.

Fokusi kryesor i amendamenteve është forcimi i pavarësisë dhe kapaciteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike(POB) dhe krijimi i një strukture mbështetëse profesionale të përhershme, e cila do të ndihmojë POB dhe do të angazhohen në kontrollin e sigurimit të cilësisë, veçanërisht të atyre entiteteve me interes publik.

Kontabiliteti

Që nga viti 2008, sipas Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të amenduar, janë përkthyer rregullisht në gjuhën shqipe nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Llogarive (NAC) të gjitha ndryshimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar siç është publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), Londër. Ndryshimet e SNRF-ve bëhen të detyrueshme me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë si dhe publikohen në faqen elektronike të MFE dhe NAC. Në përputhje me praktikën vjetore të BSNK-së, përgatitet dhe publikohet versioni i konsoliduar i SNRF-ve në gjuhën shqipe në faqen e internetit të NAC.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe Bankën Botërore ka miratuar ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Ligji i ri i miratuar synon përafrimin e mëtejshëm me Direktivën Nr. 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian e datës 26 qershor 2013 “Lidhur me pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet në lidhje me lloje të caktuara të ndërmarrjeve”, që amendon Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe shfuqizon Direktivat e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE, duke mbështetur kështu angazhimin strategjik të vendit në Bashkimin Evropian.

Miratimi i këtij ligji u realizua brenda tremujorit të dytë të vitit 2018.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- Qendra Kombëtare e Biznesit;

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

II.1.3. Masat e planifikuara 2019 – 2021

II. 1.3.1. Korniza e politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka zhvillim

II. 1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Gjatë vitit 2018 është miratuar Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Gjatë periudhës kohore 2019-2021, në mbështetje të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 të auditimit ligjor dhe Ligjit të ri të kontabilitetit nr. 25/2018, janë parashikuar të miratohen brenda vitit 2019 aktet nënligjore të mëposhtme:

- Projektvendimi “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”;
- Projektvendimi “Për miratimin e rregullores së brendshme së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”.

II. 1.3.2. Veprime të tjera të planifikuara

Nuk ka zhvillim

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

000 Lek

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total i institucionit koordinues për këtë kapitull	0	0	0
Buxheti total i institucioneve të tjera.	0	0	0
Buxheti total i kapitullit	0	0	0

Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e *acquis* e BE-së

Kapitulli paraqet një vështrim të situatës aktuale të pronësisë intelektuale në Shqipëri, duke përfshirë njohjen me legjislacionin në fuqi dhe ndryshimet përkatëse por dhe rezultatet konkrete të punës të dy institucioneve përgjegjëse. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale dhe Ministria e Kulturës/Drejtoria e të Drejtës së Autorit janë institucionet kryesore përgjegjëse, të angazhuara direkt me çështjet e Pronësisë Intelektuale në Shqipëri. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale bashkëpunon me Drejtorinë e të Drejtave të Autorit në aktivitete të përbashkëta, siç parashikohet në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020. Të dy institucionet përgatisin, promovojnë, shpërndajnë materiale informative, organizojnë fushata sensibilizimi për institucionet, grupet e interesit dhe publikun nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar, si dhe aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si seminare, konferenca, trajnime etj. Ato bashkëpunojnë me një sërë institucioneve të tjera, siç janë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve etj, të cilat janë pjesë e mekanizmit zbatues të këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë.

Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe sigurimi i një niveli mbrojtjeje , të njëjtë me atë të vendeve të BE, ka qenë një nga angazhimet e Qeverisë Shqiptare parashikuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, (neni 73). Në zbatim të këtij angazhimi, janë ndërmarrë masa legjislative dhe aktivitete zbatuese, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar në fushën e pronësisë intelektuale me *acquis*, ashtu edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë.

I.1.2 Kërkesat e MSA-së

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* të BE-së.

Neni 73 Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare;

- Në përputhje me dispozitat e këtij Neni dhe Shtojcën V, Palët konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.
- Shqipëria merr masat e nevojshme për të garantuar brenda katër viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale,

industriale dhe tregtare të njëjtë me atë që ekziston në Komunitet, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.

- Shqipëria merr përsipër të bëhet palë brenda periudhës së përcaktuar më lart në konventat shumëpalëshe për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të përmendura në Shtojcën VI, paragrafi 1. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të vendosë për të detyruar Shqipërinë të bëhet palë në Konventa të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.
- Nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, me kërkesë të një Pale, problemet i dërgohen urgjentisht Këshillit të Stabilizim-Asociimit, me synim arritjen e zgjidhjeve të kënaqshme për palët.

I.2 Situata aktuale / përmbledhja

Shqipëria ka arritur njëfarë niveli në përgatitje në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale. Në fushë e drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura me të është plotësuar kuadri ligjor në fushën e të drejtës së autorit i cili synon përafrimin e këtij legjislacioni me direktivat përkatëse të BE. t. Për zbatimin, në vitin 2017 aplikacionet për regjistrimin e markave tregtare u rritën me 12.3% krahasuar me 2016 dhe aplikacionet për patentat dhe modelet e përdorimit u rritën me 16%. Gjatë periudhës raportuese GDIP mori pjesë në 54 procedura gjyqësore.

Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to sjell harmonizim të legjislacionit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me Direktivat e Bashkimit Evropian në këtë fushë, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e respektimit të të drejtave të autorit në të njëjtin nivel, nga pikëpamja juridike, me ato të vendeve të Bashkimit Evropian, detyrim që buron drejtpërsëdrejti nga neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA) është një drejtori e dedikuar politikash me një gamë të gjerë kompetencash në rritje të profesionalizmit. DDA ka kompetenca të reja për mbikëqyrjen e veprimtarisë së agjencive të administrimit kolektiv, bashkëpunim me aktorët e tjerë por dhe me organet tatimore. Gjithashtu DDA është e orientuar qartë drejt ndërgjegjësimit publik të të drejtave pasurore të krijuesve dhe fushatave të edukimit, kundrejt gjeneratave të reja.

Më datë 09.01.2018 sporteli unik në administrimin e të drejtës së autorit – SUADA është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku qëllimi kryesor i kësaj Qendre është kryerja e funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblymit nga përdorimi i veprave të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet përdorues, si një sportel i vetëm në emër të të gjitha agjencive të administrimit kolektiv të licencuara, si dhe shpërndarjen e këtyre të ardhurave tek këto agjenci në përputhje me legjislacionin në fuqi Pra, SUADA ka fituar personalitet juridik për të mbledhur të ardhurat nga përdorimi i veprave të të drejtës së autorit në emër të 4 agjencive të licencuara për kategoritë përkatëse të artit.

Sporteli unik ndihmon në mënyrë të veçantë në respektimin e ligjit për të drejtën e autorit për faktin se duke nënshkruar një autorizim të vetëm, subjekti përdorues detyrohet të paguajë automatikisht të gjitha agjencitë njëherazi dhe jo disa prej tyre, pasi shpesh herë ndeshet problematika kur një subjekt arrinte marrëveshjen me disa prej tyre, por jo me të gjitha agjencitë. Në zbatim të ligjit Nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me to”, administrimi kolektiv kryhet nga agjencia e administrimit të të drejtave të autorit, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre të titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, e cila ka marrë licencimin nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit pas propozimit nga Drejtoria e të Drejtave të Autorit (DDA).

Në korrik të vitit 2018 janë kryer procedurat e licencimit dhe të rilicensimit të agjencive të administrimit kolektiv në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura.

Agjencitë e administrimit kolektiv mbikëqyren nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit mbi të gjithë veprimtarinë e funksionimit të tyre. Janë licencuar katër agjenci në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura konkretisht: Agjencia Albautor për të drejtat e autorëve, Agjencia “AKDIE” për të mbrojtur të drejtat e artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave, Agjencia “FMAA”- në fushën e audio-vizualit dhe produktit kinematografik shqiptar, licencuar Agjencia “GRAMM-A”- Agjenci e administrimit kolektiv të Mbrojtjes të Producentëve.

Në fushën e Pronësisë Industriale vizioni i DPPI në lidhje me sistemin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale është ndërtimi i një sistemi më të fortë të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, që siguron mbrojtje efektive të objekteve PI-së, inkurajon kreativitetin dhe inovacionin në shërbim të nxitjes së rritjes ekonomike dhe kulturore si dhe zhvillimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, me mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë iniciativë për reformimin e Sistemit të Pronësisë Industriale në vend.

Neni 189 i Ligjit 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, përcakton Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) si një institucion publik jo-buxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI, dhe funksionon si një agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë.

Kapacitetet administrative të DPPI-së janë forcuar; me strukturën e re administrative numri i punonjësve është rritur në 39 dhe aktualisht DPPI është në proces rekrutimi të punonjësve të rinj.

Është krijuar Qendra e trajnimeve në fushën e PI, në Drejtorinë e Koordinimit, Promovimit, Trajnimit dhe Analizave në DPPI. Struktura e re ka mundur trajnimin e institucioneve të tjera të përfshira në sistemin e PI-së dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut rreth rolit të Pronësisë Industriale në tregun shqiptar, duke ndikuar kështu në rritjen e numrit të aplikimeve.

Shqipëria është anëtare e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale. DPPI përfaqëson Shqipërinë në Organizatën Evropiane të Patentave (EPO), në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe ka filluar procedurat për anëtarësim në Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Pronësisë Industriale (EUIPO).

Në fushën e zbatimit të pronësisë intelektuale janë realizuar iniciativat legislative për ndryshimin e Kodit Penal dhe me ligjin nr. 135/2015 është hartuar një dispozitë shtesë në Kodin Penal për prodhimin dhe tregtimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara e rrezikshme për jetën dhe shëndetin. Neni 284/d shtohet me këtë përmbajtje: “Prodhimi dhe shitja e barnave dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin”, si në vijim: “Prodhimi, posedimi për qëllime komerciale, shitja ose oferta për shitje, furnizim, shpërndarje , eksportimin, importimin e drogave, substancave aktive ose materialeve ndihmëse për prodhimin e tyre, si dhe produkteve të pajisjeve mjekësore, aksesoreve, përbërësve ose materialeve të falsifikuara ose të rrezikshme për jetën ose shëndetin, dënohet nga gjashtë deri në pesë vjet”.

Kur kjo vepër kryhet në ushtrimin e një aktiviteti profesional, nëpërmjet internetit, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me tre deri në shtatë vjet.

I njëjti veprim, kur ka shkaktuar pasoja serioze për jetën ose shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet”.

Nismat legislative u zbatuan për të nënshkruar dhe ratifikuar në Kuvend, Konventën e Këshillit të Evropës “Për falsifikimin e produkteve mjekësore dhe krimeve të ngjashme që përbëjnë kërcënim për shëndetin publik” (Konventa MEDICRIME - Moska 28.10.2011) Vendimi Nr. 520, datë 16.06.2015, Këshilli i Ministrave u miratua në parim; datë 12.17.2015 është nënshkruar në Strasburg nga ambasadori ynë në Këshillin e Evropës; datë 10.03.2016 me Ligjin nr. 18/2016 të ratifikuar nga Parlamenti.

Më 12 janar 2016, hyri në fuqi Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1090, datë 28.12.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 205, datë 13.04.1999 ‘Zbatimi i dispozitave të Kodit Doganor”, i cili është plotësisht i përafuar me Rregulloren e BE 608/2013.

Duke ndjekur bazën e re ligjore, Drejtoria e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale ka hartuar:

Udhëzimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 205, datë 13.04.1999 ‘Zbatimi i Kodit Doganor” (VKM Nr. 1090, datë 28.12.2015). Kjo do të minimizojë keqkuptimet për interpretimin e duhur të legjislacionit të ri dhe gjithashtu do të unifikojë procedurat për mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

- Manuali bazuar në VKM nr. 1090, datë 28.12.2015.
- Draft Manual për zyrtarët doganorë të bazuar në manualin që rezultoi pas Rregullores së BE 608/2013.

- Draft udhëzimi për mjetet e IT bazuar në Vendimin nr. 1090, datë 28.12.2015, për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale nga Dogana.

Në vijim të VKM Nr. 1090, datë 28.12.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime të VKM nr. 205, datë 13.04.1999 ‘Zbatimi i dispozitave të Kodit Doganor’, Drejtoria e Mbrojtjes së të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, ka administruar 71 kërkesa për veprim nga mbajtësit e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Drejtoria doganore ka pezulluar 21,809 mallra të dyshuara për shkelje të një prone intelektuale dhe është në proces verifikimi. Totali i mallrave të shkatërruara si në kundërshtim me një pronë intelektuale është 3815 copë.

Nga shtatori 2015 deri në prill 2016, Administrata Doganore ka trajnuar 200 punonjës doganorë për Pronën Intelektuale sipas planeve mujore të punës dhe planit “300-ditor”. Trajnimi ka ofruar informacion dhe njohuri për procedurat e mbrojtjes së pronësisë intelektuale nga administrata doganore dhe ka ofruar njohuri në nivel ndërkombëtar.

I.3 Prioritetet

Në fushën e të drejtës së autorit dhe të të drejtave fqinje, zbatimi i Ligjit për të Drejtën e Autorit të vitit 2016 synonte përafrimin e Shqipërisë me direktivat përkatëse të BE. Në mars të vitit 2017, Kodi Penal u ndryshua për të përmirësuar mekanizmat ligjorë dhe për të trajtuar më mirë shkeljet e të drejtave të autorit, e cila tashmë ka sjellë rezultate pozitive dhe pritet të intensifikojë më tej veprimet kundër shkeljes së të drejtës së autorit. Dy subjektet kryesore përgjegjëse për pronësinë intelektuale janë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Drejtoria e të Drejtave të Autorit (DDA). DPPI është një agjenci publike nën mbikëqyrjen e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave e cila regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së. Në Ministrinë e Kulturës, DDA-ja i ofron këshilla inspektoritativit dhe publikut në rast të shkeljes së të drejtave.

Për të drejtat e pronësisë intelektuale, në vitin 2017 u ndryshua Ligji për Pronësinë Industriale, duke krijuar një bazë ligjore për mbrojtjen e objekteve IP.

Për zbatimin, në vitin 2017 aplikimet për regjistrimin e markave tregtare u rritën me 12.3% krahasuar me 2016 dhe aplikimet për patentat dhe modelet e përdorimit u rritën me 16%. Gjatë periudhës raportuese DPPI mori pjesë në 54 procedura gjyqësore. Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut është përgjegjës për inspektimin, kontrollin dhe zbatimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to. Inspektorati është në proces të forcimit të kapaciteteve të tij. Që nga themelimi i tij në vitin 2016 ka kryer 261 inspektime në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale. Për më tepër, gjatë periudhës raportuese, administrata doganore pezulloi zhdoganimin e një numri mallrash që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale, bazuar në

kërkesë nga bartësi i së drejtës dhe / ose me procedura ex officio. Megjithatë, ende ekzistojnë shqetësime në lidhje me numrin e lartë të produkteve të falsifikuara në vend.

Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to është një ligj tërësisht i harmonizuar dhe i integruar me Direktivat e Bashkimi Evropian dhe në këtë kuadër lind nevoja e përafrimit të këtij ligji dhe me Direktivën nr. 2012/28 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 25 tetor 2012, “Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor”

Miratimi i Traktatit të Marrakeshit dhe Traktatit të Pekinit janë dy traktate të parashikuara për të aderuar me ligj, në kuadër Strategjisë Kombëtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (2016-2020).

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale (2016-2020) Ministria e Kulturës përmes Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, si një prioritet në politikat e saj, ka përbushur pjesën e ndërgjegjësimit me shkollat e arsimit para-universitar dhe atij universitar me qëllim dhënien dhe shpërndarjen e informacionit sa i takon të drejtave të autorit. Këto aktivitete janë zhvilluar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe do të vijojnë dhe në vitet në vijim për të rritur ndërgjegjësimin te brezat e ring dhe te komuniteti në tërësi.

- Përmirësimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, trajnimi dhe rritja e ekspertizës së tyre.
- Krijimi i një mekanizmi të vazhdueshëm për të forcuar bashkëpunimin me agjencitë e administrimit kolektiv si dhe për të përmirësuar gjithë sistemin në tërësi.
- Trajnimi i vazhdueshëm i sistemit gjyqësor si një nga hallkat kryesore në gjithë këtë proces mbetet prioritet.
- Organizimi dhe zbatimi i mëtejshëm i fushatave të ndërgjegjësimit publik mbi çështjet e pronësisë intelektuale.
- Aplikimi i regjistrimit on-line (e-registration) të të drejtave të autorit.
- Forcimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.
- Zbatimi i masave dhe planit të veprimit që do të jetë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (2016-2020).
- Mirë-funksionimi i sistemit të sportelit unik – SUADA në administrimin kolektiv;
- Shpërblimi i autorit/krijuesit për shfrytëzimin e veprave të tyre nga ana e AAK-ve.
- Futja në kurrikulën mësimore dhe në cikle të tjera të arsimit para-universitar.
- Fushata të gjera ndërgjegjësimi për komunitetin e biznesit dhe shoqërisë në tërësi.
- Miratimi i Traktatit të Marrakeshit për personat me dëmtime në shikim;
- Miratimi i Traktatit të Pekinit për veprat audiovizuale.

Në fushën e Pronësisë Industriale

Në 25 mars 2017, hyri në fuqi ligji i ri nr. 17/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008" Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar, i cili u miratua nga Parlamenti

shqiptar më 16 shkurt 2017. Në zbatim të ligjit janë miratuar rregulloret e reja. Ky ligj pasqyron të gjitha rekomandimet e dhëna në raportet e Komisionit Evropian për fushën e Pronësisë Industriale. Ligji përmbush detyrat e dhëna nga Komisioni Evropian në raportet e tij më të fundit, duke zbatuar prioritetet e përcaktuara nga Strategjia Kombëtare e PI 2016-2020, duke shkurtuar afatet e ekzaminimit, duke rritur cilësinë e shërbimeve të ofruara, në përputhje me direktivat e BE-së në fushën e pronësisë industriale të miratuar nga 2012 deri 2015, dhe të zgjerojë njohuritë mbi përvojat dhe praktikatat që të përputhen me ato të zyrave tona homologe ndërkombëtare.

Gjithashtu, DPPI mbështetet në më shumë se 14 marrëveshje dhe konventa ndërkombëtare që Shqipëria ka nënshkruar në fushën e Pronësisë Industriale.

Parlamenti miratoi me Ligjin nr. 66/2018, datë 24.9.2018, aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Lisbonës mbi emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë dhe së shpejti pritet miratimi nga Parlamenti i Marrëveshjes së Lisbonës për Mbrojtjen e Emërtimeve të Origjinës dhe regjistrimit ndërkombëtar të tyre. Marrëveshja e Lisbonës pritet të miratohet nga Parlamenti.

Parlamenti miratoi me Ligjin nr. 34/2018 , aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Vjenës.

Parlamenti miratoi me Ligjin nr. 33/2018, aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Lokarnos.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (2016-2020), DPPI, si prioritet në politikat e saj, ka përmbushur planin ndërgjegjësues për ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimit me shkollat parauniversitare dhe universitare me qëllim të ofrimit dhe shpërndarjes së informacionit në lidhje me pronësinë industriale dhe në përgjithësi me pronësinë intelektuale.

Prioritetet e DPPI (2018-2019)

Prioritetet afatshkurtra

- Miratimi i 4 rregulloreve për zbatimin e ligjit të PI;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Lisbonës;
- Forcimi i kapaciteteve administrative dhe infrastrukturës së TIK-ut;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të përfshira në sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Industriale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit;
- Hartimi i udhërrëfyesit për ekzaminimin e patentave;
- Rritja e shërbimeve on-line të përmirësuar;
- Fuqizimi i qendrave së informacionit teknik dhe shkencor;

- Përgatitja dhe organizimi i trajnimeve specifike për qendrat e informacionit mbi sistemet e përdorura nga DPPI;
- Zhvillimi i aktiviteteve promicionale dhe trajnuese për rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve dhe publikut;
- Trajnimi i stafit të DPPI-së, përfaqësuesve të autorizuar dhe grupeve të interesit;
- Rritje e ndërgjegjësimit të publikut rreth rëndësisë të regjistrimit të objekteve të tyre. Gjithashtu ofrimi i trajnimeve për të gjitha institucionet e përfshira në sistemin e PI, etj;
- Implementimi dhe monitorimi i Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale (2016-2020);
- Identifikimi i bizneseve me potencial të mundshëm inovativ si dhe organizimi i seminareve dhe aktiviteteve trajnuese në lidhje me to.
- Identifikimi i bizneseve me potencial të mundshëm për regjistrimin e shërbimeve që ato ofrojnë, si markë tregtare.

Prioritetet afatmesme të DPPI-së

- Modernizimi i sistemeve TIK me qëllim përmirësimin e komunikimit ndërmjet institucioneve të përfshira në sistemin e regjistrimit dhe zbatimit të të drejtave të PI;
- Zhvillimi i kapaciteteve dhe pajisjeve në mënyrë që të implementojë një sistem TIK modern. Sigurimi i një përputhshmërie të plotë të sistemit TIK kombëtar me atë të OBPI, ZEP dhe ZPIEU;
- Aplikimi online për të gjitha shërbimet që ofron DPPI dhe integrimi i sistemit SAPI në rrjetin e ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore, implementimin 100% për çdo dokument i depozituar në DPPI në sistemin EDMS duke e kthyer procedurat e zyrën në e-dossie;
- Nxitja e punës shkencore tek brezat që rriten përmes aktiviteteve promovuese të ndryshme në formën e konkurseve në kuadër dhe të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, çdo 26 prill. (2019-2020);
- Trajnimin e autoriteteve të zbatimit të ligjit për PI-në;
- Krijimi i qendrave të informacionit në Universitetet e Gjirokastrës dhe Shkodrës;
- Trajnimin e autoriteteve gjyqësore me çështjet e PI-së nëpërmjet projekte dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës;
- Trajnimi i stafit të DPPI-së, përfaqësuesve të autorizuar dhe grupeve të interesit;
- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese dhe trajnuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe biznesit;
- Studimi në krahinat e ndryshme dhe sidomos në zonat rurale të Shqipërisë për të evidentuar produktet potenciale për tu mbrojtur si TGJ;
- Hartimi i analizës dhe përcaktimi kriterëve dhe karakteristikave të produkteve potenciale të secilës krahine, për tu mbrojtur si TGJ;
- Organizimi i aktiviteteve promovuese dhe trajnuese për mbrojtjen dhe regjistrimin e TGJ të organizuar sipas rretheve: Gjirokastrë, Tepelene, Elbasan, Vlorë, Malësia e Madhe etj;
- Reformimi i kurrikulës së arsimit parauniversitar fushën e pronësisë intelektuale;

- Hartimi dhe zbatimi i projekteve me bizneset për ndërgjegjësimin e tyre në financimin e departamenteve të kërkim zhvillimit, dhe regjistrimin e objekteve të PI-së;
- Fushata ndërgjegjëse me qëllim rritjen dhe forcimin e besimit të biznesit dhe qytetarëve tek administrata dhe ndryshimin e imazhit apo perceptimit qytetar për të;
- Bashkëpunim i ngushtë me Dhomat e Tregtisë në RSH për organizimin e sesioneve të ndryshme informative për kategorinë e biznesit.

II.1. Të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të lidhura me të

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Ligji nr. 35/2016 “Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 31 mars 2016. Janë miratuar të gjitha aktet nënligjore në dhe për zbatim të ligjit organik. Ligji është i plotë dhe i integruar me zhvillimet e fundit të direktivave evropiane dhe adreson problematikat e hasura me ligjin aktual në fuqi si në kuadrin e parashikimeve më të gjera të drejtave vetjake jo pasurore ashtu edhe në parashikimet e detajuara të drejtave pasurore. Në dhe për zbatim të ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, Drejtoria për të Drejtën e Autorit ka hartuar draft vendimin për kopjen private, e cila u është dërguar për mendim dhe institucioneve të tjera të përfshira.

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

Në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtat tjera të lidhura me të institucion përgjegjëse është Ministria e Kulturës (MK) si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) konkretisht Drejtoria e të Drejtës së Autorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

Institucione të tjera, të përfshira në procesin e zbatimit, janë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
- Autoriteti i Mediave Audiovizive.
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.
- Policia e Shtetit – Drejtoria e Krimit Ekonomik.
- Ministria e Drejtësisë.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Shkolla e Magjistraturës.

II.1.3. Masat e planifikuara

II.1.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

II.1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Amendimi i Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura” është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ligji do të përafrojë pjesërisht Direktivën 2012/28/BE për disa përdorime të lejuara të veprave jetime.

II.1.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Nuk janë planifikuar masa të tjera në këtë nënkapitull.

II.2 Pronësia Industriale

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016 – 2020, miratuar me Vendimin nr. 527, datë 20.07.2016, të Këshillit të Ministrave, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 140, datë 28.07.2016. Ky është një nga dokumentet më të rëndësishme në fushën e të drejtave të PI në Shqipëri. DPPI në rolin e Sekretariatit Teknik ka luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e kësaj strategjie.

Ligji nr. 17/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 ‘Për pronësinë industriale’” i ndryshuar, i cili hyri në fuqi më 25 mars 2017 dhe u miratua nga Parlamenti shqiptar më 16 shkurt 2017.

Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", ndryshuar me:

- Ligji nr. 10/2013, datë 01.03.2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 ‘Për pronësinë industriale’”;
- Ligji Nr. 55/2014, datë 24.06.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 ‘Për pronësinë industriale’”;
- Ligji Nr. 17/2017 datë 16.02.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 ‘Për pronësinë industriale’”.

Ligji i lartpërmendur përafrohet plotësisht me *acquis* e mëposhtme të BE-së:

- Direktiva 98/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 korrikut 1998 mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike;
- Direktiva 98/71/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor 1998 mbi mbrojtjen ligjore të disenjove;

- Direktiva 2008/95/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2008 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare;
- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- Direktiva 2015/2436/EC, dt.16.12.2015 “Për harmonizimin e bazës ligjore të vendeve anëtare në lidhje me markat tregtare”;
- Rregullorja Nr. 1151/2012/EC të datës. 21.11.2012 “Për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”;
- Rregullorja Nr. (EEC) Nr. 1308/2013/EC dt.17.12.2013 “Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe shfuqizimin e rregulloreve (EEC) Nr. 922/72, (EEC) Nr. 234/79, (EC) Nr. 1037/2001 dhe (EC) Nr. 1234/2007”.

Ligji Nr. 8488, datë 13.05.1999, “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara”, i ndryshuar nga Ligji Nr. 66/2014, datë 24.07.2014, “Për ndryshimet dhe shtesat në ligjin nr. 8488, datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara”.

Ligji i përmendur më lart është përafruar plotësisht me Direktivën e BE-së:

- Direktiva e Këshillit 87/54/EEC e 16 dhjetorit 1986 mbi mbrojtjen ligjore të topografive të produkteve gjysmëpërçuese.

Aktet në vijim janë miratuar në bazë të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale” të ndryshuar:

- VKM nr. 270, datë 16.05.2018, “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e disenjove industriale”;
- VKM nr. 315, datë 31.05.2018, “Për miratimin e Rregullores për markat tregtare”;
- VKM nr. 316, datë 31.05.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 883, datë 13.05.2009 për Këshillin e Ministrave ‘Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”;
- VKM nr. 460, datë 26.07.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1707, datë 29.12.2008 “Për miratimin e Rregullores për Patentat për Shpikje dhe Modele e përdorimit”;
- VKM nr. 317 datë 31.05.2018 “Për miratimin e Rregullores së Përfaqësuesve të Autorizuar të DPPI-së”;
- VKM nr. 252, datë 09.05.2018 “Për përcaktimin e shkallës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”.
- VKM nr. 501, datë 29.08.2018 “Për miratimin e Rregullores së ekspertëve të DPPI”.

Gjithashtu, janë hartuar edhe katër rregullore për zbatimin e ligjit dhe së shpejti pritet miratimi i tyre nga Këshilli i Ministrave:

- Projektvendimi i KM “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës”.
- Projekt-vendimi i KM “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Bordit të Apelit të DPPI”.

- Projekt-vendimi i KM “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e funksionimit të Qendrës së Trajnimit në fushën e PI”;
- Hartimi i Vendimit të KM “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Pronësinë Industriale, Sistemin e Administrimit të Pronësisë Industriale”.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

Në fushën e Pronësisë Industriale, institucionet kryesore për zbatimin e këtij kapitulli janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale dhe Drejtoria e të Drejtës së Autorit.

Institucionet drejtpërdrejt përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
- Prokuroria e Përgjithshme
- Policia e Krimit Ekonomik.
- Sistemi gjyqësor që ka të bëjë kryesisht me Gjykatën e Tiranës.
- Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve.
- Ministria e Drejtësisë.
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.
- Shkolla e Magjistraturës.

II.2.3. Masat e planifikuara

II.2.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2020

Nuk është parashikuar miratimi i dokumenteve të tjera të politikave.

II.2.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2020

Për ndryshimin e Ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale” është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ligji amendues do të përafrojë pjesërisht Direktivën (BE) 2016/943 të Parlamentit Evropian.

II.1.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Nuk janë planifikuar masa të tjera në këtë nënkapitull.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

000 Lek

Viti	2018	2019	2020
Buxheti total per këtë kapitull i Institucionit lider	0	0	0
Buxheti total per këtë kapitull i institucioneve te tjera	5000	1500	1600
Buxheti total i Kapitullit	5000	1500	1600

Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhja e legjislacionit të Bashkimit Evropian

Acquis e konkurrencës mbulon politikat anti-kartel, kontrollin e bashkimeve dhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Ai përfshin rregulla dhe procedura për të luftuar sjelljen anti-konkurruese të kompanive (marrëveshjet kufizuese midis ndërmarrjeve dhe abuzimi i pozitës dominuese) dhe për të parandaluar qeveritë nga dhënia e ndihmës shtetërore e cila shtrembëron konkurrencën në tregun e brendshëm. Sa i përket kontrollit të bashkimit, Komisioni ka kompetencë të shqyrtojë bashkimet mbi kufijtë e caktuar të qarkullimit, ndërkohë që Shtetet Anëtare janë të lira të kontrollojnë bashkimet nën këto kufij.

Acquis e konkurrencës bazohet në Nenin 37 (monopolin shtetëror me karakter tregtar), Nenet 101-105 (Rregullat e zbatueshme për ndërmarrjet), Neni 106 (Ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive) dhe Nenet 107-109 (Rregullat e zbatueshme për Ndihmën shtetërore) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Në fushën e anti-karteleve, autoritetet kombëtare të konkurrencës duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Komisionin në procedurat e konkurrencës. Që nga 1 maji 2004, të gjitha autoritetet kombëtare të konkurrencës gjithashtu janë të autorizuar të zbatojnë plotësisht Nenin 101 dhe 102 të TFBE për të siguruar që konkurrenca të mos shtrembërohet apo kufizohet. Për këtë qëllim, ata duhet të kenë kompetenca të krahasueshme me ato të Komisionit Evropian. Gjykatat kombëtare mund të zbatojnë rregullat e anti-trustit të BE-së drejtpërsëdrejti në mënyrë që të mbrojnë të drejtat individuale të dhëna për qytetarët nga TFEU. Termi liberalizimi i referohet në thelb Neni 3 të TFBE, i cili thotë se aktivitetet e BE-së do të përfshijnë një sistem që garanton që konkurrenca në tregun e brendshëm të mos shtrembërohet. Për këtë qëllim, ekziston një sistem i veçantë mbikëqyrës në rastin e ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjeve në të cilat Shtetet Anëtare japin të drejta të veçanta ose ekskluzive

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është promovimi dhe mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive nëpërmjet ruajtjes së mjedisit konkurrues dhe nxitjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Ruajtja apo nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat, apo ai shtetëror, mund t'i bëjnë konkurrencës, prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, ndarjen e tregut, kufizimin apo kontrollin e prodhimit, të zhvillimit teknik, zbatimin e kushteve të ndryshme për transaksione të njëjta etj, abuzimin me pozitën dominuese, si dhe kontrollin e përqendrimeve që rrezikojnë të krijojnë, ose forcojnë një pozitë dominuese në treg.

Kuadri ligjor i BE-së në fushën e konkurrencës përbëhet ndër të tjera nga aktet e mëposhtme:

- Nenet e Traktatit të Lisbonës , neni 101-102 i Traktatit të Funksionit të BE-së
- Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit;
- Rregullorja e Komisionit Evropian (EC) nr. 773/2004, e datës 7 Prill 2004 mbi kryerjen e procedurave nga ana e Komisionit në mbështetje të neneve 81 dhe 82 të Traktatit të KE;
- Rregullorja e Komisionit nr. 330/2010 e datës 20 Prill 2010 mbi zbatimin e nenit 101/3 të traktatit të Funksionimit të BE-së për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikat e bashkërenduara;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1217/2010, e datës 14 dhjetor 2010 “Për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve të kërimit dhe zhvillimit;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1218/2010, e datës 14 dhjetor 2010 “Për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve të specializimit;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 772/2004, e datës 27 prill 2004 “Për zbatimin e nenit 81 (3) të Traktatit për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike;
- Rregullorja e Komisionit Nr 316/2014 e datës 21 Mars 2014 mbi zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike;
- Rregulloren e Komisionit Nr. 461/2010 e datës 27 Maj 2010 Mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike;
- Rregullorja e Këshillit Evropian Nr 487/2009 e datës 25 Maj 2009, “Mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori marrëveshjesh dhe praktika të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror;
- Rregullorja e BE-së: Rregullorja e Këshillit nr. 246/2009 e datës 26 shkurt 2009 mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar;
- Rregullorja e Komisionit nr. 906/2009 e datës 28 Shtator 2009 mbi zbatimin e nenit 6 të ligjit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar;
- Direktiva 2014/104/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 nëntorit 2014 mbi rregullat që menaxhojnë veprimet për dëmet sipas legjislacionit vendas për shkeljet e dispozitave të ligjit të konkurrencës të vendeve anëtare dhe të Bashkimit Evropian.
- Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” (Rregullorja e Përqendrimit të KE);
- Rregullorja e Komisionit 802/2004 e datës 21 Prill 2004 që implementon Rregulloren e këshillit (EC) Nr 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve.

I.1.2 Kërkesat e MSA-së

Nenet 70, 71 dhe 72 të MSA parashikojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e AK në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive nga veprimet dhe praktikat anti-konkurrese, që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë. Neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, parashikon përgjegjësinë që ka Autoriteti i Konkurrencës dhe ndërhyrjen që duhet të bëjë në rastet e (1) të gjitha marrëveshjeve ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve, të cilat kanë si objektiv të tyre, ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës; (2) abuzimit me pozicionin dominues nga një ose më shumë ndërmarrje në territoret e BE, apo të Shqipërisë, si një e tërë, ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre. Referenca janë nenet e Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian dhe konkretisht nenet 101, 102 dhe 106 të tij. Gjithashtu, në bazë të Neni 72 “Sipërmarrjet publike”, parashikohet se Shqipëria zbaton për sipërmarrjet publike dhe ndërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta dhe ekskluzive, parimet e parashikuara në Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian, me referencë të veçantë tek Neni 86 (tani neni 106 i TFEU-së).

Neni 71 i MSA-së Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike

1. Nuk janë të pajtueshme me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, në masën që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë:
 - (i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objektiv të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës;
 - (ii) abuzimi me pozicionin dominues nga një ose më shumë sipërmarrje në territoret e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre;
 - (iii) çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të kërcënojë të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara.
2. Praktikrat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës që zbatohen në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretues të adoptuara nga institucionet e Komunitetit.
3. Palët sigurojnë që një institucioni publik dhe funksionalisht të pavarur t’i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (i) dhe (ii) të këtij neni, lidhur me sipërmarrjet private dhe publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta.
4. Shqipëria do të ngrejë një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (iii) të këtij neni brenda katër vjetësh që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ky autoritet do të ketë, inter alia, kompetenca për të autorizuar skema të ndihmës shtetërore dhe grante ndihme individuale në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni, si dhe kompetenca për të urdhëruar rikthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme.
5. Secila prej palëve garanton transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, duke i paraqitur, inter alia, palës tjetër një raport të rregullt vjetor, ose i njëjtë me të, duke ndjekur metodologjinë dhe

paraqitjen e sondazhit të Komunitetit për ndihmën shtetërore. Me kërkesë të njëres palë, pala tjetër jep informacione për çështje të veçanta të ndihmës publike.

6. Shqipëria do të hartojë një inventar gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës të krijuara para ngritjes së autoritetit të përmendur në paragrafin 4 dhe të sigurojë pajtueshmërinë e këtyre skemave ndihme me kriteret e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni brenda një periudhe jo më shumë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

7. (a) Me qëllim zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 (iii), Palët pranojnë që gjatë dhjetë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo ndihmë publike e dhënë nga Shqipëria vlerësohet duke marrë parasysh faktin se Shqipëria konsiderohet si një zonë e njëjtë me zonat e përshkruara në Nenin 87 (3)(a) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian.

(b) Brenda pesë viteve që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Evropiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Autoriteti i përmendur në paragrafin 4 dhe Komisioni i Komuniteteve Evropiane atëherë do t'i vlerësojnë bashkërisht nevojën e zonave të Shqipërisë si dhe intensitetet maksimale të ndihmës në lidhje me to për hartimin e një harte ndihmash zonale në bazë të direktivave përkatëse të Komunitetit.

8. Në lidhje me produktet e përmendura në Kapitullin II të Titullit IV:

- paragrafi 1 (iii) nuk zbatohet;
- çdo praktikë në kundërshtim me paragrafin 1(i) vlerësohet sipas kriterëve të vendosura nga Komuniteti në bazë të Neneve 36 dhe 37 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve specifike të Komunitetit të adoptuar mbi këtë bazë.

9. Në qoftë se një nga Palët është e mendimit se një praktikë e veçantë nuk përputhet me termat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, ajo mund të marrë masat e nevojshme pas këshillimeve me Këshillin e Stabilizim-Asociimit ose tridhjetë ditë pune pas kërkesës për këshillim. Asgjë në këtë Nen nuk cenon ose ndikon në ndonjë mënyrë marrjen, nga secila prej Palëve, të masave antidumping ose masave kundërbalancuese në përputhje me Nenet përkatëse të GATT 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese apo legjislacionit të brendshëm përkatës.

I.2 Situata aktuale / Përmbledhja

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2018, Shqipëria ka arritur një nivel të përgatitjes / mesatarisht të përgatitur në fushën e politikës së konkurrencës. Ka pasur një progres të lidhur me përafrimin legjislativ gjatë periudhës raportuese.

Në fushën e antikarteleve dhe bashkimeve, kuadri legjislativ është gjerësisht në pajtim me *acquis* dhe dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës është gjerësisht në përputhje me nenin 101 mbi ndryshimet respektive dhe nenin 102 mbi abuzimet e qëndrimit dominues të TFEU. Gjithashtu, ai parashikon kontrolle ex ante të bashkimeve, në përputhje me Rregulloren e BE-së mbi Bashkimet. Legjislacioni dytësor parashikon rregulla të tjera thelbësore dhe udhëzime mbi mënyrën se si duhet të aplikohen rregullat e konkurrencës,

është gjerësisht në përputhje me rregulloret përkatëse të BE-së dhe udhëzuesit e Komisionit. Autoriteti i Konkurrencës ka thjeshtuar procedurat e saj për trajtimin e përqendrimeve dhe rregulloreve të saj mbi procedurat e angazhimit.

Në lidhje me kuadrin institucional, Autoriteti shqiptar i Konkurrencës është përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Një program lehtësues për kompanitë që ofrojnë informacion mbi rastet e kartelit është gati. Palët mund të apelojnë vendimet e AK-së në gjykatë.

Në lidhje me forcimin e kapaciteteve, AK ka një staf me 39 punonjës. Përmes pjesëmarrjes së stafit të AK në një numër të konsiderueshëm seminaresh dhe trajnimesh, niveli i ekspertizës është përforcuar.

Në fushën e ndihmës shtetërore, kuadri legjislativ është gjerësisht në pajtim me *acquis* dhe me dispozitat e MSA-së. Ligji për ndihmën shtetërore, i ndryshuar në 2016, reflekton kryesisht Nenet 107 e 108 të TFEU në lidhje me përkufizimin e pajtueshmërisë ose papajtueshmërisë për ndihmë shtetërore, si dhe procedurat. Legjislacioni shqiptar është ndryshuar për tu përafëruar me Rregulloren de minimis mbi ndihmën e dhënë për shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik dhe modifikimet më të fundit të Rregullores së përjashtimeve në bllok.

Në lidhje me kuadrin institucional, Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) është përgjegjës për zbatimin e ligjit për ndihmën shtetërore.

Përsa i përket liberalizimit, ligji për mbrojtjen e konkurrencës dhe ligji për ndihmën shtetërore gjejnë zbatim për sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive, përveç rasteve kur zbatimi i tyre pengon kryerjen e detyrave të caktuara të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik që u janë caktuar atyre.

I.3 Prioritetet

- Zbatimi i ligjit të konkurrencës, zbulimi i marrëveshjeve të ndaluara, abuzimi me pozitën dominuese si dhe kontrolli i përqendrimeve;
- Avokatia e konkurrencës nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në sektorët/tregjet ku ka të drejta ekskluzive/të veçanta, barrierat e hyrjes në treg, monopole natyrore etj;
- Realizimi i studimeve mbi të drejtat ekskluzive/të veçanta, me qëllimin kryesor rekomandimin e ndërhyrjeve për liberalizimin e tregjeve në funksion të rritjes së konkurrencës së ndërmarrjeve private dhe/ose publike sipas tregjeve përkatëse;
- Rritja dhe forcimi i kapaciteteve administrative;
- Monitorimi i tregut;
- Hetimi i përgjithshëm në sektor të ekonomisë;

- Hetimi paraprak dhe hetimi i thelluar me synim rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg;
- Procesi i përfarimit të legjislacionit;
- Organizimi i seminareve dhe workshop-ve për rritjen e kapaciteteve administrative, duke kërkuar edhe asistencën e programit TAIEX;
- Pjesëmarrja në seminare trajnuese të organizuara nga International Competition Network (ICN), UNCTAD, OECD, OECD-GVH/RCC, South-East Europe Transport Observatory (SEETO), Energy Community Secretariat (ECS), Sofia Competition Forum (SCF), për trajtimin e çështjeve të konkurrencës;
- Sigurimi i pavarësisë operationale të Komisionit të Ndihmës Shtetërore si dhe forcimi i kapaciteteve në Njësinë e Ndihmës Shtetërore;
- Rritja e përpjekjeve për të përmirësuar të dhënat e zbatimit të saj në fushën e kontrollit të ndihmës shtetërore.

II.1 Politikat e konkurrencës

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Politika Kombëtare e Konkurrencës është miratuar nga Komisioni i Konkurrencës Nr. 43 datë 28.12.2006 në bazë të Nenit 24 / a të Ligjit Nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Është miratuar Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

Kuadri ligjor i konkurrencës në Shqipëri është përafruar me kornizën ligjore të BE-së, duke përfshirë Nenet 101, 102, 106 TFEU, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 1/2003 të datës 16 dhjetor 2002 mbi zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në Nenet 81 dhe 82 të Traktatit; Rregullorja e Këshillit Nr. 139 /2004 të datës 20 janar 2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (Rregullorja e BE-së për Bashkimet); Njoftimi i Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit të konkurrencës së Komunitetit; Njoftimi i Komisionit për imunitetin nga gjobat dhe zvogëlimi i gjobave në rastet e kartelit; Udhëzime mbi mënyrën e përcaktimit të gjobave të imponuara në pajtim me Nenin 23 (2) (a) të Rregullores Nr. 1/2003 në Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël që nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas Nenit 81 (1) të Traktatit Komuniteti Evropian (de minimis), etj;

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

Autoriteti i Konkurrencës është koordinator dhe përgjegjës për kapitullin e 8 "Politika e Konkurrencës".

Autoriteti i Konkurrencës vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në zbatim të ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" duke u mbështetur në tre shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës: abuzimin me pozitën dominuese; marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve dhe bashkimet ose përqendrimit e ndërmarrjeve, si dhe të gjithë kuadrin ligjor që rregullon aktivitetin e një institucioni të pavarur në Republikën e Shqipërisë. Ky institucion e koncepton funksionimin e tij si nxitës dhe avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit, me synimin final që tregu të gjenerojë zhvillimin.

II.1.3. Akte të planifikuara

II.1.3.1. Politika Kuadër të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk është planifikuar miratimi i dokumenteve të tjera të politikave gjatë periudhës 2019 – 2021.

II.1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

- Udhëzim “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar)” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Udhëzimi do të përafrojë në mënyrë të pjesshme Direktivën Nr. 2014/104/BE e datës 26 nëntor 2014 mbi rregullat lidhur me veprimet për dëmet sipas ligjeve kombëtare të shteteve anëtare dhe BE-së, për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës.
- Udhëzimi “Mbi analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së konsiderueshëm të tregut për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ky udhëzim do të përafrojë në përputhje të plotë Udhëzimin e Komisionit Evropian (2002/C 165/03) mbi analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së konsiderueshëm të tregut, në kuadrin rregullator të Komunitetit, për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.
- Udhëzimi “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020. Ky udhëzim do të përafrojë në përputhje të plotë Direktivën e Komisionit Evropian 2002/77/EC e 16 shtatorit 2002 mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike.
- Udhëzimi “Praktikat më të mira për dorëzimin e dokumentacionit ekonomik dhe mbledhjes së të dhënave në rastet e zbatimit të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe në rastet e përqendrimeve”, është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2021. Ky udhëzim do të përafrojë në përputhje të plotë Praktikat më të mira të DG Competition për dorëzimin e dokumenteve ekonomike dhe mbledhjes së të dhënave në rastet e zbatimit të neneve 101 dhe 102 të TFEU dhe në rastet e përqendrimeve.

- Udhëzimi “Praktikat më të mira për kryerjen e procedurave të kontrollit të përqendrimeve” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021. Ky udhëzim do të përafrojë në përputhje të plotë Praktikat më të mira për kryerjen e procedurave të kontrollit të përqendrimeve të KE.

II.1.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Nuk janë planifikuar masa të tjera në këtë nënkapitull.

II.2 Ndihma shtetërore

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën Shtetërore” është amenduar dhe është plotësisht i përfaruar me direktivat e mëposhtme të BE-së: Rregullore Nr. 69/2001, (KE) e datës 12 Janar 2001 “Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën “de minimis”; Rregullore 70/2001 “Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së lidhur me ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; Rregullore Nr. 2204/2002 “Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën shtetërore për punësimin”; Rregullore Nr. 68/2001, “Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën për trajnim”; Rregullore e Këshillit nr. 659/1999 “Për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të KE-së; Rregulloren e Komisionit “Për ndihmën De minimis” nr. 1407/2013; Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 651/2014 e 17 qershor 2014 “Për deklarimin e disa kategori të ndihmës shtetërore në përputhje me tregun e brendshëm në zbatim të Nenit 107 dhe 108 të Traktatit”, Vendimi i Komisionit Evropian “Për zbatimin e Nenit 106(2) TFBE “Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike dhënë ndërmarrjeve që janë mandatuar për të ofruar shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik”.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

Komisioni i Ndhmës Shtetërore është organi vendimmarrës për kontrollin e ndihmës shtetërore. Komisioni është i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, me kryetarin ministri që mbulon çështjet ekonomike. Anëtarët e Komisionit emërohen për një periudhë katër vjeçare dhe do të jenë profesionistë me përvojë në fushën e ekonomisë. Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore: a) vlerëson dhe autorizon skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale, bazuar në propozimet e Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore; b) urdhëron kthimin e ndihmës së paligjshme dhe të paligjshme; c) mbikëqyr përdorimin e ndihmës shtetërore dhe rezultatin ekonomik të përfituar nga granti; ç) merr vendime të tjera, bazuar në

procedurat e këtij ligji; d) nxjerr udhëzime përkatëse, në pajtim me këtë ligj; f. Harton, me ndihmën e Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore, Raportin vjetor të Ndihmës Shtetërore dhe e paraqet atë në Këshillin e Ministrave, i cili ia përcjell atë Komisionit Evropian; e) bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare, në kuadër të marrëveshjeve dhe angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

II.2.3. Akte të planifikuara

II. 2.3.1. Politika Kuadër të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka dokumente politikash të planifikuara për t'u miratuar gjatë periudhës 2019 – 2021.

II. 2.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk është parashikuar miratimi i akteve që synojnë përafrimin e legjislacionit gjatë vitit 2019.

II.1.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Nuk janë planifikuar masa të tjera në këtë nënkapitull.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

000 Lek

	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull të si institucion kryesor	960,600	0	0
Buxheti total për këtë kapitull nga institucionet e tjera kontribuuese	0	0	0
Buxheti total për kapitull	960,600	0	0

Kapitulli 9: Shërbimet financiare

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e *acquis* së BE-së

Acquis në fushën e shërbimeve financiare përmban rregulla për licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimet e investimeve dhe tregjet e titujve. Institucionet financiare mund të veprojnë në të gjithë BE-në në përputhje me parimin e "kontrollit kombëtar", duke krijuar degë ose duke ofruar shërbime ndërkufitare.

Objektivat kryesorë të *acquis* në lidhje me shërbimet financiare janë siguri i stabilitetit financiar, forcimi financiar i shoqërive që operojnë në sektorin financiar dhe mbrojtja e duhur e konsumatorëve dhe investitorëve. Shërbimet financiare sipas *acquis* të Bashkimit Evropian (BE) bazohen në parimet themelore të legjislacionet parësor (traktatet) si dhe rregullohen më në detaj nga legjislacioni dytësor (rregullore, direktiva, vendime, rekomandime dhe vendimet gjyqësore).

Qëllimi është të krijohet besim mbi tregjet financiare dhe të sigurohet një fushë loje e barabartë për të gjithë aktorët e tregut. *Acquis* për shërbimet financiare përfshijnë rregullat për licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e veprimtarive bankare, sigurimeve, pensioneve private vullnetare dhe tregjeve të titujve, si dhe mbi infrastrukturën e tregjeve financiare. Institucionet financiare mund të kryejnë veprimtari në të gjithë BE-në, sipas parimit të “një pasaportë të vetme” dhe “kontrollit në vendin e origjinës”, duke ngritur degë ose duke ofruar shërbime ndërkufitare drejtpërsëdrejti.

Legjislacioni evropian në fushën e shërbimeve financiare përbëhet nga aktet ligjore të mëposhtme:

- Rregullore e BE-së nr. 648/2012 “Për mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditimit dhe shoqërive të investimit”;
- Direktiva 2013/36/KE “Për aksesin e aktivitetit të institucioneve të kreditimit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditimit dhe shoqërive të investimit”
- Rregullore (BE) Nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 qershor 2013 “ Mbi kërkesat e kujdesshme për institucionet e kreditimit dhe shoqëritë e investimit” që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 648/20;
- Direktiva 2007/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 shtator 2007 që ndryshon Direktivën e Këshillit, 92/49/KEE dhe Direktivat 2002/83/KE, 2004/39/KE, 2005/68/KE dhe 2006/48/KE në lidhje me rregullat procedurale dhe kriteret e vlerësimit për vlerësimin prudencial të blerjeve dhe rritjes së pjesëmarrjes në sektorin financiar ;
- Direktiva 2009/111/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shtator 2009 që ndryshon Direktivat 2006/48/KE, 2006/49/KE dhe 2007/64/KE në lidhje me bankat që

kanë lidhje me institucione qendrore, disa çështje për fondet e veta, ekspozimet e mëdha, masat mbikëqyrëse, dhe administrimin e krizave (Direktiva për Kërkesat për Kapital II) ;

- Direktiva 2010/76/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 nëntor 2010 që ndryshon Direktivat 2006/48/KE dhe 2006/49/KE në lidhje me kërkesat për kapital për portofolin e librit të tregtueshëm dhe rishikimin mbikëqyrës të politikave të remunerimit;
- Direktiva 2002/47/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 6 qershor 2002 mbi marrëveshjeve të kolateralit financiar;
- Direktiva 2001/24/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 4 prill 2001 për riorganizimin dhe likuidimin e institucioneve të kreditit;
- Direktiva 2008/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 prill 2008 për marrëveshjet e kredisë për konsumatorët që shfuqizon Direktivën 87/102/KEE;
- Direktiva 2002/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 shtator 2002 lidhur me marketingun në distancë të shërbimeve financiare për konsumatorin që ndryshon Direktivën 90/619/KEE dhe Direktivat 97/7/KE dhe 98/27/KE;
- Direktiva 1986/635/KEE e Këshillit e datës 8 dhjetor 1986 për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të bankave dhe institucioneve të tjera financiare ;
- Direktiva e Këshillit 1989/117/KEE e datës 13 shkurt 1989 për detyrimin e degëve të vendosura në një Shtet Anëtar të institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare që i kanë selitë qendrore jashtë atij Shteti Anëtar në lidhje me publikimin e dokumenteve të llogarive vjetore ;
- Direktiva 2001/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 shtator 2001 që ndryshon direktivat 78/660/KEE, 83/349/KEE dhe 86/635/KEE në lidhje me rregullat e vlerësimit për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara të disa lloj kompanive si dhe bankave dhe institucioneve të tjera financiare;
- Direktiva 2003/51/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 qershor 2003 që ndryshon direktivat 78/660/KEE, 83/349/KEE, 86/635/KEE dhe 91/674/KEE në lidhje me rregullat e vlerësimit për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara të disa lloj kompanive si dhe bankave dhe institucioneve të tjera financiare, si dhe sipërmarrjeve në fushën e sigurimeve;
- Direktiva 2009/110/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009 mbi marrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të institucioneve të parasë elektronike, ndryshimit Direktivat 2005/60/ KE dhe 2006/48/ KE dhe shfuqizimi i Direktivës 2000/46/KE;
- Direktiva 2007/64/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 Nëntor 2007 në shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm që ndryshon Direktivat 97/7/ KE, 2002/65/ KE, 2005/60/ KE dhe 2006/48/ KE dhe shfuqizon Direktivën 97/5/ KE;
- Direktiva 94/19/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 30 maj 1994 për skemat e depozitave të garancisë;
- Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 Mars 2002, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 73/239/KEE në lidhje me kërkesat për nivelin e aftësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve jo- jetë;
- Direktiva e Këshillit 91/674/KEE, datë 19 Dhjetor 1991 për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të ndërmarrjeve të sigurimeve;

- Direktiva 2009/138/KE datë 25 Nëntorit 2009 mbi krijimin dhe kryerjen e veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit (Solvency II);
- Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 Prill 2004 “Mbi tregjet e instrumenteve financiarë” që ka ndryshuar Direktivën 85/611/KEE dhe 93/6/KEE dhe Direktivën 2000/12/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe ka shfuqizuar Direktivën 93/22/KEE;
- Direktiva 2003/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 4 Nëntorit 2003 “Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t’u tregtuar” që amendon Direktivën;
- Direktiva 2010/73/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 24 Nëntor 2010 që ka ndryshuar Direktivën 2003/71/KE “Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t’u tregtuar” dhe Direktivën 2004/109/KE “Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth emetuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t’u tregtuar në tregjet e rregullta”;
- Direktiva 2004/109/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 15 Dhjetorit 2004 “Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t’u tregtuar në tregjet e rregullta dhe që ka ndryshuar Direktivën 2001/34/KE;
- Direktiva 2001/34/KE e Parlament Evropian dhe e Këshillit të 28 Maj 2001 “Mbi pranimin e titujve në listimin e bursave zyrtare të titujve dhe informacioni që duhet publikuar për këto tituj”;
- Direktiva 2003/41/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 3 Qershorit 2003 “Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensioneve profesionale”;
- Direktiva 2009/103/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 16 Shtatorit 2009 “Në lidhje me sigurimin kundër përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike”;
- Direktiva 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 13 Korrikut 2009 “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS)”;
- Rregullorja (KE) Nr. 583/ 2010 e datës 1 Korrik 2010 që ka implementuar Direktivën 2009/65/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me informacionin kyç të investitorit dhe kushtet që duhet të plotësohen kur sigurohet informacioni kyç i investitorit ose prospektit të aksesueshëm gjatë një periudhe të përshtatshme, e ndryshme nga ajo në letër dhe në formë elektronike;
- Rregullorja (KE) Nr. 1606/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 korrik 2002 për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;
- Direktiva 2014/65KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 Maj 2014 “Mbi tregjet e instrumenteve financiarë” që ka ndryshuar Direktivën 2002/92/KE dhe Direktivën 2011/161/KE. (MiFID II);
- Direktiva 2014/51BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 Prill 2014 ka ndryshuar Direktivën 2003/71/KE dhe Direktivën 2009/138/KE dhe Rregulloren (KE) Nr.1060/2009, (BE)Nr.1094/2010 dhe (BE) Nr.1095/2010 në lidhje me kompetencat e Autoritetit Mbikëqyrës Evropian EIOPA (Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe

Pensioneve Profesionale) dhe Autoritetit Mbikëqyrës Evropian ESMA(Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve).

- Rregullorja (BE) Nr. 600/ 2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 Maj 2014 “Mbi tregjet e instrumenteve financiarë” është publikuar në fletoren zyrtare të BE-së.
- Rregullorja (BE) Nr. 596/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 Prill 2014 mbi manipulimin e tregut(Rregullore mbi manipulimin e tregut).
- Direktiva 2014/49/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 Prill 2014 për skemat e garantimit të depozitave;
- Direktiva 2014/59/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 Maj 2015 mbi krijimin e një kuadri për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e institucioneve të kreditimit dhe shoqërive të investimit e cila ndryshon Direktivën 82/891/KEE, Direktivën 2001/24/KE, Direktivën 2002/47/KE, Direktivën 2004/25/KE, Direktivën 2005/56/KE, Direktivën 2007/36/KE, Direktivën 2011/35/BE, Direktivën 2012/30/BE dhe Direktivën 2013/36/BE, Rregulloren e (BE) Nr. 1093/2010 dhe (BE) Nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit;
- Direktiva 2014/17/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 04 Shkurt 2014 “Mbi kontratat e kredisë për konsumatorët lidhur me pasurit e paluajtshme” dhe amendimin e Direktivës 2008/48/BE “Mbi kontratat e kredisë për konsumatorët”.
- Direktiva e Komisionit 2010/ 43 / KE e datës 1 korrik 2010, mbi zbatimin e Direktivës 2009/65 / KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat organizative, konfliktet e interesit, zhvillimin e biznesit, menaxhimin e rrezikut dhe përmbytjen e marrëveshjes ndërmjet depozitarit dhe një kompanie të menaxhimit.
- Direktiva 2016/97/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 Janar 2016“ Direktiva e Shpërndarjes në Sigurime”.
- Direktiva 2016/2341/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 14 Dhjetor 2016 “Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional”.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Përafrimi i kuadrit ligjor në fushën e shërbimeve financiare me *acquis*, lind si detyrim për përmbytjen e angazhimeve të marra në kuadër të zbatimit të neneve 50, 57, 70,82 dhe 89 të MSA-së.

I.2 Situata Aktuale/Përmbledhje

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare. Njëfarë progresi është bërë në mbikëqyrjen bankare si dhe në harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit me Direktivën Solvency II.

Sa i përket bankave dhe konglomerateve financiare, Banka e Shqipërisë (BSH) ka përforcuar dhe ristrukturuar departamentin e saj të mbikëqyrjes me theks të veçantë në mbikëqyrjen e bazuar në rrezik. Memorandume Mirëkuptimi janë nënshkruar me institucionet e tjera në tregun financiar vendas dhe me autoritetet e huaja mbikëqyrëse të subjekteve bankare që veprojnë në Shqipëri. BSH është pjesë e Kolegjit të Autoritetit Bankar Evropian dhe mban kontakte me Autoritetet Evropiane të Mbikëqyrjes.

Kapaciteti i BSH-së është i përshtatshëm për zbatimin e harmonizimit legjislativ të Shqipërisë me *acquis*. Një strategji afatmesme e zhvillimit 2018-2020 u miratua nga Banka e Shqipërisë në nëntor 2017. Banka e Shqipërisë ka vijuar të harmonizojë më tej kuadrin rregullator bankar dhe manualin e mbikëqyrjes me Marrëveshjen Bazel II dhe Bazel III.

Përcaktimi i kapitalit sipas Bazel III është miratuar. Puna duhet të vazhdojë në fushat e politikës makroprudenciale (përcaktimit të kapitalit mbrojtës kundër-ciklik si dhe identifikimit të bankave vendase me rëndësi sistematike) dhe atë të kuadrit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar udhëzime dhe rregullore të reja që synojnë harmonizimin e mëtejshëm me *acquis* e BE-së për mjaftueshmërinë e kapitalit, licencimin dhe veprimtarinë e bankave, menaxhimin e rrezikut, raportimin nga shoqëritë e kursim-kreditit dhe transparencën për shërbimet bankare dhe financiare.

Shqipëria ka një sistem identifikimi të bankave me rëndësi sistematike, të ngjashëm me praktikën e BE-së. Raporti i kredive me probleme u ul nga 18% në dhjetor 2016 në 13.2% në tetor 2017, kryesisht për shkak të procedurës së shlyerjes dhe të ristrukturimit të kredisë. Përpjekjet për të zbatuar planin e veprimit të kredive me probleme si dhe për të lehtësuar më tej procesin e ekzekutimit të kolateralit duhet të vijojnë.

Tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, përkatësisht tregu i sigurimeve, i titujvedhe fondeve të investimeve, si dhe i fondeve të pensioneve private vullnetare, në vite kanë përfjetuar zgjerim gradual të veprimtarisë së tyre, por mbeten relativisht të kufizuara në raport me tregun bankar dhe në krahasim me tregjet e rajonit, si dhe me kontribut modest në ndërmjetësimin financiar.

Për rrjedhojë, viti 2018 është përcaktuar si viti i zhvillimit strategjik për AMF-në dhenjëherësh për tregjet.

Bordi i Autoritetit miratoi “me Vendimin e Bordit nr. 78, datë 23.04.2018, Strategjinë 5-vjeçare për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje”, hartuar nga Komitetin Këshillimor.

Ky kuadër strategjik do të mbështetet nga një plan i detajuar zbatimi me objektiva vjetore, gjë që do ta bëjë atë lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesit dhe aktorët e tregut, sidhe do të mundësonte monitorimin e kësaj strategjie dhe rishikim e saj sipas nevojave.

Vizioni në thelb udhëhiqet nga mbrojtja e konsumatorit, në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë financiare dhe të zhvillimit të sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

Janë përcaktuar disa drejtime të rëndësishme për zhvillim për periudhën afatmesme. Nisur nga madhësia dhe niveli jo i njëjtë i zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje, kjo strategji është konceptuar, duke marrë në konsideratë nivelin e zhvillimit, nevojat përmbështetje të ndara sipas tregjeve, dhe në veçanti problematikat akute që shfaq secili treg.

Në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare janë thelluar përpjekjet dhe është bërë progres në përafrimin e legjislacionit të tregut të sigurimeve, titujve dhe pensioneve me legjislacionin evropian. Kështu Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2017 dhe 2018 konsolidoi punën për hartimin dhe rishikimin e kuadrit ligjor rregullator e mbikëqyrës me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me acquis e Bashkimit Evropian në fushën e tregut financiar jo-bankar, në zbatim të nenit 89 të MSA-së, rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2018, me synim përmirësimin e mëtejshëm të këtij tregu, forcimin e mbikëqyrjes dhe të kapaciteteve institucionale.

Mbas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Autoriteti ka vijuar punën për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me acquis e Bashkimit Evropian në fushën e tregut financiar jo-bankar.

AMF hartoi projektligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në zbatim të MSA-së, rekomandimeve të Progres Raporteve, rekomandimeve të NënKomitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca”, si dhe rekomandimeve të dhëna nga misioni i përbashkët FMN dhe Banka Botërore në kuadër të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP).

Me këtë projektligj synohet përafrimi i pjesshëm me Direktivat Evropiane të fushës së sigurimit motorik të cilat kanë për qëllim harmonizimin e funksionimit dhe mbikëqyrjes së kësaj veprimtarie dhe konkretisht Direktivën 2009/103/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009, për sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe për zbatimin me forcë të detyrimit për të marrë një sigurim të tillë.

Në maj 2018 projektligji është dërguar nga Autoriteti në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të vazhduar procesin e miratimit.

AMF gjithashtu ka përfunduar punën për hartimin e ndryshimeve të ligjit Nr. 10197 të datës 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”. Ndryshimet në ligj synojnë përqasjen e tij me Direktivën 2003/41/KE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e 3 qershor 2003 “Mbi aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve për dhënien e pensioneve profesionale”, parimet e mbikëqyrjes së pensioneve private të hartuara dhe të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve (IOPS) si dhe Udhëzuesit e OECD-së. Projektligji

është dërguar nga Autoriteti në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të vazhduar procesi i miratimit.

Në funksion të rregullimit ligjor të tregut të fondeve të investimit gjithnjë e në rritje, si dhe në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të veprimtarisë së operatorëve të këtij tregu AMF ka vazhduar punën për përmirësimin e bazës rregullatore për fondet e investimeve dhe tregut të kapitalit në tërësi.

AMF në bashkëpunim me konsulentët e projektit ("Forcimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF): Fokusimi në Zhvillimin e Tregut të Kapitalit") janë duke punuar për dy projektligjet të cilat janë rezultatet më të rëndësishme të këtij projekti:

- Projektligji “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”
- Projektligji “Për tregun e kapitaleve”.

Projektligji “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”synon të përputhet me direktivat-Direktiva 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 Korrik 2009, “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT)” dhe Direktiva 2011/61/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 8 Qeshor 2011,"Për administruesit e fondeve alternative të investimit " dhe që ndryshon direktivat 2003/41/KE dhe 2009/65/KE dhe rregulloret(KE) NR.1060/2009 DHE (BE) NR. 1095/2010

Projektligji “Për Titujt”synon përafrimin me Direktivën 2014/65 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi tregjet e instrumenteve financiare dhe duke ndryshuar Direktivën 2002/92 / KE dhe Direktivën 2011/61 / BE.

Zhvillimi i fondeve të investimeve dhe tregut të titujve në vitet e fundit përbën një hap pozitiv përpara drejt zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri, zhvillim ky që solli edhe vendimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për të licencuar më datë 3 korrik 2017 shoqërinë “Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE” sh.a., (Albanian Stock Exchange) si bursën e parë shqiptare me kapital privat e licencuar në vend.

Bordi i AMF-së me Vendimin nr. 88, datë 03.07.2017, licenoi shoqërinë e parë me kapital privat “Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE” sh.a. për ushtrimin e veprimtarisë si bursë e titujve.

Krijimi i Bursës Shqiptare erdhi si domosdoshmëri për të plotësuar nevojat e biznesit për financim si dhe kërkesën e investitorëve për alternativa të reja investimi përtej atij bankar.

Domosdoshmëria e licencimit të Bursës lidhet edhe me funksionin e rëndësishëm të tregutsekondar për të krijuar likuiditet dhe një vlerësim të drejtë të çmimit të titujve.

Tregtimi i titujve në Bursë realizohet nëpërmjet një platforme elektronike tregtimi, e quajtur “Quick Trade”, sistem i cili përdoret nga disa bursa të rajonit.

Në gjysmën e dytë të vitit 2017, pranë Bursës u kryen të gjitha testimet e nevojshme mbi funksionimin e sistemit të tregtimit. Në dhjetor të vitit 2017, Bursa Shqiptare e Titujve organizoi trajnimin mbi sistemin e tregtimit me disa brokera, kryesisht banka të licencuara për aktivitetin e brokerimit në tregun e letrave me vlerë dhe që do të jenë anëtarët potencialë të Bursës.

Funksionimi i Bursës në transaksionet e titujve të Qeverisë, është i lidhur domosdoshmërisht me sistemin e Shlyerjes dhe Regjistrimit të Titujve, AFISaR, pranë Bankës së Shqipërisë. Nga pikëpamja ligjore dhe teknike pothuajse është realizuar procesi i ndërveprimit të Bursës me sistemin AFISaR.

Bursa Shqiptare e Titujve, (ALSE) filloi veprimtarinë e saj me 22 Shkurt 2018. Bursa e Titujve do të ushtrojë veprimtarinë vetëm në titujt e Qeverisë. Pas heqjes së kufizimit (shkurt 2019), Bursa Shqiptare e Titujve ka në plan të fillojë me tregtimin e letrave me vlerë të tjera të tilla si obligacionet e korporatave dhe aksionet. Tregtia e letrave të tjera me vlerë lidhet edhe me licencimin e Regjistrimit të letrave me vlerë dhe depozitarit qendror të letrave me vlerë të nevojshme për procesin e klerimit dhe shlyerjes. AMF po bashkëpunon me BSH-së në këtë drejtim. Ky proces mbështetet edhe nga projekti "Studimi i formës së ardhshme të depozitarit qendror të letrave me vlerë në Shqipëri.

I.3. Prioritetet

Prioritetet e Bankës së Shqipërisë janë:

- Të harmonizojë legjislacionin e saj me Bazel III dhe të përgatitet për zbatimin e dispozitave të Bazel IV;
- Të zbatojë Planin e Veprimit për kreditë me probleme;
- Të punojë për lehtësimin e procesit të ekzekutimit të kolateralit;
- Të punojë për rihapjen e Bursës publike, e cila mbetet e pezulluar;
- Të nxisë përdorimin e monedhës kombëtare.

Në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Bankës së Shqipërisë prioritetet në fushën e mbikëqyrjes bankare janë:

- Përafrimi i kuadrit rregullator me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe forcimi i bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse të huaja
- Forcimi i bashkërendimit të mbikëqyrjes bankare, stabilitetit financiar dhe politikës monetare.

Në përputhje me rekomandimet e lëna në takimin e Nënkomitetit për Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat :

- Shqipëria duhet të vijojë implementimin e masave të mbetura të Planit të Veprimit për Kreditë me Probleme me qëllim forcimin e stabilitetit financiar dhe ekonomisë reale;

- Të vijojë promovimi i monedhës kombëtare përmes implementimit të masave të parashikuara në Memorandumin e Bashkëpunimit;

Në përputhje me rekomandimet e Bankës Qendrore Evropiane në fushën e mbikëqyrjes bankare prioritetet janë:

- Rishikimi i ligjit për Bankën e Shqipërisë në kuadër të harmonizimit të standardeve të Marrëveshjes së Basel III, Direktivës për kërkesat e kapitalit dhe Rregullores për kërkesat e kapitalit, veçanërisht për sa i përket dispozitave që rregullojnë raportin e mbulimit me likuiditet
- Hartimi i manualeve përkatëse për harmonizimin me standardet e Marrëveshjes së Basel III, Direktivës për kërkesat e kapitalit dhe Rregullores për kërkesat e kapitalit;
- Harmonizimi i metodologjisë së raportimit financiar me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Prioritetet e AMF-së janë:

- Miratimi dhe fillimi i zbatimit të Ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;
- Miratimi dhe zbatimi i projekt-amendamenteve të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar";
- Hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
- Hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për tregun e kapitaleve”;

Në përputhje me Strategjinë afatmesme për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje”, prioritetet janë:

- Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe rregullimit;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator;
- Edukimi financiar;
- Nxitja e besueshmërisë së konsumatorit, nëpërmjet stabilizimit të tregut;
- Promovimi i tregjeve;
- Nxitja e transparencës dhe besueshmërisë në tregjet financiare;
- Ngritja e kapaciteteve për mbikëqyrjen e grupeve financiare dhe zhvillimin e mbikëqyrjes së konsoliduar;
- Ndërtimin e një mekanizmi për mbrojtjen e konsumatorëve ndaj falimenteve dhe daljeve nga tregu të operatorëve;

II.1 Bankat dhe konglomeratet financiare

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Banka e Shqipërisë ka vijuar procesin e finalizimit të rregulloreve të reja dhe ndryshimeve përkatëse në disa rregullore ekzistuese të mbikëqyrjes bankare, të cilat kanë marrë në konsideratë

kryesisht përshtatjen me detyrimet që rrjedhin për Bankën e Shqipërisë nga dokumentet strategjikë të integritetit evropian të tilla si Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, raportet progresive të Komisionit Evropian dhe nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri. Paralelisht, gjatë procesit të rishikimit të kuadrit rregullator përpjekjet janë fokusuar mbi përafrimin e mëtejshëm me standardet e Komitetit të Bazelit si dhe praktikën më të mirë në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare.

Akte të reja rregullative dhe ndryshime me rëndësi në aktet në fuqi për mbikëqyrjen bankare, të cilat kanë realizuar një përafrim të pjesshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe standardet e Komitetit të Bazelit mund të përmenden:

- Rregullore nr. 48, datë 31.07.2013 “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, e ndryshuar – Përafruar pjesërisht me Rregulloren e BE-së nr. 575/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 26 qershor 2013 “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit” që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 dhe me Direktivën 2013/36/KE “Mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe shoqërive të investimit”;
- Rregullore nr.63, datë 14.11.2012 “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.73, datë 6.12.2017 - Përafruar pjesërisht me Direktivën 2013/36/EC “Mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe shoqërive të investimit”; me Udhëzuesit e Autoritetit Bankar Evropian (EBA), përkatësisht GL-2017-11 “Udhëzues mbi qeverisjen e brendshme” dhe GL-2017-12 “Mbi vlerësimin e përshtatshmërisë së anëtarëve të organeve drejtuese dhe drejtuesve në pozicione kryesore”; si dhe me Dokumentin e Komitetit të Bazelit “Udhëzimi mbi parimet e qeverisjes korporative”;
- Rregullore nr.67, datë 2.9.2015 “Për sistemin e kontrollit të brendshëm”, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.74, datë 6.12.2017 – Përafruar pjesërisht me Dokumentin e Komitetit të Bazelit “Funksioni i kontrollit të brendshëm në banka”, Qershor 2012;
- Rregullore nr. 69 datë 18.12.2014 “Për kapitalin rregullator të bankës” - Përfaruar pjesërisht me Rregulloren nr. 575/2013 “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit”;
- Rregullore nr. 10 datë 26.02.2014 “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, e ndryshuar – Përafruar pjesërisht me Rregulloren nr. 575/2013 “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit”;
- Rregullore nr. 11, datë 06.02.2008 “Për instrumentet e pagesave elektronike”, e ndryshuar – Përafruar pjesërisht me Direktivën 2009/110/KE “Mbi sipërmarrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të institucioneve elektronike të parasë” dhe Direktivën Evropiane 2015/2366, “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”;
- Rregullore nr. 60 datë 29.8.2008 “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, ndryshuar me Vendimin Nr. 25, datë 01.04.2015 – përafruar pjesërisht me Rregulloren nr. 575/2013 “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit”, dokumentin e Komitetit të Bazelit

“Konvergjenca ndërkombëtare e Matjes së Kapitalit dhe Standardeve të Kapitalit”, si dhe dokumentin e Komitetit të Bazelit “Kërkesat për informacion sipas Shtyllës 3, në lidhje me shpërbimin”;

- Rregullore nr. 70 “Për veprimtarinë valutore” – Përafruar pjesërisht me Direktivën 88/361/KEE për zbatimin e nenit 67 të Traktatit;
- Rregullore nr. 48 datë 01.07.2015 “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore”, e ndryshuar – Përafruar pjesërisht me Direktivën 2008/48/KE “Mbi kontratat e kredisë për konsumatorët” dhe me Direktivën 2014/17/KE “Mbi kontratat e kredisë për konsumatorët në lidhje me pasuritë e paluajtshme”;
- Rregullore nr. 59 datë 29.08.2008 “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, e ndryshuar – Përafruar pjesërisht me Direktivën 2008/48/KE “Mbi kontratat e kredisë për konsumatorët”;
- Rregullore nr. 72 datë 6.12.2017 “Për planet e rimëkëmbjes së bankave” - Përafruar pjesërisht me Rregulloren 2016/1075 të BE-së që plotëson Direktivën 2014/59/BE; me Udhëzuesin e Autoritetit Bankar Evropian (EBA) GL 2015-02 “Për listën minimale të treguesve cilësorë dhe sasiorë të planit të rimëkëmbjes”, si dhe me Udhëzuesin e Autoritetit Bankar Evropian (EBA) GL 2014-06 “Për tërësinë e skenarëve që do të përdoren në planet e rimëkëmbjes”;
- Rregullore nr. 4 datë 1.2.2017 “Për mbikëqyrjen e konsoliduar” - Përafruar pjesërisht me Direktivën 2013/36/BE “Mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe shoqërive të investimit” dhe me Rregulloren nr. 575/2013 “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit”;
- Udhëzimi nr.26 datë 3.5.2017 “Mbi procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit” – Përafruar pjesërisht me Direktivën 2013/36/BE “Mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe shoqërive të investimit” dhe Rregulloren 575/2013 “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit”, si dhe me kërkesat e Shtyllës së Dytë – Procesi i Rishikimit Mbikëqyrës - të Akordit të Kapitalit.
- Ligji 9662 datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – Përafruar pjesërisht me Direktivat sipas Aneksit II.
- Ligji nr. 52/2016, datë 19.05.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre”- Përafruar pjesërisht me Direktivën 2013/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 qershor 2013 “Mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe shoqërive të investimit” që ndryshon Direktivën 2002/87/KE dhe shfuqizon direktivat 2006/48/KE dhe 2006/49/KE;
- Ligji 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”- Përafruar pjesërisht me Direktivën 2014/59/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15 maj 2014, “Mbi krijimin e një kuadri për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e institucioneve të kreditit dhe firmave të investimit”, që ndryshon Direktivën e Këshillit 82/891/KEE, dhe Direktivat 2001/24/KE, 2002/47/KE, 2004/25/KE, 2005/56/KE, 2007/36/KE, 2011/35/BE, 2012/30/BE dhe 2013/36/BE, si dhe

Rregulloret (BE) nr. 1093/2010 dhe (BE) nr. 648/2012, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”.

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë

II.1.3 Masat e parashikuara 2019-2021

II.1.3.1 Kuadri politik i planifikuar

Strategjia Afatmesme e Bankës së Shqipërisë 2018-2020.

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara

- Hartimi i Udhëzimit "Mbi stress test-et e bankave"
- Rishikimi i Rregullores nr.10 datë 26.02.2014 “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”
- Rishikimi i rregullores nr.48, datë 31.7.2013 "Për mjaftueshmërinë e kapitalit", që synon kryesisht përfshirjen e trajtimit sipas peshave të rrezikut të kredisë për disa ekspozime, bazuar në vlerësimin e cilësisë së kredisë së vetë kundërpartisë
- Rishikimi i rregullores nr.48, datë 31.7.2013 "Për mjaftueshmërinë e kapitalit", që synon kryesisht përfshirjen e trajtimit sipas peshave të rrezikut të kredisë për disa ekspozime, bazuar në vlerësimin e cilësisë së kredisë së vetë kundërpartisë
- Hartimi i Rregullores “Për përcaktimin e kushteve kur zbatohen masat e ndërhyrjes së hershme dhe të kushteve dhe mënyrës së kryerjes së administrimit të përkohshëm”
- Hartimi i Aktit rregullativ "Për përcaktimin e kushteve për dhënien e miratimit paraprak për marrëveshjen e mbështetjes financiare brenda grupit bankar"
- Rishikimi i rregullores nr.27 datë 16.05.2012 "Për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë"
- Hartimi i Dokumentit "Për procesin e rishikimit dhe vlerësimit mbikëqyrës"
- Hartimi i Rregullores "Për raportin e levës financiare të bankave"
- Hartimi i Rregullores “Për raportin neto të financimit të qëndrueshëm (NSFR)”
- Hartimi i Udhëzimit "Për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit (ILAAP)"
- Hartimi i rregullores "Për raportin e mbulimit me likuiditetit".

II.1.3.3 Masa të tjera të planifikuara

N/A

II.2 Sigurimet dhe pensionet

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Legjislacioni ekzistues i Shqipërisë në shërbimet financiare jo-bankare ka qenë pjesërisht përafruar me legjislacionin e BE; megjithatë, kjo përbën një bazë të fortë për një përafrim të mëtejshëm dhe të plotë me legjislacionin e BE.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", AMF, bazuar në këtë ligj, ka vazhduar hartimin e akteve nënligjore, në mënyrë që të përafrohet edhe më tej me Solvency II.

AMF hartoi dhe Parlamenti miratoi ligjet e mëposhtme:

- Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" – Përafruar pjesërisht me Direktivën 2003/41/KE "Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjes e institucioneve të pensioneve profesionale";
- Ligji nr. 10 076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar - Përafruar pjesërisht me Direktivën 72/166/KEE, për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike; Direktivën 84/5/KEE, direktiva e dytë e sigurimit motorik, për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike; Direktivën 90/232/KEE, direktiva e tretë e sigurimit motorik, për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike; Direktivën 2000/26 KE, direktiva e katërt e sigurimit motorik për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike; Direktivën 2005/14/KE, që amendon Direktivat 72/166/KEE, 84/5/KEE, 88/357/KEE dhe 90/232/KEE, dhe Direktiva 2000/26/KE;
- Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" - Përafruar pjesërisht me Direktivat: 73/239/KEE, 73/240/KEE, 87/344/KEE, 87/343/KEE, 88/357/KEE, 92/49/KEE, 2002/13/KE, 98/78/KE, 2002/92/KE, 2005/68/KE, 2002/83/KE, 2001/17/KE dhe 84/641KEE.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

II.2.3 Masat e parashikuara 2019-2021

II.2.3.1 Kuadri politik i planifikuar

Strategjia 5-vjeçare për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje” 2018-2022, hartuar nga Komitetin Këshillimor. Bordi i Autoritetit e miratoi “me Vendimin e Bordit nr. 78, datë 23.04.2018.

II.2.3.2 Masat ligjore të planifikuara

- Projektligj "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"
- Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar"

II.2.3.3 Masa të tjera të planifikuara

N/A

II.3 Infrastruktura e tregut financiar

II.3.1 Kuadri politik dhe ligjor

Autoriteti Shqiptar i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ka intensifikuar vazhdimisht përpjekjet e saj për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të krijuar një bazë të nevojshme rregullatore për zhvillimin e qëndrueshëm të tregut financiar jo-bankar. Sipas angazhimeve në kuadrin e MSA-së, AMF ka vazhduar përmirësimin dhe përafrimin e legjislacionit ekzistues me direktivat e BE-së. Si rezultat, një numër i ligjeve dhe akteve nënligjore janë duke u hartuar dhe miratuar për të ngritur dhe forcuar procese të qarta, transparente dhe të qëndrueshme rregullatore dhe mbikëqyrëse në fushën e institucioneve financiare jobankare. Legjislacioni ekzistues i Shqipërisë në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare ka qenë pjesërisht përafruar me legjislacionin e BE-së; megjithatë, kjo përbën një bazë të fortë për një përafrim të mëtejshëm dhe të plotë me legjislacionin e BE-së.

AMF hartoi dhe Parlamenti miratoi ligjin e mëposhtëm:

- Ligji nr. 10158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisjes vendore”- Përafruar pjesërisht me Direktivën 2004/39/KE (MiFID) “Mbi tregjet e instrumenteve financiarë”;

II.3.2 Institucionet përgjegjëse

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

II.3.3 Masat e parashikuara 2019-2021

II.3.3.1 Kuadri politik i planifikuar

Strategjia 5-vjeçare për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje” 2018-2022, hartuar nga Komitetin Këshillimor. Bordi i Autoritetit e miratoi “me Vendimin e Bordit nr. 78, datë 23.04.2018.

II.3.3.2 Masat ligjore të planifikuara

- Projektligji “Për tregun e kapitaleve”

II.3.3.3 Masa të tjera të planifikuara

N/A

II.4 Tregjet e sigurimeve dhe shërbimet e investimeve

II.4.1 Kuadri politik dhe ligjor

Legjislacioni ekzistues i Shqipërisë në shërbimet financiare jo-bankare ka qenë pjesërisht i përafëruar me legjislacionin e BE-së; megjithatë, kjo përbën një bazë të fortë për një përafërim të mëtejshëm dhe të plotë me legjislacionin e BE-së.

AMF hartoi dhe Parlamenti miratoi ligjet e mëposhtme:

- Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”- Përafëruar pjesërisht me Direktivën 85/611/KEE “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me shoqëritë e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm”, amenduar nga Direktiva 88/220/KEE dhe Direktiva 95/26/KE;
- Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt” - Përafëruar pjesërisht me Direktivën 2004/109/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 dhjetor 2004, “Mbi

harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t'u tregtuar në tregjet e rregullta"; amenduar Direktiva 2001/34/KE; Direktivën 2003/71/KE "e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 4 Nëntor 2003, "Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t'u tregtuar"; që amendon Direktivën 2001/34/KE ; Direktivën 2004/39/KE (MiFID) "Mbi tregjet e instrumenteve financiarë"; Direktivën 2003/6/KE "Për trajtimin e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut";

- Ligji nr.36, datë 31.03.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10 198, datë 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive"- Përafruar pjesërisht me Direktivën 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 13 Korrikut 2009 "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS)".

II.4.2 Institucionet përgjegjëse

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

II.4.3 Masat e parashikuara 2019 – 2021

II.4.3.1 Kuadri politik i planifikuar

Strategjia 5-vjeçare për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje” 2018-2022, hartuar nga Komitetin Këshillimor. Bordi i Autoritetit e miratoi “me Vendimin e Bordit nr. 78, datë 23.04.2018.

II.4.3.2 Masat ligjore të planifikuara

Projektligji "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive"

II.4.3.3 Masa të tjera të planifikuara

N/A

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare janë institucione të pavarura të cilat financohet nga të ardhurat e veta dhe jo nga Buxheti i Shtetit.

Kapitulli 10: Shoqëria e Informacionit dhe Media

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e acquis së BE-së

Legjislacioni i BE-së synon:

- eliminimin e pengesave ndaj funksionimit të efektshëm të tregut të brendshëm në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike;
- promovimin e konkurrencës në tregun e brendshëm;
- mbrojtjen e konsumatorit.

Pjesa kryesore e acquis në fushën e komunikimeve elektronike përbëhet nga paketa e direktivave e njohur si kuadri rregullator për komunikimet elektronike 2002 dhe 2009 të BE-së. Më 14 shtator 2016, Komisioni Europian ka miratuar propozimin për Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike që pritet të zëvendësojë paketen e direktivave të vitit 2002 dhe 2009. Kodi i komunikimeve elektronike përfshin masa për nxitjen e investimeve në rrjetet e kapaciteteve shumë të larta, rregulla të reja për spektrin e frekuencave dhe rrjetet celulare 5G, ndryshime në regjimin e shërbimit universal, rregulla për mbrojtjen e konsumatorit, dhe numeracionin si dhe komunikimet e emergjencave.

Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme hyri në fuqi në Maj 2018.

BE-ja aktualisht është duke rishikuar shumë politika për të përmbushur qëllimet e Tregut të Vetëm Digjital. Rregulla të reja priten në lidhje me tregtinë elektronike dhe mbrojtjen e konsumatorit në mënyrë që të sigurohet akses i mirë për konsumatorët dhe bizneset për mallrat dhe shërbimet digjitale. Gjithashtu, shumë përpjekje po bëhen për arritjen e përfitimeve nga ekonomia digjitale dhe ekonomia e të dhënave. Në këtë fushë, zbatimi i politikave që rregullojnë përdorimin e të dhënave të mëdha, të dhënat e hapura dhe sigurimi i shërbimeve të informatizimit cloud tashmë janë duke dhënë rezultatet e tyre.

Më datë 6 Nëntor 2018, Këshilli i BE-së ka miratuar ndryshimet në Direktivën 2010/13/BE për shërbimet audiovizive. Këto ndryshime përfshijnë disa rregullime të reja që synojnë mbrojtjen më të mirë të minoreneve; rregulla të reja për platformat online, promovimin e punëve europiane etj. Prioriteti i ardhshëm do të jetë vlerësimi i domosdoshmërisë së hedhjes në treg të rregullave për platformat e internetit (motorët e kërkimit, mediat sociale, dyqanet e aplikacioneve etj.). Kjo do të mbulojë çështje të tilla si mos transparenca e rezultateve të kërkimit dhe e politikave të çmimeve, si dhe mënyra se si të trajtohen më mirë përmbajtjet ilegale në internet.

I.1.2. Kërkesat sipas MSA-së

Nenet 102-104 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit parashikojnë detyrimin për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me acquis të BE-së dhe harmonizimin me politikat e BE-së. Neni 102 i MSA parashikon bashkëpunimin në fushën audio-vizuale. Kjo përfshin një detyrim që Shqipëria të harmonizojë politikat e saj në rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimit ndërkufitar me standardet dhe legjislacionin e BE-së. Gjithashtu kërkon që vëmendje e veçantë t'i kushtohet respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në transmetimin e programeve me mjete të ndryshme, përfshirë tokësore, satelitore, kablllore etj. Ndryshimet e shpejta në teknologjinë e mediave, realitetin aktual të televizionit digjital në Shqipëri dhe përditësimin e legjislacionit me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane në këtë fushë kanë shërbyer si një nxitje e fuqishme për të ndërmarrë hapat e duhur në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe një vizioni afatgjatë të qasjeve rregullatore.

Neni 103 i MSA mbulon bashkëpunimin në fushën e shoqërisë së informacionit, ndërsa Neni 104 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit merret me bashkëpunimin që fokusohet në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

I.2. Situata aktuale/Përmbledhje

Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit të saj për komunikimet elektronike me rregullat e BE-së. Miratimi i ligjit Nr 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” shënoi një hap të rëndësishëm duke arritur liberalizimin e plotë të tregut të telekomunikacioneve dhe reformimin e sistemit të licencimit.

Në veçanti, ky ligj eliminoi pengesat për sipërmarrësit ndaj hyrjes në tregun shqiptar të komunikimeve elektronike si edhe siguroi:

- të drejtën e çdo sipërmarrësi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, për të përmbushur kërkesat e autorizimit të përgjithshëm si edhe ato të autorizimit individuale të nevojshme vetëm në rastin e përdorimit të burimeve të fundme (frekuenca dhe numra);
- një mjedis rregullator të përshtatshëm, që respekton parimin e paanshmërisë teknologjike;
- futjen në treg të 'lojtarëve' të rinj pa kërkuar përdorimin e burimeve të fundme, çka realizohet me procedura të thjeshta dhe të shpejta, pa qenë nevoja e ndonjë vendimi specifik paraprak;
- dhënien e të drejtave të përdorimit burimeve të kufizuara përmes procedurave transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale.

E ndërgjegjshme për rolin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në zhvillimin e shoqërisë dhe rritjen ekonomike, në promovimin e pjesëmarrjes përfshirëse dhe qeverisjes efikase, në respektimin dhe kontributin që jep në përmbushjen e parimeve bazë që shërbejnë për

demokraci cilësore, shtet ligjor funksional si dhe përfaqësim politik transparent, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash për zhvillimin e shoqërisë së informacionit. Në përmbushje të angazhimeve të MSA-së që rrjedhin nga nenet 102,103 dhe 104 të saj është punuar për planifikimin dhe implementimin e politikave në fushën e telekomunikacioneve dhe shoqërisë së informacionit. Strategjia ndërsektoriale për Agjendën Digjitale 2015-2020, e miratuar në Prill 2015 përbën një dokument strategjik për zhvillimet në të ardhmen në Shqipëri në drejtim të një ekonomie të bazuar në njohuritë. Strategjia mbulon një sërë aspektesh për zhvillimin e TIK në sektorë të ndryshëm si dhe përfshin objektiva dhe aktivitete për përmirësimin e shërbimeve publike dhe e-shërbimeve.

Janë bërë përpjekje për të harmonizuar legjislacionin kombëtar me acquis të BE-së për krimin kibernetik dhe Konventën e Këshillit të Evropës për krimin kibernetik (ETS Nr. 185). Në vitin 2004 Shqipëria ratifikoi “Protokollin Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik” në lidhje me kriminalizimin e akteve të një natyre raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike" (ETS Nr. 189). Ligji për Sigurinë Kibernetike u miratua në shkurt 2017.

Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit u përmirësua më tej dhe zbatimi i agjendës digjitale të Shqipërisë dhe plani kombëtar për zhvillimin e broadband vazhdoi. Shërbimet elektronike të ofruara institucioneve publike dhe qytetarëve janë rritur.

Në mars të vitit 2017, pas konsultimeve publike me aktorë të ndryshëm, AMA miratoi planin e saj strategjik të veprimit për 2017-2019.

I.3. Prioritete

Raporti i progresi i Komisionit European për Shqipërinë për 2018, në kapitullin 10, nënvizon që: BE mbështetet funksionimin e butë të tregut të brendshëm për komunikimet elektronike, tregtinë elektronike dhe shërbimet audiovizive, rregullat për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbështet disponueshmërinë e shërbimeve moderne publike.

Shqipëria është përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias audiovizuale. Progres është bërë në planin e veprimit të axhendës digjitale dhe shërbimet e e-qeverisjes. Autoriteti i Medias Audiovizive ka miratuar planin e tij të veprimit për 2017-2019. Në vitin e ardhshëm Shqipëria në vecanti:

- të finalizojë procesin e vonuar të digital sëitchover, të lirojë dividendin digjitale, dhe rishikojë planin kombëtar të broadbandit me objektiva të qarta;
- të ndërmarrë hapa të mëtejshme për miratimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore për komunikimet elektronike në përputhje me acquis;
- të implementojë numrin European të emergjencave në një zonë gjeografike më të gjerë;

Për të adresuar rekomandimin nga raporti i progresit i KE për Shqipërinë për kalimin nga transmetimi analog në digjital, Autoriteti i Mediave Audiovizuale (AMA) ka ndërmarrë aktivitete të rëndësishme. Aktualisht ka progres në zbatimin e infrastrukturës digjitale, e cila është e pranishme në të gjithë vendin dhe transmetimi analog është jashtë funksioni në tre qarqe.

Prioritetet normative afatshkurtra dhe afatmesme përfshijnë :

- Miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit;
- Plotësimi i kuadrit nënligjor të medias audiovizive në zbatim të ligjit Nr 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;
- Përafrimi i mëtejshëm me acquis të BE-së të Kapitullit 10 në përputhje me zhvillimet e acquis të BE-së.

II.1. Komunikimet elektronike dhe teknologjitë e informacionit

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri i politikave të komunikimeve elektronike përbëhet nga:

- Strategjia për Komunikimin Elektronik 2010 – 2017;
- Plani Kombëtar për Broadband 2013 – 2020;
- Strategjia ndersektoriale për Agjendën Digjitale 2015 – 2020.

Fusha e komunikimeve elektronike rregullohet nga masat e mëposhtme ligjore:

- Ligji Nr 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me Ligjin nr. 102/2012, i cili është në përputhje me zhvillimet më të fundit të acquis të BE-së, është ligji kryesor në fushën e komunikimeve elektronike (plotësisht në linjë me Direktivën 2002/19/EC; Direktivën 2002/20/EC; Direktivën 2002/21/EC; Direktivën 2002/22/EC; Direktivën 2002/58/EC; Direktivën 2009/136/EC; Direktivën 2009/140/EC; Direktivën 676/2002/EC; Direktivën 2002/77/EC, si dhe pjesërisht në linjë me Direktivën 2006/24/EC;
- Ligji Nr 120/2016 datë 24.11.2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, i cili ka transpozuar plotësisht direktivën 2014/61/EU, të Parlamentit Evropian;
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pjesërisht në linjë me Direktivën 2006/24/EC;
- Ligji për Bazat e të Dhënave Shtetërore.
- Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Legjislacioni zbatues përfshin aktet në vijim:

- Rregullore Nr 47 datë 26.10.2017 “Për zbatimin e Autorizimit të Përgjithshëm” plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/20/EC dhe Direktivën 2002/21/EC;

- Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr 2418 datë 06.02.2014 “Për miratimin e Planit të Përdorimit të Frekuencave”, i ndryshuar, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/20/EC; Direktivën 2002/21/EC; Direktivën 2009/114/EC dhe Vendimin 676/2002/EC;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 277 datë 29.3.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”, plotësisht në përputhje me Direktivën 2009/114/EC; Direktivën 2005/82/EC dhe Vendimin 676/2002/EC;
- Rregullorja e AKEP-it Nr 30 datë 05.12.2013 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/20/EC dhe Direktivën 2002/21/EC;
- Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr 932 datë 11.08.2009 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Numeracionit”, i ndryshuar, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/20/EC dhe Direktivën 2002/21/EC;
- Rregullorja e AKEP-it Nr 10 datë 11. 08. 2009 “Për përcaktimin e numrave dhe serive numerike”, e ndryshuar, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/20/EC dhe Direktivën 2002/21/EC;
- Rregullore Nr 33 datë 15.05.2014 “Për kushtet e përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza” plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/20/EC dhe Direktivën 2002/21/EC;
- Vendim i AMA Nr 99 datë 07.06.2017 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/20/EC dhe Direktivën 2002/22/EC;
- Rregullorja Nr 13 datë 16.04.2010 “Për portabilitetin e numrit”, e ndryshuar Rregullore Nr 43 datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” e ndryshuar, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/21/EC;
- Rregullore Nr 35 datë 10.09.2015 “Rregullat për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike”, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/21/EC;
- Rregullore Nr 37 datë 19.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/21/EC dhe Direktivën 2002/58/EC;
- Rregullorja Nr 16 datë 16.04.2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/22/EC;
- VKM Nr 546 datë 13.06.2013 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre”, plotësisht në përputhje me Direktivën 1999/5/EC;
- Rregullorja Nr 25 datë 14.06.2012 “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit të tyre”, plotësisht në përputhje me Direktivën 1999/5/EC;
- Rregullorja Nr 9 datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, ndryshuar me Vendim të Bordit Drejtues Nr 2342 datë 31.07.2013, plotësisht në përputhje me Rekomandimin 2007/879/EC dhe udhëzimet e Komisionit mbi analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë

së rëndësishme të tregut në kuadrin rregullator të Komunitetit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, (2002/C 165/03);

- Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr 2431-2435 datë 13.03.2014, plotësisht në përputhje me Rekomandimin 2009/396/EC
- Rregullore Nr 32 datë 26.12.2013 “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT)”, plotësisht në përputhje me Rekomandimin 2005/698/EC dhe Rekomandimin 2009/396/EC.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE);
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
- Autoriteti Audiovizual i Medias (AMA);
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ministria e Brendshme;
- Instituti i Statistikave.

II.1.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.1.3.1. Kuadri i politikave të parashikuara

- Dokument Politikash për politikat spektrale 2020-2025
- Rishikimi i Planit Kombëtar të Broadband 2019

II.1.3.2. Masat ligjore të parashikuara

- Projekt VKM për miratimin e Planit të ri Kombëtar të Frekuencave 2021
- Projektligj për ndryshime në ligjin për komunikimet elektronike për reflektimin e Kodit të Komunikimeve Elektronike të BE-së, në 2020;

II. 1.3.2. Akte të tjera të parashikuara

- Udhëzim i Ministrit për zbatimin e rregullave të menaxhimit të trafikut mbi bazën e rregullores së BE-së 2015/2120 për internetin e hapur; 2019

II.2. Shërbimet e shoqërisë së informacionit

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri i politikave në fushën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit përbëhen nga:

- Strategjia ndërsektoriale për Agjendën Digjitale 2015 – 2020.
- Dokumenti i Politikave për Sigurinë Kibernetike 2015-2017.

Fusha e shërbimeve të shoqërisë së informacionit rregullohet nga masat e mëposhtme ligjore:

- Ligji Nr 10128 datë 11.05.2009, për “Tregtinë Elektronike”, i ndryshuar me ligjin Nr 135/2013, plotësisht në përputhje me Direktivën 2000/31/EC;
- Ligji Nr 9880 datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik” ndryshuar me Akt normativ Nr 8 datë 30.9.2009, plotësisht në linjë me Rregulloren 910/2014/EU;
- Ligji Nr 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, plotësisht në linjë me Direktivën 98/84/EC;
- Ligji Nr 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë”, pjesërisht në linjë me Direktivën 2007/2/EC;
- Ligji Nr 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike”, pjesërisht në linjë me Rregulloren 910/2014/EU;
- Korniza Kombëtare e Ndërveprimit 2014, plotësisht në linjë me Vendimin 2004/387/EC;
- Ligji Nr 120/2016 datë 24.11.2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, i cili ka transpozuar plotësisht direktivën 2014/61/EU, të Parlamentit Evropian;
- Ligji për të drejtën e Informimit;
- Ligji për Dokumentin Elektronik
- Ligji për të dhënat Shtetërore.

Legjislacioni zbatues përfshin aktet në vijim:

- Korniza Kombëtare e Ndërveprimit 2014, plotësisht në linjë me Vendimin 2004/387/EC;
- VKM Nr 1077 datë 23.12.2015 “Për krijimin ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet për krijimin e metadatave specifike për çdo temë”, plotësisht në linjë me Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 1205/2008;
- Udhëzues Nr 40/2, datë 20.09.2016 “Rregullat për Shërbimet e Rrjetit”, plotësisht në linjë me Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 976/2009, e ndryshuar.

II.2.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);
- Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

- Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI);
- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor (ASIG)
- Autoriteti Kombëtar për certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
- Autoriteti Audiovizual i Medias (AMA);
- Ministria e Brendshme;

II.2.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.2.3.1 Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.2.3.2 Masat ligjore të parashikuara

N/A

II.2.3.3 Masat të tjera të parashikuara

Nuk janë parashikuar masa të tjera.

II.3. Politikat audiovizuale

II.3.1. Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri i politikave në politikën audiovizuale përbëhet nga:

- Strategjia e kalimit në transmetimet numerike;
- Plani i Veprimtimit në zbatim të strategjisë për kalimin në transmetimet numerike, pjesë integrale e Strategjisë.

Akti legjislativ kryesor në fushën e politikës audiovizuale është Ligji Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar plotësisht në përputhje me Direktivën 2010/13/EC; Direktivën 2002/19/EC; Direktivën 2002/20/EC dhe pjesërisht në përputhje me Direktivën 2002/21/EC; Direktivën 2002/22/EC.

Legjislacioni zbatues përfshin aktet në vijim:

- Kodi i Transmetimit për median audiovizive, miratuar nga AMA me Vendimin Nr 228, datë 11.12.2017, plotësisht në linjë me Direktivën 2010/13/EU;

- Rregullore “Për transmetimin pa shpërblim të informacioneve, mesazheve dhe njoftimeve me interes të lartë për publikun e gjerë” miratuar nga AMA me Vendimin nr. 76 datë 04.04.2016, plotësisht në linjë me Direktivën 2010/13/EU;
- Rregullore “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar nga AMA me Vendimin nr. 99, datë 07.06.2017, plotësisht në përputhje me Direktivën 2010/13/EU dhe Direktivën 2002/21/EC;
- Rregullore “Për procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes”, miratuar me vendimin e AMA-s, Nr 181 datë 11.09.2017, plotësisht në përputhje me Direktivën 2010/13/EU;
- Rregullorja “Për komunikimet me natyre tregtare audio dhe/ose audiovizive. Llojet, kërkesat dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e tyre”, miratuar me vendimin e AMA-s, Nr 42 date 19.03.2018, plotësisht në përputhje me Direktivën 2010/13/EU;
- Rregullore “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre përmes procedurës *beauty contest*”, miratuar nga AMA me Vendimin Nr 28 datë 16.04.2015, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/21/EC;
- Rregullore “Mbi dhënien e licencave audio të komunitetit” miratuar nga AMA me Vendimin e Nr 55 datë 04.04.2016, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/21/EC;
- Rregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio” miratuar nga AMA me Vendimin Nr 153 datë 18.07.2016, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/21/EC;
- Rregullore “Rregullat për Mbartjen”, miratuar nga AMA me Vendimin nr. 4, datë 26.3.2014, plotësisht në përputhje me Direktivën 2002/22/EC.
- Rregullorja “Mbi kriteret e ofrimit të shërbimeve të mbrojtura”, miratuar nga AMA me Vendimin Nr 68 datë 20.04.2018, në linjë me Direktivën 98/84/EC.

II.3.2. Institucionet përgjegjëse

- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA);
- Kuvendi i Shqipërisë
- Radio Televizioni Shqiptar

II.3.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II. 3.3.1. Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II. 3.3.2. Masat ligjore të parashikuara

- Projekt-Rregullore “Për promovimin e prodhimit të veprave Evropiane nga shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive në bazë të kërkesës së përdoruesit”;
- Projekt-Rregullore “Për përcaktimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe dhe mënyrën e transmetimit të tyre;
- Projekt-Udhëzim “Mbi të drejtën për raporte të lajmeve të shkurtra”.
- Rishikimi i Kodit të Transmetimit (nuk është në plan veprimi), por ligji kërkon rishikim. Akti fillimisht është miratuar në janar 2014 dhe rishikuar në dhjetor 2017. Kjo masë ligjore propozohet rishtazi.

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit përgjegjës	1,468,400	1,253,100 Leke	924,000
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera	2,048,238	682,746 Leke	0
Buxheti total i kapitullit	3,516,638	1,935,846	924,000

Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e legjislacionit të Bashkimit Evropian

Kapitulli i bujqësisë përmban një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumë prej të cilave janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Zbatimi i duhur i këtyre rregullave dhe kontrolli efektiv nga një administratë publike efikase janë thelbësore për funksionimin e politikës së përbashkët bujqësore (PPB). Politika e PPB-së kërkon ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe cilësisë të tilla si agjencia e pagesave, sistemin e integruar dhe të kontrollit të pagesave (IACS), dhe kapacitetin për të zbatuar masat e zhvillimit rural. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat e mbështetjes direkte në fermë dhe për zbatimin e dispozitave për organizimin e përbashkët të tregut për produkte të ndryshme bujqësore.

Zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli i Politikave të Përbashkëta Bujqësore (CAP) kërkojnë krijimin, modifikimin dhe / ose përforcimin e strukturave të përshtatshme administrative. Në disa raste, acquis paraqet specifikime të hollësishme për strukturat e kërkuara administrative. Në shumë raste, acquis thjesht përdor terma të tilla si "autoriteti kompetent" për t'iu referuar strukturës administrative që është e nevojshme. Kjo do të thotë se i mbetet çdo Shtet Anëtar të vendosë se cili institucion është përgjegjës për zbatimin efektiv të acquis. Megjithatë, funksionet që Shtetet Anëtare të BE-së duhet të kryejnë përmes strukturave administrative që ato krijojnë janë të përcaktuara qartë në acquis.

Duke ndjekur reformën e Politikës së Përbashkët Bujqësore pjesët kryesore të acquis të BE-së janë:

- Rregullorja (BE) Nr 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 në mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural (EAFRD) dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1698/2005
- Rregullorja (BE) Nr 1306/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 dhjetor 2013.
- Rregullorja (BE) Nr 1307/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 dhjetor 2013 në vendosjen e rregullave për pagesat direkte për fermerët nën skemat e mbështetjes në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 637/2008 dhe Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 73/2009 mbi financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr 352/78, (KE) Nr 165/94, (KE) Nr 2799/98, (KE) Nr 814/2000, (KE) Nr 1290/2005 dhe (KE) Nr 485/2008
- Rregullorja (BE) Nr 1308/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 dhjetor 2013 në krijimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe që

shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr 922/72, (KEE) Nr 234/79, (KE) Nr 1037/2001 dhe (KE) Nr 1234/2007

I.1.2 Kërkesat e MSA-së

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me acquis e Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe sektorit agroindustrial midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është parashikuar në nenin 96 të MSA-së. Neni 96 përcakton se fokusi duhet të jetë në fushat prioritare që lidhen me acquis të Komunitetit në fushën e bujqësisë.

Bashkëpunimi do të synojë në mënyrë të veçantë modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit bujqësor dhe sektorit agroindustrial shqiptar dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit dhe praktikave shqiptare me rregullat dhe standardet e Komunitetit.

1.2 Situata aktuale / Përmbledhja

Pagesat direkte gjatë vitit 2018 kanë zënë një përqindje të lartë të fondeve totale të Ministrisë. Në ndryshim nga viti 2017, iu dha rëndësi rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore dhe kryesisht 15 produkteve, me potencialin më të lartë, duke mbështetur të gjithë zinxhirin e vlerës, nga prodhimi deri në shitje.

Pagesat direkte lidhen me:

- rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve:
 - mbjellje të reja të drufrutorëve dhe bimëve mjekësore;
 - ndërtimi i serrave për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit;
 - përmirësimi i teknologjive të kultivimit dhe inovacioneve;
 - rritje dhe përmirësim i kapacitete të grumbullimit, ruajtjes, seleksionimit, paketimit dhe përpunimit të prodhimit bujqësor dhe peshkimit;
 - certifikim dhe mbrojtje e prodhime bujqësore.
- Përmirësimin e zinxhirit ushqimor të produkteve:
 - për krerë të lindur të matrikulluar;
 - për enë të certifikuara për transportin e qumështit;
 - për ndërtim thertore, pika grumbullimi, ambiente për mbarështimin e kafshëve;
 - për dorëzimin e qumështit;
 - për mbarështimin e bletarisë.

- Për përmirësimin e menaxhimit të peshkimit;
- Për nxitjen e formalizimit dhe kooperimit të prodhuesve;
- Për diversifikimin e aktivitetit ekonomik në zonat rurale.

Sa i përket fushës së zhvillimit rural, përparim i mirë është shënuar në dhënien e besimit të IPARD II. Paketa e plotë e fitimit të besimit për zbatimin e buxhetit për programin IPARD II, 2014-2020 është dorëzuar për miratim në Komisionin Evropian më 20 shtator 2016 dhe pas disa konsultimeve dhe një misioni auditimi nga BE, Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (DG AGRI) në janar 2018 solli vlerësimin pozitiv se autoritet kompetente në Shqipëri kanë adresuar të gjitha çështjet për ta marrë këtë besim. Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nënshkroi Marrëveshjen e Financimit në mars 2018 dhe më datë 27.03.2018 kjo Marrëveshje u firmos nga Komisioni Evropian. Tre masat më të mëdha siç janë investimet në fermat bujqësore, përpunimi dhe diversifikimi i aktiviteteve bujqësore i është dhënë besimi në fillim të vitit 2018.

Me shkresën nga Dg-AGRI e datës 25 Tetor 2018 u hoqën kushtet e vendosura në nenin 7 të Marrëveshjes Financiare, për të filluar zbatimin e programit IPARD II.

Fushata e informimit për programin IPARD II u realizua nga datat 12 deri 27 Tetor 2018 dhe takimet u organizuan në 12 Qarqet e vëndit.

Në fushën e organizimit të tregut të përbashkët është miratuar legjislacioni zbatues për ligjin e ri për vajin e ullirit. Janë miratuar dy akte ligjore në sektorin e vajit të ullirit i cili pjesërisht harmonizon legjislacionin kombëtar përkatës me *acquis*.

Sa i përket bujqësisë organike, ligji për bujqësinë organike u miratua në tetor të vitit 2016. Ka pasur një rritje të subvencioneve sipas skemave direkte nga 600 euro për fermë të certifikuar në 2016 deri në 1 500 euro në vitin 2017. Dy operatorë organikë aplikuan në 2016, nga të cilët një ishte përfitues, ndërsa në vitin 2017, gjashtë (nga tetë) aplikues ishin përfitues. Kultivuesit e ullirit organik kanë përfituar edhe në mënyrë indirekte nga skema e mbështetjes për mbrojtjen e ullinjve nga miza e ullirit.

Sa i përket politikës së cilësisë, Ligji për Pronësinë Industriale u ndryshua në gusht të vitit 2017 dhe është pjesërisht në linjë me *acquis* e BE-së, duke përcaktuar dhe autoritet kompetent për vlerësimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore me specifikimet teknike. Është në proces miratimi në Këshillin e Ministrave ligji “Për skemat e Cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”.

I.3 Prioritetet

Sektori bujqësor dhe ai i agropërpunimit duhet të arrijnë një nivel më të lartë prodhueshmërie dhe konkurrueshmërie, si në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar, mbi bazën e përmirësimit të

kushteve për veprimin e iniciativës private, por dhe të një mbështetje zhvilluese më të plotë, në një mënyrë të qëndrueshme dhe që të garantohet nga institucione eficiente.

Prodhueshmëria dhe konkurrueshmëria më e lartë janë themelet e rritjes së prodhimit, të përmirësimit të daljes në treg për fermerët dhe biznesin agropërpunues, të rritjes së të ardhurave dhe të përmirësimit të nivelit të jetesës së fermerëve dhe familjeve të tyre.

Për periudhën afatshkurtër prioritetet më kryesore janë:

- Formalizimi i fermës dhe rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë dhe primare ushqimore, ndërsa progresive përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian;
- Rivendosjen, ruajtjen dhe rritjen e ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pylltaria;
- Zhvillimi i balancuar territorial i zonave rurale promovimit të përfshirjes sociale, reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e balancuar ekonomik në zonat rurale;
- Transferimi i njohurive dhe inovacionit në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale dhe ndihmë për zbatimin e politikave të zhvillimit rural;
- Qëndrueshmëri në të ardhurat e fermerëve - mbështetje direkte për fermerët dhe skema të tjera mbështetëse investimi;
- Përmirësimi i infrastrukturës rurale;
- Mbulimi i rreziqeve nënë bujqësi;
- Zhvillimi institucional, implementimi dhe zbatimi i kërkesave rregullative të BE-së;
- Përfundimi i reformës së shërbimit këshillimor (ekstensioni bujqësor) në bujqësi me qëllim përforcimin e rritjes së investimeve në bujqësi dhe agro-përpunim;
- Përfundimi i kuadrit ligjor, institucional dhe administrativ për produktet organike, dhe skemat e cilësisë.

II.1 Çështjet horizontale

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 709 datë 29.10.2014.

Ligji Nr 9426 datë 06.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, amenduar, tetor 2018 për “Reduktimin e barrierave administrative, liberalizimin e tregut, përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit”.

Ligji Nr 10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, amenduar, tetor 2018 për “Përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, përcaktimi i rregullave kritereve që duhet për laboratorin e akredituar dhe të miratuar, si dhe procedurave për marrjen e mostrave, përgatitjes dhe dërgimit të tyre në laboratorët përkatës”.

Ligji Nr 8691 datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave, amenduar nëntor 2018, për ndryshimin e emërtesave, për rregullat e prodhimit, manipulimit dhe tregtimit të duhanit, marrëdhëniet mes prodhuesit dhe grumbullues/përpunuesit, procedurat për markat e duhanit, si dhe sanksionet përkatëse.

Ligji Nr 8702, datë 01.12.2000 "Për sistemin dhe identifikimin e regjistrit të kafshëve" është miratuar. Ky ligj përafron në mënyrë të pjesshme Rregulloren e Bashkimit Evropian Nr. 1306/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 mbi financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit (KEE) Nr. 352/78, (KE) Nr. 165/94, (KE) Nr. 2799/98, (KE) Nr 814/2000, (KE) Nr. 1290/2005 dhe (KE) Nr. 485/2008

Ligji Nr 9817 datë 22.10.2017 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, është miratuar. Në zbatim të këtij ligji është miratuar dhe VKM Nr 709 datë 29.10.2014 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, e cila është amenduar me VKM Nr 21 datë 12.01.2018 “Për krijimin e programit të integruar të zhvillimit rural të 100 fshatrave Programi i integruar i 100 fshatrave ka për qëllim të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në zonat rurale të 100 fshatrave, nga qasja ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, veçmas nga ndërhyrjet e fragmentuara dhe qasjet strikte sektoriale që po ndodhin ose pritet të ndodhin në vend.

Ky program ka tre objektiva kryesore:

- Përmirësimin e infrastrukturës publike (mbështetje për infrastrukturën e rrugëve, rivitalizim i hapësirave publike, etj);
- Zhvillimi ekonomik përmes diversifikimit të aktiviteteve ekonomike (përmirësimi i turizmit potencial në zonat rurale, agro turizmi and turizmi rural, investime në prodhimin e produkteve tradicionale; mbështetje për inkubatorët e prodhimit të produkteve tradicionale);
- Zhvillimi i kapitalit social dhe human (mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve të punës dhe shoqërisë civile në zonat rurale, trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë).

Përfitues nga programi i 100 fshatrave janë popullsia rurale, fermerët dhe grupet e fermerëve, individët, në veçanti gratë dhe të rinjtë, personat juridik, bashkitë, organizatat jofitimprurëse, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, etj.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka planifikuar një buxhet për këtë qëllim (10% e buxhetit total të skemave kombëtare).

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (ARDA) është struktura e zbatimit të skemave kombëtare të mbështetjes në bujqësi dhe zhvillim rural. ARDA është pjesë e strukturave të menaxhimit dhe operimit që do t'i besohen detyrave të zbatimit të buxhetit nën programin IPARD II (2014-2020). Pas strukturimit në muajin nëntor të vitit 2017, ARDA ka 123 anëtarë të stafit.

II.1.3. Akte të planifikuara

II. 1.3.1. Politika Kuadër të Planifikuara 2019 – 2021

II. 1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Aktet ligjore si më poshtë janë në proces miratimi:

Ligji Nr 10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” për “Përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, përcaktimi i rregullave kritereve që duhet për laboratorin e akredituar dhe të miratuar, si dhe procedurave për marrjen e mostrave, përgatitjes dhe dërgimit të tyre në laboratorët përkatës”.

Ligji Nr 8691 datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave për ndryshimin e emërtesave, për rregullat e prodhimit, manipulimit dhe tregtimit të duhanit, marrëdhëniet mes prodhuesit dhe grumbullues/përpunuesit, procedurat për markat e duhanit, si dhe sanksionet përkatëse.

II.2 Organizimi i tregut të përbashkët

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 709 datë 29.10.2014.

Ligji Nr 87/2013 "Për kategorizimin e prodhimit, etiketimit dhe tregtimit të vajit të ullirit" është miratuar. Ligji përafron në mënyrë të pjesshme Rregulloren (BE) Nr 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 17 dhjetor 2013, për përcaktimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit (KEE) Nr 922/72, (KEE) Nr 234/79, (KE) Nr 1037/2001 dhe (KE) Nr 1234/2007.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

II.2.3. Akte të planifikuara

II.2.3.1. Politika Kuadër të Planifikuara 2019- 2021

II.2.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 - 2021

Ligji "Për vreshtarinë dhe verën". Ky ligj është parashikuar të miratohet brenda tremujorit të katërt të vitit 2019. Vendimi përafron pjesërisht rregulloren e Parlamentit Europian Nr 1308/2013 dhe të Këshillit, të datës 17 Dhjetor 2013 "Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve në prodhimet bujqësore".

VKM Për regjistrin e vreshtave, deklaratimet e detyrueshme dhe grumbullimin e informacionit për të monitoruar tregun e verës, dokumentet shoqëruese për ngarkesat e produkteve të verës dhe regjistrave që mbahen për sektorin e verës. Ky vendim është parashikuar të miratohet brenda tremujorit të katërt të vitit 2020. Vendimi përafron pjesërisht rregulloren e Parlamentit Evropian Nr. 1308/2013 dhe të Këshillit, të datës 17 Dhjetor 2013 "Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve në prodhimet bujqësore".

VKM Për përcaktimin e kategorive të produkteve në sektorin e verës, praktikave enologjike dhe kufizimeve të zbatueshme. Ky vendim është parashikuar të miratohet brenda tremujorit të katërt të vitit 2020. Vendimi përafron pjesërisht rregulloren Nr. 479/2008 "Për sa i përket regjistrin të vreshtave, deklaratave të detyrueshme dhe grumbullimit të informacionit për të monitoruar tregun e verës, dokumentet që shoqërojnë dërgesat e produkteve ushqimore dhe regjistrat e sektorit që duhet të mbahen".

II.3 Zhvillimi rural

II.3.1 Kuadri politik dhe ligjor

Çështjet e zhvillimit rural mbulohen nga Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 709 datë 29.10.2014. Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Konsolidimin e Tokës në Shqipëri u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 700 datë 12.10.2016.

Ligji Nr 9817 datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" është miratuar dhe përafron në mënyrë të pjesshme Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 718/2007 të datës 12 qershor 2007 për

zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1085/2006 për krijimin e një instrumenti për asistencën e para-anëtarësimit (IPA)

Ligji Nr 9840 datë 10.12.2007 "Mbi ratifikimin e marrëveshjes kornizë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e bashkëpunimit për ndihmën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit të Para-aderimit (IPA) është miratuar dhe përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 1085/2006 të datës 17 korrik 2006 për krijimin e një Instrumenti për Ndihmën Para Anëtarësimit (IPA)

II.3.2 Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është përgjegjëse për themelimin e Autoritetit Menaxhues (MA) dhe Agjencisë IPARD si një forum për zbatimin e Programit të Zhvillimit Rural IPA II (2014-2020). Janë ngritur të dyja strukturat, janë trajnuar dhe përgatitur për zbatimin e procedurave kryesore të zbatimit të IPARD.

Autoriteti Menaxhues (MA) është një strukturë e pavarur në MBZHR, e cila përgatit programimin, zgjedh masat, monitoron, vlerëson, raporton, koordinon dhe publikon Programin IPARD.

II.4 Prodhimi organik

II.4.1 Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 709 datë 29.10.2014.

Është miratuar Ligji Nr 106/2016 "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre", i cili përafron në mënyrë të pjesshme Rregulloren (KE) Nr 834/2007 të datës 28 qershor 2007 mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, dhe shfuqizon rregulloren (EEC) Nr 2092/91.

Është miratuar Urdhëri i Ministrit Nr 131 datë 28.03.2018 "Për listën e produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin biologjik", i cili përafron në mënyrë të pjesshme Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 889/2008 i 5 shtatorit 2008 i cili përcakton rregulla të hollësishme në zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 834/2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin.

Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 336 datë 06.06.2018 Për miratimin e rregullave të hollësishme, për prodhimin, kalimin, rregullat përjashtuese të prodhimit dhe kontrollin e prodhimit biologjik bimor e algave të detit”, i cili përaftron në mënyrë të pjesshme Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 889/2008 i 5 shtatorit 2008 i cili përcakton rregulla të hollësishme në zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 834/2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin.

II.4.2 Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Trupat e Kontrollit të miratuara nga Ministria e Bujqësisë kanë si funksion inspektimin dhe certifikimin e produkteve biologjike/organike.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryen kontrollin në treg të produkteve ushqimore që deklarohen organike, nëse ato janë të certifikuara nga një trup kontrolli e miratuar nga MBZGR.

II.4.3. Akte të planifikuara

II.4.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

II.4.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 - 2021

Vendimi i Këshillit të Ministrave ”Për miratimin e rregullave të hollësishme për etiketimin, mbledhjen, paketimin, transportin, ruajtjen dhe kontrollin e produkteve biologjike”. është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ky vendim do të përafrojë pjesërisht Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 889/2008 i 5 shtatorit 2008 i cili përcakton rregulla të hollësishme në zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 834/2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin.

Vendimi i Këshillit të Ministrave ”Për përbërjen, funksionimin, organizimin dhe detyrat e KPB-së” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ky vendim do të përafrojë pjesërisht Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 889/2008 e datës 5 shtator 2008 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 834/2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin.

Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ”Për miratimin e listës së produkteve dhe substancave të përdorura në përpunimin e ushqimeve biologjike” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020. Ky urdhër do të përafrojë në mënyrë të pjesshme

Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 889/2008 e datës 5 shtator 2008 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 834/2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin.

Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të hollësishme për prodhimin e ushqimeve për kafshë të përpunuara biologjike, ushqimeve biologjike të përpunuara dhe majave biologjike” është parashikuar të miratohet gjatë tre mujorit të katërt të vitit 2020. Ky vendim do të përafrojë pjesërisht Rregulloren e Komisionit European Nr 889/2008 datë 5 shtator 2008, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit European Nr 834/2007 “Për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin.”

Vendim i Këshillit të Ministrave, “Kriteret dhe procedurat e hollësishme të miratimit të trupave të kontrollit”, është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021. Ky vendim do të përafrojë pjesërisht rregulloren e Komisionit European Nr 889/2008, datë 5 shtator 2008, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit European Nr 834/2007 “Për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin.”

II.5 Politikat e cilësisë

II.5.1 Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 709 datë 29.10.2014.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 1705 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për regjistrimin e treguesve gjeografikë" është miratuar dhe përafron në mënyrë të pjesshme Rregulloren (BE) Nr 1151/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 21 nëntor 2012 mbi cilësinë skemat për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore.

Ligji Nr 17/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr 9947 datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale ", të ndryshuar", është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 16 shkurt 2017.

Ligji “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, është në proces miratimi.

II.5.2 Institucionet përgjegjëse

Institucioni përgjegjës për zhvillimin dhe miratimin e politikave në lidhje me skemat e cilësisë dhe standardet e marketingut në Shqipëri është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Struktura kryesore përgjegjëse për rregullimin e emërimit të origjinës dhe treguesve gjeografik në Shqipëri është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

II.5.3. Akte të planifikuara

II. 5.3.1. Politika Kuadër të Planifikuara 2019 – 2021

II. 5.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 - 2021

Ligji "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore" është parashikuar të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2019. Ky ligj do të përafrojë pjesërisht Rregulloren (BE) Nr 1151/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 21 nëntor 2012 mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore, pasi pjesa e tjetër e rregullores për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës është përafëruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për funksionimin, kohëzgjatjen, organizimin dhe detyrat e Komisionit për Skemat e Cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ky vendim është në zbatim të ligjit për skemat e cilësisë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e Logos Kombëtare për produktet STG (specialitet tradicional i garantuar)”, është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ky vendim është në zbatim të ligjit për skemat e cilësisë.

VKM Për emërtimet e origjinës dhe treguesve gjeografikë të mbrojtur, termave tradicionale, etiketimet dhe paraqitjes së informacionit për konsumatorin të disa produkteve të sektorit të verës. Ky vendim është parashikuar të miratohet brenda tremujorit të katërt të vitit 2021. Vendimi përafëron pjesërisht rregulloren Nr. 607/2009 "Për sa i përket që përcakton disa rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 479/2008 për sa i përket emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe treguesve gjeografikë, termave tradicionale, etiketimit dhe paraqitjes së disa produktet e sektorit të verës”.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

000/Lekë

	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull të si institucion kryesor	15960	13750	6550
Buxheti total për këtë kapitull nga institucionet e tjera kontribuuese	0	0	0
Buxheti total për kapitull	15960	13750	6550

Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitetit

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e legjislacionit të Bashkimit Evropian

Acquis për politikat e sigurisë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare pasqyron qasjen e integruar të BE-së në sigurinë ushqimore me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda Bashkimit Evropian nëpërmjet masave koherente dhe monitorimin, duke siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm. Parakushtet kryesore për një vend kandidat në këtë fushë janë transpozimi i legjislacionit të BE-së, si dhe zbatimi i tij nga një administratë e strukturuar mirë dhe e trajnuar. Acquis në këtë kapitull përbëhet nga një numër shumë i madh i rregulloreve, direktivave dhe vendimeve. Për zbatimin e legjislacionit të sigurisë ushqimore, çdo Shtet Anëtar duhet të ketë struktura adekuate administrative për të kryer kontrollet dhe kontrollin e produkteve ushqimore duke përfshirë një kapacitet të përshtatshëm laboratorik. Rregullat themelore përcaktohen nga Rregullorja e Përgjithshme e Ushqimit të kafshëve dhe ushqimit për njerëzit (KE) Nr 178/2002 që siguron parimet dhe kërkesat e përgjithshme të prodhimit, përpunimit, paketimit, etiketimit, marketingut dhe shpërndarjes së ushqimit. Në veçanti, ajo përcakton përkufizimet, parimet dhe detyrimet që mbulojnë të gjitha fazat e prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit. Përmeshja e kërkesave të gjurmueshmërisë për të gjithë ushqimin dhe ushqimin e kafshëve, si dhe operatorët e lidhur me të, janë të detyrueshëm. Për më tepër, legjislacioni për sigurinë ushqimore mbulon paketimin, etiketimin, marketingun, aditivët, tretësit e nxjerrjes, aromatizuesit, materialet e kontaktit ushqimor, shtesat ushqimore, ujërat minerale dhe rrezatimet jonizuese, ndotësit, ushqimet e reja, ushqimet e ngrira të shpejta, cilësinë e farërave dhe materialit shumues, produktet, organizmat e dëmshëm, të drejtat e varieteteve të bimëve, si dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Në fushën e politikës veterinarë dhe fitosanitare, legjislacioni i BE-së përcakton rregullat për tregtinë e brendshme dhe futjen e kafshëve të gjalla dhe produkteve nga vendet e treta në sektorët veterinar, shëndetin e bimëve dhe ushqimin e kafshëve duke mbrojtur shëndetin publik, shëndetin e bimëve dhe kafshëve dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe sigurinë e ushqimit me origjinë shtazore në tregun e brendshëm.

Regjimi i BE bazohet në zbatimin e të njëjtave rregulla nga ana e autoriteteve në Shtetet Anëtare. Kontrollet e veterinarisë dhe shëndetit të bimëve në kufijtë e brendshëm janë shfuqizuar. Një regjim i përbashkët i kontrolleve në kufijtë e jashtëm zbatohet. Një pjesë thelbësore e acquis në këtë fushë mbulon aspektet e higjienës në lidhje me përpunimin dhe vendosjen në treg të ushqimit me origjinë shtazore, kontrollin e sëmundjeve të kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve.

Legjislacioni i BE-së për sigurinë ushqimore bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Këto parime përfshijnë parimin parandalues i cili kërkohet për të siguruar mbrojtjen e shëndetit në Komunitet dhe parimin e transparencës për të siguruar që konsumatorët, palët e tjera dhe partnerët tregtarë të kenë besim në proceset e vendim-marrjes të destinuara për forcimin legjislationit të ushqimit, bazën e saj shkencore dhe strukturat dhe pavarësinë e institucioneve që mbrojnë shëndetin dhe interesat e tjera. Duhet të sigurohet një nivel i lartë mbrojtjeje i jetës dhe shëndetit të njerëzve, në zbatim të politikave të Bashkimit, të cilat implementohen në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit në përputhje me parimin nga ferma tek piruni/ nga stalla tek tavolina. Kërkesat e sigurisë ushqimore janë të rregulluara në tërësi në legjislationin dytësor të Bashkimit Evropian.

Ky kapitull përfshin rregullat e detajuara në fushën e veterinarisë, të cilat janë thelbësore për ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, sigurinë e ushqimeve me origjinë shtazore në tregun e brendshëm. Në fushën e fitosanitetit, rregullat e Bashkimit Evropian përfshijnë çështjet e cilësisë së farërave, të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, bimëve dhe kafshëve, të sigurojë një funksionim efektiv të tregut të brendshëm nëpërmjet praktikave të drejta në tregtinë e produkteve të mbrojtjes së bimëve, duke marrë në konsideratë, në çdo rast edhe mbrojtjen e mjedisit si dhe materialet e mbrojtjes së bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve.

I.1.2 Kërkesat e MSA-së

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislationin e saj kombëtar me acquis të BE-së.

Bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe sektorit agroindustrial midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është parashikuar në nenin 96 të MSA-së. Neni 96 përcakton se fokusi duhet të jetë në fushat prioritare që lidhen me acquis të Komunitetit në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi do të synojë në mënyrë të veçantë modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit bujqësor dhe sektorit agroindustrial shqiptar dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislationit dhe praktikave shqiptare me rregullat dhe standardet e Komunitetit.

I.2 Situata aktuale / Përmbledhja

Shqipëria ka arritur njëfarë niveli përgatitje në politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitetit. Ky progres është vënë re dhe në zbatimin e politikave relevante në sektorët e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë.

Në fushën e sigurisë ushqimore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer kontrollet zyrtare nën planin me bazë risku të miratuar në fillim të vitit 2017. Gjithashtu, gjatë vitit 2017, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka filluar të përdorë sistemin TRACE me qëllim lëshimin e certifikatave të eksportit veterinarë për produktet e kafshëve (peshk dhe vezë).

Referuar politikave veterinare, ka vijuar fushata e vaksinimit në masë kundër tërbimit të dhelprave të kuqe, brucelozës në kafshët e remontit në bagëtitë e imëta, dermatozës nodulare të gjedhit dhe antraksit në zonat e infektuara, gjurmimit të brucelozës dhe tuberkulozit në fermat e gjedhit me 10 krerë e lart. Janë bërë përpjekje pozitive për të përditësuar informacionin në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve.

Në lidhje me hedhjen në treg të ushqimit, ushqimit të kafshëve dhe nën-produkteve shtazore, programet vjetore të monitorimit të mbetjeve për substanca të padëshiruara, kanë mbuluar mbetjet e pesticideve në 10 produkte bimore. Është miratuar paketa ligjore e higjienës ushqimore duke përfshirë edhe kriteret mikrobike në produktet ushqimore dhe kontrollin e *Trichinella* në mish.

Në fushën e rregullave të sigurisë ushqimore, kanë vazhduar përgatitjet e legjislacionit dytësor në disa fusha si: kriteret mikrobiologjike në ushqim, tricinelat në mish, materialet plastike që vijnë nga kontakti me ushqimin, niveli maksimal i mbetjeve të pesticideve në disa produkte dhe kufijtë maksimal të mbetjeve për substance aktive farmaceutike në ushqimet me origjinë shtazore.

Janë regjistruar përmirësime në metodologjinë e monitorimit mikrobiologjik të qumështit të papërpunuar të bazuar në mostrat e çdo përpunimi të qumështit ose në fabrikat e qumështit me kapacitet më shumë se 1 ton në ditë. Mostrat janë analizuar për përmbajtjen e mikroflorës së përgjithshme dhe qelizave somatike nga ku një mesatare gjeometrike gjenerohet çdo 3 muaj. Kjo qasje siguron një pasqyrë më të qartë të situatës në lidhje me qumështin e papërpunuar.

Në zbatim të Ligjit Nr 10 433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kontrollet dhe inspektimet sanitaro-veterinare kryhen në ferma, njësitë e mbajtjes së kafshëve të gjalla, tregjet dhe panairët e kafshëve, regjistrimin dhe identifikimin e kafshëve, transportin dhe lëvizjen e tyre, masat veterinare profilaktike, mbrojtjen e mjedisit, kushtet e mbarështimit, trajtimin e kafshëve (mirëqenia) dhe kontrollin dhe shitjen e Produkteve Mjekësore Veterinare si dhe monitorimin e mbetjeve në kafshë të gjalla dhe produktet me origjinë shtazore.

I.3 Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra në fushën e sigurisë ushqimore përfshijnë:

- Forcimin e sistemit të sigurisë ushqimore dhe të sistemeve të kontrollit të ngjashme.

- Përforcimi i kapaciteteve laboratorike në fushën e sigurisë ushqimore.

Prioritetet në fushën e veterinarisë përfshijnë:

- Plotësimi i kuadrit ligjor mbi kontrollin e sëmundjeve në kafshë, higjienën e mirëqenien e kafshëve, kontrollet veterinare në përputhje me aktet normative të BE-së dhe zbatimi i plotë i tyre;
- Përcaktim i qartë i përgjegjësi të institucioneve të përfshira në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit për të siguruar të ruajtjen e shëndetit të kafshëve dhe sigurinë ushqimore të produkteve me origjinë shtazore;
- Rritja e përmirësimeve të ndjeshme në lidhje me kushtet sanitaro-veterinare në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian;
- Funksionim i plotë i sistemit të identifikimit për kafshët gjedhe e të imta, regjistrimin dhe kontrollin e plotë të lëvizjeve të kafshëve; vendosja e sistemit të identifikimit në derra;
- Kontroll i plotë i situatës epizootike, veçanërisht lidhur me sëmundjet zoonotike; një sistem të mirë informacioni mbi kafshët;
- Staf i trajnuar në fushën e kontrollit të sëmundjeve në kafshë, të kontrollit të stabilimenteve dhe legjislacioni.

Në fushën e farave dhe materialeve fidanorë, prioritet është përmirësimi i standardeve të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për të rritur sasinë dhe cilësinë e prodhimit bujqësor. Organizimi dhe funksionimi strukturave të mbrojtjes së bimëve, përbërja e këtyre strukturave si dhe detyrat specifike të tyre është një ndër prioritetet e forcimit të shërbimit të mbrojtjes së bimëve.

Lidhur me rregullat specifike të ushqimit të kafshëve, prioritet është hartimi i legjislacionit në këtë fushë.

Në lidhje me fushën e organizmave të modifikuara gjenetikisht, mbetet një prioritet kryesor hartimi i legjislacionit dhe caktimi i strukturës e cila mbulon këtë fushë.

II.1 Siguria ushqimore

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Çështjet e Sigurisë Ushqimore mbulohen nga Strategjia Ndërsektorale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Kjo Strategji është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 709, datë 29.10.2014.

Ligji Nr 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, është përafruar në mënyrë të pjesshme me aktet e mëposhtme:

- Rregullorja Nr 178 / 2002 / KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 28 janar 2002 që përcakton parimet dhe kërkesat e përgjithshme të ligjit të ushqimit, krijimin e Autoritetit Evropian të Sigurisë Ushqimore dhe përcaktimin e procedurave në çështjet e sigurisë ushqimore;
- Rregullorja (KE) Nr 882/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi kontrollet zyrtare të kryera për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me ligjin për ushqim dhe ushqim, rregullat e shëndetit të kafshëve dhe mirëqenies së kafshëve.
- VKM Nr 760 datë 16.09.2015 “Mbi kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, përgjatë zinxhirit ushqimor”, adopton plotësisht kërkesat kryesore të Udhëzimit “Mbi zbatimin e neneve 11, 12, 14, 17, 18, 19, dhe 20 të Rregullores (EC) nr. 178/2002 “Mbi ligjin kuadër të ushqimit”, të Komitetit të Përhershëm mbi Zinxhirin Ushqimor dhe Shëndetin e Kafshëve, të Komisionit Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Shëndetit dhe Konsumatorit, të datës 26 janar 2010.
- VKM Nr 434 datë 11.07.2018 "Mbi etiketimin e ushqimit dhe informimin e konsumatorit", i përafuar pjesërisht me Rregulloren (EU) nr. 1169/2011 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian të 25 October 2011 mbi ofrimin e informacionit ushqimor për konsumatorët që amendon Rregulloren (EC) Nr. 1924/2006 dhe (EC) Nr 1925/2006 shfuqizon Direktivën e Komisionit 87/250/EEC, Direktivën e Këshillit 90/496/EEC, Direktivën e Komisionit 1999/10/EC, Direktivën 2000/13/EC të këshillit dhe parlamentit evropian, Direktivën e Komisionit 2002/67/EC dhe 2008/5/EC dhe Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 608/2004

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

Institucioni lider është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MARD).

MARD është përgjegjëse për formulimin e politikave, legjislacionit dhe strategjive për kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim integrimin e kontrollit të ushqimit si një funksion kyç në mbrojtjen e shëndetit dhe interesave të konsumatorit, duke siguruar konkurrencë të ndershme në tregun kombëtar dhe futjen e ushqimit produkteve në tregun ndërkombëtar.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si një institucion nën MARD, i cili siguron një nivel të lartë të mbrojtjes së qytetarëve dhe garanton sigurinë e produkteve ushqimore në vendin tonë. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është autoriteti kompetent për menaxhimin e funksioneve të inspektimit në nivel kombëtar në fushën e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e bimëve dhe shëndetin e kafshëve.

II.1.3 Akte të planifikuara

Aktet nënligjore të miratuara për vitin 2018

VKM Nr 434 date 11.07.2018 "Mbi etiketimin e ushqimit dhe informimin e konsumatorit", i përafuar pjesërisht me Rregulloren (EU) nr. 1169/2011 të këshillit dhe parlamentit evropian të 25 October 2011 mbi ofrimin e informacionit ushqimor për konsumatorët që amendon Rregulloren (EC) Nr. 1924/2006 dhe (EC) Nr 1925/2006 shfuqizon Direktivën e Komisionit 87/250/EEC, Direktivën e Këshillit 90/496/EEC, Direktivën e Komisionit 1999/10/EC, Direktivën 2000/13/EC të këshillit dhe parlamentit evropian, Direktivën e Komisionit 2002/67/EC dhe 2008/5/EC dhe Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 608/2004.

Urdhër Nr 13 datë 31/05/2018 i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, "Mbi përcaktimin e metodave të kampionimit dhe analizës për kontrollin e niveleve të dioksinave, PCB-ve të ngjashme me dioksinat dhe PCB-ve jo të ngjashme me dioksinat në disa ushqime", që përafuron pjesërisht Rregulloren e Komisionit (EU) 2017/644 të 5 prillit 2017 mbi përcaktimin e metodave të kampionimit dhe analizës për kontrollin e niveleve të dioksinave, PCB-ve të ngjashme me dioksinat dhe PCB-ve jo të ngjashme me dioksinat në disa ushqime.

Udhëzim Nr 15 datë 10.10.2018, i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, "Mbi përdorimin e ujit të ngrohtë të ricikluar për të larguar kontaminimin mikrobiologjik sipërfaqësor nga karkasat", që përafuron plotësisht Rregulloren e Komisionit Nr 2015/1474/EC në lidhje me përdorimin e ujit të nxehtë të ricikluar për të hequr kontaminimin sipërfaqësor mikrobiologjik nga karkasat.

II.1.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021:

Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për ushqimin e destinuar për foshnje dhe fëmijë të vegjël, ushqim për qëllime mjekësore të veçanta dhe zëvendësim total i dietës për kontrollin e peshës", është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020. Udhëzimi do të përafrojë në mënyrë të pjesshme Rregulloren (BE) Nr. 609/2013 Parlamenti Evropian dhe Këshilli i 12 qershorit 2013 mbi ushqimin e destinuar për foshnje dhe fëmijë të vegjël, ushqim për qëllime të posaçme mjekësore dhe zëvendësim i përgjithshëm i dietave për kontrollin e shpejtë dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 92/52/KEE, Direktivat e Komisionit 96/8/KE, Direktiva 2009/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit dhe Rregulloret e Komisionit (KE) Nr 41/2009 dhe (KE) Nr 953 / 2009.

Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Mbi lëngjet të frutave dhe produkteve të caktuara të ngjashme të destinuara për konsum njerëzor" është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020. Ky udhëzim do të përafrojë pjesërisht Direktivën e Këshillit 2001/112/KE të 20 Dhjetor 2001 lidhur me lëngjet e frutave dhe disa produkte të ngjashme të destinuara për konsum njerëzor.

VKM për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e pulpës së frutit të thatë Baobab si një përbërës i ri ushqimor”, është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 dhe përafron pjesërisht Vendimin e Komisionit 2008/575/EC të 27 qershorit 2008 mbi autorizimin dhe vendosjen në treg të pulpës së frutit të thatë Baobab si një përbërës i ri ushqimor, sipas Rregullores (EC) Nr. 258/97 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit

Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në lidhje me “Rregullat për etiketimin e mishit të gjedhit dhe produkteve të tij”, që përafron pjesërisht Rregulloren 1825/2000/KE në lidhje me rregullat për etiketimin e mishit të gjedhit dhe produkteve të tij është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019.

Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Për miratimin e Aditivëve në produktet ushqimore”. Përafron pjesërisht Rregulloren (EC) Nr 1333/2008 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020.

Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Që përcakton masat zbatuese për produkte të caktuara për organizimin e kontrolleve zyrtare”. Përafron pjesërisht Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 2074/2005 e datës 5 dhjetor 2005 që përcakton masat zbatuese për produkte të caktuara sipas Rregullores (KE) Nr 853/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe për organizimin e kontrolleve zyrtare sipas Rregullores (KE) Nr. 884/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregullorja (EC) Nr. 882/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, duke shfuqizuar Rregulloren (EC) Nr 852/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe duke amenduar rregulloret (KE) Nr 853/2004 dhe (KE) Nr 854/2004 është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020.

Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Mbi kushtet dhe procedurat për dhënien e autorizimit për nxjerrjen në treg të ushqimeve të reja”. Përafron pjesërisht Rregulloren (EU) 2015/2283 e parlamentit dhe këshillit evropiane të 25 nëntorit 2015 mbi ushqimet e reja, e cila amendon Rregulloren (EU) Nr 1169/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizon Rregulloren (EC) Nr 258/97 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 1852/2001 është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021.

Ligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar. Përafron pjesërisht Rregulloren 178/2002/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 28 janar 2002 mbi parimet e përgjithshme dhe kërkesat e ligjit të ushqimit, krijimi i Autoritetit Evropian të Sigurisë Ushqimore dhe nxjerrja e procedurave të çështjet e sigurisë ushqimore dhe Rregulloren 882/2004/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 29 prill 2004 mbi kontrollin zyrtar të kryer për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me ligjin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, shëndetin e kafshëve dhe rregullat për mirëqenien e kafshëve, është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019.

II.2 Politikat e veterinarisë

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Çështjet në fushën e veterinarisë mbulohen nga Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 709, datë 29.10.2014.

Në fushën e veterinarisë, është miratuar Ligji Nr 10465 datë 29.09.2011, "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së¹⁵.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

¹⁵ Direktivë e Këshillit 82/894/EEC, 21 dhjetor 1982, mbi njoftimin e sëmundjeve të kafshëve brenda komunitetit; Direktivë e Këshillit 86/609/EEC, 24 nëntor 1986, mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të vendeve anëtare në lidhje me mbrojtjen e kafshëve që përdoren për eksperimente ose qëllime të tjera shkencore; Direktivë e Këshillit 90/425/EEC, 26 qershor 1990, mbi kontrollet veterinare dhe zooteknike të zbatueshme në tregtinë brenda- komunitare për disa kafshë të gjalla dhe produkte me synim për plotësimin e tregut të brendshëm; Direktivë e Këshillit 91/496/EEC, 15 korrik 1991, që skicon parimet që drejtojnë organizimin e kontrolleve veterinare mbi kafshët që hyjnë në Komunitet nga vendet e treta dhe që ndryshon direktivat 89/662/EEC, 90/425/EEC dhe 90/675/EEC; Direktivë e Këshillit 92/119/EEC e 17 dhjetor 1992 që paraqet masat e përgjithshme komunitare për kontrollin e disa sëmundjeve të kafshëve dhe masat e veçanta në lidhje me sëmundjen vezikulare të derrit; Direktivë e Këshillit 93/119/EEC, 22 dhjetor 1993, mbi mbrojtjen e kafshëve në kohën e therjes ose eliminimit; Direktivë e Këshillit 96/23/EEC, 29 prill 1996, mbi masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe produktet e kafshëve dhe që shfuqizon direktivat 85/358/EEC dhe 86/469/EEC si dhe vendimet 89/187/EEC dhe 91/664/EEC; Direktivë e Këshillit 97/78/EC, 18 dhjetor 1997, që skicon parimet që drejtojnë organizimin e kontrolleve veterinare mbi produktet që hyjnë në Komunitet nga vendet e treta; Direktivë e Këshillit 98/58/EC, 20 korrik 1998, në lidhje me mbrojtjen e kafshëve që mbahen për qëllime mbarështimi; Direktivë e Parlamentit Europian dhe e Këshillit 2002/32/EC, 6 nëntor 2001, mbi kodin komunitar në lidhje me produktet mjekësore veterinare; Direktivë e Këshillit 2002/99/EC, që skicon rregullat e shëndetit të kafshëve që drejtojnë prodhimin, përpunimin, shpërndarjen dhe hyrjen e produkteve me origjinë shtazore për konsum njerëzor; Direktivë e Parlamentit Europian dhe e Këshillit 2003/99/EC, 17 nëntor 2003, mbi monitorimin e zoonozave dhe agjentëve zoonotike, që ndryshon Vendimin e Këshillit 90/424/EEC dhe shfuqizon direktivën e këshillit 92/117/EEC; Direktivë e Këshillit 2006/88/EC, 24 tetor 2006, mbi kërkesat shëndetësore të kafshëve të akuakulturës dhe produkteve të tyre dhe mbi parandalimin dhe kontrollin e disa sëmundjeve në kafshët e ujë; Rregullore EC Nr. 999/2001 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, 22 maj 2001, që skicon rregullat për parandalimin, kontrollin, dhe çrënjosjen e disa encefalopative sfungjerore të transmetueshme; Rregullore EC Nr. 178/2002 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, 28 janar 2002, që skicon parimet dhe kërkesat kryesore të ligjit të ushqimit, krijon Autoritetin Europian të Sigurisë Ushqimore dhe përcakton procedurat për çështjet e sigurisë ushqimore; Rregullore EC Nr. 1774/2002 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, 3 tetor 2002, që përcakton rregullat në lidhje me nën-produktet shtazore jo për konsum njerëzor; Rregullore EC Nr. 1831/2003 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, 22 shtator 2003, mbi aditivët për përdorim në të ushqyerin e kafshëve,

Institucioni lider është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MARD) e cila harton dhe zbaton politikat në fushën e veterinarisë.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është në varësi të Ministrisë të Bujqësisë, dhe Zhvillimit Rural dhe është përgjegjës për kryerjen e analizave në zbatim të strategjive të gjurmimit dhe luftimit të sëmundjeve infektive, parazitare në kafshët e tokës, të ujit dhe shpendëve.

Instituti kryen diagnozat veterinarë dhe testimin e profilaksisë së shëndetit të kafshëve në përputhje me programin kombëtar. Ai kryen programe testuese për kontrollin e sëmundjeve epizootike, ilaçeve veterinarë dhe diagnozat e sëmundjeve të përgjithshme, është përgjegjës për zbatimin e programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve, ujërave e molusqeve bivalve. Ai është përgjegjës gjithashtu për kryerjen e testeve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik. ISUV bashkëpunon me FAO, WHO, OIE dhe laboratorë të tjerë reference për konfirmimin e sëmundjeve të ndryshme infektive.

II.2.3 Akte të planifikuara

II.2.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

II.2.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

1. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve që rregullojnë tregtinë në vend dhe të importit nga vendet e treta të embrioneve të kafshëve shtëpiake të llojit të gjedhit” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Ky urdhër do të transpozohet pjesërisht Direktivën e Këshillit 89/556 /KEE të datës 25 Shtator 1989.
2. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Për përcaktimin e kriterëve për planet kombëtare për të përshpejtuar çrrënjosjen e brucelozës, tuberkulozit dhe leukozës në gjedhë” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019. Ky urdhër do të transpozohet pjesërisht Direktivën 78/52/KEE të 13 dhjetorit 1977, kriteret e Komunitetit për çrrënjosjen e përshpejtuar të brucelozës, tuberkulozit dhe leukozës enzootike në bagëti.
3. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve që rregullojnë lëvizjen dhe importin e njëthundrakëve nga vendet e treta” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ky urdhër do të transpozohet pjesërisht Direktivën e Këshillit 2009/156/KEE të datës 30 nëntor 2009.

4. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit rural “Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve për importet e zogjve të caktuar dhe kushtet e karantinës së tyre” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të 2019. Ky urdhër do të transpozojë pjesërisht Rregulloren Implementuese të Komisionit (BE) Nr 139/2013, datë 7 janar 2013 që përcakton kushtet e shëndetit të kafshëve për importet e zogjve të caktuar në Bashkim dhe kushtet e karantinës.
5. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për mbrojtjen e kafshëve të përdorura për qëllime shkencore" është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020. Ky urdhër do të përafrojë pjesërisht Direktivën 2010/63/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 22 shtator 2010 për mbrojtjen e kafshëve të përdorura për qëllime shkencore.
6. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Për përcaktimin e kushteve për përgatitjen, vendosjen në treg dhe përdorimin të ushqimeve të medikuara për kafshë” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020. Ky urdhër do të transpozojë pjesërisht Direktivën e Këshillit 90/167/EEC të 26 Marsit 1990
7. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Mbi listën e produkteve mjekësore veterinarë që janë substanca thelbësore për trajtimin e njëthundrakëve” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020. Ky urdhër do të transpozojë pjesërisht Rregulloren (EC) Nr 1950/2006 dhe Rregulloren (EU) Nr 122/2013
8. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Mbi aditivët për përdorim në ushqimin e kafshëve” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021. Ky urdhër do të transpozojë pjesërisht Rregulloren (EC) Nr 1831/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 22 Shtator 2003.
9. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Mbi përcaktimin e vendeve, territoreve, zonave apo pjesëve të tyre nga të cilat Republika e Shqipërisë mund të importojë dhe tranzitojë shpendë dhe produkte shpendësh dhe kërkesat e certifikimit veterinar” është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021. Ky urdhër do të transpozojë pjesërisht Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 798/2008 të datës 8 Gusht 2008.

II.3.1 Kuadri politik dhe ligjor

Çështjet fitosanitare mbulohen nga Strategjia Ndërsektorale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Strategjia është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 709 datë 29.10.2014.

Ligji Nr 105/2016 për "Mbrojtjen e Bimëve", u miratua nga Parlamenti më datë 14.10.2016.

II.3.2 Institucionet përgjegjëse

Strukturat kryesore administrative përgjegjëse për politikën fitosanitare si dhe kontrollin zyrtar përcaktohen në bazë të dispozitave të Ligjit Nr 105/2016 për "Mbrojtjen e Bimëve"

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është institucioni që zbaton politikën fitosanitare.

II.3.3 Akte të planifikuara

II.3.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

II.3.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 –2021

Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave fitosanitare të karantinës" është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë 2020. Vendimi do të përafrojë pjesërisht Direktivën e Këshillit 2000/29 / KE të datës 8 maj 2000 mbi masat mbrojtëse kundër futjes në Komunitetin e organizmave të dëmshëm për bimët ose produktet bimore dhe kundër përhapjes së tyre brenda Komunitetit. Vendimi synon të sigurojë shëndetin e bimëve dhe produkteve bimore nga parazitët.

Udhëzim mbi Rregullat për njohjen e zonave të pastra është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020. Udhëzimi do të përafrojë në mënyrë të pjesshme Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 690/2008 të datës 4 korrik 2008 për njohjen e zonave të mbrojtura të ekspozuara ndaj rreziqeve të veçanta të shëndetit të bimëve në Komunitet.

Udhëzim mbi Rregullat për lëvizjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera brenda dhe ndërmjet zonave të pastra është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të 2020, e cila është një dokument i lëshuar nga prodhuesi i autorizuar. SPMB verifikon plotësimin e kushteve dhe kriterëve për lëshimin e pasaportës bimore nga prodhuesit e autorizuar.

II.4 Mbarështimi zooteknik / blegtori

II.4.1 Kuadri politik dhe ligjor

Çështjet zooteknike mbulohen nga Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 709 datë 29.10.2014.

Është miratuar Ligji Nr 9426 datë 6 tetor 2005 "Për blegtorinë". Ligji përafuron pjesërisht Direktivën 2009/157/KEE të datës 30 nëntor 2009 për kafshët riprodhuese të llojit të gjedhit të pastër.

II.4.2 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është institucioni që zbaton politikën e mbarështimit të blegtorisë.

II.4.3 Aktet e planifikuara

II.4.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

II.4.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 - 2021

Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për kushtet e shëndetit të kafshëve që rregullojnë lëvizjen dhe importimin nga vendet e treta të hekurave" është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ky urdhër do të përafrojë pjesërisht Direktivën e Këshillit 2009/156/KE të 30 nëntorit 2009 për shëndetin e kafshëve kushtet që rregullojnë lëvizjen dhe importimin nga vendet e treta të hekurave.

Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për sa i përket produkteve medicinale veterinare, një listë e substancave esenciale për trajtimin e ekuadrave" është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të 2020. Do të përafrojë pjesërisht Rregulloren (KE) Nr. 1950/2006 të datës 13 dhjetor 2006, në përputhje me Direktivën 2001/82 / KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi Kodin e Komunitetit në lidhje me produktet medicinale veterinare, një listë të substancave esenciale për trajtimin e hekurave dhe rregulloren (EU) Nr. 122/2013 e datës 12 shkurt 2013 që ndryshon Rregulloren (EC) Nr 1950/2006, që përcakton, në përputhje me Direktivën 2001/82 / KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi Kodin e Komunitetit në lidhje me produktet medicinale veterinare, listën e substancave thelbësore për trajtimin e ekuakëve.

II.5 Cilësia e farës dhe materiali shumëzues

II.5.1 Kuadri politik dhe ligjor

Çështjet e Cilësisë së farës dhe materialit shumëzues mbulohen nga Strategjia Ndërsektorale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 709 datë 29.10.2014.

Legjislacioni shqiptar për farërat dhe materialet shumëzuese përfshin:

- Ligji Nr 10416, datë 7 Prill 2011, "Për mbjelljen dhe materialin për përhapjen e bimëve", i ndryshuar, i cili përafron pjesërisht Direktivën 66/401/KEE; Direktiva 66/402/KEE; Direktiva 2002/54/KE; Direktiva 2002/55/KE; Direktiva 2002/53/KE; Direktiva 2002/56/KE; Direktiva 68/193/KEE; Direktiva 2008/72/KEE; Direktiva 92/90/KEE; dhe Direktiva 98/56/KE;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 86 datë 30.01.2013 "Për përcaktimin e kërkesave për marketingun, certifikimin dhe varietetet e testimit të farave të drithërave", i cili përafron pjesërisht Direktivën 66/402/KEE;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 87 datë 30.01.2013 "Për përcaktimin e kërkesave për marketingun, certifikimin dhe testimin e farave të bimëve foragjere, i cili përafron pjesërisht Direktivën 66/401/KEE;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 409 datë 8.05.2013 për përcaktimin e kërkesave për marketingun dhe certifikimin e materialit për përhapjen vegjetative të hardhisë, i cili përafron pjesërisht Direktivën 2005/43/KE dhe Direktivën 68/193/KEE;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 332 datë 18 prill 2013, për përcaktimin e kërkesave për marketingun dhe certifikimin e farave të perimeve, pjesërisht duke e miratuar Direktivën 2002/55/KE;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 530 datë 13 qershor 2013, për përcaktimin e kërkesave për marketingun dhe certifikimin e mbjelljeve dhe materialeve riprodhuese të perimeve, përveç farërave, i cili përafron pjesërisht Direktivën 2008/72/KE.

II.5.2 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është institucioni që zbaton politikën e cilësisë së farës dhe materialit shumëzues

II.5.3 Aktet e planifikuara

II.5.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

II.5.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 - 2021

Amendimi i Ligjit Nr 10416 datë 7.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" i cili përafron pjesërisht, 66/401 - 14 qershor 1966 Për marketingun e farës së bimëve; 66/402 - 14 qershor 1966 "Për marketingun e farës së drithërave; 2002/53 - 13 qershor 2001 "Mbi katalogun e përbashkët të varieteteve të bimëve bujqësore"; 2002/56, "Për marketingun e farës së patatet";

68/193 – “Mbi marketingun e përhapjes së materialit vegjetativ të verës”; 2008/72 – “Mbi marketingun e përhapjes së perimeve dhe materialit mbjellës përveç farërave”; 92/90 - 15 Janarit “Përcaktimi i taksës së importit për drithërat, për miellin ose miellin nga thekra, drithë, bollgur”; 98/56 – “Mbi marketingun e përhapjes së materialeve për bimët dekorative”, është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2019.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

000/lekë

	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull si institucion kryesor	14939	13371	2764
Buxheti total për këtë kapitull nga institucionet e tjera kontribuuese	0	0	0
Buxheti total për kapitull	14939	13371	2764

Kapitulli 13: Peshkimi

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e legjislacionit të Bashkimit Evropian

Acquis për peshkimin përbëhet nga rregulloret, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, kjo kërkon futjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për zbatimin e Politikës së Përbashkët të Peshkimit. Qëllimi, objektivat dhe parimet e PPP janë të përcaktuara në rregulloren kuadër mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Këshillit (BE) Nr 1380/2013). PPP ofron rregulla për ruajtjen e burimeve ujore të gjalla, kufizimin e ndikimit mjedisor të peshkimit dhe kushtet e qasjes në ujërat dhe burimet. Ai gjithashtu përfshin një politikë strukturore dhe rregulla specifike për menaxhimin e kapacitetit të flotës, kontrollin e aktivitetit të peshkimit dhe zbatimin e rregullave të saj. PPP bazohet në këshilla të shëndosha shkencore dhe ofron një kornizë për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave të peshkimit. Masat specifike të menaxhimit për shfrytëzimin e qëndrueshëm të peshkimit në Detin Mesdhe përcaktohen në Rregulloren (EC) Nr 1967/2006 (Rregullorja Mesdhetare). Në lidhje me menaxhimin e resurseve dhe flotës, *acquis* përmban rregulla specifike për rregullimin e kapacitetit të peshkimit me qëllim që të kërkojë një ekuilibër midis flotës dhe rezervave me tonazhin e flotës. Shteteve Anëtare u kërkohet të mbledhin dhe përditësojnë të dhënat lidhur me kapacitetin e peshkimit në një regjistër të veçantë të flotës së peshkimit. Inspektimi dhe kontrolli janë kryesisht përgjegjësi e Shteteve Anëtare që kanë nevojë të sigurojnë kapacitetet administrative për zbatim efektiv, ndërsa korniza ligjore është themeluar në nivel të BE. *Acquis*-ja krijon ndërmjet të tjerash rregulla të hollësishme për regjistrimin dhe raportimin e kapjeve dhe funksionimin e një sistemi monitorimi satelitor të anijeve.

Rregullorja (BE) Nr 508/2014 përcakton dispozitat për Fondin Evropian të Peshkimit Detar (EMFF) dhe përcakton masat financiare për zbatimin e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, masat përkatëse në lidhje me Ligjin e Detit, zhvillimin e qëndrueshëm të fushës së peshkimit dhe akuakulturës, dhe peshkimin e brendshëm, si dhe Politikën e Integruar Detare. Për të përfituar nga Fondi Evropian i Peshkimit Detar, Shtetet Anëtare të BE duhet të miratojnë një dokument strategjik dhe një Program Operacional (OP). Shtetet Anëtare gjithashtu duhet të kenë kapacitetet e nevojshme administrative dhe të kontrollit me qëllim që të sigurojnë një zbatim të shëndoshë dhe efikas të Programit Operacional.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian për politikën e tregut përcaktohet nga Rregullorja Nr 1379/2013 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit si dhe është i bazuar në organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacionin për konsumatorin, rregullat e konkurrencës dhe inteligjenca e tregut. Përveç rregulloreve të përgjithshme të ndihmës shtetërore, *acquis* përmban rregulla specifike të ndihmës shtetërore të zbatueshme për sektorin e

peshkimit dhe akuakulturës. Duke pasur parasysh kompetencën e saj ekskluzive në fushën e ruajtjes së burimeve biologjike detare, BE është pjesë e një numri të marrëveshjeve dhe organizatave ndërkombëtare. Në disa raste, marrëveshjet ekzistuese të peshkimit dhe konventat me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare duhet të përshtaten ose të raportohen përpara anëtarësimit.

I.1.2 Kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

Sipas Nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin kombëtar me *acquis* e BE-së.

Detyrimi nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit rrjedh nga neni 96 i MSA-së. Neni përcakton rëndësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellët me interes të përbashkët me prioritetin që lidhet me *acquis* e BE-së për peshkimin, duke përfshirë respektimin e detyrimeve ndërkombëtare lidhur me rregullat e organizimit ndërkombëtar dhe rajonale të peshkimit për menaxhimin dhe ruajtjen e burimeve të peshkimit.

Shqipëria ka harmonizuar kuadrin e saj ligjor dhe dispozitat e rregulloreve kombëtare me dispozitat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit (CFP) me qëllim që në mënyrë adekuate të përgatisë sektorin dhe administratën për përmbushjen e plotë të detyrimeve të saj në kuadër të Politikës së Përbashkët të Peshkimit.

I.2 Situata aktuale/Përmbledhje

Shqipëria ka përditësuar regjistrin e anijeve të peshkimit dhe ka bërë përparime për përmirësimin e statistikave të zbarkimit. Është vënë në zbatim sistemi i lëshimit të certifikatave të zënies për produktet e peshkimit.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 701 datë 12.10.2016 u miratua "Strategjia Kombëtare për Peshkimin dhe Akuakulturën 2016 - 2020". Me qëllim harmonizimin dhe menaxhimin e politikës me legjislacionin e BE-së në fushën e peshkimit dhe Politikës së Përbashkët të Peshkimit, ky dokument planifikimi strategjik udhëhiqet nga legjislacioni përkatës i politikave të BE-së për peshkimin, veçanërisht Rregullorja (BE) Nr 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Dhjetorit 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit.

Ligji Nr 103/2016 "Për akuakulturën" u miratua duke marrë në konsideratë Rregulloren Nr. 1380/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, Rregullorja (BE) 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 15 maj 2014 mbi Fondin Evropian të Detarisë dhe Peshkimit si dhe Vendimin e Komisionit

të datës 25 shkurt 2016 për ngritjen e Komitetit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik për Peshkimin (2016 / C 74/05).

Ligji Nr 80/2017 datë 4.05.2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr 64/2012" Për peshkimin", të ndryshuar, është miratuar. Ligji përcakton qartë rolin dhe detyrat ndërmjet inspektorëve të peshkimit, monitoruesve dhe vëzhguesve si dhe marrëdhëniet e tyre të ndërlidhura, me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit".

Regjistri Kombëtar i Flotës së anijeve të peshkimit është përditësuar dy herë.

Në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare, Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në aktivitetet e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun dhe ka përmbushur rekomandimet e dhëna. Përpos kësaj, Shqipëria ka përmbushur të gjitha kërkesat e rekomandimet e Komisionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut. Shqipëria ka përmirësuar ndjeshëm raportimet në këto organizata në përputhshmëri me kërkesat e tyre.

Shqipëria ka përgatitur dhe dorëzuar Statlant37A_GFCM_FAO_2018 dhe Albania008A_2018, duke rishikuar të gjitha të dhënat e kapur që nga 2013. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2018, Shqipëria dorëzoi të gjitha të dhënat sipas GFCM_DCRF-2017 si dhe ICCAT - Task I + II (2014 - 2017).

Në kuadër të peshkimit, Shqipëria nënshkroi Deklaratën MedFish4Ever të Maltës në lidhje me qëndrueshmërinë e burimeve të peshkimit në Mesdhe (një iniciativë e BE-së për të kthyer peshkimin në Mesdhe për qëndrueshmëri dhe në këtë mënyrë të ruajë rritjen ekonomike dhe vendet e punës) si dhe deklaratën e konferencës së Nivelit të lartë të peshkimit artizanal (HL-SSF) në shtator 2018 në Maltë.

I.3 Prioritetet

- Arritja e përputhjes së mëtijshme me kuadrin ligjor me rregullat e BE në fushën e peshkimit, akuakulturës dhe ujërat e brendshme;
- Forcimi administrativ i administratës së peshkimit, duke përfshirë shërbimet e inspektimit dhe kontrollit si dhe grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të zënive për hartimin e planeve të menaxhimit të peshkimit si dhe raportimin në organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit (GFCM); rekrutimi i monitoruesve dhe vëzhguesve për të bashkëpunuar me shërbimet e peshkimit sikurse parashikuar në ndryshimet e ligjit të peshkimit, në maj 2017;
- Zbatimi i strategjisë kombëtare të zhvillimit të peshkimit;
- Mbështetje për monitorimin vjetor të gjendjes së burimeve të peshkimit për të mundësuar zbatimin e politikës së peshkimit në Shqipëri;
- Zhvillimi i mekanizmave të duhura për grumbullimin e të dhënave në nivel kombëtar, e cila duhet të jetë plotësisht në përputhje me *acquis* të BE;

- Zbatimi dhe zhvillimi i politikave për organizimin e tregjeve të produkteve të peshkut me shumicë dhe pakicë për të arritur kontrollin 100% të produkteve të peshkut dhe promovuar përmirësimin e cilësisë së produkteve të peshkut;
- Ringritja sistemit të monitorimit satelitor të anijeve (VMS) për monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit nga anijet me gjatësi mbi 12 m brenda 6/mujorit të parë të 2019 me fonde të buxhetit të shtetit;
- Zgjerimi i mëtejshëm i porteve të peshkimit ekzistuese, ndërtimin shkallëve për riparimin e anijeve dhe ndërtimin e bankinave për anijet e peshkimit në Vlorë, Sarandë dhe Shëngjinit, në mënyrë që të rritet gatishmërinë e treguesve teknike për flotën e peshkimit detar;
- Mbështetje për dhënien e kredive të buta për operatorët e peshkimit me qëllim riparimin dhe modernizimin e anijeve të tyre të peshkimit;
- Rritja e nivelit të përpunimit industrial të produkteve të peshkimit dhe të akuakulturës, përmirësimin e marketingut të tyre përmes rritjes së cilësisë dhe sigurisë; Ndërmarrja e hapave për të siguruar menaxhimin e duhur të burimeve peshkore, duke përfshirë shpërndarjen e burimeve të nevojshme në këtë fushë, duke ndërmarrë veprimet e duhura zbatuese, duke zhvilluar një sistem të përshtatshëm të mbledhjes së të dhënave, duke siguruar rregullimin e kapaciteteve të flotës së peshkimit për mundësitë e peshkimit me objektiv arritjen e një balance të qëndrueshme midis tyre, dhe mbledhjen e statistikave të sakta të zënies së peshkut;
- Forcimi i kapaciteteve të inspektimit, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes.

II.1 Peshkimi dhe akuakultura

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Çështjet e peshkimit dhe akuakulturës mbulohen nga Strategjia Kombëtare për Peshkimin dhe Akuakulturën 2018-2020.

Ligji Nr 80/2017 datë 4.05.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr 64/2012 "Për peshkimin", i ndryshuar, përafrohet pjesërisht me legjislacionin e mëposhtëm të BE-së:

- Rregullorja e Këshillit (KE) Nr 1224/2009 e datës 20 nëntor 2009 për krijimin e një sistemi kontrolli të Komunitetit për të siguruar përputhjen me rregullat e politikës së përbashkët të peshkimit, duke ndryshuar rregulloret (KE) Nr 847/96, (KE) Nr 2371/2002, (KE) Nr 811/2004, (KE) Nr 768/2005, (KE) Nr 2115/2005, (KE) Nr. 2166/2005, (KE) Nr 388/2006, (KE) Nr 509/2007, (KE) Nr 1342/2008, dhe shfuqizimin e Rregulloreve (KEE) Nr 2847/93, (KE) Nr 1627/94 dhe (KE) Nr 676/2007, (KE) Nr 1098/2007, Nr 1966/2006;
- Rregullore Nr 1380/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, duke ndryshuar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr 1954/2003 dhe (KE) Nr 1224/2009 dhe duke shfuqizuar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr 2371/2002 dhe (KE) Nr 639/2004 dhe Vendimit të Këshillit 2004/585/EC;

- Rregullorja (BE) 2015/2102 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 28 tetor 2015 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr 1343/2011 për disa dispozita për peshkim në GFCM (Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun);
- Vendimi Zbatues i Komisionit (BE) 2016/1251 i datës 12 korrik 2016 që miraton një program shumëvjeçar të Bashkimit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorët e peshkimit dhe akuakulturës për periudhën 2017-2019

Ligji 103/2016 "Për akuakulturën" është pjesërisht i përafuar me legjislacionin e mëposhtëm të BE-së:

- Rregullorja Nr 1380/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr 1954/2003 dhe (KE) Nr 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloret e Këshillit (EC) Nr 2371/2002 dhe (EC) Nr 639/2004 dhe Vendimit të Këshillit 2004/585/EC;
- Rregulloren e Këshillit (BE) Nr 199/2008 të Këshillit të datës 25 shkurt 2008 lidhur me krijimin e një kornize të Komunitetit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshilla shkencore në lidhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit;
- Rregulloren (BE) Nr 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi Fondin Evropian të Detarisë dhe Peshkimit dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit (KE) Nr 2328/2003, (EC) Nr 861/2006, (KE) Nr 1198/2006 dhe (KE) Nr 791/2007 dhe Rregullorja (EU) Nr 1255/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 512 datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", strukturat kryesore administrative përgjegjëse për peshkimin dhe akuakulturën janë si në vijim:

- Sektori i politikave dhe strategjive të peshkimit dhe akuakulturës, nën Drejtorinë e Politikave dhe Strategjisë së Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural;
- Sektori i programeve të peshkimit dhe akuakultures, nën Drejtorinë e Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

Sektori i politikave dhe strategjive të peshkimit dhe akuakulturës është përgjegjës për përcaktimin e vizionit të përgjithshëm për zhvillimin e sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës, duke përcaktuar objektivat dhe përparësitë në secilën nga fushat në përputhshmëri edhe me Politikën e Përbashkët të Peshkimit (PPP) të BE, të Organizmave rajonale dhe Ndërkombëtare ku vendi ynë aderon dhe kontribuon (GFCM dhe ICCAT). Gjithashtu, Sektori harton objektivat, strategjitë dhe politikat specifike të peshkimit detar, peshkimit në ujëra të brendshme dhe akuakulturës së bashku me indikatorët matës të realizimit të tyre në kohë dhe volum.

Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës mbulon funksione rregullatore në lidhje me peshkimin dhe akuakulturën në Shqipëri. Ky sektor harton dhe propozon plane afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të menaxhimit, zhvillimit dhe bashkë-menaxhimit të peshkimit detar dhe në ujëra të brendshme e akuakulturën në përputhje me politikat dhe strategjinë e zhvillimit të këtij sektori.

II.1.3 Akte të planifikuara

II.1.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Amendimi i Ligjit Nr 64/2012 "Për peshkimin", "Për organizimin e tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe akuakulturës" është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 duke përafuar në mënyrë të pjesshme Rregulloren (BE) Nr 1379/2013 të (KE) Nr 1184/2006 dhe (KE) Nr 1224/2009 dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 104/2000.

Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në VKM Nr 301 datë 10.04.2013 'Për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshilla shkencore në strategjinë kombëtare të peshkimit" është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2019. Ky vendim do të përafrojë pjesërisht Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2016/1251 të 12 korrikut 2016 Miratimi i një programi shumëvjeçar të Unionit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në peshkimin dhe sektorët e akuakulturës për periudhën 2017-2019.

Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në VKM Nr 407 datë 3.05.2013" Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim" (Sistemi pikëzimit) është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2019. Ky vendim do të përafrojë në mënyrë të pjesshme Rregulloren zbatuese të Komisionit Nr 404/2011 të 8 prillit 2011 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr 1224/2009 për krijimin e një sistemi kontrolli të Komunitetit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave "Procedurat për shitjen e parë të produkteve të peshkimit dhe organizimin e tregjeve të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës" është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Ky vendim do të përafrojë pjesërisht Rregulloren Implementuese të Komisionit (BE) 1418 / 2013 të datës 17 dhjetor 2013 në lidhje me planet e prodhimit dhe marketingut në përputhje me Rregulloren (EU) Nr 1379/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës. Vendimi synon të formalizojë më tej sektorin e peshkimit dhe në veçanti tregjet e produkteve të peshkimit.

Rregullorja "Procedurat për shitjen e parë të produkteve të peshkimit dhe organizimin e tregjeve të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës" është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Kjo rregullore do të përafrojë pjesërisht Rekomandimin e Komisionit Evropian të datës 3 mars 2014 për krijimin dhe zbatimin e Rregullores Nr 1379/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës.

Rregullore dhe plan menaxhimi është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 dhe do të përafrojë pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 1100/2007 të datës 18 shtator 2007 që përcakton masat për rimëkëmbjen e stokut të ngjallës evropiane.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

000/Lekë

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull si institucion kryesor	10774	0	0
Buxheti total për këtë kapitull nga institucionet e tjera kontribuuese	0	0	0
Buxheti total për kapitull	10774	0	0

Kapitulli 14: Transporti

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e *acquis* së Bashkimit Evropian

Politika e BE-së në sektorin e transporti ka për qëllim lëvizjen e qëndrueshme, duke kombinuar konkurrueshmërinë e Evropës me mirëqenien e qytetarëve të saj dhe duke kontribuar kështu në një siguri rrugore më të madhe, siguri dhe të drejta të zgjeruara. Ky është një komponent thelbësor i strategjisë Evropa 2020 dhe kontribuon në kohezionin social dhe territorial të BE-së. Objektivat e politikës së transportit të BE-së janë: të përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm duke promovuar një sistem transporti të sigurt, konkurrues, me përdorim eficient të resurseve, në përputhje me kërkesat mjedisore, lehtësisht të përdorshëm nga përdoruesit, dhe efektivisht të integruar, duke ofruar një nivel të lartë të mobilitetit të qëndrueshëm në të gjithë Bashkimin Evropian, mbrojtjen e mjedisit, promovimin e standardeve të punës dhe kualifikimeve për sektorin dhe mbrojtjen e sigurisë së qytetarëve. Politika e qëndrueshme e transportit të BE-së kërkon një sistem transporti të integruar, ndërveprues dhe të ndërlidhur për të plotësuar nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të shoqërisë.

Politika e transportit rregullohet nga Titulli VI “Transporti”, nenet 90 – 100 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Një pjesë e rëndësishme e *acquis* përbëhet nga legjislacioni i detyrueshëm dhe i zbatueshëm direkt në formën e rregulloreve dhe vendimeve. Pjesa tjetër e legjislacionit në këtë kapitull përbëhet kryesisht nga direktiva që duhet të transpozohen në sistemin ligjor të vendit.

Acquis në këtë kapitull mbulon transportin rrugor, transportin hekurudhor, transportin ujor të brendshëm, transportin e kombinuar, aviacionin, transportin detar dhe navigimin satelitor.

Pjesë të *acquis* në këtë kapitull mbulohen nga Marrëveshja e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), veçanërisht nëpërmjet Shtojcës I.

I.1.2 Kërkesat e MSA-së

Kërkesat e MSA-së në sektorin e transportit përfshihen në disa nene. Neni 106 “Transporti” parashikon që palët, d.m.th. Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të përqendrohen në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së, me qëllim ristrukturimin dhe modernizimin e mënyrave të transportit shqiptar, përmirësimin e lëvizjes së lirë të udhëtarëve dhe mallrave, lehtësimin e aksesit në tregun dhe infrastrukturën e transportit, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multimodale dhe lidhjen me rrjetet kryesore trans-evropiane dhe arritjen e standardeve operative të krahasueshme me ato të Bashkimit Evropian.

Neni 59 i MSA-së në lidhje me Protokollin 5 “Për transportin tokësor” përcakton detyrimet e palëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit midis Komunitetit dhe Shqipërisë. Neni 59 parashikon se palët do të sigurojnë trafikun rrugor transit të pakufizuar bazuar në zbatimin efektiv të parimit të mosdiskriminimit. Në transportin detar, palët do të aplikojnë në mënyrë efektive parimin e aksesit të pakufizuar në treg dhe trafik në baza komerciale pa hyrë në marrëveshje për ndarjen e mallrave me shtetet e treta, duke eliminuar të gjitha masat e njëanshme dhe pengesat administrative, teknike dhe të tjera që mund të pengojnë aksesin në transportin detar dhe garantimin e trajtimit kombëtar ndaj anijeve të palës tjetër. Në transportin ajror, palët do të bien dakord mbi kushtet e aksesit të ndërsjellët në tregun e transportit ajror.

Neni 70 dhe Neni 59(6) përcaktojnë se Shqipëria do të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së me qëllim përmirësimin e sistemit të transportit dhe shërbimeve të transportit.

I.2 Situata aktuale

Në përgjithësi, në fushën e politikës së transportit është arritur njëfarë niveli përgatitje. Gjatë vitit 2018, përparim është arritur në përgatitjen e raportit të parë të monitorimit të Strategjisë së Transportit dhe Rishikimit të dytë pesëvjeçar të Planit Kombëtar të Transportit (PKT3).

Me ligjin Nr. 8/2018, datë 26.02.2018 “Për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit” u miratua nga Parlamenti Shqiptar ky Traktat, që është një nga dokumentet më të rëndësishëm për të gjithë sektorët e transportit, dhe që do të jetë udhërrëfyesi për vitet në vijim. Zbatimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit do të përmirësojë sektorin e transportit jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shtrirjen e lidhjen e tij me rrjetin e transportit të BE-së. Traktati parashikon përafrimin e mëtejshëm të legjislacioneve kombëtare me *acquis* e BE-së, për të gjitha fushat e transportit.

Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016 – 2020 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020” është duke u zbatuar. Është përgatitur raporti i parë i monitorimit të Strategjisë së Sektorit të Transportit, i cili është publikuar në portalin zyrtar të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe është në proces hartimi i raportit të dytë të monitorimit.

Shqipëria me financimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ka përfunduar hartimin e dokumentit “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, i cili u prezantua më 12 dhjetor 2018. Ka përfunduar hartimi i dokumentit përfundimtar të VSM, në përputhje me ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Aktualisht jemi në procesin e marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe më pas do vijohet me miratimin e tij.

Në transportin rrugor janë miratuar disa udhëzime të ministrit përgjegjës për transportin dhe infrastrukturën për kushtet që duhen përmbushur për të punuar si operator i transportit rrugor dhe për sistemet inteligjente të transportit, regjistrin elektronik dhe терминаlet (lidhur me të drejtat e udhëtarëve në transportin me autobus), të cilat kanë përafruar direktiva dhe rregullore përkatëse të BE-së. Drejtimet e punës në të ardhmen do të përqendrohen në përmirësimin dhe përafrimin e legjislacionit, veçanërisht në lidhje me inspektimet e automjeteve komerciale, sistemet e menaxhimit të trafikut dhe sigurinë rrugore.

Kodi i ri Hekurudhor u miratua. Megjithatë, duhet të miratohet edhe legjislacioni zbatues i këtij Kodi. Përgatitja e legjislacionit zbatues ka filluar dhe ky legjislacion është planifikuar të miratohet në vitin 2019. Për këtë qëllim, Delegacioni i Bashkimit Evropian ka aprovuar dhënien e Asistencës teknike për përgatitjen e legjislacionit për sektorin hekurudhor, e cila është bërë efektive në nëntor 2018 dhe ka një kohëzgjatje 6 muaj (përfundon në prill 2019).

Në transportin ajror, Faza I e Marrëveshjes Shumëpalëshe Kalimtare mbi Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), po zbatohet, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Protokollin I të kësaj Marrëveshjeje. Shqipëria po përgatitet për Vizitën Përfundimtare të Vlerësimit me qëllim verifikimin e plotësimit të kërkesave të Fazës I të ECAA. Vizita pritet të bëhet gjatë vitit 2019. Projektligji “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i cili është një tekst i konsoliduar i ligjit aktual duke përfshirë ndryshimet në përputhje me *acquis* të BE-së është përgatitur. Megjithatë, në menaxhimin e trafikut ajror, duhet të garantohet përputhshmëria me kërkesat e fazës së parë transitore të Qiellit të Vetëm Evropian, sepse përdorimi funksional i hapësirës ajrore ende nuk është në zbatim.

I.3 Prioritetet

Transporti rrugor

Legjislacioni rrugor do të përafrohet më tej me *acquis* të BE-së, siç rekomandohet nga Komisioni Evropian dhe në përputhje me Strategjinë e Sektorit të Transportit që parashikon përafrimin e legjislacionit si Veprimi Prioritar 1 në transportin rrugor. Për këtë qëllim, do të synohet përafrimi i plotë me Rregulloret 1071/2009/EC, 1072/2009/EC dhe 1073/2009/EC. Qëllimi do të jetë përmirësimi i rregullave për pranimin në tregun e transportit të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe kriteret për licencimin / autorizimin / certifikimin në transportin rrugor.

Gjithashtu, do të plotësohet legjislacioni për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, lidhur me institucionet e trajnimit, trajnimit dhe drejtuesve të mjeteve ADR dhe këshilltarëve të sigurisë së ndërmarrjeve që kryejnë transport të mallrave të rrezikshme, në zbatim të Marrëveshjes Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR)” dhe Protokollin e Nënshkrimit”, nënshkruar në Gjenevë, më 30 Shtator 1957, me pjesët e saj përbërëse, Aneksat A dhe B, ratifikuar me ligjin nr. 9272, datë 16.09.2004.

Komisioni Evropian ka rekomanduar që Shqipëria t'i kushtojë vëmendje mirëmbajtjes së rrugëve. Strategjia e Transportit përfshin si Veprimi Prioritar 4 në transportin rrugor rritjen e fondeve për mirëmbajtjen e rrugëve. Kontratat e mirëmbajtjes financohen rreth 50% nga buxheti i shtetit dhe 50% nga IBRD-ja. Duhet theksuar që janë lidhur katër kontrata në zbatim të Projektit të Bankës Botërore për mirëmbajtjen me performancë të rreth 1 400 km rrugë, pjesë e rrjetit rrugor kombëtar nën administrim të ARRSH. Gjithashtu, do të përdoret partneriteti publik-privat për të rritur financimin dhe për të përmirësuar efikasitetin e mirëmbajtjes së rrugëve, para së gjithash për mirëmbajtjen dhe funksionimin e akseve kryesore rrugore, siç janë rrugët Milot – Morinë, Tiranë – Elbasan dhe Rruga e Arbrit.

Gjithashtu do të synohet përmirësimi i sigurisë rrugore. Ky objektivi është në përputhje me rekomandimet e shërbimeve të KE dhe Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Rrugore 2011 – 2020 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 125, datë 23.02.2011 “Për zbatimin e objektivave për përmirësimin e sigurisë rrugore”. Strategjia Kombëtare e Sigurisë Rrugore përcakton se Shqipëria synon të zvogëlojë viktimat e trafikut rrugor në 250 viktima në vit, nga 378 viktima në vitin 2009. Reduktimi i pikave të zeza është parashikuar gjithashtu në Strategjinë Kombëtare të Transportit si Veprimi Prioritar 4 në transportin rrugor.

Transporti hekurudhor

Në sektorin hekurudhor, gjatë vitit 2019 objektivi i synuar është hartimi dhe miratimi i legjislacionit zbatues të Ligjit Nr. 142/2016, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Miratimi i legjislacionit zbatues do të bëjë të mundur ngritjen e strukturave administrative hekurudhore siç kërkohet nga *acquis* e BE-së. Objektivi është në përputhje me rekomandimin e Raportit të KE-së për Shqipërinë të vitit 2016 dhe Raportin e vitit 2018 dhe konkluzionet operative të Nënkomitetit BE-Shqipëri për Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal për vitin 2019. Përveç kësaj, Strategjia e Sektorit të Transportit Shqiptar dhe Plani i saj i Veprimit 2016 – 2020 parashikojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, ngritjen e strukturave administrative dhe përmirësimin e mirëmbajtjes hekurudhore. Këto qëllime janë parashikuar në këtë Strategji si Veprimet Prioritare 1, 2 dhe 3 në transportin hekurudhor.

Objektivi përfshin ngritjen e strukturave të mëposhtme administrative (siç parashihet në Veprimin Prioritar 3 të Strategjisë Kombëtare të Transportit):

- Menaxheri i Infrastrukturës
- Ndërmarrjet hekurudhore
- Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore
- Autoriteti i Licencimit Hekurudhor
- Autoriteti Rregullator i Tregut Hekurudhor
- Autoriteti Kombëtar i Hekurudhave për Hetimin e Incidenteve dhe Aksidenteve

Transporti detar

Në transportin detar, BE rekomandoi që Shqipëria të bëhet pjesë e Memorandumit të Mirëkuptimit të Parisit për kontrollin shtetëror portual. Për këtë është paraqitur kërkesa zyrtare e Shqipërisë nëpërmjet kanaleve diplomatike për t'u bërë anëtare. Edhe Strategjia Kombëtare e Transportit parashikon përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe rritjen e kapaciteteve administrative, përkatësisht si Objektivat 1.1 dhe 1.2 në sektorin e transportit detar.

Si pjesë e procesit të përafrimit, do të miratohet Projektligji për ngritjen e Grupit të Investigimit të incidenteve, aksidenteve ajrore, detare dhe hekurudhore në Republikën e Shqipërisë, plotësisht në përputhje me Direktivën 2009/18/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 23 prillit 2009 që vendos parimet themelore që rregullojnë hetimin e aksidenteve në sektorin e transportit detar duke ndryshuar Direktivën e Këshillit 1999/35/KE dhe Direktivën 2002/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Përforcimi i mëtejshëm i sigurisë dhe kontrollit detar do të arrihet përmes miratimit të një projektvendimi të Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores për sistemin e monitorimit të trafikut dhe sistemit të informacionit të anijeve (VTMIS), i cili do të përafrohet plotësisht me *acquis* të BE-së. Miratimi i këtij vendimi do të jetë në përputhje me rekomandimin e Komisionit Evropian për transportin detar. Strategjia Kombëtare e Transportit gjithashtu parasheh ngritjen e VTMIS në Shqipëri si Veprimi Prioritar 5 në transportin detar.

Përafrimi i legjislacionit do të shoqërohet me forcimin e përgjithshëm të kapaciteteve administrative, në përputhje me Veprimin Prioritar 3 në transportin detar të Strategjisë Kombëtare të Transportit. Kjo do të adresojë rekomandimet e KE-së për të përmirësuar kontrollin shtetëror të flamurit për anijet me flamurin e Shqipërisë dhe kontrollin shtetëror portual, me qëllim që të reduktohet më tej shkalla e ndalimit të anijeve shqiptare.

Përveç kësaj, Shqipëria synon të ratifikojë ndryshimet e Manilës në Konventën Ndërkombëtare mbi Standardet e Trajnimit, Certifikimit dhe Kujdesit për Detarët (STCW - Manila Amendments).

Transport ajror

Në transportin ajror, Shqipëria synon të përafrojë më tej legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së. Objektivi është në përputhje me rekomandimin e përgjithshëm të Komisionit Evropian në sektorin e transportit. Ky objektivi është parashikuar në Strategjinë Kombëtare të Transportit si Veprimi Prioritar 5 në transportin ajror.

Përafrimi i legjislacionit do të mundësojë përfshirjen e shpejtë të Shqipërisë me të drejta të plota në Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, si dhe në iniciativën evropiane “Qielli i Vetëm Evropian”. Shqipëria duhet të marrë masa për të zbatuar përdorimin funksional të hapësirës ajrore.

Përafrimi i legjislacionit do të shoqërohet me forcimin e kapaciteteve administrative.

II.1 Transporti rrugor

II.1.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Dokumenti kryesor i politikave në sektorin e transportit është Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plan i saj i Veprimit 2016 – 2020 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020 është (i) të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit të Shqipërisë, dhe (ii) përmirësojë ndjeshëm ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij me sistemin e transportit ndërkombëtar dhe evropian dhe rajonin.

Strategjia dhe Plan i Veprimit janë në përputhje të plotë me vizionin strategjik të Qeverisë Shqiptare dhe me konceptet kryesore të Politikës Evropiane të Transportit. Ajo parashikon zhvillimin e një sistemi transporti efikas, të qëndrueshëm dhe ekologjik, i aftë për të mbështetur objektivat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë dhe integrimin e ardhshëm të vendit në Bashkimin Evropian.

10 veprimet prioritare në transportin rrugor të identifikuar për periudhën 5 vjeçare janë thellësisht të ndërlidhura dhe marrin parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian dhe prioritetet e pranimit në BE.

Është përgatitur raporti i parë i monitorimit të Strategjisë së Sektorit të Transportit.

Shqipëria me financimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ka përfunduar hartimin e dokumentit “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, i cili u prezantua më 12 dhjetor 2018. Ka përfunduar hartimi i dokumentit përfundimtar të VSM, në përputhje me ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Aktualisht jemi në procesin e marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe më pas do vijohet me miratimin e tij.

Legjislacioni në transportin rrugor përfshin një numër aktesh të përafruara me *acquis* e BE-së.

Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, është pjesërisht i përafruar me Rregulloren (EU) Nr. 165/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 4 shkurt 2014 mbi tahografin në transportin rrugor, që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 3821/85 mbi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor dhe ndryshon Rregulloren (EC) Nr. 561/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për harmonizimin e disa rregullave

sociale në lidhje me transportin rrugor. Të gjitha aktet zbatuese të Ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998, janë miratuar tashmë.

Përveç kësaj, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 153, datë 7.04.2000 “Për miratimin e Rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor” është i përafruar plotësisht me Direktivën 2006/126/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 20 dhjetor 2006 mbi lejet e drejtimit.

Për sa i përket transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, është miratuar Ligji nr. 118/2012, datë 13.12.2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, pjesërisht i harmonizuar me:

- Direktivën 2008/68/KE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 24 shtatorit 2008 mbi transportin tokësor të mallrave të rrezikshme;
- Direktivën e Këshillit 95/50/KE e 6 tetorit 1995 mbi procedurat uniforme për kontrollin e transportit të mallrave të rrezikshme në rrugë;
- Direktivën 2010/35/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 qershorit 2010 mbi pajisjet nën presion të transportueshme dhe shfuqizimin e Direktivave të Këshillit 76/767/KEE, 84/525/KEE, 84/526/KEE, 84/527/KEE dhe 1999/36/KE.

Për sa i përket aksesit në tregun e transportit rrugor, Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportin rrugor”, i ndryshuar së fundmi, nga Ligji Nr. 10/2016, datë 11.02.2016 është pjesërisht i përafruar me:

- Rregulloren (EC) Nr. 1071/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 tetor 2009 që përcakton rregullat e përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të respektohen për t’u pranuar në profesionin e operatorit të transportit rrugor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 96/26/EC;
- Rregulloren (KE) Nr. 1072/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 tetor 2009 mbi rregullat e përbashkëta për aksesin në tregun ndërkombëtar të transportit rrugor;
- Direktivën 2006/22/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 mars 2006 mbi kushtet minimale për zbatimin e Rregulloreve të Këshillit (KEE) Nr. 3820/85 dhe (KEE) Nr. 3821/85 lidhur me legjislacionin shoqëror në lidhje me aktivitetet në transportin rrugor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 88/599/KEE;
- Direktivën 2010/40/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 korrik 2010 mbi kornizën për vendosjen e Sistemeve Inteligjente të Transportit në fushën e transportit rrugor dhe për ndërlidhjen me mënyrat e tjera të transportit;

dhe në përputhje të plotë me Direktivën 2003/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 15 korrik 2003 mbi kualifikimin fillestar dhe trajnimin periodik të drejtuesve të automjeteve të caktuara rrugore për transportin e mallrave ose udhëtarëve, duke ndryshuar Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr. 3820/85 dhe Direktivës së Këshillit 91/439/KEE dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 76/914/KEE.

Akte të tjera të përafruara në transportin rrugor janë:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 19.03.2008, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, ndryshuar me VKM nr. 520, datë 13.07.2016, i përafuar pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE”;
- Udhëzimi nr. 3616/3, datë 20.07.2017 “Mbi rregullat për zbatimin e sistemeve inteligjente në fushën e transportit rrugor dhe lidhjet me mënyrat e tjera të transportit”, i përafuar pjesërisht me Direktivën 2010/40/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 qershor 2010 “Mbi kuadrin për vendosjen e sistemeve inteligjente në transport në fushën e transportit rrugor dhe për lidhjen me mënyrat e tjera të transportit”;
- Udhëzimi nr. 328, datë 20.1.2017 “Mbi rregullat e hollësishme për listën e të dhënave që mbahen në regjistrin elektronik kombëtar të transportit rrugor, si dhe modalitetet e mbajtjes së tij”, i përafuar pjesërisht me nenin 16(1) të Rregullores (KE) Nr. 1071/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 tetor 2009 që përcakton rregullat e përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të respektohen për t’u pranuar në profesionin e operatorit të transportit rrugor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 96/26/KE;
- Udhëzimi nr. 446, datë 10.05.2018 “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve, i përafuar pjesërisht me Rregulloren nr. 181/2011 (BE) të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 shkurt 2011, në lidhje me të drejtat e udhëtarëve në transportin me autobus dhe ndryshon Rregulloren nr. 2006/2004.

Politikat në sigurinë rrugore janë përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Rrugore 2011 – 2020 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 125, datë 23.02.2011 “Për zbatimin e objektivave për përmirësimin e sigurisë rrugore”. Sipas këtij dokumenti, baza e vitit 2009 ishte 378 viktima. Objektivi 2020 është 250 vdekje në vit.

Kuadri ligjor në sigurinë rrugore është i përafuar me *acquis* e BE-së. Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Infrastrukturës Nr. 2, datë 11.02.2010 “Për inspektimin teknik të mjeteve rrugore” është përafuar plotësisht me Direktivën 2009/40/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 6 maj 2009 për testet e automjeteve dhe rimorkiot e tyre.

Direktiva 2006/126/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 dhjetor 2006 mbi lejet e drejtimit, është përafuar plotësisht me miratimin e tre akteve ligjore shqiptare:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 940, datë 18.11.2015 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 153 datë 7.04.2000 “Për miratimin e Rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor”;
- Udhëzimi i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 241/3, datë 19.02.2016 “Mbi karakteristikat e materialit, elementet e sigurisë, elementet grafike dhe mënyrën e plotësimit të leje drejtimit të ri të mjeteve rrugore”;

- Udhëzimi i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 682/4, datë 1.04.2016 “Për aktivitetin e autoshkollave, pajisjen e kandidatëve me leje drejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave dhe specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)”.

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Instituti i Transportit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Ministria e Brendshme / Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

II.1.3 Aktivitetet e planifikuara

II. 1.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Shqipëria me financimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ka përfunduar hartimin e dokumentit “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, i cili u prezantua më 12 dhjetor 2018. Ka përfunduar hartimi i dokumentit përfundimtar të VSM, në përputhje me ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Aktualisht jemi në procesin e marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe më pas do vijohet me miratimin e tij.

Objekti i përgjithshëm i PKT3 do të jetë rritja e zhvillimit ekonomik dhe social e udhëhequr nga një sektor transporti eficient në një kuadër politikash gjithëpërfshirëse. PKT3 do të shërbejë si instrument kryesor për planifikimin e transportit në Shqipëri, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Transportit dhe Planin e saj të Veprimit 2016 – 2020 dhe duke synuar forcimin e kapaciteteve të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të Ministrisë përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën dhe Institutit të Transportit.

II. 1.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Aktet ligjore që do të propozohen për miratim janë një Projektvendim i Këshillit të Ministrave, një udhëzim i përbashkët i ministrit përgjegjës për transportin dhe të ministrit të brendshëm dhe

tjetri i ministrit përgjegjës për transportin dhe parashikohen të miratohen gjatë periudhës 2019-2020 dhe konkretisht:

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, të ndryshuar, i cili përaftron pjesërisht Rregulloren (KE) Nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 21 tetor 2009 që përcakton rregullat e përbashkëta në lidhje me kushtet që duhen përmbushur për të kryer profesionin e operatorit të transportit rrugor që shfuqizon Direktivën 96/26/KE. Ky projektvendim është parashikuar të miratohet tremujorin e parë të vitit 2019;
- Projektudhëzim “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, i cili përaftron plotësisht Rregulloren (KE) Nr. 1071/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 21 tetor 2009 që përcakton rregullat e përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të respektohen për t’u pranuar në profesionin e operatorit të transportit rrugor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 96/26/KE, si dhe Rregulloren (KE) Nr. 1073/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 21 tetor 2009 mbi rregullat e përbashkëta për pranimin në tregun e ndërkombëtar për shërbimet me autobus dhe shfuqizimin rregullores (KE) Nr. 561/2006. Ky projektudhëzim është parashikuar të miratohet tremujorin e katërt të vitit 2019;
- Projektudhëzim “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të mallrave”, të ndryshuar, i cili përaftron plotësisht Rregulloren (KE) Nr. 1071/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 21 tetor 2009 që përcakton rregullat e përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të respektohen për t’u pranuar në profesionin e operatorit të transportit rrugor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 96/26/KE, si dhe Rregulloren (KE) Nr. 1072/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 21 tetor 2009 mbi rregullat e përbashkëta për pranimin në tregun e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave. Ky projektudhëzim është parashikuar të miratohet tremujorin e katërt të vitit 2020.

Masat ligjore, që do të planifikohen gjatë kësaj periudhe në fushën e sigurisë rrugore kanë të bëjnë me përgatitjen e akteve ligjore, që synojnë transpozimin e plotë të Direktivave 2014/45/BE “Mbi testet periodike të gatishmërisë teknike në rrugë të mjeteve motorike” dhe 2014/47/BE “Mbi inspektimet në anë të rrugës të gatishmërisë teknike të mjeteve tregtare që qarkullojnë në BE”. Konkretisht, aktet ligjore të planifikuara për sektorin e sigurisë rrugore janë:

- Projektudhëzim “Për ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 2, datë 11.02.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, i ndryshuar” i cili do të synojë përafrim të plotë me Direktivën 2014/45/BE “Mbi testet periodike të gatishmërisë teknike në rrugë të mjeteve rrugore”. Ky projektudhëzim është parashikuar të miratohet tremujorin e katërt të vitit 2019;

- Projektudhëzim “Mbi kontrollet në anë të rrugës të mjeteve rrugore”, i cili do të synojë përafrim të plotë me Direktivën 2014/47/BE “Mbi inspektimet në anë të rrugës të gatishmërisë teknike të mjeteve tregtare që qarkullojnë në BE”. Ky projektudhëzim është parashikuar të miratohet tremujorin e katërt të vitit 2019.

II. 1.3.2 Aktivitete të tjera të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka aktivitete të tjera të planifikuara në transportin rrugor.

II.2 Transporti hekurudhor

II.2.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Dokumenti kryesor i politikave në sektorin e transportit është Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016 – 2020 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020 është (i) të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit të Shqipërisë, dhe (ii) përmirësojë ndjeshëm ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij me sistemin e transportit ndërkombëtar dhe evropian dhe rajonin.

Strategjia dhe Plani i Veprimit janë në përputhje të plotë me vizionin strategjik të Qeverisë Shqiptare dhe me konceptet kryesore të Politikës Evropiane të Transportit. Ajo parashikon zhvillimin e një sistemi transporti efikas, të qëndrueshëm dhe ekologjik, i aftë për të mbështetur objektivat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë dhe integrimin e ardhshëm të vendit në Bashkimin Evropian.

Shtatë veprimet prioritare në transportin hekurudhor të identifikuar për periudhën 5 vjeçare janë thellësisht të ndërlidhura dhe marrin parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian dhe prioritetet e pranimit në BE.

Është përgatitur raporti i parë i monitorimit të Strategjisë së Sektorit të Transportit.

Shqipëria me financimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ka përfunduar hartimin e dokumentit “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, i cili u prezantua më 12 dhjetor 2018. Ka përfunduar hartimi i dokumentit përfundimtar të VSM, në përputhje me ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Aktualisht jemi në procesin e marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe më pas do vijohet me miratimin e tij.

Legjislacioni në transportin hekurudhor po përmirësohet në mënyrë që të përafrohet me acquis të BE-së.

Ligji nr. 142/2016, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë. Kodi i ri hekurudhor është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2012/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 nëntor 2012 për krijimin e një zone të vetme hekurudhore evropiane;
- Direktivën (BE) 2016/798 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 maj 2016 për sigurinë hekurudhore;
- Direktivën (BE) 2016/797 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 maj 2016 mbi ndërveprimin e sistemit hekurudhor brenda Bashkimit Evropian;
- Direktivën 2007/59/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2007 mbi certifikimin e drejtuesve të trenave që drejtojnë lokomotivat dhe trenat në sistemin hekurudhor në Komunitet;
- Rregulloren (BE) 2016/796 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 maj 2016 mbi Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudhat dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) Nr 881/2004;
- Rregulloren (KE) 1370/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetorit 2007 mbi shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me rrugë hekurudhore dhe rrugore dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit (KEE) Nr. 1191/69 dhe 1107/70;
- Rregulloren (KE) Nr 1371/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2007 mbi të drejtat dhe detyrimet e udhëtarëve hekurudhorë.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Instituti i Transportit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave/Hekurudha Shqiptare;
- Departamenti i Inspektimit Hekurudhor/Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

II.2.3 Aktivitetet e planifikuara

II. 2.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Shqipëria me financimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ka përfunduar hartimin e dokumentit “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, i cili u

prezantua më 12 dhjetor 2018. Ka përfunduar hartimi i dokumentit përfundimtar të VSM, në përputhje me ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Aktualisht jemi në procesin e marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe më pas do vijohet me miratimin e tij.

II. 2.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Për zbatimin e Kodit Hekurudhor, do të miratohen aktet e mëposhtme ligjore:

- Projektligji për Administratorin e Infrastrukturës hekurudhore, për krijimin e Organit të Menaxherit të Infrastrukturës (IM), në përputhje dhe në zbatim të Kodit Hekurudhor dhe Direktivës 2012/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 21 nëntor 2012 për krijimin e një zone të vetme hekurudhore evropiane. Projektligji synon dhe do të garantojë ndarjen e administrimit të Infrastrukturës nga operacionet dhe shërbimet që kryhen, siç kërkohet nga *acquis* e BE-së;
- Projektligji për Sipërmarrësit Hekurudhorë, për përcaktimin dhe krijimin e subjekteve private apo shtetërore, që do të kryejnë shërbime të ndryshme në këtë fushë;
- Projektligji për Autoritetin Rregullator të Hekurudhave, i cili synon krijimin e organit garantues të zbatimit të Direktivës 2012/34/BE dhe rregulloreve zbatuese të saj për garantimin e tregut hekurudhor. ;
- Projektakti ligjor për Autoritetin Licencues Hekurudhor, i cili synon krijimin e Organit Licencues në fushën e transportit hekurudhor, në zbatim të Kodit Hekurudhor dhe rregulloreve zbatuese të BE-së në këtë fushë;
- Projektakti ligjor për Autoritetin Kombëtar për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve në Hekurudhë, i cili synon krijimin e një organi, i cili do të jetë i ngarkuar për të hetuar incidentet në transportin hekurudhor, si një organ i pavarur nga Menaxheri i Infrastrukturës, Sipërmarrësit Hekurudhor, organi Licencues dhe Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore;
- Projektligji për ngritjen e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, i cili do të përafrojë:
 - o Direktivën (BE) 2016/798 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 11 maj 2016 për sigurinë hekurudhore;
 - o Direktivën (BE) 2016/797 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 11 maj 2016 mbi ndërveprimin e sistemit hekurudhor brenda Bashkimit Evropian;
 - o Direktivën 2007/59/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 23 tetor 2007 mbi certifikimin e drejtuesve të trenave që drejtojnë lokomotivat dhe trenat në sistemin hekurudhor në Komunitet;
 - o Rregulloren (BE) 2016/796 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 11 maj 2016 mbi Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudhat dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) Nr 881/2004.

Të gjitha projektaktet në transportin hekurudhor do të miratohen në tremujorin e tretë të vitit 2019, pasi për përgatitjen e tyre është dhënë asistenca teknike e BE, e cila deri në prill 2019 do të dorëzojë draftet e këtyre akteve ligjore, në zbatim të Kodit Hekurudhor.

II. 2.3.2 Aktivitete të tjera të planifikuara

Transpozimi i të gjitha akteve të BE-së në legjislacionin kombëtar, të parashikuara në Traktatin për krijimin e Komunitetit të Transportit, është përfshirë në planet e punës në vijimësi dhe do të kryhet me akte zbatuese (si rregullore, udhëzime, etj) nga të gjitha njësitet administrative të reja që do të krijohen në fushën e transportit hekurudhor si Menaxheri i Infrastrukturës, Sipërmarrësit Hekurudhor, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, etj.

Do të merren masat e nevojshme për ndarjen e plotë administrative dhe financiare të HSH sh.a.

II.3 Transporti detar

II.3.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Dokumenti kryesor i politikave në sektorin e transportit është Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016 – 2020 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020 është (i) të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit të Shqipërisë, dhe (ii) përmirësojë ndjeshëm ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij me sistemin e transportit ndërkombëtar dhe evropian dhe rajonin.

Strategjia dhe Plani i Veprimit janë në përputhje të plotë me vizionin strategjik të Qeverisë Shqiptare dhe me konceptet kryesore të Politikës Evropiane të Transportit. Ajo parashikon zhvillimin e një sistemi transporti efikas, të qëndrueshëm dhe ekologjik, i aftë për të mbështetur objektivat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë dhe integrimin e ardhshëm të vendit në Bashkimin Evropian.

13 veprimet prioritare në transportin detar të identifikuar për periudhën 5 vjeçare janë thellësisht të ndërlidhura dhe marrin parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian dhe prioritetet e pranimit në BE.

Është përgatitur raporti i parë i monitorimit të Strategjisë së Sektorit të Transportit.

Shqipëria me financimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ka përfunduar hartimin e dokumentit “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, i cili u prezantua më 12 dhjetor 2018. Ka përfunduar hartimi i dokumentit përfundimtar të VSM, në

përputhje me ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Aktualisht jemi në procesin e marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe më pas do vijohet me miratimin e tij.

Legjislacioni shqiptar në transportin detar po përafrohet me *acquis* të BE-së dhe njëkohësisht, Shqipëria po ratifikon konventat ndërkombëtare në transportin detar.

Në mënyrë të veçantë, Ligji Nr. 103/2015, datë 23.09.2015 “Për ratifikimin nga Republika e Shqipërisë të Konventës së Punës të ILO-s (MLC) 2006”, ratifikoi Konventën e Punës Detare.

Përveç kësaj, disa konventa të tjera ndërkombëtare janë ratifikuar si më poshtë:

- UNCLOS 1982,
- MARPOL 73/78,
- SOLAS 74/78,
- Linjat e ngarkesës 66,
- Konventa e tonazhit 69,
- Konventa e COLREG '72,
- Konventa STCW 78/95,
- Konventa e SAR-it 79,
- Konventa e lehtësimit 65,
- Konventa e QNL 69,
- Konventa e Fondit 71/76/92,
- Konventa PAL 74/76/90,
- Konventa LLMC 76/96,
- Konventa e SUA dhe Protokolli 2005,
- Konventa e rikuperimit 89,
- Konventa e OPRC 90,
- Protokolli OPRC-HNS 2000,
- Konventa HNS 96,
- Konventa e Bunkerëve 01,
- Konventa e BWM 2004,
- Nairobi WRC 2007.

Aktet kryesore ligjore të harmonizuara me *acquis* të BE-së përfshijnë:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 892, datë 21.12.2011 “Për miratimin e rregullores “Për formalitetet e anijeve që operojnë në portet detare të Republikës së Shqipërisë”, i përafuar plotësisht me Direktivën 2010/65/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 20 tetor 2010 mbi formalitetet e raportimit për anijet që mbërrijnë dhe / ose dalin nga portet e Shteteve Anëtare dhe që shfuqizon Direktivën 2002/6/KE;
- Urdhri i Ministrit Nr. 113, datë 13.12.2011 “Për miratimin e Udhëzimit të Ministrit të Transportit për Rregulloren e Trajnimit të Detarëve”, i përafuar plotësisht me Direktivën 2008/106/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 nëntor 2008 mbi nivelin minimum të trajnimit të detarëve;

- Ligji Nr. 168/2013, datë 30.10.2013 “Për sigurinë e anijeve dhe porteve”, i cili është i përafuar pjesërisht me Direktivën 2005/65/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 tetor 2005 mbi rritjen e sigurisë së portit;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 462, datë 9.07.2014 “Për miratimin e Rregullores për regjistrimin e anijeve në Republikën e Shqipërisë”, i përafuar plotësisht me Rregulloren (KE) Nr 789/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 21 prillit 2004 mbi transferimin e anijeve të mallrave dhe pasagjerëve në mes të regjistrave brenda Komunitetit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KEE) Nr. 613/91;
- Urdhri i ministrit Nr. 85, datë 11.06.2015 “Për rritjen e sigurisë detare në anijet dhe portet e Republikës së Shqipërisë” i përafuar pjesërisht me Rregulloren (KE) Nr 725/2004 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 31 Mars 2004 për rritjen e sigurisë së objekteve të anijeve dhe porteve;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 809, datë 16.11.2016 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit të ISM-së në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje të plotë me Rregulloren (KE) Nr. 336/2006 të Parlamentit Evropian dhe i Këshillit të datës 15 shkurt 2006 mbi zbatimin e Kodit të Menaxhimit Ndërkombëtar të Sigurisë brenda Komunitetit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 3051/95;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 13, datë 11.01.2017 “Për miratimin e rregullores për kontrollin shtetëror portual në Republikën e Shqipërisë”, i përafuar plotësisht me Direktivën 2009/16/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2009 për kontrollin shtetëror portual.

II.3.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Instituti i Transportit;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Regjistri Detar Shqiptar Sh.A.

II.3.3 Aktivitetet e planifikuara

II. 3.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Shqipëria me financimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ka përfunduar hartimin e dokumentit “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, i cili u prezantua më 12 dhjetor 2018. Ka përfunduar hartimi i dokumentit përfundimtar të VSM, në

përputhje me ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Aktualisht jemi në procesin e marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe më pas do vijohet me miratimin e tij.

II. 3.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit Shtetëror të Flamurit”, do të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2019. Miratimi i këtij Vendimi do të adresojë një rekomandim të lënë nga Auditimi i IMO-s, por gjithashtu do të jetë një nga arritjet e përcaktuara në Strategjinë Sektoriale të Transportit. Vendimi i Këshillit të Ministrave do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2009/21/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2009.

Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores për sistemin e monitorimit dhe të informacionit të trafikut të anijeve (VTMIS)” do të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2020. Miratimi i Vendimit do të adresojë një rekomandim të Komisionit Evropian dhe një nga veprimet prioritare sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit. Vendimi i Këshillit të Ministrave do të përafrohet plotësisht me:

- Direktivën 2002/59/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 qershor 2002 për krijimin e sistemit të monitorimit dhe informacionit të trafikut të anijeve të Komunitetit dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 93/75/KEE;
- Direktivën 2009/17/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 prillit 2009 që ndryshon Direktivën 2002/59/KE për krijimin e një sistemi komunitar për sistemin e monitorimit dhe informacionit të trafikut të anijeve;
- Direktivën e Komisionit 2011/15/BE e 23 shkurtit 2011 për ndryshimin e Direktivës 2002/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e një sistemi komunitar për sistemin e monitorimit dhe informacionit të trafikut të anijeve;
- Direktivën e Komisionit 2014/100/BE e 28 tetorit 2014 që ndryshon Direktivën 2002/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e një sistemi komunitar të monitorimit dhe informacionit të trafikut të anijeve.

Projektligji për ngritjen e Autoritetit të Hetimeve të Incidentit dhe Aksidenteve do të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2020. Miratimi i Ligjit do të trajtojë një rekomandim të Komisionit Evropian dhe një nga Veprimet Prioritare të Strategjisë Kombëtare të Transportit. Projektligji do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2009/18/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2009 që përcakton parimet themelore që rregullojnë hetimin e aksidenteve në sektorin e transportit detar dhe që amendon Direktivën e Këshillit 1999/35/KE dhe Direktivën 2002/59/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

II. 3.3.2 Aktivitete të tjera të planifikuara

Nuk ka aktivitete të tjera të planifikuara në transportin detar.

II.4 Transporti ajror

II.4.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Dokumenti kryesor i politikave në sektorin e transportit është Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016 – 2020 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020 është (i) të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit të Shqipërisë, dhe (ii) të përmirësojë ndjeshëm ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij me sistemin e transportit ndërkombëtar evropian dhe rajonin.

Strategjia dhe Plani i Veprimit janë në përputhje të plotë me vizionin strategjik të Qeverisë Shqiptare dhe me konceptet kryesore të Politikës Evropiane të Transportit. Ajo parashikon zhvillimin e një sistemi transporti efikas, të qëndrueshëm dhe ekologjik, i aftë për të mbështetur objektivat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë dhe integrimin e ardhshëm të vendit në Bashkimin Evropian.

Shtatë veprimet prioritare në transportin ajror të identifikuar për periudhën 5 vjeçare janë thellësisht të ndërlidhura dhe marrin parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian dhe prioritetet e pranimit në BE.

Legjislacioni shqiptar në transportin ajror është kryesisht në përputhje me *Acquis* të BE-së. Shqipëria ka përmbushur kushtet në lidhje me përfundimin e fazës së parë të Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit ECAA, duke përfshirë në legjislacionin kombëtar, kuadrin ligjor të BE-së, i përcaktuar në Shtojcën I të – ECAA. Ky proces është në vazhdimësi për shkak të dinamikës së ndryshimeve në legjislacionin përkatës evropian.

Rregullat në lidhje me aksesin në treg, menaxhimin e trafikut ajror, sigurinë e aviacionit, aspektet sociale dhe mbrojtjen e konsumatorit përcaktohen me Ligjin Nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe legjislacioni zbatues i tij, të përafuar me legjislacionin evropian.

Republika e Shqipërisë është palë në “Marrëveshjen Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës.(etj), për Krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”, ratifikuar me Ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, si dhe në “Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së

Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për disa aspekte të caktuara të shërbimeve ajrore”, ratifikuar me Ligjin nr. 9586, datë 20.07.2006.

Ndër konventat/marrëveshjet ndërkombëtare të tjera që Republika e Shqipërisë ka aderuar/ratifikuar përmendim:

- Dekretin, nr. 7438, datë 01.12.1990, “Për aderimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në konventën për aviacionin civil ndërkombëtar (ICAO) dhe në protokollin për tekstin autentik tri gjuhësh të kësaj konvente” (Konventa Çikagos e vitit 1944);
- Ligjin nr. 8197, datë 6.03.1997 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventat “Për kundërvajtjet dhe akte të tjera të kryera në bordin e avionit”, nënshkruar në Tokio më 14.9.1963, “Për ndërhyrjet e akteve të paligjshme të rrëmbimit të avionit”, nënshkruar në Hagë më 16.12.1970 dhe “Për ndërhyrjet e akteve të paligjshme ndaj sigurisë së aviacionit civil”, nënshkruar në Montreal më 23.09.1971”;
- Ligjin nr. 8196, datë 6.03.1997 “Për ratifikimin nga Republika e Shqipërisë të marrëveshjes për shërbimet transite ajrore ndërkombëtare”, nënshkruar në Çikago më 7 dhjetor 1944;
- Ligjin nr. 8259 datë 26.11.1997 “Për anëtarësimin e Shqipërisë në Konferencën Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC)”;
- Ligjin nr. 8278, datë 15.01.1998 “Për ratifikimin nga Republika e Shqipërisë të protokollit në lidhje me një amendament të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar”, nënshkruar në Montreal më 6 tetor 1980” (neni 83 bis);
- Ligjin nr. 8821, datë 15.10.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare të EUROCONTROL-it”;
- Ligjin nr. 9255, datë 15.7.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për unifikimin e disa rregullave për transportin ajror ndërkombëtar”, bërë në Montreal, më 28 maj 1999;
- Ligjin nr. 9881, datë 28.02.2008 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për tregtinë me avionët civilë”, bërë në Gjenevë, më 12 prill 1979;
- Ligjin nr. 133/2014, datë 23.10.2014 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin në lidhje me një amendament të konventës së aviacionit civil ndërkombëtar (neni 3 bis)”, nënshkruar në Montreal, më 10 maj 1984.

Aktet kryesore ligjore të harmonizuara me *Acquis* të BE-së përfshijnë:

- Urdhrin e Ministrit nr. 3, datë 7.02.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, i përputhur plotësisht me Rregulloren (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 20 shkurt 2008 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit;
- Udhëzimin nr. 1, datë 26.02.2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës gjatë fluturimeve”, i përputhur plotësisht me Rregulloren (KE) Nr. 261/2004 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 shkurt 2004 mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës gjatë fluturimeve;

- Urdhri e Ministrit nr. 149, datë 7.04.2014 “Mbi përcaktimin e rregullave implementuese për vlefshmërinë ajrore dhe certifikimin mjedisor të avionëve, produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të ngjashme me to, gjithashtu dhe për certifikimin e organizatave projektuese dhe prodhuese” i përafuar plotësisht me Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 748/2012 të 3 gushtit 2012, që përcakton rregullat zbatuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe mjedisore të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të lidhura me të, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit;
- Urdhri e Ministrit nr. 151 datë 9.04.2014 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operacionet ajrore”, në përputhje të plotë me Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 965/2012 të datës 5 tetor 2012, kërkesat teknike dhe procedurat administrative lidhur me operacionet ajrore në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- Urdhri e Ministrit nr. 250, datë 12.09.2014 “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil, sipas parashikimeve të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, në përputhje të plotë me Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011 të 3 nëntorit 2011, që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative lidhur me ekuipazhin e aviacionit civil në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- Urdhri e Ministrit nr. 329, datë 22.12.2014 “Për miratimin e rregullores për të drejtat e invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit”. Ky Urdhër përafuron Rregulloren nr. 1107/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 5 korrik 2006 në lidhje me të drejtat e invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit”;
- Urdhri e Ministrit nr. 33, datë 25.02.2015 “Për miratimin e Rregullores “Për kërkesat për vlerësimin dhe zbatimin e ndryshimeve që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror”, në përputhje të plotë me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) Nr. 1034/2011 të datës 17 tetor 2011, mbi mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e lundrimit ajror;
- Udhëzimin e Ministrit nr. 3, datë 13.03.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 7.02.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil në fushën e aerodromeve, menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e lundrimit ajror” në përputhje të plotë me Rregulloren (KE) Nr. 1108/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 21 tetorit 2009, që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 216/2008, në fushën e aerodromeve, menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror;
- Udhëzimin e Ministrit nr. 8, datë 15.09.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 5, datë 3.06.2010, “Kuari Rregullator në Qiellin e Vetëm Evropian”, në Udhëzimin Nr. 6, datë 3.06.2010, “Për dispozitat e shërbimeve të navigimit ajror në Qiellin e Vetëm Evropian”, në Udhëzimin Nr. 7, datë 3.06.2010, “Për organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore në Qiellin e Vetëm Evropian” dhe Udhëzimin Nr. 8, datë 3.06.2010, “Për ndërveprimin në rrjetin evropian të menaxhimit të trafikut ajror”, me qëllim të përmirësimit të performancës dhe qëndrueshmërisë së sistemit të aviacionit civil”, i përafuar plotësisht me Rregulloren (KE) Nr. 1070/2009 të Parlamentit Evropian

dhe Këshillit të 21 tetorit 2009, që ndryshon Rregulloret (KE) Nr. 549/2004, Nr. 550/2004, (KE) Nr. 551/2004 dhe (KE) Nr. 552/2004, me qëllim të përmirësimit të performancës dhe qëndrueshmërisë së sistemit të aviacionit evropian;

- Urdhrin e Ministrit nr. 124, datë 28.09.2015, “Për miratimin e rregullores për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore”, në përputhje të plotë me Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1332/2011 të 16 dhjetor 2011, duke përcaktuar kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat operative për shmangien e përplasjeve në ajër.
- Udhëzimin e Ministrit nr. 1362, datë 16.03.2016 “Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit Ky udhëzim përaftron plotësisht Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës Nr. 2009/12/KE të 11 marsit 2009 “Për tarifat e aeroportit”;
- Urdhrin e Ministrit nr. 3746, datë 10. 07. 2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 151, datë 09.04.2014 për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”, i përafuar pjesërisht me Rregulloret e Parlamentit dhe Këshillit Evropian nr. 800/2013, nr. 71/2014, nr. 379/2014, nr. 2015/140, nr. 2015/1329, nr. 2015/2338, të cilat amendojnë Rregulloren (BE) nr. 965/2012 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative që lidhen me operimet ajrore në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 216/2008 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Udhëzimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 834, datë 03.12.2018 “Për hyrjen në tregun e shërbimeve të përpunimit në tokë në aeroportet e Republikës së Shqipërisë”, i përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit nr. 96/67/KE e 15 tetor 1996 mbi hyrjen në tregun e përpunimit në tokë në aeroportet e Komunitetit, e ndryshuar me Rregulloren (EC) nr 1882/2003, të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 867, datë 13.12.2018 “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta për përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore”, i përafuar pjesërisht me Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 2150/2005 e 23 dhjetorit 2005, që përcakton rregullat e përbashkëta të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore.
-

II.4.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Instituti i Transportit;
- Autoriteti i Aviacionit Civil.

II.4.3 Aktivitetet e planifikuara

II.4.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka politika të planifikuara në transportin ajror.

II.4.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Projektligji “Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë” parashikohet të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2019. Projektligji është një tekst i konsoliduar i Ligjit aktual Nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10484, datë 24.11.2011, si dhe ndryshimet në dispozitat në fuqi, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e ekspertëve të Komisionit Evropian, në kuadër të Marrëveshjes Shumëpalëshe, në veçanti aneksin e saj të përditësuar, gjetjet e vizitave të standardizimit të Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (EASA) dhe rekomandimet e ekspertëve të IPA 2012 “Forcimi i Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar”. Projektligji gjithashtu bën një sqarim gjuhësor dhe standardizon të gjitha kushtet në fushën e aviacionit civil.

Disa nga aktet e BE-së që përafron pjesërisht projektligji “Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë” janë:

- Rregullorja (EU) 2018/1139 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 4 korrik 2018 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një Agjencie Evropiane të Sigurisë së Aviacionit dhe ndryshimin e rregulloreve (KE) nr. 2111/2005, (BE) nr. 376/2014 dhe direktivave 2014/30/BE dhe 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e Rregulloreve (KE) nr. 1008/2008, (BE) nr 996/2010, dhe shfuqizimin e Rregulloreve (KE) nr. 552/2004 dhe (KE) nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3922/91;
- Rregulloren (KE) Nr. 1070/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 tetor 2009 për ndryshimin e Rregulloreve (KE) Nr. 549/2004, (KE) Nr. 550/2004, (KE) Nr. 551/2004 dhe (KE) Nr. 552/2004 për të përmirësuar performancën dhe qëndrueshmërinë e sistemit evropian të aviacionit;
- Rregulloren (BE) Nr. 996/2010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi hetimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil dhe shfuqizimin e Direktivës 94/56/KE;
- Rregulloren (KE) Nr. 1008/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 shtator 2008 mbi rregullat e përbashkëta për funksionimin e shërbimeve ajrore në Komunitet;
- Rregulloren (KE) Nr. 300/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2008 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) Nr. 2320/2002.

Gjatë periudhës 2019 – 2020 do të miratohen edhe aktet e mëposhtme:

- Projekturdhri “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të

trafikut ajror”, do të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2019. Rregullorja, e miratuar me këtë urdhër do të përafrohet pjesërisht me Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/340 e datës 20 shkurt 2015 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror në pajtim me Rregulloren (KE) Nr 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Komisionin Rregullorja (BE) nr. 805/2011;

- Projekturdhri “Për miratimin e Rregulloreve për Përcaktimin e Kërkesave dhe Procedurave Administrative që lidhen me Aerodromet në Republikën e Shqipërisë”, do të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2019, i cili përafrohet plotësisht Rregulloren e Komisionit Evropian 139/2014 e datës 12 shkurt 2014 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet në pajtim me Rregulloren (KE) nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e ndryshuar me Rregulloren (BE) 2018/401;
- Projekturdhri “Për miratimin e Rregulloreve për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil, do të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2019, e cila përafrohet plotësisht Rregulloren Evropiane 376/2014, e datës 3 prill 2014 për raportimin, analizimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil, ndryshuar me rregulloren 2018/1139, e datës 4 Korrik 2018, mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e EASA;
- Projekturdhër “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin e Ministrit nr. 250, datë 12.09.2014 për miratimin e rregulloreve “Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil, sipas parashikimeve të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 07.02.2011 për rregullat e përbashkëta në fushën e Aviacionit Civil”, e cila përafrohet plotësisht Rregulloren Evropiane nr. 2015/445 e 17 mars 2015 që amendon Rregulloren Evropiane nr. 1178/2011 në lidhje me kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin në aviacionin civil. Ky projekt akt parashikohet të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2019;
- Projektvendim “Rregullat për procesin e investigimit për Sigurinë e operimit (safety) në Aviacionin Civil”, do të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2020. Projektvendimi do të përafrohet pjesërisht me Rregulloren (BE) Nr. 996/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 Tetor 2010 “Mbi investigimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil dhe shfuqizon Direktivën 94/56/KE.

II.1.3.2 Aktivitete të tjera të planifikuara

Nuk ka aktivitete të tjera të planifikuara në transportin detar.

III. Abokimet financiare

III.1. Buxheti

000 Lek

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total i institucionit koordinues të këtij kapitulli	29,600	6,800	0
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera	0	0	0
Buxheti total i kapitullit	29,600	6,800	0

Kapitulli 15: Energjia

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e acquis së Bashkimit Evropian

Objektivat e politikës energjetike të BE janë konkurrueshmëria, siguria e furnizimit dhe qëndrueshmëria. Acquis e energjisë përbëhet nga rregulla dhe politika, veçanërisht në lidhje me konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, duke përfshirë sektorin e qymyrit, kushtet për akses të barabartë në burimet për kërkimin, eksplorimin dhe prodhimin në sektorin e hidrokarbureve, tregun e brendshëm të energjisë (hapja e tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit), energjia bërthamore dhe siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimi, si dhe promovimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe efikasitetit të energjisë. Sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, kapitulli përmban Traktatin e Kartës së Energjisë dhe instrumentet përkatëse.

I.1.2 Kërkesat e MSA-së

Kërkesat e MSA-së në sektorin e energjisë përfshihen në nenin 107 që përcakton se bashkëpunimi energjetik do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me acquis e BE-së në fushën e energjisë, duke përfshirë aspektet e sigurisë bërthamore. Bashkëpunimi në sektorin e energjisë reflekton parimet e ekonomisë së tregut dhe do të bazohet në Traktatin rajonal të Komunitetit të Energjisë të nënshkruar me qëllim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet e energjisë të Evropës.

Përveç kësaj, neni 17(2) parashikon se tregtia e produkteve të mbuluara nga Traktati themelues i Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike do të bëhet në përputhje me dispozitat e këtij Traktati.

Neni 70 parashikon se Shqipëria do të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me acquis e BE-së me qëllim përmirësimin e sektorit të saj energjetik.

I.2 Situata aktuale

Në përgjithësi, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në sektorin e energjisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Në përgjithësi, gjatë dy viteve të fundit ka pasur njëfarë përparimi në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit dhe në linjat e interkonjeksionit. Zbatimi i masave të buta ka vazhduar dhe përgatitjet po bëhen për ngritjen e bursës së energjisë. Aktivitetet vazhduan për

të garantuar qëndrueshmërinë ekonomike të sektorit të energjisë elektrike dhe zbatimin e legjislacionit të sektorit të energjisë.

Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë. Ligji Nr. 9501, datë 3.04.2006 “Për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Energjisë”, është miratuar nga Parlamenti Shqiptar. Themelimi i Komunitetit të Energjisë ka ndihmuar në përmirësimin e sektorit të energjisë në Shqipëri, në përmirësimin e bashkëpunimit me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe në harmonizimin e legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së. Si rezultat, rrjeti shqiptar i energjisë elektrike është pjesë e rrjetit evropian të energjisë elektrike. Komuniteti i Energjisë po ndihmon gjithashtu, në zbatimin e masave të buta në kuadër të Procesit të Berlinit.

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 – 2030, (miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 480, datë 31.07.2018 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030), përcakton se vizioni i Shqipërisë është zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimal.

Në sektorin e energjisë elektrike, Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” është plotësisht i përafuar me Direktivën 2009/72/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm në energjinë elektrike dhe që shfuqizon Direktivën 2003/54/EC. Në bazë të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016, “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”. Miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike ishte një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri në një treg të energjisë plotësisht konkurrues, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” u ndryshua me Ligjin Nr. 7/2018, datë 15.02.2018, për të lejuar ngritjen e bursës së energjisë elektrike. Bursa e energjisë do të organizohet dhe do të funksionojë si një platformë e tregut elektronik për energjinë elektrike duke plotësuar një nga angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Kjo masë do të liberalizojë më tej tregun e energjisë në Shqipëri. Ndarja e ndërmarrjeve të energjisë elektrike ka bërë përparim të mirë, por duhet të finalizohet.

Kapaciteti total i instaluar për prodhimin e energjisë elektrike u rrit në 2 145 MW në fund të vitit 2017. Rritja i dedikohet kryesisht hidrocentraleve të vogla dhe të mesme të vënë në punë në vitin 2017. Përparim është arritur gjatë vitit 2018 në lidhje me reduktimin e humbjeve dhe rritjen e faturimit në rrjetin e shpërndarjes së energjisë.

Linja e interkonjeksionit Shqipëri – Kosovë përfundoi më 28 qershor 2016. Ndërtimi i kësaj linje synon të përmirësojë balancën e tregut të energjisë mes dy vendeve dhe të reduktojë rrezikun hidrologjik në Shqipëri. Ndërtimi i kësaj linje interkonjeksioni është pjesë e krijimit të një tregu të integruar rajonal të energjisë elektrike.

Kanë filluar procedurat për ndërtimin e linjës së transmetimit të energjisë 400 kV Elbasani (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni), pjesë e Korridorit Lindje – Perëndim. Është përzgjedhur konsulenti për këtë projekt dhe së shpejti do të fillojë përgatitja e dokumenteve të tenderit për ndërtimin e linjës së transmetimit.

Spektori i gazit rregullohet me Ligjin Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “Për spektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, i cili është plotësisht i përafuar me Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe për shfuqizimin e Direktivës 2003/55/EC. Gjatë periudhës 2017 – 2018 ka pasur një progres të dukshëm në miratimin e legjislacionit dytësor të Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 nëpërmjet miratimit të vendimeve përkatëse nga Këshilli i Ministrave dhe Enti Rregullator i Energjisë, si dhe urdhrave apo udhëzimeve nga Ministri përgjegjës për energjinë.

Për zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Shqipëri, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektori të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. Master Plani i Gazit përcakton linjat kryesore për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve të gazit në Shqipëri bazuar në gazin natyror të furnizuar nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), por edhe vendburime potenciale të gazit të zbuluara dhe konkretizuara në vend, apo edhe nëpërmjet gazsjellësve të tjerë si gazsjellësi Jonian Adriatik (Projekti IAP), gazsjellësi Shqipëri – Kosovë (Projekti ALKOGAP).

Shoqëria “Albgaz” sh.a. që është krijuar nga ndarja e aktiviteteve në spektorin e gazit realizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 848, datë 12.07.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.”. Albgaz, gjatë periudhës 2017 – 2018, është konsoliduar më tej në aktivitetin e saj institucional dhe pjesëmarrje në aktivitete të sektorit të gazit, si një operator i kombinuar në aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

Në vitin 2018 shoqëria “ALBGAS” sh.a. së bashku me shoqërinë italiane të gazit SNAM S.p.A. krijoi shoqërinë e përbashkët “Albanian Gas Service Company” sh.a. (marrëveshje e miratuar me VKM nr. 609, datë 17.10.2018 “Për miratimin e marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët nga dhe ndërmjet “Snam” S.p.a. dhe “Albgaz” sh.a., lidhur më 11 qershor 2018”) me qëllim marrjen përsipër të shërbimit të mirëmbajtjes së projektit TAP në territorin shqiptar, gjë për të cilën është nënshkruar edhe marrëveshja përkatëse me shoqërinë TAP AG.

Ndërtimi i seksioneve tokësore të projektit TAP po vazhdon. Ndërkohë, përqindja e realizimit të ndërtimit të seksionit tokësor deri më 14 tetor 2018 është 91%. Përsa i përket ndërtimit të

mikrotunelit, përfundimi i instalimit të tubacionit pritet të jetë Q3 2019. Në vitin 2017 filluan punimet për ndërtimin e Stacionit të Kompresorëve të Fierit, si dhe për ndërtimin e Stacionit të Matjes në Korçë. Aktualisht, brenda muaji tetor 2018, TAP ka realizuar 64.6% të punimeve të Stacioneve të Kompresorit dhe Kompresor/Matjes të Projektit të gazsjellësit Trans Adriatik. Në 19 tetor 2018 u inaugurua fillimi i punimeve për seksionin detar të projektit TAP.

Pas amendimit të parë të Marrëveshjes së Qeverisë Pritëse (HGA), si dhe përfitimeve lokale dhe mbështetjen për krijimin e gazit tregu në Shqipëri, të miratuara respektivisht me Ligjin Nr. 53/2017, datë 13.04.2017 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me Qeverinë e Vendit Pritës”, si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 233, datë 21.03.2017 “Për miratimin e Marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit dhe Marrëveshjes për përfitimet vendase, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik”. në vitin 2018 u ratifikua edhe amendimi i dytë i Marrëveshjes së Qeverisë Pritëse (HGA), me Ligjin nr. 45/2018, datë 19.7.2018.

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit” (miratuar me VKM 233, datë 21.03.2017), gjatë vitit 2018 është konkluduar për ndërtimin e Pikës së Daljes së projektit TAP në zonën e Fierit, pikë dalje e cila do të ndërtohet dhe pajiset nga shoqëria TAP AG dhe do të kalojë në pronësi dhe përdorim të shoqërisë “ALBGASZ” sh.a.

Përpjekjet për të ndërtuar Gazsjellësin Adriatiko – Jonian (IAP) po vazhdojnë. Palët kanë ftuar si vëzhgues kompaninë SOCAR (Kompania shtetërore e naftës e Republikës së Azerbajxhanit), si dhe palët e tjera të interesuara për të dhënë mbështetjen dhe kontributin e tyre në projektin IAP. Diskutime janë zhvilluar për të përfshirë projektin në listën e projekteve PECI/PMI në 2018 (si dhe listën e projekteve PCI), por nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë projekti IAP është përfshirë në Listën PMI 2018. Shqipëria, në bashkëpunim me Malin e Zi, aplikoi në raundin e 15-të të WBIF për fonde për të përgatitur dizajnin teknik paraprak për pjesët shqiptare dhe malazeze të këtij projekti. Vlera e grantit e miratuar nga WBIF është 2.5 milion euro. Data e nisjes së këtij projekti është 04.09.2018 dhe është planifikuar të zgjasë 24 muaj. Më datë 30.10.2018 nga Konsulenti SUEZ IPF-6 u organizua në Tiranë Workshop-i mbi Raportin fillestar.

Në bashkëpunim me Republikën e Kosovës, Shqipëria aplikoi në raundin e 15-të të WBIF për fonde për të përgatitur një studim fizibiliteti dhe vlerësimin mjedisor për një gazsjellës që do të lidhë Shqipërinë me Kosovën (projekti ALKOGAP). Nga WBIF, u aprovua një grant me vlerë 0.3 milionë euro për të financuar përgatitjen e studimit të para-fizibilitetit për gazsjellësin ALKOGAP. Mbi bazën e Termave të Referencës të miratuara, konsulenti COWI-IPF-4 filloi të përgatiste studimin e para-fizibilitetit për projektin ALKOGAP. Më 9 nëntor 2018 u zhvillua në Prishtinë, Kosovë, Workshop-i përmbyllës i këtij projekti, ku u paraqit edhe versioni përfundimtar i studimit të parafizibilitetit.

ALKOGAP është pjesë e listës së Projekteve me interes për Komunitetin e Energjisë PECE/PMI 2018 duke u klasifikuar me statusin PECE 2018. Për këtë Projekt, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës kanë aplikuar për përfshirjen e këtij projekti në ENTSG TYNDP 2018. Ky projekt është pjesë e Aneksit A e ENTSG TYNDP 2017 (kodi i Projektit TRA-F-1028). https://www.entsog.eu/public/uploads/files/publications/Events/2016/TYNDP049-160713_Projects-Details.pdf . .

Shqipëria synon të zhvillojë një vend-depozitim nëntokësor të gazit natyror në Dumre, pranë Elbasanit (Projekti UGS Dumrea). Shqipëria aplikoi në nëntor 2017 në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, për të përfshirë këtë vend-depozitim nëntokësor në listën PECE/PMI të vitit 2018. Ndërkohë, në shkurt 2018, Shqipëria aplikoi në raundin e 20-të të WBIF për një grant për të financuar Studimin e Fizibilitetit dhe VNSM për projektin e Depozitimit Nëntokë të Gazit në Dumre (UGS Dumrea Project). Në dhjetor 2018 Komiteti Drejtues i WBIF miratoi një grant për financimin e projektit për përgatitjen e studimit të Fizibilitetit dhe të VNMS për projektin UGS Dumrea, në shumën 1 Milionë Euro.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018-2030 (të miratuar me VKM Nr. 480, datë 31.07.2018 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030), si dhe në mbështetje edhe të Master Planit të Gazit për Shqipërinë (miratuar me VKM Nr. 87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektori të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”), në bazë të aplikimit që bëri Shqipëria në Raundin e 20-të të WBIF në dhjetor 2018 Komiteti Drejtues i WBIF miratoi një grant prej 1.1 milionë Euro për financimin e projektit për përgatitjen e dizajnit të plotë teknik për gazsjellësin që do të lidhë projektin TAP në afërsi të zonës së Stacionit të Kompresorëve Fier me TEC-in Vlorë dhe krejt rajonin e Vlorës. Ndërtimi i këtij gazsjellësi do të bëjë të mundur rivënien në punë të TEC-it Vlorë duke përdorur si lëndë djegëse gazin natyror (pas rikonstruksionit të TEC-it nga një koncesionar i mundshëm).

Sa i përket sigurisë së furnizimit, Ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, është ende në fuqi. Ligji është përafëruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2009/119/KE të datës 14 shtator 2009 që vendos një detyrim ndaj Shteteve Anëtare për të ruajtur rezervat minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës. Ligji përcakton detyrimin për të mbajtur një rezervë sigurie për naftën dhe nënproduktet e naftës për 90 ditë, duke filluar nga viti 2010. Shqipëria po punon aktualisht për hartimin e një ligji të ri në përputhje me Direktivën e Këshillit 2009/119/KE të 14 shtatorit 2009, që vendos një detyrim ndaj Shteteve Anëtare për të ruajtur rezervat minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë 2015/09/MC-EnC: Për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi udhëzimet për infrastrukturën trans-evropiane të energjisë, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 14.11.2018 “Për miratimin e praktikave për promovimin e investimeve

të përbashkëta, rajonale, në infrastrukturën e sektorit të energjisë”, nëpërmjet të cilit është bërë përafrimi i pjesshëm i Rregullores (BE) Nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 17 prill 2013 mbi udhëzimet për infrastrukturën trans-evropiane të energjisë dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 1364/2006/KE dhe ndryshimin e Rregullores (KE) Nr. 713/2009, (KE) Nr. 714/2009 dhe (KE) Nr. 715/2009. Ky vendim që u përgatit me asistencën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, përbën një akt të konsoliduar ligjor për sektorin e energjisë dhe synon të përcaktojë parimet e përgjithshme mbi integritetin e praktikave për nxitjen e investimeve të përbashkëta rajonale në infrastrukturën e sektorit të energjisë dhe për të përcaktuar marrëdhëniet midis institucioneve shqiptare si një Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, me institucionet e tjera të vendeve anëtare të kësaj Komuniteti dhe, sipas rastit, me Shtetet Anëtare të BE-së, në lidhje me promovimin e investimeve të përbashkëta rajonale në infrastrukturën e sektorit të energjisë.

Cilësia e karburanteve rregullohet me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”. Këto dy Vendime kanë përafruar Direktivën e Këshillit 1999/32/KE të datës 26 prill 1999 lidhur me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të caktuara të lëngshme dhe ndryshimin e Direktivës 93/12/KEE si dhe Direktivën 98/70/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 tetor 1998 lidhur me cilësinë e benzinës dhe diezeleve dhe që amendon Direktivën e Këshillit 93/12/KEE.

Efienca e energjisë në Shqipëri është e rregulluar me Ligjin Nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për Eficencën e Energjisë” që pjesërisht transpozon Direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 tetor 2012 mbi eficientësinë e energjisë, që ndryshon Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizon Direktivat 2004/8/EC dhe 2006/32/EC. Megjithatë, përafrimi i plotë i kësaj Direktive duhet të arrihet siç rekomandohet nga Raporti i KE-së për vitin 2018. Ky Ligj gjithashtu synon krijimin dhe zbatimin e politikave kombëtare dhe rregulloreve për promovimin dhe përmirësimin e përdorimit efikas të energjisë, me qëllim kursimin e energjisë sipas pikësnyimit kombëtar të përcaktuar në PKVEE e dytë dhe të tretë 2017 – 2020 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 709, datë 1.12.2017.

Si një kërkesë e Ligjit Nr. 124/2015 “Për Eficencën e Energjisë”, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 852, datë 7.12.2016, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë për Eficencën e Energjisë”, si institucion përgjegjës për zbatimin e politikave dhe promovimin e masave për eficientësinë energjetike. Për këtë qëllim duhet të krijohet edhe fondi i eficientësisë së energjisë.

Ligji Nr. 116/2016 “Për performancën energjetike të ndërtesave” është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 maj 2010 mbi performancën energjetike të ndërtesave. Ky Ligj ka për qëllim krijimin e kuadrit ligjor për përmirësimin e performancës së energjisë në ndërtesa, duke marrë parasysh kushtet lokale të

klimes, nivelet e brendshme te komoditetit te nje ndertese dhe gjithashtu efektivitetin e kosos per ndertimin e ndertesave te reja dhe rindertimin e ndertesave ekzistuese. Megjithate, perafrimi i plotë i Direktivës 2010/31/BE duhet te arrihet.

Lidhur me energjinë e rinovueshme, Ligji Nr. 7/2017, datë 2.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” u miratua pjesërisht i përafuar me Direktivën 2009/28/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2009 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/EC dhe 2003/30/EC. Është miratuar edhe legjislacioni zbatues i Ligjit Nr. 7/2017, datë 2.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjive nga burimet e rinovueshme”.

Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 179, datë 28.03.2018 “Planin Kombëtar të Veprimit për Energjitë e Rinovueshme (NREAP) 2018-2020”, i cili parashikon një rritje mesatare të gjeneruesve të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme në masën 798 MW deri në vitin 2020.

Qeveria shqiptare gjatë Samitit të Parisit në korrik 2016 nënshkroi Udhërrëfyesin “Karta e qëndrueshmërisë së Ballkanit Perëndimor”, duke nënvizuar nevojën për të zbatuar eficientë të energjisë, për të promovuar përdorimin e burimeve të rinovueshme dhe për të mbështetur politikën e ndryshimeve klimatike. Në takimin Ministerial të Komunitetit të Energjisë, të zhvilluar në datë 14 dhjetor 2017, Republika e Shqipërisë u angazhua që në bashkëpunim me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë të hartojnë dhe miratojnë Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës. Procesi i hartimit të këtij plani, i cili integron temat e sigurisë energjetike, eficientës së energjisë, energjive të rinovueshme dhe zbatimin e politikave ambicioze për ndryshimin e klimës filloi në shtator 2018.

Siguria, siguri dhe mbrojtja nga rrezatimet në Republikën e Shqipërisë rregullohet me Ligjin Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9973, datë 28.07.2008, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet”, i cili transponon Direktivën e Këshillit 96/29/Euratom të 13 majit 1996, që përcakton standardet themelore për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe publikut të gjerë nga rrezatimet që vijnë nga rrezatimi jonizues, dhe me Ligjin Nr. 26/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8025, datë 9.11.1995”, amendime të cilat janë bërë në përputhje me Ligjin Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji është një ligj kuadër bazë, i cili hap rrugën për zbatimin e të gjitha elementeve të përfshira në këtë Direktivë në lidhje me sigurinë, sigurinë dhe mbrojtjen kundër rrezatimit jonizues. Nenet që nuk janë përafuar në ligj janë përafuar ose do të përafrohen në rregulloret përkatëse.

Strukturat kryesore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi siguri dhe siguri janë: Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi (KMR) dhe Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimi (ZMR) respektivisht si organe rregullatore dhe ekzekutive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jo-jonizuese.

I.3 Prioritetet

Siguria e furnizimit

Lidhur me sigurinë e furnizimit, projektligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe / ose nënprodukteve të saj” do të finalizohet dhe miratohet në tremujorin e II-të të vitit 2019. Projektligji synon të përafrojë pjesërisht Direktivën e Këshillit 2009/119/KE të datës 14 shtator 2009 që vendos një detyrim ndaj Shteteve Anëtare për të ruajtur rezervat minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës. Miratimi i Ligjit do të jetë në përputhje me rekomandimin e Komisionit Evropian dhe do të përmbushë një nga detyrimet e Shqipërisë sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Miratimi i Ligjit do të pasohet me miratimin e rregulloreve zbatuese.

Siguria e furnizimit do të rritet me ndërtimin e linjës 400 kV që lidh Shqipërinë dhe Maqedoninë. Është përzgjedhur konsulenti për këtë projekt dhe së shpejti do të fillojë përgatitja e dokumenteve të tenderit për ndërtimin e linjës së transmetimit.

Tregu i energjisë

Referuar “Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018 – 2030”, miratuar me VKM Nr. 480, datë 31.07.2018”, vizioni i Shqipërisë është zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimal.

Finalizimi i ndarjes dhe liberalizimit të tregut të energjisë sipas Ligjit Nr. 43/2015 është një nga prioritetet kryesore në sektorin e energjisë. Aktualisht, ndarja ligjore dhe funksionale e OSHEE sh.a. është në proces. Modeli i ndarjes u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE Sh.a me Vendimin Nr. 65, datë 19.12.2016 “Për miratimin e modelit të korporatës” dhe gjithashtu nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë. Me urdhër të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE) nr. 157, datë 12.02.2018 “Për krijimin e tre kompanive të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, u urdhërua krijimi nga OSHEE Sh.a (kompania mëmë) e tre kompanive të kontrolluara me qëllim ndarjen e aktivitetit të shpërndarjes, shërbimit të furnizimit dhe aktivitetin e shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike.

Sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe Urdhrit të Asamblesë së

Përgjithshme nr. 157, datë 12.02.2018 “Për krijimin e tre kompanive të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, OSHEE Sh.a, në cilësinë e Aksionarit Themelues ka themeluar tre kompani të reja të kontrolluara si më poshtë:

- **Furnizuesi i Shërbimit Universal** (FSHU), me objekt të aktivitetit "Furnizimi me energji elektrike i klientëve fundorë që operojnë në tregun e rregulluar të përcaktuar me legjislacionin në fuqi"
- **Furnizuesi i Tregut të Lirë** (FTL), me objekt të aktivitetit "Blerja dhe menaxhimi i energjisë elektrike dhe operimi në tregun e lirë, etj".
- **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes** (OSSH), me objekt të aktivitetit "Shpërndarja e energjisë elektrike, ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për furnizimin me energji elektrike konsumatorëve, lidhja e konsumatorëve dhe shfrytëzuesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, shërbimet e matjes etj."

Liberalizimi dhe ndarja do të shoqërohen me masa të mëtejshme për të përmirësuar stabilitetin financiar të ndërmarrjeve të energjisë elektrike duke ulur humbjet teknike dhe duke rritur mbledhjen e faturave.

Në sektorin e gazit natyror do të finalizohen dhe miratohen aktet zbatuese të Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Legjislacioni i ri në sektorin e gazit natyror do të shoqërohet me masa zbatuese që synojnë të garantojnë ndërtimin sipas planit të projektit TAP (Trans Adriatic Pipeline Project), si dhe për realizimin e projekteve të tjera lidhur me zhvillimin e infrastrukturës së gazit.

Eficienca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë

Prioritet në efencën e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë është përafrimi i legjislacionit që lejon krijimin e organeve (publike ose private) dhe zbatimin e programeve.

Projektligji “Për prodhimin, transportin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe karburanteve të tjera të rinovueshme për transport” do të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2019. Projektligji do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2009 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE. Miratimi i projektligjit do t’i përgjigjet një prej rekomandimeve të Komisionit Evropian në lidhje me burimet e rinovueshme të energjisë në transport. Pas miratimit të projektligjit, do të përgatitet dhe miratohet legjislacioni zbatues.

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kategoritë, kushtet, kualifikimet dhe kërkesat e eksperiencës për certifikimin e auditorëve të energjisë” është dërguar për mendim në ministrinë e linjës dhe është parashikuar të miratohet në tremujorin e II-të të vitit 2019. Projektvendimi përafrohet pjesërisht Direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 25 tetorit 2012 mbi efencën e energjisë, duke ndryshuar Direktivat 2009/125/KE

dhe 2010/30/BE dhe shfuqizimin e Direktivave 2004/8/KE dhe 2006/32/KE. Projektvendimi i përgjigjet rekomandimit të Komisionit Evropian për përafrimin e *acquis* të efikasitetit të energjisë.

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherët e energjisë” do të miratohet në tremujorin e II-të të vitit 2019. Projektvendimi do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 tetorit 2012 mbi efikasitetin e energjisë, duke ndryshuar Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe duke shfuqizuar Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE. Projektvendimi i përgjigjet rekomandimit të Komisionit Evropian për përafrimin e *acquis* të energjisë.

Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimi

Prioriteti kryesor në mbrojtjen nga rrezatimi është përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së. Hartimi i projektvendimi “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e publikut, punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht dhe sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimit jonizues” është ende në proces. Pas konsultimit të draftit të parë me ekspertët e ANEA-s është propozuar që përveç ekspozimeve të publikut, mjekësore dhe profesionale, të përfshihen dhe elemente të rregullores për punë të sigurtë me burime të rrezatimit jonizues, pra do të shkrihen katër rregullore në një. Sa më sipër ky projektvendim do të miratohet në vitin 2019, tremujori i IV-ët. Projektvendimi do të përafrojë pjesërisht Direktivën e Këshillit 2013/59/Euratom të datës 5 dhjetor 2013 që përcakton standardet bazë të sigurisë për mbrojtjen nga rrezatimet që dalin nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues dhe shfuqizimin e Direktivave 89/618/Euratom, 90/641/Euratom, 96/29/Euratom, 97/43/Euratom dhe 2003/122/Euratom, si dhe GSR-part 3 dokument i ANEA-s.

II.1 Siguria e furnizimit

II.1.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Dokumenti kryesor i politikës në sektorin e energjisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 - 2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 480, datë 31.07.2018”. Ajo është në përputhje me përpjekjet kombëtare për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për të përmbushur angazhimet për Komunitetin e Energjisë, integrimin në BE dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe duke minimizuar ndikimet mjedisore me kosto të përballueshme për qytetarët shqiptarë dhe të gjithë sektorët e ekonomisë.

Legjislacioni shqiptar në lidhje me sigurinë e furnizimit është kryesisht në përputhje me *acquis* e BE-së.

Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, është plotësisht në linjë me Direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54/KE.

Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i cili është plotësisht i përafuar me Direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55/KE, u ndryshua dy herë gjatë vitit 2018, përkatësisht: me Ligjin nr. 64/2018, datë 24.09.2018, “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe me Ligjin nr. 89/2018, datë 3.12.2018, “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar”.

Të dy ligjet e sipërpërmendura synojnë ndër të tjera të përmirësojnë sigurinë e furnizimit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Ligji Nr. 7/2017, datë 2.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” u miratua pjesërisht i përafuar me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2009 mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE. Ligji ka për qëllim të nxisë përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë në Shqipëri, duke synuar në mënyrë indirekte rritjen e sigurisë së furnizimit.

Ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, është ende në fuqi. Ligji është i përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2009/119/KE të datës 14 shtator 2009 që vendos një detyrim ndaj Shteteve Anëtare për të ruajtur rezervat minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës. Ligji përcakton detyrimin për të mbajtur një rezervë sigurie për naftën dhe nënproduktet e naftës për 90 ditë, duke filluar nga 2010.

Ligji Nr. 9876, datë 14.2.2008 “Për prodhimin, transportin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport” i ndryshuar, është pjesërisht i përafuar me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2009 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE.

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Enti Rregullator i Energjisë;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

II.1.3 Aktivitetet e planifikuara

II.1.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk do të ketë ndryshime në kuadrin e politikave në sektorin e energjisë gjatë vitit 2019.

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019– 2021

Projektligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe / ose nënprodukteve të saj” do të finalizohet dhe miratohet në tremujorin e II-të të vitit 2019. Projektligji synon të përafrojë pjesërisht Direktivën e Këshillit 2009/119/EC të 14 shtatorit 2009 që vendos një detyrim ndaj Shteteve Anëtare për të ruajtur rezervat minimale të naftës së papërpunuar dhe/ose të nënprodukteve të naftës. Miratimi i Ligjit do të pasohet me miratimin e rregulloreve zbatuese.

Gjithashtu, do të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2019, edhe projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë në furnizimin me gaz dhe mënyrën e trajtimit të tyre”. Ky projektvendim do të përafrojë plotësisht Direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, e cila shfuqizon direktivën 2003/55/KE”.

II.1.3.3 Aktivitete të tjera të planifikuara

Miratimi i ligjit “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe / ose nënprodukteve të saj” do të pasohet me miratimin e rregulloreve zbatuese.

II.2 Tregu i energjisë

II.2.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Dokumenti kryesor i politikës në sektorin e energjisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 - 2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 480, datë 31.07.2018”. Ajo

është në përputhje me përpjekjet kombëtare për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për të përmbushur angazhimet për Komunitetin e Energjisë, integrimin në BE dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe duke minimizuar ndikimet mjedisore me kosto të përballueshme për qytetarët shqiptarë dhe të gjithë sektorët e ekonomisë.

Legjislacioni shqiptar në tregun e energjisë është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së.

Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” është plotësisht i përputhur me Direktivën 2009/72/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54/EC. Në bazë të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”. Miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike ishte hapi i fundit drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri në një treg të energjisë plotësisht konkurruese, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, i cili është plotësisht i përafuar me Direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm natyror gaz dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55/KE. Në bazë të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 590, datë 9.10.2018 “Për miratimin e modelit të tregut të gazit natyror”. Miratimi i Modelit të Tregut të Gazit është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të tregut të gazit në Shqipëri duke garantuar një treg plotësisht konkurruese, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Enti Rregullator i Energjisë;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

II.2.3 Aktivitetet e planifikuara

II.2.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk do të ketë ndryshime në kuadrin e politikave në sektorin e energjisë gjatë vitit 2019.

II.2.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk janë planifikuar masa ligjore në PKIE 2019 – 2021.

II.2.3.3 Aktivitete të tjera të planifikuara

Do të miratohen aktet zbatuese të Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar:

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, që ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”;
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 89/2018 datë 3.12.2018 “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar”.

II.3 Eficenca e energjisë dhe burimet e energjisë së rinovueshme

II.3.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Dokumenti kryesor i politikës në sektorin e energjisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 - 2030, miratuar me VKM Nr. 480, datë 31.07.2018”. Ajo është në përputhje me përpjekjet kombëtare për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për të përmbushur angazhimet për Komunitetin e Energjisë, integrimin në BE dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe duke minimizuar ndikimet mjedisore me kosto të përballueshme për qytetarët shqiptarë dhe të gjithë sektorët e ekonomisë.

Duke synuar arritjen e qëllimeve që lidhen me efencën e energjisë në Shqipëri, në zbatim të Ligjit Nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për Eficencën e Energjisë” u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 709, datë 1.12.2017, PKVEE i dytë dhe i tretë 2017 – 2020. Objektivi për efencën e energjisë në PKVEE është kursimi i energjisë me 6.8% deri në vitin 2020 dhe lidhet me zbatimin e masave të propozuara për përdorimin e energjisë në ndërtesa, proceset industriale dhe transport, si dhe respektimin e rëndësisë së rolit model që duhet të luajë sektori publik.

Këshilli i Ministrave ka miratuar gjithashtu Planin Kombëtar të Veprimit për Energjitë e Rinovueshme (NREAP) 2018-2020”, me VKM-në Nr. 179, datë 28.03.2018, i cili parashikon një rritje mesatare të gjeneruesve të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme në masën 798 MW. Gjithashtu për të nxitur përdorimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.06.2018 “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”.

Legjislacioni shqiptar mbi eficientësinë e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë është në përputhje të pjesshme me *acquis* e BE-së.

Ligji Nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për Eficencën e Energjisë”, transponon pjesërisht Direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 tetorit 2012 mbi eficientësinë e energjisë, duke ndryshuar Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizuar Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE. Ky Ligj gjithashtu synon krijimin dhe zbatimin e politikave dhe rregulloreve kombëtare për nxitjen dhe përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë, me qëllim kursimin e energjisë sipas objektivave kombëtare.

Ligji Nr. 116/2016 “Për performancën energjetike të ndërtesave” është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 maj 2010 mbi performancën energjetike të ndërtesave. Ky Ligj rregullon përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave, duke marrë parasysh kushtet lokale të klimës, nivelet e komoditetit të brendshëm të një ndërtese dhe gjithashtu efektivitetin e kostos për ndërtimin e ndërtesave të reja dhe rindërtimin e ndërtesave ekzistuese.

Si një kërkesë e Ligjit Nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 852, datë 7.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë për Efiçencën e Energjisë” si institucion përgjegjës për zbatimin e politikave dhe promovimit të masave për eficientësinë e energjisë.

Lidhur me energjinë e rinovueshme, Ligji Nr. 7/2017, datë 2.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” u miratua pjesërisht i përafruar me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2009 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE.

Bazuar në Ligjin Nr. 7/2017, datë 2.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, janë miratuar aktet e mëposhtme ligjore:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 369, datë 26.04.2017 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e çmimit të blerjes për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”;

- Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 120, datë 27.07.2017, “Mbi përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MW”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 687, datë 22.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes vjetore të energjisë elektrike që duhet paguar tek prodhuesit me prioritet ekzistues”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 27, datë 17.01.2018 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneruesit e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbeturinave të ngurta duke shfrytëzuar mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”.
- Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 19, datë 19.01.2018 “Për çmimin vjetor të blerjes që duhet t’i paguhet prodhuesve me prioritet ekzistues të energjisë elektrike për vitin 2018”;
- Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës Nr. 170, datë 2.11.2017 “Për vendosjen e sasisë së energjisë që do të përdoret për masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë”;

II.3.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Enti Rregullator i Energjisë;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

II.3.3 Aktivitetet e planifikuara

II. 3.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk do të ketë ndryshime në kuadrin e politikave në sektorin e energjisë gjatë vitit 2019.

II. 3.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Në efikasitetin e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë, parashikohet miratimi i katër akteve ligjore:

- Projektligji “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport” do të miratohet në tremujorin e II-të të vitit 2019. Projektligji do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2009 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/EC

dhe 2003/30/EC. Pas miratimit të projektligjit, legjislacioni zbatues do të përgatitet dhe miratohet;

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për certifikimin e audituesit të energjisë”, do të aprovohet në tremujorin e dytë të vitit 2019, i përafshuar pjesërisht me Direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 tetor 2012 mbi efikasitetin e energjisë, ndryshimin e Direktivave 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizimin e Direktivave 2004/8/KE dhe 2006/32/KE;
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kategorive, kushtet dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherët e energjisë” do të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2019. Projektvendimi do të përafshohet pjesërisht me Direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 tetorit 2012 mbi efikasitetin e energjisë, duke ndryshuar Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe duke shfuqizuar Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE;
- Projektvendim “Për statistikën e energjisë” që transponon pjesërisht Rregulloren (KE) Nr 1099/2008 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 22 tetor 2008 mbi statistikën e energjisë. Parashikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2020.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave” që transponon plotësisht Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 maj 2010 mbi performancën energjetike të ndërtesave. Ky projektvendim i Këshillit të Ministrave do të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2019;
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Mbi metodologjinë për llogaritjen e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, njësive dhe elementeve të ndërtesave”, që transponon pjesërisht Rregulloren e deleguar të Komisionit Nr. 244/2012, të datës 16 janar 2012, që plotëson Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi performancën energjetike të ndërtesave duke krijuar një kuadër krahasimor metodologjik për llogaritjen e niveleve të kostos-optimale të kërkesave minimale të performancës së energjisë për ndërtesat dhe elementët e ndërtimit. Projektvendimi është parashikuar të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2019;
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë të ndërtesave” i cili do të përfshijë plotësisht Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 maj 2010 mbi performancën energjetike të ndërtesave. Ky vendim do të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2020;
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Mbi procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës së energjisë në ndërtesa”, që transponon plotësisht direktivën 2010/31/BE “Mbi performancën e energjisë në ndërtesa (EPBD)”. Ky vendim do të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2020.

II. 3.3.3 Aktivitete të tjera të planifikuara

Nuk ka aktivitete të tjera të planifikuara.

II.4 Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet

II.4.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Kuadri i politikave në mbrojtjen e rrezatimit përfshin tre dokumente të politikave:

- Politika për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, e përgatitur si dokumenti Nr 1319/3 e 25.03.2013 nga Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi;
- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 435, datë 14.10.2015 “Për miratimin e dokumentit ‘Hapat strategjikë për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë’”. Dokumenti është i vlefshëm për periudhën 2017 – 2030 duke përcaktuar masat që duhen marrë për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Shqipëri;
- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 434, datë 14.10.2015 “Për miratimin e dokumentit ‘Arsimi dhe trajnimi për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi jonizues dhe hapat për zbatimin e tij’”, që përcakton masat për trajnimin e personelit që merret me materiale radioaktive.

Akti kryesor ligjor në mbrojtjen e rrezatimit është Ligji Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, i ndryshuar, pjesërisht i përafuar me Direktivën e Këshillit 2013/59/Euratom të 5 dhjetorit 2013 që përcakton standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen kundër rreziqeve që dalin nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues dhe shfuqizimin e Direktivave 89/618/Euratom, 90/641/Euratom, 96/29/Euratom, 97/43/Euratom dhe 2003/122/Euratom. Kjo direktivë është e përafuar pjesërisht me:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 7.01.2010 “Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Shqipëri”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 9, datë 7.01.2010 “Për miratimin e Rregullores për kategorizimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 7.01.2010 “Për miratimin e Rregullores për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me rrezatim jonizues”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 481, datë 25.07.2012 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë e publikut ndaj ekspozimit ndaj burimeve të rrezatimit jonizues”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 543, datë 7.07.2010 “Për miratimin e Rregullores për punën e sigurtë me burimet e rrezatimit jonizues”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 590, datë 18.08.2011 “Për miratimin e Rregullores për mbrojtjen e punëtorëve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 877, datë 30.10.2015 “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen fizike të materialeve radioaktive”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 957, datë 25.11.2015 “Për miratimin e rregullores mbi nivelet e përqendrimit të radonit të brendshëm dhe përqendrimin radioaktiv në mallra, me qëllim mbrojtjen e publikut”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 638, datë 7.09.2016 “Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 815, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Rregullores për transportin e sigurt të materialeve radioaktive”.

Përveç kësaj, në fushën e mbrojtjes bërthamore dhe rrezatimit, Shqipëria ka ratifikuar konventat e mëposhtme ndërkombëtare:

- Konventa e përbashkët për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të përdorur dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive, ratifikuar me Ligjin Nr. 10379, datë 24.02.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e bashkuar “Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive” i cili hyri në fuqi më 27.09.2011;
- Konventa për Sigurinë Bërthamore, ratifikuar me Ligjin Nr. 10380, datë 24.02.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Sigurinë Bërthamore”, që ka hyrë në fuqi më 27.09.2011;
- Konventa mbi Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore, ratifikuar me Ligjin Nr. 8853, datë 31.01.2002 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore’”, hyrë në fuqi më 4.04.2002. Amendamentet e Konventës për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore të ratifikuara me Ligjin Nr. 88/2013, datë 21.02.2013 “Për ratifikimin e ndryshimeve në Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore”, hynë në fuqi më 6.03.2013;
- Konventa për njoftimin e hershëm të një aksidenti bërthamor, e ratifikuar me Ligjin Nr. 9026, datë 13.03.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për njoftimin e hershëm të një aksidenti bërthamor’”, që hyri në fuqi më 30.10.2003;
- Konventa për ndihmën në rastin e një aksidenti bërthamor ose të emergjencave radiologjike, ratifikuar me Ligjin Nr. 9015, datë 20.02.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për ndihmë në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjik”, e cila hyri në fuqi më 31.05.2003;
- Konventa mbi protokollin shtesë, ratifikuar me Ligjin Nr. 10314, datë 16.09.2010 “Për ratifikimin e Protokollit Shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për zbatimin e garancive për të gjitha aktivitetet bërthamore në Shqipëri”, e cila hyri në fuqi më 3.11.2010.

II.4.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

- Agjencia Kombëtare Bërthamore;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi.

II.4.3 Aktivitetet e planifikuara

II.4.3.1 Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk është planifikuar miratimi i ndonjë dokumenti politikash në periudhën 2019 – 2021.

II.4.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Prioriteti kryesor në mbrojtjen e rrezatimit është përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së. Në këtë drejtim, për përafrimin e pjesshëm të Direktivës së Këshillit 2013/59/Euratom të 5 dhjetorit 2013, që përcakton standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen nga rreziqet që dalin nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues dhe shfuqizon Direktivat 89/618/Euratom, 90/641/Euratom, 96/29/Euratom, 97/43/Euratom dhe 2003/122/Euratom, projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e publikut, punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht dhe sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimit jonizues”, do të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2019.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 ZMR do të përgatisë dhe një rregullore të re mbi “Dekomisionimin e qendrave që përdorin burime jonizuese”. Kjo rregullore do të bazohet në kërkesat e ANEA-s si dhe do të marrë në konsideratë dokumentin TECDOC-1816 të ANEA-s mbi “Modelin e Rregullores për dekomisionimin e qendrave”. Kjo rregullore do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave në tremujorin e katërt të vitit 2020.

II.4.3.3 Aktivitete të tjera të planifikuara

Nuk është parashikuar miratimi i akteve të tjera ligjore ose masave të tjera që lidhen me mbrojtjen bërthamore dhe rrezatimit.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

000 Lek

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për kapitull i institucionit koordinues	5,403,900	3,453,900	3,453,900
Buxheti total për kapitullin i institucioneve të tjera			
Buxheti total i kapitullit	5,403,900	3,453,900	3,453,900

Kapitulli 16: Tatimet

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e acquis së BE-së

Acquis në fushën e tatimit indirekt përbëhet kryesisht nga legjislacioni i harmonizuar në fushën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe akcizave. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar përfshin zbatimin e një takse të përgjithshme mbi konsumin e cila është vendosur në të gjitha fazat e prodhimit dhe shpërndarjes së mallrave dhe shërbimeve. Acquis e TVSH-së parashikon një trajtim tatimor të barabartë të transaksioneve vendase dhe jo-kombëtare. TVSH bazohet gjithashtu në parimin e neutralitetit ku tatimi i aplikuar është proporcional me çmimin, pavarësisht nga numri i transaksioneve të ndërmjetme.

Në fushën e akcizave, acquis përfshin legjislacionin e harmonizuar për produktet e fushës së energjisë duke përfshirë energjinë elektrike dhe produktet e naftës, prodhimet e duhanit dhe pijet alkoolike. Legjislacioni i BE-së përcakton strukturën e akcizës që duhet të ngarkohet, së bashku me një sistem të normave minimale për secilin grup produkti. Mallrat u nënshtrohen detyrimeve kur ato prodhohen brenda BE-së ose importohen nga një vend i tretë. Megjithatë, në parim, detyrimi i paguhet vetëm shtetit anëtar në të cilin mallrat lëshohen për konsum (me përjashtime të caktuara të kufizuara) dhe sipas normave të aplikueshme në atë Shtet Anëtar. Legjislacioni i BE-së përcakton dispozitat për prodhimin, mbajtjen, lëvizjen dhe monitorimin e mallrave të akcizës, si dhe dispozitat për lejimet e udhëtarëve. Sa i përket produkteve të akcizës, mbajtja dhe lëvizja e tyre për qëllime komerciale brenda Tregut të Brendshëm vazhdon të monitorohet nga afër për të përcaktuar tatimin përkatës.

Acquis në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë ka të bëjë me aspekte të caktuara të tatimeve të fitimit dhe shmangies së taksimit të dyfishtë. Fokusi është në eliminimin e parregullsive për aktivitetet ekonomike ndërkufitare ndërmjet ndërmarrjeve brenda Bashkimit. Kodi i Sjelljes për Taksimin e Biznesit përfaqëson një angazhim politik nga Shtetet Anëtare për të trajtuar konkurrencën e dëmshme tatimore. Shtetet Anëtare janë të detyruara të mos vendosin masa të reja të dëmshme tatimore dhe të rikthejnë ato ekzistuese.

Legjislacioni i BE-së në fushën e bashkëpunimit administrativ dhe asistencës së ndërsjellë midis autoriteteve tatimore dhe doganore të Shteteve Anëtare siguron mjete për të shkëmbyer informacione me qëllim parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangien e tyre dhe ndihmën e tyre në zbatimin e legjislacionit doganor. Informata të caktuara lidhur me tatimet dhe doganat shkëmbehen automatikisht; informacione të tjera shkëmbehen në mënyrë spontane ose pas një kërkesë.

Acquis në fushën e kapaciteteve operacionale dhe kompjuterizimit mbulon fusha të ndryshme të taksimit. Acquis për Sistemin e Shkëmbimit të Informacionit mbi Vlerën e Shtuar (VIES) parashikon shkëmbimin e drejtpërdrejtë elektronik të të dhënave ndërmjet administratave kombëtare të TVSH-së. Kjo lejon që administratat kombëtare të monitorojnë dhe kontrollojnë tregtinë brenda BE-së dhe të zbulojnë parregullsi të mundshme. Përveç kësaj, kërkohet një sistem specifik i TI (Mini One Stop Shop - MOSS) për të vendosur ndërlidhjen për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare lidhur me skemën e veçantë për shërbimet elektronike, telekomunikacionet dhe transmetimet e ofruara nga tregtarët që nuk janë të vendosur në Shtetin Anëtar, që do të thotë personat jo të tatueshëm. Rimbursimi i TVSH-së është sistemi që u mundëson tregtarëve të regjistruar të TVSH-së që të marrin rimbursimin e TVSH-së së zbritshme të paguar në një Shtet tjetër Anëtar në të cilin tregtari nuk ka ndërmarrje apo aktivitet. Bashkëpunimi administrativ përdor formatin e standardizuar elektronik që ka për qëllim komunikimin dhe kërkimin e informacionit që konsiderohet i duhur për të siguruar tatimin korrekt të aktiviteteve në çdo Shtet Anëtar. Këto forma sigurohen nga Komisioni Evropian dhe do të vendosen dhe mbështeten nga shërbimet informative të Shteteve Anëtare. Lidhur me akcizat, acquis kërkon që sistemet e IT-së t'u lejojnë Shteteve Anëtare të shkëmbejnë informacion mbi prodhuesit dhe tregtarët e produkteve të akcizës. Sisteme të tilla janë Regjistri Evropian i operatorëve (Sistemi për Shkëmbimin e të Dhënave të Akcizave - SEED) dhe sistemi për monitorimin e Shërbimeve Qendrore / Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Akcizat (CS/MISE). Lëvizjet e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit mbikëqyren brenda BE-së nëpërmjet Sistemit Elektronik të Lëvizjes dhe Kontrollit të Akcizës (EMCS). Në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë, Shtetet Anëtare duhet të vendosin një sistem të shkëmbimit automatik të informacionit për pesë kategori të të ardhurave dhe kapitalit (të ardhurat nga punësimi, tarifatat e drejtorëve, pensionet, produktet e sigurimit të jetës dhe pronësia e të ardhurave nga pronat e paluajtshme (dividentë, fitime kapitale, të ardhura të tjera të gjeneruara në lidhje me pasuritë e mbajtura në një llogari financiare, çdo shumë në lidhje me faktin nëse një institucion financiar është obliguesi apo debitori, duke përfshirë pagesat e riblerjes, balancat e llogarisë) përmes formave të kompjuterizuara standarde. Përdorimi i formave standarde dhe formateve kompjuterike parashikohet edhe në fushën e informacionit të shkëmbyer sipas spontanisht dhe pas një kërke.

I.1.2. Kërkesat sipas MSA-së

Neni 98 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon se, Shqipëria dhe BE-ja do të vendosin bashkëpunimin në fushën e tatimeve, duke përfshirë masat që synojnë reformimin e mëtejshëm të sistemit fiskal dhe ristrukturimin e administratës tatimore, me qëllim që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e taksave dhe luftën kundër evazionit fiskal. Për më tepër, ky bashkëpunim duhet të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e BE-së në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Në këtë drejtim, Shqipëria dhe BE-ja e njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë mospagimin ose evazionin tatimor. Gjithashtu, Neni

98 i MSA kërkon konsultime ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së me qëllim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve midis Shteteve Anëtare të BE-së dhe Shqipërisë, për të siguruar një nivel të barabartë për sa i përket tatimit të biznesit.

I.2. Situata aktuale/Përmbledhje

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e tatimeve. Njëfarë progresi është bërë, veçanërisht në përafrimin e legjislacionit me acquis-në për procedurat tatimore, në zhvillimin e mëtejshëm organizativ të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), në zbatimin e planit të veprimit kundër ekonomisë informale dhe pajtueshmërisë së taksave. Performanca e të ardhurave për vitin 2018 (të dhënat e 9 muorit 2018 janar-shtator 2018) është mbi nivelet e vitit 2017 (+5.4 %).

Në fushën e tatimit të tërthortë, norma standarde e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) është 20%. Që nga qershori 2017, një normë e reduktuar prej 6% aplikohet për shërbimet e akomodimit turistik. Përfshirjet nga TVSH për furnizimet pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së janë kryesisht në përputhje me acquis.

Me qëllim formalizimin e tregut të lirë dhe uljes së barrës së tatimpaguesit, u bënë ndryshime në ligjin dhe VKM për TVSH-në, të miratuara me Ligjin nr. 107/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me VKM Nr. 652, datë 10.11.2017, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Zbatimi i këtij ndryshimi ligjor ka filluar në datë 01.04.2018, duke i lënë kohën e mjaftueshme tatimpaguesit për njohjen e ligjit.

Taksimi i akcizës është pjesërisht në përputhje me acquis të BE-së. Markimi i vajrave minerale është bërë për disa kategori. Akciza e duhanit do të rritet gradualisht gjatë 3 viteve të ardhshme, nga 5850 lekë për 1000 cigare nga 1 janari 2018, në 6500 lekë nga 1 janari 2021. Që nga viti 2016, niveli i taksimit mbi puro dhe cigarillos të prodhuara në vend me gjethe duhani rritur në Shqipëri është vendosur në 2500 lekë/kg krahasuar me 4400 lekë/kg për të importuarat, në një përpjekje për të luftuar ekonominë informale. Prodhuesit e vegjël të pijeve alkoolike gëzojnë norma tatimore të reduktuara. Për konsum personal, sasitë deri në 100 litra për pije alkoolike dhe deri në 200 litra për verë janë të përjashtuara nga tatimi. Ligji kombëtar i TVSH-së përfshin të gjitha produktet e energjisë elektrike të listuara në Direktivën 2003/96/KE.

DPT miratoi planin vjetor të veprimit 2017 për luftën kundër ekonomisë informale dhe e zbatoi atë në përputhje me rrethanat.

I.3. Prioritetet

Aktualisht, legjislacioni fiskal shqiptar është pjesërisht në përputhje me *acquis* e BE-së dhe për këtë arsye një nga prioritetet kryesore është përafrimi i plotë i legjislacionit me *acquis*-në e BE-së. Në një periudhë afat-mesme, fokusi ynë kryesor do të jetë përafrimi i mëtijshëm i strukturës dhe normave të akcizës me *acquis*. Gjithashtu, vazhdon të jetë prioritet zbatimi i legjislacionit të përafruar me *acquis* për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Ky ligj ka përafruar legjislacionin shqiptar me Direktivën 2006/112/KE.

Pas krijimit të kadastrës fiskale, një nga objektivat kryesore është vendosja e bazës së informacionit për tatimin e ri të pronës. Qëllimi i kadastrës është të konsolidojë dhe të përmirësojë cilësinë e të gjitha të dhënave ekzistuese mbi tokën, ndërtesat dhe pronarët / banorët dhe për të llogaritur obligimet vjetore tatimore të lidhura me secilën pronë. Objektiva të tjera janë përpjekjet e mëtijshme për të negociuar marrëveshje të tatimit të dyfishtë, veçanërisht me shtetet e BE-së, si dhe adresimi i përsëritjes së vonesave në rimbursimet e TVSH dhe evitimi i shumave të mëdha të borxheve.

Lidhur me politikat tatimore prioritet mbetet përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si edhe përmirësimi i administrimit të tatimeve në rritjen e bazës së tatueshme. Ky objektiv strategjik do të realizohet nëpërmjet:

- harmonizimit të politikave tatimore me *acquis* e BE-së;
- krijimit të klimës së biznesit të favorshme për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja;
- formulimit të politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë;
- përmirësimit të menaxhimit të administratës tatimore, duke u bazuar në realizimin e të ardhurave me profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, me një standard që krijon besueshmëri tek qytetarët dhe kredibilitet me partnerët ndërkombëtarë dhe komunitetin e biznesit, vendas dhe të huaj.

II.1. Tatimi i tërthortë: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar dhe detyrimet e akcizës

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Politikat tatimore mbulohen nga Plani Strategjik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve 2017-2021, ndërsa çështjet specifike për tatimin e tërthortë mbulohen nga Strategjia e Financave Publike 2018-2022.

Ligji Nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2008/118/EC të datës 16 dhjetor 2008 lidhur me aranzhimet e përgjithshme të akcizës dhe shfuqizimin e Direktivës 92/12/EEC.

Ligji Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2006/112/EC të datës 28 nëntor 2006 mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfaqësuar kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale harton ligjet fiskale, duke respektuar programin ekonomik dhe bën një analizë të thellë të ekonomisë dhe të rajonit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është Institucioni Kryesor Tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të zbatuar ligjet tatimore, duke administruar taksat dhe tarifatat kombëtare, të përcaktuara me ligjet përkatëse. Qëllimi kryesor i DPT është të ndihmojë tatimpaguesit që të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e aplikueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga këto taksa të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke u ofruar tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

II.1.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.1.3.1. Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.1.3.2. Masat ligjore të parashikuara

N/A

II.2. Tatimi i drejtpërdrejtë

Ligji i ri për tatimin mbi të ardhurat është planifikuar të miratohet në vitin 2020.

II.2.1. Kuadri politik dhe ligjor

Politikat tatimore mbulohen nga Plani Strategjik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve 2017-2021, ndërsa çështjet specifike për tatimin e drejtpërdrejtë mbulohen nga Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2018-2022.

II.2.2. Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Financave (përfaqësuar kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale harton ligjet fiskale, duke respektuar programin ekonomik dhe bën një analizë të thellë të ekonomisë dhe të rajonit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është institucioni kryesor tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të zbatuar ligjet tatimore, duke administruar taksat dhe tarifat kombëtare, të përcaktuara me ligjet përkatëse. Qëllimi kryesor i DPT është të ndihmojë tatimpaguesit që të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e aplikueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga këto taksa të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke u ofruar tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

II.2.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.2.3.1 Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.2.3.2 Masat ligjore të parashikuara

Ligji i ri për tatimin mbi të ardhurat, lidhur me shkrirjen dhe bashkimin është planifikuar të miratohet në vitin 2020. Me këtë ligj do të transpozohet pjesërisht Direktiva 2009/133/EC e datës 19 tetor 2009 mbi sistemin e përbashkët tatimor të zbatueshëm për bashkimet, shkrirjet, shkrirjet e pjesshme, transferimet e aseteve dhe shkëmbimet e aksioneve në lidhje me kompanitë e Shteteve të ndryshme Anëtare dhe për transferimin e zyrës së regjistruar të SE ose SCE ndërmjet Shteteve Anëtare.

Për shkak të nevojave të tregut, në vitin 2020, është planifikuar ndryshimi i ligjit për tatimin mbi të ardhurat, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, duke transpozuar pjesërisht Direktivën 2009/133/EC. Pritet të rregullojë më tej çështjet që kanë të bëjnë me tatimin mbi të ardhurat personale dhe të korporatave. Objektivi kryesor është miratimi i rregullave dhe procedurave të qarta për më pak burokraci dhe më pak nevojë për interpretim.

II.3 Bashkëpunimi administrativ dhe ndihma e ndërsjellë

II.3.1. Kuadri politik dhe ligjor

N/A

II.3.2. Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Financave (përfaqësuar kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale harton ligjet fiskale, duke respektuar programin ekonomik dhe bën një analizë të thellë të ekonomisë dhe të rajonit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është institucioni kryesor tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të zbatuar ligjet tatimore, duke administruar taksat dhe tarifat kombëtare, të përcaktuara me ligjet përkatëse. Qëllimi kryesor i DPT është të ndihmojë tatimpaguesit që të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e aplikueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga këto taksa të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke u ofruar tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

II.3.3. Masat e parashikuara 2019-2021

N/A

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

Në lekë

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total i institucionit përgjegjës për këtë kapitull	N/A	900.000	0
Buxheti total i institucioneve të tjera kontribuuese për këtë kapitull	N/A	N/A	0
Buxheti total për kapitullin	N/A	900.000	0

Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e acquis së BE-së

Acquis në fushën e politikës ekonomike dhe monetare rregullohet nga Titulli VIII (nenet 119 deri 144) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), dhe nga legjislacioni përkatës zbatues. Dispozitat e Traktatit që lidhen me miratimin e euros nuk zbatohen për Shtetet Anëtare me një përjashtim të përkohshëm siç përcaktohet në Nenin 139 të TFEU.

Legjislacioni përmban rregulla specifike që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore në Shtetet Anëtare, duke ndaluar financimin e drejtpërdrejtë të sektorit publik nga bankat qendrore dhe duke ndaluar qasjen e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet Anëtare i konsiderojnë politikat e tyre ekonomike si një çështje me interes të përbashkët dhe i nënshtrohen një mbikëqyrje më të gjerë fiskale, ekonomike dhe financiare. Ata janë të detyruar gjithashtu t'i përmbahen rregullave të detajuara në lidhje me karakteristikat e kuadrit të tyre kombëtar në fushën e buxhetit. Shtetet e reja Anëtare duhet të përmbushin gjithashtu kriteret e përcaktuara në Traktat në mënyrë që të jenë në gjendje të adoptojnë euron në kohën e duhur pas anëtarësimit. Deri atëherë, ata do të jenë një Shtet Anëtar me përjashtim nga përdorimi i euros dhe do të trajtojnë politikat e tyre të kursit të këmbimit si një çështje me interes të përbashkët.

Acquis përbëhet kryesisht nga dispozitat dhe protokollet e Traktatit, si dhe rregulloret dhe vendimet që nuk kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, siç tregohet në nenin 131 të TFBE, secili Shtet Anëtar do të sigurojë që legjislacioni i tij kombëtar, duke përfshirë edhe statutet e bankës qendrore, të jetë në përputhje me TFBE dhe Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane (Statuti i ESCB/ECB). Rregulloret sipas këtij kapitulli u kërkojnë shteteve anëtare të identifikojnë rreziqet e mundshme, parandalojnë ose korrigjojnë çdo deficit fiskal të tepërt si dhe pabarazitë makroekonomike të dëmshme. Direktiva 2011/85 përcakton kërkesat për kuadret buxhetore të Shteteve Anëtare dhe kërkon transpozimin në rendin juridik dhe administrativ të vendit.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Neni 87 i MSA-së përcakton bashkëpunimin në fushat e politikave ekonomike dhe tregtare, duke theksuar se Komuniteti dhe Shqipëria do të lehtësojnë procesin e reformës ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar të kuptuarit e bazave të ekonomive të tyre përkatëse dhe formulimit e zbatimit të politikës ekonomike në ekonomitë e tregut. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, Komuniteti mund të ofrojë asistencë të dizenuar për të mbështetur përpjekjet e

Shqipërisë për krijimin e një ekonomie tregu funksionale dhe përafrimin gradual të politikave të saj me politikat e orientuara drejt stabilitetit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

I.2 Situata aktuale/Përmbledhje

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Njëfarë progresi është bërë, veçanërisht në fushën e politikës fiskale ku u zbatuan rregulla të reja për reduktimin e borxhit dhe ekzekutimin e buxhetit në vitet zgjedhore.

Në fushën e politikës monetare, Banka e Shqipërisë është e pavarur financiarisht dhe ka kapacitete të mjaftueshme administrative për të funksionuar në mënyrë efektive. Objektivi kryesor i bankës qendrore, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën e Shqipërisë, është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Banka e Shqipërisë ka përcaktuar stabilitetin e çmimeve në nivelin e rritjes vjetore prej 3% të çmimeve të konsumit dhe synon të mbajë inflacionin e çmimeve të konsumit në atë nivel në periudha afat-mesme dhe afat-gjata. Politika monetare kryhet nëpërmjet një paket instrumentesh standarde dhe brenda një regjimi të lirë të kursit të këmbimit. Rezervat valutore mbahen në një nivel adekuat.

Në fushën e politikës ekonomike, tabelat e njoftimit të EDP-së dërgohen rregullisht në Eurostat në bazë të përpjekjeve më të mira. Një Memorandum Mirëkuptimi u nënshkrua në vitin 2016 ndërmjet Institutit të Statistikave, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave për të përmirësuar më tej raportimin e statistikave fiskale sipas kërkesave të Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010). Përgatitjet për pjesëmarrje në procedurat e mosbalancimit makroekonomik (MIP) kanë filluar në Bankën e Shqipërisë dhe në Institutin e Statistikave. Shqipëria paraqiti në kohë ERP-in 2018-2020.

I.3. Prioritetet

Prioritetet e kapitullit janë si më poshtë:

- Ndërmarrja e masave për të harmonizuar më tej legjislacionin me acquis në lidhje me pavarësinë dhe llogaridhënien e Bankës së Shqipërisë
- forcimi i mekanizmit të qeverisë për koordinimin dhe konsultimin e politikave me palët e interesuara jo-qeveritare kur formulohen reformat prioritare sektoriale
- përafrimi i mëtejshëm me Direktivën mbi Kërkesat për Kuadrin Buxhetor
- plotësimi i boshllëqeve për statistikën ndër-vjeçare
- transmetimet e rregullta të statistikave të deficitit qeveritar dhe të borxhit dhe statistikave të financave të qeverisë
- harmonizimi i statistikave fiskale me ESA 2010.

II.1. Politika monetare

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Aktualisht, Ligji i Bankës së Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me *acquis* e BE-së. Megjithatë një pjesë e madhe e dispozitave të tij janë përafruar, është e nevojshme të punohet më tej për të plotësuar parimet e përgjithshme të *acquis* së BE-së dhe rekomandimeve të KE-së lidhur me forcimin e pavarësisë së saj.

Dokumenti i Politikës Monetare përcakton kuadrin e politikës monetare. Është rishikuar në janar 2105. Ky dokument i ri përshkruan regjimin e shënjestrimit të inflacionit, kuadrin teorik që udhëheq formulimin e politikës monetare dhe instrumentet e përdorura për zbatimin e saj. Vendimet e politikës monetare bazohen në devijimet e inflacionit nga objektivi dhe vlerësimi i pritjeve të inflacionit për periudhën e ardhshme. Kuadri aktual i politikës monetare, i njohur si regjimi i shënjestrimit të inflacionit, është komplementar me regjimin e lirë të luhatjeve të kursit të këmbimit.

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

Politika monetare në Republikën e Shqipërisë është një detyrë dhe e drejtë ekskluzive e Bankës së Shqipërisë. Është formuluar për të përmbushur objektivin kryesor: arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Koordinimi i punës për formulimin, miratimin dhe zbatimin e politikës monetare në Bankën e Shqipërisë realizohet nëpërmjet strukturave të mëposhtme:

- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, i cili është përgjegjës për formulimin dhe miratimin politikës monetare dhe tëkuadrin rregullativ për zbatimin e politikës monetare në Republikën e Shqipërisë. Ai përcakton normën bazë të interesit në operacionet e tregut të hapur të Bankës së Shqipërisë, normën e interesit për depozitat e mbajtura në Bankën e Shqipërisë, normat e zbritjes dhe të huadhënies së Bankës së Shqipërisë dhe nivelin e kërkuar të rezervës së detyruar që bankat tregtare duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë;
- Departamenti i Politikës Monetare mbështet Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në formulimin, zbatimin dhe vlerësimin e efikasitetit të politikës monetare, me qëllim arritjen e objektivit ligjor parësor të Bankës;
- Departamenti i Operacioneve Monetare zbaton politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, menaxhon rezervën valutore, llogarinë qendrore të Ministrisë së Financave dhe tregun primar, si dhe regjistrin e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Bankës së Shqipërisë;

- Departamenti i Kërkimeve kontribuon me punën e tij kërkimore për thellimin e njohurive mbi fenomenet ekonomike dhe ndihmon në krijimin e një politike të shëndoshë monetare dhe të vendimeve të mbikëqyrjes bankare;
- Komiteti për Zbatimin dhe Këshillimin e Politikës Monetare, një organ ndër-departamental në Bankën e Shqipërisë, i cili merr vendime në lidhje me ndërhyrjet në tregun e parasë dhe tregun e brendshëm valutor dhe ka rolin e këshilltarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipëria për çështjet që lidhen me qëndrimin e politikës monetare.

II.1.3 Masat e parashikuara 2018-2020

II.1.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

N/A

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara

1. Projekt-ligji për ndryshimin e ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është planifikuar për miratim brenda vitit 2019. Ky ligj ka për qëllim përshtatjen e mëtejshme me dispozitat e Protokollit 4 të Statutit të Bankës Qendrore Evropiane, Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë.

II.1.3.3 Masa të tjera të planifikuara

N/A

II.2 Politika ekonomike

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Si vend kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria paraqet një herë në vit në Komisionin Evropian Programin e Reformave Ekonomike (ERP).

ERP për periudhën 2018-2020 paraqet prioritetet kryesore, politikat dhe reformat e qeverisë shqiptare dhe Bankës së Shqipërisë në aspektet ekonomike. Ky program bazohet në Ligjin nr.

130/2016 "Për Buxhetin e 2017" dhe në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2019-2021, të miratuar në janar 2018¹⁶.

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal parashikojnë:

- PBB. Rritja reale ekonomike parashikohet të vazhdojë përsheptimin gradual nga 3.9% në 2017 në rreth 4.5% në vitin 2021.
- Shkalla e papunësisë. Objektivi kryesor është që norma e papunësisë vazhdon të bjerë, me një normë papunësie prej 13.9% për 2017, duke arritur një nivel prej 10.6% në vitin 2021.
- Deficitet fiskale. Ky kuadër fiskal synon një deficit total fiskal prej 1.7 përqind të PBB-së për vitin 2019, nga 2.0 përqind të programuar për vitin 2018; 1.2 përqind e PBB-së në vitin 2020; dhe 0.5 për qind në vitin 2021. Parashikimi i vitit 2017 është 2% e Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndërsa skenari më i mirë është arritja e deficitit prej -0.5% në vitin 2021. Të ardhurat totale pritet të arrijnë një nivel mesatar prej 28.1% të PBB-së për periudhën afatmesme 2019-2021, me një parashikim prej 28.5% të PBB-së për vitin 2017, ndërsa shpenzimet totale parashikohet të arrijnë një nivel prej 29.2% të PBB-së në periudhën afatmesme 2017 - 2019, me një parashikim prej 30.5% të PBB-së për vitin 2017.
- Borxhi publik. Ky objektivi mbetet i rëndësishëm për arritjen e objektivave të qeverisë. Konsolidimi fiskal do të mundësojë që niveli i borxhit publik në raport me PBB-në të vazhdojë trajektoren në rënie të nisur që nga viti 2016. Borxhi publik pritet të bjerë rreth 66.4 përqind të PBB-së deri në 2019, 63.5 përqind në 2020 dhe më tej në 59.9 përqind në 2021.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës fiskale në Shqipëri.

Në mënyrë të veçantë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është struktura përgjegjëse për zbatimin e politikës fiskale me qëllim arritjen e stabilitetit makroekonomik. Ajo është përgjegjëse për analizën makroekonomike dhe fiskale dhe parashikimet në përputhje me programet e zhvillimit ekonomik të vendit.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Politikave Fiskale përbëhet nga dy drejtori:

- Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave, e cila është përgjegjëse për analizën e vazhdueshme të zhvillimeve ekonomike makroekonomike, parashikimin afatshkurtër,

¹⁶Miratuar nga Këshilli i Ministrave, më datë 17.01.2018, Nr.25

afatmesëm dhe afatgjatë të ecures së ekonomisë dhe për parashikimin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të burimeve buxhetore, si dhe rekomandon objektivat kryesorë afatshkurtër dhe afatmesëm të politikës fiskale, duke synuar një kurs optimal të politikës fiskale në përputhje të plotë me zhvillimet dhe perspektivat makroekonomike të vendit. Dokumenti kryesor përmes të cilit materializohen dhe formulohen përgjegjësitë e mësipërme të kësaj drejtorie, është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 29.01.2014 për Kornizën Makroekonomike dhe Fiskale Afat-mesme dhe Afat-gjatë dhe rishikimet periodike të saj. Drejtoria e Makroekonomisë përbëhet nga 7 punonjës.

- Drejtoria e Politikës Fiskale, e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave tatimore dhe të ligjit të taksave në vend, duke zhvilluar një model të plotë fiskal. Ajo ka në përbërjen e saj 6 punonjës.

II.2.3 Masat e parashikuara 2018-2020

II.2.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

Qeveria do të miratojë Programin Ekonomik dhe të reformave 2019-2021 deri në fund të vitit 2018.

Do të vijojë gjithashtu me miratimin e Dokumentit të Politikave mbi Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal.

II.2.3.2 Masat ligjore të planifikuara

N/A

II.1.3.3 Masa të tjera të planifikuara

N/A

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

N/A

Aktivitetet në lidhje me Bankën e Shqipërisë do të financohen nga buxheti i Bankës së Shqipërisë, jo nga buxheti i shtetit.

III.2 Fondet e planifikuara të ndihmës së huaj

N/A

Kapitulli 18: Statistikat

I.1. Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e acquis së BE-së

Acquis në fushën e statistikave përbëhet pothuajse ekskluzivisht nga legjislacioni i cili është direkt i zbatueshëm në Shtetet Anëtare siç janë Rregulloret e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Vendimet dhe Rregulloret e Komisionit. Acquis statistikore përmban gjithashtu një gamë të gjerë të manualeve metodologjike në fusha të ndryshme statistikore si bujqësia, politikat ekonomike dhe monetare, statistikat demografike dhe sociale dhe kërkimet. Marrëveshjet ndërkombëtare ose standardet ndërkombëtare si kodi i praktikës në statistika ofrojnë një bazë tjetër për prodhimin statistikor.

I.1.2. Kërkesat sipas MSA-së

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar për statistikat zyrtare me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 70 dhe 88 të MSA-së.

Neni 88 parashikon se “bashkëpunimi midis palëve do të përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis të Komunitetit në fushën e statistikave. Kjo do të synojë në veçanti zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna krahasimore, të besueshme, objektive dhe të sakta të nevojshme për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformën në Shqipëri. Ai gjithashtu do të mundësojë Institutit të Statistikave të Shqipërisë që të plotësojë më mirë nevojat e klientëve të saj kombëtarë dhe ndërkombëtarë (si administratës publike, ashtu edhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të prodhuara nga Kombet e Bashkuara, Kodi Statistikor Evropian i Praktikës dhe dispozitat e Ligjit Evropian Statistikor dhe të zhvillohet drejt acquis të Komunitetit”.

I.2. Situata aktuale/Përmbledhje

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për prodhimin e statistikave zyrtare. Në shumë fusha statistikore, janë bërë disa përparime pas miratimit të Programit Zyrtar të Statistikave për vitet 2017-2021 dhe kuadrin ligjor. Instituti i Statistikave (INSTAT) ka nënshkruar disa marrëveshje me ofruesit e të dhënave për akses në të dhënat administrative për të lehtësuar përdorimin statistikor të këtyre të dhënave. Gjithashtu, INSTAT ka nënshkruar një sërë memorandumesh dhe në vitin 2018 është angazhuar në rishikimin e memorandumëve të nënshkruara me qëllim përshtatjen me standardet e reja të përcaktuara në ligjin e ri për statistikat zyrtare. INSTAT ka përmirësuar gamën dhe cilësinë e statistikave që boton.

Lidhur me infrastrukturën statistikore, Ligji Nr. 17/2018, datë 05.04.2018 “Për statistikën zyrtare” ka hyrë në fuqi më datë 13 maj 2018. Ky ligj është përgatitur dhe miratuar në tërësi me një strukturë të re, në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe Rregullores EC 223/2009. Në nenet 4 dhe 5 të ligjit të ri janë specifikuar 15 parimet e Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane që do të zbatohen nga Sistemi Statistikor Kombëtar në Shqipëri. Kjo e bën INSTAT një institucion të pavarur, duke e pozicionuar atë në një nivel më të lartë hierarkie nën piramidën e administratës publike, duke raportuar drejtpërdrejt në Parlamentin Shqiptar.

Si rezultat i ligjit të ri, INSTAT ka një autonomi më të madhe në menaxhimin e burimeve të saj. Në vitin 2018 stafi i INSTAT ka një nivel më të lartë pagash, ndërkohë që numri i stafit u rrit me 10 persona.

Sa i përket statistikave makroekonomike, të dhënat e PBB-së vjetore dhe tremujore vazhdojnë të prodhohen bazuar në metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, në çmimet aktuale dhe konstante. Në maj të vitit 2018, INSTAT publikoi për herë të parë prodhimin dhe gjenerimin e llogarive të të ardhurave nga sektorët institucionalë për vitet 2013-2015. Këto të dhëna janë transmetuar në EUROSTAT. Tabelat e Burim – Përdorimeve dhe tabelat e input-outputeve janë prodhuar dhe harmonizuar me konceptet dhe përkufizimet e Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010). Në tetor 2018, tabelat e Burim - Përdorimeve u publikuan për vitin referues 2015. Në fillim të 2018, INSTAT transmetoi për herë të parë tabelat e Burim - Përdorimeve në Eurostat me SDMX. Ky transmetim në Eurostat do të vazhdojë rregullisht edhe për vitet në vijim. Një herë në vit Produkti i Brendshëm Bruto prodhohet rregullisht nga mënyra e prodhimit dhe shpenzimeve, në çmimet aktuale dhe në vazhdimësi (me çmimet e vitit të kaluar). Koha e publikimit reduktohet me pothuajse 2 muaj (T + 15).

Llogaritë rajonale janë prodhuar dhe botuar rregullisht. Më 18 qershor 2018 u publikua PBB-ja rajonale dhe komponentët e saj për vitin 2016. Koha e publikimit është zvogëluar për pothuajse 2 muaj (T + 17).

Tabelat e njoftimit të procedurave të deficitit të tepërt dërgohen rregullisht (dy herë në vit) në Eurostat. INSTAT ka dërguar njoftime mbi EDP që nga viti 2014, me dërgimin e fundit në prill 2018, për vitet 2013-2017 duke përdorur EDAMIS në formatin SDMX.

INSTAT po ndjek ESA2010 TP dhe po bën përpjekje të mëtijshme në rritjen e numrit të tabelave të dërguara në EUROSTAT. Gjatë vitit 2018, përveç transmetimit të rregullt, janë transmetuar gjashtë tabela të reja (Tabela 0117, Tabela 302, Tabela 0501, Pjesërisht Tabela 0800, Tabela 1500 dhe Tabela 1600).

Në mars të vitit 2018, INSTAT publikoi dhe transmetoi për herë të parë komponentët kryesorë tremujorë të qasjes së shpenzimeve për të dhënat e rregulluara sezonalisht për periudhën 2008Q1-2018Q2. Në maj të vitit 2018, INSTAT publikoi për herë të parë prodhimin dhe gjenerimin e llogarive të të ardhurave nga sektorët institucionalë për vitet 2013-2015. Këto të

dhëna janë transmetuar në EUROSTAT. Ndërkohë, INSTAT-i përpilon (nuk publikon) setin e plotë të llogarive jofinanciare për Qeverinë e Përgjithshme, për periudhën 2009-2017. Përpilimet e llogarive të sektorit tremujor bazohen në vlerësimin vjetor të llogarive të sektorit si vlera referente dhe pastaj vlerësohen treguesit tremujorë. Në maj 2018, Shqipëria lëshoi për herë të parë prodhimin dhe gjenerimin e llogarive të të ardhurave në frekuencë vjetore, ndërsa vlerësimi i llogarive të sektorit tremujor ka nevojë për konsolidim të vlerësimit vjetor dhe më pas do të fillojë procesi i hartimit të llogarive tremujore të sektorit.

Në prill 2018 u botuan për herë të parë rezultatet e Statistikave Strukturore të Biznesit sipas Rajonit, të cilat kanë për qëllim të tregojnë zhvillimin dhe strukturën e aktiviteteve ekonomike sipas rajoneve. INSTAT filloi për herë të parë në shkurt 2018 pilotin e PRODCOM për mbledhjen e të dhënave.

INSTAT prodhon dhe publikon Indeks të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (HICP). Shpenzimet klasifikohen duke përdorur Klasifikimin Evropian të Konsumit Individual sipas qëllimit ECOICOP-5 shifror. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për çmimin e administrimit (HICP_AP) është zhvilluar në vitin 2018 dhe aktualisht INSTAT po punon për të zhvilluar indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit për taksën konstante (HICP_CT).

Statistikat afatshkurtra publikohen rregullisht çdo tremujor. Që nga tremujori i parë 2018, disa nga treguesit kryesorë afatshkurtra transmetohen rregullisht në Eurostat. Sipas statistikave të çmimeve, sondazhi i Indeksit të Çmimeve të Prodhimit të Shërbimit kryhet rregullisht nga tremujori i parë 2018.

Për statistikat sociale, Anketa e Fuqisë Punëtore kryhet rregullisht dhe mikro-të-dhënat i dërgohen Eurostat-it. Ka një punë të vazhdueshme për përmirësimin e rezultateve të AFP-së në lidhje me afatin kohor të transmetimit në Eurostat dhe raportin e cilësisë. Këto objektiva, së bashku me automatizimin e proceseve dhe projektimin e kampioneve, po përkrahen nga projekti pilot në kuadrin e IPA Shumëpërfituese 2015.

Në vitin 2016 INSTAT filloi studimin e saj të parë në shkallë të gjerë BE-SILC midis një kampioni përfaqësues bruto prej 9,216 familjesh. Grumbullimi i të dhënave është kryer duke përdorur metodën PAPI (letrës dhe lapës) gjatë periudhës korrik-shtator 2016. Gjatë muajve qershor dhe korrik 2017, INSTAT ka nisur një sondazh piloti për të testuar mundësinë e drejtimit të anketës longitudinale BE-SILC duke përdorur sistemin CAPI. Grupet e të dhënave të sondazhit SILC të vitit 2016 tashmë janë dërguar në EUROSTAT.

Bazuar në rezultatet pilot, INSTAT përditësoi pyetësoin dhe programin CAPI që do të përdoret për EU-SILC 2017. Raporti Përfundimtar u dërgua në Eurostat më 30 nëntor 2017. INSTAT realizoi në terren valën e dytë të Anketës BE-SILC gjatë periudhës tetor-dhjetor 2017 dhe vala e tretë gjatë periudhës prill-korrik 2018 në një kampion përfaqësues prej rreth 7,700 familjeve, ¼ e kampionit është tërësisht i ri. Vitin e ardhshëm do të publikohen rezultatet e para të vitit 2016-2017. Anketa e Buxhetit të Konsumatorëve (ABEF) përdoret për të matur shpenzimet e konsumit

të familjeve në Shqipëri dhe për të përditësuar Indeksën e Çmimeve të Konsumit dhe Konsumin Final në familje si një agregat i rëndësishëm i PBB-së nga shpenzimet metodë. Nga janari i vitit 2014, ABF është një studim i vazhdueshëm dhe në baza vjetore.

Për sa i përket Anketës së Turizmit në Familje “Pushime dhe Udhëtime” ka përfunduar grumbullimi, përpunimi dhe redaktimi i të dhënave për periudhën e anketës së parë të kryer gjatë periudhës Nëntor - Dhjetor 2017. Të dhënat për anketën e 2017-ës transmetohen në EUROSTAT sipas kërkesave dhe udhëzimeve të tyre. Sondazhi i 2018-ës ka filluar, deri më tani kanë përfunduar në terren faza e parë, e dytë dhe tremujori i tretë. Procesi në vazhdim është futja e të dhënave për tremujorin e tretë.

Në kuadrin e Programim IPA Shumëpërfituese 2015, INSTAT ka filluar të zhvillojë një studim të plotë të TIK-ut mbi familjen në vitin 2018, në përputhje me rregulloret e mëposhtme të BE-së: Rregullorja (EC) Nr. 808/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 21-të (EU) 2017/1515 të datës 31 gusht 2017 mbi zbatimin e Rregullores (EC) Nr. 808/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi shoqërinë e informacionit për vitin 2018. Mbledhja e të dhënave filloi në korrik 2018 dhe ka përfunduar në gusht 2018. Proceset në vazhdim janë: redaktimi i të dhënave dhe transmetimi i të dhënave në Eurostat.

Statistikat e Kostos së Punës (LCS) llogariten mbi bazën e Anketës të Kostos së Punës, e cila kryhet çdo 4 vjet. Sondazhi i dytë është nisur për periudhën prill 2017 dhe rezultatet janë publikuar në prill 2018. Raporti i mikro-të-dhënave dhe raportit të cilësisë është transmetuar në Eurostat për të qenë në përputhje me kërkesat e BE. Përgatitjet për zbatimin e Anketës së Strukturës së Fitimit në vitin 2019 kanë filluar studimin e rregulloreve dhe hartimin e pyetësorit.

Botimi vjetor i “Gratë dhe burrat në Shqipëri” është një botim periodik i cili publikohet çdo vit nga INSTAT. Në këtë botim publikohen çështjet e gjinisë dhe treguesit gjinorë dhe shpërndahen për aspekte të ndryshme si popullsia, arsimi, vendimmarrja e punës në sektorin publik dhe privat etj.

Statistikat bujqësore janë pjesërisht të përafruara me acquis të BE-së. INSTAT ka realizuar anketën vjetore bujqësore duke filluar nga viti 2016 në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të dhënat janë në fazën e përpunimit të të dhënave dhe rishikimin e serive kohore. Ky studim do të zhvillohet në baza vjetore. Gjatë muajit nëntor 2018 INSTAT ka kryer rishikimin sektorial të Statistikave Bujqësore të mbështetura nga Eurostat. Pas përfundimit të raportit përfundimtar, rekomandimi do të publikohet në faqen e internetit të Eurostat dhe të INSTAT-it.

Të dhënat përfundimtare të regjistrimit të fermave bujqësore 2012 u botuan në tetor 2017. Anketa e Strukturës së Fermave nuk është implementuar ende.

Statistikat për mjedisin dhe energjinë janë pjesërisht të përafruara me acquis të BE-së. INSTAT prodhon dhe publikon Bilancin e Energjisë Elektrike në baza tremujore dhe publikon Bilanci i Energjisë i prodhuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në baza vjetore.

Të dhënat e detajuara për statistikat e mbetjeve urbane janë në përputhje me acquis të BE-së. Llogaritë e emetimit të ajrit janë në mënyrë të kufizuar në përputhje me acquis të BE-së për shkak të mungesës së të dhënave administrative mbi inventarët e emetimeve të ajrit. Në vitin 2017, për herë të parë, INSTAT ka prodhuar të dhëna mbi rrjedhën materiale të ekonomisë dhe i ka publikuar në vitin 2018 në faqen e INSTAT.

Taksat mjedisore si pjesë e llogarive mjedisore kanë filluar të publikohen nga viti 2017 dhe do të vazhdojnë të publikohen në baza vjetore. Të dhënat për shpenzimet mjedisore ende nuk janë duke u prodhuar për shkak të mungesës së vazhdueshme të informacionit.

I.3. Prioritetet

Qëllimi kryesor i INSTAT-it është të përafrojë më tej legjislacionin e vet me acquis të BE-së në lidhje me standardet statistikore evropiane dhe të rrisë rolin e saj si koordinator i Sistemit Kombëtar të Statistikave.

Bazuar në rekomandimet e fundit të BE-së, prioritetet e identifikuara janë si më poshtë:

- INSTAT do vazhdojë të forcojë burimet duke përshtatur strukturën e saj organizative dhe të pagave, si dhe postet e nëpunësve civilë;
- Do bëhen më shumë përpjekje mbi zbatimin e legjislacionit ekzistues (siç janë programi i ri i statistikave zyrtare dhe plani vjetor për zbatimin e tij, nënshkrimi i memorandumeve të reja të mirëkuptimit dhe nxjerrja e udhëzimeve për përmirësimin e standardeve të statistikave zyrtare të prodhuara);
- Përgatitja e një Strategjie Kombëtare për zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Statistikave;
- Harmonizimi i mëtejshëm i statistikave makroekonomike me ESA 2010 dhe paraqitja e një njoftimi të plotë të procedurës së deficitit të tepruar.
- Përmirësimi i qasjes në të dhënat administrative dhe hartimi i një inventari të proceseve dhe të dhënave sistematike;
- Përmirësimi i disa fushave të statistikave sektoriale për të siguruar që të dhënat statistikore janë në dispozicion të publikut të gjerë;
- Zbatimi i programit të punës për statistikë shumëvjeçare 2017-2021 dhe vënien në dispozicion të burimeve financiare të nevojshme;
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet agjencive shtetërore dhe ministrive për të lehtësuar prodhimin efikas të statistikave të besueshme.

II.1. Infrastruktura statistikore

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Puna e Sistemit Kombëtar të Statistikave bazohet në Programin Kombëtar për Statistikat Zyrtare 2017-2021 të miratuar me VKM 10/2017, datë 9.2.2017. Ky është dokumenti kryesor që rregullon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Statistikor Kombëtar i nevojshëm për të vëzhguar gjendjen ekonomike, sociale dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet statistikore të parashikuara në Nenet 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, të cilat janë në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Programi shërben gjithashtu për të orientuar INSTAT-in dhe agjencitë e tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor të kërkuar nga standardet e acquis.

Ligji nr. 17/2018, datë 05.04.2018 “Për statistikat zyrtare” është hartuar sipas Kodit të Praktikës dhe Rregullores Evropiane të Statistikave EC 223/2009 dhe parimeve të Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane.

Baza ligjore për zhvillimin, mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e statistikave të Bankës së Shqipërisë është Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili është pjesërisht në përputhje me Rregulloren 184/2005 KE.

Aktet dhe metodologjitë e tjera politike dhe ligjore që mbulojnë këtë nënkapitull janë:

- VKM nr. 669, datë 7.11.2018 “Për miratimin e procedurave, kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u emëruar në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it”;
- VKM nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret e procedurave dhe përzgjedhjen, përfaqësimin, emërimin dhe shkarkimin, rregullat e funksionimit dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave”;
- VKM nr. 671, datë 7.11.2018 “Për vendosjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturës”;
- Strategjia afatgjatë për zhvillimin e INSTAT 2017 - 2030;
- Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë 2019 - 2021;
- Rregullorja e Bankës së Shqipërisë nr. 45, “Për Raportimin e Bankës së Shqipërisë në Sistemin e Raportimit të Unifikuar”, i ndryshuar me Vendimin nr. 80, datë 6.7.2016, e cila përafron pjesërisht Rregulloren 184/2005 KE;
- Metodologjia e Statistikave Monetare dhe Financiare, Banka e Shqipërisë - korrik 2003, pjesërisht në përputhje me Rregulloren 184/2005 KE;
- Metodologjia e Bilancit të Pagesave, Banka e Shqipërisë, dhjetor 2016, pjesërisht në përputhje me Rregulloren 1055/2008 / EC;
- Rregullorja nr. 48, datë 6 shtator 2017 “Për Raportin e Bankës së Shqipërisë për statistikën e normave të interesit”.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

INSTAT është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar të Statistikave (NSS). NSS përbëhet nga INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë. Institucionet e tjera publike kontribuojnë në prodhimin e statistikave zyrtare si ofrues të të dhënave administrative.

II.1.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.1.3.1. Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.1.3.2. Masat ligjore të parashikuara

Masat ligjore të parashikuara janë:

- Projektligji “Për Censin e Popullsisë dhe Banesave”, i cili përafron pjesërisht Rregulloren (KE) Nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009 “Mbi statistikave evropiane”, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), Nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 322/97 “Mbi Statistikat e Komunitetit”, si dhe Vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane. Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 87, datë 31.3.2009, faqe 164 – 173;
- Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021”, i cili përafron pjesërisht Rregulloren (KE) Nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009 “Mbi statistikave evropiane”, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), Nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 322/97 “Mbi Statistikat e Komunitetit”, si dhe Vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane. Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 87, datë 31.3.2009, faqe 164 – 173;
- Projektligji “Për miratimin e Planit Vjetor 2019, i cili përafron pjesërisht Rregulloren (KE) Nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009 “Mbi statistikave evropiane”, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), Nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 322/97 “Mbi Statistikat e Komunitetit”, si dhe Vendimin e Këshillit

89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane. Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 87, datë 31.3.2009, faqe 164 – 173;

- Projektligji “Për miratimin e Planit Vjetor 2020”, i cili përaftron pjesërisht Rregulloren (KE) Nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009 “Mbi statistikave evropiane”, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), Nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 322/97 “Mbi Statistikat e Komunitetit”, si dhe Vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane. Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 87, datë 31.3.2009, faqe 164 – 173;
- Projektligji “Për miratimin e Planit Vjetor 2021”, i cili përaftron pjesërisht Rregulloren (KE) Nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009 “Mbi statistikave evropiane”, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), Nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 322/97 “Mbi Statistikat e Komunitetit”, si dhe Vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane. Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 87, datë 31.3.2009, faqe 164 – 173.

II.2. Statistikat makroekonomike

II.2.1. Kuadri politik dhe ligjor

Puna e INSTAT bazohet në Programin Kombëtar për Statistikat Zyrtare 2017-2021 të miratuar me VKM 10/2017, datë 9.2.2017. Ky është dokumenti kryesor që rregullon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar i Statistikave dhe i cili është i nevojshëm për të vëzhguar gjendjen ekonomike, sociale dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet statistikore të parashikuara në Nenet 4 dhe 4/1 të Ligji mbi Statistikat, të cilat janë në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane. Programi shërben gjithashtu për të orientuar INSTAT dhe agjencitë e tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor të kërkuar nga standardet e acquis.

Aktet tjera të rëndësishme ligjore për këtë nënkapitull janë:

- Ligji Nr. 17/2018, datë 05.04.2018 “Për statistikave zyrtare” ndërtohet sipas Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane dhe Rregullores EC 223/2009. Në nenet 4 dhe 5 të ligjit të ri janë specifikuar 15 parimet e Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane që do të zbatohen nga Sistemi Statistikor Kombëtar në Shqipëri.

- VKM nr. 320, “Për zbatimin e klasifikimit të aktiviteteve ekonomike NACE Rev 2”, i cili është plotësisht i përafuar me Rregulloren 715/2010 / BE.

II.2.2. Institucionet përgjegjëse

INSTAT është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar të Statistikave. Kontribuues të tjerë janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë.

II.2.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.2.3.1 Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.2.3.2 Masat ligjore të parashikuara

N/A

II.3. Statistikat e biznesit

II.3.1. Kuadri politik dhe ligjor

Puna e INSTAT bazohet në Programin Kombëtar për Statistikat Zyrtare 2017-2021 të miratuar me VKM 10/2017, datë 9.2.2017. Ky është dokumenti kryesor që rregullon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar i Statistikave dhe i cili është i nevojshëm për të vëzhguar gjendjen ekonomike, sociale dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet statistikore të parashikuara në Nenet 4 dhe 4/1 të Ligji mbi Statistikat, të cilat janë në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane. Programi shërben gjithashtu për të orientuar INSTAT dhe agjencitë e tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor të kërkuar nga standardet e acquis.

Aktet tjera të rëndësishme ligjore për këtë nënkapitull janë:

- Ligji Nr. 17/2018, datë 05.04.2018 “Për statistikat zyrtare” ndërtohet sipas Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane dhe Rregullores EC 223/2009. Në nenet 4 dhe 5 të ligjit të ri janë specifikuar 15 parimet e Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane që do të zbatohen nga Sistemi Statistikor Kombëtar në Shqipëri.
- VKM nr. 320, “Për zbatimin e klasifikimit të aktiviteteve ekonomike NACE Rev 2”, i cili është plotësisht i përafuar me Rregulloren 715/2010 / BE.

II.3.2. Institucionet përgjegjëse

INSTAT është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar të Statistikave. Kontribuues të tjerë janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë.

II.3.3 Masat e parashikuara 2019-2021

II.3.3.1 Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.3.3.2 Masat ligjore të parashikuara

N/A

II.4. Statistikat monetare, financiare, tregtare dhe statistikat e bilancit të pagesave

II.4.1. Kuadri politik dhe ligjor

Puna e agjencive statistikore bazohet në Programin Kombëtar për Statistikat Zyrtare 2017-2021 të miratuar me VKM 10/2017, datë 9.2.2017. Ky është dokumenti kryesor që rregullon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar i Statistikave dhe i cili është i nevojshëm për të vëzhguar gjendjen ekonomike, sociale dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet statistikore të parashikuara në Nenet 4 dhe 4/1 të Ligji mbi Statistikat, të cilat janë në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane. Programi shërben gjithashtu për të orientuar INSTAT dhe agjencitë e tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor të kërkuar nga standardet e acquis.

Gjithashtu, i rëndësishëm për këtë nënkapitull është Ligji Nr. 17/2018, datë 05.04.2018 “Për statistikat zyrtare”, i cili është hartuar sipas Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane dhe Rregullores EC 223/2009. Në nenet 4 dhe 5 të ligjit të ri janë specifikuar 15 parimet e Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane që do të zbatohen nga Sistemi Statistikor Kombëtar në Shqipëri. Baza ligjore për zhvillimin, mbledhjen, hartimin dhe publikimin e statistikave të Bankës së Shqipërisë është Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Mbi Bankën e Shqipërisë”, pjesërisht në përputhje me Rregulloren 184/2005 EC.

Aktet të tjera politike dhe ligjore dhe metodologjitë që mbulojnë këtë nënkapitull janë:

- Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë 2019 – 2021;
- Rregullore e BSH Nr. 45, “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar”, i ndryshuar me vendimin nr. 80, datë 6.7.2016, e cila përafron pjesërisht Rregulloren 184/2005 EC;
- Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare, Banka e Shqipërisë - Korrik 2003, pjesërisht në përputhje me Rregulloren 184/2005 EC;
- Metodologjia e Bilancit të Pagesave, Banka e Shqipërisë, Dhjetor 2016, pjesërisht në përputhje me Rregulloren 1055/2008/EC.
- Rregullore Nr. 48, datë 6.9.2017 “Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit”.

II.4.2. Institucionet përgjegjëse

INSTAT është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, si dhe institucioni përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar të Statistikave. Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për prodhimin e statistikave monetare, financiare dhe statistikave të bilancit të pagesave.

II.4.3 Masat e parashikuara 2019-2021

II.4.3.1. Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.4.3.2. Masat ligjore të parashikuara

Përditësimi i Rregullores së Statistikave Monetare dhe Financiare në linjë me standardet ndërkombëtare është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të fundit të 2020, në përputhje me Rregulloren (EU) Nr. 1071/2013 të Bankës Qendrore Evropiane e 24 Shtatorit 2013 “Mbi bilancin e institucioneve monetare dhe financiare” (ECB/2013/33).

II.4.3.3. Akte dhe metodologji të tjera të planifikuara

Gjithashtu të parashikuara për miratim gjatë tremujorit të fundit të 2020 janë:

- Përditësimi i Manualit të Bilancit të Pagesave, pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, shërbimeve ndërkombëtare të tregtisë dhe Investimet e Huaja, i cili do jetë në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 184/2005 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 Janarit

2005 mbi statistikat e Komunitetit në lidhje me bilancin e pagesave, tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve dhe investimet e huaja direkte dhe me Rregulloren e Komisionit (EU) Nr 555/2012 e 22 Qershorit 2012 që ndryshon Rregulloren (EC) Nr. 184/2005 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi Statistikat e Komunitetit në lidhje me bilancin e pagesave, tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve dhe investimet e huaja direkte, në lidhje me përditësimin e kërkesave dhe përkufizimeve të të dhënave;

- Përditësim i Manualit të llogarive financiare, i cili do të jetë në përputhje me Udhëzimin e Bankës Qendrore Evropiane e 25 Korrik 2013 mbi kërkesat e raportimit statistikor të Bankës Qendrore Evropiane në fushën e llogarive financiare tremujore.
- Implementimi i rregullores së BQE 2015/730, ndryshuar me rregulloren e BQE nr. 1011/2012 lidhur me statistikat e letrave me vlerë.

III. Alokimet financiare

Instituti i Statistikave ka alokuar fondet e mëposhtme në lek:

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit përgjegjës	682.000	682.000	504,000

Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e acquis te Bashkimit Evropian

Në bazë të Artikullit 153 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian (TFBE), Unioni mbështet dhe plotëson aktivitetet e Vendeve Anëtare në fushën e politikave sociale.

Acquis në fushën e politikës sociale përfshin standarde minimale në fusha si, ligji i punësimit, trajtimi i barabartë i grave dhe burrave në punësim dhe politika sociale¹⁷, shëndeti dhe siguria në punë, mosdiskriminimi në punësim dhe politika sociale, gjithashtu në përfshirje sociale dhe mbrojtje.

Fondi Social Evropian (FSE) është instrumenti financiar kryesor me anë të së cilit BE mbështet zbatimin e Strategjisë së Punësimit dhe kontribuon në përpjekjet për përfshirje sociale.

Kapitulli 19 fokusohet në funksionimin e dialogut social, veçanërisht struktura e përgjithshme ligjore mbi sindikatat dhe organizimet e punëdhënësve, e drejta për të organizuar/bashkuar sindikatat, kontratat kolektive dhe veprimi industrial, e drejta e grevës, mekanizmat trepalësh të konsultimit, duke përfshirë këshillin ekonomik dhe social, dialogun/kontratën, marrëveshjet dypalëshe dhe përfshirjen e partnerëve social në dizejnimin dhe zbatimin e legjislacionit.¹⁸

Në fushën e aftësive të kufizuara, BE-ja është pjesë e Kuvendit për të Drejtat e Personave me Aftësi Ndryshe të Kombeve të Bashkuara dhe ka përshtatur një strategji që synon integrimin, përhapjen e çështjeve të aftësive të kufizuara me politikat e përshtatshme të Unionit dhe rritjen e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së njerëzve me aftësi ndryshe, njëjloj si të tjerët.

Marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura me punësimin, punën dhe çështjet sociale, siç është Kuvendi i ONP dhe Kuvendi i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njerëzve me aftësi të kufizuara, duhet të merren në konsideratë.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Detyrimi i përgjithshëm për të përafëruar ligjin Shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga Artikulli 70 i MSA-së. E ndarë nga kjo dispozitë, Shqipëria nuk ka vetëm detyrimin për të sjellë

¹⁷ Aspekte të tjera mbi punësimin dhe politikave sociale lidhur me mosdiskriminimin dhe barazisë midis grave dhe burrave janë të mbuluara nga Kapitulli 23 Drejtësia dhe të Drejtat Themelore.

¹⁸ Kapitulli 23 “Drejtësia dhe të Drejtat Themelore” mbulojnë lirinë e asambles dhe shoqërive nga një e perspektive themelore e të drejtave.

teknikisht legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të siguroje që implementohet dhe zbatohet siç duhet.

Mënjatë nga përafrimi i përgjithshëm i klauzolave të ligjit, MSA siguron gjithashtu dispozita të hartuara në mënyrë të posaçme mbi kushtet e punës dhe mundësi të barabarta. Përsa i përket Artikullit 77 MSA, Shqipëria duhet të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të Unionit në fushat e kushteve të punës, sidomos në shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mundësi të barabarta.

Detyrimet në fushën sociale dhe politikave të punësimit rrjedhin nga Artikulli 99 mbi “Zhvillimin dhe përmirësimin e Sistemit të Sigurisë Sociale”, Artikulli 48 “mbi Koordinimin e sistemeve të Mbrotjtjes Sociale për Komunitetin e Qytetarëve Punëtorë në territorin Shqiptar dhe të shtetasve Shqiptarë të punësuarve në vendet e Bashkimit Evropian.

Nenet 46, 47, 48, 77, 99 të MSA-së përcaktojnë bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, duke synuar në modernizimin dhe ristrukturimin e shërbimeve të punësimit dhe trajnimit profesional, zbatimit të programeve të punësimit aktiv dhe pasiv dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit Shqiptar dhe praktikave në fushën e tregut të punës dhe trajnimit profesional me rregullat dhe standardet e Unionit. Për më tepër, Artikulli 70 i MSA, bashkë me Artikullin 99 mbi bashkëpunimin social është i përshtatshëm në këtë fushë.

I.2. Situata Aktuale/Përmbledhje

Shqipëria ka njëfarë niveli të përgatitjes në fushën e politikave sociale dhe punësimit.

Njëfarë zhvillimi pozitiv përfshin, njëfarë progresi në rritjen e përfshirjes në tregun e punës dhe në cilësinë dhe efikasitetin e institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës, dhe në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (NESS) për 2014-2020; inicimi i ristrukturimit të qeverisjes së punësimit të përcaktuara në ligjin e rishikuar mbi trajnimin dhe edukimin profesional (VET); punësim i përmirësuar dhe statistika të zhvillimit të kapitalit njerëzor të krahasueshme me një vit më parë.

Sfidat e mbetura përfshijnë: shkalla e punësimit dhe pjesëmarrjen në tregun e punës janë akoma të ulëta, dhe ekonomia informale është akoma një ofrues pune i rëndësishëm.

Të dhënat e tregut të punës tregojnë se rritja ekonomike e përjetuar në Shqipëri gjatë katër viteve të fundit është përkthyer në përmirësime të rëndësishme të tregut të punës. Krijimi i vendeve të punës dhe rritja e punësimit kanë lëvizur sëbashku. Përmirësimi i përputhjes së gamës së profesioneve, që ofrohet nga sistemi i arsimit dhe formimit profesional, me kërkesat e tregut të punës, do të bëjë të mundur kapërcimin e një ndër pengesave kryesore që ekziston.

Për vitin 2018, është i njëjti fond (490 milionë lekë) dhe po zbatohen 8 programe të nxitjes së punësimit, duke mbështetur grupet më vulnerabël në tregun e punës.

Në kuadër të zbatimit të reformës së ndihmës ekonomike, u miratua programi i ri i nxitjes së punësimit me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 162/2018 “Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional”, i cili synon, që në kuadër të orientimit të qeverisë për aktivizimin e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe personave, që dalin nga kjo skemë, përfshirjen e tyre në programet e formimit profesional, në mënyrë që të marrin një profesion dhe të riaktivizohen në tregun e punës. Dhënia e pageses në nivelin prej 50% të pagesës së papunësisë, për çdo muaj pjesëmarrje në kurs, është një nxitje për t’i mbështetur këta persona për periudhën e daljes nga skema e ndihmës ekonomike dhe marrjen e një profesioni të kërkuar në tregun e punës, me synimin final gjetjen e një vendi të qëndrueshëm pune.

Në fushën e të drejtës së punës, në terma të zbatimit, hapa pozitivë u bënë për depozitimin dhe regjistrimin e organizatave të sapo krijuara për punëmarrësit dhe punëdhënësit në pajtim me dispozitat e Kodit të Punës.

Në lidhje me kërkesat e shëndetit dhe sigurisë në punë, objektiv parësor mbetet zbatimi i politikave OSH më të mira dhe më të dobishme dhe ligje që mund të zbatohen në mënyrë të dobishme, përfundim i procesit të zhvendosjes së direktivave OSH të BE-së, dhe zhvillimin e një inspektimi më të dobishëm OSH dhe sistemeve të menaxhimit.

Në fushën e dialogut social, prioriteti kryesor i Qeverisë përfshin angazhimet për zgjerimin e dialogut social trepalësh në nivel rajonal, duke siguruar konsultime efektive dhe reale në nivel kombëtar dhe sipas standardeve të ILO-s.

Në lidhje me politikat e punësimit, zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (NESS) 2014-2020 ka vijuar që nga fundi i vitit 2014 sipas aktivitete të parashikuara në planin përkatës të veprimit. Rezultatet e arritura përfshijnë përmirësimin e punësimit të rinjve, reduktimit të hendekut në punësim, rritjen e numrit të punëkërkuesve që u punësuan në saj të programeve të punësimit, rritjen e kapacitete të mësuesve dhe instruktorëve për arsimin dhe arsimin profesional. Bazuar në ligjin Për nxitjen e punësimit, programe të ndryshme të promovimit të punësimit, janë realizuar në vitet 2016 dhe 2017, të fokusuara në grupet vulnerabel, në trajnimet për punë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, nënat e vetme, praktikantët për të diplomuarit, jetimët, emigrantët e kthyer, punëkërkuesit që janë pjesë e skemës së mbështetjes, romët dhe viktimat e trafikimit, me një buxhet total 490 milion lek në 2016 dhe 490 milion lek në 2017.

Reforma e Shërbimit Kombëtar të Punësimit është përqendruar në një model të ri të shërbimit që po aplikohet në të gjitha Zyrat e Punësimit për të përmirësuar shërbimin ndaj klientit (punëkërkuesit dhe Punëdhënësit) dhe për të rritur depërtimin në treg.

Në lidhje me përfshirjen dhe mbrojtjen sociale, përparësitë kryesore të qeverisë të parashikuara në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale dhe Dokumentin Politik të Përfshirjes Sociale përfshin objektivat e reduktimit të varfërisë, monitorimit të politikave ndërsektoriale të përfshirjes zbatimin e reformave në fushën e mosdiskriminimit dhe krijimin e sistemit të mbrojtjes sociale.

Reforma e pensioneve ka vazhduar të zbatohet për të synuar rritjen e qëndrueshmërisë financiare të skemës përmes rritjes së të ardhurave nga kontributet, për të çuar në një mbulim të plotë të popullsisë me elementë të sigurimit social dhe përfitim të vazhdueshëm të rritjes nga kjo skemë.

Lidhur me Dokumentin e Politikave të Përfshirjes Sociale për 2016-2020, është bërë përparim në ngritjen e strukturave të nevojshme dhe në zbatimin e masave për kuadrin e indikatorëve.

Në kuadër të mosdiskriminimit në punësim dhe politika sociale, në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe anti-diskriminimit”, KMD pilotoi 3 zyra rajonale në qytetet Koçë, Gjirokastrë dhe Shkodër. Me strukturën e re, tre zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytetet Korçë, Fier, Shkodër, bëhen zyra të përhershme. Në bazë të strukturës së re, me qëllim forcimin e kapaciteteve monitoruese të KMD, janë parashikuar specialist të posaçëm për monitorim dhe raportim.

Në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi për personat LGBT në Shqipëri, vazhdon zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit 2016-2020, miratuar me VKM-në Nr. 390, datë 05.25.2016 “Për një ndryshim në VKM-në Nr. 87, datë 3.02.2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Përfshirjen Sociale 2016-2020". Drejtimit kryesore të planit janë përmirësimi në fushën e legjislacionit dhe zhvillimit të politikave, sigurisë dhe mbrojtjes së të drejtave dhe qasjes në shërbime të personave LGBTI.

Gjithashtu, është rritur numri i rasteve të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit në lidhje me punësimin.

Sa i përket barazisë midis grave dhe burrave në punësim dhe politikë sociale, në kuadër të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me Konventën CEDAË dhe Konventën e Stambollit, me iniciativën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), u rishikua Ligji. Nr 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar. Ndryshimet e miratuara me Ligjin Nr. 47/2018 hynë në fuqi më 18 gusht 2018.

Strukturat përgjegjëse për Barazinë Gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje, vazhdojnë të fuqizohet nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve gjinorë, për integrimin gjinor në nivel qendror dhe vendor, nën rolin koordinues të MSHMS.

Në fushën e luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje ka patur arritje në: përmirësimin e kuadrit ligjor, shtrirjen e mekanizmave të referimit në të gjitha bashkitë e vendit (39 nga 61 deri tani), ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve, zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimi të mirëkoordinuara me shtrirje në të gjithë vendit dhe gjatë gjithë vitit.

Konkluzion: Përgjithësisht, politika dhe struktura ligjore në punësim dhe politika sociale është kryesisht por jo e gjitha në linjë me acquis e BE-së. Ka një përafrim i plotë në fushën e dialogut social, politikat e punësimit dhe mosdiskriminimit në punësim dhe politika sociale.

I.3. Prioritetet

Qeveria e Shqipërisë është e vendosur të zhvillojë një politikë sociale dhe punësimi, që është në linjë me kërkesat e BE-së dhe praktikave më të mira, duke investuar në kapital njerëzor dhe kohezion social, si një ndër shtyllat kryesore të vizionit strategjik primar e të bërit një anëtar i Bashkimit Evropian.¹⁹

Objektivat primare të Shqipërisë përsa i përket politikave të punësimit dhe sociale përfshijnë:

- Zbatimi efektiv i Strategjisë së Dokumentit të Mbrojtjes Sociale dhe Politikës së Përfshirjes Sociale për të reduktuar varfërinë, përmirësuar kohezionin social dhe territorial, lufta kundër mospërfshirjes sociale dhe vendosjes së një sistemi të kujdesit social.
- Reduktimi i punës së padeklaruar dhe informalitetit përmes zbatimit të politikave më të mira dhe shërbimeve më efektive të inspektimit të punës.
- Përmirësimi i statistikave të tregut të punës dhe zhvillimit të statistikave sociale në dakortësi me sondazhet e BE-së, dhe përmirësimi i mbledhjes së të dhënave statistikore mbi OSH, në mënyrë që kemi dëshmi të mirë dhe zhvillim të instrumenteve të monitorimit.

II.1. E drejta e punës

II.1.1 Kuadri Politik dhe ligjor

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 (SKPA)

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (NESS) 2014 - 2020 ka vazhduar që nga fundi i vitit 2014, sipas aktiviteteve të parashikuara në planin e saj të veprimit.

Aktualisht, rishikimi afatmesëm i Strategjisë është në vazhdim. Rishikimi afatmesëm është duke analizuar rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë ndryshime në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror, do të vlerësojë, nëse qëllimet janë ende relevante, duke krahasuar gjendjen me situatën fillestare dhe do të çojë në identifikimin e veprimit të kërkuar korrigjues, ku do të rishikohen të gjitha masat dhe në Planin e Veprimit të Strategjisë mund të futen masat e reja. Një nga shtyllat, në të cilat strategjia ka pasur

¹⁹ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020

probleme në zbatimin e saj, është prioriteti C "Promovimi i Përfshirjes Sociale dhe Kohezionit Territorial", kryesisht për masat që lidhen me zgjerimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional në zonat rurale. Ky rishikim filloi në korrik 2018 dhe rezultatet do të dalin në dhjetor 2018.

Kuadri ligjor në fushën e Ligjit të Punës është prezantuar parimisht nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, miratuar paraprakisht më 12.07.1995. Ndryshimet e fundit të Kodit të Punës transpozuan 16 direktiva të BE-së mbi ligjin e punës, duke mbuluar të drejtën e informimit dhe konsultimit të të punësuarit, marrëdhëniet punëmarrës-punëdhënës, orari i punës, reduktimet kolektive, e drejta e punësimit në rast të transferimit të ndërmarrjes, punësimi në agjenci të përkohshme dhe tele-puna , por gjithashtu dhe direktiva të BE-së mbi mosdiskriminimin në punë, të drejta të barabarta midis grave dhe burrave në punësim dhe politika sociale (leje lindje), dhe siguria dhe shëndeti në punë i punonjëseve shtatzëna, që kanë lindur së afërmi ose që ushqejnë me fëmijën me gji.²⁰ Gjithashtu një "Ligj mbi profesionet në Republikën e Shqipërisë" u miratua në Qershor të 2016.

Ligji bazë në fushën e punësimit është Ligji Nr 7995 datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit" i ndryshuar. Ky ligj mbështet si zbatimin e programeve për zhvillimin e punësimit, ashtu edhe ngritjen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Qëllimi i këtij ligji është ndjekja e politikave aktive të përgjithshme për të mbështetur punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht, nëpërmjet sigurimit që të ketë punë për të gjithë ata që kërkojnë punë, një punë e tillë të jetë sa më produktive që të jetë e mundur, të ketë liri në zgjedhjen e punës dhe mundësitë më të plota të mundshme për çdo person të punësuar, që të kualifikohet dhe të përdorë aftësitë dhe dhuntitë e tij në një punë ku ai është përshtatur siç duhet.

Ligji Nr 145/2015 "Për punëkërkuesit e papunë" ka për qëllim realizimin e misionit të zyrave të punësimit për të ofruar sa më shumë mundësi punësimi dhe kualifikimi për punëkërkuesit e papunë, në mënyrë të veçantë për përfituesit e mbështetjes me të ardhura, për t'i integruar ata në tregun e punës, pra për t'i kaluar ata nga skemat pasive në ato aktive, duke rritur kështu punësimin e tyre. Ligji ka si objektiv rregullimin e procesit të rregjistrimit të punëkërkuesve të papunë në zyrat e punësimit, përshtatjen e kërkesës dhe ofertës për punë dhe kualifikimit profesional, si dhe sigurimin e zbatimit të këtij procesi.

Konkluzion: Edhe pse një sasi e madhe e acquis së BE-së në fushën e ligjit të punës është zhvendosur tashmë në ligjin kombëtar, legjislacioni i tanishëm i punës, është kryesisht, por jo plotësisht në linjë me acquis relevante të BE-së. Të gjitha direktivat në fushën e ligjit të punës janë transpozuar, por shumë prej tyre vetëm pjesërisht, pra ato duhet të vihen plotësisht në linjë me acquis e BE-së.

²⁰ Shih në Aneks, Tabela IV.2 Masat Ligjore të Planifikuara dhe Ekzistuese

I.1.2. Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor përgjegjës në fushën e ligjit të punësimit tani është Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Roli i ministrisë është të përkujdeset për hartimin e politikave dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e ligjit të punës dhe të mbikëqyrë agjencitë e tjera që merren me çështjet e punës.

Inspektorati Shtetëror për Punën dhe Shërbimet Sociale (ISHPSHS) është përgjegjës për përforcimin e kërkesave të ligjit të punës përmes supervizimit të tregut të punës, inspektimeve dhe penaliteteve. Më specifikisht fusha përfshin, kushtet e punës, mbrojtjen e punëtorëve, orari i punës, pagesat, siguria, higjiena dhe mirëqenia në punë, puna e të miturve, minorenët, gratë dhe çështje të tjera të lidhura.

II.1.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.1.3.1 Kuadri Politik i Planifikuar

N/A

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara

Projektligji “Për nxitjen e punësimit” dhe të gjitha aktet nënligjore që autorizon ky ligj.

Ky projektligj do të përafrojë në mënyrë të pjesshme Direktivën Nr 2006/54/KE dhe është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të 4 të vitit 2019.

II.1.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Në mënyrë që të promovohen amendamentet e Kodit të Punës, disa aktivitete po organizohen për të rritur ndërgjegjësimin midis punëmarrësve dhe punëdhënësve me inovacionet dhe përmirësimet.

Aktivitete janë parashikuar gjithashtu në Strategjinë për OSH dhe Aftësitë dhe Punësimin për të forcuar kapacitetet e Inspektoratit të Punës, i cili është një nga prioritetet, pasi ka një impakt të madh në sigurimin e duhur të zbatimit të ligjit të punës.

II.2. Kërkesat e shëndetit dhe sigurisë në punë

II.2.1 Kuadri Politik dhe ligjor

Kuadri ligjor në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë është parashtruar në Dokumentin e Punësimit, Sigurisë dhe Shëndetit 2016-2020 dhe Plani i tij i Veprimit, miratuar në 2016. Dokumenti i SSP dhe Plani i tij i Veprimit 2016-2020 është konsistent me Kuadrin Strategjik të BE-së mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Punë, 2014-2020, strategjia e OBSH në Shëndetin në Punësim për të gjithë, dhe planit të veprimit të ONP, 2010-2016, i cili synon të arrijë përhapjen e ratifikimit dhe zbatimit të dobishëm, të instrumenteve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Kuadri ligjor në fushën e Shëndetit dhe Sigurisë në punë është i përfaqësuar në dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjin Nr 10237 në 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punësim”, i cili transponon plotësisht OSH-në e BE-së, Direktivën Kuadër 89/391/EEC të 12 Qershorit 1989 “Hyrje e masave të inkurajuara për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë”, dhe një set kërkesash minimale që duhen zbatuar (në nivel të aktit normativ të Qeverisë me forcë detyruese të përgjithshme), duke transpozuar plotësisht një pjesë të madhe të direktivave individuale të OSH së BE-së dhe acquis të tjera të BE-së të lidhura me OSH.²¹

Janë miratuar aktet e mëposhtme ligjore, respektivisht:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 969 datë 02.12.2015 “Për miratimin e Rregullores “Për kërkesat minimale për mbrojtjen e sigurisë e të shëndetit të punëmarrësve në industrinë minerare nxjerrëse, sipërfaqësore dhe nëntokësore”, e cila transponon Direktivën 92/104/EEC “Industrië mineral-nxjerrëse”. Ky vendim ka hyrë në fuqi më datë 04.06.2016).
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 484 datë 29.6.2016 “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet lidhur me asbestin në vendin e punës”, i cili transponon Direktivën 2009/148 / EC “Mbi mbrojtjen e punëtorëve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj asbestit në punë”. Ky vendim ka hyrë në fuqi më 06.07.2018).
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 639 datë 7 Shtator 2016 “Mbi përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”, marrë nga Komisioni i Rekomandimit 66/464 mbi kontrollin mjekësor të punëtorëve që kanë një rrezik të ekspozimit ndaj risqeve të veçanta.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 108 datë 15.2.2017 “Për miratimin e Rregullores “Për mbrojtjen e fëmijëve në punë” e cila transponon Direktivën e Këshillit 94/33/EC të 22 Qershorit 1994 “Për mbrojtjen e njerëzve të rinj në punë”.

Gjithashtu Ligji Nr 9634 datë 30.10.2006 “Mbi Inspektimin e Punës” u ndryshua në 2017 për të fuqizuar kapacitetet e ISHPSHS dhe për të përmirësuar zbatimin e ligjit, dhe për të adresuar në mënyrë më të dobishme punën e padeklaruar. Në veçanti, Artikulli 35 i Ligjit Nr 9634 i 30.10.2006 u ndryshua duke lejuar pezullimin e punës nga inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të Punës, në rast të punës informale apo rrezikut të menjëhershëm, serioz dhe të pashmangshëm të shëndetit dhe sigurisë që kërkon evakuimin e punëtorëve.

²¹ Raporti i Komisionit Evropian mbi Shqipërinë 2018

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 150 datë 01.03.2017 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin mbi Inspektimin e Punës” përcakton masat administrative, rastet kur sigurohen masa administrative dhe urgjente, sipas konceptit të përcaktuar në ligjin e Inspektimit, për të shmangur abuzimet me subjektet. Ky draft jep përcaktimin e “punësimit informal” në vijim të kërkesave të vazhdueshme të ekspertëve ndërkombëtarë, ILO-s, Indeksit të Rishikuar Social apo Nënkomitetit të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore, sikurse dhe përcaktimet e pamundësisë për të punuar në vendin e punës për personat me aftësi të kufizuara. Ky është një proces në vazhdimësi dhe ja vlen të përmendet që VKM-ja e re ka lehtësuar shumë biznese.

Legjislacioni i tanishëm i Shqipërisë për sigurinë dhe shëndetin në punë është kryesisht por jo plotësisht i përafër me acquis e BE-së, duke marrë parasysh që disa direktiva të BE-së janë duke pritur transpozimin, por janë parashikuar të transpozohen sikurse përshkruar në seksionin më poshtë “Masat ligjore të planifikuara”

II.2.2. Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor përgjegjës në fushën e ligjit të punësimit tani është Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Roli i ministrisë është të përkujdeset për hartimin e politikave dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e ligjit të punës dhe të mbikëqyrë agjencitë e tjera që merren me çështjet e punës.

Inspektorati Shtetëror për Punën dhe Shërbimet Sociale (ISHPSHS) është përgjegjës për përforcimin e kërkesave të ligjit të punës përmes supervizimit të tregut të punës, inspektimeve dhe penaliteteve. Më specifikisht fusha përfshin, kushtet e punës, mbrojtjen e punëtorëve, orari i punës, pagesat, siguria, higjiena dhe mirëqenia në punë, puna e të miturve, minorenët, gratë dhe çështje të tjera të lidhura.

II.2.3 Masat e parashikuara 2019-2021

II.2.3.1 Kuadri Politik i Planifikuar

Asnjë dokument strategjik apo që parashikon politika nuk është parashikuar në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

II.2.3.2 Masat ligjore të planifikuara

Me synim përafrimin e legjislacionit shqiptar mbi sigurinë dhe shëndetin në punë me atë të acquis të BE-së, masat e mëposhtme janë parashikuar për tu përshtatur:

- Draft-VKM-ja “Për miratimin e Rregullores “Mbi masat për inkurajimin e përmirësimeve në siguri dhe shëndet në punë të punëtorëve me kohëzgjatje fikse apo të përkohshme” e cila transponon tërësisht Direktivën e Këshillit 91/383/EEC të 25 Qershorit 1991 për të plotësuar masat që inkurajojnë përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të punëtorëve me kohëzgjatje fikse apo të përkohshme”. Përshtatja është parashikuar të ndodhë në tremujorin e dytë të 2019.
- Draft VKM “Për miratimin e rregullores “Për rregullimin e kohës së punës dhe pushimit”, e cila transponon tërësisht Direktivën 2003/88 të Këshillit dhe Parlamentit Europian datë 4 Nëntor 2003 në lidhje me disa aspekte të veçanta të organizimit të punës;
- Draft-amendamentet e Ligjit “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Vendin e Punës” të cilat transpozojnë plotësisht Rekomandimin e Këshillit të 18 Shkurtit 2003 në lidhje me përmirësimet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë të vetë-punësuarve (2003/134/EC). Miratimi parashikohet të ndodhë në tremujorin e dytë të 2019-ës.
- Draft Rregullorja e MoHSP dhe MEI “Mbi minimumin e kërkesave të sigurisë dhe shëndetit për trajtimin mjekësor të përmirësuar në bordin e anijeve”, e cila do të transpozohet plotësisht Direktivën 92/29/EEC “Mbi minimumin e kërkesave të sigurisë dhe shëndetit për trajtimin mjekësor të përmirësuar në bordin e anijeve”. Miratimi parashikohet të ndodhë në tremujorin e katërt të 2019.

Ndërsa planifikimi i transpozimit për direktivat e mëposhtme pritet që të ndodhë:

- Direktiva 2010/32/EU Për zbatimin e Marrëveshjes Kuadër mbi parandalimin e lëndimeve nga mjete të mprehta në spital dhe sektorin e përkujdesjes mjekësore përfunduar nga HOSPEEM dhe EPSU,
- Direktiva e Këshillit 2013/59/Euratom e 5 Dhjetorit 2013 Vendosja e standardeve minimale të sigurisë për mbrojtjen ndaj rreziqeve të ekspozimit ndaj radioaktivitetit jonizues, e cila shfuqizon Direktivat 89/618/Euratom, 90/641/Euratom, 96/29/Euratom, 97/43/Euratom dhe 2003/122/Euratom,
- Direktiva 2014/27/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 Shkurtit 2014, e cila ndryshon Direktivat e Këshillit 92/58/EEC, 92/85/EEC, 94/33/EC, 98/24/EC dhe Direktivën 2004/37/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në mënyrë që t'i përafrojë ato me Rregulloren (EC) Nr 1272/2008 Mbi klasifikimin, etiketimin, dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve.

II.2.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Mbledhja e të dhënave statistikore të OSH do të përmirësohet në mënyrë që të ketë një dëshmi të mirë dhe zhvillim të instrumenteve monitorues.

II.3. Dialogu social

II.3.1 Kuadri Politik dhe ligjor

Nuk ka strategji apo dokumente politike të veçanta për dialogun social.

Kuadri ligjor në fushën e dialogut social përbëhet nga Kodi i Punës, i amenduar (Ligji Nr 7961 datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”

Konkluzion: Kuadri ligjor në fushën e dialogut social është plotësisht i përafëruar me acquis e BE-së.

II.3.2. Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor përgjegjës në fushën e dialogut social është Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ministria është përgjegjëse për zhvillimin dhe hartimin e politikave në fushën e punësimit, marrëdhënieve të punës dhe dialogut social, zhvillimin e akteve ligjore dhe nënligjore në këto fusha. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për mbikëqyrjen, koordinimin e përgjithshëm të të gjitha institucioneve që mbulojnë punësimin, dialogun social dhe marrëdhëniet e punës .

Agjencia kryesore për zbatimin e politikës së punësimit në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë është Shërbimi Kombëtar i Punësimit, i cili drejton programet e punësimit dhe ofron shërbimet e punësimit, ndërmjetësimit dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve kolektive të punës.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit mbi punësimin, duke kryer mbikëqyrje, inspektime dhe ndërgjegjësim. Inspektorati është përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të punës nëpërmjet inspektimeve dhe penaliteteve. Fusha e tij e përgjegjësisë përfshin kushtet e punës, mbrojtjen e të punësuarve, kohën e punës, pagën, sigurinë, higjienën dhe mirëqenien në punë, punësimin e të miturve dhe grave dhe çështje të tjera.

Gjithashtu Këshilli Kombëtar i Punës (KKP), është institucioni më i lartë i dialogut social në nivel kombëtar.

II.3.3 Masat e parashikuara 2019-2021

II.3.3.1 Kuadri Politik i Planifikuar

Nuk ka strategji apo dokumente politike të veçanta për dialogun social.

II.3.3.2 Masat ligjore të planifikuara

N/A

II.3.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Në terma afatmesëm dhe afatgjatë, sistemi aktual për zgjidhjen miqësore të mosmarrëveshjeve të punës duhet të reformohet në mënyrë që të jetë më efektiv në adresimin e nevojave të punëmarresve dhe punëdhënësve, duke përfshirë rritjen e besimit dhe pavarësinë e këtij mekanizmi.

II.4. Politikat e punësimit

II.4.I Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2014-2020 dhe Plani i saj i Veprimit, është dokumenti kryesor strategjik i qeverisë në fushën e punësimit. Ajo fokusohet në punësimin dhe zhvillimin cilësor të fuqisë punëtore, duke reflektuar prioritetet e qeverisë dhe zhvillimin e përshpejtuar ekonomik, duke konsideruar punësimin si kolona kryesore e ndihmës sociale.

Dokumenti strategjik synon të integrojë politikat ekonomike, edukuese dhe trajnuese të sipërmarrjes, duke prodhuar një plan veprimi që synon ta nxjerrë shoqërinë shqiptare nga situata e papunësisë. Është vendosur një mekanizëm për monitorimin.. Raporti i parë vjetor për zbatimin e NESS është përgatitur, dhe progresi më i madh është arritur në fushën e politikave dhe shërbimeve të punësimit, ndërkohë që progresi ishte i kufizuar në fushat e përfshirjes sociale, kohezionit territorial dhe sistemit të qeverisjes së tregut të punës.

Strategjia është në përputhje me vizionin dhe direktivat e Bashkimit Evropian, Strategjinë Evropiane të Punësimit 2020, dhe kërkesat e integritetit të vendit në BE.

Në kuadrin e politikave për rininë, me VKM Nr. 383, datë 6 Maj 2015 u miratua Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 që synon zhvillimin dhe koordinimin ndërsektorial të politikave për rininë në arsim, shëndetësi, kulturë dhe forcimin e pjesëmarrjes së rinisë në jetën sociale dhe procesin e vendimmarrjes.

Kuadri ligjor në fushën e punësimit në Shqipëri është prezantuar fillimisht nga Ligji Nr. 7995, i datës 20.09.1995, “ Mbi promovimin e punësimit” i amenduar dhe aktet e tij nënligjore, si dhe Ligji Nr 8872 datë 29.03.2002 “Mbi sistemin e Edukimit dhe Trajnimit” i amenduar dhe aktet nënligjore përkatëse.

Ligje të tjera përfshijnë Ligjin Nr 70/2016 “Mbi zejtarinë në Shqipëri”, i cili parashikon krijimin e një dhome të zejtarisë dhe rregullon të gjithë sistemin e trajnimit profesional në nivel nxënësi, asistenti dhe mjeshtri, në bashkëpunim me shkollat profesionale në këtë duke prezantuar për herë të parë një sistem të dyfishtë.

Gjithashtu një ligj i ri mbi nxitjen e punësimit është finalizuar dhe pritet miratimi nga Këshilli i Ministrave.

Është finalizuar një ligj i ri mbi arsimin dhe trajnimin profesional që synon të mbështesë reformat në këtë fushë duke u përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe të përmirësojë elementë kyç të këtij sistemi si menaxhimi, financimi, decentralizimi dhe të tjerë. Projekti u miratua nga kuvendi me Ligjin 15/2017 datë 16.02.2017 “Mbi arsimin dhe trajnimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Me qëllim forcimin e luftës kundër informalitetit është miratuar Ligji Nr 57/2017 “Për disa amendime dhe shtesa në Ligjin Nr 9634 datë 30.10.2016 “Mbi Inspektimet e Punës”. Ndryshimet kanë hyrë në fuqi më datë 25.05.2017. Në mënyrë të veçantë u amendua neni 35 që lejon pezullimin e punës nga inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të Punës, në rast konstatimi të punësimit informal apo të risqeve serioze për sigurinë dhe shëndetin në punë që kërkojnë evakuimin e të punësuarve.

Kuadri ligjor në fushën e punësimit është plotësisht i përputhur me kërkesat e BE-së.

II.4.2. Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor përgjegjës në fushën e punësimit është Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Ministria është përgjegjëse për zhvillimin dhe hartimin e politikave në fushën e punësimit dhe zhvillimin e akteve ligjore dhe nënligjore në këtë fushë. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për mbikëqyrjen, koordinimin e përgjithshëm të të gjitha institucioneve që mbulojnë punësimin.

Agjencia kryesore për zbatimin e politikës së punësimit në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë është Shërbimi Kombëtar i Punësimit, i cili drejton programet e punësimit dhe ofron shërbimet e punësimit. Inspektorati për Punën dhe Shërbimet Sociale është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit mbi punësimin, duke kryer mbikëqyrje, inspektime dhe ndërgjegjësim. Inspektorati është përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të punës nëpërmjet inspektimeve dhe penaliteteve. Fusha e tij e përgjegjësisë përfshin kushtet e punës, mbrojtjen e të punësuarve, kohën e punës, pagën, sigurinë, higjienën dhe mirëqenien në punë, punësimin e të miturve dhe grave dhe çështje të tjera.

II.4.3 Masat e parashikuara 2019-2021

II.4.3.1 Kuadri Politik i Planifikuar

Nuk ka dokumente politike të parashikuara për këtë periudhë në fushën e punësimit.

II.4.3.2 Masat ligjore të planifikuara

Nuk ka masa ligjore të parashikuara për këtë periudhë në fushën e punësimit.

II.4.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Masa të tjera përfshijnë nevojën për të modernizuar dhe rritur efikasitetin e shërbimeve të punësimit publik, duke shpallur programe të reja efektive të promovimit të punësimit që rrisin punësimin e grave dhe të rinjve.

Gjithashtu masa për të reformuar VET në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Masa për të përmirësuar statistikën e tregut të punës dhe për të zhvilluar statistika sociale në përputhje me sondazhet e BE-së.

II.5. Përfshirja dhe Mbrojtja Sociale

II.5.1 Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri kryesor i politikave në fushën e mbrojtjes së përfshirjes sociale përfaqësohet nga “Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020” dhe Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale 2016-2020. Gjithashtu me rëndësi në këtë fushë janë Plani Kombëtar i Veprimit për Romët dhe Egjiptianët 2016-2020, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK), Plani i Veprimit për Fëmijët 2012-2015, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBT në Shqipëri 2016-2020, Strategjia e Sigurimeve Shoqërore 2015-2020 dhe Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, Strategjia Kombëtare e Strehimit Social 2016-2025.

Strategjia e Mbrojtjes Sociale është në përputhje me nenet 70 dhe 99 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Dokumentin e Partneritetit 2007.

Reforma e pensioneve u materializua në përgatitjen e Dokumentit të Politikave Pensionale, i cili u prezantua nga Kryeministri, më datë 29.04.2014, dhe Ligji Nr 104/2014 datë 31/07/2014 “Për përmirësimin e sigurimeve shoqërore”. Reforma u shoqërua nga një fushatë e gjerë e fushatave informuese dhe sensibilizuese për popullatën, për futjen e përmirësimeve dhe inovacioneve të ligjit duke organizuar takime me palët e interesit, shoqërinë civile, mediat dhe prezantime të shumta në fushatën reklamuese të medias sociale. Reforma e pensioneve garanton, përfitime të një niveli normal duke sjellë një përmirësim të ndjeshëm në shkallën e zëvendësimit në krahasim me skemën aktuale. Zbatimi i reformës do të çojë në një reduktim më të shpejtë të deficitit të skemës së pensioneve, përmirësimin e gjendjes financiare të skemës dhe uljen e subvencioneve nga buxheti i shtetit.

Një nga programet për zbutjen e varfërisë është skema e ndihmës ekonomike. Ligji Nr. 9355/2005 “Për ndihmën sociale dhe shërbimet” të ndryshuar me ligjin Nr 44/2016 i cili parashikon që kriteret përjashtuese do të hiqen, aplikimi dhe verifikimi dhe dhënia e ndihmës financiare për familjet në nevojë do të kryhet në mënyrë efikase, transparente, duke përdorur një formulë të pikëzuar duke synuar më të varfrit, përmes përdorimit të një Sistemi të Menaxhimit të Informacionit.

Aktualisht skema është shtrirë në të gjithë vendin ndërkohë që korniza ligjore është përfunduar. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës, dokumentacionit dhe shumës së ndihmës ekonomike” është miratuar.

Reforma e Shërbimeve Sociale ka si qëllim decentralizimin e shërbimeve të kujdesit social dhe deinstitutionalizimit të shërbimeve të ofruara në qendrat e kujdesit social dhe shërbimet e integruara të kujdesit social.

I gjithë kuadri i politikave në përfshirjen sociale dhe mbrojtjen sociale është në përputhje me kornizën strategjike të BE-së, siç është Strategjia EVROPA 2020 dhe Paketa e Investimeve Sociale të synuara nga varfëria dhe Platforma Evropiane kundër Varfërisë dhe Përjashtimit Social, Strategjia Evropiane për Aftësinë e Kufizuar 2010-2020.

II.5.2 Kuadri Ligjor

Kuadri ligjor në fushën e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale përfaqësohet nga Ligji i ri për ndihmën ekonomike, i miratuar nga parlamenti në maj 2016, i cili synon ta bëjë sistemin më transparent, të drejtë dhe efikas. Gjithashtu, Ligji Nr 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji Nr 65/2016 “Për Ndërmarrjet Shoqërore”, Ligji për Pensionet dhe aktet nënligjore të tyre.

Zhvillim i ngjashëm është edhe Ligji Nr 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Social në Republikën e Shqipërisë” dhe ndjekja e akteve nënligjore, ku parashihet edhe krijimi i një Fondi Social dhe Ligji Nr 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale” dhe ngritje e vazhdueshme e kapaciteteve për profesionistët. Aktet nënligjore të reja të legjislacionit mbi ndërmarrjet sociale do të mundësojnë krijimin e bizneseve të vogla artizanale, ku personat nga grupet e vulnerabël do të punësohen, nëpërmjet mbështetjes financiare të shtetit në fillimet e tyre fillestare. Një paketë standarde e shërbimeve është hartuar dhe është miratuar nga Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 për të ndihmuar komunat që të planifikojnë siç duhet dhe shërbimet e kujdesit buxhetor në nivel lokal për të adresuar nevojat e familjeve dhe fëmijëve të tyre.

Kuadri ligjor në këtë fushë është kryesisht, por jo plotësisht në përputhje me kërkesat e BE-së.

II.5.2. Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor përgjegjës në këtë fushë është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ajo është përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe strategjive, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore. Ajo është përgjegjës për të koordinuar dhe mbikëqyrur agjencitë e tjera që merren me përfshirjen sociale dhe çështjet e mbrojtjes.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, i themeluar me VKM Nr 48 datë 21.01.2015, “Rregullorja për Funkcionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar”. Gjithashtu, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Shëndetit.

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ngritur me Urdhër të Kryeministrit dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 54 datë 31.01.2018.

II.5.3. Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.5.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

Asnjë dokument strategjik ose politik nuk parashikohet për periudhën e ardhshme në këtë fushë. Shumica e dokumenteve strategjike ose të politikave të zbatueshme mbulojnë periudhën deri në vitin 2020.

II.5.3.2 Masat Ligjore të Parashikuara

Në përputhje të mëtjshme të legjislacionin shqiptar me acquis të BE-së në fushën e përfshirjes sociale dhe mbrojtjes sociale, masat e mëposhtme ligjore janë planifikuar për miratim:

- Hartimi i VKM “Për asistentin personal të PAN”, për përafrimin e pjesshëm të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European (2010 / C 83/02) Miratimi parashikohet të kryhet në tremujorin e 4-të të vitit 2019.
- VKM Nr 708 datë 26.8.2015 “Për kategoritë, periodicitetin dhe raportimin e të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga organet shtetërore, në nivel qendror dhe lokal”, për përafrimin e pjesshëm të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European (2010 / C 83/02) Miratimi parashikohet të bëhet në tremujorin e II-të të vitit 2019.

II.5.3.3 Masa të tjera të planifikuara

Masat e tjera përfshijnë përpjekjet për të siguruar zbatimin efektiv të “Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015-2020” dhe përparimin e mëtejshëm me Reformën e Kujdesit Social dhe për të zhvilluar një qasje strategjike për trajtimin e përjashtimit social.

II.6. Mosdiskriminimi në punësim dhe politika sociale

II.6.1 Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri i politikave në fushën e mosdiskriminimit në punësim dhe politikë sociale përfaqësohet nga Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2014-2020, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBT në Shqipëri 2016-2020, Plani Kombëtar i Veprimit për Romët dhe Egjiptianët, Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK).

Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale 2016-2020 përcakton një kuadër politik dhe monitoron përfshirjen sociale dhe integrimin e grupeve të prekshme.

Ndërsa qëllimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 është të mbrojë dhe promovojë të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, nëpërmjet zbatimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve, me një qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar të të drejtave të fëmijëve. Agjenda paraqet një kuadër multidisiplinar dhe sistematik, i cili duhet të integrohet në të gjitha dokumentet, planet dhe aktivitetet e tjera vendore dhe kombëtare në lidhje me fëmijët, në frymën e Konventës së OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës"

Në zbatim të Ligjit Nr 93/2014 datë 24.07.2014 është miratuar VKM Nr 48 datë 21.01.2015 “Për miratimin e rregullave për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar” (i ndryshuar). Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është duke punuar për të përmirësuar raportimin e të dhënave mbi aftësinë e kufizuar nga autoritetet shtetërore në nivel qendror dhe lokal. MSHMS koordinon aksesueshmerine dhe masat për eliminimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike si një masë ndërinstitucionale.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka miratuar *Planin e Strategjik 2018-2021*. Ky dokumenta është hartuar me mbështetjen financiare dhe ekspertizen e ofruar në kuadër të projektit të përmbashkët BE/KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit”

Në përgjithësi, kuadri i politikave në fushën e mosdiskriminimit në punësim dhe në politikat sociale është në përputhje me kërkesat e BE-së.

Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, garanton zbatimin e të drejtave për të gjithë fëmijët, si dhe ngritjen e një sistemi të integruar të mbrojtjes me ndërhyrje dhe masa mbrojtjeje për të parandaluar, rehabilituar ose mbrojtur fëmijën në rrezik nga dhuna, abuzimi, neglizhimi. Janë miratuar 8 VKM në zbatim të ligjit.

Në Shqipëri, me miratimin e Ligjit Nr 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë mori një nivel të ri të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në kuadrin ligjor. Miratimi i këtij ligji dhe emërimi i një komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (CPD) konsiderohen një arritje për Shqipërinë në aspektin institucional dhe në politikën e saj anti-diskriminuese.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (LMD) është përafruar me katër direktivat e BE-së në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. Megjithatë, në kuadër të nevojave për përmirësim që kanë lindur nga zbatimi në praktikë i ligjit, KMD është në proces për ndryshimin e tij.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë procesit për ndryshimin e LMD, do të marrë në konsideratë rekomandimin për të parashikuar në ligj “*diskriminimin e shumfishtë*”. Megjithatë, në lidhje me këtë rekomandim, dëshirojmë të sjellim në vëmendje se, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, KMD ka adresuar si nëpërmjet rekomandimeve ashtu edhe vendimeve diskriminimin e shumfishtë. KMD ka konstatuar në disa raste diskriminimin e ankuesve bazuar në më shumë se një shkak. Aktualisht KMD ka filluar procesin e mbledhjes së propozimeve dhe rekomandimeve nga ana e shoqërisë civile, mbi nevojat për për shtesa apo ndryshime në Ligjin 10221/2010;

Kuadri ligjor në fushën e mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta është plotësisht në linjë me *acquis* e BE-së.

II.6.2. Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor përgjegjës në fushën e mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ministria është përgjegjëse për zhvillimin e politikave në fushën e punësimit dhe hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore në këtë fushë. Ajo gjithashtu është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe koordinimin e përgjithshëm të të gjitha institucioneve që merren me punësimin.

Agjencia kryesore për zbatimin e legjislacionit për mos-diskriminimin, gjithashtu në lidhje me çështjet e mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta është Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kjo zyrë u krijua si rezultat i kërkesave të BE-së në kuadër të procesit të integritetit dhe tregon angazhimin e autoriteteve shqiptare për respektimin e të drejtave të barabarta të njeriut dhe mos-diskriminimin. Roli i Zyrës së Komisionerit është të merret me ankesat për diskriminim jo vetëm nga administrata publike, por edhe nga palët private. Ajo gjithashtu kryen hetime administrative, anketime dhe paraqet rekomandime dhe gjithashtu imponon sanksione sipas ligjit.

Gjithashtu, Zyra e Avokatit të Popullit ka një rol në mbrojtjen nga diskriminimi.

Më datë 28 maj 2018, Avokati i Popullit (AP) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje do të sigurojë një koordinim më të mirë midis dy institucioneve duke tejkaluar mbivendosjen e mundshme të kompetencave, me qëllimin final për të garantuar në mënyrën më të mirë të drejtat dhe liritë e individit, në baza të barabarta dhe pa diskriminim.

Në praktikë kjo marrëveshje është duke u zbatuar jo vetëm në kuadër të bashkërendimit të iniciativave të përbashkëta, por edhe nëpërmjet përcjelles reciproke së ankesave të bëra nga individët tek institucioni që ka kompetencën për t'a trajtuar.

Në frymën e bashkëpunimit midis institucione të pavarura kombëtare dhe konkretisht midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është në proces nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi midis këtyre tre institucioneve. Qëllimi i kësaj marrëveshje është forcimi i bashkëpunimit institucional me qëllimin e garantimit në mënyrën më të mirë të të drejtave të qytetarëve, sipas kompetencave që secili nga këto institucione ka. Kjo marrëveshje mbështetet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi për personat LGBT në Shqipëri, është ngritur dhe funksionon Grupi Kombëtar i Zbatimit dhe Koordinimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë (GKZZK), i cili drejtohet nga Ministri i MSHMS dhe në përbërje ka përfaqësues nga Ministrinë përgjegjëse për zbatimin e këtij plani.

II.6.3. Masat e parashikuara 2018-2020

II.6.3.1 Kuadri Politik i Planifikuar

II.6.3.2 Masat ligjore të planifikuara

N/A

II.6.3.3 Masa të tjera të planifikuara

N/A

II.7. Barazia midis grave dhe burrave në punësim dhe politikë sociale

II.7.1 Kuadri politik dhe ligjor

Në këtë fushë, kuadri i politikave në barazinë midis grave dhe burrave në punësim dhe politikë sociale përfaqësohet nga Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2016-2020, e cila është

miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr 733 datë 20.10.2016. Strategjia synon veprime konkrete për përmirësimin dhe forcimin e mekanizmave institucionalë që sigurojnë monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor, veprime të mëtejshme për zbatimin efektiv të përmirësimeve ligjore dhe adresimin e çështjeve që ndikojnë në rritjen e aksesit dhe fuqizimin socio-ekonomik të grave në zonat rurale; zhvillimin e shërbimeve të nevojshme, në numër të mjaftueshëm, në dispozicion dhe lehtësisht të arritshme për viktimat/të mbijetuarit, si dhe përmirësimin e burimeve ekzistuese njerëzore dhe financiare (sipas standardeve dhe në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara).

Korniza e politikave për barazinë gjinore është në përputhje me strategjinë kuadër të BE-së për barazi gjinore.

Kuadri ligjor në fushën e barazisë midis grave dhe burrave në punësim dhe politikë sociale kryesisht përfaqësohet nga Ligji Nr 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligji Nr 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Kodi i Punës, Ligji Nr 7995, datë 20.09.1995 “Për Promovimin e Punësimit”, i ndryshuar, si dhe Ligji Nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë periudhës së fundit legjislacioni shqiptar në këtë fushë u përafrua më tej me acquis e BE-së. Kështu, ndryshimet e fundit në Kodin e Punës përafruan një numër direktivash të BE-së në këtë fushë, duke përfshirë ato që lidhen me barrën e provës në rastet e diskriminimit të bazuar në seks, lejen e lindjes, dhe trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit, trajtim të barabartë për burrat dhe gratë përsa i përket qasjes në punësim, aftësimin profesional dhe kushteve të punës, trajtimin të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimeve shoqërore profesionale, sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzënë dhe punëtoreve që kanë lindur kohët e fundit, ose ushqejnë fëmijët me gji.

Në kuadër të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me Konventën CEDAË dhe Konventën e Stambollit, me inisiativën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), u rishikua Ligji Nr 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar. Ndryshimet e miratuara me Ligjin Nr. 47/2018 hynë në fuqi më 18 gusht 2018. Ligji i ndryshuar dhe plotësimi i kuadrit nënligjor përkatës synojnë në:

- Parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës në familje,
- Rritjen e efikasitetit dhe bashkëpunimit të strukturave përgjegjëse që punojnë në mbështetje të Viktimave të dhunës në familje.
- Rritjen e pjesëmarrjes së dhunuesve në shërbimet specifike të rehabilitimit me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, droguar, ose me probleme të shëndetit mendor, të dhëna qartësisht në vendimet e gjykatave për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.
- Rritjen e mbështetjes së kualifikuar gjyqësore falas për viktimat e dhunës në familje.

Në përgjithësi, kuadri ligjor në fushën e barazisë midis grave dhe burrave në punësim dhe politikë sociale është kryesisht, por jo plotësisht në linjë me acquis e BE-së.

II.7.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

II.7.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.7.3.1 Kuadri i politikave të parashikuara

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020 është parashikuar të kryhet një vlerësim i Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020. Ky vlerësim do të shërbejë si bazë për hartimin e Strategjisë për vitet 2021-2025. Miratimi i saj është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2021.

II.7.3.2 Masat ligjore të parashikuara

Me qëllim harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së, është parashikuar të miratohet draft Vendimi “ Për indeksimin e pensioneve”, i cili do të përafrojë në mënyrë të pjesshme Direktivën e Këshillit 86/378/EEC të 24 korrikut 1986 “Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimeve shoqërore profesionale.. Afati për miratimin e këtij vendimi është tremujori i dytë i vitit 2019.

II.7.3.3 Masa të tjera të parashikuara

N/A

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për kapitullin i institucionit koordinues	3,524,120	327,000	327,000
Buxheti total i institucioneve kontribuuese	0	0	0
Buxheti total i kapitullit	3,524,120	327,000	327,000

Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politikat industriale

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e acquis së Bashkimit Evropian

Acquis në Kapitullin e ndërmarrjeve dhe politikës industriale përbëhet nga parime dhe instrumente të politikave të cilat kryesisht reflektohen në komunikimet, rekomandimet dhe konkluzionet e Këshillit dhe kryesisht zbatohen në nivel kombëtar. Në nivelin e BE-së, këto zbatohen përmes programeve të BE-së. Përveç parimeve horizontale dhe instrumenteve, ndërmarrjet dhe politikat industriale mund të përfshijnë edhe politika sektoriale. Në përgjithësi, ndërmarrjet dhe politikat industriale të BE-së janë nxitur fuqimisht nga strategjia Evropa 2020.

Duke vendosur parime të përgjithshme të politikave, BE-ja kërkon të nxisë hartimin e politikave industriale dhe të ndërmarrjeve që përmirësojnë konkurrueshmërinë. Këto janë zhvilluar, në përputhje me Nenin 173 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), për të përshpejtuar përshtatjet strukturore, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për krijimin e biznesit, investimet e huaja brenda dhe jashtë vendit, promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), dhe sipërmarrjen dhe inovacionin. Më konkretisht, politika e BE-së për NVM-të karakterizohet nga rekomandimet e politikave dhe mekanizmat e përbashkët të rishikimit të politikave të përfshira në Aktin e Biznesit të Vogël si dhe në një përkufizim të përbashkët të NVM-ve.

Instrumentet e politikës së ndërmarrjeve dhe asaj industriale janë zhvilluar në programin e BE-së për Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve dhe të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME). Programi siguron mbështetje financiare për ndërmarrjet dhe hartuesit e politikave dhe fokusohet në masat që promovojnë aksesin në financa, aksesin në tregje, sipërmarrjen, shërbimet mbështetëse të biznesit si rrjeti i Ndërmarrjeve Evropiane, zhvillimin e politikave më të mira në mbështetje të NVM-ve. Një instrument i rëndësishëm i politikave është Direktiva 2011/7/BE për luftën kundër pagesave të vonuara në transaksionet tregtare. Programet e politikës së hapësirës së BE-së gjithashtu, janë pjesë e këtij kapitulli, pasi ato kontribuojnë në përmirësimin e konkurrueshmërisë së BE-së.

Përmes politikave të ndërmarrjeve dhe atyre sektoriale industriale, BE-ja nxit një analizë më të fokusuar në konkurrueshmërinë e sektorëve të veçantë dhe fillimin e iniciativave specifike sektoriale, siç janë grupet e nivelit të lartë, forumet e politikave, panele studimesh dhe ekspertësh si dhe iniciativat e rrjetëzimit.

Formulimi dhe zbatimi i politikës së ndërmarrjeve dhe asaj industriale kërkon kapacitete adekuate administrative në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, përfshirë proceset efikase të

konsultimit dhe një mekanizëm bashkëpunimi me grupet kryesore të interesit, siç janë shoqatat e industrialistëve.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Bashkëpunimi mes BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politikat e ndërmarrjeve dhe atyre industriale rregullohet në disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Së pari, neni 86 përcakton se bashkëpunimi do të synojë të kontribuojë në potencialin për zhvillim dhe rritje të Shqipërisë. Masat do të hartohen për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social në Shqipëri. Këto masa do të marrin parasysh bashkëpunimin rajonal.

Neni 91 përcakton se palët (si BE dhe Shqipëria) do të synojnë të sjellin një klimë të favorshme për investimet private të cilat janë vendimtare për zhvillimin e Shqipërisë.

Neni 92 përqendrohet në bashkëpunimin industrial që mbulon modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë shqiptare, forcimin e sektorit privat, bashkëpunimin ndërmjet operatorëve ekonomikë etj. Bashkëpunimi industrial do të marrë parasysh edhe aspektet rajonale të politikave industriale. Acquis e BE-së do të përafrohet gjithashtu.

Neni 93 i dedikohet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe synon të fokusojë bashkëpunimin BE-Shqipëri në zhvillimin dhe forcimin e NVM-ve duke marrë parasysh Aktin e Biznesit të Vogël, etj.

Neni 94 trajton turizmin si një sektor të veçantë të industrisë. Neni 94 parashikon forcimin e rrjedhës së informacionit mbi turizmin dhe transferimin e njohurive. Duhet të përafrohet edhe acquis në lidhje me turizmin.

Së fundi, Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit përcakton detyrimin e përgjithshëm të Shqipërisë për të përafëruar legjislacionin e saj me acquis e BE-së.

I.2. Situata aktuale

Në përgjithësi, në fushën e ndërmarrjeve dhe politikës industriale, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur. Njëfarë përparimi u bë në vitin 2018, pasi u prezantuan një numër masash për nxitjen e investimeve, mbështetjen e biznesit dhe u ruajt fokusi në parimet e Aktit të Biznesit të Vogël.

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020 është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 635, datë 1.10.2014 “Mbi miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020”. Strategjia po zbatohet si dokumenti kryesor strategjik i qeverisë shqiptare që përcakton përqasjen ndaj zhvillimit industrial/ristrukturimit dhe

përmirësimit të konkurrencës. Zhvillimi industrial dhe përmirësimi i konkurrencës janë prioritet kryesorë për Qeverinë që adresojnë çështjet kryesore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Qeveria shqiptare është duke i kushtuar rëndësi të veçantë forcimit të kapaciteteve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për të thithur teknologji të reja dhe për të rritur punësimin. Për 2018, 4 fonde janë menaxhuar nga AIDA, konkretisht:

- 13 kompani përfituan nga Fondi i Ekonomisë Kreative, i cili u disbursua në masën 5,000,000 Lekë për kompanitë fituese;
- 14 kompani përfituan nga Fondi Start Up, i cili u disbursua në masën 7,000,000 Lekë për kompanitë fituese;
- 15 kompani përfituan nga Fondi i Konkurrueshmërisë, i cili u disbursua në masën 17,000,000 Lekë për kompanitë fituese;
- 6 kompani përfituan nga Fondi i Inovacionit, i cili u disbursua në masën 3,388,668 Lekë për kompanitë fituese.

Megjithatë, duhet të ndërmerren hapa të mëtejshëm për të rritur aftësinë e NVM-ve për të përthithur teknologjitë e reja dhe proceset e biznesit.

Shqipëria merr pjesë në programin COSME të BE-së për NVM-të dhe Rrjetin e Ndërmarrjeve Evropiane nëpërmjet një konsorciumi të udhëhequr nga Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve. Gjatë vitit 2018 u zhvilluan aktivitete ndërgjegjëse për të nxitur ndërmarrjet shqiptare për të marrë pjesë në programin COSME. Si pjesë e këtij programi, deri më tani janë alokuar 570 000 euro për operatorët ekonomikë shqiptarë në grante për to aksione: Enterprise Europe Network (EEN) dhe Erasmus for Young Entrepreneurs (EYE).

Ligji Nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara” është përafuar pjesërisht me Direktivën 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 16 shkurtit 2011 mbi luftën kundër pagesave të vonuara në transaksionet tregtare. Ligji hyri në fuqi më 4 qershor 2014. Ligji përcakton rregullat për luftën kundër pagesave të vonuara në transaksionet tregtare ndërmjet ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve dhe autoriteteve publike. Raporti i KE-së i vitit 2018 për Shqipërinë rekomandon se duhet të arrihet përafrimi i plotë i Direktivës.

Dy studime u përfunduan në vitin 2017 në industrinë e bakrit dhe sektorin e lëkurë-këpucës si pjesë e reformave strukturore në kuadrin e Programit të Reformave Ekonomike që synon nxitjen e investimeve private në këto fusha. Bizneset janë informuar mbi këto studime dhe potencialet për investime dhe zhvillim në këta sektorë të industrisë shqiptare.

Ligji Nr. 93/2015 “Për Turizmin” është miratuar në korrik të vitit 2015 dhe i janë bere disa shtesa ne dhjetor te vitit 2017 qe lidhen kryesisht me nxitjen e investimeve ne hotelet me 4-5 yje . Ligji është në përputhje me angazhimet që rrjedhin nga nenet 70 dhe 94 “Turizmi” të MSA-së. Ligji është përafuar pjesërisht me Rregulloren (EU) Nr 692/2011 të Parlamentit Evropian dhe

Këshillit të datës 6 korrik 2011 lidhur me statistikën evropiane mbi turizmin dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 95/57/EC dhe Direktivën e Këshillit 90/314/KEE të 13 qershor 1990 mbi paketat e udhëtimit, paketat e pushimeve dhe paketat e tureve turistike. Për më tepër, gjatë kësaj kohe, 13 nga 15 aktet nënligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 93/2015 janë miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ne të njëjtën kohë me synimin për të nxitur dhe rregulluar zhvillimin e agroturizmit është miratuar nga Këshilli i Ministrave VKM-ja mbi kriteret për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit. Për më tepër, Ministri përgjegjës për turizëm miratoi 9 Urdhra të Ministrit dhe 4 Udhëzime të Ministrit. Grupi i punës është në proces hartimi të paketës së plotë të akteve ligjore.

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm 2019 – 2022, u rishikua nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pas ndryshimit në fushën e përgjegjësi të ministrive që ndodhi në shtator 2017, duke forcuar dimensionin mjedisor. Ky dokument u prezantua dhe u konsultua me aktorë të ndryshëm, biznese, universitete, organizata ndërkombëtare dhe individë. Komentet dhe sugjerimet e tyre janë reflektuar në projektstrategji dhe drafti do të dërgohet për diskutim pranë Ministrive të linjës brenda tremujorit të parë. Strategjia do të miratohet nga Këshilli i Ministrave brenda tremujorit të dytë të vitit 2019.

Përpyqje të mëtejshme u ndërmorën në vitin 2018, me qëllim zbatimin e masave efektive për formalizimin e ekonomisë joformale, për të luftuar evazionin fiskal dhe për të nxitur pajtueshmërinë vullnetare të taksave. Për këtë qëllim, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miratoi një Strategji të posaçme komunikimi për përfshirjen e taksapaguesve me xhiro mbi 2 milion Lekë në skemën e TVSH-së. Strategjia u zbatua me sukses gjatë vitit 2018. Po ashtu, masa të tjera u morën nga Drejtoria e Hetimit Tatimor dhe degët e saj duke synuar luftën kundër evazionit fiskal. Një plan i veçantë pune u miratua dhe u zbatua gjatë sezonit turistik të verës fokusuar në zbatimin e legjislacionit tatimor nga hotelet, restorantet, etj. Edhe Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Sociale shtoi aktivitetin e tij në luftën kundër evazionit fiskal në bashkëpunim me autoritetet tatimore dhe institucione të tjera.

I.3. Prioritetet

Në vitin 2019, Shqipëria do të vazhdojë përpjekjet e saj për të zbatuar masat për përmirësimin e kuadrit rregullator për biznesin, duke përfshirë hyrjen dhe daljen nga tregu, me fokus të veçantë në përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve të *Doing Business*. Sipas Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020, dhe duke marrë parasysh Raportin e KE të vitit 2018 e Shqipërisë, prioritetet janë:

- Vazhdimi i zbatimit të SBA për NVM-të;
- Forcimi i kapaciteteve teknologjike të NVM-ve;
- Hartimi dhe zbatimi i një politike kërkimore të integruar dhe zhvillimi i mëtejshëm i masave për të nxitur inovacionin dhe konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla;
- Kryerja e analizave sektoriale si nikel-silikate, hekur-nikel, kuarcite, etj për të analizuar mundësitë për investime të brendshme dhe të huaja;

- Inicimi i një projekti për krijimin e një luster industrial në sektorin e industrisë përpunuese të drurit.

II.1. Politika industriale – Operacionet sektoriale

II.1.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020 është dokumenti kryesor strategjik i Qeverisë shqiptare që përcakton përqasjen ndaj zhvillimit industrial / ristrukturimit dhe përmirësimit të konkurrueshmërisë. Strategjia u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 635, datë 1.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020”. Zhvillimi industrial dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë janë prioritet kryesorë për Qeverinë që adresojnë çështjet kryesore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020 është në përputhje me dokumentet kryesore të BE-së në fushën e nxitjes së biznesit dhe investimeve dhe si e tillë, ajo ka si fokus të saj një nga prioritetet kryesore të BE-së për periudhën 2014 – 2020, rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë. Prioritetet e Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020 janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 11.05.2016.

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020 është në harmoni me strategjinë e Evropës Juglindore 2020, e cila reflekton politikat e nevojshme për të përmirësuar mirëqenien e të gjithë qytetarëve dhe për të lehtësuar integrimin evropian.

Qendra Kombëtare e Biznesit (NBC) e themeluar sipas Ligjit Nr. 131/2015 funksionon si “one-stop-shop” për biznesin, për regjistrimin e tij dhe procesin e licencimit / dhënies së lejeve.

Kuadri ligjor për zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik është i plotësuar me Ligjin Nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Gjatë vitit u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 16.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 646, datë 22.07.2015 ‘Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen e zhvilluesit të zonës së zhvillimit teknologjik dhe ekonomik” dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 35, datë 10.09.2018 “Për përcaktimin e procedurës për zgjedhjen e zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në procedurën e aplikimit, prona private”. Këto ndryshime të fundit të kuadrit ligjor lejojnë që njësitë e qeverisjes qendrore ose njësitë vendore të bëhet zhvilluese të një zone zhvillimi teknologjik dhe ekonomik dhe mundësinë e shpalljes së TEDA-ve në pronën private.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Agjencia e Prokurimit Publik; Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK);
- Instituti i Statistikave (INSTAT)

II.1.3. Aktivitetet e planifikuara

II. 1.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023 është duke u finalizuar. Strategjia do të miratohet nga Këshilli i Ministrave brenda tremujorit të dytë të vitit 2019.

II. 1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka akte ligjore të planifikuara në këtë nënkapitull.

II. 1.3.3. Aktivitete të tjera të planifikuara

Në vitin 2019, bazuar në ndryshimet në kuadrin ligjor të zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të bëra gjatë vitit 2018, do të iniciohet ngritja e dy modeleve të reja të zonave teknologjike dhe të zhvillimit ekonomik:

- TEDA në pronë private;
- TEDA me zhvilluesit e njësisë së qeverisjes qendrore ose njësisë vendore.

II.2. Privatizimi dhe ristrukturimi

II.2.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Privatizimi i paketave aksionare strategjike (shoqërive tregtare që operojnë në sektorë me rëndësi të veçantë për ekonominë) zbatohet në përputhje me Ligjin Nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

Ministri përgjegjës për ekonominë rishikon çdo vit planin për privatizimin e pasurive publike. Plani aktual i veprimit për privatizimin/likuidimin e shoqërisë shtetërore në sektorët jo strategjikë 2017 – 2020, u miratua nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si dokumenti Nr. 2564, datë 29.03.2017.

Në lidhje me privatizimin, Ministri i Financave dhe Ekonomisë nxori Urdhrin Nr. 88, datë 21.03.2018, duke ndryshuar Planin e veprimit për privatizimin e aseteve shtetërore, për periudhën 2016 - 2020, për vitet 2018– 2020. Gjatë vitit 2018, janë privatizuar 16 asete shtetërore duke realizuar 79,100,000 lekë dhe 90,633,000 Bono Privatizimi (në lekë), pra në total 169,000,000 lekë. Shitja e aseteve bëhet nëpërmjet procedurës së ankandit publik ku ish-pronarët e tokës kanë të drejtën e parablerjes.

II.2.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

II.2.3. Aktivitetet e planifikuara

II. 2.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka masa politikash të planifikuara në këtë nënkapitull.

II. 2.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka akte ligjore të planifikuara në këtë nënkapitull.

II. 2.3.3. Aktivitete të tjera të planifikuara

Nuk ka aktivitete të tjera të planifikuara në këtë nënkapitull.

II.3. Mjedisi i biznesit

II.3.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020 është dokumenti kryesor strategjik i Qeverisë shqiptare që përcakton përjasjen ndaj zhvillimit industrial / rristrukturimit dhe përmirësimit të konkurrueshmërisë. Strategjia u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 635, datë 1.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020”. Zhvillimi industrial dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë janë prioritetet kyçe të Qeverisë që adresojnë çështjet kryesore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Lidhur me konkurrueshmërinë, Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020 synon veprime dinamike për të përmirësuar klimën e biznesit, për të krijuar mekanizma rregullatorë dhe institucionalë për të përmirësuar proceset e regjistrimit dhe licencimit të biznesit dhe për të zvogëluar kostot e saj, si dhe masat për të reduktuar ekonominë informale dhe për të siguruar konkurrencë të ndershme në treg, diçka që do të ketë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e biznesit.

Për përmirësimin e konkurrueshmërisë është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 591, datë 10.09.2014 “Për miratimin e planit të veprimit për përmirësimin dhe monitorimin e treguesve të “*Doing Business*”, të ndryshuar. Masat synojnë të përmirësojnë treguesit e *Doing Business* duke u përqendruar kryesisht në lejet e ndërtimit, regjistrimin e biznesit, marrjen e energjisë elektrike dhe tregtinë jashtë kufijve.

II.3.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Instituti i Statistikave (INSTAT).

II.3.3. Aktivitetet e planifikuara

II. 3.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Gjatë periudhës 2019 – 2021 nuk është parashikuar miratimi i akteve ligjore që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis e Bashkimit Evropian.

II. 3.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka akte ligjore të planifikuara në këtë nënkapitull.

II. 3.3.3. Aktivitete të tjera të planifikuara

Në tremujorin e katërt të vitit 2019 është parashikuar miratimi i Projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj synon reduktimin e barrës rregullore dhe lehtësimin e të bërit biznes. Projektligji do të bazohet në rezultatet e grupit të punës për derregullimin.

II.4. Politika e NVM-ve

II.4.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020 është dokumenti kryesor strategjik i Qeverisë shqiptare që përcakton përjasjen ndaj zhvillimit industrial / ristrukturimit dhe përmirësimit të konkurrueshmërisë. Strategjia u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 635, datë 1.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020”. Zhvillimi industrial dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë janë prioritetet kyçe të Qeverisë që adresojnë çështjet kryesore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve është pjesë integrale e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 – 2020. Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 - 2020 shërben si dokument bazë i politikës së NVM-ve. Vizioni i këtij dokumenti politikash është “Përmirësimi i klimës për përshpejtimin e zhvillimit të biznesit dhe investimeve, rritja e konkurrueshmërisë së NVM-ve në tregjet rajonale dhe globale, përmes zhvillimit dhe teknologjisë së informacionit, dhe reduktimit të barrierave administrative dhe krijimit të lehtësirave për biznesin”.

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi strategjik është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i sektorit të NVM-ve përmes rritjes së numrit të ndërmarrjeve të reja dhe sigurimit të përmirësimit të vazhdueshëm të produktivitetit, konkurrueshmërisë dhe treguesve të eksportit.

Në Republikën e Shqipërisë, SME-të rregullohen në Ligjin Nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme”, të ndryshuar. Ligji është në përputhje me Rekomandimin e Komisionit të 6 majit 2003 lidhur me përcaktimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Ky Ligj i klasifikon ndërmarrjet si ndërmarrje mikro, ndërmarrjet e vogla dhe ndërmarrjet e mesme.

Neni 4 i këtij Ligji përcakton kriteret për secilën kategori. Kategoria e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM) përbëhet nga ndërmarrjet që punësojnë më pak se 250 persona me një qarkullim vjetor dhe / ose një bilanc vjetor total prej jo më shumë se 250 milionë lekë (rreth 2.03 milionë euro).

Një ndërmarrje e vogël përkufizohet si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 50 persona dhe qarkullimi vjetor dhe / ose totali i bilancit vjetor nuk i kalon 50 milionë lekë (rreth 0.41 milion euro).

Një ndërmarrje mikro është definuar si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 10 persona dhe qarkullimi vjetor dhe / ose totali i bilancit vjetor nuk kalon 10 milionë lekë (afërsisht 0.08 milion euro).

Për qëllime statistikore, ndërmarrjet klasifikohen:

- a. Ndërmarrjet mikro: 0 deri në 9 persona, brenda këtij grupi ndahen në 0-1 persona dhe 2-9 njerëz;
- b. Ndërmarrjet e vogla: 10 deri në 49 persona;
- c. Ndërmarrjet e mesme: 50 deri në 249 persona.

Ligji Nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara” është përafuar pjesërisht me Direktivën 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 16 shkurtit 2011 mbi luftën kundër pagesave të vonuara në transaksionet tregtare. Ligji hyri në fuqi më 4 qershor 2014. Ligji përcakton rregullat për luftën kundër pagesave të vonuara në transaksionet tregtare ndërmjet ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve dhe autoriteteve publike. Sipas nenit 17 të këtij Ligji, dispozitat e tij nuk do të zbatohen ndaj detyrimeve financiare të krijuara dhe të mos ekzekutuara para hyrjes në këtë ligj, d.m.th. Ligji nuk zbatohet për pagesat e vonuara të autoriteteve publike të grumbulluara para 4 qershorit 2014. Sidoqoftë, siç rekomandohet nga Raporti i KE-së i vitit 2018 mbi Shqipërinë, duhet të arrihet përafrimi i plotë i Direktivës.

II.4.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Instituti i Statistikave (INSTAT).

II.4.3. Aktivitetet e planifikuara

II.4.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka masa politikash të planifikuara në këtë nënkapitull.

II.4.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka akte ligjore të planifikuara në këtë nënkapitull.

II.4.3.3. Aktivitete të tjera të planifikuara

Nuk ka aktivitete të tjera të planifikuara në këtë nënkapitull.

III. Allokimet financiare

III. 1. Buxheti

000 Lek

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total i institucionit koordinues për këtë kapitull	0	0	0
Buxheti total i institucioneve të tjera.	600	0	0
Buxheti total i kapitullit	600	0	0

Kapitulli 21: Rrjetet Trans-Evropiane

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e acquis së Bashkimit Evropian

Politika e Bashkimit Evropian në lidhje me rrjetet trans-evropiane për transport (TEN-T) dhe energji (TEN-E) bazohet në tri elemente themelore: baza ligjore për TEN-të, nenet 170 – 172 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, Rregullorja (BE) 1315/2013 mbi udhëzimet e Unionit për zhvillimin e rrjetit trans-evropian të transportit në transport dhe energji dhe Rregullorja (BE) 1316/2013 për krijimin e Connecting Europe Facility, që ndryshon Rregulloren (BE) 913/2010 dhe shfuqizon Rregulloret (KE) 680/2007 dhe (KE) 67/2010. Kjo kornizë përcakton objektivat e politikës së BE-së për politikën e rrjetit ndër-evropian, i cili përfshin rrjetet e transportit dhe të energjisë dhe synon përshtatjen dhe zhvillimin e rrjeteve dhe sigurimin e ndërlidhjeve dhe ndërveprimit të tyre. Politikat TEN-T dhe TEN-E kanë pësuar një rishikim substancial. Instrumenti i ri i financimit për rrjetet trans-evropiane, CEF (Connecting Europe Facility) dhe udhëzimet e rishikuara TEN-T dhe TEN-E hynë në fuqi më 1 janar 2014. Qëllimi i krijimit dhe zhvillimit të rrjeteve trans-evropiane dhe promovimi i interkonjeksionit dhe ndërveprimit të përshtatshëm të rrjeteve kombëtare është për të përfituar plotësisht nga tregu i brendshëm dhe për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në Bashkimin Evropian.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Lidhur me rrjetet trans-evropiane në transport, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në nenin 106 “Transporti” përcakton se palët, d.m.th. Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të përqendrohen në fushat prioritare që lidhen me acquis e BE-së, duke synuar ristrukturimin dhe modernizimin e mënyrave të transportit të Shqipërisë, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multimodale dhe lidhjen me rrjetet kryesore trans-evropiane dhe arritjen e standardeve operative të krahasueshme me ato të Bashkimit Evropian.

Në sektorin energjetik, neni 107 përcakton se bashkëpunimi në energji do të bazohet në Traktatin rajonal të Komunitetit të Energjisë të nënshkruar me synim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet e energjisë të Evropës.

Neni 70 përcakton se Shqipëria do të përafrtojë gradualisht legjislacionin e saj me acquis të BE-së me qëllim përmirësimin e sistemit dhe shërbimeve të transportit dhe energjisë.

I.2. Situata aktuale

Njëfarë niveli përgatitjeje është arritur tashmë në fushën e rrjeteve ndër-evropiane. Shqipëria bëri përparime vitin e kaluar, si në rrjetet e transportit ashtu edhe në atë energjetik.

Lidhur me rrjetet trans-evropiane të transportit, Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Planit i saj i Veprimit 2016 – 2020 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”. Strategjia parashikon zhvillimin e rrjeteve bazë dhe gjithëpërfshirëse të transportit në përputhje me kërkesat e BE-së nën qasjen trans-evropiane. Aktualisht është përgatitur raporti i parë i monitorimit të kësaj strategjie, duke theksuar arritjet edhe në këtë fushë.

Me Ligjin Nr. 8/2018, datë 26.02.2018 “Për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë ky Traktat, që është një nga dokumentet më të rëndësishëm për të gjithë sektorët e transportit, dhe që do të jetë udhërrëfyese për vitet në vijim. Zbatimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit do të përmirësojë sektorin e transportit, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe do të përmirësojë në lidhjen e rrjetit shqiptar të transportit me rrjetin e transportit të BE-së. Traktati parashikon përafrimin e mëtejshëm të legjislacioneve kombëtare me Acquis e BE-së, për të gjitha fushat e transportit

Në sektorin e energjisë, Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018 – 2030” (VKM nr. 480, datë 31.07.2018 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030”). Përparim është arritur veçanërisht në sektorin e gazit. Së pari, u miratua Master Plani i Gazit (miratuar me VKM nr. 87, datë 14.2.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”) dhe u përgatit studimi strategjik i vlerësimit mjedisor dhe identifikimit të projektit. Së dyti, Gazsjellësi Trans-Adriatik po ndërtohet sipas planit (deri në nëntor 2018 janë përfunduar mbi 90% të punimeve në seksionin tokësor, si dhe kanë filluar punimet në pjesën tokësore të seksionit detar). Në sektorin e energjisë elektrike, do të fillojë ndërtimi i linjës së transmetimit të energjisë Shqipëri – Maqedoni.

Sidoqoftë, në periudhën e ardhshme, zhvillimi i rrjeteve bazë të transportit dhe energjisë duhet të përshpejtohet siç parashikohet në strategjitë kombëtare dhe në përputhje me prioritetet e investimeve në infrastrukturë në kuadër të listës së vetme të projekteve dhe agjendës së konektivitetit.

Përveç kësaj, kuadri ligjor shqiptar nuk është plotësisht i përafruar me acquis e BE-së dhe me rregulloret mbi TEN-T dhe TEN-E. Përafrimi ligjor duhet të pasohet me forcimin e kuadrit institucional dhe kapaciteteve administrative për të zhvilluar dhe monitoruar rrjetet trans-evropiane.

I.3. Prioritetet

Rrjetet Trans-Evropiane të Transportit

Për sa i përket rrjeteve trans-evropiane të transportit, prioritet kryesor mbetet përshpejtimi i ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës bazë dhe gjithëpërfshirëse të transportit në përputhje me kërkesat e Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (që do të zëvendësohet nga Komuniteti i Transportit) dhe sipas Listës Kombëtare të Vetme të Projekteve. Ky prioritet, në përputhje me Strategjinë e Transportit, përkthehet në masat e mëposhtme kryesore:

- Ndërtimi i korridoreve kryesore të transportit rrugor me parametrat teknikë të autostradave ndërrbane, duke përfshirë Korridorin VIII Pan-Evropian, Korridorin Durrës – Morinë, që bën të mundur lidhjen me Korridorin 10, Korridorin Rrugor Veri-Jug (pjesë e autostradës Adriatiko-Joniane), Rrugës së Arbrit, si një degë e Korridorit VIII dhe Boshtit Qendror Jugor;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore ekzistuese dhe eliminimi i pikave të zeza;
- Rritja e vëmendjes ndaj Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve rrugore;
- Integrimi i mëtejshëm i rrjetit hekurudhor shqiptar në rrjetin rajonal të Evropës Juglindore, ku përfshihen Projekti i detajuar i zbatimit të rehabilitimit të linjës hekurudhore Vorë – Hani i Hotit kufi, Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë dhe ndërtimi i një lidhje të re me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, si dhe ndërtimi i lidhjes hekurudhore me Maqedoninë, etj.

Rrjetet Trans-Evropiane të Energjisë

Lidhur me rrjetet energjetike trans-evropiane, prioritet kryesor mbetet zgjerimi i rrjeteve energjetike me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit, diversifikimin e furnizimit dhe përmirësimin e integritetit të rrjetit elektrik shqiptar në rrjetet rajonale dhe evropiane.

Në përputhje me Strategjinë e Energjisë që është miratuar, Shqipëria synon të eksplorojë mundësitë për të zgjeruar linjat e saj të transmetimit të energjisë dhe gazit me vendet e tjera të Ballkanit dhe të Evropës Jug-Lindore.

Për sektorët e transportit dhe të energjisë, kërkohet përafrimi i mëtejshëm i Acquis së BE-së dhe rregulloreve mbi TEN-T dhe TEN-E.

Forcimi i kapaciteteve administrative do të mbështetet veçanërisht në sektorin e gazit në mënyrë që të zbatohet masat që përfshihen në Master Planin e Gazit.

II.1. Rrjetet Trans-Evropiane të transportit

II.1.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Dokumenti kryesor i politikës në sektorin e transportit është Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016 – 2020 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020 është (i) të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit të Shqipërisë, dhe (ii) përmirësojë ndjeshëm ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij me sistemin dhe rajonin më të gjerë të transportit ndërkombëtar dhe evropian.

Strategjia dhe Plani i saj i Veprimit janë plotësisht në përputhje me vizionin strategjik të Qeverisë Shqiptare dhe me konceptet kryesore të politikës evropiane të transportit. Ai siguron zhvillimin e një sistemi transporti eficient, të qëndrueshëm dhe ekologjik, në gjendje të mbështesë objektivat kyçe të zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë dhe të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Strategjia e Sektorit të Transportit parashikon zhvillimin në Shqipëri të shtrirjes të TEN-T indikative në Ballkanin Perëndimor të rrjeteve gjithëpërfshirëse dhe bazë sipas Rregullores (BE) Nr. 1315/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 11 dhjetorit 2013 mbi udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit trans-evropian të transportit dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 661/2010/BE të ndryshuar nga Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2016/758 e datës 4 shkurt 2016 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1315/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me përshtatjen e Aneksit III me to.

Shqipëria ka marrë pjesë në mënyrë aktive në Observatorin e Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) dhe ka për qëllim të vazhdojë të bashkëpunojë me fqinjët e saj me qëllim përcaktimin e përbashkët të projekteve me interes rajonal, shkëmbimin e informacionit mbi projektet aktuale të infrastrukturës dhe projektet prioritare për të ardhmen.

Ratifikimi i Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit do të rrisë edhe më tej integrimin e rrjetit shqiptar dhe rajonal të transportit në rrjetet evropiane të transportit. Sipas Traktatit, domethënë Neni 8(1) “Infrastruktura”, hartat e zgjatjes së rrjeteve gjithëpërfshirëse dhe bazë të rrjetit indikativ trans-evropian të transportit (TEN-T) në Ballkanin Perëndimor janë pjesë përbërëse e Traktatit të detyrueshme për të gjithë palët në Traktat. Neni 3 i Traktatit përcakton se palët kontraktuese janë të detyruar të harmonizojnë legjislacionin e tyre me *acquis* e BE-së, në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe vendimet e Komitetit Drejtues Rajonal.

Në rastin e rrjetit bazë rrugor, është arritur përparim në lidhje me cilësinë dhe densitetin e tij. Gjatë viteve të fundit janë realizuar disa projekte që synojnë të zvogëlojnë distancën kohore midis Tiranës dhe qyteteve të mëdha dhe / ose midis qyteteve të mëdha. Investimet synonin gjithashtu përmirësimin e sigurisë rrugore. Projektet janë të hartuara për të integruar rrjetin kombëtar në rrjetin rajonal dhe pan-Evropian TEN-T.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është pothuajse i përfshirë në rrjetin rajonal të transportit. Gjatësia e përgjithshme e linjës kryesore është rreth 420 km; ka 200 kilometra linjë dhe degë hekurudhore dytësore.

Lidhur me infrastrukturën portuale, investime janë kryer në të gjitha portet shqiptare. Qëllimi ishte rritja e kapaciteteve, shtimi i terminaleve / mjediseve të reja për anijet, pastrimi i baseneve të porteve, etj.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Instituti i Transportit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Portet detare, Sh.A;
- Autoriteti Portual i Durrësit;
- Hekurudha Shqiptare;
- Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

II.1.3. Aktivitetet e planifikuara

II.1.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Shqipëria me financimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ka përfunduar hartimin e dokumentit “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, i cili u prezantua më 12 dhjetor 2018. Ka përfunduar hartimi i dokumentit përfundimtar të VSM, në përputhje me ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Aktualisht jemi në procesin e marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe më pas do vijohet me miratimin e tij.

II.1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Një projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për rrjetin e transportit trans-evropian”, do të përgatitet dhe aprovohet në tremujorin e katërt të vitit 2019. Vendimi i Këshillit të Ministrave do të përafrohet pjesërisht me Rregulloren (BE) Nr. 1315/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 mbi udhëzimet e Bashkimit për zhvillimin e rrjetit trans-evropian të transportit dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 661/2010/BE.

Miratimi i Vendimit do të jetë në përputhje me rekomandimin e Raportit të KE-së të vitit 2018 për Shqipërinë dhe masat prioritare të Strategjisë Shqiptare të Transportit që synon të zhvillojë infrastrukturën e transportit në lidhje me sistemet dhe standardet e transportit rajonal dhe evropian.

II.1.3.3. Aktivitete të tjera të planifikuara

Nuk ka masa të tjera të planifikuara në këtë nënkapitulli.

II.2. Rrjetet Trans-Evropiane të Energjisë

II.2.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Dokumenti kryesor i politikave në sektorin e energjisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 – 2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 480, datë 31.07.2018. Kjo Strategji përcakton se vizioni i Shqipërisë është zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimal.

Për zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Shqipëri, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektori të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. Master Plani i Gazit përcakton linjat kryesore për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve të gazit në Shqipëri bazuar në gazin natyror të furnizuar nga gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), por edhe vendburime potenciale të gazit të zbuluara dhe konkretizuara në vend, apo edhe të gazsjellësve të tjerë si gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri – Kosovë.

II.2.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Enti Rregullator i Energjisë.

II.2.3. Aktivitetet e planifikuara

II.2.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka politika të planifikuara për t'u miratuar gjatë periudhës 2019 – 2021.

II.2.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk janë parashikuar akte ligjore që synojnë përafrimin e legjislacionit gjatë periudhës së planifikimit.

II.2.3.3. Aktivitete të tjera të planifikuara

Për sa u përket rrjeteve Trans-Evropiane të Energjisë për periudhën 2019- 2021 Shqipëria ka një sërë aktivitete të planifikuara. Kështu duke ju referuar sektorit të gazit, projektet prioritare në këtë sektor që lidhen kryesisht me rajonin e Evropës Juglindore janë:

- Ndërtimi i Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), i cili është parashikuar që në vitin 2019 të përfundojë punimet e ndërtimit dhe komisionimin, duke qenë i gatshëm që në fillimin e vitit 2020 të fillojë operimin për transportin e gazit;
- Zhvillimi i projektit të Gazsjellësit Adriatik - Jonian (Projekti IAP), për të cilin gjatë vitit 2019 do të vazhdojë përgatitja e Projektit Paraprak Teknik për seksionet e tij në territorin e Shqipërisë dhe të Malit të Zi, që po realizohet nga konsulenti SUEZ IPF-6, në bazë të një financimi prej 2.5 milionë Euro nga WBIF. Realizimi i këtij projekti ka filluar në vitin 2018;
- Zhvillimi i projektit të Gazsjellësit Shqipëri - Kosovë (Projekti ALKOGAP), për të cilin në fundin e vitit 2018 ka përfunduar Studimi i Parafizibilitetit i përgatitur nga Konsulenti COWI-IPF-4, sipas një financimi prej 0.3 milionë Euro nga WBIF;
- Zhvillimi i projektit për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit dhe të VNMS për ndërtimin e Depozitave Nëntokësore për stokimin e gazit në Zonën e Dumresë (Projekti UGS Dumrea), për të cilin është miratuar një financim prej 1 milionë Euro në Raundin e 20-të të WBIF. Projekti parashikohet të fillojë në vitin 2019 dhe të përfundojë në vitin 2020;
- Rikonstruksioni dhe rivënia në punë e TEC-it Vlorë duke përdorur gazin si lëndë djegëse, nëpërmjet dhënies me koncesion të rikonstruksionit të TEC-it dhe përcaktimit të versionit më optimal për ndërtimin e gazsjellësit që do të lidhë projektin TAP (në Fier) me TEC-in Vlorë dhe rajonin e Vlorës.

Informata më të hollësishme mbi ecurinë e projekteve të sipërpërmendura janë dhënë në kapitullin 15 të këtij dokumenti

III. Allokimet financiare

III. 1. Buxheti

000 Lek

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit koordinues	1,500	0	0
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve kontribuuese	0	0	0
Kostoja totale e kapitullit	1,500	0	0

Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e acquis së Bashkimit Evropian

Acquis në këtë kapitull përbëhet kryesisht nga rregulloret kuadër dhe ato zbatuese, të cilat nuk kërkojnë përafrimin në legjislacionin kombëtar. Këto rregullore përcaktojnë rregullat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të Fondeve Strukturore dhe Investuese Evropiane (ESIF) të cilat do të pasqyrohen në organizimin territorial të secilit vend. Këto programe janë negociuar dhe janë dakordësuar me Komisionin, por zbatimi është përgjegjësi e Shteteve Anëtare.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Republika e Shqipërisë në Kapitullin 22 do të fokusohet në:

- Zbatimin e nenit 110 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit që përcakton se palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë rajonale. Ndihma financiare e siguruar nga BE është e rregulluar me nenet 112 – 115 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA);
- Marrjen e masave për të reduktuar pabarazitë ekonomike, duke krijuar rajone konkurruese, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, zhvillim social, mjedisor dhe rrjedhimisht ekonomik dhe social të vendit në përputhje me standardet e BE;
- Përgatitjet e strukturave institucionale shqiptare për të zbatuar pas hyrjes në Bashkimin Evropian, programet e Bashkimit Evropian të përmendura më lart.

I.2. Situata aktuale

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore. Njëfarë përparimi u bë gjatë vitit 2018 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Financimit për programin kombëtar IPA 2017.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015 – 2020 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”. SKZHI 2015 – 2020 është dokumenti kryesor strategjik i Qeverisë shqiptare që siguron kombinimin e agjendës së integrimit në BE me zhvillimin e qëndrueshëm

ekonomik dhe social të vendit, duke përfshirë korrelacionin me Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). SKZHI është dokumenti ombrellë për të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale dhe në të njëjtën kohë strategjia kombëtare që promovon zhvillimin e përgjithshëm harmonik dhe koheziv të Shqipërisë. Gjatë vitit 2018 vazhdoi plotësimi i kuadrit strategjik sektorial veçanërisht me miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2015 – 2030 dhe Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore.

Qeveria shqiptare e inicioi konceptin e ri të zhvillimit rajonal në vitin 2015. Koncepti ishte një përgjigje ndaj domosdoshmërisë për të pasur një politikë koherente rajonale në përputhje me parimet e politikës së kohezionit të BE, duke mundësuar krijimin e rajoneve konkurruese, duke synuar një politikë të ekuilibruar dhe zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha rajoneve përmes reduktimit të pabarazive të zhvillimit midis rajoneve të ndryshme. Përjasja e re përqendrohet në hartimin e politikave zhvillimore që marrin parasysh perspektivën horizontale (territoriale), të koordinuar me instrumentet sektoriale dhe vendimmarrëse.

Zyra e Kryeministrit në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 176, datë 10.10.2017 përfshin tre departamente kryesore drejtpërdrejt nën Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave:

- Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes;
- Departamenti Rregullator dhe i Pajtushmërisë;
- Departamenti i Burimeve, Transparencës dhe Mirëadministrimit.

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes është përgjegjës për planifikimin strategjik, menaxhimin e politikave rajonale duke përfshirë Fondin e Zhvillimit Rajonal dhe listën e vetme të projekteve.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 961, datë 2.12.2015 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, Agjencisë për Zhvillimin Rajonal dhe agjencive Rajonale të Zhvillimit Ekonomik”, u shfuqizua. Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Rajonal (RED) dhe katër agjencitë për zhvillim rajonal (AZHR) iu bashkuan Fondit Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH). Ky ndryshim u bë për të përmirësuar dhe njësuar kuadrin institucional në zhvillimin rajonal dhe rritur eficienten e burimeve njerëzore të dedikuara për zhvillimin rajonal.

Programi Operacional i Zhvillimit Rajonal (RDOP) është dokumenti kuadër që paraqet drejtimet kryesore të Fondit të Zhvillimit Rajonal. Programi Operacional i Zhvillimit Rajonal për periudhën 2018 – 2019 u miratua me Vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve Nr. 1, datë 10.4.2018, “Për miratimin e Programit Operacional ‘Zhvillimi Rajonal 2018 – 2019’, të granteve të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”. Programi Operacional parashikonte për vitin 2018 vazhdimin e projekteve të iniciuara gjatë vitit 2017.

NSPP 2016 – 2017 u miratua më 17 maj 2017 nga Këshilli Kombëtar i Investimeve (NIC) / Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), që është organi vendimmarrës, i kryesuar nga Kryeministri. Ndërkohë ka filluar rishikimi i NSPP 2016 – 2017 duke synuar përmirësimin e përgjithshëm të përgatitjes së lista të vetme sektoriale dhe të Listës së Vetme Kombëtare dhe

cilësinë e paketave të dokumenteve të kësaj Liste. Rritja e cilësisë së kësaj Liste dhe prioritizimit dhe përgatitjes së projekteve i përgjigjet rëndësisë në rritje të Instrumentit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Sikurse specifikuar edhe në Strategjinë e BE-së të Zgjerimit të Ballkanit Perëndimor, të datës 6 shkurt 2018, Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) do të jetë gjithmonë e në rritje instrumenti kryesor për investimet në rajon.

Koordinimi sektorial do të përmirësohet me zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ ndërsektorial të integruar”. Bazuar në këtë Urdhër janë duke u ngritur 10 Grupe të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe Komitete Drejtuese Sektoriale (KDS) të cilët do të jenë përgjegjës për koordinimin, programimin dhe monitorimin e politikave dhe projekteve sektoriale. Ngritja e këtij mekanizmi për koordinimin sektorial dhe ndërsektorial plotëson një nga rekomandimet e Komisionit Evropian.

Koordinimi i programimit dhe monitorimit të asistencës IPA kryhet nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme me cilësinë e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (NIPAC), sikurse përcaktuar në Urdhër të Kryeministrit Nr. 151, datë 27.09.2017. Ky urdhër përcakton edhe se Drejtoria për Fondet e BE-së do të shërbejë si Zyra Mbështetëse e NIPAC-ut (NIPAC SO). NIPAC dhe NIPAC OS kanë të njëjtat detyra dhe përgjegjësi siç kërkohet në Marrëveshjen Kuadër të BE-së ndërmjet KE – Shqipëri. Drejtoria e Fondeve të BE-së është pjesë e strukturës organizative të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Zyrtari Kombëtar Autorizues (Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë) mban përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin financiar të asistencës IPA në Shqipëri duke siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve sipas IPA I dhe IPA II. ZKA-ja mbështetet nga strukturat drejtuese, të cilat përbëhen nga Fondi Kombëtar dhe Drejtoria për Mbështetjen e ZKA/NAO. Të dyja këto janë struktura të veçanta brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të përgjegjshme tek NAO për qëllimet e zbatimit të IPA-s.

Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës e Akredituar nga BE u krijua me Ligjin Nr. 90/2016, datë 15.09.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit për Programet e Asistencës të akredituar nga BE në Republikën e Shqipërisë”. Agjencia ka si objekt të veprimtarisë auditimin për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit European.

Gjatë viti 2018, u nënshkrua Marrëveshja e Financimit për Programin IPA 2017. Ndërkohë është finalizuar programimi për paketën financiare IPA 2018. Gjatë vitit 2019 do të finalizohet programimi për Programet Vjetore IPA 2019 dhe 2020. Marrëveshjet e Financimit për IPA 2018, 2019 dhe 2020 do të nënshkruhen gjatë vitit 2019. Këto programe do të synojnë mbështetjen për reformat në sektorët strategjike në funksion të procesit të anëtarësimit dhe plotësimit të politikave prioritare të Qeverisë shqiptare. Fushat kryesore për mbështetje janë: drejtësia, shteti i së drejtës dhe antikorrupsioni, sektori i ujit me fokus ujësjellës-kanalizimet, turizmi, respektimi i së drejtës së pronës, përfshirja sociale, ekonomia qarkulluese me fokus mbrojtjen e mjedisit.

Monitorimi i programeve IPA, gjatë vitit 2018 u fokusua në zbatimin e kontratave të mbështetjes buxhetore për reformat me rëndësi primare për hapjen e negociatave të anëtarësimit: reforma në drejtësi, reforma në administratën publike, lufta kundër korrupsionit dhe menaxhimi i financave publike. Në tërësi, nga monitorimi i kryer gjatë vitit 2018, rezulton se fondet nën menaxhim të decentralizuar dhe indirekt po përdoren sipas planeve të veprimit dhe nuk janë vërejtur probleme të mëdha ose problemet janë adresuar duke mosjellë pengesa serioze gjatë zbatimit të tyre.

Gjatë vitit 2018 vazhdoi forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e fondeve IPA dhe konsolidimi i institucioneve përkatëse. Megjithatë, Shqipëria synon të forcojë më tej kapacitetet e saj lidhur me menaxhimin e IPA-s si pjesë e përgatitjeve për anëtarësimin në BE. Kjo është në përputhje me rekomandimin e Raportit të KE-së të vitit 2018 për Shqipërinë që bëri thirrje për forcimin e kapaciteteve administrative, veçanërisht të Njesisë Qendrore të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU) të Ministrisë së Financave, Zyrës për Mbështetje të Zyrtarëve Kombëtar të Autorizuar dhe Autoritetit të Auditimit.

Në kuadër të Bashkëpunimit Territorial, Shqipëria merr pjesë në 8 Programe Ndërkufitare dhe Transnacionale nën perspektiven IPA II 2014-2020, koordinimi dhe zbatimi i të cilave kryhet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe konkretisht Struktura Operuese në Drejtorinë e Fondeve të BE-së. Në këtë aspekt janë ngritur dhe funksionojnë të gjitha strukturat e përfshira në zbatimin e Programeve të Bashkëpunimit Territorial, si: zyrat e Kontrollit të Nivelit të Parë (FLC), Sekretariatet e Përbashkëta, Antenat, Pikat e Informimit, etj. Drejtuesi i Strukturës Operuese është caktuar me urdhrin e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme/KKIPA nr. 50, datë 29.01.2018.

Gjithashtu, MEPJ ka ndjekur procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse të financimit për programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar, konkretisht: Programi IPA BNK Mali i Zi-Shqipëri për vitet 2016 dhe 2017, Programi Maqedoni-Shqipëri dhe Programi Kosovë-Shqipëri për vitin 2017.

Gjatë vitit 2018 janë shpallur disa thirrje për projekt propozime ku është vënë re një numër në rritje e aplikantëve shqiptarë, çka tregon një rritje e interesit nga ana e tyre për të përfituar nga fondet e BE-së.

I.3. Prioritetet

Prioritetet në Kapitullin 22 janë në përputhje me rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Evropian siç janë paraqitur në Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2018 për Shqipërinë. Këto prioritetet janë:

- Forcimi i kapaciteteve administrative të Njesisë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit, Autoritetit të Auditimit dhe në veçanti Zyrës Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar të Autorizuar (CAO);
- Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPSI) dhe të grupeve për menaxhimin e integruar të politikave dhe strukturave të tjera të përqasjes sektoriale dhe ndërsektoriale;
- Përshpejtimi i zbatimit të programeve reformuese sektoriale duke shmangur vonesat në thithjen e fondeve për përkrahjen e buxhetit për të ecur përpara drejt plotësimit të kritereve të anëtarësimit;
- Rritja e kapaciteteve programuese në përputhje me përqasjen sektoriale dhe përmirësimin e funksionimit të listës sektoriale të projekteve të maturuara;
- Programimi sektorial shumëvjeçar në përputhje me përqasjen sektoriale IPA 2014 – 2020 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm;
- Forcimi i koordinimit midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshillit të Ministrave, etj, për zhvillimin e politikave dhe programeve të zhvillimit rajonal realiste dhe të buxhetuara;
- Bashkërendimi i suksesshëm dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe institucional të zhvillimit rajonal;
- Përdorimi në mënyrë eficiente dhe strategjike i fondeve për zhvillimin e rajoneve përmes një përqasjeje të bazuar në partneritet;
- Rritja e pjesëmarrjes së suksesshme të Shqipërisë në Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) dhe lehtësimi i hartimit të projekteve rajonale në mbështetje të Strategjisë.

II.1.1 Kuadri i politikave dhe ai ligjor

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015 – 2020 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”. SKZHI 2015 – 2020 është dokumenti kryesor strategjik i Qeverisë shqiptare që siguron kombinimin e agjendës së integrimit në BE me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit, duke përfshirë korrelacionin me Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Është dokumenti ombrellë për të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale dhe në të njëjtën kohë strategjia kombëtare që nxit zhvillimin e përgjithshëm harmonik dhe koheziv të Shqipërisë. SKZHI 2015 – 2020 dhe strategjitë sektoriale rregullojnë përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm.

Projektligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin është duke u përgatitur. Projektligji rregullon koordinimin e institucioneve dhe programeve të zhvillimit rajonal. Projektligji parashikohet të filloje procedurën e miratimit brenda vitit 2019. Miratimi i Projektligjit për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin do të pasohet nga përgatitja dhe miratimi i legjislacionit të nevojshëm dytësor, i cili do të sqarojë autoritetet menaxhuese dhe sistemin e qeverisjes së fondeve strukturore.

Buxheti shumëvjeçar dhe fleksibiliteti i buxhetit parashikohen në Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008, kërkon përgatitjen e buxhetit vjetor për vitin e ardhshëm dhe përgatitjen njëkohësisht të programit buxhetor afatmesëm (PBA). Sipas Neneve 25 dhe 26 të Ligjit, PBA siguron parashikimin trevjeçar të shpenzimeve buxhetore për të gjitha institucionet buxhetore në Republikën e Shqipërisë.

Ligji Nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10296, datë 8.07.2010 ‘Për menaxhimin financiar dhe kontrollin’ është akti kryesor ligjor që rregullon kontrollin financiar.

Ligji Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” është akti kryesor ligjor që rregullon auditimin e brendshëm në entitetet publike.

Struktura institucionale dhe koordinimi për menaxhimin e fondeve IPA rregullohen me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 541, datë 18.06.2015 “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit IPA II (2014 – 2020). Çdo rol siç përcaktohet në rregulloret e KE dhe nga Marrëveshja Kuadër midis Shqipërisë dhe Komisionit Evropian është përcaktuar për strukturat dhe autoritetet brenda Qeverisë shqiptare dhe funksionet e tyre janë përshkruar në detaje.

Ligji Nr. 90/2016, datë 15.09.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit për Programet e Asistencës së Akredituar nga BE në Republikën e Shqipërisë, krijoi Agjencinë e Auditimit për Programet e Asistencës së Akredituar të BE-së dhe rregullon aktivitetin e saj.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- INSTAT;
- Agjencia e Auditimit për Programet e Ndihmës së Akredituar në BE;
- Njësite zbatuese IPA në ministritë e linjës.

II.1.3. Aktivitetet e planifikuara

II.1.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka dokumente të planifikuara të politikave për t'u miratuar në vitin 2019.

II.1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka dokumente të planifikuara të politikave për t'u miratuar në vitin 2019.

II.1.3.3. Aktivitete të tjera të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka masa të tjera të planifikuara në këtë kapitull.

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

000 Lek

Viti	2019	2020	2021
Buxheti i kapitullit i institucionit koordinues	342,000	275,780	226,780
Buxheti total i Kapitullit i institucioneve kontribuuese			
Buxheti total i kapitullit	429,330	381,000	406,000

Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

I.1 Përmbajtja

Kapitulli 23 është një kapitull thelbësor për përpjekjet e para-aderimit dhe ka një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim, ku përcaktohen kufizime të sakta dhe pika të rëndësishme së bashku me monitorimin nga Bashkimi Evropian. Ky kapitull mbulon tri fusha të rëndësishme, sistemin gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore.

Në pajtim me deklaratën e Politikës së BE-së për Fqinjësinë dhe Negociatave të Zgjerimit në Kapitullin 23 përfshihen: "Politikat e BE-së në fushën e gjyqësorit dhe të të drejtave themelore, të cilat synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej Bashkimin si një fushë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Krijimi i një gjyqësori të pavarur dhe efikas ka një rëndësi të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe standardi i lartë i gjyqimit nga ana e gjykatave janë thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit. Kjo kërkon një angazhim të fortë për të eliminuar ndikimet e jashtme mbi gjyqësorin dhe për t'i përkushtuar burime të mjaftueshme financiare dhe trajnime. Me rëndësi të veçantë janë dhe krijimi i garancive ligjore për procedurat e një gjykimi të drejtë. Po kështu, Shtetet Anëtare duhet të luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive, pasi kjo paraqet një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit. Një kuadër i fortë ligjor dhe institucione të besueshme janë të nevojshme për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin e korrupsionit. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë respektin për të drejtat themelore dhe të drejtat e qytetarëve të BE-së, siç garantohet nga Acquis dhe nga Karta e të Drejtave Themelore.²²

Ky parashtrim i parimeve është përkthyer në kuadrin e fortë ligjor të Bashkimit Evropian i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Anëtare të tij dhe gjithashtu të atyre vendeve kandidatë që synojnë të jenë shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Prandaj është e domosdoshme për secilin vend kandidat që synon të bëhet një shtet anëtar i BE-së për të njohur dhe përafruar acquis e BE-së që mbulon kapitullin 23.

Më konkretisht Neni 2 i Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE) parashikon që Bashkimi themelohet nga parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Neni 3 (2) i TBE dhe neni 67 (1) i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) kanë krijuar zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Parimi i sundimit të ligjit dhe e drejta për një gjykim të drejtë, gjithashtu përfshihen në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe në nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta). Të dy artikujt parashikojnë që gjyqësori duhet të jetë i

pavarur dhe i paanshëm. Zbatimi i këtyre parimeve kërkon angazhimin e shteteve anëtare për eliminimin e ndikimeve të jashtme mbi gjyqësorin, për të vendosur burime të mjaftueshme financiare dhe trajnime për rritjen e nivelit të gjyqësorit dhe gjithashtu për të pasur garancitë ligjore për procedurat e gjykimit të drejtë.

Përveç kësaj, Shtetet Anëtare duhet të luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive pasi paraqet një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe për sundimin e ligjit. Neni 83 (1) i TFBE përcakton kompetencën e BE-së për të hartuar rregulla minimale në lidhje me përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e korrupsionit. Konventa e vitit 1995 për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Evropiane dhe Konventa e vitit 1997 e hartuar në bazë të nenit K.3 (2) (c) të TBE-së për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarët e Komuniteteve Evropiane ose zyrtarët e Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian nënkuptojnë se për të luftuar korrupsionin kërkohet dënimi penal "efektiv, proporcional dhe bindës". Një kornizë e fortë ligjore dhe institucione të besueshme janë të nevojshme për të mbështetur një politikë koherente të parandalimit të korrupsionit.

Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave themelore është i domosdoshëm. Sipas nenit 6 të TBE-së dhe jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE), Bashkimi respekton të drejtat themelore, të garantuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian siç rezulton nga traditat kushtetuese të përbashkëta për Shtetet Anëtare, si parime të përgjithshme të së drejtës së BE-së. Kështu, ato janë të detyrueshme për institucionet e Bashkimit në ushtrimin e kompetencave të tyre dhe për Shtetet Anëtare kur zbatojnë ligjin e BE-së (neni 51 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian). Mbrojtja e të drejtave themelore përfshin të drejtat tradicionale civile, si e drejta për jetë, e drejta për dinjitet dhe integritet, ndalimi i torturës dhe trajtimi degradues, e drejta për liri dhe siguri, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, liria e feja, liria e fjalës, liria e asociimit dhe e kuvendit, liria e edukimit, e drejta e pronësisë etj.

Këto të drejta mbrohen jo vetëm në nivelin e Kartës së të Drejtave Themelore, por edhe nëpërmjet akteve ligjore në fuqi. Për shembull, e drejta themelore për jetën private dhe mbrojtja e të dhënave personale mbrohet nëpërmjet një sërë aktesh ligjore: në veçanti nëpërmjet Direktivës 95/46 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave; Vendimit Kuadër 2008/977 mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kuadrin e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale dhe Direktivës 2002/58 / EC në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike (Direktiva mbi privatësinë dhe komunikimet elektronike). Acquis gjithashtu përmban garancitë për të siguruar barazinë. Ekziston një ndalim i përgjithshëm i diskriminimit në baza të ndryshme; duhet të sigurohet barazia ndërmjet burrave dhe grave; si dhe respektimi i barazisë kulturore, fetare dhe gjuhësore. Sipas nenit 21 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, anëtarët e pakicave kombëtare nuk duhet të diskriminohen. Për më tepër, të drejtat e fëmijëve kanë nevojë për mbrojtje të veçantë; përmbajtja e këtyre të drejtave mund të nxirret nga Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës të ratifikuara nga të gjitha Shtetet

Anëtare. Së fundi, Acquis në fushën e të drejtave themelore përmban një numër të garancive të rëndësishme gjyqësore dhe vendimeve përkatëse gjyqësore.

Acquis i lartpërmendur i BE-së është i detyrueshëm për procesin e integritetit dhe gjithashtu një detyrim për Shqipërinë që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Në veçanti, nenet 1, 2, 13, 70 dhe 78 të MSA-së janë të një rëndësie të madhe për këtë kapitull. Sipas nenit 78 të MSA-së, një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet forcimit të sundimit të ligjit dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si dhe të zbatimit të ligjit dhe administrimit të drejtësisë. Përveç kësaj, neni 78 i MSA-së vendosi që bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian duhet të synojë forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e efektivitetit të tij, përmirësimin e funksionimit të organeve të policisë dhe të zbatimit të ligjit duke siguruar trajnime të përshtatshme si dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

I.1.2 Gjendja aktuale / Përmbledhja

Shqipëria është plotësisht e angazhuar në detyrimin dhe zbatimin e një reforme gjithëpërfshirëse të të gjitha aspekteve që janë të përshtatshme në kapitullin e gjyqësorit dhe të të drejtave themelore. Kjo jo vetëm për shkak të faktit se ky kapitull dhe fushat e tij në fokus janë thelbësore për integritetin evropian, por gjithashtu sepse ato janë thelbësore drejt krijimit të një shteti të bazuar në sundimin e ligjit. Tre shtyllat kryesore aktuale për reformën janë:

- Sistemi Gjyqësor
- Lufta kundër korrupsionit
- Përmirësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore.

Të tre këto shtylla janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën në një mënyrë të tillë, ku zbatueshmëria e njëres pa tjetrën është e pamundur.

Reforma e thellë strukturore e shtetit shqiptar ka filluar në sistemin gjyqësor, e cila është dhe një nga degët më problematike. Qëllimi është harmonizimi me standardet e BE-së për pavarësinë dhe paanshmërinë, profesionalizmin dhe kompetencën, efektivitetin dhe integritetin. Për këtë arsye organet qeverisëse të gjyqësorit janë përmirësuar në aspektin e organizimit dhe funksionimit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të tyre.

Sistemi gjyqësor shqiptar po pëson një transformim të vazhdueshëm, ku një ndër reformat më të rëndësishme është procesi i vetingut. Proces i vetingut është çmuar si thelbësor në zbatimin e reformës në drejtësi për shkak se një sistem drejtësie i pavarur dhe i paanshëm ndikon në vendosjen e sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës në vend. Ky proces bazohet në tre elementë në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Gjithashtu procesi i vetingut kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe komisionerët publik në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar. Komisioni organizohet

në 4 trupa gjykuese të përbërë nga 3 anëtarë, të cilët caktohen me short, ndërkohë që Kolegji i Apelit gjykon në trupa gjykuese të përbërë nga 5 gjyqtarë. Ligji i vetingut ishte ligji i parë që u miratua nga Kuvendi pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese, që hapën rrugën për zbatimin e reformës në drejtësi. Përveç kësaj, janë krijuar edhe organe të reja të cilat janë të përshtatshme për shtyllën tjetër të reformës shtetërore, atë të luftës kundër korrupsionit.

Në lidhje me reformën e mbrojtjes së të drejtave themelore në Shqipëri, aktivitetet kryesore janë të përqendruara në mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, mbrojtjen e të drejtës së fëmijëve dhe reformimin e sistemit të burgjeve.

I.2 Prioritetet

Sa i përket tre shtyllave të Kapitullit 23, Shqipëria po zbaton energjikisht dhe hap pas hapi prioritetet e vendosura në vitet e fundit.

Prioritetet e reformës të sistemit të drejtësisë për Shqipërinë janë si më poshtë:

- Forcimi i pavarësisë, efektivitetit, llogaridhënies të sistemit gjyqësor;
- Konsolidimi i arsimit dhe specializimi i magistratëve;
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke forcuar transparencën dhe qasjen e saj në përputhje me standardet e BE-së;
- Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion përmes konsolidimit të sistemit të drejtësisë penale;
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë nëpërmjet sistemeve moderne të TI-së dhe lehtësirave për zhvillimin e bashkëpunimit të rëndësishëm ndërkombëtar;
- Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
- Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të varësisë;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve juridike dhe krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazhin.

Përsa i përket luftës kundër korrupsionit, objektivi strategjik i Shqipërisë mund të përmbledhet në: Forcimi i luftës kundër korrupsionit në administratën publike dhe përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit. Objektivat specifike janë:

- të përmirësojë trajtimin e raporteve kundër korrupsionit;
- të rrisë numrin e operacioneve në të cilat përdoren teknika të veçanta të hetimit;
- rritjen e hetimit proaktiv dhe ngritjen e kapaciteteve të strukturave të zbatimit të ligjit;
- ndërtimin e kapaciteteve përmes trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshirë në luftën kundër korrupsionit;
- të garantojnë pandryshueshmërinë e zyrtarëve të policisë gjyqësore (ZPGJ) dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit;
- të përmirësojë bashkëpunimin, organizimin e takimeve si dhe kryerjen e analizave me Njësitë e Përbashkëta Hetimore (NJPH);
- të rritet ndërgjegjësimi në luftën kundër korrupsionit;

- ngritja e kapaciteteve si dhe rritjes të tyre në luftën kundër korrupsionit përmes disa trajnimeve.

Në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore ekzistojnë prioritete të ndryshme për fushat e përfshira. Të drejtat themelore më të rëndësishme të cilat janë prioritet për reformën aktuale në situatën të vendit janë:

Të drejtat e fëmijëve

Vizioni i strategjisë për të drejtat e fëmijëve është përmirësimi i drejtësisë për të mitur që garanton një drejtësi të favorshme ndaj fëmijëve dhe që mbron interesat e tyre më të mira. Për të arritur këtë vizion, janë parashikuar pesë qëllime/objektiva strategjike të nivelit të lartë:

- Garantimi i aksesit së fëmijëve në drejtësi;
- Siguria për një gjykim të drejtë për fëmijët;
- Parandalimi i ri-përfshirjes së fëmijëve në shkeljet ligjore;
- Riintegrimi dhe përfshirja sociale e fëmijëve në konflikt me ligjin;
- Ngritja e kapaciteteve të strukturave të sistemit të drejtësisë për fëmijët.

Sistemi i burgjeve

Prioritet i Qeverisë Shqiptare në kuadër të rekomandimeve të Komisionit Evropian të vitit 2016 të Komitetit Evropian kundër Torturës (KEKT) është reforma e sistemit të burgjeve. Duke marrë parasysh rekomandimet e projektit të binjakëzimit "Për reformën e sistemit të burgjeve dhe shërbimin e provës", mbështetur nga Bashkimi Evropian, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve do të vazhdojnë reformimin e sistemit të burgjeve bazuar në këto fusha kyçe:

- Përmirësimi i akteve ligjore dhe nënligjore për Sistemin e Burgjeve
- Përmirësimin strukturor dhe organizativ të Sistemit të Burgjeve
- Krijimin e një sistemi për menaxhimin e monitorimit të të burgosurve me rrezik të lartë dhe vlerësimit të rrezikut.
- Krijimin e një sistemi për të përmbushur nevojat për të burgosurit e rrezikuar.
- Forcimi i sistemit të integritetit dhe rehabilitimit për të burgosurit.

Për vitin 2019 janë parashikuar si pjesë e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2019 - 2021, ndryshimet në kuadrin ligjor ekzistues, si më poshtë vijon:

- Ndryshime në Ligjin Nr. 1032, datë 11.12.2008, "Për Policinë e Burgjeve", të ndryshuar;
- Ndryshime në Ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve dhe të burgosurve", të ndryshuar.

Përsa i takon dokumenteve strategjike, është duke u rishikuar Plani i Veprimit i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020, të miratuar nëpërmjet VKM-së Nr. 773, datë 02.11.2016.

E drejta e pronës

Prioriteti kryesor i Shqipërisë në aspektin e të drejtës së pronës është reformimi i shërbimeve publike në lidhje me të drejtat e pronësisë, me qëllim krijimin e një sistemi modern, efektiv dhe transparent, në përputhje me praktikat më të mira evropiane. Objektivat kryesore të kësaj reforme konsistojnë në:

- Trajtimi i integruar dhe i koordinuar për çështjet e pronësisë: një ndalesë për lëshimin dhe regjistrimin e titujve të pronësisë;
- Krijimi i Agjencisë së Integruar të Titujve të Pronësisë;
- Përfundimi i regjistrimit të tokave të përcaktuara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe verifikimit të tokave bujqësore të përcaktuara në dispozicion të Agjencisë të Trajtit të Pronës.

II.1 Funksionimi i sistemit gjyqësor

Reforma që po zbatohet në sistemin e drejtësisë ka si qëllim harmonizimin e sistemit gjyqësor shqiptar me standardet e BE-së në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë, llogaridhënien, cilësinë e drejtësisë dhe efikasitetin.

Me paketën ligjore të miratuar është krijuar dhe po vazhdon plotësimi i kuadrit të ri institucional që pritet të sigurojë standardet e mësipërme. Institucionet e reja të gjyqësorit shqiptar janë si më poshtë:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP)
- Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD)
- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED)
- Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar²³ (SPAK)
- Njësia Speciale e Hetimeve / Byroja Kombëtare e Hetimeve²⁴
- Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar²⁵
- Këshillat Gjyqësor²⁶

Disa prej institucioneve të mësipërme tashmë janë krijuar dhe funksionojnë plotësisht, të tjerë janë në proces dhe pritet të krijohen brenda një afati të shkurtër. Më poshtë jepet një përmbledhje e progresit të krijimit të institucioneve të reja gjyqësore:

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), referuar parashikimeve kushtetuese (nenit 147 të Kushtetutës) siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në

²³ Kushtetuta e Shqipërisë dhe Ligji nr. 95/2016

²⁴ Kushtetuta e Shqipërisë dhe Ligji nr. 95/2016

²⁵ Ligji nr. 95/2016

²⁶ Ligji nr. 98/2016

Republikën e Shqipërisë. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe 5 anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë përkatësisht: 2 anëtarë nga radhët e avokatëve; 2 anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës dhe 1 anëtar nga shoqëria civile.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), referuar parashikimeve kushtetuese (nenit 149 të Kushtetutës) garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe 5 anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë përkatësisht: 2 anëtarë nga radhët e avokatëve; 2 anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës dhe 1 anëtar nga shoqëria civile.

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, bashkëveprimi i Kuvendit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në ngritjen për herë të parë të këtyre organeve kushtetuese, kompetencat, mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtyre organeve është detajuar në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Kuvendi i Shqipërisë ka përfunduar procedurat për zgjedhjen e 5 anëtarëve jo-gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe 5 anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pas përfundimit të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe parashikimet e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Me vendimin nr. 18/2018 dhe 19/2018, datë 08.02.2018, Kuvendi i Shqipërisë vendosi të konsiderojë respektivisht të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në nënkomisionin “Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Më 12.12.2018 u mbajt Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve e cila zgjodhi 6 gjyqtarët, anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky këshill mbajti takimin e parë (konstituiv) më 20 dhjetor 2018, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit. Në mbledhjen e tij të datës 22 dhjetor 2018, KLGJ, duke marrë parasysh rëndësinë e zgjedhjes së nënkryetarëve të gjykatave dhe ushtrimin e veprimtarisë së tyre, në kushtet kur nuk ka kryetarë në gjykata, hapi rrugën për këtë proces duke miratuar rregullat për zgjedhjen e nënkryetarëve të gjykatave.

Më 11.12.2018 u mbajt Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve e cila zgjodhi 6 prokurorët, anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky këshill mbajti takimin e parë (konstituiv) më 19 dhjetor 2018, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit.

Në cilësinë e autoritetit kompetent për emërimin e prokurorëve të **Prokurorisë Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** dhe në bazë të nenit 179/8 të Kushtetutës, nenit 7 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar" (në vijim Ligji për SPAK) dhe nenet 48/2 dhe 3 të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka njoftuar fillimin e procedurave për mbushjen e 15 vendeve të lira në Prokurorinë Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenet 147/d, 147/dh, 147/e dhe 147/ë parashikon kushtet dhe procedurat për zgjedhjen e **Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**, si një organ i ri në sistemin e drejtësisë. Sipas dispozitave kushtetuese, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ende nuk është zgjedhur për shkak se procesi i aplikimit dhe përzgjedhja e kandidaturave për këtë pozicion është e kushtëzuar njëkohësisht në funksionimin e KED si dhe kryerja e procesit të rivlerësimit të kandidatëve. Parlamenti i Shqipërisë është zyrtarisht i informuar për paraqitjen e kërkesës për shprehje interesi nga dy kandidatë: një gjykatës i Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kryeinspektori aktual i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Parlamenti i Shqipërisë ka dorëzuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimeve dosjet e kandidatëve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për të ndjekur procedurat e rivlerësimit kalimtar në bazë të dispozitave ligjore. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka përfunduar procedurën e rivlerësimit për një nga kandidatët për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në pozitën e një gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit, duke vendosur për konfirmimin e tij në detyrë.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar vendimin nr.74/2018, datë 31.05.2018 "Për themelimin e **Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Zbatimin** e Ligjit nr. 115/2016 "Për organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë". Komisioni i Pavarur, i cili do të themelohet në pajtim me nenin 288 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë" është përgjegjës:

- të monitorojë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve dhe zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të organeve qeverisëse të sistemit të drejtësisë;
- për të koordinuar institucionet dhe organet që zbatojnë ligjin nr. 115/2016 "Për organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë" dhe të ndjekë progresin e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 115/2016 nga institucionet përkatëse të parashikuara me këtë ligj, brenda afateve ligjore të përcaktuara,

- të raportojë një herë në muaj në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut lidhur me përparimin e zbatimit të ligjit dhe sa herë që është e nevojshme dhe e kërkuar nga ai,
- t'i raportojë Parlamentit për ecurinë e zbatimit të ligjit sa herë që i është kërkuar prej tij.

Komisioni i Pavarur përbëhet nga 5 anëtarë, të zgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë, nga lista e kandidatëve të miratuar nga Komisioni për Çështje Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Me vendimin nr. 97/2018, datë 20.9.2018 Parlamenti ka zgjedhur 4 anëtarët e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Zbatimin e Ligjit nr. 115/2016.

II.1.1 Dokumentet strategjike

Nëpërmjet VKM nr. 773, datë 02.11.2016 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020 dhe Planit të saj të Veprimit", (Strategjia Ndërsektoriale 2017-2020), Qeveria Shqiptare po ndjek zbatimin e reformës të përgjithshme të sistemit gjyqësor shqiptar. Kjo strategji dhe plani i saj i veprimit është një vazhdim i dokumenteve të mëparshme të politikave mbi reformën e drejtësisë, duke i zhvilluar ato më tej në mënyrë që të zbatohet çdo aspekt i reformës. Me anë të saj identifikohen aktivitetet ligjore, administrative dhe organizative, tabela kohore dhe më e rëndësishmja masat e nevojshme financiare.²⁷

Strategjia ndërsektoriale 2017-2020 është hartuar me qëllim trajtimin dhe identifikimin e çështjeve të drejtësisë në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar mirë. Kjo qasje strategjike është në përputhje të plotë me qasjen sektoriale të BE-së. Sa i përket reformës së drejtësisë, strategjia ka këto objektiva kryesore: (i) konsolidimin e pavarësisë dhe paanshmërisë, llogaridhënien, profesionalizmin dhe kompetencën, cilësinë e drejtësisë dhe efikasitetin e gjyqësorit; (ii) rritjen e transparencës dhe besimit publik në sistemin e drejtësisë. Strategjia ndërsektoriale 2017-2020 jo vetëm që liston objektivat, por gjithashtu parashikon një Plan Veprimi të detajuar dhe masat përkatëse financiare të nevojshme për zbatimin e objektivave. Ministria e Drejtësisë ka hartuar tre raporte monitoruese të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020, për periudhën:

- 1 Janar 2017 deri me 31 Dhjetor 2017;
- Janar-Qershor 2018; Janar – Shtator 2018.

Më 18 prill 2018, Mekanizmi Institucional për Monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë miratoi Raportin Vjetor të Monitorimit për periudhën prej 1 janarit 2017 deri më 31 dhjetor 2017, dhe në tetor të vitit 2018 miratoi Raportin Vjetor të Monitorimit për periudhën Janar-Shtator 2018. Rezultatet e monitorimit për periudhën janar-shtator 2018 paraqiten si më poshtë:

²⁷ VKM nr. 773, datë 02.11.2016 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020 dhe Planit të saj të Veprimit", fq. 5.

Deri më tani nga 201 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë janë realizuar 59 prej tyre, 33 janë ende në proces zbatimi dhe 109 nën-aktivitete të porealizuara (nga të cilat 65 nën-aktivitete janë nën fushën e përgjegjësisë së institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, të cilat nuk janë ngritur ende). Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit është në nivelin 29% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 17% për nën-aktivitetet në proces, 54% për nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Aktualisht, Ministria e Drejtësisë po rishikon Planin e Veprimit 2018-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë me mbështetjen e Projektit V EURALIUS për konsolidimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri.

Përveç dokumentit të polikave të lartpërmendura, Shqipëria ka miratuar një kuadër të rëndësishëm të akteve ligjore të nevojshme për ti harmonizuar me standardet e BE-së, një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, të përgjegjshëm, profesional, kompetent, cilësor dhe efikas. Së pari, Ligji nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8417/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" mundësoi fillimin drejt reformës së sistemit të drejtësisë. Në kuadër të reformës në drejtësi Parlamenti ka miratuar në total 20 ligje nga paketa e 27 projektligjeve të reformës në drejtësi.

Një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare për vitin 2019 është zbatimi i plotë i reformës së drejtësisë duke siguruar përmirësimin e kuadrit ligjor dhe funksionimin e institucioneve të reja të drejtësisë. Ky prioritet do të arrihet nëpërmjet objektivave strategjike në vijim si:

- mbështetja për krijimin e institucioneve të reja qeverisëse të sistemit të drejtësisë;
- rritja e aksesit në sistemin e drejtësisë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;
- zbatimi i reformës së sistemit të drejtësisë në lidhje me fëmijët në konflikt me ligjin, duke rritur sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale.

Organet drejtuese

Reforma në drejtësi ka sjellë ndryshime të rëndësishme në vendosjen institucionale të gjyqësorit shqiptar. Këto ndryshime janë veçanërisht të rëndësishme për organet e tij të menaxhimit dhe kompetencat e tyre. Institucionet ekzistuese janë gati të zëvendësohen dhe aktualisht po kryejnë funksione të administratës së zakonshme. Përmes këtyre ndryshimeve kushtetuese dhe ligjeve specifike organike të miratuara si pjesë e reformës së drejtësisë, organet drejtuese të gjyqësorit shqiptar janë modifikuar me qëllim arritjen e standardeve të lartpërmendura të pavarësisë dhe paanësisë, llogaridhënies, profesionalizmit dhe kompetencës, efikasitetit dhe integritetit. Organet e sapo krijuara të drejtimit të gjyqësorit shqiptar janë si në vijim:

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) është organi i ri që qeveris gjyqësorin shqiptar dhe zëvendëson Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD). Për shkak të mekanizmit të emërimit dhe përbërjes së tij, pritët që KLGJ të ketë pavarësi më të madhe nga ndikimi politik si dhe të luftojë korrupsionin.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP)²⁸ është një organ i sapoformuar i cili është kompetent për menaxhimin e karrierës së prokurorëve si dhe çështjeve disiplinore. Në mënyrë të ngjashme me KLGJ, për shkak të mekanizmit të ri të emërimit dhe përbërjes së tij, pritet që KLP të përmirësojë menaxhimin e organit prokurorial shqiptar duke siguruar pavarësi më të madhe nga ndikimet politike për luftimin e korrupsionit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD)²⁹ është një nga organet e reja të krijuara për të kontribuar në sistemin gjyqësor shqiptar të paraqitur përmes Reformës së Drejtësisë. Zgjidhet nga Parlamenti me një shumicë të kualifikuar prej 3/5 për një periudhë 9 vjeçare midis juristëve me kualifikim të lartë. ILD ushtron inspektime të rëndësishme dhe funksione qeverisëse në gjyqësorin shqiptar duke përfshirë gjykatësit, prokurorët e të gjitha niveleve, anëtarët e KLGJ-së, anëtarët e KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Është kompetent për vlerësimin e ankesave, hetimet ex officio dhe fillimin e procedurave disiplinore midis anëtarëve të lartpërmendur të gjyqësorit shqiptar. Gjithashtu ka në kompetencë inspektimet në gjykata dhe prokurori.

Institucionet e ri-vlerësimit³⁰ janë organe që do të funksionojnë për një periudhë të kufizuar kohore, në mënyrë që të kryejnë rivlerësimin e anëtarëve të gjyqësorit shqiptar. Këto janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) dhe Komisionerët Publik, të cilët do të bashkëpunojnë me vëzhguesit ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). Këto nuk janë organe drejtuese, pasi ato do të veprojnë për një periudhë të kufizuar kohore, por aktualisht po kryejnë një funksion shumë të rëndësishëm, atë të rivlerësimit të anëtarëve bazuar në tre kritere: vlerësimi i pasurisë, vlerësimi i kualifikimeve dhe aftësive (vlerësimi i kompetencave profesionale). Në fakt, vendimi i KPK dhe i KPA mund të shkaktojë pezullimin nga detyra ose edhe shkarkimin nga sistemi i gjyqësorit të subjekteve të rivlerësimit që nuk arrijnë të kalojnë një nga tre kriteret e mësipërme. Të dy institucionet janë themeluar dhe aktualisht po zbatojnë procesin e rivlerësimit.

Për më shumë informacion mbi ecurinë e punës së institucioneve të rivlerësimit, ju lutemi kontrolloni paragrafin "Përgjegjshmëria" më poshtë.

Pavarësia dhe paanësia

Reforma e drejtësisë ka filluar dhe po zbatohet me qëllim të sigurimit të pavarësisë së gjyqësorit shqiptar, një parim i cili pavarësisht se ishte i sanksionuar në Kushtetutë edhe para ndryshimeve të tij, de facto u rrezikua nga politizimi i lartë i Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, emërimet në sistemin gjyqësor dhe kompetencat që gëzonin KLD-ja dhe Prokurori i Përgjithshëm në menaxhimin e sistemit të karrierës të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pritet që reforma e drejtësisë, me organet e reja të administrimit të garantojë pavarësinë e gjyqësorit nga

²⁸ Nenet 149-149 (ç) të Kushtetutës dhe Ligjit Shqiptar nr. 115/2016

²⁹ Nenet 147 (d) dhe 147 (ë) të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të Ligjit nr. 115/2016.

³⁰ Shtojca e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e miratuar me Ligjin nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8417/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"; Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin e përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

ndikimet politike apo të tjera. Kjo si rezultat i mekanizmave të reja të emërimit në organet që administrojnë sistemin gjyqësor shqiptar dhe kompetencave të reja që u ofrohen këtyre organeve.

Përgjegjësia

Përgjegjësia e sistemit të gjyqësorit dhe prokurorisë në Shqipëri është një nga shtyllat e reformës së ndërmarrë të drejtësisë. Ndryshimet kushtetuese dhe legislative kanë si qëllim forcimin e sistemit të llogaridhënies në afat të shkurtër dhe afatgjatë.

Procesi i përgjegjësisë aktualisht po ndërmerret për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët. Ky proces njihet ndryshe si rivlerësimi ose procesi i vetting-ut dhe është i rregulluar në pjesën e veçantë të Kushtetutës së ndryshuar si dhe në ligjin nr. 84/2016 dhe po zbatohet nga institucionet e rivlerësimit:

- Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve (KPK);
- Kolegji Posaçëm i Apelit (KPA);
- Komisionerët Publikë;
- Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) si një organ bashkëpunimi i përbërë nga vëzhgues ndërkombëtarë.

Numri i përgjithshëm i vendimeve të dhëna nga **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit** gjatë periudhës janar-dhjetor 2018 është **92**:

42 vendime për konfirmimin në detyrë të 20 gjyqtarëve dhe 18 prokurorëve dhe 4 ndihmësve ligjorë/ kandidatë për magjistratë. Në listë janë:

- 10 kandidatë për Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- 10 kandidatë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
- 4 kandidatë për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

35 vendime për shkarkimin nga detyra të 22 gjyqtarëve dhe 12 prokurorëve dhe 1 ndihmës ligjor/magjistrat. Mes listës janë:

- 9 kandidatë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
- 6 kandidat për Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- 8 kandidatë për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

7 vendime për ndërprerjen e procesit për 4 gjyqtarë dhe 2 prokurorë, 1 ish-këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese;

8 vendime për pushimin e procesit për 3 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 4 ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit ushtron funksionet e veta sipas Nenit 179/b, Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Rregullorja "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të

Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese" dhe aktet e tjera të brendshme të miratuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

KPA kryen rolin e saj në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve pas marrjes së vendimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve dhe pas parashtrimit të ankesës, qoftë nga vlerësuesi, ose nga Komisioneri Publik, kundër vendimit të KPK-së.

Deri me datën 31.12.2018, pranë KPA-së janë regjistruar 40 (dyzetë) çështje të juridiksionit të rivlerësimit, nga të cilat 12 (dymbëdhjetë) kanë përfunduar, 3 (tre) janë nën gjykim (seancat janë planifikuar të zhvillohen në datat 9, 15 dhe 31 janar) dhe 25 (njëzetepesë) janë në përgatitje për gjykim.

Nga çështjet të cilat kanë përfunduar, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – në 8 vendime; Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me përmbajtjen në dispozitiv për ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ ose KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare - në 2 vendime;
- ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit: shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit – në 1 vendim.
- Pushimin e shqyrtimit të çështjes për shkak të tërheqjes së ankimit nga ankuesi – në 1 vendim.

Gjithashtu, janë marrë 2 (dy) vendime për dy çështje të Juridiksionit Disiplinor.

Sa i përket institucionit të Komisionerëve Publik, deri në dhjetor 2018 janë rishikuar 73 vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Komisionerët Publik kanë vendosur apelin e 16 vendimeve pranë KPA-së, ndërsa për 57 vendimet e tjera kanë vendosur të mos apelojnë.

Përveç procesit të verifikimit, i cili do të funksionojë për një periudhë të kufizuar kohore, llogaridhënia në afat të gjatë është përmirësuar nëpërmjet paketës ligjore të reformës së drejtësisë. Kjo për arsye të një sërë risive në sistemin e përgjithshëm të drejtësisë si ngritja e organit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një organ i pavarur kompetent për hetimin dhe fillimin e procedimeve disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të KLGJ-së, anëtarëve të KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm, i cili shman mbivendosjen e mëparshme të inspektimit nga Ministria e Drejtësisë dhe funksionimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 96/2016, datë 06.10.2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", Ministria e Drejtësisë, e humbet kompetencën e mëparshme në lidhje me procedurat hetimore dhe disiplinore. Brenda sistemit të ri gjyqësor, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për koordinimin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave shtetërore dhe strategjisë sektoriale të sektorit të drejtësisë; për përgatitjen e projekt-akteve ligjore në fushën e drejtësisë

penale pas marrjes së mendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë; për paraqitjen e ankesës/apelimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për shkelje të dyshuar disiplinore të prokurorëve; për të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë që të kryejë inspektime institucionale dhe tematike në Prokurorinë e Përgjithshme ose në zyrat e prokurorisë. Përveç kësaj, Ministri i Drejtësisë bashkëpunon me KLGJ-në dhe KLP-në për të siguruar përputhjen e planeve strategjike dhe buxhetore të sistemit gjyqësor me politikat shtetërore dhe strategjinë sektoriale të sektorit të drejtësisë.

Së dyti, vlen të përmendet se procedura disiplinore është përmirësuar me rregulla dhe procedura shumë të detajuara, kritere, shkelje konkrete, ndarje të hollësishme të funksioneve të institucioneve të përfshira dhe të drejta të apelit të përcaktuara me ligjin nr. 96/2016. Gjithashtu, janë sqaruar dhe strukturuar procedurat e bashkëpunimit me organet e tjera ekzistuese si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), autoritetet tatimore, autoritetet e pastrimit të parave.

Sa i përket etikës, integritetit dhe formimit profesional, ligji nr. 96/2016 rregullon në detaje të gjitha aspektet e këtyre elementeve. Neni 4 i ligjit nr. 96/2016 parashikon rëndësinë e etikës dhe përcakton se standardet etike dhe rregullat për gjyqtarët dhe prokurorët do të miratohen nga organet përkatëse administruese, KLGJ dhe KLP. Neni 5 i ligjit nr. 96/2016 parashikon detyrimin e formimit të vazhdueshëm profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Përveç kësaj, të gjitha këto elemente janë të rëndësishëm për vlerësimin e karrierës të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe për sanksionet disiplinore.

Deklarimi dhe kontrolli i pasurive është një detyrim për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët. Pavarësisht se ekzistonte në të kaluarën, aktualisht është përforcuar dhe rifreskuar nga reforma e drejtësisë. Siç u tha më lart, procesi i rivlerësimit/verifikimit është përqendruar në deklarimin e pasurive dhe në posedimin e pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë kuadër, koordinimi ndërmjet institucioneve të kontrollit është forcuar. Përveç kësaj është parashikuar për të ardhmen që gjyqtarët/prokurorët, të cilët do të kenë rritje të pajustificuar të pasurisë ose stilit të jetesës, do të mbajnë barrën e provës gjatë procedurës disiplinore dhe në rastet e mungesës së arsytimit gjyqtarët dhe prokurorët mund të shkarkohen nga detyra.

Profesionalizmi dhe kompetenca

Me organet e reja qeverisëse të gjyqësorit, përkatësisht KLGJ-së dhe KLP-së, shkalla e pavarësisë nga ndikimi politik është rritur për shkak të ndryshimeve kushtetuese që rregullojnë sistemin për rekrutimin, përzgjedhjen, emërimin, transferimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët janë të pavarur nga ndikimi politik dhe të fokusuar në kriteret bazë dhe objektive. Kjo do të kontribuojë në forcimin e profesionalizmit dhe kompetencave së gjyqësorit dhe prokurorisë shqiptare.

Integriteti i gjyqtarëve dhe prokurorëve përbën një kriter jo vetëm gjatë procesit të përzgjedhjes, por edhe në shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë procesit të rivlerësimit. Paketa e re

ligjore ka vendosur rregulla dhe procedura të qarta dhe objektive për vlerësimin e karrierës së gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe shkarkimin e tyre. Përveç kësaj, organet që do të kryejnë këtë vlerësim janë të përcaktuara qartë dhe funksionet e tyre janë të ndara në KLGJ-në, KLP-në dhe ILD-së. Ligji i ri nr. 96/2016 përmirëson dukshëm sistemin e vlerësimit periodik të magistratëve (gjyqtarëve dhe prokurorëve) përmes kritereve objektive për vlerësimin e kompetencave profesionale dhe integritetit të tyre moral dhe psikologjik. Sistemi i vlerësimit të magistratëve tani përfshin edhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Cilësia e drejtësisë

Sikurse u përmend edhe më lart, formimi profesional dhe trajnimi është një detyrim i rëndësishëm i sistemit gjyqësor shqiptar, të përforcuar dhe përcaktuar më mirë me paketën e re ligjore të reformës së drejtësisë. Detyrimi i formimit të vazhdueshëm profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve përcaktohet me nenin 5 të ligjit nr. 96/2016. Përveç kësaj, ligji nr. 115/2016 "Për organet drejtuese të sistemit të drejtësisë" rregullon funksionet e autoritetit zyrtar përgjegjës për trajnimin fillestar dhe të përhershëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në pajtim me Pjesën VI të ligjit nr. 96/2016 ky organ është Shkolla e Magjistraturës, e cila është një institucion publik me autonomi akademike, financiare dhe administrative. Ajo gjithashtu mund të sigurojë trajnime për kancelarët e gjykatës, nëpunësit civilë të gjyqësorit, prokurorisë dhe profesioneve të tjera ligjore të lidhura me sistemin e drejtësisë. Nga Buxheti Afatmesëm 2017-2019³¹ rezulton me një rritje të burimeve buxhetore të Shkollës së Magjistraturës, nga 91 milionë lekë në 2017 në 106 milionë lekë në vitin 2018 dhe 107 milionë lekë në 2019. Numri më i madh i gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkak të krijimit të gjykatave të reja dhe organeve të ndjekjes penale për anti-korrupsion dhe krim të organizuar do të kërkojnë programe specifike të trajnimit dhe burime të tjera njerëzore dhe buxhetore të Shkollës së Magjistraturës.

Me paketën e re ligjore të reformës së drejtësisë, monitorimi dhe vlerësimi i funksionimit të gjykatave shqiptare është kompetencë e organit të ri të pavarur drejtues të gjyqësorit shqiptar, KLGJ-së. Këto kompetenca përcaktohen në detaje në ligjin nr. 115/2016. KLGJ gjithashtu është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e politikave të menaxhimit të gjykatave. Gjykatat janë të detyruara të informojnë KLGJ-në për çdo çështje të funksionimit të tyre të kërkuar nga ky i fundit. Përveç kësaj, ligji Nr. 115/2016 parashikon krijimin e një sistemi elektronik të teknologjisë së TI-së. Sistemi, së bashku me funksione të tjera, do të gjenerojë informata statistikore që përmbajnë tregues mbi funksionimin e gjyqësorit, në përputhje me standardet evropiane, të tilla si numri i rasteve për secilin gjyqtar, ecuria mesatare e rasteve, etj.³² Pas vendosjes së sistemit këto të dhëna mund të përdoren për vlerësimin e performancës së gjykatave.

³¹ http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Buxheti/Programi_Buxhetor_Afatmesem_ne_Vite/PBA_2017-2019_Faza_III_Shkurt_2017.pdf

³² Neni 92 i Ligjit nr. 115/2016.

Sa i përket buxhetit dhe burimeve të gjyqësorit, paketa e re ligjore e reformës së drejtësisë përmirëson kapacitetet planifikuese dhe synon të shmangë ndikimin e ekzekutivit në buxhet. Në të vërtetë dispozitat e reja legjislative³³ e bëjnë KLGJ-në organin përgjegjës për planifikimin strategjik të buxhetit të gjyqësorit, duke i lënë Ministrisë së Drejtësisë vetëm të drejtën për të marrë pjesë pa të drejtë vote në takimin ku diskutohet plani strategjik dhe buxheti i sistemit gjyqësor. Sa i përket fondeve buxhetore të alokuara, duke filluar nga viti 2017, Qeveria ka programuar një fond specifik nga fondi rezervë për financimin e institucioneve të reja të reformës së drejtësisë. Në bazë të Planit Afatmesëm të Buxhetit 2018-2020 (PBA 2018-2020)³⁴ fondi rezervë për vitin 2017 ishte 500 milion lekë; për 2018, 1 miliardë lekë; dhe për vitin 2019 1.8 miliardë lekë. Për këtë arsye, rritja e treguesit të buxhetit rezervë të alokuar nga Qeveria e Shqipërisë për reformën e drejtësisë, tregon vullnetin për të vazhduar me zbatimin efektiv të saj. Paketa e re ligjore gjithashtu rregullon në mënyrë shumë të hollësishme burimet njerëzore të gjyqësorit, duke përfshirë stafin jo gjyqësor, pozitën e tyre, përzgjedhjen, transferimin, kriteret e shkarkimit, procedurat disiplinore, funksionet etj. Të gjitha këto elementë janë të rëndësishëm për të siguruar stabilitetin në zyra të stafit mbështetës të gjyqësorit, cilësinë, profesionalizmin dhe kompetencat e tyre.

Efikasiteti

Efikasiteti i gjyqësorit shqiptar ka qenë një shqetësim për një kohë të gjatë. Kjo si pasojë e një sërë faktorësh, si burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe financiare, planifikimi strategjik jo i përshtatshëm dhe mungesa e dispozitave ligjore të hollësishme që rregullojnë funksionimin e brendshëm të gjykatave me procedura specifike për menaxhimin, shpërndarjen e çështjeve si dhe çështje të tjera. Problemet kryesore kanë qenë çështjet e mbartura, veçanërisht në gjykatat Administrative, gjykatat e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë; njoftimi i akteve; prodhimin e të dhënave statistikore. Kuadri i ri ligjor, pjesë përbërëse e reformës në drejtësisë, ka prezantuar disa risi thelbësore të cilat pritet të adresojnë çështjet e efikasitetit të gjyqësorit shqiptar.

Për shembull kufizimi i kompetencave të Gjykatës së Lartë, duke e shndërruar atë në një gjykatë të kasacionit, do të sjellë pasojat e zvogëlimit të ngarkesës së punës. Gjithashtu, Gjykata e Lartë do të lirohet nga kompetenca e saj për të gjykuar akuzat penale ndaj zyrtarëve më të lartë shtetërorë të cilët do të gjykohen nga gjykata të veçanta. Përveç kësaj, krijimi i gjykatave të posaçme që merren me korrupsionin dhe krimin e organizuar do të rezultojë në zvogëlimin e numrit të çështjeve të prapambetura të gjykatave ekzistuese penale dhe do të përmirësojë sistemin e drejtësisë penale në aspektin e efikasitetit, për shkak të specializimit të gjykatave të reja në shumë krime të tjera.

³³ Ligji nr. 115/2016

³⁴ http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Buxheti/Programi_Buxhetor_Afatmesem_ne_Vite/PBA_2017-2019_Faza_III_Shkurt_2017.pdf

Me qëllim të adresimit të problemit të njoftimit janë miratuar disa akte ligjore³⁵, duke futur mundësinë për të përdorur njoftimin elektronik, për të përdorur konceptin e ri të personit të autorizuar për të marrë njoftim kur palët nuk kanë mundësi, përmirësimin e procedurës së njoftimit publik dhe futjen e portalit elektronik për njoftime publike.

Vlen të përmendet se çështje të tilla si rritja e buxhetit, rregullimi i statusit të stafit mbështetës si ndihmesa civile të gjyqësorit, miratimi i rregullave të hollësishme për sistemin e menaxhimit të rasteve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen e gjykatave, krijimi i një sistemi IT që do të mbledhë dhe ofrojë të dhëna në përputhje me standardet e BE-së, janë të gjitha elementet që do të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit.

II.1.3 Aktet e planifikuara

II.1.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Së pari vlen të përmendet se Mekanizmi Institucional i Monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020 po finalizon procesin e përditësimit të Planit të Veprimit për 2018-2021. Përditësimi i Strategjisë do të identifikojë masat e nevojshme politike që duhen miratuar në të ardhmen e afërt.

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka masa ligjore të planifikuara në këtë nënkapitull.

II.1.3.3 Akte të tjera të planifikuara 2019 – 2021

Nuk është parashikuar miratimi i akteve të tjera gjatë kësaj periudhe.

II.2 Lufta kundër korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit është një ndër prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare, e cila është e lidhur ngushtë me reformën e gjyqësorit. Politikat kundër korrupsionit synojnë uljen progresive të nivelit të korrupsionit, duke rritur integritetin e institucioneve dhe duke promovuar administrimin përmes përmirësimit të shërbimeve publike për qytetarët, zbatimin e ligjit dhe transparencën.

³⁵ Ligji Nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116 datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Objektivi strategjik i luftës kundër korrupsionit është: Forcimi i luftës kundër korrupsionit në administratën publike dhe përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit. Objektivat specifike janë:

- përmirësimi i trajtimit të raporteve kundër korrupsionit;
- rritja e numrit të operacioneve në të cilat përdoren teknika të posaçme të hetimit;
- rritja e hetimit proaktiv dhe ngritja e kapaciteteve të strukturave të zbatimit të ligjit;
- përdorimi më i mirë dhe menaxhimi i informacionit për hetimin e korrupsionit;
- ngritja e kapaciteteve përmes trajnimit nga agjencitë e zbatimit të ligjit, të përfshirë në luftën kundër korrupsionit;
- garantimi i stabilitetit në zyrën e zyrtarëve të policisë gjyqësore (ZPGJ) dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit;
- përmirësimi i bashkëpunimit, organizimi i takimeve dhe kryerja e analizave me Njësitë e Përbashkëta Hetimore (NJPH);
- rritja e ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit.

Një ndër arritjet kryesore të Shqipërisë është fillimi i reformës së drejtësisë që pritet të sjellë përmirësime thelbësore në luftën kundër korrupsionit në vend. Si hap i parë, reforma po lufton korrupsionin brenda gjyqësorit me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky proces do të sigurojë që sistemi gjyqësor shqiptar të funksionojë në mënyrë të pavarur nga zyrtarët e korruptuar dhe do të jetë një instrument në parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit të nëpunësve të administratës publike dhe zyrtarëve të lartë politikë.

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë disa masa konkrete politike të cilat janë dëshmi e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin në vend. Në mars të vitit 2015, Shqipëria miratoi dokumentet strategjike më të rëndësishme kundër korrupsionit: Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe Plan i Veprimit i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015 - 2017, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.03.2015. Këto akte bazohen në një analizë të plotë të dokumenteve të mëparshme të politikave dhe pasqyrojnë rekomandimet e Raporteve të Progresit të BE-së dhe udhëzimet mbi 5 prioritetet për integrimin në BE. Strategjia është plotësisht në përputhje me objektivat e Qeverisë Shqiptare për arritjen e standardeve të BE-së në luftën kundër korrupsionit dhe reflekton rekomandimet e treguara nga projekti i BE-së për Vlerësimin e Kornizës Shqiptare kundër Korrupsionit (ACFA).³⁶

Strategjia gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit 2015-2020 përmban një akses të trefishtë për të luftuar korrupsionin: parandalimin, eliminimin dhe edukimin (rritjen e ndërgjegjësimit). Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit duke qenë një strategji ndërsektoriale, është bazuar në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në Strategjinë Kombëtare Zhvillimit dhe Integritetit duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar. Rishikimi vjetor i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë u krye nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, në mënyrë që të lejojë përshtatjen e strategjisë me realitetet e reja dhe prioritetet e sektorëve.

³⁶ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.03.2015, fq. 3.

Me Vendimin Nr. 241, dt.20.04.2018 të Këshillit të Ministrave është miratuar Plan i Veprimit 2018 – 2020 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, Pasaporta e Indikatorëve, krijimi, funksionimi dhe detyrat e Komitetit Koordinator për zbatimin e SNKK-së dhe Task-Forca Ndërinstitucionale Anti-korrupsion.

Krijimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale Anti-korrupsion, përgjegjëse për inspektimet ndërinstitucionale, sipas Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, kryesohet nga Ministri i Drejtësisë, Koordinator Kombëtar Anti-korrupsion, dhe ka në përbërje përfaqësues nga Kryeministria, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Inspektorati Qendror.

Komiteti Koordinator kryesohet nga Ministri i Drejtësisë dhe ka në përbërje 10 anëtarë, në nivel Zëvendësministri nga secila ministri linje (pa përfshirë këtu dy ministrat pa portofol).

Gjatë muajve maj - dhjetor 2018 kjo Task-Forcë Anti-korrupsion ka kontrolluar mbi 50 institucione dhe si më poshtë ka rekomanduar:

- a) 327 masa disiplinore;
- b) 108 shkarkime nga shërbimi civil;
- c) 36 kallëzime penale.

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri institucional

Ministria e Drejtësisë caktohet si Koordinatore Kombëtare Kundër Korrupsionit (KKKK) me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e qëllimit të veprimtarisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”. Për shkak të këtij vendimi, Ministria e Drejtësisë është organi përgjegjës për të koordinuar përpjekjet dhe politikat kundër korrupsionit midis të gjithë aktorëve në nivel kombëtar dhe lokal.

Roli i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) konsiderohet thelbësor për parandalimin e korrupsionit. Janë bërë ndryshime ligjore për të përmirësuar auditimin e pasurive, në kuadër të luftës kundër korrupsionit. Përveç kësaj, ILDKPKI është e përfshirë fuqimisht në procesin e reformës së drejtësisë, veçanërisht gjatë procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ku është angazhuar në hartimin dhe dorëzimin e raporteve të vlerësimit të pasurisë tek institucionet përkatëse të rivlerësimit. ILDKPKI, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, njohur dhe si Vettingu në Polici, në zbatim të nenit 9 pika 2 në të cilin parashikohet se “...pesë anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit caktohen nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të

Interesave, të përzgjedhur ndërmjet punonjësve të këtij institucioni, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Ky organ cakton, gjithashtu, edhe dy anëtarë zëvendësues, të cilët zëvendësojnë anëtarët që mungojnë..” ka përzgjedhur dhe emëruar pesë Inspektorë pranë këtyre organeve. Inspektorët e ILDKPKI do të jenë tërësisht të angazhuar pranë organeve të vettingut për të dhënë ekspertizën dhe eksperiencën e tyre gjatë procesit të vlerësimit të subjekteve të parashikuar nga ligji, kryesisht në komponentin e vlerësimit të pasurisë.

Kuadri ligjor

Kuadri ligjor shqiptar në luftën kundër korrupsionit po përmirësohet për të arritur standardet përkatëse të BE. Ligji ka tendencë të trajtojë aspektet e luftës kundër korrupsionit: parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të tij.

Zhvillimet e fundit në aspektin e legjislacionit, pas rekomandimeve të Raportit të Progresit të BE-së të vitit 2016 janë si në vijim:

- Ligji nr. 60/2016 "Mbi sulmin dhe mbrojtjen e informatorëve", i cili siguron rregullat dhe procedurat e mbrojtjes të informatorëve brenda administratës publike ose në vendin e punës private. Po ashtu, janë miratuar dhe aktet nënligjore.
- Ligji nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar". Ky ligj, i miratuar si pjesë e paketës ligjore të reformës së drejtësisë, krijon institucionet e reja që do të jenë përkushtuar ekskluzivisht për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar: Struktura e Specializuar kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Zyra Kombëtare e Hetimeve dhe Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- Ligji nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’”;
- Ligji nr. 42/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9049 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimet financiare të zyrtarëve të zgjedhur dhe disa zyrtarëve publikë”. Ky ligj ndikon kryesisht, por jo vetëm, në reduktimin e numrin dhe disa kategori të zyrtarëve publikë që mbartin detyrimin për deklarim, duke synuar që detyrimi për deklarim të kryet tashmë nga zyrtarët e nivelit më të lartë drejtues, ndryshimin apo harmonizimin e emërtimeve me institucionet e reja apo të transformuara nga Reforma në Sistemin e Drejtësisë, parashikimit të mundësisë së deklarimit online, si dhe ashpërsimin me 5-fish të sanksioneve për kundravajtjet administrative. Gjithashtu, në përmbushje edhe të rekomandimit të GRECO-s, një ndër ndryshimet më kryesore që solli ky ligj është ai që lidhet me nenin 25/1 të ligjit “Kontrolli i plotë i deklaratës së pasurive dhe interesave private”, pika a), ku specifikisht shkurtohet intervali kohor i kryerjes së kontrollit të plotë, nga 1 herë në 3 vjet në 1 herë në 2 vjet, për të gjitha kategoritë e subjekteve të përmendura nën këtë paragraf, duke përfshirë edhe deputetët.
- Ligji nr. 70/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, i ndryshuar". Ndryshimet paraqesin zgjerimin e fushës së veprave penale mbi të cilat mund të konfiskohen pasuritë, zbatimin e këtij ligji

nga strukturat e tjera kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sqarimin e procedurave të konfiskimit, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të barasvlershme, revokimin e sekuestrimit etj.

- Ligji nr. 90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike" të ndryshuar". Ky ligj synon përmirësimin e rregullave për financimin e partive politike gjatë zgjedhjeve dhe rritjen e transparencës për shpërndarjen e fondeve publike, duke shmangur mundësinë e favorizimit të padrejtë të partive politike nëpërmjet financimit publik. Ndryshimet rregullojnë mjetet financiare dhe shpenzimet e partive politike gjatë fushatës zgjedhore, duke parashikuar që financimi i fushatës zgjedhore të partive politike, të regjistruara si subjekte zgjedhore, do të bazohet vetëm në burimet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
- Disa shtesa dhe ndryshime u miratuan në vitin 2017 në lidhje me Ligjin "Për masat kundër financimit të terrorizmit"; Ligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", Ligjin "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", Ligjin "Për përgjimin e komunikimeve elektronike". Ndryshimet synojnë harmonizimin e këtyre ligjeve me strukturat e reja të krijuara me Kushtetutë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.
- Disa Ndryshime në Ligjin Nr. 9643, Datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, në të cilin theksohet se Autoriteti Kontraktor skualifikon nga procedura e për zgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste; b) korrupsion; c) mashtrim; ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste; dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve; e) falsifikim; ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Vështirësi të mëdha ka pasur në drejtim të hetimit dhe të eliminimit të praktikave korruptive. Një nga aktivitetet kryesore që po zbatohet është reforma e drejtësisë e cila ofron masa të forta anti-korrupsion. Para së gjithash lufta kundër korrupsionit brenda gjyqësorit ka sjellë procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit ligjor brenda gjyqësorit shqiptar. Siç është shpjeguar edhe më sipër, procesi ka filluar dhe po jep rezultatet e para. Përveç kësaj, mekanizmat e reja të cilat po krijohen si Struktura e Specializuar kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Zyrës Kombëtare të Hetimeve dhe Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, do luftojnë korrupsionin në kuadër të reformës së drejtësisë. Kjo vendosje e re institucionale është themeluar në bazë të Ligjit nr. 95/2016. Këto institucione janë të përkushtuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe kanë kompetenca të mirë vendosura, ku kompetencat e tyre ekskluzive do të sjellin specializimin e lartë të zyrtarëve të tyre duke rezultuar në një luftë më efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Vlen të theksohet se ligji për rivlerësimin e zyrtarëve të Policisë së Shtetit ka hyrë në fuqi dhe procesi pritet të fillojë së shpejti.

Regjistrimi dhe aksesimi në bazat e të dhënave

Aksesi në bazat e të dhënave të shtetit është i rëndësishëm për hetim cilësor, të shpejtë dhe efektiv të rasteve të korrupsionit. Në këtë kuadër, Prokuroria ka ndërmarrë hapa konkretë për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet kompetente për të arritur këtë objektiv. Zyra e Prokurorit nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi në vitin 2016 me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për akses në sistemin e të dhënave, në Arkivin Kombëtar të Automjeteve dhe Regjistrin Kombëtar të Drejtuesve të Automjeteve. Më tej, në korrik 2017, Policia e Shtetit dhe Prokuroria nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi “Për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve të Prokurorisë”. Aktualisht është duke u punuar për ndërlidhjen e dy sistemeve të Menaxhimit të Çështjes të Policisë dhe Prokurorisë në mënyrë që të sigurohet shkëmbimi i informacionit mes këtyre dy institucioneve.

Në kuadër të zbatimit të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 204 datë 23.11.2017, është mundësuar dhënia e aksesit të integruar në bazat e të dhënave të institucioneve të përfshira në zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën Kundër Krimit të Organizuar, nëpërmjet AKSHI-t. Aktualisht Policia ka akses në bazat e të dhënave të disa institucioneve të caktuara si: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ujësjellës Kanalizime Tiranë, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSSHE. Së fundmi, në gusht të vitit 2017, në parim është rënë dakord me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit "Për dhënien e të drejtës për akses Prokurorisë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme", ndërkohë teknikat e marrëveshjes janë duke u trajtuar.

Sa i përket përpjekjeve të Shqipërisë në krijimin e një historiku solid të hetimeve, ndjekjeve penale, dënimeve dhe konfiskimit të pasurisë në rastet e korrupsionit, Qeveria shqiptare raporton sistematikisht statistikën e harmonizuar dhe historikun e të dhënave mbi rastet e korrupsionit dhe sipas formatit të tabelave të miratuara nga Komisioni Evropian.

Përpunimi dhe harmonizimi i statistikave dhe raportimi i historikut të të dhënave kryhet nga një Grup Ndërinstitucional Pune, i përbërë nga ekspertë të Policisë së Shtetit, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Lartë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si koordinatore e këtij procesi.

Hetimi

Kapaciteti për hetimin proaktiv në rastet e korrupsionit dhe krimit të zyrtarëve është përmirësuar, ndërsa fokusi kundër korrupsionit të zyrtarëve të lartë në sistemin gjyqësor do të vazhdojë të mbetet prioritet gjatë vitit 2019, deri në themelimin e Byrosë Kombëtare të Hetimeve. Aktualisht po punohet për riorganizimin e strukturave dhe ngritjen e Drejtorisë Qendrore të Hetimeve (Task Force). Në vitin 2019, objektivi është rritja e numrit të raportimeve nga qytetarët të veprave penale të korrupsionit si dhe e numrit të hetimeve financiare ndaj subjekteve të proceduar penalisht, të përfshira në vepra korruptive ose krime të kryera gjatë detyrave institucionale, paralelisht me hetimin e çështjeve përkatëse për veprat penale.

Deklarimi i pasurive

Prioritet i ILDKPKI-së është finalizimi i procesit të digjitalizimit të deklarimit të pasurisë (deklaratë në internet), e cila do të mundësojë rritjen e efektivitetit të këtij procesi, si dhe publikimin brenda afateve kohore të deklaratave të zyrtarëve për interesat privatë, pa nevojën e kërkesave të mëparshme nga publiku.

Edukimi dhe sensibilizimi

Sa i përket nismave edukative dhe ndërgjegjësuere në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, janë parashikuar disa masa për të rritur rolin e shoqërisë civile si dhe rritjen e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit të publikut në luftën kundër korrupsionit. Aktualisht po zbatohet një plan masash edukative në formën e një fushate kombëtare sensibilizimi për rastet e korrupsionit dhe vendosjes të mjeteve inovative për të raportuar korrupsionin.

II.2.2 Aktet e planifikuara

II.2.2.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 - 2021

Nuk ka dokumente politikash për të miratuar në këtë nënkapitull.

II.2.2.2 Masat ligjore të planifikuara 2019 - 2021

Nuk ka masa ligjore që synojnë përafrimin në këtë nënkapitull.

II.2.2.3 Akte të tjera të planifikuara

Nuk është parashikuar miratimi i akteve të tjera ligjore në këtë nënkapitull.

II.3 Të drejtat themelore

II.3.1 Kuadri politik dhe ligjor

Shqipëria është e angazhuar në mbrojtjen e të drejtave themelore. Pjesa II e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë i kushtohet mbrojtjes të të drejtave themelore, si: të drejtat civile, të drejtat ekonomike dhe të drejtat politike. Përveç kësaj, Shqipëria ka ratifikuar të gjitha konventat kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Për sa i përket promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut, ekziston korniza ligjore dhe institucionale. Megjithatë, forcimi i kapaciteteve në aspektin e burimeve njerëzore dhe financiare është i nevojshëm dhe i vazhdueshëm përmes ndërhyrjeve politike dhe ligjore. Avokati i Popullit është një institucion kushtetues i rregulluar në Kapitullin VI të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Përveç kësaj, Ligji Nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, përcakton organizimin dhe funksionimin e Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta nga organet e administratës publike, si dhe palët e treta që veprojnë në emër të tyre. Avokati i Popullit promovon në mënyrë aktive të drejtat e njeriut, veçanërisht ato të grupeve më të prekshme dhe bashkëpunon intensivisht me shoqërinë civile. Është promotori i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend.

Vlen të përmendet se për shkak të ndryshimeve të fundit kushtetuese u paraqit një përmirësim i dukshëm në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Më konkretisht në nenin 134 të Kushtetutës që rregullon të drejtën për t'iu adresuar Gjykatës Kushtetuese, shtohet shkronja (e) me kusht që kjo e drejtë shtrihet tek "çdo komisioner i krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë". Kjo do të thotë që komisionerët e Avokatit të Popullit kanë të drejtë ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese, kur gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, ata ndeshen me shkelje të të drejtave të njeriut.

Sistemi i burgjeve

Për sa i përket sistemit të burgjeve, lirimi i 968 të burgosurve pas Ligjit të amnistisë së janarit 2016 reduktoi ndjeshëm numrin e të burgosurve. Megjithatë, mbipopullimi dhe rreziqet që kanë të bëjnë me keqtrajtimin njerëzor dhe degradues mbeten çështje me rëndësi. Sipas statistikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për muajin mars 2018, në paraburgim kanë qenë 2357 persona dhe 3175 persona të burgosur. Numri i personave në ambientet e paraburgimit mbetet i lartë dhe masat e shërbimit të provës duhet të rriten. Kjo kërkon reformimin e shërbimit të provës, i cili është një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare.

Shqipëria po reformon sistemin e saj të burgjeve në mënyrë që të arrijë standardet më të larta të BE-së dhe të përmbushë detyrimet ndërkombëtare brenda sistemit të burgjeve. Një sërë aktesh

ligjore janë propozuar për miratim gjatë vitit 2019 (ju lutem referohuni tabelës së masave ligjore të parashikuara për Kapitullin 23).

Kushtet e institucioneve ndëshkuese në Shqipëri janë të ndara në dy kategori: institucionet që janë ndërtuar pas viteve 1990 dhe institucionet e trashëguara nga sistemi i kaluar. Institucionet e ndërtuara pas viteve 1990 përmbushin kushtet për trajtimin e personave me liri të kufizuar. Me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, kushtet e përgjithshme të sistemit të burgjeve janë përmirësuar ndjeshëm.

Institucioni ndëshkues i Shkodrës, një nga investimet më të fundit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, i cili është përfunduar më 1 gusht 2018 dhe është vënë në funksionim më 5 tetor 2018, mundëson deri në 780 të burgosur, nga të cilët 180 të paraburgosur dhe 600 shkelës të dënuar. Me hapjen e Burgut të Shkodrës, mbipopullimi i shprehur në numrin e personave është -505, ose (-8%). Numri aktual i të burgosurve është 5731, prej të cilëve 24 të mitur, 269 pacientë mjekoligjorë dhe 102 gra, me një kapacitet total për 6236 persona.

Për vitin 2018, me fonde të buxhetit të shtetit, janë planifikuar investime për të përmirësuar kushtet materiale dhe infrastrukturore në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimit Penal (IEVP) Peqin, Burrel, Lezhë, si dhe institucionin penitenciar të "Jordan Misja".

Në fakt, i vetmi financim i kërkimit shkencor nga buxheti i shtetit është Programi Kombëtar për Kërkim-Zhvillim, i cili që nga viti 1994 deri në vitin 2009 është administruar nga Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në MAS. Ndërkohë që nga viti 2009 me krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI, tani AKKSHI që nga viti 2016), këto programe financohen dhe menaxhohen nga Drejtoria e Programeve Kombëtare, në Agjenci. Në këtë

kuadër, pas realizimit të procesit të identifikimit të fushave prioritare të Kërkimit Shkencor, në datën 04.06.2018, u shpall Thirrja për aplikim me projekte në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) për vitet 2018-2020 në fushat prioritare të kërkimit.

Në përgjigje të kësaj Thirrje janë paraqitur 95 projekt-propozime për të cilat pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga Ekspertët e Komisioneve, pritet miratimi i projekteve fituese nga Bordi i Administrimit të AKKSHI.

Nga ana tjetër, financimi i kërkimit nga qeveria bëhet përmes një numri entitetesh si ministrinë e linjës dhe organizatat publike, të angazhuara drejtpërdrejt ose tërthorazi në aktivitetet kërkimore dhe politikat e inovacionit.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural financon aktivitete në fushën e kërkimit të aplikuar dhe transferimit të teknologjisë në fusha të veçanta, kryesisht në përgjigje të nevojave të komunitetit bujqësor. Aktivitetet janë kryer nga gjashtë Qendrat për Transferimin e Teknologjive Bujqësore (QTTB), që varen nga kjo ministri.

Ministria e Mbrojtjes parashikon intensifikimin e veprimtarive të K&ZH për sigurinë dhe mbrojtjen, si pjesë e një plani afatgjatë për zhvillimin e Forcave të Armatosura deri në vitin 2020. Për më tepër, anëtarësimi në NATO nënkupton pjesëmarrjen e komunitetit të kërkuesve shqiptarë, në Programin e NATO-s të Shkencës për Siguri e Paqe (PSP).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka programin e saj të kërkimit, Institutin e Shëndetit Publik dhe Qendrën Bio-mjekësore, që i shërbejnë përmirësimit të shërbimeve në këtë sektor.

Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës mbështet dy agjenci të mëdha, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), që kryejnë studime dhe shërbime në fushën e burimeve natyrore, energjisë, shkencave të tokës, etj.

Ministria e Ekonomisë e Financës Financave dhe Ekonomisë ka ngritur pranë Agjencisë Kombëtare të Investimeve (AIDA), një Qendër për Ndërmjetësimin e Inovacionit (BRIC), e cila siguron shërbime për ndërmarrjet që lidhen me transferimin e inovacionit dhe të teknologjisë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka një program që jep grante për studime në fushat që mbulon, ndërsa Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) kryen një sërë studimesh, analizash e vlerësimesh në fushën e mjedisit.

Aktualisht ekzistojnë pesëdhjetë e dy marrëveshje ndërkombëtare të bashkëpunimit dypalësh, të ndara si më poshtë:

- Tridhjetë e dy marrëveshje me vendet e BE;
- Katërmëdhjetë marrëveshje me vendet e Ballkanit Perëndimor;
- Gjashtë marrëveshje me shtete në Amerikë, Azi, Afrikë.

AKKSHI, si një institucion ekzekutiv përmes Udhëzimit nr. 13 datë 12.7.2012 "Për procedurën e dorëzimit, rishikimit, miratimit dhe raportimit të projekteve të financuara nga programet e bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik", aktualisht po implementon marrëveshjet bilaterale si më poshtë vijon:

1. AKKSHI, në zbatim të Marrëveshjes për Bashkëpunim Shkencor ndërmjet MASR dhe Qendrës Kombëtare të Kërkimit (CNR), nënshkruar më 19.05.2017, hapi Thirrjen për Propozime ndërmjet Studiuesve shqiptarë dhe italianë që përfaqësojnë institucionet shkencore brenda CNR.

Brenda afatit të 29 shtatorit 2017, janë dorëzuar rreth 29 projektpropozime, të cilat janë vlerësuar nga Komisionet e Ekspertëve në AKKSHI. Financimi i tyre është planifikuar të fillojë brenda vitit 2018, me një fond vjetor prej 2,500 Euro.

Numri i përgjithshëm i projekteve fituese që parashikohet të financohen çdo vit sipas Marrëveshjes për Bashkëpunim Shkencor ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të Qendrës Kombëtare të Kërkimeve të Italisë (CNR) është 10, me një kohëzgjatje maksimale prej 2 vjetësh. Projektet janë grante të vogla që synojnë nxitjen e iniciativave të përbashkëta shkencore, shkëmbimin e hulumtuesve dhe ndërtimin e partneriteteve për projektet afatgjata.

Hapja e kësaj thirrje ka për qëllim nxitjen e lëvizshmërisë akademike midis kërkuesve shqiptarë dhe italianë, duke treguar përvojat e shkëmbimit dhe përfundimin e bashkëpunimit për projektet afatgjata në kuadër të ERASMUS +, ose HORIZON 2020.

Projekt propozimet i janë dorëzuar Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - AKKSHI deri më 29 shtator 2017.

Fushat e hulumtimit që mbulohen në këto propozime projekti janë si vijon:

- Shkenca Sociale dhe Albanologjike;
- Teknologjia dhe Teknologjia e Informacionit;
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia;
- Uji dhe Energjia;
- Biodiversiteti dhe Mjedisit;
- Kujdesit shëndetësor;
- Materiale.

Pas përfundimit të aplikimit dhe rishikimit paraprak të propozimeve të paraqitura është vërejtur se: Numri i përgjithshëm i projektpropozimeve të paraqitura është 27. Nga 27 projektpropozime të dorëzuara, 3 janë nga institucionet private të arsimit të lartë dhe 24 nga institucionet publike të arsimit të lartë:

- 9- Projekte vijnë nga fusha e "Biodiversitetit dhe Mjedisit";
- 6 - Projekte vijnë në fushën e "Bujqësisë, Ushqimit dhe Bioteknologjisë";

- 4- Projektet vijnë në fushën e "Shkencave Sociale dhe Albanologjike";
- 3 - Projekte vijnë në fushën e "Ujit dhe Energjisë";
- 3- Projektet vijnë në fushën e "Materialeve";
- 2 - Projektet vijnë në fushën e "Sistemeve Informative dhe Teknologjisë";
- 0 - Projektet vijnë në fushën e "Shëndetit"

Nga 27 projektet vetëm 10 projekte do të financohen nga buxheti i shtetit i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Fondi i alokuar për AKKSHI nga MoESY, parashikohet të jetë rreth 5 mijë euro për projekt për dy vjet.

2. Sipas Protokollit të Takimit të Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Austri, datë 11.04.2012 për Bashkëpunimin në Fushat e Kulturës dhe Shkencës për vitet 2012-2014 dhe VKM nr. 657, datë 26.09.2012, “Mbi miratimin e Protokollit ndryshues të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për bashkëpunimin në fushën e Arsimit, Kulturës dhe Shkencës”. AKKSHI, në 8 prill 2018, shpalli Thirrjen e Dytë për Propozime për Bashkëpunimin Shkencor, Projekte dypalëshe 2019-2020 midis Shqipërisë dhe Austrisë. Thirrja u mbyll më 31 qershor 2018, me një numër prej 14 kërkuesish. Kjo fazë hap rrugën për konfirmimin e fituesve, pas miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI.
3. Për më tepër, Sektori i Marrëveshjeve Bilaterale, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 21.04.2010, për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës, me bashkëpunimin rajonal si platforma rajonale për bashkëpunim të ngushtë në fushën e arsimit dhe trajnimit, "ERI SEE", AKKSHI është e angazhuar në ndërtimin e urave të komunikimit paraprak me agjencitë ose organet ekzekutive të marrëveshjeve dhe protokollat e bashkëpunimit, është në hapat e parë të hartimit të Draftit të Protokollit të Bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë. Ky angazhim i përbashkët synon të finalizohet në një takim të përbashkët në MASR, për të hapur thirrjen e parë shkencore-teknike me Kosovën.
4. Në bazë të dispozitës së nenit 9 të Protokollit të Sesionit të 5-të të Komitetit të Përbashkët Bashkëpunimi Ekonomik Shqiptaro-Kroat të nënshkruar më 15 maj 2018, Sesioni i 5-të i Komitetit të Përbashkët Shqiptaro-Kroat të Bashkëpunimit Ekonomik, në Zagreb, Kroaci, KCAHI ka filluar bashkëpunimin me homologët kroatë në hartimin e Draft Protokolleve të Përbashkëta, me qëllim të hapjes së Thirrjes së parë Teknike-Shkencore për vendet. Thirrja do të fillojë brenda 2018-ës, ndërsa financimi i projekteve fituese do të fillojë në vitin 2019.

Në kuadrin të informimit mbi këtë program të financuar nga BE dhe të rritjes së mundësisë së bashkëpunimit ndërmjet Industrisë dhe Sektorit Publik, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), Drejtorinë për të Drejtën e Autorit (DDA) gjatë vitit 2018 ka organizuar Ditët

Informative me temë: Programet financuese të BE-së për SME-të, Pronësia Industriale dhe e Drejta e Autorit.

Në aktivitetet e oraganizuara në muajt Shkurt dhe Korrik të vitit 2018 është bërë promovimi i programeve të financuara nga BE, si Horizon 2020 me “SME Instrument” për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në fushat e TIK, Bujqësisë dhe Agropërpunimit, ku është përcjellë koncepti i Transferimit të Teknologjive në mbështetje të zhvillimit, rritjes së prodhimit të ndërmarrjeve dhe konkurrueshmërisë së bizneseve. Njohuri mbi pronësinë intelektuale e atë industriale si dhe mbi të drejtat e autorit. Në aktivitetet e organizuara janë ftuar dhe kanë prezantuar ekspertë nga Drejtoria e Përgjithëshme e Pronësisë Industriale dhe nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit nga Ministria e Kulturës.

Gjithashtu, në bashkëpunim edhe me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Inestimeve (AIDA), nga përfaqësues të saj është përcjellë informacioni mbi Rrjetin European të Ndërmarrjeve, (EEN) me synim promovimin dhe shtimin e numrit të profileve në këtë Rrjet, si output kryesor i këtij projekti, gjithashtu dhënie e informacionit mbi fondet që AIDA menaxhon për SME-të shqiptare.

Pas përfundimit të programit kuadër të BE FP7 (2007-2013), Shqipëria merr pjesë si vend i asociuar në Programin Kuadër të BE-së për Kërkim dhe Zhvillim Horizon 2020 (2014-2020). Bazuar në Ligjin Nr. 132/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian lidhur me pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin Kuadër të BE-së Horizon 2020 Programi i BE për Kërkim Shkencor dhe Inovacion. Shqipëria është pjesë e Programit Horizont 2020 (H2020). Lidhur me pjesëmarrjen e Shqipërisë në këtë program, si më poshtë vijon janë disa të dhëna.

Tabela: Të dhëna për Horizon 2020 për marrëveshje të firmosura deri në 16/4/2018⁴⁶

Shqipëria (Të dhëna për marrëveshje të firmosura deri më 16/4/2018)	Horizon 2020	FP7
Numri total i pjesëmarrësve nga Shqipëria	20	37
Numri total i Granteve me pjesëmarrës shqiptarë	18	27
Kontributi total i BE-së (milionë Euro)	2,1	2
Projekte bashkëpunuese: Numri i pjesëmarrjeve të Shqipërisë	17	37
Projekte Bashkëpunimi: Numri i granteve me pjesëmarrës shqiptarë	17	27
Projekte bashkëpunimi: Kontributi i BE-së për pjesëmarrësit Shqiptarë (milionë Euro)	2	2
Veprimet e komponentit Marie Sklodowska-Curie: Numri i pjesëmarrjeve nga Shqipëria	3	0
Veprimet e komponentit Marie Sklodowska-Curie: Numri i kërkuesve me kombësi shqiptare	22	25

⁴⁶ <https://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/home.html>

Grantet e Qendrës Kërkimore Evropiane (ERC)s Numri i pjesëmarrjeve nga Shqipëria	0	0
Grantet e Qendrës Kërkimore Evropiane (ERC): Numri i kërkuësve me kombësi shqiptare	0	0
Instrumenti i SME: Numri i pjesëmarrjeve nga Shqipëria	0	

Tabela: Të dhëna për Horizon 2020 deri në 7.09.2018

Shqipëria	Horizon 2020
Numri total i pjesëmarrjeve nga Shqipëria	26
Kontributi total i BE-së (Euro)	2.427.573 Euro
Propozime të pranuar	231
Propozime të shqyrtuara	19
Kontributi i kërkuar nga BE (Euro)	57.465.891 Euro
Aplikimi	288

Në zhvillim të takimit më datë 25-26 prill 2018, në Rejkavik të Islandës u zhvillua takimi i 203-të i Komitetit të Zyrtarëve të Lartë gjatë së cilit u morr vendimi se Shqipëria i plotëson të gjitha kërkesat mbi anëtarësimin me të drejta të plota në programin COST. Shqipëria tashmë është vendi 37-të që i bashkohet programit COST.

Bashkëpunimi rajonal në fushën e kërkimit

Shkenca, Teknologjia dhe Inovacioni (ShTI) synon të japë një kuadër përmes të cilit, forumi shumëpalësh i donatorëve dhe bashkëpunimi dypalësh të mund të ndihmojnë në një mënyrë të strukturuar në fuqizimin e kërkuësve shqiptarë për Kërkim – Zhvillim K&ZH. Përparësi e lartë nga pikëpamja e ndërkombëtarizimit është përshtatja graduale e një procesi të ngjashëm me “planet e reformimit kombëtar” në shtetet anëtare të BE-së, sipas të cilit Qeveria shqiptare do të ketë një angazhim për prioritetet afatgjata në fushat e politikave të kërkimit dhe inovacionit.

Rritja e bashkëpunimit rajonal në fushën e kërkimit në Ballkanin Perëndimor inkurajohet, në mënyrë që vendet e rajonit të mund të jenë pjesë e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA) gjatë procesit të integritetit. Shqipëria është anëtare e Grupit të Punës për Shkencën e Hapur të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) me qendër në Sarajevë dhe ka emëruar Pikat Kombëtare të Referencës -NPR.

Ndërkohë Shqipëria ka ratifikuar në 2015 marrëveshjen rajonale për krijimin e Qendrës së Ballkanit Perëndimor për Shkencë e Inovacion (WISE) dhe në Tetor 2017 ka nënshkruar në Gjenevë Deklaratën e Vullneti të Mirë për të marrë pjesë në krijimin e Institutit të Evropës Juglindore për Teknologjitë e Qëndrueshme-SEEIST. Shqipëria merr pjesë në zbatimin e Planit Vjetor Shumëvjeçar për krijimin e Zonës Ekonomike Rajonale - MAP ARM, e cila është një iniciativë e vendeve të BE dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të procesit të Berlinit të miratuar gjatë Samitit të Triestes më 12 korrik 2017. Shqipëria ka vënë përpjekjet e saj kërkimore për të kontribuar përmes shtyllës së Mobilitetit të MAP, duke promovuar dhe mbështetur çdo iniciativë që lehtëson mobilitetin e hulumtuesve në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Një nga treguesit në drejtim të bashkëpunimi rajonal në fushën e shkencës dhe inovacionit është pjesëmarrja e Shqipërisë në procesin e hartimit të disa strategjive. Në këtë kuadër është Strategjia e Evropës Juglindore 2020 (South East Europe Strategy 2020 - SEE) e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (Regional Cooperation Council) me qendër në Sarajevë (ish Pakti i Stabilitetit), e miratuar në 21 shkurt 2013 në një konferencë të ministrave të ekonomisë së Ballkanit Perëndimor, ku përfshihej edhe Shqipëria. Strategjia synon të përmirësojë kushtet e jetës në rajon, aftësinë konkurruese dhe zhvillimin ekonomik, duke ndjekur vizionin e BE-së në strategjinë e saj 2020. Ajo synon që vendet e Ballkanit Perëndimor të hapin 1 milion vende pune deri në 2020, të rrisin tregtinë rajonale nga 94 miliardë Euro në 210 miliardë Euro dhe rritjen e të ardhura për frymë në 44% të mesatares së vendeve të BE, duke i shtuar deri në 2020 forcën e aftë për punë në rajon rreth 300 000 individë shumë të kualifikuar. Kjo strategji vlerësohet çdo vit për treguesit e realizimit të saj përmes një metodologjie të caktuar. Një nga shtyllat e saj është shtylla e kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Nga ana tjetër, një dokument i rëndësishëm është Strategjia për Kërkim Shkencor dhe Inovacionin e Ballkanit Perëndimor, e cila u nxit fillimisht nga një Deklaratë e Përbashkët e Ministrave të Arsimit dhe Shkencës në 2009. Më pas, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian nënshkruan në shtator 2011 një marrëveshje për financimin e kësaj strategjie, prej 1.5 milion Euro nga fondet IPA. Ndërkohë për bashkërendimin e kësaj strategjie, vendet e rajonit kanë rënë dakord të krijojnë Western Balkans Innovation Strategy Exercise Facility (WISE), me qendër në Split të Kroacisë, një mekanizëm që mbështet e nxit iniciativat në këtë fushë.

I.3 Prioritetet

Një nga përparësitë kryesore të Shqipërisë në këtë fushë është reformimi dhe përmirësimi i sistemit institucional të kërkimit shkencor duke synuar rritjen e financimit në nivel kombëtar për shkencën e zhvillimin, nxitjen e qasjes së bashkëpunimit të trefishtë qeveri-akademi-biznes (Triple Helix), si dhe përballimin e zgjidhjen e sfidave social-ekonomike të vendit përmes një kërkimi shkencor sa më cilësor. Nga ana tjetër, Qeveria shqiptare ka për qëllim forcimin e kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore të kërkimit shkencor për të rritur pjesëmarrjen dhe nivelin e suksesit në Programet kuadër të BE-së për Kërkimin Shkencor & Inovacionin. Në këtë kuadër, identifikimi i fushave të kërkimit shkencor ku Shqipëria ka më shumë nevojë, do të jetë një ndër përparësitë bazë që mban parasysh zbatimin e qasjes së specializimit të zgjuar (smart specialization). Gjithashtu thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkencës e kërkimit shkencor, qoftë në nivel rajonal e ndërkombëtar, përbën një objektiv dhe prioritet të rëndësishëm për fuqizimin e këtij sektori. Përfshirja dhe zbatimi i parimeve të Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor-ERA në hartimin kuadrit strategjik e ligjor për zhvillimin e shkencës në Shqipëri do të pasohet nga ndjekja e aktiviteteve që afrojnë Shqipërinë me Unionin e Inovacionit.

Rekomandimet e Komitetit të Stabilizim Associmit për kërkimin dhe inovacionin, 2018:

- Autoritetet shqiptare inkurajohen të zhvillojnë Strategjinë Shqiptare të Specializimit të Zgjuar.

- Shqipëria duhet të rrisë buxhetin për kërkimin dhe shkencën (më shumë se 0.2% të GDP-së që është aktualisht).

Rekomandimet e Progres Raportit 2018

Gjatë vitit që vjen, Shqipëria duhet të:

- të rrisë investimet në kërkim, në përputhje me angazhimet e veta dhe prioritetet e Zonës Evropiane të Kërkimit;
- rritja e pjesëmarrjes në Horizon 2020, për shembull duke bërë përpjekje për të rritur shkallën e pjesëmarrjes.

II.1. Shkenca dhe kërkimi shkencor

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Në përgjithësi, Shqipëria ka qenë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga MSA në fushën e politikës kërkimore dhe shkencore.

Dokumenti kryesor politik në këtë fushë është Strategjia Kombëtare për Kërkimin, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 710 datë 01.12.2017

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka vazhduar proceset e rishikimit të legjislacionit primar dhe sekondar me qëllim që ta përafrojë atë me acquis e BE-së. Në këtë kuadër janë miratuar akte të reja dhe janë bërë ndryshime të nevojshme që përmirësojnë dhe rregullojnë më tej mënyrën se si punon sistemi i kërkimit në Shqipëri dhe bashkëpunon me programet e Kuadrit të BE-së. Një sërë aktesh legjislative janë në fuqi dhe së fundmi të tjerë janë miratuar si më poshtë:

- Ligji Nr. 132/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin Kuadër Horizon 2020- programi IBE-së për Kërkimin dhe Inovacionin”, i përafuar plotësisht me Rregulloren Nr. 1290/2013 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e 11 Dhjetorit 2013 për përcaktimin e rregullave mbi pjesëmarrjen dhe shpërndarjen e informacionit në Programin Kuadër për Kërkimin Shkencor e Inovacionin 2014-2020 Horizon 2020;
- Ligji Nr. 61/2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë e Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Unionit "Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme- COSME 2014-2020" i përafuar plotësisht me Rregulloren Nr. 1287/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2013, për krijimin e programit për konkurrencën e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME)
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 607 datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit” i përafuar pjesërisht me Rregullore e Këshillit Nr. 58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 për

përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimin e programeve Komunitare

- Ligj Nr. 75/2015 datë 09.07.2015 "Për ratifikimin e Marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë e Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Unionit për punësim e inovacion social –EaSI" i cili përaftron pjesërisht Rregulloren Nr. 1296/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2013, për krijimin e Programit të Bashkimit Evropian për Punësim dhe Inovacion Social;
- Ligji Nr. 16/2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e qendrës së kërkimit shkencor dhe inovacionit të Ballkanit Perëndimor (WISE)" në linjë me Deklaratën për bashkëpunim të përbashkët në Shkencë dhe Novacion, firmosur në Sarajevë në vitin 2013 dhe Deklaratën për Strategjinë Rajonale të Kërkimit dhe Zhvillimit për novacion, të firmosur në vitin 2013;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 567 datë 23.10.1995 "Për pagesën e këshillave, komiteteve dhe ekspertizës së veprimeve shkencore dhe teknologjike";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 18.03.1996 "Për rrjetin institucional shkencor shtetëror";
- Ligji Nr. 8366, datë 02.07.1998 "Për themelimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (AGS);
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 333, datë 15.07.1999 "Për ndryshimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 18.03.1996 "Për rrjetin institucional shkencor shtetëror";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 278, datë 02.06.2000 "Për themelimin e Institutit të Policisë Shkencore"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 178, datë 30.03.2001 "Për bashkimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit dhe Promovimit të Shëndetit me Institutin e Shëndetit Publik";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 19.06.2004 "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 03.1.1996" Për rrjetin institucional shkencor shtetëror".
- Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 225, datë 29.06.2004 "Për themelimin e Institutit të Ndërtimit".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 515, datë 19.07.2006 "Për ristrukturimin e instituteve kërkimore nën Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 09.08.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (NANR);
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 579, datë 23.08.2006 "Për krijimin e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve (EFA);
- Ligji Nr. 9655, datë 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 807, datë 06.12.2006 "Për ristrukturimin e Institutit të Kërkimeve dhe Dizajnit të Industrisë së Lehtë (ISPIL)"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 163, datë 21.03.2007 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 515, datë 19.07.2006" Për ristrukturimin e instituteve kërkimore nën Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 146, datë 28.03.2007 "Për bashkimin e Institutit të Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar dhe riorganizimit të tij si pjesë e Universitetit

Politeknik të Tiranës, dhe me ndryshimin e vendimit Nr. 440, datë 16.06.2005 të Këshillit të Ministrave" për miratimin e listës së inventarit të pronave, shtetit, i cili transferoi përgjegjësinë e menaxhimit të Akademisë së Shkencave";

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 202, datë 11.04.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 547, datë 09.08.2006" Për themelimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (NANR)",
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 255, datë 27.04.2007 "Për Fondin e Ekselencës për mbështetjen financiare të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyeshëm";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 364, datë 13.06.2007 "Për një shtesë të VKM Nr. 547, datë 09.08.2006" Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 382, datë 20.06.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 515, datë 19.07.2006" Për ristrukturimin e instituteve kërkimore nën Ministrinë e Bujqësisë, Mbrojtjes e Ushqimit".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 559, datë 22.08.2007 "Për bashkimin e disa instituteve të Akademisë së Shkencave, organizimin e Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe funksionimin e kësaj qendre në periudhën kalimtare";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 560, datë 22.08.2007 "Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 561, datë 22.8.2007 "Për unifikimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave (GI) në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit për periudhën e tranzicionit";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 562, datë 22.08.2007 "Për përfundimin e Institutit të Kërkimeve Biologjike të Akademisë së Shkencave dhe Integrimit të tij në Universitetin e Tiranës;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 563, datë 22.08.2007 "Për krijimin e Qendrës së Fizikës Bërthamore të Aplikuar dhe Autoritetit Atomik Shqiptar, pranë Universitetit të Tiranës";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 467, datë 18.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat për kualifikimin shkencor dhe pedagogjik të personelit akademik";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 661, datë 18.10.2007 "Për përcaktimin e masave për organizimin e qendrave ose instituteve të kërkimit dhe zhvillimit, për të filluar operacionet në periudhën kalimtare";
- Vendimi Këshillit të Ministrave Nr. 861, datë 21.11.2007 "Për themelimin, organizimin dhe funksionimin e Institutit të Transportit (IT).
- Ligji Nr. 9853, datë 26.12.2007 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9655, datë 11.12.2006" Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë ";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 156, datë 13.02.2008 "Për ndryshimin e vendimit Nr. 559, datë 22.08.2002 "Për bashkimin e disa instituteve të Akademisë së Shkencave, organizimin e Qendrës së Studimeve Albanologjike, si dhe funksionimin e kësaj qendre në periudhën kalimtare";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 349, datë 27.03.2008 "Për themelimin e komisionit përzgjedhës të anëtarëve të rinj të Akademisë së Shkencave";

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 399, datë 27.03.2008 "Për miratimin e shumës së kompensimit për anëtarët e anëtarëve të rregullt dhe të përhershëm të Akademisë së Shkencave";
- Ligji Nr. 9949, datë 07.07.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9655, datë 11.12.2006" Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë";
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 18, datë 29.07.2008 Me objekt: 1. Shfuqizim të Ligjit nr. 9853, datë 26.12.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9655, datë 11.12.2006 Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë ", si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë 2. Pezullimi i këtij ligji deri në shqyrtimin përfundimtar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 863, datë 29.07.2009 "Për miratimin e Strategjisë për Shkencë, Teknologji dhe Inovacion 2009-2015";
- Ligji Nr. 10242, datë 25.02.2010 "Për Institutin e Kërkimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri";
- Ligji Nr. 10271, datë 22.04.2010 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9655, datë 11.12.2006" Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 399, datë 26.05.2010 "Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 787, datë 24.09.2010 "Për një ndryshim dhe plotësim të Vendimit Nr 399, datë 27.03.2008" Për miratimin e shumës së kompensimit të anëtarëve të anëtarëve të rregullt dhe të përhershëm të Akademisë së Shkencave;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 380, datë 18.05.2011 "Për themelimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Shkencor të Institutit të Shëndetit Publik (IPH)";
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit Nr. 19, datë 31.05.2011 "Për elaborimin e buxhetit të institucioneve publike të arsimit të lartë në programin" për hulumtim dhe përsosmëri fundamentale";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 490, datë 06.07.2011 "Për shfuqizimin e VKM Nr. 560, datë 22.8.2007" Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimi i tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionin e Institutit për periudhën kalimtare";
- VKM nr. 561, datë 22.8.2007" Për unifikimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimi i tyre në Institutin e Gjeoshkencave dhe afër në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe funksionin e Institutit për periudhën kalimtare";
- Urdhri i Ministrit të Arsimit Nr. 371, datë 28.07.2011 "Për themelimin e Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Ambientit pranë Universitetit Politeknik";
- Urdhri i Ministrit të Arsimit Nr. 105, datë 23.03.2012 "Për miratimin e Rregullores" Për etikën në hulumtim dhe botim";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 150, datë 27.02.2013 "Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 989, datë 09.12.2015 "Për themelimin, funksionimin, kohëzgjatjen dhe tarifat e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit CHER";

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 329 datë 12.04.2017 Për statusin dhe trajtimin e veçantë të stafit akademik;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 505, datë 13.09.2017 Për përcaktimin e fushave të përgjegjëseve shtetërore të caktuara në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 88 datë 14.02.2018 “Për krijimin e Rrjetit Akademik Ndërinstitucional të Rrjetit Shqiptar – RASH”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 75 datë 12.02.2018 “Për modelin e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe të kërkimit”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 112 datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për ndarjen e shkallës së doktoratës dhe standardeve shtetërore për fitimin e titullit akademik Ass.Prof dhe Prof.Dr”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 165 datë 21.03.2018 “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore në departamentet e institucioneve të arsimit të lartë”

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Arsimit e Sportit dhe Rinisë;
- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit;
- Këshilli për Arsimin e Lartë dhe Shkencën;
- Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë;
- Instituti i Statistikave –INSTAT;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale;
- Akademia e Studimeve Albanologjike;
- Institucionet e Arsimit të Lartë Publik;
- Institucionet e Arsimit të Lartë Jo-Publik.

II.1.3. Akte të planifikuara

II. 1.3.1. Politika Kuadër të Planifikuara 2019 – 2021

Strategjia për Specializimin Inteligjent, pritet të miratohet brenda tremujorit të IV-ërt të vitit 2020.

II. 1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Ndryshimi i ligjit aktual për shkencën në RSH. Dokumenti për “Reformimin institucional të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë” është parashikuar për t’u miratuar në tremujorin e IV-ërt të 2019-ës.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	0	0	0
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera	0	0	0
Buxheti total i Kapitullit	0	0	0

Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e acquis e BE-së

Acquis për arsimin dhe kulturën konsiston kryesisht në kuadrin e bashkëpunimit të përbërë nga programe dhe metoda të koordinimit të hapur (OMC), që synojnë konvergjencën e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave të përbashkëta. Në fushën e arsimit dhe kulturës shtetet anëtare duhet të sigurojnë menaxhimin e mirë të programeve të decentralizuara të Bashkimit Evropian. Acquis kërkon gjithashtu, që shtetet anëtare të lehtësojnë arsimin për fëmijët e punëtorëve emigrantë në Bashkimin Evropian dhe që ata të mos diskriminohen kundrejt shtetasve të BE-së. Në fushën e kulturës, Konventa e UNESCO-s e vitit 2005, “Mbi mbrojtjen dhe nxitjen e diversitetit të shprehjeve kulturore” e cila është ratifikuar nga Bashkimi Evropian, është një komponent kryesor i acquis. BE kontribuon gjithashtu, në promovimin e çështjeve sportive evropiane.

Acquis i BE për kulturën bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga “Traktati për Bashkimin Evropian” dhe “Traktati për Funksimin e Bashkimit Evropian”. Qëllimi i politikave të BE-së për kulturën është për të inkurajuar bashkëpunimin në mbështetje dhe për plotësimin e veprimeve që lidhen me rritjen e dijes dhe përhapjen e kulturës, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, shkëmbimet kulturore dhe krijimet letrare dhe artistike duke përfshirë dhe sektorin audiovizual. BE gjithashtu fokusohet dhe inkurajon pjesëmarrjen në programet e BE-së.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar në arsim me Acquis të BE-së buron nga neni 70 MSA për përafrimin e legjislacionit dhe neni 100 lidhur me përafrimin e legjislacionit në arsim dhe trajnim. Në fushën e kulturës neni 101 i MSA thekson se ‘palët zotohen të ndërmarrin bashkëpunim kulturor. Ky bashkëpunim do të shërbejë gjithashtu edhe për rritjen e mirëkuptimit të përbashkët dhe të respektit reciprok ndërmjet individëve, komunitetit dhe njerëzve. Palët gjithashtu zotohen të bashkëpunojnë për promovimin e diversitetit kulturor, veçanërisht në kuadër të Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore.”

I.2 Situata aktuale / përmbledhja

Me miratimin më 23/07/2018 të ligjit nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 69/2012 “ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar” sigurohet një qasjeje të re e përgjegjëse të institucioneve përgjegjëse për sistemin arsimor parauniversitar. Me riorganizimin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, do të krijohen struktura të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Këto struktura do të sigurojnë cilësinë e shërbimit në institucionet e arsimit parauniversitar. Ligji përcakton për herë të parë konceptin e “Vlerësimit të arritjeve në arsimin fillor”. Një tjetër risi është krijimi i bazës ligjore për Këshillin Kombëtar të Prindërve si një strukturë e prindërve në nivel kombëtar. Gjithashtu ligji siguron përmirësimin e kriterëve dhe standardeve profesionale të lidërshit të institucioneve shkollore.

Një tjetër risi lidhet me qartësimin e nivelit arsimor të kandidatëve për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit për arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë, si dhe zhvillon më tej parimet e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nxënësve që nuk dëgjojnë dhe atyre që nuk shikojnë, u krijohen mundësi reale për edukimin e tyre, si në pikëpamjen infrastrukturore, ashtu dhe në atë të pajisjeve dhe mjeteve didaktike.

Për të siguruar rritje të aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor MASR gjatë periudhës së raportimit ka ndërmarrë:

- Është nënshkruar (tetor 2018) marrëveshja e re tre ministrore MASR, MB, MSHMS , “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkolle”;
- Janë hartuar dhe miratuar standardet e mësuesit të arsimit parashkollor;
- Janë hartuar dhe miratuar programet me kurrikulën e re për grup moshën 4-5 vjeç.

Sa i përket veprimtarive për zbatimin dhe hartimin e kurrikulës së re dhe masave në lidhje me të: Në vitin shkolle 2018-2019, vijon zbatimi i kurrikulës me bazë kompetencën si qasje evropiane në përmirësimet kurrikulare të ndërmarra nga MASR për sistemin arsimor parauniversitar. Në këtë kuadër, janë trajnuar për zhvillim profesional 482 mësues dhe drejtues të shkollave pilot, 3797 mësues të klasave të 11-ta për zbatimin e kurrikulës bazuar në kompetenca, 2709 mësues për të nxënë të nëpërmjet portofolit të nxënësit, 500 mësues të gjuhëve të huaja për portofolin evropian të gjuhëve të huaja, hartimin e testeve të standardizuara, 101 specilistë të DAR/ZA-ve të trajnuar për funksionimin e rrjeteve profesionale të mësuesve sipas profileve të tyre, 1038 drejtues rrjetesh të trajnuar për organizimin dhe planifikimin e punës së rrjeteve profesionale, rreth 8000 mësues anëtarë të rrjeteve profesionale për planifikimin e kurrikulës me kompetenca, 110 mësues të klasave pilot të trajnuar për provimet e lirisimit, 400 mësues dhe drejtues rrjetesh profesionale të trajnuar për programin e arsimit parashkollor, 147 specialistë dhe drejtues shkollash të trajnuar për zbatimin e Nismës “3 lëndë në 6 orë”; 160 mësues të trajnuar për kompetencën e sipërmarrjes; 496 mësues të trajnuar të shkollave pilot për zbatimin e nismës “3 lëndë në 6 orë”; 320 mësues të trajnuar për edukimin mjedisor; 2873 mësues të klasës 12 për zbatimin e kurrikulës me kompetenca; 3208 mësues të klasave 4 dhe 9 për zbatimin e kurrikulës me kompetenca; 347 mësues për TIK kodimi dhe programimi; 88 mësues për shkollën qendër

komunitare; 306 mësues për zbatimin e udhëzuesit të Maturës shtetërore; 224 mësues për klasat kolektive për programin ndihmës të lexim – shkrimit në klasat kolektive etj.

Trajnimet për zhvillim profesional përfshijnë dhe mësues të pakicave kombëtare me 40 mësues të kësaj kategorie të trajnuar. U hartuan 14 programe lëndore për klasat 5, si dhe 15 programe për shkollat profesionale dhe me drejtim të orientuar. Programet e klases 5 po pilotohen gjatë vitit shkollor 2018-2019. U përgatitën 12 module trajnimi për kurrikulën e klasës së 12-të.

Për mbështetjen e nxënësve maturanë u përgatit një paketë informuese për IAL-të dhe u zhvilluan tryeza me përfaqësues të IAL-ve mbi kurrikulën e re të gjimnazit si dhe me vendosjen e kriterëve të pranimit të maturanëve në arsimin e lartë.

IAL- të kanë përgatitur kriteret për vitin akademik 2019-2020 të cilat janë shpërndarë nëpër shkollat e mesme gjatë periudhës prill – maj 2018.

Gjatë periudhës qershor 2018 janë zhvilluar takime informuese me 400 drejtuesit dhe me 3000 mësues të shkollave të mesme lidhur me udhëzuesin e IZHA-s për kurrikulën me zgjedhje dhe maturën shtetërore.

Gjithashtu për të standardizuar format e zhvillimit profesional dhe çertifikimin e mësuesëve, si dhe për të luftuar korrupsionin në këtë proces u reformua skema e zhvillimit profesional. Gjatë vitit 2018 janë kryer monitorime nga MASR, ISHA, IZHA në rreth 20 agjenci trajnuese lidhur me procesin e zhvillimit të trajnimeve.

Për formimin fillestar të mësuesëve, gjatë kësaj periudhe janë realizuar:

- Përcaktim i kriterëve të reja për mësuesinë nga universitetet të përshtatura me kurrikulën e arsimit parauniversitar;
- Rritje e notës mesatare si kriter hyrës në programet e mësuesisë (nota mesatare 7);
- Janë krijuar 16 grupe pune sipas profileve lëndore dhe janë angazhaur 164 profesorë të fakulteteve të mësuesisë si dhe specialistë të fushës për të punuar me harmonizimin e kurrikulave të mësuesisë.

Grupet do të përgatisin brenda dhjetorit 2018 materialin dhe rekomandimet për rishikimin e kurrikulës.

Është përgatitur drafti për standardet e formimit fillestar të mësuesëve, i cili do të punohet me universitetet.

Është përgatitur drafti i kurrikulës për formimin psiko-pedagogjik të mësuesëve të rinj.

Lidhur me mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, u trajnuan 120 mësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Gjithashtu, u realizua trajnimin i rreth 90 mësuesëve shqiptarë të arsimit parauniversitar të Luginës së Preshevës.

Për mbrojtjen dhe formësimin e shumë gjuhësisë në sistemin arsimor shqiptar dhe standardizimin e kurrikulës e trajnimit të mësuesve, vijon bashkëpunimi bilateral me vendet anëtare të BE.

Ka filluar përgatitja për pjesëmarrjen e Shqipërisë në PISA 2018. Për herë të parë, PISA 2018, do të zhvillohet në modelin computer based assesment. Gjatë muajit prill 2017 në 32 shkolla të 17 DAR/ZA-ve, u zhvillua pilotimi i PISA 2018, me pjesëmarrjen e 2147 nxënësve 15-vjeçarë.

Sa i përket implementimit të reformës së teksteve shkollore, për herë të parë, në fillim të vitit shkollor 2018-2019, janë shpërndarë tekste falas (të cilat fëmijët i përdorin përgjatë vitit shkollor dhe duhet t'i rikthejnë në përfundim të vitit shkollor) për fëmijët nga klasa e I – IV ërt, si dhe për 16 kategori të tjera nxënësish.

Kompensimi i pagesës së teksteve shkollore në masën 100%, për nxënësit nga klasa e I – IX, që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie, fëmijët që gëzojnë statusin e jetimit, statusin e të verbrit, fëmijët e minoriteteve kombëtare, fëmijët Rom dhe Egjiptian, fëmijët e familjeve emigrante, fëmijët me aftësi ndryshe fëmijët që vijnë nga familjet ku kryefamiljari merr pension dhe ka fëmijë të varur që janë pa të ardhura, familje në nevojë dhe viktimat të trafikimit.

Gjatë muajve Mars – Maj 2018, MASR ndërmorri procesin e përzgjedhjes së teksteve të reja për klasat IV, IX dhe XII sipas kurrikulës së re.

Tekstet e kalsave III, VIII dhe XI, u rivlerësuan nga mësuesit që i përdorën ato përgjatë një viti shkollor. Pas këtij procesi vlerësimi dhe pas rishikimit nga botuesit këto teskte do të botohen.

Për përmirësimin e politikave gjithëpërfshirëse në sistemin arsimor parauniversitar, në vitin shkollor 2017-2018, në arsimin parauniversitar, numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara arriti në mbi 700 mësues duke sjellë rritje me 125% krahasuar me vitin shkollor 2016-2017. Janë ngritur rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës, si bërthama të trajnimit dhe të zhvillimit profesional, si dhe janë trajnuar gjatë vitit 2018 nga agjensi të akredituara mbi 355 mësues për gjithëpërfshirjen.

Me dy vendimet e qeverisë, VKM nr. 319 datë 12 prill 2017 “Për miratimin e standarteve të projektimit të shkollave” dhe VKM nr. 159 datë 01.03.2017 “Për miratimin e standarteve të projektimit të kopshteve”; garantohen standardet e aksesueshmërisë për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore.

Janë rehabilituar në arsimin bazë 24 objekte arsimore, dhe në arsimin e mesëm të përgjithshëm 8 objekte arsimore, të cilat janë vënë në shfrytëzim në vitin 2018. Gjithashtu në shtator 2018 janë vënë në shfrytëzim 8 objekte të reja shkollore. Në këto 32 rikonstruksione dhe 8 ndërtime të reja është siguruar akses për fëmijet me AK.

Edhe gjatë vitit 2017-2018, ishte prioritet mbështetja e fëmijëve romë dhe egjiptianë. U pajisën me tekste falas 5328 nxënës romë (37538 tekste); 7667 nxënës egjiptianë (60033 tekste), ndërkohë që dy vite më parë përfituan tekste falas vetëm 3205 nxënës romë dhe 4673 nxënës egjiptianë. Detyrë e institucioneve arsimore, që nga parashkollori, është ruajtja e planit të edukimit, që do të thotë: të gjithë fëmijët që regjistrohen në një nivel arsimor, ta frekuentojnë atë rregullisht dhe t'a përfundojnë me sukses. MASR hartoi dhe miratoi Udhëzimin e ri Nr. 17, datë 09.05.2018 "Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë".

Udhëzimi i ri lehtëson procedurat e regjistrimit/rikthimit në shkollë të fëmijëve që për rrethana të përcaktuara në udhëzim nuk e kanë ndjekur arsimin bazë për të paktën dy vite shkollore, e kanë braktisur shkollën, identifikohen si të paregjistruar në shkollë ose janë fëmijë në situatë rruge. Ky udhëzim krijon lehtësira për ndjekjen e arsimit bazë me kohë të pjesshme nga të rriturit që nuk kanë arritur të mbarojnë arsimin bazë me kohë të plotë në mënyrë që ata të mund të pranohen në një apo dy klasa më të larta se klasa për të cilën zotërojnë dokument shkollor. Sipas udhëzimit të ri, nxënësit braktisës nuk kanë nevojë të ndjekin shansin e dytë. Ata integrohen menjëherë në klasat e zakonshme dhe i nënshtrohen programit mësimor individual për plotësimin e mangësive që kanë për shkak të braktisjes apo mosregjistrimit në kohën e duhur në shkollë.

Në fushën e arsimit të lartë, gjatë vitit 2018 u hartuan disa akte nënligjore. Konkretnisht:

- Vendimi Nr. 488, datë 31.07.2018 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 424, datë 10.05.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës së përzgjedhjes e të emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare";
- Vendimi nr. 75, datë 12.02.2018 e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor";
- Vendimi nr. 112, datë 23. 2. 2018 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore (Doktor)" dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik" Profesor i asociuar dhe Profesor ";
- Vendimi nr. 88, datë 14.02.2018 i Këshillit të Ministrave "Për Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH);
- Vendim nr. 216, datë 20.4.2018, i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019";
- Vendim nr. 288, datë 21.5.2018 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë";
- Vendim nr.41, datë 24.01.2018 i Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë";

- Vendimi nr. 165, datë 21.03.2018 i Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë”;

Qëllimi i akteve të mësipërme, është mbështetja e institucioneve, strukturave të arsimit të lartë në zbatimin efektiv të Ligjit Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga ana e tyre. Përmes këtyre akteve, IAL-të mbështeten në:

- Krijimin e strukturave të menaxhimit dhe drejtimit të njësive të IAL-ve në fushën e studimeve mjekësore;
- Kriteret, modalitetet dhe masën e financimit të IAL-ve publike;
- Promovimin e stafëve akademike, përmes kriterëve dhe standardeve shtetërore për fitimin e gradës shkencore ”Dr” dhe titujve akademik “Prof Ass” dhe “Prof.Dr”;
- Zhvillimi dhe promovimi i projekteve të kërkimit shkencor dhe inovacionit në fushën e ICT për arsimin dhe shkencën;
- Krijimi i infrastrukturës për ngritjen e një qendre të përbashkët ndërdisiplinore kërkim-zhvillimi nga IAL-të pjesëmarrëse apo palë të treta;
- Koordinimin e pjesëmarrjes së kërkuesve vendas në projektin evropian “Geant” dhe projekteve të tjera në fushën e TIK;
- Zhvillimin e programeve software dhe ofrimin e shërbimeve;
- Rritja e cilësisë së arritjeve shkollore të studentëve që pranohen në programet e fushës së mësuesisë, e konsideruar kjo si një fushë prioritare;
- Mbrojtjen ekonomike dhe financiare të studentëve në aksesimin dhe vijimin e programeve të studimit që ofrojnë IPAL-të;
- Vlerësimin konkret dhe të matshëm të veprimtarisë kërkimore dhe shkencore të IAL-ve.

Në fushën e arsimit dhe formimit profesional gjatë kësaj periudhe ka vijuar puna për monitorimin e “Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi” 2014 – 2020, e cila është miratuar nga ana e Këshillit të Ministrave me VKM Nr. 818 datë 26.11.2014.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka filluar nga puna për hartimin e akteve nënligjore në bazë të Ligjit Nr. 15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Është krijuar grupi i punës për këtë qëllim i cili do të bashkëpunojë me donatorët dhe ekspertë të fushës.

Konkretisht janë miratuar dy VKM:

- VKM Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”;
- VKM Nr. 753, datë 13.12.2017 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017-2018”.

Janë në proces miratimi projekt VKM-të e mëposhtme (janë të hedhura në sistem dhe në pritje të miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave):

- “Për sistemin e njohjes së të nxëniet të mëparshëm jo formal dhe informal”;
- “Për kriteret dhe procedurat e krijimit, riorganizimit dhe mbylljes së institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional”;
- “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”;
- “Për përbërjen, funksionet, funksionimin, fushën e veprimtarisë, kriteret e anëtarësimit dhe modalitetet e punës së Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional”.

Gjithashtu janë hartuar dhe miratuar udhëzimet e mëposhtme të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë:

- Udhëzimi Nr. 24, datë 30.7.2018 “Për procedurat për njohjen dhe njësimin e mësimnxënies dhe kualifikimeve profesionale të niveleve 2 deri në nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, përfshirë ato të përfuara jashtë vendit”;
- Udhëzimi Nr. 26, datë 30.7.2018 “Për katalogun kombëtar të kualifikimeve profesionale”;
- Udhëzimi Nr. 27, datë 30.7.2018 “Për formatet dhe procedurat kurrikulare të arsimit dhe formimit profesional”;
- Udhëzim Nr. 28, datë 30.7.2018 “Mbi kriteret për pjesëmarrjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit drejtues të ofruesve publikë të arsimit e formimit profesional”;
- Udhëzimi Nr. 16. Datë 08.05.2018 “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”;
- Udhëzimi Nr. 16/1 datë 17.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 16. datë 08.05.2018 “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”.

Një sërë veprimtarish janë realizuar lidhur me draftimin e disa ndryshimeve të Ligjit nr. 10247, datë 04.03.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” dhe akteve nënligjore të parashikuara në të.

Rishikimi i Ligjit u bë në kaudrin e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (NESS) dhe Planit përkatës të Veprimit (2014-2020) që parashikojnë rishikimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor për KSHK, si një instrument i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë së ofertës së kualifikimeve në vend.

Në vitin 2017, mandati i Task Forcës për KSHK-në u zgjat për 2 vjet të tjera, përmes urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Kjo Task Forcë është përgjegjëse për të mbështetur zhvillimin dhe zbatimin e KSHK. Funksionet kryesore të saj përfshijnë:

- Hartimin e paketës së plotë të tre akteve nënligjore bazuar në ligjin e ndryshuar të KSHK-së:
 - për të mësuarit gjatë gjithë jetës,

- o ngritjen dhe funksionimin e Komiteteve Sektoriale’
- o hartimin e përshkruesit e detajuar të nivele të KSHK.

T

ask Forca është përgjegjëse dhe për Procesin e Referencimit të KSHK-së me Kornizën Europiane të Kualifikimeve.

Konkretisht janë hartuar draftet e dy VKM-ve, për komitetet sektoriale dhe për përshkruesit e detajuar janë konsultuar në workshope me përfaqësues nga grupe interesi dhe do të vijohet me procedurën e miratimit të tyre nga ana e Këshillit të Ministrave.

Përsa i përket projekt VKM-së për përfshirjen e kualifikimeve të të mësuarit gjatë gjithë jetës (Life Long Learning) në KSHK, është hartuar një draft i parë, është bërë një workshop me mbështetjen e ETF (European Training Foundation), si dhe aktualisht po mundohemi të përfitojmë nga eksperiencia e vendeve të tjera në këtë fushë përmes EURYDICE, pasi rezulton që pak vende kanë kyrrer këtë proces dhe kujdesi në këtë kontekst duhet të jetë maksimal.

Përfundoi viti shkollor 2017 – 2018, në shkollat e mesme profesionale. Në këtë vit u regjistruan rreth 5.700 nxënës në vitet e para, në të gjitha shkollat e mesme profesionale, dhe totali i nxënësve që ndoqën me kohë të plotë shkollat e mesme profesionale ishte rreth 19.000.

Është punuar për të rritur imazhin e AFP-së. Ka vijuar puna e nisur për organizimin e takimeve dhe panairove rajonale, të cilat u mbyllën me eventin e Olimpiadës së Aftësive Profesionale 2018, me moton “Koha për cilësi”.

Në vitin shkollor 2018 – 2019 u regjistruan rreth 5.750 nxënës në vitet e para dhe në total numri i nxënësve që ndjekin shkollat profesionale është rreth 19.300.

Vijon puna në bashkëpunim me donatorët (BE, GIZ-Gjermani, SDC-Zvicër, ADA-Austri, Kooperacioni Italian, etj.) për mbështetjen e shkollave më të mira profesionale, me synim kthimin e tyre në shkolla të ekselencës.

Me fonde të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka vijuar punën për rikonstruksionin e disa shkollave profesionale, bazave prodhuese të shkollave, blerjen e pajisjeve si për kabinetet profesionale ashtu edhe për kabinete të lëndëve të përgjithshme. Po ashtu është menduar edhe për blerjen e mobilieve, duke synuar përmirësimin e kushteve të akomodimit të nxënësve në shkolla por edhe duke rritur cilësinë e shërbimit të ofruar. Këtij qëllimi i shërben edhe kualifikimi i burimeve njerëzore të shkollave profesionale, si të stafëve drejtuese ashtu edhe mësimeve. Ky proces është duke u mbështetur edhe nga donatorët ku evidentojmë bashkëpunimin me GIZ.

Konkretisht për përmirësimin e infrastrukturës së shkollave/bazave prodhuese, është investuar gjatë kësaj periudhe në shkollat si më poshtë:

- Ndërtimi i bazës prodhuese të shkollës “Karl Gega” Tiranë;

- Rikonstruksioni i shkollës profesionale Kamëz Tiranë;
- Rikonstruksioni i shkollës “Ali Myftiu”, Elbasan, faza e dytë;
- Ndërtimi i bazës prodhuese të shkollës “Petro Sota” Fier;
- Rikonstruksioni, përshtatja e bazës prodhuese të shkollës “Kristo Isak”, Berat;
- Ndërtimi i shkollës profesionale “Beqir Çela”, Durrës;
- Ndërtimi i bazës prodhuese të shkollës “Arben Broci”, Shkodër, faza e dytë.

Ndërkohë janë proces tenderimi dy shkolla:

- Shkolla Hoteleri Turizëm, Tiranë, faza e dytë.
- Ndërtimi i shkollës së re, “Gjergji Canco”- ‘Herman Gmainer’ Tiranë.

Kualifikimi i burimeve njerëzore të shkollave profesionale, si të stafëve drejtuese ashtu edhe mësimeve, është një element shumë i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar nga shkollat profesionale. Ky proces është duke u mbështetur edhe nga donatorët ku evidentojmë bashkëpunimin me GIZ. Konkretisht është realizuar përgatitja e 15 trainerëve dhe trainimi i parë pilot i 23 mësuesve/instruktorëve. Deri më tani janë trajnuar 289 mësues dhe instruktorë të AFP-së. Aktualisht, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) ka në proces trajnimi për 2018, 114 mësues dhe instruktorë dhe deri në fund të këtij vitit synojmë të trajnojmë 196 mësimeve/instruktorë.

Po në bashkëpunim me AKAFPK, punohet për përshtatjen e kurrikulave dhe programeve sipas nevojave të tregut të punës dhe komunitetit të biznesit. Gjatë vitit 2018, janë hartuar dhe përmirësuar 20 skelet-kurrikula.

Në ofrimin e kurseve të formimit profesional nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik vitet e fundit kemi pasur rezultate shumë të larta. Ndërsa gjatë periudhës Janar – Shtator 2018, numri i personave të rregjistruar është 12.600 persona nga të cilët 4.856 femra.

Duke konsideruar artin dhe trashëgiminë kulturore si një faktor të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, Ministria e Kulturës gjatë vitit 2018 ka intensifikuar investimet në infrastrukturë për rehabilitimin, ruajtjen dhe promovimin e artit e trashëgimisë kulturore. Ministria e Kulturës nëpërmjet koordinimit të disa sektorëve strategjikë të qeverisjes qendrore dhe partnerëve, gjatë vitit aktual ka siguruar fonde dhe planifikuar projekte dhe investime konkrete në të gjitha rajonet e Shqipërisë. Veçojmë këtu bashkëpunimin tepër të frytshëm me Fondin Amerikano-Shqiptar të Zhvillimit, Delegacionin Evropian në Shqipëri, Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, Bankën Botërore, PNUD-in, TIKA (Agjencia Turke e Bashkëpunimit dhe Koordinimit). Gjithashtu, bashkëpunimin të frytshëm për ngritje kapacitetesh institucionale kemi pasur me:

- UNESCO (ngritje kapacitetesh);
- CHW (Cultural Heritage Without Border);
- GIZ (The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit).

Me vizion të qartë për të konsoliduar Skenën e pavarur të kulturës, Ministria e Kulturës ka bashkëpunuar me subjekte të artit për të siguruar një përfshirje masive në jetën social- kulturore duke arritur brenda 9 muajve të vitit 2018 në këto shifra:

- 598 shfaqje dhe prodhime skenike të realizuara;
- 118 844 spektatorë prezent dhe ndjekës të programeve kulturore në institucionet e artit dhe skenës së pavarur;
- rreth 40 premiera të shfaqura në programet e kalendarëve artistikë;
- rreth 11 615 vizitorë në ekspozitat e zhvilluara nga Galeria Kombëtare e Arteve;
- rreth 50.000 pjesëmarrës si krijues, ekzekutues dhe realizues të projekteve kulturore artistike;
- rreth 20 projekte ndërkombëtare, përfaqësuese jashtë vendit;
- rreth 220 projekte ndërkombëtare brenda vendit.

Prioritet kanë pasur dhe do të kenë projektet me thirrje ku është krijuar një traditë e mirë gjatë këtyre viteve të fundit. Viti 2018 ka rezervuar gjithashtu angazhime, nisma dhe prioritete të reja nga Ministria e Kulturës, ku vlejnë për t'u përmendur:

- Përfaqësimi në Bienalen e Arkitekturës në Venecia;
- Përfaqësimi në Panairin e Librit në Lajpcig;
- Përfaqësimi në Panairin e Librit në Frankfurt;
- Viti i Kulturës Shqipëri-Austri;
- Kalandari i Përbashkët Kulturor Shqipëri-Kosovë;
- Kalandari i Përbashkët Kulturor Shqipëri-Maqedoni;
- Viti i Skënderbeut - përmes dy aktiviteteve mjaft të rëndësishme me karakter ndërkombëtarë;
- Kalandari Kulturor i vijës bregdetare në shërbim të turizmit kulturor;
- Dy konkurse mbarëkombëtare të krijimtarisë së re në dramaturgji dhe muzikë;
- Programi Kombëtar “Edukimi përmes Artit, Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore”;
- Projekti “Parku i Artit”;
- Fushata Kombëtare e Leximit me shtrirje gjatë gjithë vitit;
- Fondi i përkthimit nga shqip në gjuhë të huaj dhe anasjelltas;
- Dy konkurse mbarëkombëtare të krijimtarisë së re në dramaturgji dhe muzikë;
- Ekspozita fotografike “Arkiva Marubi: Rituali Fotografik” e cila organizohet në Trienalen e Milanos 16 Nëntor – 9 Dhjetor 2018 si një bashkëpunim i Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë; Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Itali dhe Museo di Fotografia Contemporanea – Milano-Itali. Për këtë ekspozitë janë përzgjedhur 170 fotografi prej autorëve më të njohur të Koleksionit të Muzeut. Ekspozita ka si qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore shqiptare në Itali përmes materialeve fotografike të Arkivit të Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi”;
- Aktivitetet kushtuar 60 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në UNESCO. Konferenca Kombëtare e organizuar në 16 Tetor 2018 kushtuar bashkëpunimit me këtë organizatë. Njëkohësisht aktiviteti kushtuar 60 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në UNESCO do të shoqërohet dhe me një ceremoni përmbyllëse në Selinë Qendrore të UNESCO-s ku do

të prezantohen vlera të ikonografisë shqiptare “Një dritare në artin mesjetar shqiptar”, 19-23 Nëntor 2018.

Gjatë vitit 2018, një rëndësi të veçantë iu dha investimeve publike ku për t’u theksuar janë:

- Ndërtimi me sukses i Qendrës Kulturore “Skena e Re”;
- Avancimi i punimeve për rikonstrukcionin e Teatrit të Operës dhe Baletit, punime të cilat janë në fazën e zbatimit;
- Dy projekte madhore të Ministrisë së Kulturës “Rehabilitimi dhe riformulimi i linjës muzeore të Muzeut Historik Kombëtar dhe Galerisë Kombëtare të Arteve”, proces i cili është në përfundim të hartimit të projekteve përkatëse.

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë bërë ndërhyrje restauruese në disa objekte të rëndësishme të trashëgimisë kulturore siç janë:

- Në Kishën e Ristozit - faza e tretë e restaurimit;
- Mbyllja e rikonstrukcionit të Muzeut të Sinjës;
- Ndërhyrje restauruese në Urën e Kollorçës;
- Në Banesën e Vëllezërve Frashëri në Përmet;
- Në Kishën Shën Mëria – Peshkëpi e Sipërme;
- Në Kishën e Shën Apostujve – Zagori;
- Në Kishën Shën Nikolli – Vend varrimi i Skënderbeut,
- Në Kishën Shën Thanasi – Sarandë;
- Në Kishën e Manastirit të Shën Mërisë – faza e parë – Mesopotam;
- Në urën e Nivanit – Zagori.

Ndërkohë është përmirësuar ndjeshëm infrastruktura e muzeve dhe parqeve arkeologjike. Është krijuar një Sistem Informatik Kombëtar i Administrimit të Trashëgimisë Kulturore si dhe është përmirësuar kuadri ligjor për menaxhimin e qendrave historike Berat, Gjirokastrë, Pogradec, Korçë etj., ndërsa është intensifikuar bashkëpunimi me autoritetet lokale në kuadrin e zbatimit të këtyre rregulloreve.

Janë realizuar një sërë aksionesh pjesë e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme. Janë rreth 60000 objekte pasuri kulturore në administrim të institucioneve publike dhe private, të regjistruara dhe të përditësuara sipas standardeve ndërkombëtare në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore” miratuar me VKM nr. 278 datë 16.05.2018 “Për krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore, Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)” dhe e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore referuar dhe në zbatim të Ligjit nr. 10325 datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Është ngritur dhe funksionon Platforma e regjistrimit dhe shkëmbimit të informacionit në sistem lidhur me rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore në vend, si dhe në rastet e denoncimeve nga Institucionet Ndërkombëtare që operojnë brenda dhe jashtë

Republikës së Shqipërisë e mundësuar përmes Sistemit Informatik Kombëtar të Regjistrimit dhe Administrimit të Pasurive Kulturore.

Është publikuar “Katalogu i objekteve të humbura / të deklaruara të humbura në institucionet e trashëgimisë kulturore në vitet 1990 – 2016” si dhe është bërë publikimi në shqip/anglisht i Kodit të Etikës për tregtarët e veprave të artit (Udhëzuesi i UNESCO-s). Në këtë kuadër po punohet për ngritjen e kapaciteteve institucionale me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive kulturore në luftën kundër trafikimit. Janë kryer trajnime me stafet në institucionet në sistemin e trashëgimisë, policisë, doganat për njohjen me aktet ligjore të fushës së trashëgimisë kulturore, përdorimin dhe aksesin në bazën e të dhënave

Gjithashtu janë realizuar dhe bashkëpunime të suksesshme me institucionet kombëtare përgjegjëse në këtë proces dhe me ato ndërkombëtare lidhur me koordinimin e operacioneve me qëllim parandalimin e këtij fenomeni.

Në fokus për vitin 2019 për këtë fushë mbetet zbatimi i Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe muzetë” si dhe hartimi dhe miratimi i akteve nën ligjore. Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore është përditësuar me 70000 objekte të regjistruara në pronësi publike dhe private. Janë ngritur 6 Zyra Rajonale të Informimit Publik për Regjistrimin Online të Pasurive Kulturore në Durrës, Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër të ndërtuara me financim të Qeverisë shqiptare përmes projektit “Krijimi i Qendrave të Informimit Publik për Regjistrimin On-Line të Pasurive Kulturore”, të cilat do të shërbejnë edhe si zyra eksporti për monitorimin e qarkullimit të pasurive kulturore dhe kryerjen e procedurave përkatëse.

Për vitin 2019:

Në vizionin e Qeverisë dhe prioriteteve institucionale të Ministrisë së Kulturës, kultura nuk është vetëm një plotësim shpirtëror por një domosdoshmëri e përditshme e të rinjve dhe audiencave të gjera. Investimet kulturore do të kenë prioritet në rikualifikim dhe ri konceptim të Institucioneve Qendrore të Artit dhe Kulturës, që synojnë të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së jetës dhe në edukimin e grup-moshave të ndryshme. Programi Kombëtar “Edukimi përmes Artit” do të jetë vijimi i një reforme të thellë dhe të qëndrueshme në institucionet e artit dhe politikat kulturore duke vënë theksin në rëndësinë dhe rolin e edukimit përmes kulturës në kohezionin social, i provuar tashmë në vende të tjera. Edukimi masiv me art e kulturë do të synojë ndërhyrjen në kurrikulat e shkollës nga njëra anë dhe duke përfshirë në çdo institucion arti linjën pedagogjike dhe edukative nga ana tjetër.

Duke ndjekur zhvillimet globale si motive për të zgjedhur dhe njohur vende dhe kultura të ndryshme, lind nevoja e përgjigjes së këtij interesi me oferta itinerarësh të reja kulturore turistike si një mënyrë atraktive interesi për kulturën, historinë, kulinarin dhe trashëgiminë tonë. Për këtë, Ministria e Kulturës do të ofrojë paketa dhe shërbime kulturore të përqendruara kryesisht në vijën Bregdetare në shërbim të turizmit kulturor.

Fokusi kryesor i realizimit të objektivave për vitin 2019 është implementimi i ligjit të ri për trashëgimisë kulturore dhe muzetë, hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu riorganizimi dhe ngritja e strukturave të reja do të bëjnë të mundur vlerësimin në mënyrë me efikase të objektivave kryesore në këtë sektor.

Njëkohësisht investimet e parashikuara për vitin 2019 do të fokusohen kryesisht në rehabilitimin e monumenteve të cilat janë në faza emergjente dhe të planifikuara si në plane pune dhe parashikimet financiare nga buxheti i shtetit apo dhe donacionet.

Gjatë vitit 2019 parashikohen në vijim:

- Zbatimi i dy projektet madhore të Ministrisë së Kulturës për Muzeun Historik Kombëtar dhe Galerinë Kombëtare të Arteve;
- Restaurimet e Xhamisë Mbret, Xhamisë së Beqarëve, Teqesë Helvetike në Berat, Xhamisë së Pazarit në Gjirokastrë, Xhamisë së Et'hem Beut në Tiranë;
- Projekti i Rikualifikimit në zonën urbane pranë Qendrës së qytetit të Vlorës; Hartimi i projektit urban, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë;
- Rikualifikimi urban, restaurimi në fshatin Dhërmi Vuno, Bashkia Himarë, etj.

Në fushën e bashkëpunimit kulturor me vendet e rajonit dhe më gjerë, gjatë vitit 2018 janë nënshkruar marrëveshjet kulturore sa më poshtë:

- Marrëveshja me Republikën e Kinës për ngritjen e Qendrës Kulturore Kineze;
- Marrëveshja financiare me Rajonin e Pulias për realizimin e Projektit “Parku i Artit”;
- Marrëveshja me Organizatën kulturore italiane Palazzo Spinelli - Dega Shqipëri mbi bashkëpunimin në sektorin e edukimit, menaxhimit të ndërhyrjeve profesionale restauruese dhe promovimit të trashëgimisë kulturore shqiptare;
- Protokoll bashkëpunimi në fushën e kulturës e lidhur mes Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë dhe Ministrisë së kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës me 08.06.2018 bazuar në “Deklaratën e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës” e datës 11.01.2014”;
- Programi i bashkëpunimit në fushën e kulturës ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës të malit të Zi për periudhën 2018-2020;
- Protokolli i bashkëpunimit ndërmjet TKOBAP (Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor) të Republikës së Shqipërisë dhe Teatrit të Operës së Beogradit, Serbi.

Gjithashtu janë në proces hartimi dhe nënshkrimi marrëveshjet kulturore dy palëshe me Italinë, Hungarinë, Irakun, Çekinë, Greqinë, Iranin, Kubën Egjiptin, Ukrainën, Arabinë Saudite, Maqedoninë, Protokollin e bashkëpunimit me Drejtorinë Përgjithshme të Vakëfeve pranë Kryeministrisë së Republikës së Turqisë për restaurimin e Xhamisë së Plumbit në Shkodër, një Program qeveritar bashkëpunimi me Gjeorgjinë në të gjitha fushat, përfshirë dhe kulturën, marrëveshjet e bashkëpunimit mes Muzeut Historik Kombëtar me homologët e tyre në Egjipt

dhe në Maqedoni, si dhe marrëveshjet e TKOBAP me homologët e tyre të Kroacisë, Greqisë, Turqisë dhe Bullgarisë.

Me Urdhër të Ministrit të Kulturës është ngritur Grupi i Punës për hartimin e “Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2020 - 2025” dhe po punohet për përgatitjen e draftit të parë të kësaj strategjie.

Për përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, Grupi i punës po merr në konsideratë dhe eksperiencat më të mira të mëparshme në këtë fushë me qëllim:

- zbatimin e platformës së edukimit përmes artit dhe kulturës në institucionet e artit dhe kulturës, trashëgimisë kulturore dhe në sistemin para universitar;
- fuqizimin e Partneritetit Publik-Privat (PPP) të institucioneve të trashëgimisë kulturore sipas modelit të paraparë në aktet ligjore për trashëgiminë kulturore;
- ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në nivel qendror, vendor dhe të pavarur;
- përmirësimin e legjislacionit për mbështetjen e zhvillimit të industrisë kreative si forcë e pa shfrytëzuar sa dhe si duhet deri më tani;
- rritjen e buxhetit dhe mbështetjes financiare për artin dhe kulturën;
- forcimi i bashkëveprimit të Ministrisë së Kulturës me komunitetin artistik.

Kjo Strategji parashikohet të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2019.

I.3. Prioritetet

Prioritetet janë si më poshtë:

- Rritja e ndjekjes së arsimit parashkollor, duke siguruar;
 - o Zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe investimit në infrastrukturë;
 - o Gjithëpërfshirje në sistemin e arsimit parashkollor;
 - o Rritjen e cilësisë së shërbimit të mësimdhënies dhe të të nxënës.
- Reforma në sistemin parauniversitar do të përqendrohet në:
 - o Rritjen e cilësisë së sistemit arsimor, duke hartuar dhe zbatuar një sistem drejtimi e kontrolli vendor kombëtar më të besueshëm.
 - o Përmirësimin e infrastrukturës shkollare: planifikim/ndërtim shkollash të reja, shkolla si qendra komunitare.
 - o Proces më të mirë vendimmarrjeje duke krijuar një komunikim të ri shkollë-prindër-qeveri, duke e bërë prindin pjesë të komunikimit dhe arsimit.
 - o Procedurat e rekrutimit të mësuesve, ku shkolla bashkë me bordin e senatin e saj, këshillin e prindërve, komunitetin dhe nxënësit, vendosin bashkarisht për zgjedhjen e mësuesve, do të institucionalizohen më tej.
 - o Përmirësimin e kriterëve dhe standardeve profesionale të lidhshpimit të institucioneve arsimore.

- o Gjithëpërfshirje sasiore dhe cilësore e grupeve të marginalizuara (uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën, pakësimi i dukurisë negative: zbatimi i rreptë i masave ndëshkuese për të gjitha praktikat korruptive të denoncuarra dhe evidentuara).
- o Zhvillimin profesional të mësuesve dhe forcimin e kapaciteteve drejtuese dhe menaxhuese në institucionet e AP.
- Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë
 - o Ofrimi i një cilësie shumë të mirë në arsimin e lartë: ngritja e cilësisë në standardet evropiane dhe qëndrueshmëri, për të fituar besimin e shoqërisë dhe të institucioneve kombëtare; reformë thelbësore në kuadrin ligjor si në drejtim të programeve të studimit (zhvillimi i panevojshëm i disa profesioneve dhe i mangët i disa profesioneve të tjera më të kërkuara në tregun e punës, e deri në cilësinë e diplomave)
 - o Eficencë financiare nëpërmjet menaxhimit dhe alokimit efikas
 - o Njohje ndërkombëtare dhe emër/përfaqësim më të mirë
 - o Hartimin e një skeme të re financiare për universitet publike, bazuar në arritje dhe rezultate të institucioneve arsimore, vendosjen e një mekanizmi të ri për dhënie llogari ndaj shtetit dhe aktorëve të tjerë publikë.
- Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025, përparësitë strategjike të së cilës, në përputhje dhe me programin e qeverisë shqiptare si dhe me planifikimin buxhetor afatmesëm do të jenë:
 - o Përmirësimi dhe zgjerimi i tregut kulturor nëpërmjet një legjislacioni në dobi të krijuesve, krijimtarisë artistike e kulturore dhe trashëgimisë kulturore;
 - o Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale – pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza;
 - o Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve;
 - o Promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, materiale dhe shpirtërore në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare;
 - o Hartimi dhe zbatimi i platformës së edukimit përmes artit dhe kulturës në institucionet e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore dhe në sistemin para universitar.
- Zbatimi me sukses i Platformës kombëtare “*Edukimi përmes Artit*” nga të gjitha institucionet e Artit dhe Trashëgimisë;
- Forcimi i partneritetit publik dhe privat për realizimin e projekteve rijetëzuese në qendrat e trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Rishikimi i ligjit “Për Artin dhe Kulturën” Nr. 10352, datë 18.11.2010 me fokus përmirësimin e kuadrit ligjor në funksion të menaxhimit të sistemit kulturor institucional e më gjerë brenda vitit 2019;
- Rishikimi i Ligjit për Librin Nr. 9616, datë 27.09.2006 për krijimin e bazës ligjore për krijimin e Qendrës Kombëtare të Librit brenda vitit 2019.

II.1. Arsimi dhe formimi profesional

II.1.1 Politikat dhe kuadri ligjor

Strategjia Kombëtare për Arsimin Para-Universitar 2014-2020;

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014-2020;

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe “Ligji Nr. 56/2015 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, synon:

- Fuqizimin e kompetencave të institucioneve që realizojnë drejtpërdrejt shërbimin arsimor nëpërmjet decentralizimit, dekoncentrimit e autonomisë shkollore dhe saktësimin të rolit të nivelit qendror në politikbërje për vendosjen e standardeve të cilësisë së shërbimit arsimor.
- Përmirësimin e ndjeshëm të aftësive menaxhuese në sistemin arsimor nëpërmjet përcaktimit më të qartë të përgjegjësisë të institucioneve e individëve, vlerësimit të jashtëm, vetëvlerësimit e raportimit periodik të punonjësve arsimorë e institucioneve, si dhe shtimit të transparencës së performancës së tyre. Vendosjen e baraspeshës ndërmjet përgjegjësisë dhe hapësirës vendimmarrëse.
- Shtimin e larmisë së kurrikulës që t’i shkojë përshtat larmisë së prirjeve, mundësive dhe aspiratave të karrierës së nxënësve.

Ky Ligj është në përputhje të plotë me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000/C 364/01), datë 18 dhjetor 2000.

Risite e Ligjit Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” janë si vijon:

- Rrit lirinë akademike, autonominë financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit;
- Garanton arsimim të lartë jo vetëm për ata që kanë mundësi financiare, por dhe për individët që plotësojnë kriteret e pranimit, por që nuk kanë mundësi financiare për të studiuar;
- Krijon kushtet për një arsim të lartë që t’i përgjigjet nevojave të tregut të punës dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit;
- Unifikon dhe standardizon sistemin e arsimit të lartë;
- Heq maturën shtetërore, përcakton notën mesatare si kriter bazë dhe u jep IAL-ve të drejtën të përcaktojnë kriteret shtesë për pranimin e studentëve dhe të përzgjedhin ata fitues;
- Krijon mekanizma të qëndrueshme të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të IAL-ve, në mënyrë që të sigurohen standarde evropiane për arsimin e lartë;
- Krijon baza financiare të qëndrueshme dhe mundësi për të shfrytëzuar burime të ligjshme financimi;
- Ligji sanksionon raportin që duhet të ekzistojë midis pranimeve në IAL dhe aftësive të këtyre të fundit për të përthithur fluksin e studentëve;

- Mundëson konkurrencën e lirë mes IAL-ve, personelit akademik dhe studentëve;
- Përcakton detyrimin për të mbështetur vetëm institucionet publike të arsimit të lartë me infrastrukturë të nevojshme kërkimore-shkencore;
- Krijon fondin për mbështetjen studentore (studentë të shkëlqyer, studentë në programet e studimit që janë prioritet kombëtar, studentë të shtresave në nevojë) për studentë të institucioneve publike të arsimit të lartë;
- Mundëson dhënien e kredive studentëve për të përballuar kostot e studimeve dhe kreditë për institucionet publike me qëllim zhvillimin e tyre institucional dhe infrastrukturor;

Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Deklaratën e Bolonjës të datës 19 korrik 1999.

Ligji Nr. 15/2017 "Për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2005/36 KE;

Ligji Nr. 90/2014 "Për një shtesë të Ligjit Nr. 10171 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2005/36/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE.

Ligji Nr. 117/2014, datë 11.09.2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin Erasmus Plus të BE-së për Arsimin, Rininë dhe Sportet, është plotësisht në përputhje me Vendimin e Këshillit Evropian Nr. 2005/517 / KE, datë 22 nëntor 2004 "Për nënshkrimin e një marrëveshjeje kornizë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë që përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Kornizën Evropiane, Programi Erasmus Plus "CELEX 32005L0517, Rregullorja (EU) Nr. 1288/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së të datës 11 dhjetor 2013" Për krijimin e Erasmus Plus "(vendimet e pavlefshme Nr. 1719/2006 / KE, Nr. 1720 / 2006 / KE dhe Nr. 1298/2008 / KE), CELEX 32013L1288.

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR),
- Ministria e Kulturës,
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
- Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA),
- Inspektoriati Shtetëror i Arsimit (ISHA),
- Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA),
- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL),
- Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet (AKAFPK),
- INSTAT,

II.1.3. Masat e planifikuara

II. 1.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

- Strategjia e Arsimit, 2020-2025.

II. 1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për skemat e kreditimit të studentëve" duhet të përafrohet pjesërisht me Deklaratën e Bolonjës 1999, planifikuar për miratim tremujorin e katërt.

Hartimi i tre akteve nënligjore bazuar në ligjin e ndryshuar të KSHK-së, të cilat duhet të përafrohen plotësisht me Direktivën 2000/78/KE, të planifikuara për miratim tremujorin parë:

- Projektvendim "Për përshkruesit e detajuar për çdo nivel të KSHK-së";
- Projektvendim "Mbi kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës, duke përfshirë kurset afatshkurtra për të rriturit, kurset e veçanta për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, kualifikimet e ofruara nga institucione të arsimit të lartë dhe/ose nga ofrues të tjerë të tyre dhe kualifikime të tjera të parashikuara në kuadrin ligjor përkatës";
- Projektvendim "Për mënyrën e organizimit, funksionimit, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre".

II.2. Kultura

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Ligji "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"

Ka përfunduar përgatitja dhe miratimi i ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" pas një konsultimi të kujdesshëm me gjitha grupet e interesit dhe institucionet kulturore publike dhe ato private. Hartimi i këtij ligji ka qenë një proces kompleks, sepse përveç analizës së mangësive të ligjit aktual, ka qenë i nevojshëm studimi i legjislacionit në fuqi që rregullon pjesë të caktuara që janë objekt i ligjit të trashëgimisë kulturore si dhe krijimi i një modeli të qartë veprimi duke marrë parasysh jo vetëm ruajtjen e trashëgimisë kulturore të vendit, por edhe administrimin e tyre në bashkëpunim me biznesin. Ky ligj përafrohet legjislacionin shqiptar me Direktivën 2014/60/EU për "Kthimin e objekteve kulturore të trafikuara në mënyrë të paligjshme nga territori i një vendi anëtar". Gjithashtu ligji është fokusuar në përmirësimin dhe riorganizimin e mbrojtjes së siteve të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë rishtazi dhe peizazhin dhe do të përmirësojë sistemin e administrimit të siteve të trashëgimisë kulturore duke

prezantuar forma të tilla administrimi dhe mbikëqyrjeje të trashëgimisë kulturore që do të mundësojnë nga njëra anë, një situatë të përmirësuar inputesh në to, dhe nga ana tjetër një mbikëqyrje rigorozë të vlerave kulturore që administrohen nga institucionet e trashëgimisë kulturore dhe një promovim më të mirë të tyre.

Ligji parashikon sanksione ligjore të një forme të plotë dhe të diversifikuar për ashpërsimin e masave administrative për personat fizikë dhe juridikë që shkelin rëndë dispozitat e këtij projektligji. Gjithashtu ai parashikon dispozita të rëndësishme për institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore; organet kolegjiale të trashëgimisë kulturore; mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore; përdorimin, vlerësimin dhe administrimin e pasurive kulturore; qarkullimin, parablerjen, shpronësimin e pasurive kulturore; pasuritë e pejsazhit si dhe sanksionet administrative që aplikohen për rastet e shkeljes së dispozitave.

Ligjin “Për Trashëgiminë Kulturore dhe muzetë” përfshin një kapitull të plotë edhe për rregullimet ligjore mbi sistemin e muzeve në Shqipëri si një komponent i rëndësishëm i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Kjo do të mundësojë realizimin e objektivit për të pasur një ligj plotësisht të integruar në rendin juridik shqiptar për Trashëgiminë Kulturore, si në rastin e praktikave ligjore më të mira të vendeve evropiane dhe më gjerë.

Ligji i ri “Për trashëgiminë kulturore” është miratuar nga Kuvendi me 17.05.2018 si dhe ka hyrë në fuqi me datë 28.06.2018. ndërkohë me këtë ligj janë shfuqizuar dhe ligjet e mëparshme nr. 9048, datë 07.04.2013 “Për trashëgiminë kulturore” dhe nr. 9386, datë 04.05.2005 “Për muzetë”.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Kulturës

II.2.3. Masat e planifikuara

II.2.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Strategjia Kombëtare e Kulturës 2020 – 2025, planifikuar për miratim tremujorin e katërt 2019.

II.2.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka masa ligjore të planifikuara në këtë nënkapitull.

II. 2.3.3. Masa të tjera të planifikuara

Nuk ka masa të tjera të planifikuara në këtë nënkapitull.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

000 Lek

Viti	2018	2019	2020
Buxheti i institucionit koordinues të kapitullit	47,248,463	48,633,616	50,692,651
Buxheti i institucioneve kontribuese në këtë kapitull	0	0	0
Buxheti total	47,248,463	48,633,616	50,692,651

Kapitulli 27: Mjedisi

I. Përmbajtja e kapitullit

I.1 Acquis i BE-së

I.1.1 Përmbledhje e acquis e BE-së

Politikat e BE-së për mjedisin kanë si qëllim që të promovojnë ndërmarrjen e veprimeve më të forta ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe mbrojtjes së mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen mbi integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së, veprimet parandaluese, parimin ndotësi paguan, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim dhe ndarjen e përgjegjësisë. Legjislacioni mjedisor i BE-së përfshin dispozita që trajtojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndryshimet klimatike, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, organizmat e modifikuara gjenetikisht, kimikatet, zhurmat dhe pyjet. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së kërkon investime të rëndësishme, por sjell edhe përfitime të rëndësishme. Një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal është e domosdoshme për aplikimin dhe zbatimin e acquis.

I.1.2 Kërkesat e MSA-së

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me acquis të BE-së.

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit Shqiptar në fushën e mjedisit me atë të BE-së, rrjedh nga Neni 108 i MSA-së, në të cilin citohet si më poshtë vijon:

- Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore;
- Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit për fushën e mjedisit.

I.2 Situata aktuale / përmbledhja

Shqipëria ka njëfarë niveli të përgatitjes në fushën e Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimatike. Janë bërë disa përpertime në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe zbatimit të politikave. Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e turizmit dhe mjedisit si një nga objektivat kryesorë të Shtetit. Ligji i vitit 2011 për mbrojtjen e mjedisit

siguron bazat për akte ligjore specifike që normojnë komponentët e ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Ligje specifike ekzistojnë për të normuar procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, turizmin.

Në korrik 2016, Qeveria Shqiptare ratifikoi Marrëveshjen e Parisit si hapi kryesor drejt zbatimit të saj. Komunikimi i Tretë Kombëtar i Shqipërisë drejtuar Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (Tetor 2016), ka identifikuar një seri masash prioritare lidhur me reduktimin e gazeve serrë dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke bërë të mundur që Shqipëria të aktivizojë burimet që bazohen në mekanizmat politikë dhe të tregut. Nëpërmjet aderimit në Amendamentin e Kigalit, të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e Ozonit”, Republika e Shqipërisë merr përsipër përgjegjësinë për të reduktuar përdorimin e gazeve të fluorinuara me potencial të lartë në ngrohjen globale siç janë Hidrofluorokarbonet (HFC), duke kontribuar në shmangien deri në 0.5°C të ngrohjes globale deri në fund të shekullit, mbrojtjen e shtresës së ozonit, në përputhje edhe me Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Projektvendimi i ri që adreson rregullat për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe përdorimin e produkteve dhe të pajisjeve që përmbajnë këto substanca, ka sjellë harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian mbi substancat ozonholluese, në përputhje edhe me kërkesat e Protokollit të Montrealit.

Që nga shkurti 2018, me miratimin e Ligjit Nr 6/2018 menaxhimi i ujërave në Republikën e Shqipërisë është përgjegjësi e Sekretariatit Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)), dhe jo më e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Për t’u theksuar është fakti se disa vendime të qeverisë kanë përmirësuar ndjeshëm partneritetin ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile. Miratimi i VKM Nr 247, datë 30.04.2014 “Për miratimin e rregullave, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, miratimi i VKM Nr 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, miratimi i VKM Nr 219, datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”, rritja e numrit të stafit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) i përfshirë drejt për drejt në shqyrtimin e aplikimeve për procesin e VNM-së dhe atë për lejet e mjedisit, kryerja rregullisht e konsultimeve me publikun për planet e mjedisit, programet dhe legjislacionin, organizimi i takimeve të rregullta me OJQ-të mjedisore, si dhe

shpërndarja e Buletineve Mjedisore Javore dhe Mujore, kanë përmirësuar ndjeshëm situatën lidhur me ndërgjegjësimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrjen mjedisore, si dhe aksesin e publikut për informacion mjedisor.

Gjithashtu, miratimi i Ligjit Nr 12/2015 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr 10440/2011 ‘Për vlerësimin e ndikimit në mjedis’”, bëri të mundur që aplikimet për vlerësimin e ndikimit në mjedis të mos kryhen më pranë QKL-së (sot QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit), por direkt pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Ky zhvillim ka ndikuar në përmirësimin e procesit të informimit dhe konsultimeve të publikut, si dhe ka eliminuar konceptin “miratim në heshtje” për procesin e VNM-së.

Në shkurt 2014, është krijuar Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP), i cili është një institucion publik, i financuar nga buxheti i shtetit, në varësi të MTM-së. Misioni i tij është garantimi dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e mjedisit dhe pyjeve.

Gjithashtu, me qëllim mbrojtjen e natyrës dhe ndalimin e aktiviteteve të paligjshme në zonat e mbrojtura, janë ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm siç janë (i) amendimi i ligjit për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës. Tashmë, Qendra Kërkimore për Florën dhe Faunën duhet të konsultohet përpara se të lëshohet një leje për tregtimin e tyre, (ii) miratimi i akteve ligjore që ndalojnë gjuetinë apo transportin e qymyrit të drurit, (iii) nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Brendshme “Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Pyjeve”, i cili krijon Task Forcën mbi Pyjet, (iv) rritja e numrit të kontroleve nga ana e Policisë Pyjore, (v) vendosja e masave administrative për të gjithë shkelësit e legjislacionit mjedisor, etj. Bazuar në VKM Nr 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, janë krijuar Drejtoritë e Pyjeve në çdo bashki që menaxhon fondin pyjor e kullosor të transferuar sipas VKM-ve.

Në kuadër të reformës për menaxhimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura, në Shkurt 2015, u krijua Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) si një institucion në varësi të MTM-së, që siguron për herë të parë në vend krijimin e administratave të pavarura të zonave të mbrojtura, jashtë strukturave të shërbimit pyjor. Në këtë kontekst, është hartuar Programi Strategjik 2015-2020 për Zonat e Mbrojtura.

Qeveria Shqiptare ka konsideruar çështjen e mbetjeve, si një ndër gjashtë prioritetet e programit analitik, duke i dhënë rëndësi të lartë trajtimit dhe depozitimit fundor të mbetjeve të ngurta urbane. Është miratuar VKM Nr 645, datë 14.09.2016 “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave, si marrës, dhe KfW, Frankfurt am Main, për financimin e shërbimeve të ekspertit ndaj marrësit në kuadër të një studimi për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta në Shqipëri, financuar nga një fond i veçantë (Nr 11469) të dhënë nga Qeveria Gjermane”.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në kuadër të aksionit “Të Pastrojmë Shqipërinë që Duam 2020”, në Shqipëri, në bashkëpunim me Pushtetin Vendor dhe me Prefekturat, ka nisur në shkurt 2018, procesin e identifikimit të gjithë vend-depozitimeve ekzistuese të mbetjeve në të gjithë vendin tonë dhe ka bërë vlerësimin për rehabilitimin e tyre për çdo bashki për një periudhë 5-10 vjeçare.

Janë identifikuar 199 deponive ilegale me ndihmën e DLDP dhe po ashtu është zhvilluar raporti përkatës me identifikimin e këtyre deponive ilegale, shpenzimet e rehabilitimit dhe mbylljes.

Ligji Nr 27, datë 17.03.2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, si dhe 3 aktet nënligjore që rregullojnë importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme, kufizimet dhe ndalimet e tyre përpara vendosjes në treg, listën e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë, si dhe krijimi i zyrës së kimikateve, kanë hyrën në fuqi në 28 Mars 2018. Kjo paketë ligjore përbën hapin e parë në krijimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut nga kimikatet me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit. Përmbushja e detyrimeve ndaj Konventës së Stokholmit për Ndotësit Organik të qëndrueshëm (NOQ) ka shënuar përparësi me miratimin në Gusht të 2018, të Planit të ri Kombëtar të Veprimit për NOQ, Transpozimi në legjislacionin kombëtar i dispozitave specifike teknike të Rregullores REACH Nr 1907/2006, ka avancuar nëpërmjet dy projektakteve nënligjore lidhur me: (i) kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar, të rrezikshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisit; (ii) rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit dhe kërkesat specifike, përmbajtjen dhe formatin e dokumentit me të dhënat e sigurisë.

I.3 Prioritetet

Për sa i përket mjedisit, në fushën e legjislacionit horizontal, disa nga prioritetet kryesore kanë të bëjnë me (i) zbatimin e legjislacionit kombëtar që ka transpozuar Direktivën 2001/42/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara” dhe Direktivën e VNM-së (2011/92/EU) amenduar me Direktivën 2014/52/EU, si dhe transpozimi i plotë i Direktivës 2014/52/EU, (ii) forcimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor.

Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, por nevojitet më shumë punë për të arritur pjesëmarrje dhe konsultim efektiv të publikut në procesin e vendimmarrjes, veçanërisht në nivel lokal. Progres i mëtijshëm është i nevojshëm për të arritur pajtueshmërinë e plotë me aspektet e mbetura ndërsektoriale të direktivave mbi përgjegjësinë mjedisore, krimin mjedisor dhe inspektimin mjedisor.

Të zhvillojë kuadrin ligjor, institucional dhe politik për ujin, të përmirësohet më tej procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, me theks të veçantë për procesin e konsultimit publik, veçanërisht në sektorin e hidrocentraleve, sektorin e ndërtimit dhe atë të minierave.

Përmirësimi i cilësisë së ajrit është një nga prioritetet mjedisore të Programit të Qeverisë 2017-2021. Në këtë drejtim, miratimi i planit kombëtar për cilësinë e ajrit është një prioritet i MTM në këtë fushë siç është planifikuar në PKIE për vitin 2019. Kuadri I përgjithshëm ligjor i BE mbi Cilësinë e Ajrit, në përputhje me legjislacionin kombëtar, ka për qëllim të zbatojë Strategjinë Kombëtare të Mjedisit dhe dispozitat e Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis”.

Prioritet në fushën e cilësisë së ajrit për vitin 2019, përbën zbatimin e planit kombëtar për cilësinë e ajrit, përafrimi i rregullave për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve kombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër, në përputhje me Direktivën NEC të BE-së; ngritja e kapaciteteve teknike të stafit të MTM dhe AKM lidhur me Inventarin kombëtar të shkarkimeve në ajër etj.

Megjithëse, janë miratuar aktet nënligjore për menaxhimin e mbetjeve, dhe planet e menaxhimit për Tiranën, Lezhën dhe Shkodrën, janë përgatitur gjithashtu edhe projektplanet rajonale të menaxhimit të mbetjeve për 12 rajonet. Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve është përafëruar pjesërisht. Strategjia kombëtare për menaxhimin e mbetjeve (2010-2025) është në fazë rishikimi.

Në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe cilësisë së ujërave, MBZHR ka si prioritet të punës së saj (i) përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Progres i mëtijshëm është arritur në procesin e licencimit për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza.

Në fushën e mbrojtjes së natyrës, po punohet për të garantuar (i) menaxhimin e integruar të zonave të mbrojtura, (ii) identifikimin dhe studimin e zonave potenciale Natura 2000 për Shqipërinë, (iii) masat për ndalimin e veprimeve të paligjshme si gjuetia, prerjet në pyje si masë zbatuese përkatësisht për ndalimin e gjuetisë dhe prerjeve, si dhe ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura.

Përafrimi me *acquis* në fushën e mbrojtjes së natyrës, në veçanti Direktivat e Habitave dhe Zogjeve, është shumë i avancuar. Niveli i transpozimit të Direktivave të Habitave dhe Zogjeve është rritur.

Përsa i përket fushës së ndotjes industriale, menaxhimit të risqeve dhe aksidentet një nga prioritetet kryesore është përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me Direktivën 2010/75/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes), si dhe me Direktivën 2012/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 4 Korrik 2012 “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë

substancia të rrezikshme”, ndryshimi dhe më pas shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 96/82/EC. Përafrimi me legjislacionin e BE mbi ndotjen industriale dhe menaxhimin e rrezikut është ende në një fazë të hershme.

Përsa i përket politikave për zhurmën në mjedis, një nga prioritetet kryesore të MTM për vitin 2019 në këtë fushë është: (i) zbatimi i kërkesave ligjore për menaxhimin e zhurmave në mjedis dhe forcimi i zbatimit të legjislacionit në këtë fushë; (ii) përmbushja e detyrimit ligjor nga njësitë e qeverisjes vendore për hartimin e planeve lokale të veprimit për zhurmat, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të MTM nr. 01, datë 19.02.2018; (iii) forcimi i zbatimit të vendimeve të task forcës, së ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare.

Në fushën e kimikateve, ndër prioritetet kryesore të MTM-së për 2019 është ratifikimi i Konventës së Minamatës “Për Merkurin”, ngritja e Zyrës së Kimikateve si një detyrim i Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, përafrimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian në legjislacionin kombëtar dhe miratimi i akteve nënligjore që rrjedhin në zbatim të Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, specifikisht lidhur me rregullat e nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti; rregullat e ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurtë të merkurit metalik dhe kriteret specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje; ngritja e kapaciteteve administrative dhe teknike të inspektoratit të mjedisit për zbatimin e legjislacionit në këtë fushë.

Për sa i përket ndryshimeve klimatike, përafrimi i plotë me legjislacionin e BE-së, miratimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planeve Kombëtar të Veprimit për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, miratimi i Ligjit për Ndryshimet Klimatike dhe ngritja e sistemit kombëtar të inventarëve të shkarkimeve në ajër dhe të gazeve me efekt serrë, si dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave të ndryshimeve klimatike në strategjitë e tyre sektoriale, janë disa nga prioritetet në këtë fushë.

Gjithashtu duhet të fillojë zbatimi i Marrëveshjes së Parisit dhe kontributit të Shqipërisë ndaj saj, duke miratuar një Strategji Kombëtare dhe legjislacionin mbi Ndryshimet Klimatike si dhe politikat e lidhura me energjinë dhe transportin.

Në fushën e pyjeve, prioritetet e MTM-së kanë të bëjnë me (i) përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së në këtë fushë, si dhe hartimin e akteve nënligjore që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave në Shqipëri, (ii) hartimin e strategjisë së re 10-vjeçare për Pyjet dhe Kullotat.

Ne kete kuader Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke përgatitur dokumentin politik për mbrojtjen e pyjeve në Republikën e Shqipërisë, i cili do të vijojë me përgatitjen edhe të një projektligji të ri për pyjet në Republikën e Shqipërisë. Synimet afatgjate të dokumentit politik të pyjeve janë për të siguruar një administrim të mirë, organizim funksional, shfytëzim të qëndrueshëm, shërbime cilësore, në fushën e pyjeve.

Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti politik, është parë e nevojshme krijimi i Agjencië Kombëtare për Pyjet, e cila do të ketë për mision mirëqeverisjen e pyjeve, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, shfrytëzimin e qëndrueshëm e multifunksional të burimeve pyjore si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare, për të realizuar:

- a) Sigurimin e performacës në sektorin e pyjeve;
- b) Vlerësimin e gjendjes së pyjeve;
- c) Të organizojë punën për inventarizimin dhe kërkimin në fushën e pyjeve;
- d) Organizimin e punës dhe hartimin e dokumenteve për menaxhimin e pyjeve;
- e) Organizimin e punës për monitorimin dhe kontrollin e pyjeve.

II.1 Legjislacioni horizontal

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Në fushën e legjislacionit horizontal është shënuar progres për sa i përket transpozimit të Direktivave të VNM-së dhe VSM-së, por nuk ka ndonjë progres për sa i përket Direktivave të tjera. Transpozimi i Direktivës së VNM-së (2011/92/EU) ka përparuar së tepërmi duke arritur në masën 100 % nëpërmjet amendimit të Ligjit për VNM-në në shkurt 2015 dhe akteve nënligjore që rrjedhin nga ky ligj, të cilat janë miratuar gjatë viteve 2015 dhe 2016. Ndërkohë do të punohet me transpozimin e Direktivës 2014/52/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 16 prill 2014, e cila ka amenduar Direktivën (2011/92/EU), amendim ky që parashikohet të transpozohet brenda tre mujorit të fundit të vitit 2019.

Pjesa më e madhe e dispozitave të kësaj Direktive janë transpozuar me miratimin e Ligjit Nr 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, në shkurt 2013, ndërsa pjesa e mbetur është transpozuar nëpërmjet akteve nënligjore që rrjedhin nga ky ligj, të cilat janë miratuar gjatë vitit 2015, duke arritur transpozimin e plotë të kësaj Direktive.

Është miratuar me Udhëzimin e veçantë Nr 6, datë 22.12.2016 të Ministrit përgjegjës për mjedisin “Metodologjia Kombëtare e Vlerësimit Strategjik Mjedisor”, i cili ndihmon të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e VSM-së të zbatojnë kërkesat e ligjit nr. 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe VKM-ve në zbatim të tij.

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

Për fushën e Legjislacionit Horizontal

MTM – është institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për fushën e mbrojtjes së mjedisit, vlerësimit të ndikimit në

mjedis, vlerësimi strategjik mjedisor, si dhe për fushën e informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje mjedisore. Gjithashtu, MTM dhe institucionet e saj të varësisë (AKM, AKZM, ARM-të dhe ISHMP) kanë angazhimin për të garantuar zbatimin e tyre.

Përveç MTM-së dhe institucioneve të saj të varësisë, edhe ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të fushës së tyre të përgjegjësisë janë përgjegjëse për të siguruar zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe plotësimin e standardeve mjedisore, sigurimin e procesit të VNM-së dhe VSM-së, si dhe informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje me ndikim në mjedis. Në këtë kuadër përmendim:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).
- Si dhe çdo Ministri apo institucion tjetër që harton plane/programe apo projekte që janë objekt i procesit të VNM-së apo VSM-së.

Ministritë e linjës dhe autoritetet vendore, kanë një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e procedurës së VSM-së dhe në përmbushjen e detyrimeve për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje mjedisore, veçanërisht për sa i përket hartimit të planeve dhe programeve që janë objekt i procesit të VSM-së, si edhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga paketa e ligjore për VNM-në për projekte të mëdha publike.

II.1.3. Masat e planifikuara

II.1.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk është parashikuar miratimi i dokumenteve të reja të politikave në këtë nënkapitull.

II.1.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Amendim i Ligjit 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar ose Ligji i ri për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ligji i ri do të përafrojë plotësisht Direktivën 2014/52/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 16 prill 2014 që ndryshon Direktivën 2011/92/BE mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis.

II.2 Cilësia e ajrit dhe ndryshimet klimatike

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Në fushën e cilësisë së ajrit, Ligji i ri Nr 162, datë 04.12.2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit” dhe VKM Nr 352, datë 29.04.2015 “Mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat në lidhje me disa ndotës” transpozojnë 99% dispozitat e Direktivës 2008/50/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 maj 2008 mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për Evropën, si dhe të Direktivës 2004/107/EC.

Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit është miratuar me VKM Nr 594, datë 10.09.2014 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit”.

Në fushën e ndryshimeve klimatike, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit, në Tetor 1999, si dhe është anëtare e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), që nga Janari 1995 dhe Protokollit të Kiotos që prej vitit 2005. Aktualisht, Shqipëria ka përgatitur tre Komunikime Kombëtare të UNFCCC në 2002, 2009 dhe 2016. Gjithashtu, në vitin 2015 Shqipëria ka miratuar dokumentin e INDC-së me VKM Nr 762, datë 16.09.2015 “Për miratimin e kontributit kombëtar të pikësnyuar ndaj UNFCCC-së” dhe e dorëzoi atë pranë Sekretariatit të UNFCCC-së në datën 24 Shtator 2015. Mbas nënshkrimit në 22 prill 2016 në New York të Marrëveshjes së Parisit, Kuvendi i Shqipërisë ratifikoi Marrëveshjen e Parisit nëpërmjet Ligjit Nr 75, datë 14.07.2016 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit”.

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) - është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit nga ndotja. Me riorganizmin e MTM dhe mbylljen e sektorit të ajrit dhe ndryshimeve klimatike, politikat e cilësisë së ajrit trajtohen nga Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Mjedisit, e përbërë nga 4 specialistë, ku 1 specialistë ndër të tjera është i dedikuar për fushën e cilësisë së ajrit.

AKM - është organi qendror për menaxhimin e Rrjeti i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit Urban, nëpërmjet institucioneve të kontraktuara nga MTM. AKM grumbullon dhe përpunon të dhënat e monitorimit, si dhe bën publike raportin e gjendjes së cilësisë së ajrit.

ISHMP - është autoriteti kompetent që kontrollon kushtet e lejes së mjedisit të aktiviteteve industriale dhe të ndërtimit lidhur me shkarkimet në ajër.

Gjithashtu, MTM është institucioni që harton politikat kombëtare për ndryshimet klimatike dhe koordinon integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike në politikat sektoriale të bujqësisë, turizmit, shëndetësisë, energjisë, transportit, pyjeve, ujërave, etj. MTM është përcaktuar si Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP) në kuadër të detyrimeve të vendit ndaj Konventës

Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Protokollit të Kiotos, si dhe për ndjekjen e projekteve të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër.

Përveç MTM-së, përgjegjëse për fushën e Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike janë edhe:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria përgjegjëse për fushën e transportit,
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

II.2.3. Masat e planifikuara

II.2.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Është përfunduar Dokumenti Strategjik dhe Planet e Veprimit për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, i planifikuar të miratohet përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2019.

II.2.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Projektligji “Për ndryshimet klimatike” që transpozon Direktivën 2004/101/KE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i 27 tetorit 2004 që ndryshon Direktivën 2003/87 /KE për krijimin e një skeme për tregtimin e lejuar të emetimit të gazrave serrë brenda Komunitetit, në lidhje me mekanizmat e projektit të Protokollit të Kiotos, është parashikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019.

Projektvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e VKM Nr. 594, datë 10.09.2014, për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit, është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 2008/50/KE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i 21 majit 2008 mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe ajrit më të pastër për Evropën.

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor detar” që transpozon plotësisht Direktivën 2016/802 (EU) në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta, planifikuar për tu miratuar në tremujorin e dytë të vitit 2019.

II.3. Menaxhimi i mbetjeve

II.3.1 Kuadri politik dhe ligjor

Pavarësisht se ka vazhduar progresi lidhur me transpozimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve, përpjekje të tjera janë të nevojshme për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis* të menaxhimit të mbetjeve. Për sa i përket transpozimit të Direktivës Kuadër të Mbetjeve, ai ka arritur në masën rreth 95%.

Transpozimi i Direktivës së Baterive ka përparuar për shkak të miratimit të VKM-së nr. 866, datë 4.12.2012 “Mbi bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre”. Niveli i transpozimit është i lartë duke arritur afërsisht 90%. Megjithatë, legjislacioni kombëtar nuk ka transpozuar ende gjashtë dispozitat e mbetura të kësaj Direktive.

Transpozimi i Direktivës mbi Paketimin e Mbetjeve, Mbetjet e Paketimeve ka përfunduar në vitin 2012, me miratimin e Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, në Shtator 2011, si dhe VKM 177/2012 “Për paketimin dhe mbetjet e tyre”, në Mars 2012.

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit (“Strategjia”) është dokumenti kryesor i planifikimit në fushën e menaxhimit të mbetjeve komunale, jo komunale dhe të rrezikshme. Dokumenti u hartua për herë të parë në vitin 2010. Dokumenti aktual paraqet strategjinë e përditësuar që mbulon periudhën 2018-2033.

Qëllimi i përgjithshëm i dokumentit është dhënia e udhëzimeve strategjike dhe përcaktimi i një sërë masash që do ta sjellin Shqipërinë më afër miratimit të një Sistemi të Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve i cili reflekton praktikën më të mira në Shtetet Anëtare të BE dhe që i ndihmon vendit të përmbushë detyrimet e tij që rrjedhin nga *acquis communautaire*, veçanërisht Kapitulli 27 mbi mjedisin, në përpjekjet drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Strategjia paraqet një hap tjetër thelbësor në rrugën drejt përputhjes së plotë me *acquis* të KE për menaxhimin e mbeturinave.

Transpozimi i Direktivës së Landfilleve është në shkallën 98%. Vetëm dy dispozita të Direktivës (neni 2 dhe 14 (d)), mbeten për tu transpozuar në legjislacionin kombëtar. Progresi në transpozim është arritur nëpërmjet miratimit të VKM “Për landfillet e mbetjeve”, në Korrik 2012.

Gjithashtu, është miratuar VKM Nr 428, datë 8.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, për hartën digjitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane”, e cila do të miratojë hartën GIS, të krijuar me informacione që reflektojnë situatën aktuale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane, si dhe zhvillime të tjera në terren.

II.3.2 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) - është institucioni kryesor i përfshirë në menaxhimin dhe hartimin e politikave për menaxhimin e mbetjeve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit harton rregullat / legjislacionin e menaxhimit të mbetjeve në të gjitha nivelet (ndarja, ripërdorimi,

riciklimi, asgjësimi dhe djegia), vlerëson dhe lëshon leje për transportimin dhe eksportin e mbetjeve, përcakton rregullat për monitorimin dhe inspektimin / kontrollin e zbatimit të akteve të mbetjeve, organizon dhe menaxhon regjistrat për çështje të ndryshme të mbetjeve.

Ministria e Industrisë dhe Energjisë (MIE) - ka si mision të udhëheqë, të planifikojë, të koordinojë dhe të monitorojë aktivitetin e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve të ndërtimit në të gjitha fazat e zhvillimit, si projektimi, zbatimi i punimeve dhe shfrytëzimi i landfilleve rajonal dhe impianteve të incenerimit të mbetjeve urbane, duke përcaktuar rregullat, teknikat dhe metodat e trajtimit të tyre, në çdo fazë, duke përfshirë krijimin, ndarjen, grumbullimin, ruajtjen, transportin, riciklimin, trajtimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe në zvogëlimin e ndikimit të tyre.

Gjithashtu, MIE është përgjegjëse edhe për:

- Planifikimin dhe ndjekjen e investimeve - bazuar në prioritetet e përfshira në PBA duhet të sigurojë realizimin e studimeve, projekteve dhe implementimin e tyre për mbylljen e vend-depozitimeve ekzistuese dhe ndërtimin e impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve;
- Sensibilizimin, koordinimin dhe bashkëpunimin me strukturat dhe institucionet përkatëse, donatorët dhe NjQV-të për të vënë në jetë parimet më të rëndësishme të metodave bashkëkohore (parandalimi, pakësimi, riciklimi dhe më pas asgjësimi i mbeturinave);
- Hartimin e regjistratit vjetor të mbetjeve në rang bashkie, qarku apo vendi, me qëllim njohjen dhe vlerësimin e situatës mjedisore të shkaktuar nga mbetjet në vend. Përgatitjen e raporteve të nevojshme për evidentimin e problemeve dhe rrugët e zgjidhjes;
- Identifikimin e metodave të përshtatshme të trajtimit të mbetjeve të ngurta, duke bërë të mundur reduktimin e rreziqeve ndaj shëndetit të banorëve.
- Hartimin e rregulloreve për mbetjet industriale dhe mbetjet minerare, si dhe rehabilitimin e vendeve të hedhjes sipas specifikave të përmbajtjes së mbetjeve.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) – së bashku me MTM kanë përgjegjësi për të hartuar rregulloret për menaxhimin e mbetjeve spitalore. Spitalet dhe të gjithë gjeneruesit e mbetjeve shëndetësore kanë përgjegjësi të hartojnë dhe azhurnojnë planet e tyre të menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me planet kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe planet e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme.

Ministria e Mbrojtjes - në bashkëpunim me MTM ka për detyrë të hartojë rregulloret lidhur me mbetjet ushtarake.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) - në bashkëpunim me MTM ka për detyrë të hartojë legjislacionin për taksat e ndryshme mjedisore. MF harton rregullat mbi garancitë financiare për lejet mjedisore të vendeve të mbetjeve të rrezikshme, të cilat miratohen më vonë nga Këshilli i Ministrave.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural MBZHR - në bashkëpunim me MTM ka për detyrë të hartojë rregulloret për mbetjet bujqësore dhe të kafshëve.

II.3.3. Masat e planifikuara

II.3.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka dokumente politikash të planifikuara për t'u miratuar në këtë nënkapitull.

II.3.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

VKM “Për kostot e menaxhimit të mbetjeve” është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Do të përafrojë plotësisht Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 19 nëntorit 2008 mbi mbetjet. Akti është miratuar me Vendim Nr 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.

Projektvendimi për rishikimin e VKM Nr 175, datë 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve” është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Projektvendimi do të përafrojë pjesërisht Direktivën 2008/98/KE Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 19 nëntorit 2008 mbi mbetjet.

II.4 Menaxhimi i ujit

II.4.1 Kuadri politik dhe ligjor

Në fushën e cilësisë së ujërave progres është bërë në drejtim të transpozimit të Direktivës Kuadër të Ujit me miratimin e Ligjit Nr 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, në Nëntor 2012, VKM Nr 246, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë”, VKM Nr 267, datë 07.05.2014 “Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore”, si dhe VKM Nr 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”. Ligji Nr 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, ka transpozuar edhe disa prej dispozitave të Direktivës së Ujërave të Ndotur Urban.

Si pjesë e progresit në fushën e administrimit të ujërave konsiderohet edhe miratimi i VKM Nr 662, datë 21.09.2016 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta”, VKM Nr 342, datë 4.05.2016 “Për miratimin e kufijve territorial dhe hidrografik të baseneve ujore në RSH dhe qendrën dhe përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”, si dhe VKM Nr 416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve

shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”.

Transpozimi i Direktivës së Ujit të Pijshëm është realizuar në masën 100% me miratimin e VKM-së Nr 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores për cilësinë e ujit të pijshëm”.

Edhe Direktiva e Ujërave të Larjes është transpozuar plotësisht me VKM-në “Për miratimin e rregullores higjeno-sanitare ‘Për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes”, të miratuar që në vitin 2010.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, u miratua programi kombëtar i trajnimit dhe certifikimit bazuar në testim, në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, me anë të Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr 660, datë 28.09.2018. Si pjesë e progresit në fushën e administrimit të ujërave, konsiderohet edhe miratimi i Manualit Operacional i rishikuar i Projektit të Investimeve në Sektorin e Ujit, që ka si qëllim krijojë një Sistem të Zbatimit të Projekteve dhe Procedurave të Menaxhimit Financiar në mënyrë që të shërbejë si udhëzues referues për zbatimin e Projekteve të Investimeve në Sektorin e Ujit në Shqipëri (WISP).

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve në nivel qendror, u krijua me anë të VKM Nr 431, datë 11.07.2018, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve. AKUM do të luajë një rol të rëndësishëm në monitorimin e standardeve të shërbimit të ofruar për qytetarët dhe gjithashtu në monitorimin e performancës së shërbimeve UK me qëllim shtyerjen e sektorit drejt performancës.

Me Urdhërin e Ministrit të MIE, Nr 581, datë 18.07.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e ligjit të funksionimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve”, është ngritur grupi i punës i cili, do të përgatisë ligjin sektorial të ujësjellës kanalizimeve, duke sjellë për herë të parë një ligj sektorial, i cili do të rregullojë raportet e funksionimit e të gjithë aktorëve, institucioneve të përfshira në sektor, duke arritur kështu qartësinë dhe shmangjen e mbivendosjeve ndërmjet kompetencave të institucioneve.

Është në process hartimi i Strategjisë Sektoriale të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2019-2030, e cila do të integrojë brenda saj dhe një mekanizëm të qartë dhe operacional për qendrueshmërinë financiare të sektorit.

Udhëzim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr 665, datë 4.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 837, datë 10.02.2017 të Ministrit të Transportit dhe Infrastruktures “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve”.

VKM Nr.18, datë 12.01.2018 “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësave të ujit për kategoritë në nevojë”.

II.4.2 Institucionet përgjegjëse

Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) - është organi qendror vendimmarrës për menaxhimin e burimeve ujore. Ai përbën një forum të nivelit të lartë ndërmënisht për planifikimin dhe menaxhimin në mënyrë të integruar të ujit. Kryesohet nga Kryeministri dhe anëtarë të tij janë Zëvendëskryeministri, Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Brendshëm, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Ujin (GMIP) - është i kryesuar nga Kryeministri dhe anëtarë të tij janë ministrat përgjegjës për një fushë të caktuar të sektorit të ujit, si dhe përfaqësues të donatorëve që operojnë në vend. Ky organ ka si qëllim kryesor koordinimin dhe drejtimin e punës për zhvillimin dhe monitorimin e reformave në sektorin e ujit, nëpërmjet hartimit të një programi kombëtar sektorial.

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU), zëvendësuar me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore - si organi ekzekutiv i KKU-së, ka objekt të veprimtarisë së tij projektimin dhe ngritjen e sistemit total të integruar të ujit, si dhe monitorimin e garantimit të funksionimit efikas të menaxhimit të integruar të këtij sistemi. Ai luan rolin e Sekretariati Teknik të GMIP-së për ujin, përgjegjës për koordinimin në nivel ndërinstitucional për të gjitha çështjet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

MBZHR- është institucioni lider për menaxhimin e ujit, kullimin dhe mbrojtjes nga permbytja.

Bazuar në Ligjin e ri Nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 111/2012 ‘Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore’”, është krijuar Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU). AMBU është përgjegjëse për hartimin dhe implementimin e politikave dhe strategjive që synojnë drejt një menaxhimi të integruar të burimeve ujore në të dy aspektet, sasior dhe cilësor të përdorimit të ujit.

ISHU - është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën e ujërave në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për ujërat.

Komisioni i posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitarë - ka si qëllim kryesor të hartojë, shqyrtojë dhe propozojë marrëveshje bashkëpunimi me secilin vend fqinj, duke trajtuar të gjitha çështjet që lidhen me menaxhimin e integruar të burimeve ujore ndërmjet vendeve respektive. Anëtar të tij janë përfaqësues të lartë nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), Ministria e Drejtësisë (MD), MTM, MBZHRAU, MZHU, MZHETTS, MF, Ministria e Mbrojtjes, Ministri i

Shtetit për Çështjet Vendore, MSH, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), Ministria e Kulturës (MK), MTI, Akademia e Shkencave, si dhe STKKU.

MTI - është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve (AKUK) - është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjetllës kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Ajo mbështet teknikisht politikat e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale, si dhe politikat përkatëse për administrimin e ujërave dhe mbrojtjen mjedisore të cilësisë së ujërave.

MTM - është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që synojnë mbrojtjen e turizmit dhe mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, nxitjen dhe promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe ndryshimeve klimatike.

AKM - është institucioni kryesor publik përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit, përfshi edhe burimet ujore.

Ministria e Mbrojtjes (MB) - ka rolin kryesor në emergjencat civile përfshi edhe emergjencat nga përmybtjet. Është përgjegjëse për hartimin e planit kombëtar të emergjencave civile.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) - përcakton kërkesat higjieno-sanitare, të cilat duhet të plotësohen me ujë të pijshëm dhe pajisje të furnizimit nga pellgu për përdoruesit, dhe kryen monitorimin, inspektimin dhe ekspertizën e cilësisë së ujit të pijshëm.

Instituti i Shëndetit Publik (IPH) - është qendër reference në shëndetin publik dhe institucion në varësi të MSHMS. ISHP luan rolin kryesor në monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm, ujërave sipërfaqësor të përcaktuar për ujë të pijshëm, ujërave për larje, shqyrtimin e metodave të tjera zyrtare të analizave në përputhje të standardeve sipas OBSH-së, hartimin dhe zbatimin e planeve të kontrollit të cilësisë së burimeve të ujit të pijshëm dhe rrjetin e shpërndarjes.

MIE - është institucioni me rol kryesor në hidroenergji e cila operon nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). MIE është përgjegjëse për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet.

AKBN - është institucion në varësi të MEI dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, si dhe monitorimin në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) - vepron në varësi të MEI dhe është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujërave nëntokësore.

MFE- është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në investimet kapitale financiare në sektorin e ujit.

Këshilli i Basenit Ujor (KBU) - janë autoritetet lokale përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore në basenet përkatëse. Përbëhet nga 19 anëtarë që përfaqësojnë institucione të ndryshme të lidhura me ujin, për një basen të caktuar. Ato drejtohen nga prefekti.

Agjencia e Basenit Ujor (gjashtë) - është organi ekzekutiv i Këshillit të Basenit në varësi të MBZHR. Është përgjegjës për hartimin e inventarit të përdorimit të burimeve ujore në sasi dhe cilësi dhe prodhonë raporte periodike për KBU.

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) - është përgjegjës për monitorimin e ujërave sipërfaqësore në cilësi dhe sasi. IGJEUM gjithashtu kryen studime të ndryshme në lidhje me rrjedhjen e ujit, reshjet atmosferike dhe për parandalimin nga përmbytjet.

Inspektorati Shtetëror i Shëndetësisë është përgjegjës për inspektimin e subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm, neni 22, VKM Nr 379, datë 25.05.2016 për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm".

Enti Rregullator i Ujit (ERrU) - është një autoritet i pavarur kombëtar përgjegjës për vendosjen e tarifave (për ujë të pijshëm dhe kanalizime), për licencimin e shoqërive të ujësjellës – kanalizimeve, si dhe monitorimin e performancës së tyre.

Akademia e Shkencave (ASH) - është institucioni përgjegjës për propozimin dhe kryerjen e kërkimeve e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës.

II.4.3. Masat e planifikuara

II.4.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Dokument Strategjik për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019.

Plani i Menaxhimit të Basenit Ujorë Drin-Buna parashikohet të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019.

Plani i Menaxhimit të Basenit Ujorë të Semanit planifikohet të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019.

II.4.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 - 2021

Nuk ka masa ligjore të planifikuara në këtë nënkapitull.

II.5 Mbrojtja e Natyrës

II.5.1 Kuadri politik dhe ligjor

Në fushën e mbrojtjes së natyrës, ka pasur njëfarë progresi në transpozimin e legjislacionit. Transpozimi i Direktivës së Shpendëve të egër është pothuajse i plotë, aktualisht në masën 95%, pas miratimit të Urdhrit të Ministrit Nr. 62, datë 4.4.2016 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian”, e cila transponon plotësisht Aneksin 1 të Direktivës së Zogjve (2009/147/ EU). Transpozimi i plotë i kësaj Direktive është parashikuar të përfundojë pas anëtarësimit të vendit në BE.

Gjithashtu, ka vijuar harmonizimi i legjislacionit kombëtar me kërkesat e Direktivës së Habitave, e cila lende rreth Projektvendimi i Këshillit të Ministrave vlerësohet pothuajse e plotë, në masën 98%. Progresi ka ndodhur pas miratimit të Ligjit Nr. 68/2014, datë 3.07.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” dhe të VKM Nr. 866, datë 10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian”.

II.5.2 Institucionet përgjegjëse

MTM - mbulon çështjet lidhur me hartimin e politikave për mbrojtjen e natyrës, si dhe hartimin e dokumenteve strategjike në këtë fushë. Bashkëpunimi shtrihet edhe me institucionet zbatuese të saj si AKZM, AKM, ISHMP, si dhe me Strukturat e Shërbimit Pyjor pranë 61 Bashkive të vendit. Pas reformës së shërbimit pyjor të zbatuar prej fillimit të vitit 2016, strukturat e shërbimit pyjor pranë Bashkive do të luajnë një rol të rëndësishëm dhe janë partnerë strategjik për çështjet që lidhen me administrimin e habitateve dhe ekosistemeve pyjore dhe të faunës së egër.

Gjithashtu, në fushën e mbrojtjes së natyrës MTM bashkëpunon me MBZHR-në për biodiversitetin bujqësor, MIE në për bashkëpunimin në vendim-marrjen për përdorimin e territorit, MPB-në për bashkërendimin e punës për menaxhimin e aktivitetit të gjuetisë sportive

dhe turistike, MSHÇV-në për menaxhimin e burimeve natyrore lokale në pronësi komunale, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) për kontrollin doganor të tregtimit ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër.

II.5.3. Masat e planifikuara

II.5.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka dokumente politikash të planifikuara për t'u miratuar në këtë nënkapitull.

II.5.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Ligji do të përafrojë pjesërisht Direktivën 2009/147/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 30 Nëntorit 2009 mbi ruajtjen e shpendëve të egër (versioni i konsoliduar), të ndryshuar nga Direktiva 2013/17/BE 3254/91 e datës 4 nëntor 1991, që ndalon përdorimin e kurtheve të këmbëve për llojet e faunës së egër në territorin e Bashkimit Evropian dhe futjen në BE të pëlhurave dhe mallrave të prodhuara të llojeve të caktuara të kafshëve të egra me prejardhje nga vendet që i kapin ato me mbajtjen e këmbëve kurthe ose metodat e zënies që nuk plotësojnë standardet ndërkombëtare të kurtheve.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10253, datë 11.3.2011 “Për gjuetinë”, do të miratohet në vitin 2021. Ligji do të përafrojë pjesërisht Direktivën 2009/147/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshilli i 30 nëntorit 2009 për ruajtjen e shpendëve të egër, të ndryshuar me Direktivën 2013/17/BE.

Nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, është përgatitur paketa me draft-aktet nënligjore, në zbatim të Ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” si më poshtë:

- Draft – VKM “Vlera e dëmit të shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore, mënyra e vlerësimit, mbledhjes dhe administrimit të saj”;
- Draft – VKM “Kriteret e rregullat dhe për miratimin e lejes për mbledhjen, aksesin dhe përdorimin e materialeve e të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore”;
- Draft – VKM “Kriteret e ushtrimit, miratimit dhe të monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore”;
- Draft – VKM “Për masën e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij”;
- Draft – VKM “Për të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, masa dhe kriteret e përdorimit të tyre”;

- Draft – VKM “Për kriteret dhe mënyra e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur mjedisore”;
- Draft – VKM “Për “përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore”;
- Draft – VKM “Për miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes”;
- Draft - VKM “Për miratimin e kriterëve, procedurave të shpalljes dhe administrimit të parqeve natyrore bashkiake”;
- Draft – VKM “Për miratimi i kriterëve dhe procedurave të shpalljes së “kurorës së gjelbër” dhe përcaktimi i rregullave dhe i përgjegjësisë në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës”;
- Draft – VKM “Për rregullat, kriteret dhe procedurat për përdorimin e shpellave për qëllime turistike”;
- Draft – VKM “Për shpalljen “ rezervat strikt natyror/ park kombëtar” të ekosistemit natyror (emërtimi)”;
- Draft – Udhëzim “Për rregullat për hartimin, përmbajtjen, administrimin, përditësimin dhe formatin e tij”;
- Draft – VKM “Për miratimin e strukturës së planit të menaxhimit, përmbajtja dhe kriteret e rishikimit të tij”;
- Draft – Udhëzim “Për rregullat për kalimet e vizitorëve e të turistëve për afate të shkurtra kohore, me qëllim respektimin e masave mbrojtëse të përcaktuara në planin e menaxhimit”;
- Draft – Udhëzim “Për rregullat e hyrjes, eksplorimit dhe studimit të shpellave”;
- Draft – Udhëzim “Për rregulla të veçanta për vizitat ose kalimin e vizitorëve a të turistëve, për afate të shkurtra kohore”;
- Draft – Udhëzim “Për procedurat e ndalimit të përkohshëm të veprimtarive të miratuara, kur cenohet qëllimi për të cilin është shpallur zona e mbrojtur mjedisore”.

Draft aktet ligjore janë dërguar për mendim dhe pritet të miratohen brenda vitit 2019.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin “Për mbrojtjen e biodiversitetit” Nr 9587, datë 20.07.2006, i ndryshuar” është në proces hartimi dhe është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ky projektligj do të sigurojë përafrimin e plotës të Rregullores zbatuese të BE-së ABS Nr 511/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për masat e zbatimit të protokollit të Nagoyës për përdoruesit e burimeve gjenetike për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre.

Vendimi i Këshillit të Ministrave për Kopshtet Zoologjike është planifikuar për t’u miratuar gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020. Ky projektvendim do të përafrojë pjesërisht Direktivën e Kopshteve Zoologjike 1999/22/EC “Për mbajtjen e kafshëve në Kopshtet Zoologjike”.

II.6. Kontrolli i ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut

II.6.1 Kuadri politik dhe ligjor

Në fushën e kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut, transpozimi i plotë i Direktivës së Shkarkimeve Industriale mendohet të jetë rreth 44%, ku progresi kryesor është arritur në vitin 2011 nëpërmjet miratimit të disa akteve ligjore. Shumica e përkufizimeve të kësaj Direktive, të përcaktuara në Kapitullin I, janë transpozuar nga Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”. Lidhur me Kapitullin II, III, IV dhe V të kësaj Direktive, me rëndësi për transpozim është Ligji “Për Lejet e Mjedisit”. Përveç ligjit "Për Lejet e Mjedisit", një akt tjetër i rëndësishëm për transpozimin e dispozitave të kësaj Direktive është miratimi i VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, si dhe aktet që kanë të bëjnë me impiantet e incenerimit të mbetjeve dhe impiantet e co-incenerimit të mbetjeve, siç është VKM nr. 178, datë 06.03.2012 “Për djegien e mbetjeve”.

II.6.2 Institucionet përgjegjëse

MTM - është institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për parandalimin e ndotjes industriale dhe minimizimin e saj. Përkatësisht, AKM, DRM-të dhe ISHMP janë institucionet e varësisë së MTM që janë përgjegjëse për procedurën e lëshimit të lejeve të mjedisit për instalimet industriale, si dhe për monitorimin e zbatimit të kushteve të lejeve të mjedisit.

Përveç MTM-së dhe institucioneve të saj të varësisë, edhe ministrinë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre janë përgjegjëse për të siguruar zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes industriale, sigurimin e procesit të lëshimit të lejeve të mjedisit, si dhe informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendim-marrje për lejet e mjedisit. Këtu mund të përmendim MIE, MBZHR, si dhe MSH.

MTM - është përgjegjëse edhe për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, rregulloreve dhe strategjive për fushën e aksidenteve industriale. Gjithashtu, MTM bën edhe vlerësimin e efekteve të aksidenteve mbi mjedisin.

II.6.3. Masat e planifikuara

II.6.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Hartimi i ligjit të ri për lejet e mjedisit, i cili do të transpozohet në nivel më të lartë direktivën për Shkarkimet industriale të vitit 2010, është parashikuar të miratohet në tremujorin e 4 të vitit 2020.

II.6.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Udhëzim “Për krijimin e kriterëve ekologjike për dhënien e ekoetiketës për akomodimin turistik”, i cili është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Ky Udhëzim transponon pjesërisht Vendimin e Komisionit Evropian, datë 25 janar 2017, mbi Krijimin e Kriterëve të Ekoetiketës të BE-së për akomodimet e turistëve, 2017/75/BE, EUR-Lex - 32017D0175 – EN; doi:10.2791/30096.

Ligji “Për mbrojtjen civile”, i cili është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Ky Ligj transponon Direktivën e Këshillit 2008/114/KE datë 8 dhjetor 2008 “Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre.

II.7. Organizmat e modifikuar gjenetikisht

II.7.1 Kuadri politik dhe ligjor

Si një fushë ndërsektoriale, nuk ka strukturë për organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ) të përcaktuara me ligj. Megjithatë, në kuadrin e zbatimit të Protokollit të Kartagenës mbi Biosigurinë e Konventës për Diversitetin Biologjik (CBD), palët e interesuara janë identifikuar. Në këtë drejtim, kjo fushë kërkon futjen e të gjithë aktorëve kryesorë për të përcaktuar dhe koordinuar punën ndërmjet tyre.

Në kuadër të reformës së institucioneve kërkimore shkencore, është themeluar Departamenti i Bioteknologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, i cili në bashkëpunim me institucionet e tjera në kuadër të ministrive të lartpërmendura dhe me Akademinë e Shkencave është i rëndësishëm për kryerjen e procedura e vlerësimit të rrezikut të OMGJ-ve.

Në nivel kombëtar, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", u themelua Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (NFA) si një institucion vartës i Ministrisë së Bujqësisë, ku një nga detyrat e tij është qeverisja e procesit të vlerësimit të rrezikut në fushën e sigurisë ushqimore.

II.7.2 Institucionet përgjegjëse

Institucionet kryesore janë MBZHR për mbjelljet, ushqimet dhe tregtimin, si dhe MTM për introduktimin e kontrolluar në mjedis, duke përfshirë vendosjen dhe mënyrat e sistemit të lajmërimit (njoftimit) midis shteteve Palë të Protokollit të Biosigurisë.

Aktorë të tjerë për politikën janë MSHMS për mikroorganizmat në gjendje të mbyllur dhe ndikimet në shëndetin e njeriut dhe MASR për zhvillimin e bioteknologjisë. DPD është përgjegjëse për zbatimin e Protokollit të Biosigurisë lidhur me lëvizjet ndërkufitare të OMGJ-ve.

II.7.3. Masat e planifikuara

II.7.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka dokumente politikash të planifikuara për t'u miratuar në këtë nënkapitull.

II.7.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019– 2021

VKM “Për lëshimin e kontrolluar në mjedis dhe rregullat e detajuara për OMGJ-të që përdoren për qëllime të tjera përveç hedhjes së tyre në treg si produkte që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut, do të miratohet në vitin 2020, pasi pas konsultimit të draftit të parë u vërejt se është një projektvendim që kërkon bashkërendim dhe dakortësim me MBZHR dhe konsultime të zgjeruara me grupet e interesit.

II.8. Kimikatet

II.8.1 Kuadri politik dhe ligjor

Progres është shënuar edhe për sa i përket transpozimit të legjislacionit për fushën e kimikateve, ku gjatë vitit 2016 janë miratuar Ligji Nr 27, datë 17.03.2016 “Për menaxhimin e kimikateve” dhe tre aktet nënligjore të tij. Konkretisht, VKM Nr 488, datë 29.06.2016 “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve”, VKM Nr 489, datë 29.06.2016 “Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e substancave në listën e SVHC dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC”, VKM Nr. 665, datë 21.09.2016 “Për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme”. “Plani Kombëtar

i Veprimit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm” është miratuar me VKM Nr 505, datë 29.08.2018. Miratimi i këtij dokumenti përmbush ka përmbushur një nga detyrimet ndaj Konventës së Stokholmit për Ndotësit Organik të qëndrueshëm (NOQ). Transpozimi në legjislacionin kombëtar i dispozitave specifike teknike të Rregullores REACH Nr 1907/2006, ka avancuar më tej nëpërmjet dy projektakteve nënligjore të ndërmarra në këtë fushë dhe që lidhen me: (i) kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar, të rrezikshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisit; (ii) rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatis dhe kërkesat specifike, përmbajtjen dhe formatin e dokumentit me të dhënat e sigurisë.

II.8.2 Institucionet përgjegjëse

Çështjet e menaxhimit të kimikateve janë detyrë e disa institucioneve, përkatësisht e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrisë përgjegjëse për transportin (MIE), Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Ministrisë së Mbrojtjes (MM), si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE).

MTM është gjithashtu Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e Konventës së Roterdamit. Ligji Nr 27/2016 përcakton gjithashtu edhe kompetencat e autoriteteve të tjera që lidhen me kimikatet, ku:

- Ministria përgjegjëse për tregtinë (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) është autoriteti kompetent për kontrollin e kimikateve në treg;
- Ministria përgjegjëse për industrinë (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) është autoriteti kompetent për licencimin e aktiviteteve që lidhen me kimikatet e rrezikshme, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe
- Ministria përgjegjëse për shëndetin, është përgjegjëse për sigurimin e informacionit mbi sigurinë dhe rrezikun e kimikateve në shëndet, në mënyrë që të përgatiten masat parandaluese kurative, veçanërisht në raste emergjencash.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - është përgjegjëse për lejet e prodhimit dhe të importimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe plehrave kimike, vlerësimin, testimin, administrimin dhe kontrollin e tyre. Importi dhe eksporti i tyre kontrollohen nga kjo ministri, përmes Agjencisë Kombëtare të Ushqimit (AKU-së).

Ministria përgjegjëse për punën (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) ka përcaktuar punët e vështira ose të rrezikshme, si dhe listën e substancave të rrezikshme, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin në punë nga përdorimi i tyre. Inspektorati Shtetëror i Punës në vartësi të kësaj ministrie, në bashkëpunim me inspektoratet e tjera të shtetit koordinojnë punën për të siguruar zbatimin e legjislacionit të punës nga punëdhënësit dhe personat e siguruar prej tyre.

Ministria përgjegjëse për transportin (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) përgjigjet për transportin e mallrave të rrezikshme. Ajo lëshon lejen për automjetet që transportojnë mallrat e rrezikshme, bën kontrollin teknik dhe bashkërisht me MPB i shoqëron këto mallra deri në destinacion brenda vendit.

Ministria e Mbrojtjes - lëshon lejet dhe ka përgjegjësinë kryesore për importin, eksportin, testimin e lëndëve eksplozive. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksportit (AKSHE) pajis me licencë importi, eksporti, transiti, me autorizim, me certifikatë ndërkombëtare importi, certifikatën e përdoruesit të fundit, certifikatë shpërndarjeje dhe certifikatë doganore, të mbërritjes së mallit në destinacion, subjekte fizike ose juridike, që kryejnë transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake, mallrave me përdorim të dyfishtë, si dhe të teknologjive të tyre.

Autoritetet Doganore - regjistrojnë ngarkesën me substanca dhe përzierje të rrezikshme, që kalon kufirin shtetëror, si dhe kontrollojnë dokumentacionin shoqërues sipas legjislacionit në fuqi.

Ligji Nr 27, datë 17.03.2016 “Mbi menaxhimin e kimikateve”, i cili ka hyrë në fuqi në datë 28 Mars 2018, ka përcaktuar si autoritet përgjegjës për kimikatet MTM-në dhe zyrën e kimikateve. Ligji nr.27/2016, ka autorizuar Zyrën e Kimikateve si strukturën e specializuar në përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e kimikateve në vend. Ngritja dhe funksionimi i saj e planifikuar për 2019, si dhe fillimi i zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Suedeze të Kimikateve (KEMI), po gjatë vitit 2019, do të shoqërohen me forcimin në numër dhe cilësi të kapaciteteve teknike administrative që do të angazhohen në fushën e kimikateve në vend.

II.8.3. Veprimet e planifikuara

II.8.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka dokumente politikash të planifikuara për t’u miratuar në këtë nënkapitull.

II.8.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 – 2021

- Projektvendim “Mbi kufizimet në prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm” i cili është planifikuar të miratohet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Projektvendimi përafron pjesërisht Rregulloren (KE) Nr. 1907/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 18 dhjetor 2006 në lidhje me regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH).

II.9. Mbrojtja e zhurmës

II.9.1 Politikat dhe kuadri ligjor

Progres është shënuar edhe për sa i përket transpozimit të Direktivës së Zhurmave Mjedisore. Progres ky i arritur në Janar 2013 për shkak të miratimit të Udhëzimit Nr 2, datë 7.01.2013 "Për treguesit, metodat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike të metodologjisë për vlerësimin e nivelit të zhurmës, dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për të zgjidhur dhe për të përmirësuar situatën". Megjithatë, ka ende disa dispozita që duhet të transpozohen.

Transpozimi i Direktivës 2002/49/EC "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis", ka shënuar progres në shkurt të 2018. Në zbatim të Ligjit Nr 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis", është miratuar Udhëzimi i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Nr. 1, datë 19.02.2018, "Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat", i cili është pjesërisht në përputhje edhe me kërkesat e Nenit 8 dhe Shtojcës V të Direktivës 2002/49/KE.

II.9.2 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) - është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që synojnë mbrojtjen nga zhurmat

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) - është institucioni kryesor publik përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen nga Zhurmat.

II.9.3. Veprimet e planifikuara

II.9.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019– 2021

Nuk ka dokumente politikash të planifikuara për t'u miratuar në këtë nënkapitull.

II.9.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019 - 2021

Nuk ka masa ligjore të planifikuara për t'u miratuar në këtë nënkapitull.

II.10. Pyjet

II.10.1 Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia e re 10-vjeçare për Pyjet dhe Kullotat është ende në zbatim.

II.10.2 Institucionet përgjegjëse

MTM dhe institucionet e saj të varësisë - janë institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e pyjeve.

Bashkitë - janë përgjegjëse për menaxhimin e fondit pyjor e kullosor në territorin administrativ të tyre.

ISHMP - është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fondin pyjor kullosor.

II.10.3. Veprimet e planifikuara

II.10.3.1. Kuadri i Politikave të Planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka dokumente politikash të planifikuar për t'u miratuar në këtë nënkapitull.

II.10.3.2. Masat ligjore të planifikuara 2019- 2021

Nuk ka masa ligjore të planifikuara për t'u miratuar në këtë nënkapitull.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit Lider	10.247.715	6.875.157	6.484.784
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera	1.980.000	495.000	
Buxheti total i kapitullit	12.227.715	7.370.157	6.484.784

Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit

I.1. Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e acquis së BE-së

Acquis për mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit përbëhet nga masat rregullatore, rekomandimet për Shtetet Anëtare, koordinimi dhe mbështetja e aktiviteteve të Shteteve Anëtare duke përfshirë mbështetjen financiare. Kapitulli mbulon interesat e qytetarëve në lidhje me politikën e konsumatorit, sidomos në çështjet e sigurisë dhe të interesave ekonomike, dhe shëndetin publik. Acquis në fushën e mbrojtjes së konsumatorit përfshin legjislacionin për sigurinë e produkteve dhe Sistemin e Alarmit të Bashkimit Evropian (RAPEX), bashkëpunimin ndërkufitar të zbatimit, dëmshpërblimin e konsumatorit, shitjen e mallrave të konsumit dhe garancitë përkatëse, kushtet e padrejta të kontratave, treguesit e çmimeve, të drejtat e konsumatorit, kredia konsumatore, praktikat e padrejta tregtare, etj.

Për sa i përket shëndetit publik, acquis mbulon fushat që lidhen me kontrollin e duhanit, kërcënimet serioze për shëndetin ndërkufitar, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, gjakun, indet, qelizat dhe organet, të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar, produktet medicinale, kozmetikë dhe pajisjet medicinale. Gjithashtu, këtu përfshihen shëndeti mendor, parandalimi i abuzimit me drogën, pabarazia shëndetësore, ushqyerja, reduktimi i dëmeve të lidhura me alkoolin, shfaqja e kancerit, mjedise të shëndetshme duke përfshirë parandalimin e lëndimeve, promovimin e sigurisë, plakjen aktive dhe të shëndetshme si dhe veprimin evropian në fushën e sëmundjeve të rralla.

Zbatimi i mbrojtjes së konsumatorit dhe promovimit të shëndetit, politikat e parandalimit dhe mbrojtjes kërkojnë kapacitete adekuate administrative dhe infrastrukturë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorit, kjo i referohet mbikëqyrjes efektive të tregut dhe aksesit të konsumatorit për dëmshpërblim, duke përfshirë mekanizmat e pavarura gjyqësore dhe jashtë gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ai përfshin gjithashtu edukimin e konsumatorëve, aktivitetet e informimit, përfshirjen aktive të përfaqësuesve të konsumatorëve në hartimin dhe zbatimin e politikave, duke siguruar kështu një rol për shoqatat e konsumatorëve.

I.1.2. Kërkesat sipas MSA-së

Angazhimet në fushën e mbrojtjes së konsumatorit janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga nenet 70 dhe 76 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe të dispozitave përkatëse të acquis së BE-së.

I.2. Situata aktuale/Përmbledhje

Përgatitjet janë në fazë fillestare në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe shëndetit. Ka pasur njëfarë progresi gjatë vitit të kaluar, veçanërisht në forcimin e efektivitetit të Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK), në analizën e praktikave të biznesit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve, si dhe nëpërmjet miratimit të strategjisë kombëtare shëndetësore 2016-2020.

Në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, kapaciteti i Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK) dhe i organeve të tjera të mbrojtjes së konsumatorit u forcua nëpërmjet trajnimeve dhe duke ndarë njohuritë mbi legjislacionin e BE-së dhe praktikën e zbatimit. Në çështjet që lidhen me sigurinë e produkteve, Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut, i ngritur në vitin 2016, nga 69 punonjës gjithsej, aktualisht ka 45 të punësuar, prej të cilëve 33 janë inspektorë. Rekrutimi i inspektorëve të tjerë është në proces, ndërsa legjislacioni kombëtar përputhet pjesërisht me acquis të BE-së. Është punuar për fuqizimin e kapaciteteve njerëzore të ISHMT nëpërmjet trajnimeve të ndryshme mbi njohjen e legjislacionit të BE dhe praktikave më të mira mbi mbikëqyrjen e tregut. Në çështjet që nuk lidhen me sigurinë, materialet që lidhen me rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve u bënë të disponueshme në faqen e internetit të KMK.

Strategjia Ndersektoriale “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut, 2020” është në proces monitorimi. Në lidhje me plotësimin e aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit, institucionet e përfshira kanë përgatitur pasaportat e indikatorëve dhe raportin narrativ. Procesi ka përfunduar në nëntor 2018 dhe raporti është publikuar në faqen e KMS-së.

Sa i përket shëndetit publik, Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2016-2020 u miratua në Maj 2017 dhe synon të arrijë një mbulim universal të kujdesit shëndetësor. Raportimi i të dhënave shëndetësore nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore publike dhe private është krijuar tashmë dhe cilësia dhe mbulimi i këtyre të dhënave është përmirësuar. Sa i përket sëmundjeve të rralla, strategjia kombëtare e shëndetësisë është duke u zhvilluar në bashkëpunim me Bankën Botërore. Në fushën e kërcënimeve serioze ndërkufitare për shëndetin, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, ekziston baza ligjore për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse dhe është hartuar për të qenë në përputhje me acquis. Ekziston një sistem kombëtar alarmi dhe mbikëqyrjeje për sëmundjet ngjitëse. Shkalla kombëtare e mbulimit të imunizimit është 97%. Për kontrollin e duhanit është duke u zbatuar ligji për mbrojtjen e shëndetit publik kundër produkteve të duhanit, i cili është hartuar për t'u harmonizuar me acquis. Për parandalimin e abuzimit me drogën dhe reduktimin e dëmeve, janë zhvilluar disa aktivitete parandaluese, kryesisht të iniciuara nga Departamenti i Promovimit të Shëndetit dhe Instituti i Shëndetit Publik.

I.3 Prioritetet

Prioritete në këtë kapitull janë:

- Forcimi i kapaciteteve administrative të të gjithë institucioneve përkatëse dhe Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve në veçanti;
- Funksionimi i Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut, me kapacitet të plotë punonjësish;
- Vazhdimësi në organizimin e fushatave ndërgjegjësuere me konsumatorë dhe grupe konsumatorësh;
- Përpyqje të mëtjshme për përfrimin e plotë me legjislacionin e BE-së për çështjet e produkteve të duhanit, substancat me origjinë njerëzore dhe barnat për përdorim njerëzor dhe veterinar;
- Vlerësimi dhe prioritizimi i ndikimit shëndetësor të politikave të mbrojtjes sociale, sigurisë në punë, mjedisit, planifikimit dhe rregullimit territorial, duke përfshirë transportin dhe komunikimet, politikat fiskale për të rritur barrën e taksave mbi duhanin, pijet alkoolike, lëndëve djegëse shumë ndotëse, lojërat e fatit dhe lehtësimit të politikave fiskale për produktet me interes të veçantë për shëndetin publik;
- Krijimi/konsolidimi i mekanizmit të koordinimit ndërsektorial për probleme madhorë të shëndetit publik, si droga dhe abuzimi me alkoolin, duhan-pirja, siguria rrugore, siguria ushqimore dhe ushqyerja, shpërthimi i sëmundjeve infektive, rezistenca antibiotike, përgatitja dhe reagimi ndaj pandemive, menaxhimi strategjik i kimikateve, faktorët mjedisorë, ndryshimet klimatike, migrimi, shëndeti dhe përfshirja sociale;
- Përmirësimi i programeve të mbikëqyrjes dhe reagimit ndaj sëmundjeve infektive, përmes përmirësimit të legjislacionit, forcimit të kapaciteteve dhe rrjeteve të informimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik;
- Ngritja e një sistemi mbikëqyrjeje për rezistencën antibiotike dhe të një programi kontrolli dhe monitorimi mbi konsumin dhe politikat e antibiotikëve, përmes përmirësimit të legjislacionit, forcimit të kapaciteteve dhe rrjeteve të informimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik;
- Përmirësimi i përgatitjes dhe reagimit ndaj pandemive dhe i politikave të kontrollit të sëmundjeve (HIV/AIDS, sifilizi, hetapitiviral, programi i imunizimit, etj.), përmes rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të strategjive kombëtare; përmirësimit të akteve nënligjore, forcimit të kapaciteteve dhe digjitalizimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik; ngritjen e një sistemi mbikëqyrjeje për rezistencën antibiotike.

II.1 Mbrojtja e konsumatorit

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Strategjia Ndërsektoriale “Për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut, 2020” është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 753, datë 16.09.2015.

Legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorëve përbëhet nga Ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 444 datë 14.07.2011 dhe Ligjin nr.

71/2018, si dhe nga Ligji Nr. 10480 , datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar, së bashku me aktet nënligjore për këtë fushe. Gjithashtu, dispozitat e Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 të Kodit Civil, të ndryshuar, rregullojnë aspekte të ndryshme në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.

Ligji nr. 71/2018“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar,u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në tetor 2018.Ligji bazë 9902/2008, indryshuarsë bashku me ligjin e ri të miratuar sigurojnë përputhje të plotë me Direktivën 2011/83/BE “Mbi të drejtat e konsumatorëve” dhe përputhje të pjesshme me Direktivën 2013/11/BE “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve”.

Gjithashtu, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është funksional që nga qershori i vitit 2016. ISHMT ka përgatitur rregulloren e brendshme “Për funksionimin e Inspektoratit Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut”, miratuar me Urdhrin e Ministrit Nr. 5122, datë 25.05.2017, ku përcaktohen detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e zbatimit të tyre.

Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2018, në kuadër të Kapitullit 28 ka vijuar procesin e rishikimit të kuadrit rregullativ ekzistues të mbikëqyrjes bankare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përshtatje me detyrimet që rrjedhin për Bankën e Shqipërisë nga dokumentet strategjike të integritimit evropian, raportet e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me Vendimin nr. 27, datë 04.04.2018, miratoi disa ndryshime në rregulloren nr.48, datë 01.07.2015 “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, të cilat kanë hyrë në fuqi në datë 1 qershor 2018. Ndryshimet në rregullore synojnë përafrim të mëtejshëm me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian 2014/17/EU mbi kontratat e kredisë për konsumatorët lidhur me pasuritë e paluajtshme rezidenciale,të cilat rregullon marrëveshjet e kredisë konsumatore dhe të kredisë hipotekare për individët, me qëllim shtimin e kërkesave për mbrojtjen e konsumatorit.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional që merret me mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri përbëhet nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK);
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISMT);
- Banka e Shqipërisë (BA).

II.1.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.1.3.1. Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.1.3.2. Masat ligjore të parashikuara

Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, është parashikuar hartimi i projekt VKM “Për mënyrën e organizimit dhe e funksionimit të strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, si dhe përcaktimin e kriterëve shtesë që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve”. Ky akt nënligjor siguron përputhjen e plotë me direktivën 2013/11/BE “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve”. Miratimi i kësaj mase parashikohet në tremujorin e III të vitit 2020.

II.2. Mbrojtja e shëndetit

II.2.1. Kuadri politik dhe ligjor

Shqipëria ka miratuar një sërë strategjish dhe aktesh nënligjore në fushën e shëndetit publik sikurse është Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2016-2020, miratuar në Maj 2017.

Legjislacioni bazë në fushën e shëndetit publik janë: Ligji Nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”; Ligji Nr. 9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 10454, datë 21.07.2011 “Për transplantin e indeve dhe qelizave në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 44/2012 “Për shëndetin Mendor”; Ligji Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”.

Rritja e nivelit të masave mbrojtëse të ushqyerjes me gji u bë e mundur nëpërmjet rishikimit të ligjit ekzistues dhe miratimit të Ligjit Nr. 53/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8528, datë 23.9.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”, i ndryshuar, në përputhje të pjesshme me Direktivën e Komisionit Evropian 2006/141/EC mbi formulën foshnjore dhe formulën pasuese, e cila mbulon vetëm disa dispozita të Kodit Ndërkombëtar të Marketingut të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit.

Bazuar në ligjin e mësipërm të ndryshuar është miratuar edhe VKM Nr. 116, datë 15.2.2017 “Për mënyrën e paraqitjes, formatin dhe përmbajtjen e etiketimit të produkteve zëvendësuese të qumështit të gjirit”. Prodhuarit dhe shpërndarësit e produkteve të përcaktuara, përpara se të vendosin në treg produktin, duhet të zbatojnë përcaktimet mbi etiketimin të bëra në legjislacionin për ushqimin dhe përcaktimet e bëra në këtë vendim.

Miratimi i VKM Nr. 434, datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit” ka për qëllim pikërisht të vendosë bazën për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit nëpërmjet informacionit për ushqimin, duke marrë parasysh dallimet në perceptimin e konsumatorëve dhe nevojat e tyre për informacion, si dhe duke siguruar funksionimin normal të tregut. Ky vendim është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 1169/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 tetor 2011, “Për dhënien e informacionit ushqimor për konsumatorët”, që ndryshon Rregulloret (KE) nr. 1924/2006 dhe (KE) nr. 1925/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivën e komisionit 87/250/KEE, Direktivën e Këshillit 90/496/KEE, Direktivën e Komisionit 1999/10/KE, Direktivën 2000/13/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat e Komisionit 2002/67/KE dhe 2008/5/KE, dhe Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 608/2004.

Një ndryshim të rëndësishëm ligjor ka pësuar edhe Ligji Nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i cili përfshiu për herë të parë edhe ndalimin e përdorimit të pijeve energjike dhe pijeve të gazuara me sheqer, i pasqyruar në Ligjin Nr. 74, datë 25.10.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i ndryshuar. Ky ligj ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, duke ndaluar përdorimin e pijeve energjike dhe kufizuar marketingun si të pijeve energjike ashtu dhe të pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, nga të miturit. Një pasqyrë e legjislacionit evropian mbi etiketimin e ushqimit - me vëmendje të veçantë ndaj rregullave në lidhje me pije që përmbajnë përbërës aktivë, me të cilët gjen përputhshmëri të pjesshme edhe ky ligj, jepet në vijim:

- Direktiva 2000/13 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi “Përafrimin e ligjeve të vendeve anëtare lidhur me etiketimin, prezantimin dhe reklamimin e produkteve ushqimore”;
- Direktiva 2002/67 e Komisionit Evropian për “Etiketimin e produkteve ushqimore që përmbajnë kininë dhe të produkteve që përmbajnë kafeinë”;
- Rregullorja Nr. 1169/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi “Dhënien e informacionit të ushqimit për konsumatorët”.

Sa i përket zhvillimeve në kontrollin e kancerit, janë miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 549, 15/12/2016 udhëzimet dhe protokollet e depistimit të kancerit të qafës së mitrës në kujdesin shëndetësor parësor.

Lidhur me zhvillimet në fushën e drogave, është miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 31, datë 18.10.2018 themelimi i Grupit Punues të Ekspertëve për Zhvillimin e Udhëzimeve dhe Protokolleve Kombëtare për Metodën e Zëvendësimit të Terapisë” (MST). Aktualisht, ky grup po punon në zhvillimin e udhëzimeve të MST dhe protokolleve klinike.

II.2.2. Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional që merret me shëndetin publik në Shqipëri përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
- Instituti i Shëndetit Publik;
- Spitalet Universitare për diagnostikimin, trajtimin, trajnimin e specialistëve;
- Qendra Kombëtare për Kontrollin e Gjakut;
- Inspektorati shtetëror i shëndetësisë;
- Agjencia Kombëtare e Drogave dhe Pajisjeve Mjekësore.

II.2.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.2.3.1 Kuadri i politikave të parashikuara

Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Drogës 2017-2021 është parashikuar për miratim tremujorin e parë të vitit 2019.

II.2.3.2 Masat ligjore të parashikuara

Ndërkohë është në proces përgatitja e Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për rregullimin e programit të ri kombëtar të depistimit të kancerit të qafës së mitrës”, i cili përafron pjesërisht Rekomandimin e Këshillit të datë 2 Dhjetor 2003 mbi depistimin e kancerit (2003/878/EC). Ky akt parashikohet të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2019.

III. Alokimet financiare

III.1 Buxheti

MSHMS ka alokuar fondet e mëposhtme në lek:

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit përgjegjës		400.000	
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera kontribuese			
Buxheti total i kapitullit		400.000	

Kapitulli 29: Bashkimi doganor

I.1. Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e acquis së BE-së

Acquis në fushën e Bashkimit Doganor përbëhet kryesisht nga legjislacioni i cili është direkt i detyrueshëm për Shtetet Anëtare, duke siguruar funksionimin e bashkimit doganor si dhe mbrojtjen efektive dhe kontrollin e kufijve të saj të jashtëm. Ai përfshin Kodin Doganor të BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, Nomenklaturën e Kombinuar, tarifën e përbashkët doganore dhe dispozitat për klasifikimin e tarifave, lehtësimin e detyrimeve doganore, pezullimet doganore dhe kuotat e caktuara tarifore, si dhe dispozita të tjera të tilla si ato mbi kontrollin doganor të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore dhe transit. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë ekzistencën e kapaciteteve të nevojshme zbatuese, duke përfshirë lidhjet me sistemet relevante të kompjuterizuara të BE-së. Shërbimet doganore gjithashtu duhet të sigurojnë kapacitete adekuate për zbatimin e rregullave të veçanta të përcaktuara në fushat përkatëse të acquis siç janë tregtia e jashtme, dispozitat për shëndetin dhe sigurinë.

I.1.2. Kërkesat sipas MSA-së

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit, nenet 13, 14, 15, 34, 43, 86 dhe 97. Nenet 13, 14, 15, 34, 43 dhe 86 parashikojnë në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit që kanë nënshkruar MSA, ndërsa neni 41 dhe Protokoli 4 përcaktojnë rregullat e origjinës për implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në veçanti neni 97 i referohet doganave. Ky nen parashikon, detyrimin për të përafruar legjislacionin doganor shqiptar me atë të BE-së, bashkëpunimin mes Palëve duke pasur parasysh acquis në fushën e doganave dhe bashkëpunimin për asistencë të ndërsjellë administrative në çështje doganore.

I.2. Situata aktuale/Përmbledhje

Administrata Doganore Shqiptare ka përparuar me hyrjen plotësisht në fuqi të Kodit Doganor, si dhe me riorganizimin e strukturës dhe përmirësimin e menaxhimit të riskut. Në janar të vitit 2018, u përditësua Nomenklatura e Mallrave, e cila është në linjë me Nomenklaturën e Kombinuar të BE-së. Sistemi i vendit për borxhin dhe garancitë doganore është harmonizuar me rregullat e BE-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pajis Operatorët Ekonomikë me Statusin “Eksportues i Miratuar”, në mbështetje të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”, VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 22 të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të Origjinës (Ligj Nr. 1/2012, datë 26.01.2012, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 7, datë 20 Shkurt 2012). Autorizimi jepet sipas modelit të standardizuar dhe aplikuesi pajiset me një numër identifikues.

Manuali mbi “Informacionin Detyrues të Origjinës” është miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 65, datë 16.10.2018 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit: <http://www.dogana.gov.al/dokument/1989/manuali -ido>.

Në janar të vitit 2018, Ministri i Financave dhe Ekonomisë miratoi Udhëzimin nr. 3, datë 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” duke miratuar Bazën Kombëtare të të Dhënave të Vlerësimit si një instrument të njohur dhe të rekomanduar nga Organizata Botërore e Doganave.

Sistemi doganor për procedurat e importit dhe eksportit “paperless” (Deklarata Import / Export) pritet të zbatohet nga Administrata Doganore Shqiptare brenda dhjetorit 2018. Ky është një proces që filloi në fund të vitit 2017 dhe për të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave krijoi një grup pune të specializuar që synonte rritjen e përmirësimit të shërbimit doganor për operatorët ekonomikë. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2018 është realizuar:

- Çertifikimi elektronik i dokumentacionit nga ana e Agjencive Doganore për llogari të operatorëve ekonomikë nëpërmjet strukturave të specializuara (AKSHI) duke shmangur dorëzimin e tyre pranë Degëve Doganore, duke përcaktuar qartazi dhe përgjegjësitë për mbajtjen e tyre pranë premisave të operatorëve ose përfaqësuesve të tyre sipas afateve dhe kushteve që parashikon legjislacioni.
- Nënshkrimi elektronik i deklaratës nga ana e Operatorëve Ekonomikë/Agjentëve Doganorë, si dhe punonjësve doganorë, duke implementuar certifikimin nëpërmjet vulës elektronike duke siguruar implementimin e sistemit doganor “paperless” për procedurat e importit dhe eksportit brenda vitit 2018.
- Krijimi i Kanalit Blu në momentin e përzgjedhjes së deklaratës.
- Krijimi i Vlerësimit Qendror pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Krijimi i Qendrës së Kontrollit Aposterior (kontrollit pas zhdoganimit- brenda 5 ditëve) si një strukturë e pavarur nga Vlerësimi Qendror për ato deklarata të cilat janë përzgjedhur nga sistemi në Kanal Blu, por jo vetëm. Kjo strukturë duke pasur parimin e kontrollit të dyfishtë do të kontrollojë procedurat e strukturave të tjera me qëllim identifikimin e problematikave.

Për sa i përket kapacitetit administrativ dhe operacional, në vitin 2018 u miratua Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore 2018-2021 nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me Dokumentin Nr. 12942/1 Prot., datë 24.01.2018, që përmban misionin dhe objektivat strategjike për periudhën 2018-2021 dhe duke përfshirë rritjen e sistemeve dhe platformave të TI.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me Vendimin Nr. 2, datë 08.01.2018 “Për disa ndryshime në VKM Nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, ka të përcaktuar organikën e Administratës Doganore. Aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka 1102 punonjës të shpërndarë në nivel qendror (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) dhe nivel vendor (17 Degë Doganore). Nga këta 1102 punonjës, 807 punonjës gëzojnë statusin e Nëpunësit Civil dhe 295 punonjës i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me Kodin e Punës.

Në kuadër të ristrukturimit, Drejtoria e Përgjithshme e doganave ka kryer procesin e përshkrimeve dhe klasifikimin e pozicioneve të punës, si dhe kritereve kualifikuese të rekrutimit në Administratës Doganore, të cilat janë finalizuar me miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 14474/1 prot., dt. 18.09.2018. Gjatë 2018, 12 punonjës janë punësuar nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe 42 me Kod Pune.

Është implementuar Sistemi LIMS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Laboratorit). Me vendim të Trupit Akreditues, laborator i doganor shqiptar është akredituar për 5 tregues analitikë më 25.10. 2018. Kapacitetet teknike dhe profesionale në lidhje me metodat analitike dhe sigurinë në laborator janë përmirësuar përmes trajnimeve nga Organizata Botërore e Doganave.

I.3. Prioritetet

Tek prioritetet afatshkurtra përfshihet përmirësimi i procedurave doganore dhe të akcizës në mënyrë që të rritet mbledhja efitase e detyrimeve duke përafuar më tej dhe legjislacionin. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet avancimit me regjistrimin e operatorëve ekonomik të autorizuar; ndjekjes së luftës kundër kontrabandës, importeve të produkteve të falsifikuara dhe korrupsionit.

Një rëndësi e veçantë do t'i vihet luftës kundër shkeljeve ndaj IPR, sistemit të menaxhimit të riskut me modelet e harmonizuara të menaxhimit të riskut të BE-së, si dhe bashkëpunim aktiv me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Administrata doganore do të ndërmarrë aktivitete për të përmirësuar imazhin publik dhe reputacionin e doganave. Aktivitetet dhe veprimet në fushën e luftës kundër korrupsionit do të forcohen dhe zbatohen. Një nga sfidat kryesore mbetet të sigurojë mundësinë e ndërlidhjes me sistemet dhe standardet e TI të BE-së.

Tek prioritetet afatmesme përfshihet përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit Shqiptar për doganat me atë të BE-së. Një sfidë mbetet zbatimi i Strategjisë së Biznesit 2018-2020 duke përmbushur disa objektiva kryesorë siç janë zhvillimi i mëtejshëm i procedurave dhe proceseve për të rritur mbledhjen e detyrimeve; implementimi i shërbimit duke u orientuar ndaj administratës dhe rritja e bashkëpunimit; kontributi për sigurinë dhe mbrojtjen; përmirësimi dhe modernizimi i

organizatës; përmirësimi i profesionalizmit dhe cilësisë së punës së punonjësve; përmirësimi i sistemeve dhe platformave të TI.

II.1. Legjislacioni doganor

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Në përgjithësi, Administrata Doganore Shqiptare ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA.

Sistemi doganor në Shqipëri mbështetet në politikat si më poshtë vijon:

- Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010-2025;
- Strategjia ndër-sektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020, miratuar me VKM Nr. 663, datë 17.7.2013;
- Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014 -2020;
- Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore 2018-2020.

Sa i përket kuadrit ligjor, Ligji Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” është pjesërisht i përafruar me Rregulloren Nr. 952/2013 “Kodi Doganor i Bashkimit” si dhe bazohet në një sërë aktesh të tjera evropiane që rregullojnë elementë specifikë doganorë. Kodi i Ri Doganor ka hyrë plotësisht në fuqi në qershor 2017. Gjithashtu, është miratuar VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, duke e çuar shkallën e përafrimit të legjislacionit doganor shqiptar në hapat e BE-së. Përmes kësaj VKM janë bërë një sërë përmirësimesh, lehtësime e thjeshtime të rregullave dhe procedurave doganore, duke synuar kështu përshtatjen dhe ecjen paralelisht me zhvillimet e tregtisë ndërkombëtare si dhe me nevojat e operatorëve ekonomikë. Vendimi erdhi si domosdoshmëri për zbatimin e dispozitave të reja të Kodit të ri Doganor për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, procedurat e thjeshtuara, regjimet dhe procedurat doganore, përjashtimet nga detyrimet, duke përafruar disa akte të BE-së.

Akte të tjera ligjore, të përfshira në çështjet doganore, janë:

- Ligji Nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përafron pjesërisht disa akte të BE-së;
- Më 1 janar 2018, ka hyrë në fuqi VKM Nr. 799, datë 29.12.2017 “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2018”. Ky akt përafron pjesërisht rregulloren përkatëse të BE-së;
- Përmes VKM nr. 1090, datë 28.12.2015 “Për mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në doganë” janë përafruar pjesërisht Rregullorja Nr. 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës të datës 12 Qershor 2013, në lidhje me zbatimin në doganë të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1383/2003, si dhe Rregullorja e Komisionit Nr. 1352/2013, të datës 4 dhjetor

2013,”Për vendosjen e formularëve të parashikuar në Rregulloren Nr. 608/2013, duke unifikuar procedurat e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Doganën Shqiptare me ato të Bashkimit Evropian. Tashmë këto dispozita janë të përfshira në VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Mbi dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

Administrata Doganore Shqiptare përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nga Degët Doganore. Ajo varet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe është nën mbikëqyrjen e saj. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka si mision të saj sigurinë e tregjeve dhe të popullatës (mbrojtja e konsumatorëve, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e kufijve kombëtare) nëpërmjet mbikëqyrjes efikase nga doganat dhe bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit; mbledhjen e detyrimeve dhe akcizës; krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e biznesit, nëpërmjet aplikimit të metodave moderne të punës.

Autoritetet doganore janë përgjegjëse për kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor për mallrat në hyrje dhe në dalje të territorit doganor shqiptar, parandalimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabandë, shkeljeve dhe trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara, konstatimin dhe verifikimin e shkeljeve doganore, përgatitjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare në fushën e doganave, mbikëqyrjen dhe kontrollin e mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit të autoriteteve doganore, etj.

II.1.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.1.3.1. Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.1.3.2. Masat ligjore të parashikuara

Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2019” do miratohet në tremujorin e fundit të 2018, pjesërisht në përputhje me Rregulloren e Këshillit 2658/87/EEC datë 23 korrik 1987. Me miratimin e këtij akti ligjor bëhet e mundur harmonizimi i kodeve tarifore me përshkrimet e Kodeve të Bashkimit Evropian.

Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave përditësohet çdo vit nga Administrata Doganore dhe data e hyrjes në fuqi është gjithmonë 1 janar. I njëjti akt ligjor i përditësuar planifikohet të miratohet për vitet 2019 dhe 2020.

III. Alokimet Financiare

III.1 Buxheti

Në 000/lekë

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit përgjegjës	3.537.227	3.428.220	3.428.220
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera kontribuuese	0	0	0
Buxheti total i kapitullit	3.537.227	3.428.220	3.428.220

KAPITULLI 30: Marrëdhëniet me Jashtë

I.1 Përmbajtja e Kapitullit

I.1.1. Përmbledhja e acquis së BE-së

Legjislacioni në fushën e politikës së përbashkët tregtare përbëhet kryesisht nga zbatimi i drejtpërdrejtë i legjislacionit të BE-së, i cili nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar.

Acquis në këtë fushë është produkt kryesisht i angazhimeve tregtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të Bashkimit Evropian si dhe i një sërë masash autonome tregtare. Në fushën e kredive të eksportit dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, disa elementë të acquis kërkojnë përgatitje më të hershme për të pasur një administratë plotësisht të aftë që nga dita e anëtarësimit. Vendeve kandidate u kërkohet të harmonizojnë në mënyrë graduale politikat tregtare ndaj vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare, me politikat dhe qëndrimet e miratuara nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij, në mënyrë që të jenë në gjendje të zbatojnë politikën e përbashkët tregtare të BE-së në datë e anëtarësimit. Në fushën humanitare dhe të zhvillimit tregtar, Shtetet Anëtare duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe me angazhimet ndërkombëtare të BE-së si dhe të sigurojnë kapacitetet për të marrë pjesë në zhvillimet dhe politikat humanitare të Bashkimit Evropian.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70-të i MSA-së, dispozitë nga e cila Shqipëria ka jo vetëm detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me legjislacionin e BE-së, por edhe të sigurohet që ajo të zbatohet. Marrëveshja Stabilizim-Asociimit (MSA) përfshin një titull kryesor mbi tregtinë e lirë mes Shqipërisë dhe BE-së. Ajo përfshin dispozita në disa fusha që kërkojnë se palët duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e OBT-së ose të detyrimeve ndërkombëtare. Detyrimet e Shqipërisë sipas përcaktimeve të MSA-së për politikën tregtare në mënyrë të përmbledhur janë nenet relevante të MSA-së për këtë kapitull, si: 7, 16, 19, 20, 21, 25, 26, 27, 28, 29, 33, 34, 40, 59, 60, 70, 71, 72, 73, 74, 97.

I.2. Situata Aktuale/Përmbledhje

Në lidhje me Politikën e Përbashkët Tregtare (PPT), Shqipëria koordinon pozicionet dhe i harmonizon politikat e saj me ato të BE-së, duke përfshirë dhe Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT).

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë që nga shtatori i vitit 2000 dhe politika e saj tregtare ndjek parimet dhe rregullat e kësaj organizate si dhe të gjitha zhvillimet në OBT duke rregulluar periodikisht legjislacionin e saj në përputhje me parimin e transparencës.

Përveç parimeve të OBT-së, Shqipëria respekton rregullat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian, CEFTA, EFTA dhe Turqinë. Ajo merr pjesë aktive në CEFTA duke u angazhuar në Samitin e 6-të të Ballkanit Perëndimor mbajtur në Trieste për zbatimin e planit të veprimit shumëvjeçar për zhvillimin e Zonës Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor, i cili do të thellojë dhe zgjerojë integrimin ekonomik brenda rajonit, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së.

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së mallrave me përdorim të dyfishtë", i cili synon të transpozojë plotësisht Aneksin 1 të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2017/2268 të datës 26 shtator 2017 për ndryshimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 428/2009 për krijimin e një regjimi të Komunitetit për kontrollin e eksporteve, transferimin, ndërmjetësimin dhe tranzitimit të artikujve me përdorim të dyfishtë (Rifreskimi), është dorëzuar në ministrinë e linjës për miratimin e tij. Projekt-vendimi është planifikuar të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2019.

Legjislacioni që ka të bëjë me Rregulloren e BE-së në lidhje me tregtinë e mallrave të caktuara të cilat mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën ose trajtimin ose dënimin tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues, nuk është transpozuar ende.

Kapacitetet administrative duhet të forcohen më tej. Fokusi kryesor është rritja e njohurive të administratës publike për një politikë të përbashkët tregtare, thjeshtimi i instrumenteve dhe koordinimi i politikës tregtare në mënyrë që të përputhet me politikën e përbashkët tregtare të BE.

Në fushën e politikës së zhvillimit dhe të ndihmës humanitare, Shqipëria nuk ka një kuadër politik ose ligjor, si dhe asnjë institucion apo njësi specifike për menaxhimin e ndihmës për zhvillim apo ndihmave humanitare. Ai siguron ndihmë humanitare vetëm në baza ad-hoc përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore të rënda ose situatave të jashtëzakonshme humanitare. Kjo ndihmë jepet drejtpërdrejtë në mbështetjen përkatëse të buxhetit të shtetit.

I.3. Prioritetet

Në fushën e Politikës së Përbashkët Tregtare, prioritetet janë:

- zbatimi i planit kombëtar të veprimit për koordinimin dhe lehtësimin e politikave tregtare;
- miratimi i legjislacionit përkatës në fushën e kontrollit të eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë;

- pjesëmarrja në marrëveshjen shumëpalëshe të kontrollit të eksportit në marrëveshjen “Wassenaar”;
- forcimi i kapaciteteve administrative të stafit që merret me tregtinë me BE dhe Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- të punohet brenda kuadrit të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), në veçanti me qëllim zbatimin e mirë të planit shumëvjeçar të Samitit të 6 të Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e një Zonës Ekonomike Rajonale (REA) në Ballkanin Perëndimor.

Në fushën e zhvillimit të bashkëpunimit dhe ndihmës humanitare, prioritet është miratimi i një dokumenti të politikës për të trajtuar çështjet e krijimit të strukturës strategjike, ligjore dhe institucionale në mënyrë që të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së.

II.1. Politika e përbashkët tregtare

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë nga shtatori i vitit 2000 dhe politika tregtare ndjek parimet dhe rregullat e kësaj organizate. Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj të brendshëm me atë të BE-së në fushën e importit të mallrave, ndihmës shtetërore, prokurimit publik, aviacionit civil, subvencioneve, etj, në përputhje me angazhimet e saj në këtë organizatë.

Komiteti Kombëtar për Koordinimin dhe Lehtësimin e Politikave Tregtare (KKKLPT) u krijua me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 80, datë 12.05.2016, i ngarkuar për të koordinuar politikat tregtare në nivel kombëtar. Ministri i Financave dhe Ekonomisë miratoi rregulloren e brendshme për funksionimin e KKKLPT me Urdhër Nr. 1092 të datës 8.02.2017. Për më tepër, Plani Kombëtar për Koordinimin e Politikave Tregtare dhe Lehtësimin e Tregtisë 2017 - 2020, është miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 1213 të datës 14.02.2017.

Sekretariati teknik i KKKLPT është ngritur dhe është plotësisht funksional. Përveç kësaj, është përgatitur raporti i monitorimit mbi Lehtësimin e Tregtisë.

Gjatë vitit 2018, janë organizuar katër takime të Komitetit Kombëtar Koordinimin dhe Lehtësimin e Politikave Tregtare (KKKLPT), ku janë diskutuar çështje të ngritura nga komuniteti i biznesit si inventarizimi i tarifave dhe pagesave për importet dhe eksportet; problemet e eksportit të qumështit të Shqipërisë drejt Maqedonisë.

Shqipëria tashmë po zbaton marrëveshjen e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e MSA-së) midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendeve të Evropës Lindore (CEFTA 2006),

vendeve të EFTA-s dhe Turqisë. Shqipëria ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në mënyrë konstruktive në të gjitha takimet dhe aktivitetet e CEFTA-s.

Protokolli Shtesë 5 për lehtësimin e tregtisë është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 18/2018, datë 5.4.2018 “Për ratifikimin e Protokollit shtesë 5 të Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore”. Negociatat mbi liberalizimin e tregtisë në shërbime janë përfunduar në nivel teknik. Protokolli Shtesë 6 pritet të miratohet gjatë vitit 2019, ndërsa në lidhje me Protokollin Shtesë 7 të gjitha Palët e CEFTA-s kanë rënë dakord të fillojnë negociatat. Shqipëria ka krijuar grupin negociator me urdhër të Kryeministrit Nr.144, datë 24.9.2018. Pritet të zhvillohet takimi i parë i grupit negociator për AP7 gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 në kuadër të kryesisë së Shqipërisë së Marrëveshjes CEFTA.

Për kontrollet e eksportit për artikujt me përdorim të dyfishtë, korniza ligjore përbëhet nga:

- Ligj Nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” është përafruar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 428/2009 datë 5 maj 2009, “Mbi vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe tranzitit të mallrave me përdorim të dyfishtë”, të ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 703, datë 12.10.2016 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import eksporteve” i cili miraton listën e re të mallrave me përdorim të dyfishtë të përcaktuar nga Rregullorja e Deleguar e Komisionit Rregullator (EU) 2016/1969 të datës 12 shtator 2016 që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 428/2009 për krijimin e regjimit të Komunitetit për kontrollin e eksporteve, transferimin, ndërmjetësimin dhe transitin e artikujve me përdorim të dyfishtë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.43, datë 16.01.2008 "Për Themelimin, Funksionimin dhe Statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksportit", i ndryshuar;

Në lidhje me marrëveshjet dypalëshe të bashkëpunimit ekonomik dhe teknik, Shqipëria ka nënshkruar mbi 42 marrëveshje / memorandume bashkëpunimi ekonomik dhe teknik, me vende të ndryshme si Arabia Saudite, Argjentina, Austria, Belgjika, Greqia, Hungaria, Izraeli, Japonia, Katari, Kina, Kroacia, Koreja e Jugut, Kuvajti, Libia, Rumania, Rusia, Serbia, Sllovenia, Sllovakia, Suedia; Turqia, Ukraina, Uruguai, SHBA dhe Zvicra.

Shqipëria së fundi, ka miratuar dhe nënshkruar disa Marrëveshje dhe Memorandume, Bashkëpunimi ekonomik e teknik specifikisht:

- Memorandumi “Mbi bashkëpunimin ekonomik” midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Italisë, miratuar, nënshkruar dhe hyrë në fuqi më 19.02.2018;
- Protokolli i Komisionit të Bashkëpunimit Ekonomik Shqipëri-Çeki miratuar, nënshkruar dhe hyrë në fuqi më 22 shkurt, 2018;

- Marrëveshje midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Qeverisë Federale të Republikës së Gjermanisë për bashkëpunimin teknik të projektit "Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe bashkëpunimi rajonal, promovimi i punësimit dhe financimi i VET – pjesa e II ", ratifikuar me ligjin Nr. 11/2018 dhe miratuar më 5 mars 2018;
- Protokolli i Komisionit të Përbashkët ndërqeveritar “Për bashkëpunimin ekonomik” Austri-Shqipëri”, miratuar, nënshkruar dhe hyrë në fuqi më 11 prill 2018;
- Protokolli i Komisionit të Përbashkët ndërqeveritar “ Për bashkëpunimin ekonomik” Shqipëri-Kroaci miratuar, nënshkruar dhe hyrë në fuqi më 15 maj 2018;
- Rregullore mbi Komisionin Shqipëri-Ukrainë, miratuar në parim në 23 qershor 2018 e cila pritet të nënshkruhet gjatë zhvillimit të Sesionit të Komisionit të Përbashkët Ekonomik me Ukrainën, që parashikohet të zhvillohet në pranverën e vitit 2019;
- Protokolli i Komitetit të Përbashkët për bashkëpunimin ekonomik, shkencor, teknik Shqipëri-Rumani, miratuar, nënshkruar dhe hyrë në fuqi në 9 nëntor 2018;
- Marrëveshja “Mbi Bashkëpunimin Ekonomik” midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr. 373 datë 31.12.2018.

Gjithashtu kanë filluar përgatitjet për disa Sesione Ekonomike si me Ukrainën dhe Egjiptin.

Shqipëria ka përfunduar 45 marrëveshje dypalëshe të investimeve BITS, nga të cilat 23 janë nënshkruar me Shtetet Anëtare të BE-së. Vendet me të cilat Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje për promovim dhe mbrojtje reciproke të investimeve janë: Austria, Azerbajxhani, BLEU (Bashkimi Ekonomik Belgjikë-Luksemburg), Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kina, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Egjipti, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Izraeli, Italia, Koreja, Kuvajti, Lituania, Maqedonia, Malajzia, Malta, Moldavia, Holanda, Polonia, Portugalia, Katari, Rumania, Federata Ruse, Spanja, Suedia, Zvicra, Tunizia, Turqia, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vendi ka vazhduar të përmirësojë marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare me disa shtete, duke nënshkruar "Marrëveshjet për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve" me Kosovën dhe Iranin, të cilat ende nuk janë në fuqi, ndërsa është në proces negociimi të disa "Marrëveshje për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve" si me Republikën Sllovaqe, Kanadanë dhe Arabinë Saudite.

Me mbështetjen e GIZ-it, është kryer një analizë e të gjitha BIT-seve ekzistuese me qëllim identifikimin e mospërputhshmërisë me politikën e BE-së në këtë fushë dhe planifikimin e përfarimit të duhur.

Një draft plan për Kapitullin 30 u finalizua me mbështetjen e GiZ, i cili siguron një bazë të mirë për të siguruar harmonizimin e politikave, rritjen e kapaciteteve administrative dhe koordinimin dhe ndjekjen e përafrimit të legjislacionit. Grupi Ndërinstitucional i Punës për Kapitullin 30 ka diskutuar gjerësisht Planin e Punës në mbledhjet e tij mujore. Plani i i Punes përmban gjithashtu edhe një Plan Veprimi me aktivitete dhe afate të caktuara kohore që do të zbatohen nga institucionet.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (si përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e politikave tregtare në Shqipëri) ;
- Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Banka e Shqipërisë;
- Autoriteti i Konkurrencës;
- Agjencia e Prokurimit Publik;
- Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave Tregtare;
- Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; dhe çdo ministri apo institucion që ndikon në tregti.

II.1.3. Masa të planifikuara 2019 – 2021

II. 1.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019 – 2021

Nuk ka politika të planifikuara.

II. 1.3.2. Masa ligjore të planifikuara 2019 – 2021

Projektligji për "Për tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime ç'njerëzore, ose degraduese", i cili synon të transpozojë pjesërisht Rregulloren e BE (1236/2005) e 7 Qershorit 2005 “Në lidhje me tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime ç'njerëzore, ose degraduese” është planifikuar të miratohet në tremujorin e 4-t, 2020.

Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve” i cili synon të përafrojë plotësisht Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2017/2268 të datës 26.9.2017 e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit të (KE) Nr. 428/2009

e cila krijon regjimin e komunitetit për kontrollon e eksporteve, transferimin, ndërmjetësimin dhe transitin e mallrave me përdorim të dyfishtë, do të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2019.

II. 1.3.2. Masa të tjera të planifikuara

Nuk ka masa të planifikuara

II.2. Politikat e zhvillimit dhe ndihmës humanitare

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Këshilli i Ministrave merr ad-hoc, rast-pas-rasti vendime për të dhënë kontribute në raste të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndryshime legjislative në politikën e zhvillimit dhe të ndihmës humanitare, të cilat mbeten në një fazë të hershme të harmonizimit. Nuk ka ndonjë zë buxhetor të veçantë dedikuar ndihmës humanitare ose agjenci për administrimin e ndihmës humanitare. Sa i përket ndihmës humanitare, Ligji Nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit” përcakton dispozitat në këtë fushë.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është duke punuar për ngritjen e strukturave në kuadër të ndihmës humanitare. Në bashkëpunim me projektin GIZ “Harmonizimi i legjislacionit ekonomik dhe tregtar të Shqipërisë me acquis e BE-së”, do të përcaktohet institucioni dhe struktura përgjegjëse për ndihmën humanitare. Në këtë aspekt, do të studiohet eksperiencia e Republikës së Kroacisë në lidhje me këtë fushë. Njëkohësisht do të përpunohet gradualisht edhe modeli i koordinimit dhe metodologjitë përkatëse.

II.2.2. Institucionet përgjegjëse

- Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Zyra e Kryeministrit
- Institucione të tjera që do të përcaktohen me dokumentin strategjik

II.2.3. Masa të Planifikuara 2019 – 2021

II. 2.3.1. Kuadri i politikave të planifikuara 2019- 2021

Nuk ka politika të planifikuara

II.2.3.2. Masa ligjore të planifikuara 20 - 2021

Nuk ka masa të planifikuara

II. 2.3.3. Masa të tjera të planifikuara

Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme do të ngrejë një grup pune për të adresuar çështjet në këtë fushë. Grupi i punës do të hartojë së pari një plan veprimi që të përmbajë: planet për hartimin e dokumentit strategjik dhe kornizës ligjore, që do të hartohet në korrelacion me buxhetin e shtetit, planifikimin e ngritjes së strukturës duhur institucionale, anëtarësimin në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së (duke përfshirë skemën dhe rrjetin e organizmave të përfshirë), etj.

Me mbështetjen e projektit GIZ "Harmonizimi i legjislacionit ekonomik dhe tregtar shqiptar me acquis të BE-së" dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, një nga anëtarët e Grupit të Punës do të përfshihet në masat për ngritjen e kapaciteteve (praktikë - deri në 3 javë) për të fituar përvojë relevante në një nga vendet e rajonit për të lehtësuar punën e përgjithshme që duhet të bëhet nga Grupin e Punës.

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

ALL

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit koordinues	0	0	0
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve kontribuese	70000	0	0
Buxheti total i kapitullit	70000	0	0

Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes

I.1 Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e acquis e BE-së

Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë (CFSP) dhe politika e përbashkët e sigurisë dhe e mbrojtjes (CSDP) bazohen në akte ligjore, të cilat përfshijnë marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme dhe dokumentet politike. Acquis përbëhet nga deklaratat politike, vendime dhe marrëveshje. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të mbështesin dialogun politik në kuadër të CFSP-së, të bashkohen me deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në vendimet e BE-së dhe të zbatojnë sanksione dhe masa kufizuese të dakordësuara.

Shqipëria vazhdon harmonizimin e saj me acquis në fushën e politikës së jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes. Shqipëria mbështet fuqishëm politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së, e cila synon forcimin e rolit të BE-së si entitet politik me ndikim gjithnjë e më rritje në politikat ndërkombëtare.

Samiti i Selanikut, i zhvilluar në qershor 2003, konfirmoi një perspektivë të qartë evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor. Që nga janari 2004, Shqipëria i është bashkuar qëndrimeve të Bashkimit Evropian në fushën e CFSP. Për më tepër, Shqipëria ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në misionet ushtarake të BE-së të ndërmarra në kuadër të CFSP-së.

Shqipëria po zhvillon një dialog intensiv politik me institucionet e Bashkimit Evropian dhe Vendet Anëtare të tij. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) më 1 prill 2009, dialogu politik institucional me BE-në u mbajt në kuadër të takimeve të Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Komitetit të Stabilizim Asociimit dhe gjashtë nënkomiteteve, si dhe në kuadër të Komitetit Ndërparlamentar ndërmjet Parlamentit Evropian dhe Parlamentit Shqiptar.

Shqipëria aplikoi për anëtarësim në BE në 2009 dhe në qershor 2014 mori statusin e vendit kandidatit. Me këtë rast, Këshilli konfirmoi pesë prioritetet kyçe që Shqipëria duhet të përmbushë për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Dialogu politik po zhvillohet në mënyrë intensive në disa nivele midis institucioneve shqiptare dhe atyre të BE-së për përmbushjen e kritereve të përcaktuara për marrjen e këtij hapi, veçanërisht në kuadrin e Dialogut të Nivelit të Lartë BE-Shqipëri mbi Pesë Prioritetet Kyçe dhe pesë Grupeve të Përbashkëta të Punës me Komisionin Evropian mbi pesë prioritetet.

Duke pranuar dhe vlerësuar progresin e qëndrueshëm në përmbushjen e pesë prioriteve kyçe, Komisioni Evropian, në Paketën e Zgjerimit të vitit 2016 rekomandoi që negociatat e anëtarësimit për Shqipërinë duhet të hapen, në varësi të rezultateve të pritshme të reformës në drejtësi dhe në veçanti të ligjit për vetting-un.

Gjendja e çështjes së integrimit Evropian të Shqipërisë po diskutohet gjithashtu në nivel dypalësh me Vendet Anëtare të BE-së gjatë vizitave të nivelit të lartë.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar për informacionin e klasifikuar me atë të Bashkimit Evropian rrjedh nga neni 70 i MSA-së.

Përsa i përket Armëve të Shkatërrimit në Masë, strategjia e BE-së thekson rëndësinë e të vepruarit me qëllim zgjidhjen, parandalimin, frenimin, ndalimin dhe eliminimin e programeve të shtimit dhe shumimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe raketave. BE është e angazhuar në sistemin e traktatit shumëpalësh, i cili siguron bazën ligjore dhe normative për të gjitha përpjekjet për mosshumimin e armëve të shkatërrimit në masë. Politika e BE-së synon të ndjekë zbatimin dhe universalizimin e normave ekzistuese të çarmatimit dhe mosshumimit të armëve. Për këtë qëllim, ne do të ndjekim universalizimin e NPT, marrëveshjeve të Mbrojtjes të IAEA dhe protokolleve shtesë të tyre, CWC-së, BTWC-së, HCOC-së si dhe hyrjen e hershme në fuqi të CTBT-së. Politika e BE-së synon të punojë drejt përcaktimit të ndalimit të armëve biologjike dhe kimike si rregulla universale të së drejtës ndërkombëtare. Politika e BE-së synon të arrijë një marrëveshje ndërkombëtare për ndalimin e prodhimit të materialit të zbërthyeshëm për armë bërthamore ose pajisje të tjera shpërthyes bërthamore. BE do të ndihmojë vendet e treta në përbushjen e detyrimeve të tyre sipas konventave dhe regjimeve multilaterale.

I.2 Gjendja aktuale / Përmbledhje

Shqipëria ka një nivel të mirë të përgatitjes. Progres është bërë nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të sigurisë së objekteve për ruajtjen e armatimeve dhe municioneve. Komisioni i sapoformuar për Armët e Vogla dhe të Lehta (SALW) është tashmë funksional. Po ashtu, Shqipëria vijoi pjesëmarrjen në misionet e menaxhimit të krizave ushtarake duke u linjësuar me qëndrimet e BE-së.

Dialogu i rregullt politik midis BE-së dhe Shqipërisë për çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë vijon.

Për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, Shqipëria mbështet Strategjinë Globale për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian. Shqipëria është linjësuar në të gjitha rastet kur i është kërkuar me të gjitha deklaratat e BE-së dhe vendimet e Këshillit.

Shqipëria vijoi të angazhohej në mënyrë aktive me organizatat ndërkombëtare. Mbajti një prani të fuqishme në një numër misionesh të NATO-s, duke përfshirë edhe disa misione strategjike për BE-në (p.sh. Grupi Detar i NATO-s në Detin Egje i cili kontribuon në përpjekjet evropiane për të adresuar krizën e emigracionit/refugjatëve).

Vizioni i politikës së jashtme të Shqipërisë bazohet në ndërtimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe, të karakterizuara nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Për të zbatuar këtë orientim të politikës së jashtme, Shqipëria ka mbajtur një rol gjithnjë e më aktiv në favor të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë.

Republika e Shqipërisë konsideron se bashkëpunimi dhe zotimi rajonal nuk janë vetëm parakushtet e integritetit evropian, por edhe nevojat aktuale për të transformuar imazhin e rajonit tonë. Ky orientim i politikës së jashtme të Shqipërisë pasqyrohet në pjesëmarrjen proaktive në të gjitha iniciativat dhe organizatat shumëpalëshe që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore dhe më gjerë. Shqipëria mban selinë e Fondit të Ballkanit Perëndimor, iniciativë e mbështetur nga Fondi Ndërkombëtar i Vishegradit.

Selia e Fondit është në Tiranë dhe një diplomat shqiptar është emëruar si Drejtor Ekzekutiv. Si vendi që pret këtë iniciativë, Republika e Shqipërisë ka mundësuar që zyrat të jenë funksionale.

Shqipëria u bashkua me iniciativën e Bashkëpunimit të Përmirësuar në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit (ECSAP), i cili do të sigurojë mbështetje politike për procesin e bashkëpunimit rajonal në kuadrin e PSA, duke u fokusuar në fushën e sundimit të ligjit, qeverisjes ekonomike dhe konektivitetit.

Shqipëria është një përkrahëse e përkushtuar e 'Procesit të Ballkanit Perëndimor 6' (WB6) dhe është e angazhuar plotësisht në këtë nismë, veçanërisht në agjendën e konektivitetit. Në mars të vitit 2016, Shqipëria organizoi një takim të WB6, ku vendet e rajonit shqyrtuan gjendjen e projekteve të konektivitetit rajonal dhe zbatimin e masave të buta për transportin dhe energjinë, të përcaktuara në Konferencën e Vjenës përpara Samitit të Parisit. Takimi gjithashtu propozoi një agjendë gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit për krizën e refugjatëve, duke vënë theksin në zgjerimin e mëtejshëm të partneritetit të Ballkanit Perëndimor me BE-në mbi migracionin. Puna filloi me krijimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor, dy nisma të cilat do të kenë selinë e tyre në Tiranë. Këto çështje janë ndjekur dhe avancuar më tej në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Paris, më 4 korrik 2016.

Përmirësimi i perspektivës së gjeneratave të reja është me rëndësi të madhe në sigurimin e stabilitetit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe progresit.

Për të rritur bashkëpunimin e qëndrueshëm rajonal mes të rinjve dhe për të krijuar marrëdhënie të mira ndërmjet popullatës në moshë të re të vendeve të Ballkanit Perëndimor, këto vende nënshkruan marrëveshjen për krijimin e një Zyre Rajonale për Bashkëpunim Rinor të Ballkanit Perëndimor (RYCO) me ndihmën e Zyrës Rinore Franko-Gjermane. Dokumenti themelues u nënshkrua nga Kryeministrat gjatë Samitit të Ballkanit Perëndimor në Paris, në 4 korrik 2016. Selia e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit për Rininë do të jetë në Tiranë.

RYCO do të synojë:

- Promovimin e vlerave demokratike dhe diversitetit;

- Rritjen e bashkëpunimit rajonal të qëndrueshëm midis të rinjve dhe krijimin e marrëdhënieve të reja midis të rinjve në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
- Nxitjen e pajtimit dhe qasjes konstruktive ndaj së shkuarës;
- Mësim ndërkulturor;
- Rritjen e mobilitetit rajonal, qytetarisë aktive dhe pjesëmarrjes së të rinjve;
- Nxitjen e frymës evropiane të bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe tolerancës.

Shqipëria vijoi pjesëmarrjen aktive në misionet e menaxhimit të krizave ushtarake nën politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes, veçanërisht EUFOR Althea në Bosnje-Hercegovinë dhe EUTM Mali.

Shqipëria do të vazhdojë të sigurojë koordinimin dhe bashkëpunimin në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, në mënyrë që të zvogëlojë maksimalisht rrezikun e terrorizmit, duke përmirësuar elementët e sigurisë dhe duke rritur besimin e komunitetit me masa parandaluese kundër akteve terroriste dhe fenomenit të terrorizmit.

Shqipëria ka bërë përparim të mëtjeshëm në zbatimin e planit të veprimit për shkatërrimin e armëve të tepërta. Spastrimi i pikave të kontaminuara me municione të pashpërthyera po vazhdon. Shkatërrimi i grumbullit të fundit i 1987 AVL-ve u finalizua në tetor të vitit 2016. Përmirësimi i sigurisë së objekteve të magazinimit të armëve dhe municioneve në Qafë Mollë përfundoi në dhjetor të vitit 2016. Punonjës të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Policisë së Shtetit i janë nënshtruar trajnimeve të specializuara për sigurinë fizike të armatimeve dhe municioneve dhe për menaxhimin e stoqeve. Përmirësimi i sigurisë së magazinës qendrore të armatimeve të Policisë së Shtetit dhe dy dhomave të provave në komisaritet kryesore të policisë pritet të përfundojë brenda vitit 2018.

Regjistri online i armëve dhe municioneve është i instaluar, aktualisht, në komisaritet e policisë në të gjithë vendin dhe personeli përkatës është trajnuar për përdorimin e software-it të tij. Në qershor të vitit 2017, qeveria nënshkroi vendimin për formimin e Komisionit ndërministror të AVL-ve, me detyrën e koordinimit dhe monitorimit të të gjitha aktiviteteve të lidhura me kontrollin e AVL-ve në vend. Komisioni Kombëtar i AVL-ve është funksional tashmë. Në shkurt të vitit 2018, Shqipëria kontribuoi në miratimin unanimit të një deklaratë të përbashkët rajonale të zëvendësministrave të punëve të brendshme dhe të jashtme të Evropës Juglindore, duke forcuar përkushtimin e saj ndaj kontrollit të AVL-ve në rajon.

I.3. Prioritetet

Objektivi është që të përmbushen plotësisht kërkesat e acquis në fushën e politikës së jashtme, të sigurisë së përbashkët si dhe të mbrojtjes, në të ardhmen e afërt. Prioritet i Shqipërisë është harmonizimi me politikat e BE-së në fushën e CFSP-së.

Shqipëria ka vazhduar harmonizimin e saj me *acquis* në këtë drejtim. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të kompletuar regjistrin online të armëve dhe municioneve të cilat janë nën menaxhimin e Policisë së Shtetit. Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e politikës së jashtme, sigurisë dhe të mbrojtjes mbeten në rrugën e duhur.

Shqipëria duhet të finalizojë punën për një strategji të bazuar në prova mbi AVL-të; të vazhdojë përmirësimin e sigurisë së objekteve të magazinimit të armatimeve dhe municioneve dhe të krijojë një Pikë Kryesore të Armëve të Zjarrit në Policinë e Shtetit.

II.1 Dialogu politik

II.1.1 Politika dhe kuadri ligjor

Integrimi evropian i Shqipërisë konsiderohet si një objektiv strategjik dhe një garanci për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin në rajon e më gjerë. Në këtë kuadër, Shqipëria është e gatshme të ndërmarrë të gjitha reformat e nevojshme lidhur me procesin e integritit evropian, me qëllim hapjen e negociatave për anëtarësim.

Shqipëria po mban një dialog intensiv politik me Bashkimin Evropian dhe Vendet Anëtare të tij. Ky dialog po vazhdon në kuadër të Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe strukturave të tjera të përbashkëta në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA).

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

- Këshilli i Ministrave
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEFA)

II.1.3 Veprimet e planifikuara për 2019-2021

II.1.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

N/A

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara

N/A

II.1.3.3 Veprime të tjera të planifikuara

N/A

II.2 Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët

II.2.1 Politika dhe kuadri ligjor

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

- Këshilli i Ministrave
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEFA)
- Ministria e Mbrojtjes

II.2.3 Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.2.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

N/A

II.2.3.2 Masat ligjore të planifikuara

II.2.3.3 Veprime të tjera të planifikuara

N/A

II.3 Mospërhapja

II.3.1 Politika dhe kuadri ligjor

Shkatërrimi i municioneve të tepërta

Bazuar në Direktivën e Ministrit të Mbrojtjes për vitin 2017 si dhe në urdhrat e Ministrit të Mbrojtjes Nr. 110, datë 30.01.2018 dhe Nr.720, datë 24.05.2018 “Për asgjësimin industrial dhe asgjësimin me plasje në poligonet e miratuara hotspot dhe municioneve të hequra nga armatimi

dhe përdorimi në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Ministria e Mbrojtjes ka çmilitarizuar municione tepër të dala nga Tabela e Organizimit dhe Pajisjeve të Forcave të Armatosura pas vitit 2018, si rrjedhojë e modernizimit të Forcave të Armatosura dhe municioneve të mbledhura nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Gjatë vitit 2018, 34.394 ton municione të tepërta janë shkatërruar.

Programi i pastrimit të pikave hotspot të armëve të pashpërthyera (UXO)

Nga viti 2016 deri në nëntor 2018 një sipërfaqe prej 560.000 m² është pastruar nga municionet në shtatë zona të ndryshme si: Laç, Klos, Kordhoc, Picar, Jub-Sukth dhe Selixe. Në total 439.734 mjete shpërthyes të rrezikshme që përfshijnë municione artilerie, diegore, granata dore, predha kundër tanke, municione të armëve të vogla janë gjetur dhe shkatërruar në këto hotspote. Toka e pastruar në gjashtë hotspote me municione në Laç, Klos, Kordhoc, Picar, Suç dhe Selixe është certifikuar nga zyra e AMMCO-s si e pastër nga municionet dhe i është dorëzuar autoriteteve lokale për përdorim të mëtejshëm. Plani për vitin 2019 është për të pastruar dy hotspotet: Jubë-Sukth Durrës dhe Sinanaj Tepelene nga organizata ndërkombëtare e pastrimit Norwegian People's Aid (NPA) e financuar nga SHBA si dhe nga dy ekipe të Kompanisë Xhenier të Forcave Tokësore në bashkëpunim me ekipet e Kompanisë së EOD-s (Explosive Ordnance Disposal) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Mospërhapja e Armëve të Dëmtimit në Masë (C-WMD)

Në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 79, datë 12.05.2016 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e strategjisë për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe planin e veprimit për zbatimin e tij", grupi ndërinstitucional i punës është ngritur. Ai drejtohet nga Zëvendësministri i Mbrojtjes. Grupi ka përgatitur draftin strategjisë për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe planin e veprimit kombëtar. Për këto dokumente, të gjitha institucionet kanë dhënë miratimin e tyre. Gjithashtu drafti strategjia është publikuar në faqen elektronike të Ministrisë së Mbrojtjes. Aktualisht, të gjitha institucionet e përfshira në proces janë ngarkuar me detyrën e përgatitjes së një parashikimi të përafërt të kostonë së zbatimit të planit të veprimit, përpara dërgimit të dy dokumenteve për miratim në Këshillin e Ministrave.

Armët e Vogla dhe të Lehta – AVL (SALW)

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të BE-së të datës 9 dhjetor 2013 dhe Strategjisë së BE-së për luftën kundër grumbullimit, magazinimit dhe trafikimit të jashtëligjshëm të Armëve të Vogla dhe të Lehta (SALW) dhe municioneve të paligjshmes dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr 69, datë 22.05.2017 “Për ngritjen e komisionit kombëtar për armët e vogla dhe të lehta”, i cili drejtohet nga Ministria e Brendshme, është ngritur dhe ka funksionuar Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare 2019 – 2024 dhe Planit të Veprimit 2019 – 2021 për

Armët e Vogla dhe të Lehta. Dokumentet i janë dërguar ministrive të linjës për mendim, përpara miratimit në Këshill të Ministrave, parashikuar brenda të miratohet brenda muajit nëntor 2018

Policia e Shtetit krijoi në vitin 2015 një regjistër elektronik kombëtar për të ruajtur të dhënat për të gjitha armët e vogla dhe të lehta në vend. Përmes mbështetjes së UNDP-së dhe SEESAC , që rrjedh nga Vendimi i Këshillit të BE-së 2013/730/CFSP, Policia e Shtetit ka instaluar këtë vit pajisje të TI-së, përfshirë 110 kompjuterë, 110 UPS, 60 printerë, 15 skanerë, një server dhe gjashtë pajisje switch në stacionet dhe drejtoritë e policisë në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, personeli i policisë është trajnuar në përputhje me përdorimin e bazës së të dhënave të regjistrit të armëve. Regjistri elektronik do të përmirësojë gjithnjë e më shumë kapacitetet kombëtare për të kontrolluar në mënyrë efektive dhe efikase posedimin dhe për të patur shënime të sakta për armët e vogla dhe të lehta në Shqipëri. Përveç kësaj, krijimi i këtij regjistri elektronik do të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe ekspertizës së rajonit të Evropës Juglindore, për të luftuar trafikimin dhe posedimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, duke zvogëluar në të njëjtën kohë kërcënimin për paqen, stabilitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Përveç kësaj, Drejtoria e Policisë së Shtetit ka përgatitur një plan për dhënien e "autorizimit të posedimit të armëve" dhe po bën përpjekje për t'i lëshuar këtë dokument të gjithë qytetarëve që posedojnë armë. Prodhimi i këtyre kartave elektronike do të konsistojë në grumbullimin e të dhënave nga regjistri elektronik i regjistrimit të armatimit. Nga ana tjetër, personalizimi i kartave të autorizimit të armëve do të përfshijë një sërë elementësh sigurie, si: me ose pa çip, hologramë, model guilloche, shkrim mikro-tekst, petëzim me fjalë dhe elementë sigurie, detaje të identifikimit të nxjerra nga regjistri elektronik i armatimit, etj. Ky projekt do të mundësojë kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të brezit në të gjithë vendin.

Sa i përket VKM-ve, në kuadër të Ligjit për Armët janë miratuar 6 VKM, të cilat në tërësi përbëjnë strukturën e plotë për administrimin e armëve të vogla dhe armë brezi në të gjithë Shqipërinë.

Në fushën e kontrollit të eksportit të mallrave dhe pajisjeve ushtarake, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes është struktura përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për mallrat me përdorim të dyfishtë. Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin Nr. 46/2018, datë 23.07.2018 "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", i cili përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 428/2009, datë 5 maj 2009, "Mbi vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe tranzitit të mallrave me përdorim të dyfishtë", të ndryshuar, Numri CELEX 32009R0428".

Gjithashtu, AKSHE ka përgatitur listën e mallrave me përdorim të dyfishtë, dhe ka dërguar për mendim në institucionet e linjës Projektvendimin "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve".

Ky projekt-akt, i cili përditësohet çdo vit, synon të transpozojë Shtojcën I të Rregullores së Deleguar nga Komisioni (BE) 2017/2268, datë 26 Shtator 2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 428/2009 për vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe tranzitit të sistemeve me përdorim të dyfishtë” si dhe Vendimin e Këshillit të BE-së “Lista e përbashkët ushtarake e Bashkimit Evropian” miratuar nga Këshilli më 26 shkurt 2018 (pajisje të mbuluara nga Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP që përcakton rregullat e përbashkëta që rregullojnë kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake).

II.3.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Brendshme

II.3.3 Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.3.3.1 Kuadrii Politikave të Planifikuara

N/A

II.3.3.2 Masat ligjore të planifikuara

N/A

II.3.3.3 Veprime të tjera të planifikuara

N/A

II.4 Organizatat ndërkombëtare

II.4.1 Kuadri politik dhe ligjor

Në kuadër të angazhimit të përbashkët të Iniciativës së Kartës SHBA-Karta e Adriatikut (A-5), për të kontribuar në sigurinë në Afganistan dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177 datë 25.02.2015 "Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura Shqiptare në Misionin Mbështetës të Përherëshëm (RSM), në Trajnimin Këshillimor-Trajnues, në kuadër të Iniciativës së Kartës së Adriatikut, në Afganistan, Forcat e Armatosura kanë vazhduar të

kontribuojnë me dy personel ushtarak, duke shërbyer në Qendrën e Situatave të Ndërgjegjësimit dhe të Rimëkëmbjes (SAROC) Komanda e Ndihmës Taktike dhe e Këshillimit në Veri në Mazari-Sharif.

Përveç kësaj, Ministria e Mbrojtjes është e angazhuar në iniciativën rajonale Ministeriali për Mbrojtjen i Evropës Juglindore (SEDM), i cili përfshin Iniciativën e Forcës Shumëkombëshe për Paqeruajtje në Evropën Juglindore (MPFSEE) dhe Brigadën e Evropës Juglindore (SEEBRIG) si dhe një sërë projektesh të tjera.

Në këtë kuadër, gjatë periudhës 2019 – 2021 Ministria e Mbrojtjes do të marrë drejtimin e kësaj iniciative i cili do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e rolit dhe vizibilitetit të vendit tonë në rajon.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në organizata rajonale

Organizata rajonale	Data e pranimit
Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECp)	1996
Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC)	27 shkurt 2008
Iniciativa e Evropës Qendrore (CEI)	1996
Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ/ BSEC)	25 qershor 1992
Nisma Adriatiko-Joniane (AII)	20 maj 2000
Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI)	2003
RACVIAC (Qendra Rajonale e Verifikimit të Armë- Kontrollit)	20 shtator 2000
SHBA - Karta e Adriatikut (A-5)	2 maj 2003
Fondi i Ballkanit Perëndimor (selia në Tiranë)	13 nëntor 2015
Task Forca Mjekësore e Ballkanit (BMTF)	Nëntor 2011
Iniciativa Rajonale Detare "ADRION"	20 maj 2000
Ministeriali i Mbrojtjes i Evropës Juglindore (SEDM)	1996

Pjesëmarrja e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare

Organizata ndërkombëtare	Data e pranimit
UN - Kombet e Bashkuara	14 dhjetor 1955
OSBE	20 qershor 1991
Këshilli i Evropës	13 korrik 1995
IAEA - Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike	29 korrik 1957
CTBTO - Organizata për Parandalimin Gjithëpërfshirës të Testeve Nukleare	1996
IOF - Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë	1999
UNAOC - Aleanca e Qyteteve të Kombeve të Bashkuara	2005
UNESCO - Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara	1958

IACA - Akademia Ndërkombëtare për Anti Korrupsionin	21 shtator 2011
Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior NATO	4 prill 2009

II.4.2 Institucionet përgjegjëse

- Këshilli i Ministrave
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme(MEFA)

II.4.3 Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.4.3.1 Kuadri i Politikave tëPlanifikuara

N/A

II.4.3.2 Masat Ligjore të planifikuara

N/A

II.4.3.3 Veprime të tjera të planifikuara

N/A

II.5 Masat e sigurisë

II.5.1 Kuadri politik dhe ligjor

Shqipëria ofron një kontribut proaktiv për paqen dhe stabilitetin dhe qëndron fuqishëm në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit dhe fenomenit të luftëtarëve të huaj terroristë. Shqipëria i është bashkuar në vitin 2014 Koalicionit Global kundër ISIL dhe ka përkrahur aleatët dhe partnerët që nga fillimi i luftës së përbashkët kundër terrorizmit ndërkombëtar. Si pjesë e përpjekjeve të këtij koalicioni, Shqipëria është renditur midis vendeve me kontribute konkrete. Në përpjekjet e saj për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe për të ndaluar fluksin e luftëtarëve terroristë, Shqipëria ka marrë masa konkrete legjislative, administrative dhe të sigurisë, për të parandaluar pjesëmarrjen e qytetarëve të saj në konflikte dhe luftëra jashtë kufijve. Në përputhje me kërkesat e Rezolutës së KS të OKB-së 2178 (2014), masa konkrete janë miratuar për përkufizimin si vepër penale të rekrutimit të luftëtarëve të huaj terroristë.

Masa të tilla antiterrorizëm janë paraprirë me krijimin e strukturave të specializuara me kapacitetet e duhura njerëzore dhe logjistike.

Objektivi ynë ka qenë i qartë, shkatërrimi i ISIL/Daesh dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet strategjive gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme kundër terrorizmit.

Shqipëria miratoi Strategjinë e Sigurisë Kombëtare në Korrik 2014 dhe Strategjinë Kombëtare për të luftuar Ekstremizmin e Dhunshëm, në nëntor 2015. Kjo strategji përfshin politikat për rehabilitimin dhe riintegrimin nëpërmjet paketave sociale, politike dhe ligjore, programeve arsimore dhe ekonomike, zhvillimin dhe promovimin e vlerave kulturore e fetare, si dhe angazhimin e shoqërisë civile.

Të vendosur për të arritur rezultate të matshme dhe për të shfaqur progres konkret, janë marrë masa për të shqyrtuar, zhvilluar dhe përmirësuar masat dhe mekanizmat ekzistues që lidhen me financimin e terrorizmit, duke përfshirë ngrirjen e aseteve, për t'iu përgjigjur kërcënimit të luftëtarëve të huaj terroristë.

Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes në nismat rajonale, Shqipëria synon të japë një kontribut proaktiv në paqe dhe stabilitet si dhe në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë drejtim, një hap konkret për të forcuar përpjekjet në luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel kombëtar dhe rajonal ishte zhvillimi i Konferencës së Koordinimit të RCC për çështjet e CVE-ve më 11 nëntor 2016, në Tiranë. Ky takim prodhoi disa rekomandime praktike për vitin 2017, të cilat do të shërbejnë si një bazë e mirë për bashkëpunimin rajonal në të ardhmen. Të gjitha rekomandimet aktualisht janë duke u shqyrtuar nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Hetimet e përbashkëta, filtrat në internet ndaj përmbajtjeve radikale online, programet e bashkëpunimit të rehabilitimit të ish FtF-ve në burgje, si dhe zgjerimi i skemave të përfshirjes sociale për FtF e kthyer, etj, do të jetë gjithashtu në agjendën e punës së ardhshme të RCC-së.

Shqipëria respekton dhe miraton listat e publikuara nga Këshilli i Sigurimit për individët dhe organizatat të cilat janë të listuara si terroriste ose financues të terrorizmit dhe ka miratuar masa konkrete legjislative kundër personave dhe organizatave të renditura në ato lista. Në këtë drejtim, gjatë viteve 2015-2016, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë ka miratuar një numër vendimesh si më poshtë:

VKM Nr. 31, datë 21.01.2015

VKM Nr. 124, datë 11.02.2015

VKM Nr. 162, datë 25.02.2015

VKM Nr. 273, datë 01.04.2015

VKM Nr. 311, datë 15.04.2015

VKM Nr. 351, datë 29.04.2015

VKM Nr. 431, datë 20.05.2015

VKM Nr. 488, datë 10.06.2015

VKM Nr. 721, datë 02.09.2015
VKM Nr. 852, datë 21.10.2015
VKM Nr. 931, datë 18.11.2015
VKM Nr. 951, datë 25.11.2015
VKM Nr. 985, datë 09.12.2015
VKM Nr. 1087, datë 28.12.2015
VKM Nr. 20, datë 20.01.2016
VKM Nr. 51, datë 27.01.2016
VKM Nr. 201, datë 16.03.2016
VKM Nr. 256, datë 06.04.2016
VKM Nr. 331, datë 04.05.2016
VKM Nr. 479, datë 29.06.2016
VKM Nr. 512, datë 13.07.2016
VKM Nr. 537, datë 27.07.2016
VKM Nr. 689, datë 05.10.2016
VKM Nr. 593, datë 31.08.2016
VKM Nr. 744, datë 26.10.2016
VKM Nr. 769, datë 02.11.2016

Këto masa kanë një rol të rëndësishëm me ndikim pozitiv në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme konsideron se ka nevojë të rishikohet dhe të hartohet një ligj lidhur me zbatimin e të gjitha sanksioneve ndërkombëtare, përveç sanksioneve që lidhen me Rezolutat Nr. 1267/1988 dhe 1373 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të cilat rregullohen me Ligjin Nr 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit".

Në këtë kontekst, vlen të përmendet se përparimi i bërë nga Shqipëria në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT) është njohur nga Task Forca e Veprimtarisë Financiare (FATF), e cila në mbledhjen e saj plenare, më 25-27 shkurt 2015, përgëzoi dhe përshëndeti përparimin e rëndësishëm të Shqipërisë dhe përsëriti se Shqipëria ka adresuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe rregullator, duke përmbushur kështu angazhimet e saj.

Një vlerësim i tillë dhe masat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare çuan në një vlerësim pozitiv të Konventës Kuadër MONEYVAL të Këshillit të Evropës, i cili më 18 shtator 2015 arriti në përfundimin se Shqipëria nuk do t'i nënshtrohet më procesit të monitorimit vjetor.

Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal, Shqipëria synon të japë një kontribut proaktiv në paqen dhe stabilitetin dhe të qëndrojë me vendosmëri për të luftuar përhapjen e terrorizmit.

Qeveria Shqiptare po përgatitet të prezantojë një plan mësimor të veçantë me titull "Sekularizmi dhe Kultura e Besimeve Fetare". Ne e konsiderojmë mësimin e kulturës së besimeve fetare si një

përpjekje konkrete për të mbrojtur shoqërinë tonë, për të ruajtur kohezionin tonë social, por edhe për të dalluar qartë radikalizimin dhe ekstremizmin, të cilët nuk kanë të bëjnë me besimet fetare.

II.5.2 Institucionet përgjegjëse

- Këshilli i Ministrave
- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEFA)
- Ministria e Mbrojtjes

II.5.3 Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.5.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

N / A

II.5.3.2 Masat ligjore të planifikuara

N / A

II.5.3.3 Veprimet e tjera të planifikuara

N / A

II.6 Siguria e Përbashkët dhe Politika e Mbrojtjes

II.6.1 Kuadri politik dhe ligjor

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë ndjekur zhvillimet e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes CSDP-së në kuadër të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (CFSP) dhe kanë marrë pjesë në mënyrë aktive me kontribute ushtarake në 2 (dy) operacione të drejtuara nga Bashkimi Evropian, si më poshtë:

- Operacioni “EUFOR Althea” në Bosnje-Hercegovinë;
- Misioni i trajnimit "EUTM Mali" në Republikën e Malit, në Afrikë.

Në operacionin "ALTHEA" në Bosnje-Hercegovinë, për periudhën raportuese, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë marrë pjesë me 1 (një) personel ushtarak, në pozicionin e "Këshilltarit të Stafit të Trajnimit dhe Përfaqësuesit të Lartë Ushtarak Shqiptar". Në

ketë kuadër, gjatë vitit 2018, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë ofruar asistencë me module trajnimi për Forcat e Armatosura të Bosnje -Hercegovinës.

Në misionin e trajnimit "EUTM Mali" në Republikën e Malit, në Afrikë, Forcat e Armatosura kanë kontribuar me 4 (katër) ushtarakë, si pjesë e ekipit të EOD-it "Shkatërrimi i armëve eksplozive", në mbështetje të Kompanisë së Mbrojtjes e bazës së Koulikoro. Misioni nisi në nëntor 2015 dhe vazhdon me rotacion çdo gjashtëmuajor.

Gjatë periudhës raportuese, Ministria e Mbrojtjes ka deklaruar vullnetin për vijimësinë e kontributit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në kuadër të këtyre misioneve që do të zgjasin mandatin e pranishëm të FARSH në operacione dhe misione të drejtuara nga Bashkimit Evropian.

Në vitin 2016, Shqipëria u anëtarësua zyrtarisht në DECI, duke u bashkuar me familjen e shteteve anëtare të DECI. Angazhimet e ndërmarra në kuadër të DECI-t janë forcuar edhe me partneritetin e NATO-s dhe BE-së, ndërsa në vitin 2015 u nënshkrua letra e qëllimit lidhur me Konceptin Kombëtar Kuadër (FNC). Ky partneritet, i cili përfshin shtetet anëtare të DECI-t, ndër të tjera, synon të forcojë bashkëpunimin në shërbim të identifikimit të një grupi asetesh dhe kapacitetesh në mënyrë që të mundësojë një lidhje të mundshme në kuadrin e rotacioneve të ardhshme brenda Forcës së reagimit të shpejtë të NATO-s dhe BattleGroups të BE-së.

Gjithashtu, në përputhje me prioritetet e Strategjisë Globale të Bashkimit Evropian, në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, gjatë Konferencës së Koordinimit të Grup-Batalioneve të BE-së të zhvilluar më 11 – 12 tetor 2018, në Bruksel, Belgjikë, Ministria e Mbrojtjes ka deklaruar zyrtarisht pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në konceptin e Grup Batalioneve të BE-së. Kontributi do të konsistojë në një kompani këmbësorie të lehtë të përbërë nga 145 personel ushtarak, përkatësisht në Grup Batalionin e 6-mujorit të dytë të vitit 2024 (EUBG 2024-2), që do të drejtohet nga Italia.

Këto janë nisma konkrete dhe serioze në kuadër të angazhimit dhe pjesëmarrjes sonë në strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes, duke kontribuar në këtë mënyrë në një stabilitet ndërkombëtar dhe rajonal të forcuar.

Shqipëria është e angazhuar për të bashkëpunuar edhe më tej me organizata të tjera ndërkombëtare (OKB, NATO, OSBE, Këshilli i Evropës, etj.). Në mars të vitit 2015, vendi ynë dërgoi dy përfaqësues, si pjesë e OSBE-së, për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare në Taxhikistan. Aktualisht, në kuadër të OSBE-së, Shqipëria vazhdon të kontribuojë me katër vëzhgues në Ukrainë: tre vëzhgues në MPM/EMS (Misioni Special Monitorues/Misioni i Posaçëm Monitorues) dhe një vëzhgues në Misionin Monitorues (Misioni Vëzhgues). Shqipëria i është përgjigjur gjithashtu pozitivisht thirrjes për të kontribuar me personel ushtarak në Qendrën e Trajnimit "TeamBuilding Partner Capacity (BPC-T) &Advice&TeamsAssist" në Erbil të Irakut.

Sa i përket operacioneve paqeruajtëse në kuadër të OKB, Ministria e Mbrojtjes ka filluar procedura vlerësimi të mundësive që disponohen nga FARSH, që do të ndikojë në rritjen e vizibilitetit të Republikës së Shqipërisë në këto operacione. Në këtë kuadër, Ministria e Mbrojtjes ka konfirmuar gatishmërinë e RSH-së për të marrë pjesë në operacionin e OKB-së “MINUSMA”, në Republikën e Malit, në Afrikë.

Gjithashtu, Ministria e Mbrojtjes është duke zhvilluar procedura të brendshme për dislokimin e 2 (dy) personel ushtarak (gra) në misionin e drejtuar nga OKB UNMISS, në Sudanin e Jugut, në Afrikë.

II.6.2 Institucionet përgjegjëse

- Këshilli i Ministrave
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEFA)
- Ministria e Mbrojtjes
- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)

II.6.3 Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.6.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

N/A

II.6.3.2 Masat ligjore të planifikuara

- Projektligji “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, NATO, BE, shtetet dhe organizatat e tjera ndërkombëtare”, i cili synon të përafrohet me “Vendimin e Këshillit 2013/488/BE, "Për rregullat e sigurisë dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së”, i parshikuar të miratohet gjatë vitit 2019. Ky projektligj do të shfuqizojë ligjin Nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar. Qëllimi i kësaj nisme legjislative është përafrimi i pjesshëm i kuadrit ligjor për informacionin e klasifikuar me Vendimin e Këshillit 2013/488/BE, "Për rregullat e sigurisë dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së".
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave për “Rregulloren për Sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në Sistemet e Komunikimit dhe të Informacionit (SKI)”, i cili synon të përafrohet me Vendimin e Këshillit 2013/488/BE, "Për rregullat e sigurisë dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së", i parshikuar të miratohet gjatë vitit 2019. Projektvendimi i mësipërm do të shfuqizojë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 922, datë 19.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)”.

II.6.3.3 Veprime të tjera të planifikuara

N/A

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

Viti	2019	2020	2021
Buxheti total për kapitullin i institucionit koordinues	0	5 913 885 Lekë. ⁴⁷ 2 556 992 Lekë ⁴⁸	0
Buxheti total i institucioneve kontribuuese	0	0	0
Buxheti total i kapitullit	0	8470877 Leke	0

⁴⁷ VKM për “Projekt-Rregulloren për Sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në Sistemet e Komunikimit dhe të Informacionit (SKI)”, kjo vlerë ka dalë nga llogaritja e pagave vjetore *maksimale* për 2 struktura me përbërje përkatësisht: 1 Drejtor, 1 Përgjegjës Sektori dhe 2 Specialist dhe struktura tjetër 1 Përgjegjës Sektori dhe 2 Specialist.

⁴⁸ Projektligj i ““Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, NATO, BE, shtetet dhe organizatat e tjera ndërkombëtare”.

Kapitulli 32: Kontrolli financiar

I. Përmbajtja e kapitullit

I.1.1 Përmbledhje e acquis sëBE-së

Ky kapitull përmban dy fusha kryesore të politikave: (a) kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP) dhe auditimin e jashtëm si dhe (b) mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe mbrojtjen e euros nga falsifikimi. Në fushën e parë të politikave nuk ka legjislacion të BE-së që kërkon transpozimin në legjislacionin kombëtar ose legjislacionin e zbatueshëm direkt. Në vend të kësaj, vendet candidate pritet të miratojnë standardet ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm dhe praktikat e mira të BE-së në të gjithë sektorin publik, sikurse dhe standardet e auditimit të jashtëm, siç përcaktohet nga Organizata Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

Kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP) është një pjesë integrale e menaxhimit financiar publik kombëtar. Ky është një koncept gjithëpërfshirës në lidhje me gjithë buxhetin publik, në veçanti të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë qendrore, duke përfshirë fondet e huaja. Koncepti i KBFP bazohet në tri parime: 1) llogaridhënia menaxheriale e decentralizuar e mbështetur nga sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK), 2) auditimi i brendshëm funksionalisht i pavarur dhe 3) harmonizimi i përqendruar i metodologjive dhe standardeve në lidhje me MFK dhe auditimin e brendshëm menaxhuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit. Vendi kandidat angazhohet të zbatojë KBFP-në në të gjithë sektorin publik. Vendi kandidat pritet të miratojë dhe zbatojë një Dokument të Politikave të KBFP-së dhe planin e veprimit, dhe një kornizë ligjore të KBFP, si dhe të krijojë dhe mbajë strukturat e nevojshme kombëtare dhe kapacitetet administrative për zbatimin e KBFP. Sa i përket auditimit të jashtëm, vendi kandidat pritet të pajtohet me standardet e INTOSAI-t, veçanërisht Deklaratat në Lima dhe Meksikë, të cilat parashikojnë pavarësinë funksionale, institucionale dhe financiare të SAI-ve, si dhe zbatimin e auditimeve financiare dhe të performancës në përputhje me standardet e INTOSAI.

Lidhur me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, Neni 325 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) kërkon që Shtetet Anëtare të marrin të njëjtat masa për të luftuar mashtrimin që prekin interesat financiare të Unionit si të ndërmarra për të luftuar mashtrimin që prekin interesat financiare kombëtare, duke përfshirë koordinimin e veprimeve të tyre nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë dhe të rregullt midis autoriteteve kompetente dhe Komisionit. Mbrojtja e interesave financiare të BE-së mbulon mbrojtjen e të drejtës penale nëpërmjet përafrimit të legjislacionit kombëtar me Konventën për Mbrojtjen e Interesit Financiar të BE-së (Konventa PFI) dhe tri protokollet e saj dhe bashkëpunimin operacional ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare dhe Komisioni. Shtetet Anëtare duhet të kenë kapacitetin për të bashkëpunuar në mënyrë efektive me Komisionin Evropian dhe të komunikojnë të gjitha rastet e dyshuara të parregullsive dhe mashtrimit, si dhe gjithashtu janë të detyruar të ndihmojnë dhe të

bashkëpunojnë në kontrole të kryera nga shërbimet e Komisionit. Disa nga këto acquis zbatohen drejtpërsëdrejti në Shtetet Anëtare dhe kështu nuk ka nevojë të transpozohet. Për të lehtësuar bashkëpunimin e kërkuar nga Shtetet e ardhshme Anëtare, vendit kandidat i kërkohet të emërojë një shërbim kombëtar për koordinimin e anti-mashtimit (AFCOS), si një pikë e vetme kontakti për Komisionin përpara anëtarësimit.

Lidhur me mbrojtjen e euros kundër falsifikimit, ky Kapitull trajton aspekte jo-penale, ndërsa Kapitulli 24 trajton aspektet penale. Konventa e Gjenevës e 1929 për shtypjen e monedhës së falsifikuar përshkruan parimet e përgjithshme, të cilat janë detajuar më tej në lidhje me këtë çështje acquis. Kjo përfshin ndër të tjera ndalimin e metaleve ose monedhave të ngjashme me monedhat euro, procedurat për grumbullimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e informacionit mbi falsifikimet, detyrimin për institucionet financiare për të kontrolluar vërtetësinë, tërheqjen e falsifikimeve dhe për t'i transmetuar ato për analizë si dhe bashkëpunim në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare.

I.1.2. Kërkesat e MSA-së

Detyrimi i përafrimit të legjislacionit shqiptar në fushën e kontrollit financiar me atë të Bashkimit Evropian rrjedh nga nenet 70, 85 dhe 90 të MSA-së.

I.2 Situata aktuale

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në këtë fushë.

Kontrolli i brendshëm financiar publik

Kuadri strategjik është përgjithësisht i vendosur. Raporti Vjetor i Konsoliduar mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme 2017u paraqit në Këshillin e Ministrave dhe u botua në maj 2018, ndërsa gjetjet kryesore u diskutuan në Parlament në Tetor 2018. Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik është bërë funksional në 2017 dhe ka vazhduar veprimtarinë e tij edhe përgjatë vitit 2018 duke mbajtur dy takime gjatë muajit shkurt dhe maj ku temat kryesore që u diskutuan ishin ndryshimet në kuadrin nënligjor të KBFP, gjetjet dhe rekomandimet e Raportit Vjetor të KBFP, reforma në fushën e kontabilitetit publik (projekti i zbatimit të standardeve ndërkombëtare IPSAS), rritja e kapaciteteve profesionale të audituesve të brendshëm dhe Plani Strategjik i Auditimit të Brendshëm për periudhën për 2018-2020

Lidhur me përgjegjshmërinë menaxheriale, DH/MFK i ka kushtuar një vëmendje të veçantë ndërgjegjësimit të menaxherëve të niveleve të ndryshme të njësive publike lidhur me këtë

koncept. Me qëllimnxitjene zhvillimit të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe ndërgjegjësimin mbipërfitimet e një sistemi të shëndoshë të kontrollit të brendshëm, DH/MFK ka organizuar seminare dhe trajnime të ndryshme duke filluar nga niveli i lartë menaxherial. Mund të përmendim tre seanca trajnime në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publikëmbi sistemet e kontrollit të brendshëm financiar publik gjatëperiudhës prill-qershor 2018 (55 pjesëmarrës). Një nga temat më të rëndësishme ishte "Përgjegjësia Menaxheriale" ku interesi i menaxherëve për informacion ishte shumë i lartë.

Bazuar në procesin e monitorimit të vazhdueshëm në institucionet publike, në lidhje me përgjegjshmërinë menaxheriale, është evidentuar një rritje e ndërgjegjësimit të nëpunësve autorizues mbi paraqitjen e situatës reale në pyetësorët e vetëvlerësimit, të plotësuar prej tyre për pesë komponentët e MFK.

Bazuar në procesin e monitorimit të vazhdueshëm të njërive të auditimit të brendshëm, gjatë vitit 2018 u planifikuan 10 vlerësime të jashtme. Aktualisht janë realizuar 8 vlerësime të jashtme të cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm të: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit sha dhe Bashkinë Gjirokastrë. Gjatë monitorimeve u përcaktuan fushat që kishin nevojë për përmirësim dhe u dhanë rekomandimet përkatëse për përafrim të veprimtarisë me standardet ndërkombëtare.

Legjislacioni për zbatimin e kontrollit të brendshëm është kryesisht në përputhje me kornizën e kontrollit të brendshëm të Komitetit të Organizatave Sponsorizuese (COSO) dhe udhëzimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Inspektimi i centralizuar i buxhetit rregullohet në përputhje me kërkesat e KBFP. Drejtoria e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka gjashtë inspektorë, të cilët mbështeten nga 85 inspektorë të tjerë rast pas rasti. Legjislacioni për praktikën e auditimit të brendshëm është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Manualët, kodet e etikës dhe dokumentet e auditimit të brendshëm janë në vend. Rishikimi i cilësisë në dy ministri është sipas një metodologjie të re. Numri i rekomandimeve të auditimit të brendshëm është i lartë, si dhe norma e pranimit të rekomandimeve nga menaxhmenti.

NjQH ofron udhëzime metodologjike dhe monitoron zbatimin e kontrollit të brendshëm dhe auditimin e brendshëm, duke analizuar raportet e vetëvlerësimit dhe kryerjen e vizitave në terren.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar asistencës teknike të ofruar në katër institucione pilot të përzgjedhur (Ministria e Brendshme, Bashkia Vlorë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar) dhe trajnimeve në fushën e kontrollit të brendshëm në veçanti, në lidhje me sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë publike. Trajnimi është i nevojshëm sepse sistemet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar siç janë transparenca, efektiviteti, dhe ekonomiciteti në përdorimin e fondeve publike.

Në këtë kontekst, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike Shqiptare (ASPA) ka organizuar trajnime që synojnë informimin e niveleve të ndryshme të menaxhimit në lidhje me përgjegjshmërinë menaxheriale, mënyrën e zbatimit dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm financiar publik si dhe zbatimin në praktikë të elementeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Vlen të përmenden aktivitetet e realizuara:

- Tre seanca trajnimi gjatë muajve prill-qershor 2018, me fokus udhëzimin e nëpunësit zbatues dhe instrumentet e raportimit financiar (55 pjesëmarrës)
- Tre seancatrajnimi gjatë muajve prill-qershor 2018, mbi implementimin e bazës ligjore të MFK, regjistrin e riskut, manualin e proceseve të punës dhe kontabilitetin në sektorin publik.
- Dy trajnime 3-ditore për menaxherët e nivelit të lartë dhe menaxherë të tjerë u organizuan në qarkun e Shkodrës dhe Elbasanit me fokus zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore të MFK-së dhe në zbatimin në praktikë të instrumentave të MFK (66 pjesëmarrës). Trajnimet shërbyen për të rritur ndërgjegjësimin e menaxherëve të nivelit të lartë për rëndësinë e zbatimit të MFK;
- Tetë seanca trajnimi mbi parimet e mirëqeverisjes dhe përgjegjshmërisë menaxheriale gjatë trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm për vitin 2018;
- Gjatë periudhës prill-maj 2018, janë monitoruar në vend 20 institucione publike të zgjedhura për të vlerësuar nivelin e zbatimit të kërkesave të ligjit të MFK-së dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Rezultatet e monitorimit janë paraqitur në raportin vjetor të KBFP për vitin 2017.

NQH është përgjegjëse për kualifikimin dhe trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm të punësuar në sektorin publik. Në këtë kontekst NJQH organizon çdo vit certifikimin e audituesve të rinj, si dhe trajnimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik.

Specifikisht, në procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2017-2018, u përfshinë 51 kandidatë të cilët ndoqën provimet në 6 modulet bazë, provimin me shkrim dhe me gojë dhe në përfundim u certifikuan nga ky proces 47 kandidatë si “Auditues të brendshëm në sektorin publik”.

Në Maj 2018 filloi procesi i aplikimit për certifikimin e audituesve të rinj për sezonin 2018-2019, në të cilin aplikuan 80 kandidatë, por vetëm 48 prej tyre përmbushën kriteret në përputhje me kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor për këtë proces.

Në lidhje me programin e trajnimit të vijueshëm profesional, NJQH përcakton temat e trajnimit duke analizuar nevojat për trajnim të njëjësive të auditimit të brendshëm, si dhe zhvillimet në reformën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Ky program për vitin 2018 përfshiu tema specifike për kontrollin e brendshëm, marrëdhëniet ndërmjet auditimit të jashtëm, auditimit të brendshëm dhe inspektimit financiar, njohja nga audituesit të rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit, etj. Gjatë 2018, janë zhvilluar 13 faza trajnimi. Në këtë proces janë trajnuar 320 auditues të brendshëm në sektorin publik.

Auditimi i jashtëm

Pavarësia funksionale, operacionale dhe financiare e Institucionit Shtetëror të Auditimit (SAI) është e përcaktuar në përputhje kushtetuese dhe ligjore me standardet e INTOSAI-t.

Përsa i përket kapacitetit institucional, zhvillimi profesional i auditorëve ka qenë prioritet në vitet e fundit me mesatarisht 25 ditë trajnimi për auditor në vit. Është vendosur një plan i ri zhvillimor strategjik për 2018-2022, si dhe një strategji komunikimi për periudhën 2017-2019.

Sa i përket cilësisë së punës së auditimit, KLSH ka ndërmarrë hapa drejt përmirësimit të sigurimit dhe kontrollit të cilësisë në përputhje me ISSAI.

Lidhur me ndikimi i punës së auditimit, në 2017, 52% e rekomandimeve të SAI për përmirësime ligjore dhe organizative u pranuan nga auditet dhe 68% prej tyre janë në zbatim. Raportet e auditimit janë përmbledhur në baza tremujore dhe publikohen rregullisht në faqen e internetit të SAI. Raportet vjetore të auditimit të SAI i dërgohen rregullisht Parlamentit.

Mbi zbatimin e rekomandimit të Komisionit European

Rekomandim: Kapitullin 32 “Kontrolli Financiar”: “Shqipëria duhet në veçanti të miratojë një qasje të bazuar në risk, të auditimit të jashtëm që do të përshkruajë si të reduktojë gradualisht numrin e auditimeve të përputhshmërisë dhe të rrisë numrin e auditimeve financiare dhe të performancës”

Rekomandimi i Komisionit European është në koherencë të plotë me Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së i cili përcakton drejtimet kryesore të zhvillimit institucional për periudhën 2018-2022. Në drejtim të aktivitetit auditues, kjo strategji ka përcaktuar rritjen e auditimeve të performancës dhe të auditimeve financiare të cilat bazohen në analizën e riskut. Strategic Objective 1.2: "Increasing Focus on Performance Audit"; Strategic Objective 1.3: "Conduct Financial Audit in accordance with International Standards on Auditing Objective Strategy 1.4 Consolidate Audit Compliance Assessed to ISSAI Requirements Strategic Objective 2.2: "Risk Based Audit".

Aktualisht, KLSH është duke u fokusuar në forcimin e kapaciteteve audituese për realizimin e trajnimeve fokusuar në auditimin bazuar në risk”.

Për rrjedhojë në zbatim të këtyre objektivave dhe të rekomandimit të adresuar nga Komisioni European, KLSH përgatiti Dokumentin “Metodologjia e hartimit të planit strategjik dhe vjetor të auditimit” i cili u miratua me Vendim të Kryetarit nr. 79 datë 30.06. 2018 dokument i cili ofron qasjen e implementimit të procesit të planifikimit të auditimit bazuar në analizën e riskut, konsideruar si një faktor i rëndësishëm në performancën dhe mirëqeverisjen institucionale.

KLSH referuar rekomandimit të adresuar në Progres Raport, rishikoi planin e auditimeve duke ndryshuar në rritje numrin e auditimeve financiare dhe auditimet e performancës bazuar në Vendimin e Kryetarit nr 70 datë 30.06.2018 Pas ndryshimeve numri i auditimeve financiare nga 20 u rrit në 28 dhe numri i auditimeve të performancës nga 18 u rrit në 20 auditime.

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Sa i përket mbrojtjes së interesave financiare të BE-së, ekzistojnë elementet kryesore të acquis, si dhe kuadri institucional - Shërbimi Kombëtar i Koordinimit Anti-Mashtim (AFCOS) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Marrëveshjet e bashkëpunimit të rrjetit AFCOS me institucionet relevante kombëtare. Bashkëpunimi i Shqipërisë me Komisionin Evropian përfshin bashkëpunimin gjatë misioneve në vend dhe raportimit të parregullsisve përmes Sistemit të Menaxhimit të Parregullsisve.

Struktura organizative e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik gjatë vitit 2018 përbëhet nga dy sektorë:

- Sektori i Analizës & Investigimit & Monitorimit & AFCOS (3+1) (aktualisht janë dy vende vakante);
- Sektori i Inspektimit (3+1) (2 vende janë plotësuar me lëvizje paralele);
- Struktura e PFID-së mbështetet nga 85 inspektorë të jashtëm, të cilët angazhohen rast pas rasti.

Në vitin 2017 u krye një hetim nga OLAF, për parregullsitë në përdorimin e fondeve të BE-së, i cili u mbështet nga AFCOS_AL (në vazhdim).

Gjatë vitit 2018, në lidhje me këtë investigim u kërkuar suport dhe informacion shtesë. Në këtë kontekst, AFCOS ka vijuar me asistimin për OLAF lidhur me të dhënat dhe informacionin e kërkuar për këtë çështje.

Në vitin 2017 rritet numri i përdoruesve që kanë qasje në sistemin AFIS (respektivisht nga Drejtoria Mbështetëse e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) dhe nga Drejtoria e Fondit Kombëtar).

Në fund të vitit 2017 janë krijuar përdorues në sistemin AFIS respektivisht nga Drejtoria e Fondit Kombëtar dhe Drejtoria Mbështetëse e ZKA, të cilat aktualisht kanë akses në këtë sistem (proces i cili ka vazhduar edhe në fillim të vitit 2018).

Ndërkohë, është në proces për të pasur akses në sistem edhe Drejtoria e CFCU në MFE, proces i cili është parashikuar të finalizohet deri në fund të vitit 2018.

Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Kuadri për Mbrojtjen e euros nga falsifikimi është përafruar pjesërisht me përcaktimin e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara, si dhe procedurat për mbledhjen, ruajtjen dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi. Analiza teknike kryhet nga Qendra Kombëtare e Analizës e Bankës Kombëtare. Bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është në vazhdim. Është vendosur një marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin Evropian për monedhat. Shqipëria merr pjesë në veprimet e programit Pericles 2020. Shqipëria ka një marrëveshje me Europol për bashkëpunimin në luftën kundër falsifikimit të monedhës dhe mjeteve të pagesës që nga viti 2014.

I.3. Prioritetet

Përcaktohen prioritetet e mëposhtme:

- Përgatitja e një dokumenti të politikave gjithëpërfshirëse për KBFP me një fokus të veçantë në përgjegjshmërinë menaxheriale dhe si zbatohet për përgjegjësitë institucionale, shpërndarjen e burimeve, raportimin mbi arritjen e objektivave dhe menaxhimin financiar.
- Sigurimi i ndjekjes efektive të vlerësimit vjetor të KBFP duke adresuar dobësitë sistematike, veçanërisht në delegimin e detyrave dhe raportimit të performancës.
- Krijimi i një mekanizmi për koordinimin efektiv, monitorimin dhe raportimin e administratës publike, menaxhimin e financave publike dhe reformat e KBFP;
- Rritja e ndërgjegjësimit të menaxherëve të nivelit të lartë mbi rëndësinë e procesit të menaxhimit të riskut me qëllim diskutime risqeve me ndikim të lartë gjatë takimeve të grupit të menaxhimit strategjik.
- Rishikimi i bazës nënligjore të menaxhimit financiar dhe kontrollit; Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të sektorit publik përmes menaxhimit financiar dhe kontrollit
- Forcimi i kapaciteteve të DPH/KBFP me qëllim koordinimin dhe mbështetjen efikase për institucionet e sektorit publik në procesin e implementimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe zbatimit të auditimit të brendshëm.
- Monitorimi i vazhdueshëm i organizimit, funksionimit dhe shtrirjes së shërbimit të auditimit të brendshëm në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, si dhe nivelin e përputhjes me standardet ndërkombëtare, të pranuar.
- Organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve të vijueshme profesionale për zhvillimin profesional dhe përditësim të njohurive të të gjithë audituesve të brendshëm të çertifikuar në detyrë dhe trajtimi në to i temave sa më efektive mbi fushat dhe përgjegjësitë e njësive publike, si dhe përditësimi me të rejtat e vendeve të rajonit e më gjerë.
- Organizimi dhe menaxhimi i procesit të çertifikimit për sezonin 2018-2019, për t'i ofruar punonjësve të rinj të njësive të auditimit të brendshëm ndihmë profesionale dhe një kualifikim cilësor për marrjen e njohurive bazë në këtë fushë.
- Monitorimi në vazhdimësi i nivelit të zbatimit dhe cilësisë së rekomandimeve të dhëna gjatë realizimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim që auditimi të shihet si vlerë e shtuar nga titullarët e njësive publike dhe të gjithë grupet e interesit.

- Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së auditimit të brendshëm, nëpërmjet kryerjes së vlerësimeve të jashtme të cilësisë, për përputhje të kësaj veprimtarie me standardet ndërkombëtare, të pranuara.
- Zgjerimi i mbikëqyrjes mbi ndërmarrjet shtetërore;
- Zhvillimi i menaxhimit të performancës; decentralizimi i vendimmarrjes në institucionet; delegimi në menaxhimin e mesëm; duke siguruar udhëzime specifike për delegimin e detyrave të punonjësve në njësitë qeverisëse.
- Miratimi i një qasje të auditimit të jashtëm të bazuar në risk.
- Zbatimi i plotë i kuadrit ligjor të funksionimit të Institucionit të Kontrollit Shtetëror (SAI).
- Krijimi i një strategjie anti-mashtrim për të adresuar mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.
- Ngritja e kapaciteteve për të kryer aktivitetet e hetimit.
- Ratifikimi i Konventës Ndërkombëtare të vitit 1929 për shtypjen e falsifikimit të monedhës.

II.1 Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri ligjor për auditimin e brendshëm:

- Ligji 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kriterëve për themelimin e njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" të ndryshuar me VKM nr.353, datë 05.11.2016;
- VKM nr. 116, datë 2.7.2016, "Për funksionimin dhe përbërjen e komisionit të kualifikimit të auditorëve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit".
- VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në entitetet publike"
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 86, datë 10.12.2015, "Për miratimin e Kodit të Etikës për Auditorët e Brendshëm në sektorin publik";
- VKM Nr. 353, datë 05.11.2016 "Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, kufiri i datës 02.03.2016," Për miratimin e kriterëve për themelimin e njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik ";
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 3, datë 08.01.2016, "Për miratimin e rregullave për zhvillimin profesional të auditorëve të brendshëm në sektorin publik"
- Ministri i Financave, nr. 37, datë 16.03.2016 "Për procedurat e certifikimit të auditorëve të brendshëm në sektorin publik".
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"

- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 22, datë 06.03.2017 "Për Metodologjinë e Aprovimit për Vlerësimin e Cilësisë së Jashtme për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik";
- Publikimi i Standardeve Ndërkombëtare për praktikën më të mira të auditimit të brendshëm në sektorin publik, miratuar për zbatim në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 40, datë 08.05.2017.

Kuadri ligjor për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk ka ndonjë acquis të zbatuar nga BE. Megjithatë, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në këtë fushë janë hartuar në konsultim të ngushtë me DG Buxhetin, KE. Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, baza ligjore përmban:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ndryshuar me ligjin nr.110 / 2015, të datës 15.10.2015;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.908, datë 17.12.2014 "Për Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike në Shqipëri 2014-2020";
- Manuali për MFK, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësinë dhe detyrat e riskut dhe koordinatorët e MFK në njësitë publike";
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr.21, datë 25.10.2016 "Për zyrtarin ekzekutiv për të gjitha nivelet";
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011 "Për paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike";
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e pasurive në njësitë publike" së bashku me shtigjet e auditimit, i cili shqyrtohet me Udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014 dhe Udhëzimi Nr. 11, datë 06.05.2016;
- Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" së bashku me gjurmët e auditimit të cilat janë shqyrtuar me Udhëzim Nr. 3, datë 16.01.2015 "Për një shtojcë dhe ndryshime në ligjin nr udhëzim Nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit";
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde dhe përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm" së bashku me gjurmët e auditimit;
- Urdhri i Ministrit të Financave nr.68, datë 08.06.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike";
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike";
- Urdhri i Ministrit të Financave nr.57, datë 12.06.2014 "Për gjurmët standarde të auditimit të prokurimit me vlerë të vogël 400,000 lekë pa TVSH dhe me vlerë të lartë 400,000 lekë pa TVSH".
- Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit";
- Udhëzimi nr. 9/1, datë 20.03.2018 "Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin Sistemin Informativ Financiar të Qeverisë".

- Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme".

Kuadri ligjor për Inspektimin Financiar Publik:

- Ligji Nr. 112 / 2015, datë 15.10.2015 "Për Inspektoratin Financiar Publik";
- Udhëzimi nr. 29, datë 27.11.2015 "Për kriteret për fillimin e inspektimit financiar publik";
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.11.2015 "Për rregullat dhe procedurat për kryerjen e inspektimit financiar publik";
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 84, datë 9.12.2015 "Për krijimin e rrjetit të shërbimit të raportimit të AFCOS-it".
- Urdhri nr. 32, datë 27.02.2014 "Për kriteret për përzgjedhjen e inspektorëve financiarë publikë";
- VKM Nr. 492, datë 06.07.2011 "Për shpërblimin e inspektorëve financiarë publikë".
- Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 26, datë 17.02.2016 "Për miratimin e manualit të inspektorëve financiarë publikë".

II.1.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

II.1.3 Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.1.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

J/D

II.1.3.2 Masat ligjore të planifikuara

J/D

II.1.3.3 Veprimet e tjera të planifikuara

J/D

II.2 Auditimi i jashtëm

II.2.1 Kuadri politik dhe ligjor

Aktiviteti i auditimit AL-SAI rregullohet nga:

- Neni 158/5, 162-165 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", datë 27.11.2014.

Në fushën e auditimit të jashtëm, ndryshimet organizative dhe procedurat e reja janë futur për të rritur efikasitetin e Institucionit Shtetëror të Auditimit (KLSH). Zhvillimi i qasjes së auditimit dhe proceseve të vlerësimit metodologjik përbëjnë bazën për funksionimin e duhur institucional.

Auditimi i Lartë i Shtetit është në fazën e konsolidimit të procedurave të operimit dhe metodologjisë së auditimit. Këto zhvillime kanë mbuluar përmbushjen e tre objektivave kryesore.

- Zbatimi i kuadrit legjislativ dhe i standardeve të ISSAI për auditim;
- Të zbatojë më tej metodologjinë e auditimit dhe kapacitetet e auditimit;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i ndikimit të auditimit.

KLSH gjithashtu ka miratuar dokumentet e mëposhtme:

- Dokumenti nr.41, datë 30/03/2015 "Për Strategjinë e Menaxhimit të Riskut";
- Vendimi i Kryetarit të KLSH-së, nr. 196, datë 31.12.2015 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe Manualit të Auditimit Financiar", bazuar në Standardet e INTOSAI: ISSAI 100 - Parimet Themelore të Auditimit të Sektorit Publik; ISSAI 200 - Parimet Themelore të Auditimit Financiar; ISSAI 300 - Parimet Themelore të Auditimit të Performancës; ISSAI 400 - Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë;
- Vendimi nr. 58, datë 30.06.2015, "Për ISSAI⁴⁹ Strategjia e Zbatimit 2015 - 2016";
- Strategjia e Komunikimit 2017 -2019, e korrikut 2017.

Paketa e Auditimit të Integritetit INTOSAINIT e lançuar në 2012 nga Gjykata Holandeze e Auditimit është publikuar dhe aplikuar me sukses që nga viti 2014 dhe rezultatet e saj ishin pjesë e Analizës Vjetore të Performancës Institucionale. Ky proces ka vazhduar edhe në vitet në vijim.

Udhëzime dhe urdhëresa të veçanta që mbulojnë çështje më teknike janë përgatitur dhe zbatuar vazhdimisht, duke mbështetur veprimtarinë e të gjithë organit të auditimit, duke përfshirë:

- Udhëzuesi Nr. 1, datë 04.11.2016 "Për procedurat për përcjelljen dhe dokumentimin e punës për auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve";
- Udhëzuesi Nr. 2, datë 30.12.2016 "Për për rritjen e cilësisë së auditimit dhe kapaciteteve";

⁴⁹ Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

- Udhëzuesi nr. 4, datë 31.12.2015 "Për planifikimin vjetor të auditimit të bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut", zhvillimi i manualit aktiv të auditimit të TI dhe modulet standarde të trajnimit për auditimin e IT; zhvillimin e metodologjive për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë, etj";
- Vendimi i Kryetarit Nr. 107, datë 08.08.2017 "Për miratimin e Rregullores së procedurave të auditimit";
- Vendimi i Kryetarit nr. 219, datë 31.12.2017 "Për politikat mbi bilbilfryresit dhe mbrojtjen e bilbilfryrësve në KLSH, duke siguruar rregullat e procedurës për hetimin administrativ të bilbilfryrësve dhe përcaktimin e mjeteve për mbrojtjen e konfidencialitetit të bilbilfryrës";
- Vendimi i Kryetarit nr. 228, datë 31.12.2017 "Për dokumentin e politikave të burimeve njerëzore";
- Vendimi i Kryetarit nr Prot 1353 datë 31.12.2017 "Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së viti 2018-2022".
- Vendimi i Kryetarit nr. 81 datë 30.06.2018 "Për miratimin e Udhëzuesit për Institucionalizimin e Marrëdhënjeve të KLSH-së me Parlamentin".
- Vendimi i Kryetarit nr 79 datë 30.06.2018 "Për miratimin e Metodologjisë së Hartimit të Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit"
- Vendimi i Kryetarit nr 80 datë 30.06.2018 "Për miratimin e Manualit Udhëzues për Zbulimin e Korrupsionit dhe Mashtrimit Financiar ne Auditim"
- Vendimi i Kryetarit nr. 136, datë 26.08.2018 "Për miratimin e Rregullores" Mbi funksionimin e sistemit të Informacionit të Menaxhimit të Proceseve të Auditimit dhe Administrative Mbështetëse ne KLSH"
- Vendimi i Kryetarit nr. 91, datë 25.07.2018 "Mbi miratimin e Dokumentit "Politika e Sigurisë së Informacionit në KLSH".
- Vendimi i Kryetarit nr. 5 datë 05.02.2018 "Mbi miratimin e Manualit të Përdoruesit të sistemit të Informacionit për Menaxhimin dhe mbështetjen e Proceseve ne KLSH"
- Vendim i Kryetarit nr 5 datë 05.02.2018 "Mbi miratimin e Manualit të Administratorit të Sistemit të Informacionit"

II.2.2 Institucionet përgjegjëse

Institucioni Suprem i Auditimit të Shqipërisë (Kontrolli i Lartë i Shtetit ose KLSH).

II.2.3 Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.2.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

Politikat e veprimtarisë audituese për periudhën në vijim do të jënë:

1-Forcimi i pavarësisë dhe Mandatit të KLSH-së

- 2-Auditimi mbi bazë risku konsideruar si qasje efektive e auditimit
- 3-Fokusi në rritje i numrit të Auditimeve Financiare dhe të Performancës dhe kryerja e tyre në përputhje me Standartet ISSAI.
- 4-Thellimi në auditimin e teknologjisë së informacionit
- 5-Forcimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve duke synuar rritjen e nivelit të rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara.
- 6-Forcimi i një sistemi të strukturuar të zhvillimit profesional.
- 7-Rritja e rolit të KLSH-së kundër korrupsionit.
- 8-Konsolidimi i marrëdhënieve të KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë.

II.2.3.2 Masat ligjore të planifikuara

J/D

II.1.3.3 Veprimet e tjera të planifikuara

J/D

II.3 Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

II.3.1 Politika dhe kuadri ligjor

II.3.2 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

II.3.3 Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.3.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

J/D

II.3.3.2 Masat ligjore të planifikuara

J/D

II.3.3.3 Veprimet e tjera të planifikuara

J/D

II.4 Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Përsa i përket mbrojtjes së euros nga falsifikimi, Banka e Shqipërisë ka zbatuar Rregulloren për sigurimin e origjinalitetit të kartëmonedhave dhe gjithashtu ka themeluar një laborator forenzik i cili do të shqyrtojë të gjitha kartëmonedhat e falsifikuara, përfshirë kartëmonedhat euro.

Duke ju drejtuar raportit të Komisionit Evropian 2018, prioritetet në fushën e mbrojtjes së euros kundër falsifikimit janë:

- Ratifikimi i Konventës Ndërkombëtare të vitit 1929 për shtypjen e monedhës falsifikuese;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mbi Kartëmonedhat me Bankën Qendrore Evropiane
- Përafrimi i mëtjshëm i legjislacionit të BE-së në fushën e mbrojtjes së parave nga falsifikimi
- Miratimin e rregullores “Mbi medaljonet dhe xhetonat të ngjashme me monedhën metalike euro”.

Duke iu drejtuar rekomandimeve të Bankës Qendrore Evropiane, prioritet në fushën e mbrojtjes së euros kundër falsifikimit është:

Rishikimi i Ligjit mbi Bankën e Shqipërisë për të pasqyruar dispozitat qëparashikojnë Bankën e Shqipërisë si autoritet kompetent për autentifikimin dhe kryerjen e ekspertizës tekniko-analitike të kartëmonedhave dhe metal monedhave të dyshuara dhe te falsifikuara.

Në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë 2018-2020, prioritetet në fushën e mbrojtjes së Euros kundër falsifikimit janë:

- Përmirësimi i cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim duke rritur efektivitetin dhe kapacitetet në aktivitetet e përpunimit;
- Rritja dhe përforsimi aftësisë për marrjen e masave në parandalimin dhe mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi. Gjithashtu përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe administrative të Qendrës Kombëtare të Analizës.
- Përforsimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e falsifikimit, duke formalizuar marrëveshje me autoritetet kompetente kombëtare dhe evropiane për këtë qëllim.
- Përafrimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ sipas kërkesave të legjislacionit të Bashkimit Evropian

II.4.1 Politika dhe kuadri ligjor

Në përputhje me Ligjin për Bankën e Shqipërisë, neni 40, Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për sekuestrimin dhe konfiskimin e kartëmonedhave të falsifikuara dhe të monedhave metalike.

Në këtë drejtim, Këshilli Mbikëqyrës miratoi dy Rregullore në vitin 2013:

- Rregullorja "Për kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara euro të falsifikuara dhe kartëmonedhave të tjera të huaja" me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.49, datë 31.07.2013;
- Rregullorja "Për kartëmonedhat dhe monedhat shqiptare të dyshuara si të falsifikuara" me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 41, datë 26.06.2013.

Rregullorja 1338/2001 / EC që përcakton masat e nevojshme për mbrojtjen e euros nga falsifikimi është pjesërisht i transpozuar në Vendimin nr.49, datë 31.07.2013 për miratimin e Rregullores "Për kartëmonedhat euro të dyshuara si të falsifikuara dhe të tjera monedha të huaja" nga Banka e Shqipërisë.

Rregullorja (BE) Nr. 1210/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 15 dhjetor 2010 lidhur me vërtetimin e monedhave euro dhe trajtimin e monedhave euro të papërshtatshme për qarkullim është transpozuar pjesërisht me Vendimin nr.81, datë 06.07.2016 për miratimin e Rregullores "Për kontrollin e autenticitetit dhe kriteret për rikrijimin e monedhave LEK", nga Banka e Shqipërisë

II.4.2 Institucionet përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë

II.3.3 Veprimet e planifikuara 2019-2021

II.3.3.1 Kuadri i Politikave të Planifikuara

II.3.3.2 Masat ligjore të planifikuara

- Rishikimi i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

II.3.3.3 Veprimet e tjera të planifikuara

J/D

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

në 000 lekë

Viti	2019	2020	2021
Buxheti i përgjithshëm për këtë kapitull i institucionit udhëheqës për 3 vitet e ardhshme.	0	0	0
Buxheti i përgjithshëm për këtë kapitull i institucioneve të tjera kontribuuese	2,520,471	2,520,471	0
Buxheti i përgjithshëm për kapitullin	2,520,471	2,520,471	0

Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore

I.1. Përmbajtja e kapitullit

I.1.1. Përmbledhje e acquis së BE-së

Ky kapitull përfshin rregulloret në lidhje me burimet financiare të nevojshme për financimin e buxhetit të BE-së ('burimet vetjake'). Këto burime përbëhen nga të ashtuquajturat burimet tradicionale vetjake nga detyrimet doganore dhe taksat për sheqerin. Një burim i bazuar në tatimin mbi vlerën e shtuar; dhe më në fund, një burim bazuar në të ardhurat bruto kombëtare (GNI) të çdo shteti. Duhet pasur kapacitet të nevojshme administrative për t'u bashkërenduar në mënyrë adekuate dhe për të siguruar llogaritjen e saktë, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e kontributeve të burimeve të tyre vetjake. Acquis në këtë fushë është drejtpërdrejtë e detyrueshme dhe nuk kërkon transpozim në legjislacionin e brendshëm.

I.1.2. Kërkesat sipas MSA-së

Neni 70 i MSA-së kërkon përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së, ku gjithashtu përfshihet dhe legjislacioni i BE për këtë kapitull.

I.2. Situata aktuale/ Përmbledhje

Shqipëria ka njëfarë niveli të përgatitjeje në këtë fushë. Njëfarë progresi është bërë në fushat kryesore të politikave që ndikojnë në funksionimin e sistemit të financimit të BE-së. Ky progres konsiston në zbatimin e Ligjit Organik të Buxhetit 2016, rregullin fiskal dhe vazhdimin e reformës së menaxhimit të financave publike. Ka pasur njëfarë progresi në fushat kryesore të politikave që ndikojnë në mënyrë indirekte sistemin e burimeve vetjake.

Shqipëria ka ngritur struktura për mbledhjen e detyrimeve doganore në pikat përkatëse doganore, operon sistemin kombëtar të TVSH-së si dhe llogaritjet kombëtare dhe vlerësimet e GDP dhe GNI bazohen pjesërisht në standardet e ESA 2010. Instituti i Statistikave ka marrë të gjitha masat e nevojshme për vlerësimin e burimeve jo-shteruese.

Ndryshimet në tatimin e pronës dhe bazën tatimore të TVSH-së të cilat u prezantuan në paketën fiskale të vitit 2018, pritet të përmirësojnë mbledhjen dhe menaxhimin e taksave si dhe rritjen e të ardhurave të përgjithshme tatimore.

I.3. Prioritetet

Në kontekstin e programimit buxhetor, qëllimi i qeverisë është përmirësimi i procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm dhe harmonizimi i plotë me dokumentet e tjera strategjike, si pjesë e koncepteve bazë të Sistemit të Planifikimit të Integruar. Në këtë kuadër, qeveria shqiptare në vitin 2014 miratoi një strategji të re për menaxhimin e financave publike. Reforma e menaxhimit të financave publike ndër të tjera synon të zhvendosë fokusin nga inputet në rezultate. Kuadri konceptual dhe ligjor për këtë qëllim është përcaktuar me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit të buxhetit në Republikën e Shqipërisë” (Ligji për buxhetin organik). Rishikimi i Ligjit të Buxhetit Organik u krye nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe u miratua nga Parlamenti në qershor 2016.

Ndërkohë, për të zbatuar në mënyrë adekuate reformën e menaxhimit të financave publike, me ndihmën teknike të BE-së (TA) e cila filloi misionin e tyre në fund të prillit 2017, filloi procesin e shqyrtimit të metodologjisë së përgatitjes së buxhetit. Metodologjia e re do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si do të përgatitet Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA), duke ndarë qartë financimin e politikave ekzistuese dhe nismave të reja të politikave. Mënyra e re e organizimit të procesit përmes ndarjes në dy faza të veçanta, strategjike dhe teknike, do të përmirësojë lidhjen e dokumentit të PBA-së me dokumentet strategjike dhe në të njëjtën kohë do të zbatojë procesin e përcaktimit dhe respektimit të tavanëve buxhetorë. Në të njëjtën kohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të jetë pjesë e procesit të strategjive të hartimit që shërben si një kundërparti për secilën Strategji, për ruajtjen e implikimeve financiare dhe garantimin e përfshirjes së tyre në dokumentin e PBA-së.

Në fokus është dhe zhvillimi i mëtejshëm i burimeve të brendshme, burimeve të cilat bazohen në tatimin mbi vlerën e shtuar si dhe i burimeve që lidhen me të ardhurat e brendshme bruto. Standardet e ESA 2010 do të zbatohen më tej për të plotësuar boshllëqet e statistikave vjetore. Një informacion më i zgjeruar rreth zhvillimeve në fushën e statistikave dhe sidomos në fushën e Llogarive Kombëtare dhe qasjes ndaj standarteve ESA2010, mund ta gjeni në kapitullin 18”Statistikat”.

Në lidhje me infrastrukturën administrative, Shqipëria duhet të punojë për ngritjen e institucioneve përkatëse, organit koordinues dhe rregullave të zbatimit në mënyrë që të jetë në gjendje që të llogarisë, parashikojë, grumbullojë, paguajë, kontrollojë dhe raportojë në BE në mënyrë korrekte mbi burimet vetjake në përputhje me acquis.

II.1. Burimet vetjake tradicionale

II.1.1 Kuadri politik dhe ligjor

Veprimtaria e buxhetimit në Shqipëri rregullohet nëpërmjet Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin 57/2016, datë 02.06.2016, i cili ka si objekt kryesor përcaktimin e procedurave për buxhetimin si dhe evidentimin e rolit të institucioneve në kuadër të procesit të buxhetimit. Ky ligj është hartuar duke u bazuar në praktikat më të mira të sistemit të menaxhimit të buxhetit. Duke filluar nga viti 2010, nën zbatimin e këtij ligji, procesi i planifikimit të buxhetit afatmesëm (PBA) është zbatuar në të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre. Objektivi kryesor i ligjit të mësipërm është përmirësimi i procedurave të buxhetimit nëpërmjet forcimit të lidhjes mes politikave dhe buxhetit si dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore.

Aktet të tjera ligjore kryesore për këtë kapitull përfshijnë:

- Ligjin nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pjesërisht në përputhje me Direktivën 2006/112/EC e 28 Nëntorit 2006 mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar;
- Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i cili hyri plotësisht në fuqi në Qershor 2017 duke transpozuar Rregulloren Nr. 952/2013 , si dhe disa akte të tjera të BE-së;
- Ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky ligj është pjesërisht i përafëruar me aktet të BE-së dhe administrohet nga doganat.

Sa i përket Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, është përditësuar në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave Evropiane 2018 dhe është miratuar me VKM Nr. 799, datë 29.12.2017 “Mbi miratimin dhe publikimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2018”.

Për informacione të mëtejshme, lutemi referohuni në Kapitullin 16 dhe Kapitullin 29.

II.1.2. Institucionet përgjegjëse

Institucioni Kryesor për këtë kapitull është Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Strukturat kontribuuese janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
- INSTAT

II.1.3. Masat e parashikuara 2019-2021

II.1.3.1. Kuadri i politikave të parashikuara

N/A

II.1.3.2. Masat ligjore të parashikuara

N/A

III. Alokimet financiare

III.1. Buxheti

Viti	2019	2020	2021
Buxheti i përgjithshëm për këtë kapitull i institucionit udhëheqës për 3 vitet e ardhshme.	0	0	0
Buxheti i përgjithshëm për këtë kapitull i institucioneve të tjera kontribuuese	0	0	0
Buxheti i përgjithshëm për kapitullin	0	0	0